

MUJORI

Përzgjedhje

I

Shtator - Tetor - Nëntor

Përktheu
Atë Justini
në Malin e Shenjtë

Botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë
Tiranë, 2009

Parathënie

"Është shum' e rëndë t'endim lavdërim,
por sa i madh është malli ynë"!

Kështu këndon himnshkruesi i madh Joan Damaskinoi (në Irmosin jambik të Odes IX të Krishtlindjeve). Sot, nevoja për pasurimin e adhurimit në Kishën tonë është kolosale. Me keqardhje mund të themi se ka shumë mangësi. Mjafton të themi se çdo ditë, madje edhe të premten, lexojmë dhe këndojmë himnologjinë e së dielës që kaloi. Por e premtja është ditë zie, dita e kryqëzimit, ndërsa e diela ditë gëzimi, dita e Ngjalljes. Me të vërtetë, jemi Kisha e Ngjalljes, që u ngjall pas periudhës së monizmit, por jo deri në këtë pikë!

Himnologjia Orthodhokse është një thesar gjigant dhe madhështor. Shërbesat tona bëhen shpesh shkak që të krishterë të tjerë të vijnë brenda Kishës.

Le të kujtojmë këtu se etimologjikisht fjala "kulturë" vjen nga fjala "kult", pra qytetërimi gjithmonë bazohej dhe duhet të bazohet në adhurimin e Perëndisë. Edhe poezia kishtare është padyshim kulturë.

Pra Himnologjia, madje e kombinuar me Muzikën Bizantine të mahnitshme dhe qiellore, përveç lavdërimit të shenjtorëve, është dhe komentimi artistik i dogmës dhe i moralit të Orthodhoksisë. Analizon dhe e bën më të pranishëm Shkrimin e Shenjtë; aq më tepër që atë e kompozuan gjatë shekujve himnografë të shenjtëruar, që nuk bënin thjesht një punë rutinë, por shfaqnin përjetime dhe besime personale me shpirt të zjarrtë. Është e pamundur të mos thuash që vepra e tyre nuk ka një dozë hyjfrymëzimi.

Përpjekja jonë, me hirin e Perëndisë dhe të shenjtorëve që përfshihen këtu, fillon me të kremtet e mëdha të palëvizshme të vitit, në të cilat marrin pjesë bashkërisht besëmirët. Pra kemi bërë një koleksionim, një përzgjedhje.

Me bekimin e Perëndisë, kur të mbarojë cikli i motit, shpresojmë dhe urojmë që të ketë dhe "Plotësimi"-n, me festa më të vogla, aq sa të ekzistojë periudha vjetore e plotë. Natyrisht, paralelisht me to ka dhe festa të lëvizshme, si edhe

shërbesat për çdo ditë të javës në 8 tinguj – një tjetër fushë e shkëlqyer. Le të lutemi pra, që Zoti të aftësojë njerëz për këtë punë shumë të rëndësishme dhe jetike, por dhe mjaft të vështirë.

Atë Justini
11 gusht 2008
Në të kremten e martirit të shenjtë Efpli, dhjak dhe të shën Nifonit, patriarkut të Konstandinopojës, vëllamit të Gjergj Kastriotit.

* * *

Udhëzime

* Kjo punë e rëndësishme dhe e domosdoshme nuk ishte aspak e vështirë nga ana e përkthimit. Vështirësia qëndron në përshtatjen e metrit ("tonik") muzikor. Pothuajse e tërë Himnologjia është poezi, një pjesë shumë e vogël e saj është prozë. Dhe ne u përpoqëm që të mos improvizojmë, por të jemi shumë të saktë, besnikë në përkthim, gjë aspak e lehtë, siç është e kuptueshme. Disa Irmose, që ekzistonin që më parë, edhe pse paksa problematike, i lamë pa korrigjim, meqenëse janë mjaft të njohur. Përshtatëm poetikisht vetëm Gjysmëodet e Kanuneve, sepse të tjerat në përgjithësi nuk psalen as në manastire. Në enoritë, Kanunet zakonisht lexohen, me përjashtim në rastet e festave të mëdha Dhespotike dhe Hyjlindësoreve. [Shumë pak Irmose që duhej të kishin yje (*), por nuk kanë, nënkuptohet se nuk ekzistojnë në Irmologjitë klasike.] Në përgjithësi u përshtatën vetëm Irmoset që psalen.

* Troparet që ekzistonin të përkthyera që më parë, janë shënuar me një yll të kuq (*) në fund.

* Në Leximet biblike të Dhiatës së Vjetër **i lëmë qëllimisht, me vetëdije gabimet letrare që ajo ka,** sepse respektojmë prototipin, përkthimin e «të Shtatëdhjetëve» i bërë nga hebrejtë. Vetëm në pak raste, atje ku teksti është i ndërlikuar, e qartësojmë. Kisha me plot urtësi e përdor për dy mijë vjet, megjithëse ka gabime të shumta. Ajo veproi kështu me shumë mençuri për arsye të cilat nuk mund t'i përshkruajmë këtu.

Nga ana tjetër, Etërit e Kishës, kur përdorin citime biblike iu referohen aspekteve të ndryshme të pasazheve të paqarta. Nëse ne do t'i sqaronim pikat e paqarta duke zgjedhur një nga variante e përkthimit, nëse me pas do të shihnim se një Atë interpreton ndryshe një varg të caktuar, do të çuditeshim se ku e ka gjetur këtë Ai.

* Yjet në tekstin e himneve – një taktikë e vjetër – e ndihmojnë fuqishëm psaltin në performimin e melodisë, sepse siç u përmend më lart, adhurimi ynë është poetik, d.m.th. ka disa tropare që shërbejnë si modele, diçka si kallëp, në bazën e të cilave psalen një mori himnesh. Atje ku nuk ka yje, kuptohet që teksti është prozë.

* Në këtë vepër kemi sjellë një risi; me sa dimë, nuk është bërë askund deri tani në Himnologjinë Orthodhokse. U përpoqëm të nxjerrim në pah vargje biblike dhe t'i shtojmë citimet në fund të çdo feste. Edhe kjo s'është një punë e lehtë. Cituam vargjet që nuk janë aq shumë të njohura ose nuk zbulohen kalimthi, me një sy sipërfaqësor. Gjithashtu nuk japim të gjitha citimet, sepse atëherë do të ngarkohej shumë teksti pa qenë nevoja, pasi himnet bazohen në Shkrimet e Shenjta.

Por kujdes: Mund të ndodhë që vargu poetik të mos përputhet plotësisht me vargun biblik. Kjo shpjegohet nga tre stadet e mëposhtme:

a. Përkthimi në shqip i tekstit hyjnor nga origjinali në greqisht, pa diskutim, si çdo përkthim në një gjuhë tjetër, sjell një ndryshim, qoftë edhe të lehtë.

b. Përshtatja nga ana e himnshkruesit në tekstin e tij poetik, shpesh krijohet një farë modifikimi.

c. Shqipërimi i tekstit himnologjik origjinal (në greqisht), shkakton pa dyshim ndryshim, dhe

d. Përshtatja me metrin ("tonik") muzikor.

Pra, pas këtij zinxhiri përpunimesh, në formën përfundimtare është e kuptueshme që të mos ketë ngjashmëri të plotë.

* Duke ditur se vargjet para himneve janë pothuajse gjithmonë psalmike, nuk i citojmë.

* Në Irmoset e Kanuneve nuk këmbëngulim në citime, sepse çdo Ode i kushtohet një shenjtori, ndaj është e lehtë të gjendet referenca si më poshtë: Ode I: e profetit Moisi (Gjen. kap.15); Ode II: përsëri e Moisiut (Ligji i Dytë 32.1-47); Ode III: e profeteshës Ana (I Mbret. [Sam.] 2.1-10); Ode IV: e profetit Abakum (kap.3); Ode V: e profetit Isaia (26.9-20); Ode VI: e profetit Jona (2.3-10); Ode VII dhe Ode VIII: e Tre Djemve (Dan. kap.3 Lutja e Azariut); dhe Ode IX: e Perëndilindëses (Lluk. 1.47-55; me të bashkohet edhe lutja e Zaharias: Lluk. 1.68-79).

* Në disa botime të Dhiatës së Vjetër, mundet që numërimi i vargjeve të mos jetë i përpiktë, por të lëvizë një numër më para ose më poshtë.

* Për sa i përket vargjeve të Lavdërimeve: Të dielën, kur psalen (të 8-ta) Lavdërimet ngjallësore, fillojmë nga *Kjo lavdi do të jetë*. Në ditët e zakonshme, kur ka (në përgjithësi) 4 Lavdërime, fillojmë nga *Lavdërojeni për fuqitë e tij*. Të dielën bashkë me festën (d.m.th. kur psalim 4 Lavdërime ngjallësore dhe 4 të së kremtes) fillojmë nga *Kjo lavdi do të jetë*, por në vend të dy vargjeve të fundit, themi vargjet e Pasvargjeve të Mbrëmësores së festës.

* Tek mbylljet e festave Dhespotike dhe Hyjlindësoreve, shërbesa psalet njëlloj si në ditën kryesore, me përjashtime si më poshtë:

Në Mbrëmësore nuk lexohet Qëndrimi i Parë i Psaltirit (por Kathizma e ditës). - Nuk lexohen Leximet. Në Mëngjesore nuk psalet Litia. - Nuk psalet Polielei dhe Ndenjësoret pas tij. - Nuk lexohet Ungjilli i Mëngjesit (dhe rendi i tij). – Lexojmë Sinaksarin e ditës (jo të së kremtes).

Në Liturgji, lexojmë Apostullin dhe Ungjillin e radhës (jo të së kremtes).

* Fjalët në *italik të kuqe* nuk lexohen, as nuk psalen; janë udhëzime.

Nga sa thamë më lart, marrja përsipër e kësaj pune ndoshta ishte një përpjekje e "guximshme", por nga hiçi është më mirë diçka me mangësi. Le të na ndjejnë shenjtorët për dobësitë tona.

O shenjtorë të Perëndisë, ndërmjetoni për ata që bashkëpunuan me shpirt dhe u lodhën për himnimin tuaj, dhjak Anastasin, Donikën, Rozetën dhe Elenin, si dhe për ata që ju himnojnë.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin

Lejohet kopjimi i citimeve biblike, mjafton vetëm referimi i burimit.
Ἐπιτρέπεται ἡ ἀντιγραφή τῶν βιβλικῶν παραπομπῶν μέ μόνη τήν ἀναφορά τῆς πηγῆς.
Copyrighting of biblical quotes are permitted; it is necessary only to reference the source.
Можно выписать из текста только цитаты из библии.



MUAJI SHTATOR

QË KA 30 DITË

1 SHTATOR

Fillimi i Indiktit, d.m.th i Vitit të Ri dhe kujtimi i atit tonë oshënar Simeon Stilitit dhe arkimandrit; Mbledhja e Hyjlindëses së Tërëshenjtë të Miasinëve; kujtimi i martirit të shenjtë Aithalá; i dyzet grave të shenjta dhe i Amun dhjakut, mësuesi i tyre; i martirëve të shenjtë Kalista dhe i vëllezërve të saj Evodhit dhe Ermogjenit; i Jisuit të Naviut si dhe kujtimi i zjarrit të madh.

Tipikon

Në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Trishenjti. Përlëshorja e Indiktit.

Në Liturgji, pas Hyrjes, Përlëshoret: e Indiktit, e Hyjlindëses, e oshënarit, e shenjtit të kishës. Kontaqi i Indiktit.

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 Vargëzime ngjallësore, 3 të Indiktit dhe 3 të oshënarit (At' oshënar). Lavdi i Indiktit (O Fjalë pa nisje). Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i oshënarit (At' oshënar). Tani i Indiktit (Ti, o mbret). Përlëshoret: ngjallësore, e Indiktit, e Hyjlindëses (Gëzohu, o e hirshme).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik dhe Himnet Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e Indiktit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësorja e Indiktit (Para teje biem ne) 2 herë. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat e tingullit dhe Proqimeni. Kanunet: ngjallësor dhe i Indiktit me varg "Lavdi ty, o Pe-

rëndia ynë…". Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Ndenjësorja e oshënarit (Me një zemër). Lavdi dhe Tani i Indiktit (Para teje biem ne). Pas Odes VI, Kontaqi, Shtëpia e Indiktit dhe Sinaksari. Zbritësoret Një kryq vijosi; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e oshënarit dhe e Indiktit. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe të Indiktit të Mbrëmësores (Duke mësuar për lutjen) në 4 (d.m.th. duke përsëritur të parën). Lavdi i Indiktit (Ti që me urtësi). Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të Indiktit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Indiktit, e Hyjlindëses (Gëzohu, o e hirshme), e oshënarit dhe e shenjtit të kishës. Kontaqi i Indiktit. Apostulli dhe Ungjilli i Indiktit. Kungatore e Indiktit.

NË MBRËMËSORE

Pas Qëndrimit së parë të Psaltirit (Lum ai njeri), në Thirrtoret psalim 10 tropare

E Indiktit
Ting. I Ton uranion tagmaton

Duke mësuar për lutjen e Zotit, që e dha* pra në mësimin e tij* absolut dhe hyjnor krejt,* çdo dit' le t'i th'rrasim Krijuesit:* Ati ynë që në qiejt je,* duke harruar mëkatet që bëjm' ne,* jepna bukën e përditëshme.

Si ish e drejt' u rrëzuan këmbë hebrenjsh dikur* atje në shkretëtirë,* sepse s'bënin dot bindje* para teje, o Zot, k'shtu dhe tani,* si thon' Psalmet, shpërnda në Hadh,* kockat e gjith' agarinëve të pabes'* e të egër si dhe kryelart'.

Ti që në Malin Sina pllakat shkrove krejt dikur* dhe tash me trup e mish tok,* brenda pra Nazaretit* libër profetik pranove, o Krisht,* të lexosh, Perëndia yn';* pasi e mbylle, mësoje popujt qart' se* u përmbush Shkrimi i Shenjt' në ty.

E oshënarit
Ting. Tërth. I Ósie pater

At' oshënar, një shkall' të mirë ke zbuluar ti,* u ngjite si Ilia me qerre zjarri me k'të;* por ngjitjen ai s'e ka lën' për të tjerët,* ndërsa ti shtyllën e ke dhe pas vdekjes;* ti njeri q'ellor je,* edhe një engjëll tok'sor* edhe ndriçues i pafjetur,* që po shkëlqen botën, edhe e udhëheq;* mburrje për Kishën je,* veçanërisht për murgjit,* o Simeon, at' oshënar* i madh, i famshëm;* të lutemi të ndërmjetosh pran' Zotit ton' Krisht* të dhurojë te Kisha e tij* bashkim mendjesh dhe paqe, shpëtim shpirtrash me hir.

At' oshënar, nëse do ish e mundur të kishte* një gojë shtylla, nuk do pushonte së foluri;* do th'rriste lodhjen, luftrat dhe vajtimin tënd;* shtylla po mbahej më fort nga ç'mbante pra,* si pem', që me lotët* e tu po plehërohej;* u shtangën engjëjt në qiejtë* dhe u çuditën shum' njer'zit mbi dhé, gjithkund* demonët kishin frik'* para durimit tënd, at';* o Simeon, shenjt, oshënar i madh, i famshëm,* të lutemi të ndërmjetosh pran' Zotit ton' Krisht* të dhurojë te Kisha e tij* bashkim mendjesh dhe paqe, shpëtim shpirtrash me hir.

At' oshënar, ke imituar Zotin tënd Jisu,* u ngjite si në kryq ti në shtyllën tënde, o shenjt'* me forcën dhe fuqin' prej Frymës së Shenjtë;* por ai shuajti kontratën tonë,* ndërsa ti shfarose* revoltën e pasionit;* ai ka qenë porsi dele,* por edhe ti ke qen' për atë si flijim;* ai u ngjit në kryq,* por ti u ngjite në shtyll',* o Simeon, at' oshënar i madh, i famshëm;* të lutemi të ndërmjetosh pran' Zotit ton' Krisht* të dhurojë te Kisha e tij* bashkim mendjesh dhe paqe, shpëtim shpirtrash me hir.

Idhiomele të tjera të oshënarit
Ting. II

Nga rrënjë e mirë doli fryt i mirë, Simeoni i hyjshëm, i cili që nga foshnjëria u ushqye me hir më tepër sesa me qumësht; dhe duke lartësuar trupin mbi gur dhe duke lartësuar akoma më shumë mendjen drejt Perëndisë, ndërtoi një shtëpi në ajër nëpërmjet virtyteve dhe duke fluturuar bashkë me Fuqitë e hyjnueshme, u bë banesë e Krishtit,[1] Perëndisë dhe Shpëtimtarit të shpirtrave tanë.

I njëjti

Kujtimi yt mbetet përjetë,[2] o atë oshënar Simeon, si edhe butësia e zemrës sate, o shërbyes i lumur; se edhe pse u shpërngule nga ne, o bari i mirë, nuk u largove nga ne shpirtërisht, duke qëndruar pranë Perëndisë me dashuri dhe duke kërcyer bashkë me engjëjt në qiej, me të cilët përgjëroju që të shpëtohen shpirtrat tanë.

I njëjti I Qiprianit

Kutia e lipsaneve të tua, o atë i tërëfamshëm, buron shërime dhe shpirti yt i shenjtë, duke qenë bashkë me engjëj ngazëllohet denjësisht; ndaj duke kërcyer bashkë me të patrupët në qiell dhe duke pasur guxim tek Zoti, o oshënar, përgjëroju atij që të shpëtohen shpirtrat tanë.

I njëjti I Gjermanoit

E deshe, o hyjprurës, filozofinë e epërme dhe ike jashtë botës, duke

jetuar më lart se ato që duken; u tregove pasqyrë e hyjshme, e panjollshme e Perëndisë dhe duke u bashkuar gjithmonë me dritë, merrje dritë dhe arrite me fuqi në fundin e lumtur; ndërmjeto për shpirtrat tanë, o Simeon i urtë.

Lavdi *Ting. Tërth. II*
I Gjermanoit

Hiri i shenjtë qëndronte mbi kutinë e lipsaneve të tua, o Simeon i shenjtëruar; prandaj do të vrapojmë tek era e miros[3] së çudive të tua për të marrë shërimin e sëmundjeve; pra, o atë oshënar, përgjëroju Krishtit Perëndisë për shpirtrat tanë.

Tani *I njëjti I Bizantit*

O Fjalë pa nisje dhe Bir, që je i bashkuar me Shpirtin e Shenjtë, që je bashkëbërësi i Gjithësisë dhe bashkëkrijuesi i të gjitha gjërave të dukshme dhe të padukshme, bekoje kurorën e vitit,[4] duke ruajtur në paqe tërësitë e orthodhoksëve me ndërmjetimet e Perëndilindëses dhe të gjithë shenjtorëve të tu.

Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës dhe Leximet.*

Këndimi i profecisë së Isaisë
(61.1-10)

Shpirti i Zotit *është* mbi mua, për shkak të të cilit më leu; më ka dërguar që të ungjillëzoj të varfrit, të shëroj ata që janë të dërrmuar në zemër, t'u shpall robërve çlirim dhe të verbërve rishikim, të shpall një vit të Zotit të pranueshëm dhe dite shpagimi nga Perëndia ynë; të ngushëlloj gjithë sa janë në zi, që t'u jepet atyre të Sionit që janë në zi, lavdi në vend të hijes, lyerje ngazëllimi tek ata që janë në zi, prehje lavdie në vend të shpirtit të paralizuar dhe do të quhen gjeneratë drejtësie, mbjellje Zoti për lavdi. Dhe do të ndërtojnë shkretëtira shekullore, të shkretuara më parë; do të ngrihen dhe do të përtërijnë qytete të shkreta, të shkretuara nga brezi në brez. Dhe do të vijnë të huaj duke kullotur dhentë e tua dhe nga fise të tjera për lërim dhe vreshtarët tuaj. Ndërsa ju do të quheni priftërinj të Zotit, shërbëtorë të Perëndisë tonë. Do t'ju thuhet: Do të nginjeni me fuqi kombesh dhe në pasurinë e tyre do të admiroheni. Në vend të turpit tuaj të dyfishtë dhe në vend të poshtërsisë, do të ngazëllohet pjesa e tyre. Prandaj tokën e tyre do ta trashëgojnë për së dyti dhe hare e përjetshme *do të jetë* mbi kryet e tyre. Se unë jam Zoti që dua drejtësi dhe urrej rrëmbime nga padrejtësia. Dhe do t'u jap të drejtëve lodhjen e tyre dhe dhiatë të përjet-

shme do të vë për ata. Dhe do të bëhet e njohur ndër kombet fara e tyre dhe paraardhësit e tyre midis popujve. Dhe ai, i cili i shikon do t'i njohë, se këta janë farë e bekuar në jetë nga Perëndia dhe me gëzim do të ngazëllohen në Zotin.

Këndimi i Levitikut
(26.3-10 dhe përzgjedhje)

Zoti u foli bijve të Izraelit duke thënë: Në qoftë se do të ecni në urdhëresat e mia dhe porositë e mia do t'i ruani e do t'i zbatoni, do të jap shiun në kohën e tij dhe toka do të japë prodhimet e saj dhe pemët e fushave do të japin si shkëmbim frytin e tyre. Dhe do të kapë shirja vjeljen dhe vjelja do të kapë farën. Dhe do të hani bukën tuaj deri në ngopje dhe do të banoni me siguri në tokën tuaj dhe nuk do të ketë kush t'ju frikësojë. Dhe do të shfarosë egërsira nga toka juaj dhe lufta nuk do të kalojë përmes tokës suaj. Dhe do të bien armiqtë tuaj përballë jush. Dhe pesë nga ju do të ndjekin njëqind dhe njëqind nga ju do të ndjekin mijëra e mijëra. Dhe do të shtie syrin mbi ju dhe do t'ju bekoj, dhe do t'ju shumoj, dhe do t'ju shumëfishoj dhe do të vendos dhiatën time me ju. Dhe do të hani të vjetra dhe të vjetrat e të vjetrës dhe do të nxirrni të vjetrat para faqes së të rejave. Dhe shpirti im nuk do t'ju neveritë. Dhe do të shëtis në mes tuaj dhe do të jem Perëndia juaj, dhe ju do të jeni për mua populli im. Por nëse nuk do të më dëgjoni, as nuk do të bëni këto urdhëresat e mia dhe nuk do t'iu bindeni atyre dhe gjykimet e mia do t'i neveritë shpirti juaj, që të mos bëni gjithë porositë e mia, edhe unë do t'ju bëj kështu: Do të vendos mbi ju qorrsokakun dhe do t'i mbillni kot farërat tuaja dhe kundërshtarët tuaj do të hanë mundimet tuaja. Dhe do të fiksoj fytyrën time mbi ju dhe do të rrëzoheni përballë armiqve tuaj dhe do t'ju ndjekin dhe do të ikni edhe pa ju ndjekur kush. Dhe do të dërrmoj arrogancën e kryelartësisë suaj. Dhe do t'jua vendos qiellin si prej hekuri dhe tokën si prej bakri. Dhe do të jetë e kotë fuqia juaj dhe toka juaj nuk do të japë farën e saj dhe pemët e arës nuk do të japin frytin e tyre. Dhe do të dërgoj kundër jush bishat e egra të dheut dhe do të konsumojnë kafshët tuaja dhe thika që do ecë në mesin tuaj, do t'ju pakësojë. Dhe toka juaj do të jetë e shkretë dhe vilat tuaja do të jenë të shkreta. Meqë ju ecni drejt meje tërthorazi, edhe unë do eci drejt jush me zemërim tërthor, thotë Zoti Perëndia, Shenjti i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(4.7-15)

I drejti, nëse do të arrijë të vdesë, do të jetë në prehje; se pleqëria e çmuar nuk *është* pleqëria shumëvjeçare, as u mat me numër vitesh. Dhe thinjat janë mençuri tek njerëzit dhe mosha e pleqërisë *është* jetë e panjollosur. Meqë u bë i pëlqyeshëm te Perëndia, u dashurua dhe ndërsa jetonte në mes mëkatarësh, u transferua. U rrëmbye, që e keqja të mos ndryshojë mençurinë e tij ose dinakëria të mos mashtrojë shpirtin e tij. Sepse joshja e së keqes, errëson të mirat dhe ëndja e dëshirimit e ndryshon mendjen e patëkeq. Duke u përsosur në pak kohë, mbushi vite të gjata. Se shpirti i tij ishte i pëlqyeshëm në Zotin, prandaj vrapoi nga mesi i ligësisë. Por popujt duke parë dhe duke mos kuptuar, as duke mos vënë në mendje një gjë të tillë; se hir dhe përdëllim *ka* në oshënarët e tij dhe mbikëqyrja është në të zgjedhurit e tij.

Pasvargje Idhiomele të Indiktit
Ting. I I Joan Monakut

Arriti hyrja e vitit, duke i ftuar gjithë ata që e madhështojnë të lavdërojnë Kalistën, Evodhin dhe Ermogjenin, vëllezërit atletë; Simeonin e barabartë me engjëjt; Jisuin e Naviut; të shtatë Djemtë në Efes dhe korin si dyzet pishtarë të grave të shenjta. Duke marrë pjesë në kujtimet e tyre, o miq të të kremteve, le të thërrasim vazhdimisht: O Zot, bekoi veprat e duarve të tua dhe vlerësona që të përfundojmë me fitim periudhën e vitit.

I njëjti I të njëjtit

Varg: Ty të ka hije himn, o Perëndi, në Sion.

O Krisht Perëndia ynë, që i bëre të gjitha me urtësi dhe që i solle nga mosqenia në qenie, bekoje kurorën e vitit[4] dhe qytetin tonë ruaje të parrethuar nga armiqtë; ndërsa mbretërit tanë besnikë dëfreji me fuqinë tënde, duke u dhënë fitore kundër armiqve dhe duke i dhuruar botës nëpërmjet Hyjlindëses mëshirën e madhe.

Ting. II I Qiprianit

Varg: Do të mbushemi në të mirat e shtëpisë sate.

I çuditshëm je, o Perëndi, dhe të çuditshme janë veprat e tua[5] dhe të pagjurmësuara udhët e tua;[6] se je urtësia e Perëndisë dhe hipostazë e përsosur, dhe fuqi dhe bashkëpunim i bashkëpafillim dhe i bashkëpërjetshëm; pra me pushtet të tërëfuqishëm erdhe në botë në mënyrë të pashprehur nga nënë që nuk njohu burrë, duke mos ndryshuar përsa i takon hyjnisë, duke kërkuar Krijesën që zbuku-

rove, duke vendosur kufij dhe motet për shpëtimin tonë, o i pandryshueshëm; për këtë të thërrasim: O Zot i mirë, lavdi më ty.

I njëjti I Joan Monakut

Varg: Bekoje kurorën e vitit të mirësisë sate, o Zot.

Ti që i krijove të gjitha me urtësi, o Fjalë e parajetshme e Atit, dhe që e sistemove të gjithë Krijesën me fjalën tënde të tërëfuqishme, bekoje kurorën e vitit[4] të mirësisë sate dhe rrëzoi herezitë nëpërmjet Perëndilindëses, si i mirë dhe njeridashës.

Lavdi *Ting. Tërth. I*
Ósie pater

At' oshënar, një shkall' të mirë ke zbuluar ti,* u ngjite si Ilia me qerre zjarri me k'të;* por ngjitjen ai s'e ka lën' për të tjerët,* ndërsa ti shtyllën e ke dhe pas vdekjes;* ti njeri q'ellor je,* edhe një engjëll tok'sor,* edhe ndriçues i pafjetur,* që po shkëlqen botën, edhe e udhëheq;* mburrje për Kishën je,* veçanërisht për murgjit,* o Simeon, at' oshënar* i madh, i famshëm;* të lutemi të ndërmjetosh pran' Zotit ton' Krisht* të dhurojë te Kisha e tij* bashkim mendjesh dhe paqe, shpëtim shpirtrash me hir.

Tani *I njëjti I Joan Monakut*

Ti, o mbret, që je dhe që mbetesh edhe në shekuj pa fund, prano përgjërim mëkatarësh që kërkojnë shpëtim dhe jepi tokës sate pjellori, o njeridashës, duke dhuruar erëra të përziera mirë; bashkëlufto me mbretin shumë shpresëtar kundër barbarësh të pabesë si dikur me Davidin; se erdhën ata në tendat e tua dhe vendin e tërëshenjtë e përdhosën;[7] por ti dhuro fitore, o Krisht Perëndi, me ndërmjetimet e Hyjlindëses, se ti je fitorja dhe mburrja e orthodhoksëve.

Përlëshore
E Indiktit Ting. II

O Krijues i çdo krijese, ti që vendose kohëra dhe vite nën pushtetin tënd,[7a] bekoje kurorën e vitit të mirësisë sate, o Zot,[4] duke ruajtur në paqe mbretërit dhe qytetin tënd me ndërmjetimet e Hyjlindëses dhe shpëtona.

Lavdi *I oshënarit Ting. I*

U bëre shtyllë durimi duke patur zili stërgjyshërit, o oshënar, Jovin në pësimet, Josifin në ngasjet dhe sjelljen e të patrupëve, edhe pse ishe në trup; o Simeon, ati ynë oshënar, ndërmjeto te Krishti Perëndi, të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *I Hyjlindëses Ting. i Rëndë*

Gëzohu, o e hirshme Hyjlindëse Virgjëreshë, liman dhe mbrojtje e gjindjes së njerëzve, sepse nga ti u mishërua Çlirimtari i botës, se ti vetëm je nënë dhe virgjëreshë gjithmonë e bekuar dhe e lavdëruar; ndërmjeto te Krishti Perëndi, që t'i dhurojë botës mbarë paqe.

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësore e Indiktit
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Ti o Zot, që nga qielli jep mbi dhé* shira, kohë frytdhënëse[8] me bollëk,* kërkesat që bëjmë ne* shërbëtorët e tu, prano,* edhe nga çdo nevojë çliroje qytetin tënd,* se dhembshurit' e tua mbi çdo punë tënde jan';*[9] pra duke bekuar hyrjet tona dhe daljet*[10] dhe punët e duarve,* na drejto[11] në sukses gjithmon'* dhe dhurona* ti ndjes' fajesh,* se si Krijimtar që je ti,* e solle me fuqin' tënde* botën të gjith'* në të qenë nga e mosqena, o Perëndi.

Lavdi *dhe* Tani *I njëjti*

Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësore e oshënarit
Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Vet'përmbajtja të kish zbukuruar jetën shum'* dhe duke vrarë, o at', trupin, asgjësove plot'sisht* sulmet e armikut kundër teje, o i lum,* dhe për te Zoti shkove drejt,* për në botën e përjetshme si trash'gimtar i denjë;* ndërmjeto pra ti vazhdimisht, që të përdëllehen shpirtrat tan' me mëshir'.

Lavdi *I martirëve*

Ting. IV Tahí prokatálave

Kalista, u fute pra në stadium me shum' bes'* për martirizim dhe k'shtu e predikoje me v'llezërit e tu Krishtin ton';* me dashuri i rrite* dhe i bëre si enë* të vyer dhe mendore ti për Kishën e Zotit;* me ta u bashkove pra në jetën e sipërme.

Tani *Hyjlindësore I ngjashëm*

O Zonjë, prano shum' shpejt lutjet që po të ofrojm'* dhe k'to i blato te Biri yt edhe Perëndia, o e panjollëshme;* çdo vështir'si të njer'zve* që vrapojn' tek ti zgjidhe;* kurthet dhe arrogancat e armiqëve tanë,* që po armatosen, ti shpërndaji, Hyjlindëse.

Pas Polieleit,
Ndenjësore e Grave të shenjta
Ting. I Ton tafon su Sotír

O shqerra me logjik',* u blatuat te

Qengji,* që është dhe barí* përmes martirizimit,* k'shtu udhën e mbaruat ju*[12] dhe besimin e mbajtët prap';* ndaj me gaz të madh* kujtimin tuaj të shenjtë* lavdërojmë sot* dhe madhërojm' të gjith' Krishtin,* o të admirueshme.

Lavdi *dhe* Tani

I Indiktit
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Para teje biem ne,* sepse je Zoti i Gjith'sis',* dhënës i të mirave* edhe thërrasim besërisht:* O Shpëtimtar, zbutu fal' mirësisë sate,* me uratat e nënës sate, o Krisht,* dhe të të pëlqyerve pran' teje;* dhe denjësona ne që të nderojm' ty* në dy substanca që je me bes',* dhe të lëvdojmë,* që të ofrojmë* vit të mir'pritur nga ti.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Ungjilli i oshënari. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e oshënarit. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II

Ti që i krijove të gjitha me urtësi, o Fjalë e parajetshme e Atit, dhe që e sistemove të gjithë Krijesën me fjalën tënde të tërëfuqishme, bekoje kurorën e vitit[4] të mirësisë sate dhe rrëzoi herezitë nëpërmjet Perëndilindëses, si i mirë dhe njeridashës.

Kanune
Ode I
Kanuni i Indiktit
I Joan Monakut
Ting. I
Irmosi: Ásomen pantes laí

»Le të këndojm' për atë, o popuj, që »çliroi* Izraelin nga rob'ria e hidhur »shum'* edhe në fund të detit e çoi »pa iu lagur këmba krejt.*[12a] Fitoren »e tij këndojm', se u lëvdua fort.

Le t'i këndojm' Krishtit, se me të u bën' të gjitha*[12b] dhe qëndrojn' të parrëzueshme, se u mboll* nga Ati, Perëndia i pafillim; Fjala është' pra person.* Fitoren e tij këndojm', se u lëvdua fort.

Le t'i këndojm' Krishtit, se me mir'pëlqim të Atit* na u shfaq nga Virgjëresha dhe shpalli vit,* që është i mir'pritur[12c] prej Zotit për çlirim nga çdo mëkat.* Fitoren e tij këndojm', se u lëvdua fort.

Kur erdhi në Nazaret ai që kish dhën' Ligjin,* pra në ditën e së shtunës, jepte[12c] mësim,* u jepte ligj hebrenjve rreth ardhjes së tij të pashprehëshme;* me k'të i mëshirëshmi na e shpëton gjinin'.

Hyjlindësore

Le t'i këndojm', o besnikë, Vajzës së mahnitshme,* që për botën lindi diellin, Zotin Krisht.* E mbushi Gjithësin' me haren' e jetës së përjetëshme.* Gjithmon' të këndojm', o Zonj', se u lëvdove fort.

Kanuni i Grave të shenjta, që ka Akrostihidhë: "Psal mundimet e grave të forta martire".

Ting. IV Anikso to stoma mu

Martire, luftuat fort dhe e rrëzuat armikun ton'* përmes asketizmit dhe së dyti me ndeshje krejt* të përgjakëshme,* prandaj kujtimin tuaj* ne e madhërojmë me besë dhe me gëzim.

Kan' ndjekur tër' gjurmët e atij,[12d] i cili denjoi kryq* dhe vdekje, ato që u plagosën prej dashuris'* së tij, gratë pra,* të shenjta dhe harruan* ato dobësinë e mishit të tyre krejt.

Rrëzuat me bes' si arm' fenë helene të rreme krejt,* dhe tempujt me adhurimin e demonëve ju;* u blatuat pra, në Kishën qiellore,*[13] martire, si një thesar me shpirt të thjesht', modest.

Hyjlindësore

Me hirin e Krishtit që si diell lindi nga barku yt,* o Zonja jon', vajzat që morën forc' dhe fuqi,* zmbrapsën çdo furtun'* torturash që pësuan* dhe erdhën pas teje me gaz dhe me ngazëllim.[13]

Kanuni i oshënarit, që ka Akrostihidhë (pa Hyjlindësoret): "Prano himnin, o Simeon i tërëpasur". I Joan Monakut

Ting. Tërth. IV Ásomen to Kirio

O Simeon hyjprurës,* jepmë nëpërmjet gjith' ndërmjetimeve* të tua drit' dhe njohje,* të të psal un' me gjuh', që ësht' kalbur krejt.

Morën vesh urtësinë* tënde turma skithësh, persianësh bashk',* arabësh, indianësh* dhe lëvduan për ty Zotin Krisht, o at'.

Ishe i mbushur me hir* shpirtëror, se gjithashtu ke qen' bari* për qengja të logjikshëm,* si Jakovi,[13a] Davidi,[13b] Moisiu,[13c] at'.

Hyjlindësore

O Virgjëresh' e pastër,* g'zohu se e mbajte brenda barkut tënd* atë që bota s'e mban;* ndërmjeto të shpëtojm' nga çdo vështir'si.

Zbritësore: Stavrón haraksas

»**N**jë kryq vijosi me shkop* Moisi »profeti* dhe Det' i Kuq u ça më dysh

»dhe Izraeli shkoj përtej,* pastaj
»prapë e bashkoj* me të njëjtin shkop
»dhe kryq përsipër valëve* dhe forcat
»edhe qerret Faraonit ia mbyti,[12a] pra
»Krishtin këndojmë si* Perëndi dhe
»Zot me brohori dhe gaz.*

Ode III
E Indiktit
Irmosi: Steréosón me Hristé

»**O** Krisht, ti më siguro*[13d] mbi gurin[14]
»e urdh'rave të tua* dhe me një drit'
»nga fytyra jote[14a] më ndrit,* se, o njeri-
»dashës, s'ka tjetër shenjt veç teje.[14b]

O Zot i mir', siguro* vreshtin me shum' fruta, që e mbolle* mbi dhé me dorën e djathtë[15] me dashuri,* o i Tër'fuqishëm dhe ruaje Kishën ton'.

Na vlerëso, o Krisht ne,* që të kalojm' k'të vit duke pasur* mori të mirash shpirt'rore, si ti i do,* ne që po këndojm' me bes', o Perëndi, për ty.

Më jep një rreth viti, Krisht,* me paqe, ti që je shum' i dhembshur;* me fjalën tënde hyjnore më mbush, o Zot,* të cilën të shtunave tek judenjtë thoje shpesh.[12c]

Hyjlindësore

Gjithmonë të lavdërojm',* se vetëm ti prite brenda barkut* mbi çdo mendim, Zonjë, hirin mbinjerëzor,* pra Krishtin dhe Perëndin', që s'u ndryshua dot.

E Grave të shenjta: Tokson dhinatón

Krishti* ju kurorëzoi, se* dolët fitimtare kundër armiqve me forc', fuqi,* se të gjitha u përforcuat* me fuqin' e tër'fuqishme krejt.

Bishat* hapën gojën pa efekt* kundër jush, dhe k'të e ka bër' fuqia e Zotit Krisht,* të paprekura ju shpëtuat* dhe lëvdonit Perëndinë ton'.

Duke* u afruar drejt Zotit,* k'shtu u hyjnizuat, zmbrapsët të ftohtin e idhujve* dhe arritët pra ngrohtësinë* lart në q'ell, atlete me kuror'.

Hyjlindësore

Të dim'* dhe me bes' të shpallim ty* nënë Perëndie vërtet të paqortueshme;* se Krijuesi yn' denjoi* të na flasë përmes teje, Zonj'.

E oshënarit: Ton fovon su

Duke u larguar shpejt nga suferina dhe tufani i erërave, erdhe në vendin[16] shpëtimtar, o Simeon, nga i cili fitove edhe jetën që nuk plaket.

Eule veshin tënd të bindur me gëzim tek Zoti, i cili lumëron; dhe gjete jetesën që lumërohet, o i tërëlumur.

Duke pranuar në brazdat e zemrës sate farat[17] e Fjalës me burime lotësh, korre kalli shumë pjellor në Krishtin.

Hyjlindësore

Zure pashprehshëm, o Hyjnuse, Shpëtimtarin dhe Zotin, që na çliroi nga të këqijat, ne që të thërresim ty për ndihmë sinqerisht.

Zbritësore: Ravdhos is tipon

»**S**hkopi një herë si një simbol i mi-»sterit na u shfaq,* se filizat na tre-»guan priftërinë,*[17a] edhe për Kishën »beronjë[17b] ja ku mbiu edhe lulëzoi* »Kryqi tani për forcë dhe për siguri.*

Ndenjësore e oshënarit
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Me një zemër të ngrohtë, o oshënar,* me përbuzje të gjërave që kalojn',* ke shkuar pas Krishtit ton'* me fuqinë e Shpirtit t' Shenjtë* dhe me përmbajtje shkrive dhe mposhte, at', trupin tënd,* se para syve kishe gjithmon' lavdin qiellor;* pra ti ke zbuluar dhe një ngjitje të shenjtë* si shkall', shtyllën që ke bër',* të përshtatshme me mallin tënd;* lutju Zotit,* o Simeon,* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Lavdi *I Grave të shenjta*
Ting. I Ton tafon su Sotír

O shqerra me logjik'* u blatuat te Qengji* që është dhe barí* përmes martirizimit*, k'shtu udhën e mbaruat ju* dhe besimin e mbajtët prap';*[12] pra me gaz të madh* kujtimin tuaj të shenjtë* lavdërojmë sot* dhe madhërojm' të gjith' Krishtin,* o të admirueshme.

Tani *I Indiktit*
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Para teje biem ne,* sepse je Zoti i Gjithësis',* dhënës i të mirave* edhe thërrasim besërisht:* O Shpëtimtar, zbutu fal' mirësisë sate,* me uratat e nënës sate, o Krisht,* dhe të të pëlqyerve pran' teje;* dhe denjësona ne që të nderojm' ty* në dy substanca që je, me bes'* dhe të lëvdojmë,* që të ofrojmë* vit të mir'pritur nga ti.

Ode IV
E Indiktit
Irmosi: Katenóisa pantodhíname

»**E** kuptova, o i Tërëfuqishëm, ekono-»minë tënde dhe të lavdërova me »frikë,[17c] o Shpëtimtar.

Populli yt të ofron ty si flijim, frytin e parë vjetor, duke të lavdëruar me himne engjëjsh, o Shpëtimtar.

Si njeridashës, vlerësona ne që filluam vitin dhe që ta plotësojmë me pëlqimin tënd, o Krisht.

O i tërëpushtetshëm, Zot i vetëm, dhuroji botës të paqmet stadet të viteve.

Hyjlindësore

Le të himnojmë tani të gjithë Perëndilindësen, si limanin e shpirtrave tanë dhe shpresën e sigurt.

E Grave të shenjta:
O kathímenos en dhoksi

Duke pësuar tortura dhe ndrydhje të trupit me mënyra të ndryshme, thyerje gjymtyrësh dhe djegie, i trashëguat tendat qiellore, duke shijuar peme jete,[18] o të admirueshme.

U çuditën Forcat qiellore me luftën e vajzave të lumura, si triumfuan kundër armikut, edhe pse në natyrë femërore, duke u forcuar nga fuqia e atij që lindi si diell prej gruaje.

Duke hedhur poshtë çdo kotësi të botës, u ngjitët me gjithë shpirt tek Perëndia i vetëm; pra duruat me fuqi lodhje asketizmi dhe ndeshjeje, o nuse të Krishtit.

Duke shëtitur kryqin si armë tepër të fuqishme, u rreshtuat kundër batalioneve dhe dolët fitimtare me Krishtin, që fitoi botën[19] me forcë Hyjnie.

Hyjlindësore

Siç tha qëmoti profeti, o e tërëpaqortueshme, ka zbritur si shi mbi shtëllungë leshi[20] Zoti, brenda mitrës sate, që e linde në dy substanca dhe tek i cili thërrasim: Lavdi, o Krisht, fuqisë sate.

E oshënarit: Isakíkoa Kírie

Jo në rërë,[21] o i tërëpasur, por në lodhjet e tua shumë të thella, duke vënë themelin e asketizmit, ndërtove kullë[22] virtytesh të patundshme.

Meqë gërryente trupin tënd litari shumë i ashpër, u gozhdove nga frika[22a] e Shpirtit dhe gjete litar trashëgimi[23] të shenjtë, o oshënar.

Largoheshin pasionet e fshehta të trupit, o i tërëpasur, kur të hanin krimbat, ndërsa dergjeshe në kalbëzim, o atë.

Pas pësimit vullnetar, duke imituar të vdekurin jetëbërës, në pus si në varr të errët e dhe veten tënde, edhe pse ishe i gjallë.

Hyjlindësore

O e pacenuar Mari, lutju gjithmonë Perëndisë, që e linde, që t'u dhurojë shërbëtorëve të tu faljen e mëkateve.

Zbritësore: Isakíkoa Kírie

»Kam dëgjuar, o Zoti Krisht,* si e »rregullove këtë mister të madh,* i

»kuptova veprat që ke bër'* dhe të »lavdërova, Perëndia im.[17c] *

Ode V
E Indiktit
Irmosi: Ek niktós orthrízontes

»Që me nat' mëngojm'[23a] dhe të him- »nojmë ty, o Krisht,* që je i bashk'pa- »nisshëm me* Atin, Shpëtimtar i »shpirtrave;* njeridashës, jep paqen* »tek bota, krijimi yt.

Ti që mbush Gjithësinë me mirësi, o Krisht, ti dhuroju shërbëtorëve të tu vitin me shumë cikle, që të jetë me erëra të mirëpërziera dhe me pjellori, i kurorëzuar me bekime.[4]

Na trego neve, të cilët të njohim ty, o Fjalë, si i bashkëpërjetshëm me Atin, ndërrimin e vitit, si ndërrimin drejt një gjendjeje më të mirë dhe paqësore.

Ke ardhur mbi dhé, o i bashkëpanisshëm me Atin dhe që ekziston përtej kohës, duke iu shpallur nga Ati robërve çlirim dhe sakatëve përsëri shikim.[24]

Hyjlindësore

Tek ti i besojmë, o Hyjlindëse e dëlirë, shpresat tona dhe guximin tonë; atë të cilin linde, jepna si mirëdashje, o e Virgjër.

E Grave të shenjta:
Asevís uk ópsonte

U blatuat tek qengji[24a] dhe bariu[24b] i vërtetë, o martire, si shqerra të panjollshme, si flijime të pastra, ofertë e plotë[25] dhe holokauste të mirëpritura.

Duke imituar kryq dhe vdekje, edhe pësimet vullnetare të atij që vrau fuqinë e vdekjes, o martire, pasi vdiqët trupërisht, jetuat shpirtërisht.

Duke pasur një mendje në shumë trupa, një Zot Jisu pohonin hyjmendëset, kur çaheshin keq me fshikullime dhe digjeshin në zjarr.

Hyjlindësore

Ngremë mua që rashë në gropë tundimesh dhe qeverismë, ti e vetmja e paqortueshme, që linde Perëndi qeveritar, i cili bashkoi me mirësi ato që qenë të kundërta më parë.[26]

E oshënarit: Fótison imás

Krishti të tregoi, o Simeon, si një Daniel të ri, sepse me një vizion të mori të paprekur nga gropa e egërsisë.

Duke i ofruar Krishtit gjithë veten tënde, u stërvite në të kundërtat, në ngricë, dëborë dhe vapë.

U tregove Moisi[26a] i ri dhe si Ilia,[26b] o oshënar, duke ngrënë gjatë gjithë jetës sate, një herë në dyzet ditë.

Hyjlindësore

Gjithmonë lutju Birit tënd dhe Perëndisë tonë, o Mari pa përvojë dasme, që të na zbresë ne besimtarëve mëshirën.

Zbritësore: O trismakáriston ksílon

»**O** dru i lumur tri herë, përmbi të cilin »u nde pra mbret' i lartë Zoti Krisht,* »se prej teje u rrëzua djalli gjarpër*[26c] »i gënjyer tmerrësisht prej Zotit të »mbërthyer përmbi kryq,* q'u fal »shpirtrave* përdëllim dhe paqe[26d] »përgjithmon'.*

Ode VI
E Indiktit
Irmosi: Ton profitin dhiésosas

»**N**jeridashës, shpëtove krejt* një »profet nga një peshk i madh;* të »lutem, ti nxirrmë dhe mua* nga fundi »i fajeve.

Vlerësona, o Krishti yn',* bashk' me vitin që tash po nis* dhe ne të fillojmë një jetë,* si ti dëshiron, o Zot.

Shpëtimtar, o i dhembshur, sa* të himnojm', na trego të gjith'* të mbushur me ditë të shpirtit,* pjes'marrës të ligjit tënd.

Hyjlindësore

I shpëto nga çdo kërcënim* sa vrapojm' tek ti, lutemi,* se ti e ke lindur Jisuin,* që ësht' Perëndia yn'.

E Grave të shenjta:
Evóise protipón

Shikon me gaz* hyjnisht Eva, stërgjyshja, të çahet krejt* dhe me këmbë* grash të shkelet dinaku, që me mashtrim* prej Parajs' e nxori,* e dëboi me lodhje të tmerrshme shum'.

Bashkuat ju* asketizmin me luftën me zell të madh;* u bashkuat* pra pa prishje me dhëndrin e frymrave,* dhe tani banoni* në pallat nusëror[27] me gëzim në shpirt.

Nuk mundën dot* dallgë, valë të egra torturash plot,* që u ngritën,* për t'i mbytur anijet e shqerrave,* se me dor' fuqie* kan' arritur në portet e qiejve.

Hyjlindësore

Lëvdo më shum'* atë që të lëvdoi, Hyjlindëse,* duke parë,* se të dolën ato që ke thën' dikur,* se të lumërojnë* gjeneratat të gjitha,[28] vërtet, o Zonj'.

E oshënarit:
Hitona mi parasku

I lumur je, se Krishti yn' i madh* të tregoi at' të shenjt', bërës çudish

qart'sisht,* se banesë e fuqisë hyjnore je.

U ngjit në shtyllë si mbi kryq, o at',* trupi yt, prandaj dhe i bashk'lavdëruar je* ti me Krishtin, që u ngjit për ty mbi një dru.

Meqë zbulove udhëtim q'ellor* sa të lavdërojn', o at' i mrekullueshëm* Simeon, lart transportoi tek qiejtë.

Hyjlindësore

Të shpallim, o Hyjlindëse, të gjith'* ne besnikët, tempullin e Perëndisë[29] ton',* arkë,[30] dhomë[31] që ka shpirt, port' e qiejve.[32]

Zbritësore: Notiu thirós

»**N**ë barkun e bishës në det, profeti »shën Jona kish hapur duart në form' »kryqi* dhe pësimin e Krishtit para- »tregonte qart'sisht* pra i triditshmi »jasht' u hodh dhe ngjalljen e përmbi- »natyrëshme e paralajmëroj* të Jisujt »të mbërthyer përmbi kryq për ne,* që »na e ndriti Krijesën me ngritjen prej »varreve.*

Kontaqi i Indiktit
Ting. III I Parthenos símeron

Ti që bëre Gjithësin'* me urtësi të pashprehur* dhe vendose kohëra* sipas pushtetit tënd, o Zot,[7a]* jepna ne* popullit tënd besimtar fitore;* na beko* hyrjet e daljet[10] e vitit tashmë;* na drejto gjith' veprat tona* që k'to të jenë sipas vullnetit tënd krejt.

Tjetri i oshënarit
Ting. II Ta ano zitón

Kërkoje me zell* të lartat, por jetoje posht',* të dyja pra bashk';* karrocë zjarri[33] shtyllën ke,* nëpërmjet asaj u bëre ti shok i engjëjve, o i shenjt',* lutju bashk' me ta Perëndis',* gjithmon' ndërmjeto për ne pran' Krishtit, o at'.

Shtëpia

Cila gjuhë njerëzore do të mjaftojë ndonjëherë të rrëfejë jetën e paqortuar të Simeonit, për ta lavdëruar atë? Por unë me urtësi Perëndie, do himnoj triumfet dhe luftërat e heroit, që në tokë iu duk të gjithë njerëzve si ndriçues[33a] dhe nëpërmjet durimit shkëlqeu shumë në shoqërinë e engjëjve; pra, duke psalur me ta pa pushim, gjithmon' ndërmjeto për ne pran' Krishtit, o at'.

Sinaksari

Muaji shtator, që ka 30 ditë. Dita ka 12 orë dhe nata 12 orë.

Më 1 të të njëjtit muaj, Fillimi i Indiktit, d.m.th i Vitit të Ri.

Vargje: Na beko Indiktin e Vitit të Ri, ti/ që je edhe i vjetër edhe i ri për njerëzit.[34]

Në të njëjtën ditë, kujtojmë çudinë që u bë nga Hyjlindësja e Shenjtë në Manastirin e Miasinëve; dhe kujtojmë zjarrin që ndodhi.
Vargje: Nga fundi i liqenit del vullnetarisht si një gjah mahnitës/ ikona e gjithënderuar e Virgjëreshës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Simeon Stilitit.
Vargje: Duke lënë Simeoni bazën e shtyllës,/ gjeti qëndrimin afër Fjalës Perëndi.
Simeoni, udhëtari i të lartave, vdiq në të parën e shtatorit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënares Marta, nënës së oshënarit Simeon; kujtimi i oshënares Evanthi; dhe fjetja e Jisuit të Naviut.
Vargje: Qëmoti Marta mirëpriste Krishtin në tokë,[35]/ ndërsa Krishti të mirëpret ty, o Martë, në qiell.
Jisui shikon Diellin e lavdisë, pasi la diellin,/ të cilin qëmoti nuk e la të vrapojë.[36]

Në të njëjtën ditë, kujtimi i dyzet grave të shenjta, martire, virgjëresha dhe askete, si dhe i Amun dhjakut, mësuesi i tyre.
Vargje: Zjarri dhe shpata iu shkaktuan dyzet virgjëreshave/ Birin e Perëndisë si dhëndër.
Amuni, duke pranuar kësulën e zjarrtë,/ mbulesën mishore e zhveshi i ngazëlluar.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë, Kalistës dhe vëllezërve të saj Evodhit dhe Ermogjenit.
Vargje: Kalista gjeti vërtet fund fort të hijshëm,/ duke u prerë bashkë me të dy familjarët e mirë.

Oshënar Meleti i Ri, që asketizoi në mal të Miupojës, mbaron në paqe.

Martiri i ri i shenjtë Angjeli, që u martirizua në Konstandinopojë më 1680, mbaron me shpatë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
E Indiktit
Irmosi: I pedhes efsevia

»Tre Djemat që u rritën besëmirë,* »trimërisht përbuzën urdhërin e »shtypësit,* nga furra dhe zjarri nuk »u tremb'n aspak,* po në flakë dhe »në prush me këngë faleshin:* O »Perëndi atëror, je i bekuar.*

Duke nisur vitin, bëjmë edhe nisjen e himneve tek Krishti, i cili mbretëron mbi një mbretëri të pafundme, duke kënduar ne, populli orthodhoks: O Perëndi i etërve, je i bekuar.

O Krisht, burimi i mirësisë, o Zot që je para jetëve e në jetët dhe përtej

tyre, mbushe vitin me dhuratat e tua të mira; o Perëndi i etërve, je i bekuar.

Hyjlindësore

O Krisht, ne shërbëtorët të paraqesim ty Zotit, nënën tënde të kulluar për ndërmjetim, që ta shpëtosh, o i mirë, nga çdo shtrëngim popullin tënd, që psal: O Perëndi i etërve, je i bekuar.

E Grave të shenjta:
O dhiasosas en pirí

Sa i pamposhtur ishte shpirti yt, o Amun hyjprurës, se duke kryesuar e duke qenë i pari i korit të virgjëreshave, nuk kishe frikë nga torturat, kur po mbaroje bashkë me to, si dhjak dhe njohës i lavdisë hyjnore.

Duke qenë si mbles i urtë nusesh, i përgatit me fjalë burrërore martiret, që të shikojnë dhëndrin dhe të durojnë mundimet e mishit, duke thirrur: O Perëndi i etërve, je i bekuar.

Në stadium trimëreshat thërrisnin: Le të mos mposhtemi, o vajza; ja, u hap stadiumi; le të qëndrojmë burrërisht – Krishti po zgjat kurorat,[37] – le të mos na vijë keq për trupin tonë.

Hyjlindësore

I bekuar është fryti i barkut tënd të bekuar, të cilin e bekojnë Fuqitë qiellore dhe tërësitë e njerëzve, se na çliroi nga mallkimi i lashtë,[38] o e bekuar.

E oshënarit: Pedhes theosevís

U zgjidhe të varfërve thatësirën dhe u hape atyre dyer shiu, dhe me lutjet e ndale dheun që lëkundej, dhe i mësove popujt të thërrasin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Si ndriçues shumë i madh i Kishës dhe diell me shumë dritë, që dërgon rrezet anembanë, o Simeon, i ndriçove dhe i mësove popujt të thërrasin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Çurkat që rrodhën së bashku nga çdo anë tek vatha e asketizmit tënd, o shërbyes i Krishtit, formonin një det njerëzish, të cilët mësoheshin prej teje të thërrisnin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Qëmoti në gjirin e plakut,[39] ndërsa tani në pllakat e zemrës sate u preh Krishti me fuqi të padukshme, o Simeon oshënar; prandaj thërrisje: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Hyjlindësore

I duhej atij që mishërohej pa farë, të dilte prej teje, o Virgjëreshë e pacenuar; se ti lulëzove, o e kulluar, atë që nuk kapërcehet nga askush, tek i cili thërrasim me himne: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Zbritësore: Ékneon próstagma

»Urdhër të çmendur dha tirani besë-
»lig, e tundi popullin,* botën e tmerroi
»me blasfemi dhe paudhësi,* po të tre
»Djemat nuk i tronditi dot* tërbimi i egër
»as furra me zjarr,* dhe kur po frynte
»era vesëprurëse, këndonin brenda
»mu në zjarr:* I përhimnuar je, Perëndi
»dhe Zot i madh* përjetë i bekuar.*

Ode VIII
E Indiktit
Irmosi: Ton tus imnológus

»Atë që ruajti Djemtë himnues në
»furrë dhe shndërroi furrën që bubullo-
»nte në vesë, Krishtin Perëndinë him-
»noni dhe e përmbilartësoni në jetët.

Kisha e nderuar tek ti, o Krisht, si kryetar i shpëtimit[40] që je, ofron blatim frytash të para[41] vjetore, duke thirrur: Himnoni dhe përmbilartësoni Krishtin në gjithë jetët.

Himnoni dhe përmbilartësoni në gjithë jetët Ndërtuesin, që i bëri nga mosqenia të gjitha urtësisht dhe zhvillon stadet e stinëve të reja sipas vullnetit të tij.[7a]

Për Perëndinë që i bën të gjitha dhe ndryshon motet për qeverisjen e shumëllojshme të njerëzve, psalim: Himnoni dhe e përmbilartësoni atë në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Ne, tërësitë e orthodhoksëve, gjatë periudhave dhe stinëve të vitit, të himnojnë ty si Hyjlindësen dhe shpëtimin e të gjithëve, Hyjnënën virgjëreshë të kulluar.

E Grave të shenjta:
Pedhas evajís

U veshët nëpërmjet martirizimit si me këmishë, të shkëlqyer nga gjaku dhe ngazëlluese, duke zhveshur njeriun që vërtet prishet me mëkatet,[42] dhe duke kënduar: Zotin himnojeni, o vepra, dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

O martire, duke u ndriçuar nga buitjet e dritës së pasur, nga shkëlqimet e hyjshme të Diellit mendor, iu shmangët natës së ateizmit dhe psalnit me bashkim shpirtrash: Zotin himnoni, o vepra, dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Si dele, si shqerra të panjollshme, si pëllumbesha të hyjshme dhe flijime të vullnetshme u blatuat, o dëshmore, te Ndërtuesi dhe si therore të patëmeta,[43] duke psalur njëzëri: Zotin himnoni, o vepra, dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Me urdhër tiranësh të paligjshëm pësuat së bashku vdekjen e padrejtë

duke ju prerë gjymtyrët, duke ju dërrmuar me shkopinj, duke ju rrahur pa mëshirë, duke ju therur me shpatë; prandaj trashëgoni me gëzim shpërblimet e pasura dhe të pavdekshme.

Hyjlindësore

Pas teje vrapuan gra, o Hyjnuse e tërëdëlirë, e vetmja që nuk njohe martesë, duke ndjerë ato mirot erëkëndshme[3] të Birit të vetëmlindur, që shkëlqeu nga barku yt, bashkëmbretërojnë me të vërtetë me ty, duke himnuar Krishtin në gjithë jetët.

E oshënarit: Ton en ori ajio

Pasi u ndave nga çdo pirje e keqe dhe si të dhimbsej dobësia e nënës, pikërisht si i gjallë iu shfaqe pas vdekjes, duke thirrur: Zotin himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Një të ri të paralizuar e forcon dhe urdhëron të parin e fisit, o fort i shenjtë, që të mbajë mbi supe shtratin, duke himnuar Zotin dhe duke e përmbilartësuar në gjithë jetët.

Ai që shkëlqeu Jovin nëpërmjet pësimit, e ktheu në margaritar të çmuar kalbësirën e mishit tënd të plagosur, duke të lavdëruar, o shërbyes i Krishtit, Simeon, në gjithë jetët.

Me lutjet e Simeonit, o Zot, thirre të fëliqurin, kryetarin e kusarëve, si qëmoti kusarin mbi dru; prandaj të himnojmë dhe të përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Hyjlindësore

O Virgjëreshë Hyjlindëse, të gjithë të himnojmë dhe të lavdërojmë ty, që pranove përshëndetjen nëpërmjet engjëllit[43a] dhe linde Zotin e lavdisë dhe dritën në botë.

Zbritësore: Evlojite pedhes

»E bekoni Djema,* si Trinia nga nu»mëri, Atin q'ellor, të vetëmin Zot,* »himnoni* Fjalën që mbi dhenë zbriti* »dhe e bëri vesë zjarrin e furrave,* dhe »e lartësoni ju Shpirtin e Tërëshenj»të,* që u dhuroi që të gjith've jetën.*

Ode IX
E Indiktit
Irmosi: Tipon tis agnís lohias su

»Një lloj* barre të kulluar ja,* për ty »na dha një ferr' e zjarrtë që s'digjej »dot;*[43a] tani po kërkojm'* të shuash »furrën e ngasjeve,* se ajo egërsohet »shum' kundër nesh,* që të të madhë»shtojmë* gjithmonë pa pushim, »Hyjlindëse.

O Fjal'* Perëndie dhe fuqi,* vërtet ti urtësia[44] në hipostazë je,* ajo që mban fort* dhe me urti qeveris Gjith'-

sin',* trajto kohën që erdhi tani tek ne* me kushte shum' të buta,* se shërbëtorët e tu jemi, Zot.

Para* jetësh vetëm ti ke qen',* sepse Krijuesi i shekujve, mbreti je;* një vetëm Hyjni* trihipostate, pa ndarje je,* shfaq tek ne, trashëgimi yt, vit të mbar'* dhe fitimtar, me lutjet* e lindëses së d'lir' të Zotit ton'.

Hyjlindësore

O Zot,* shpëtimtar dhe kryetar* i Gjithësis', krijues i tër'fuqishëm je;* dhuro pra tek ne* që jemi populli yt, qet'si,* duke ruajtur Kishën ton' pa trazir'* me lutjet e asaj që* të lindi pa dhimbje si dhe pa burr'.

E Grave të shenjta:
Eva men to tis parakoís

Nxjerrin si nga kroje virgjëreshat çdo shërim,* për ata që kan' nevojë pra,* edhe pastrojn' prishje sëmundjesh,* dëbojnë vap' pasionesh çuditërisht,* ujisin zemrat e shpresëtarëve,* për frytëdhënie veprash me gëzim.

Dhjak i shenjt' Amuni dhe Qelsina, tok me ta* dyzet gra të tërëpasura,* hyjmendëse ja sipas ligjit* luftuan,[44a] dhe kurorën e morën bashk'.* Kërcejn' tani me engjëj në qiejtë;* siç u ka hije t'i lëvdojmë ne.

Dolët fitimtare kundër kundërshtarëve* dhe ngjasuat shum' me engjëjtë;* shijoni pa pengesë drurin* e jetës[18] në Parajs', o hyjnuse, pra,* arritët në burimin[45] e mirësisë* edhe për botën ndërmjetoni ju.

Hyjlindësore

O Vajz', u dëfteve si një vend i urtësis'* së tër'mirë, përmbi çdo mendim,* si fron frymor,[45a] o e panjollshme,* si port';[32] si mbretëreshë të deshën shum'* të virgjëra, Virgjëreshë; u sollën pra* mbrapa hyjbijës, mbrapa teje, Zonj'.[13]

E oshënarit: Ton prodhilothenta

Meqë mbretërove mbi vese përmes durimit,* të pranoi Krishti si anëtar të shtetit të tij;* pra me himne ne të madhështojmë* ty, o Simeon hyjmbajtës, at' i shenjt'.

Meqë denjësisht more hirin e çdo shërimi* nga thesaret që ka Shpirti, të cilat nuk i vjedhin,* Simeon, iu dhuron ti shërime* njer'zve që festojn' kujtimin tënd me gaz.

Ti u ngjite pra në virtytin që çon në qiell* dhe tregove një arritje krejt engjëllore, o at',* fluturove në tend' qiellore;* ndërmjeto që të shpëtohen shpirtrat tan'.

Hyjlindësore

Meqë zure pa farë Zotin dhe Shpëtimtarin* e gjith' botës son', që ne pa pushim e madhështojmë,* ferr' që digjej me zjarr, por nuk prishej*[46] na u shfaqe, o e virgjër, Zonja jon'.

2 Zbritësore: Mistikós i Theotoqe
dhe O dhiá vróseos tu ksilu

»**O** Hyjlindëse, parajsë mistike je,* »se pa lërim lulëzove Zotin Krisht,* që »mbolli përmbi dhé jetëprurësin Kryq* »që po lusim me besë,* se ky po lar»tësohet* dhe me anën e tij ty të ma»dhështojmë sot.*

»**M**allkim i vjetër i stërgjyshit,* që »rrodhi prej helmimit të gjarpërit,*[26c] »e shkatërroi Kryqi i Zotit Krisht, beki»mi erdhi prapë për njerinë me Mari »Hyjlindësen,* që na lindi Jisunë Çli»ruesin, të gjitha pra fuqitë e lavdë»rojnë në qiellin.*

Dërgimësore
E Indiktit: Tis mathités

Natyr' trihipostate dhe* e pandërtuar fare,* e paafrueshme aspak,* e parajetëshme je* ti, Perëndi perëndish,[46a] Zot;* e ke krijuar botën;* të falemi dhe lutemi:* Na beko pra k'të vit, si i mir' që je,* e beko dhe ruaje me çdo paqe* gjith' popullin dhe mbretërit, se je i gjith'pushtetshëm.

E oshënarit E ngjashme

Si një ndriçues, oshënar,* shkëlqente jeta jote,* u duk në gjithë rruzullin*[33a] me rrezet e çudive;* u ngjite pran' Perëndisë* duke përdorur shtyllën* si shkall' të mrekullueshme* dhe atje është kulmi që dëshirojm',* më i çmuar, o Simeon, nga çdo gjë;* atje pra, duke qen' lutju* për ne që të lëvdojmë.

Hyjlindësore E ngjashme

Si krijimtar dhe kryetar* i çdo krijese që je,* vitet dhe motet i ke vën'* ti nën pushtetin tënd,[46b] Zot;* kurorëzo periudhën* e vitit me bekime* prej mirësisë sate,[4] Krisht,* duke ruajtur popullin tënd pa dëm* dhe pa fatkeq'si, por në paqen tënde* me ndërmjetim të engjëjve* - lutemi - dhe të nënës.

Lavdërime Idhiomele
Ting. III I Joan Monakut

O Fjalë e parajetshme e Atit, e cila ekziston në formë Perëndie[47] dhe që e solle Krijesën nga mosqenia në qenie, dhe që vendose mote dhe vite në pushtetin tënd,[7a] beko kurorën e vitit të mirësisë sate,[4] duke iu dhuruar Kishave të tua paqe, mbretit shumë besimtar fitore, dhe tokës pjellori, dhe neve përdëllimin e madh.

I njëjti Ting. IV

Mbretëria jote, o Krisht Perëndi, është mbretëria e gjithë shekujve dhe sundimi yt është nga brezi në brez,[48] sepse i bëre të gjitha me urtësi,[49] duke vënë para nesh mote dhe vite;[7a] pra duke falëderuar në çdo kohë dhe për çdo gjë, thërrasim: Bekoje kurorën e vitit të mirësisë sate[4] dhe vlerësona të të thërrasim pa dënim: O Zot, lavdi më ty.

I njëjti I Andrea Pirit

Rrugëtimet e tua, o Perëndi, rrugëtimet e tua,[50] janë të mëdha e të çuditshme; prandaj do të madhështojmë fuqinë e ekonomisë sate, se dritë prej drite erdhe në botën tënde të mjerë dhe shfarose mallkimin e parë të Adamit[26c] të vjetër,[50a] siç e pëlqeve, o Fjalë, dhe vendose poshtë nesh me urtësi mote dhe vite,[7a] që të lavdërojmë mirësinë tënde gjithëbërëse: O Zot, lavdi më ty.

Ting. II I Gjermanoit

Kur me pësimin tënd, o Zot, sigurove botën,[50b] atëherë edhe të pafuqishmit u ngjeshën me fuqi;[51] gra u burrëruan kundër tiranit fort të hidhur, dhe si ndreqe disfatën e mëparshme të nënës,[52] ndodhen në dëfrimin e Parajsës për lavdinë tënde, që ke lindur nga grua dhe shpëtove gjindjen e njerëzve.

Lavdi *I oshënarit Ting. II*

Nga rrënjë e mirë doli fryt i mirë, Simeoni i hyjshëm që nga foshnjëria u ushqye me hir, më tepër sesa me qumësht; dhe si lartësoi trupin mbi gur dhe si lartësoi akoma më shumë mendjen drejt Perëndisë, ndërtoi një shtëpi në ajër nëpërmjet virtyteve dhe pasi fluturoi bashkë me Fuqitë e hyjnueshme, u bë banesë e Krishtit,[1] Perëndisë dhe Shpëtimtarit të shpirtrave tanë.

Tani *Ting. Tërth. IV*
I Gjermanoit

Ti që me urtësi të pashprehur i sistemove të gjitha, o Fjalë, Krisht Perëndi dhe që vendose para nesh mote dhe vite, bekoji punët e duarve të tua, ndërsa mbretin besimtar ngazëlloje në fuqinë tënde, duke i dhënë forcë kundër barbarëve, si i vetëm i mirë dhe njeridashës.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i Indiktit Ode III dhe i oshënarit Ode VI.

Kontaqi
I Indiktit: O ipsothís

Ti, o Krijues i gjithçkaje si dhe Zot* dhe Perëndi, që je përmbi çdo sub-

stancë,* k'të periudh' vjetore na beko si i mir',* duke na shpëtuar me mir'-si* përdëllimin tënd pa kufi,* sa të adhurojmë ty,* sundimtarin e vetëm,* ne që thërrasim me frik': Çlirimtar,* me bollëk jepna k'të vit, o i dhembshur Krisht.

Në Veçan për të Tërëshenjtën...:
Të meriton.

Kungatore: Beko kurorën e vitit të mirësisë sate, o Zot.

CITIME

[1] Joan 14.23

[2] I Mak. 3.7; Ps. 111(112).6

[3] Kënga 1.4

[4] Ps. 64(65).12

[5] Apok. 15.3

[6] Rom. 11.33

[7] Ps. 78(79).1

[7a] Vep. 17.26

[8] Vep. 14.17

[9] Ps. 144(145).9

[10] Ps. 120(121).8

[11] Ps. 89(90).17

[12] II Tim. 4.7

[12a] Eks. 14.22-29

[12b] Hebr. 1.2

[12c] Is. 61(62).1-2; Lluk. 4.16-19

[12d] I Petr. 2.21

[13] Ps. 44(45).15-16

[13a] Gjen. kap. 30

[13b] I Mbret. [Sam.] 16.11-12

[13c] Eks. 3.1

[13d] I Mbret. [Sam.] 2.1

[14] Matth. 7.24,25; Lluk. 6.48

[14a] Ps. 4.7

[14b] I Mbret. [Sam.] 2.2; 7.22; Urt. Sol. 12.13; Sirak 33(36).5; Is. 45.14; Bel 41

[15] Ps. 79(80).15

[16] Joan 14.2

[17] Matth. 13.3-9; Mark. 4.3-8; Lluk. 8.5-8

[17a] Num. 17.16-28

[17b] I Mbret. [Sam.] 2.5

[17c] Abak. 3.1-2

[18] Gjen. 2.9; Apok. 2.7

[19] Joan 16.33

[20] Gjyq. 6.37-38; Ps. 71 (72).6

[21] Matth. 7.26; Lluk. 6.49

[22] Lluk. 14.28

[22a] Ps. 118(119).120

[23] Ligji i Dytë 32.9; Gjyq. 17.14; I Kron. 16.18; Ps. 104(105).11

[23a] Is. 26.9

[24] Is. 61.1,2; 58.6; Lluk. 4.19

[24a] Is. 53.7; Joan 1.29,36; I Mbret. [Sam.] 1.19

[24b] Joan 10.11,14; Hebr. 13.20; I Petr. 2.25

[25] Num. 7.88; Lev. 22.19,21

[26] Ef. 2.14

[26a] Eks. 34.28

[26b] III [I] Mbret. 19.8

[26c] Gjen. kap. 3

[26d] Lluk. 24.36; Joan 14.27; 20.19,21,26; Ef. 2.17

[27] Matth. 25.2-10

[28] Lluk. 1.48

[29] Jez. 44.1-3

[30] Eks. 25.9(10); 38.1(37)

[31] Ps. 18(19).5

[32] Gjen. 28.17

[33] IV [II] Mbret. 2.11; 6.17

[33a] Fil. 2.15

[34] Dan. 9.7-9

[35] Lluk. 10.38-40

[36] Gjyq. 12.10

[37] Apok. 2.10; I Kor. 9.25

[38] Gjen. 3.14-19

[39] Lluk. 2.28

[40] Hebr. 2.10

[41] Eks. 22.29(28); 35.5

[42] Ef. 4.22

[43] Lev. 1.14

[43a] Eks. 3.2-5

[44] I Kor. 1.24

[44a] II Tim. 2.5

[45] Gjen. 2.6

[45a] Is. 6.1; Jez. 1.13-26; 10.1-2; Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 32

[46] Eks. 3.2-4

[46a] Ligji i Dytë 10.17

[46b] Vep. 1.7

[47] Fil. 2.6

[48] Ps. 144(145).13

[49] Ps. 103(104).24

[50] Ps. 67(68).24

[50a] I Kor. 15.45-46

[50b] Ps. 92(93).1

[51] I Mbret. [Sam.] 2.4

[52] Gjen. 3.5

MË 5 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i profetit të shenjtë Zaharia, i ati i Pararendësit.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime
Ting. IV Ἐdhokas simíosin

Ishe veshur me stolin' e hyjshme si edhe me krezmim,*[1] Zaharia me nam të madh;* si engjëll shërbeve ti,* duke qenë prift pra* për Krijesën, pran' Kryetarit ndërmjetoje mir'* edhe zbulesat i prite[2] qartësisht* prej Shpirtit t' Shenjtë; ndaj të lumërojmë dhe panairin tënd* të shenjt' ne e kremtojmë sot* dhe lëvdojm' Shpëtimtarin ton'.

(2x)

Pe një djal' që lindi prej së resë, o Zaharia prift;* ky ësht' i bashkëpafillim* me Atin dhe parathe* tek yt bir shum' qartë:* Do të jesh profeti i tij, do përgatitësh ti* udhët e tij[3] vërtet; ndaj të lumërojm';* festojm' dhe panairin tënd të tër'nderuar me hir të madh;* o hyjmbajtës i pasur shum',* kishe pra frymëzim hyjnor.

(2x)

O i lavdëruar, ishe ti një tempull i gjall', shpirt'ror* pra i Frymës;[4] në Tempullin* kur ishe me Perëndin'* me thjesht'sin' e zemrës,* të kan' therur padrejtësisht[5] dhe k'shtu mbarove krejt* detyrën, udhën e shenjt' si një martir;* prandaj me gjakun tënd u ngjite lart në tempullin qiellor*[6] dhe kërkon butësi për sa* të nderojnë me gjithë shpirt.

(2x)

Lavdi *Ting. Tërth. IV*
I Joan Monakut

I veshur vërtet me stoli priftërie të Ligjit, sipas rendit të Aaronit shërbeve;[1] dhe duke qëndruar në Tempull pe qartë një fytyrë engjëllore, o i tërëlumur; prandaj në shpërnguljen tënde, të gjithë duke psalur siç të ka hije, o Zaharia, me këngë të lavdërojmë ty, që pas pleqërisë lulëzove Joanin e lavdëruar; ndërmjeto për ne te Perëndia i mëshirshëm, që të na shpëtojë.

Tani *Hyjlindësore*
Kírie i qe kritirio

Me ndërmjetimet e asaj që të lindi na ruaj ne, grigjën tënde, Zot,* të cilën e bleve me gjakun* tënd të çmuar[7] si i dhembshur shum';* dhe mbaje larg nga çdo cen* dhe nga çdo dëm armiqsh gjithmon',* që të himnojm' dhe të lavdërojmë* tolerancën tënde të hyjshme.

ose Kryqhyjlindësore

Kur të pa dielli të varesh mbi dru ty,

Zot, Diellin e drejt'sis', o Krisht,* i fshehu gjith' rrezet e tij, dhe* hëna ktheu krejt dritën e saj* në errësirë të plot'* dhe nëna e panjollëshme* thell' e plagosur në shpirt thërriste* me shum' klithma për kryq'zimin tënd.

Pasvargje
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

O çudi paradoksale krejt! Engjëll i madh, që qëndron* në të lartat pran' Zotit ton',*[8] i ungjillëzon zënien* e Pag'zorit shërbyesit,* që qe hyjmendës, pra Zaharisë prift,* ndon'se i madh në mosh' dhe në shterpësi.* O çfarë providenc'* të pashprehshme që ke ti, o Krishti yn'!* O i vetmi mëshir'plot',* të gjith' ne na shpëto.

Varg: I bekuar është Zoti, Perëndia i Izraelit.[9]

O çudi paradoksale krejt! Heshtjen e së Vjetrës tok* me lavdin' e së Resë ja* qartësisht profetizon* Zaharia me shurdhësin',* se plotësimin e Ligjit paraqet* me heshtjen; shfaqi dritën që Hiri ka.* O çfarë providenc'* të urt' që ti ke, o njeridashës Krisht,* me të cilën ruajna,* i tër'fuqishëm Zot.

Varg: Edhe ti, o fëmijë, profet i të Shumëlartit do të quhesh.[3]

O çudi paradoksale krejt! Ky Zaharia me fam',* besnik mes priftërinjve qe* edhe mes martirëve* i shkëlqyer dhe si profet* qe lavdëruar; parashikonte k'shtu* të ardhmen; pra tri kurora ka stoli.* O sa të pasura,* njeridashës, jan' sa na dhuron; me k'to* denjësona të gjith' ne për mbretërin' tënde.

Lavdi *Ting. II I Anatoliut*

Si një prift i pastër u fute[10] në të Shenjtat e të Shenjtave[11] dhe pasi u veshe me stolinë e hyjshme,[1] i shërbeve pa qortim Perëndisë, duke vënë ligje si Aaroni dhe duke udhëhequr si Moisiu fiset e Izraelit me kombinimin e përsosur të zileve;[12] prandaj edhe u vrave;[5] por gjaku yt i drejtë na u bë shërim shpëtimtar dhe si miro erëkëndshme çel dëgjimet për fitimin e jetës së amshuar; o Zaharia i tërëpasur, prind i Joan Pagëzorit dhe bashkëshort i Elisabetës, ndërmjeto përherë për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*
Ote ek tu ksilu se

Janë* shum'fishuar me tepri* shkeljet që kam bërë; vërtet pra shumica e ligësis'* kapërceu kokën time[13] edhe kam ngarkes'* të pamasë, s'e mbaj dot un' i mjeri pa ndreqje,* o Zonjë Hyjlindëse; prandaj ti ndërmjeto*

ngrohtësisht, nxito dhe arri shpejt* dhe shpëtomë, se je e vetmja* ndreqje e të gjithë mëkatarëve.

ose Kryqhyjlindësore

Meqë* ke duruar dhimbje plot,* ndërsa kryqëzohej yt Bir, Perëndia Zot njëkoh'sisht,* lot ti derdhje dhe vajtoje fort me klithma shum':* Vaj, fëmija im fort i ëmbël, si padrejt'sisht ti* vuan duke dashur të shpëtosh adamjanët,* pra njer'zin'; ndaj, o Virgjëreshë* dhe Hyjlind'se, lutemi me bes',* zbute Birin ndaj nesh, o e Tërëshenjt'.

Përlëshore
Ting. IV
Kateplaji Iosíf

Ishe veshur, o i urt',* ti me stolin' e priftëris';* sipas ligjit të Hyjnis'* ofroje holokauste* të mirëpritura hyjshëm, o Zaharia;* pra u bëre ndriçues, vegimtar* gjërash krejt mistike dhe mbaje qart'* simbole Hiri brenda teje; edhe* u vrave me shpat' në Tempull keq;* profet i Krishtit,* tok me Pag'zorin* ndërmjeto të shpëtojmë.

NË MËNGJESORE

Stihologjia e zakonshme. Kanunet: i Oktoihut dhe i shenjtit, që ka Akrostihidhë: "Duartrokas unë për prindin e Pararendësit, kryepriftin e urtë". I Theofanit.

Ode I
Ting. Tërth. IV Igrán dhiodhefsas

Lëvdoj un' kujtimin tënd, o profet,* lutem pra për bashk'punim me Hirin e Shpirtit t' Shenjt'* përmes ndërmjetimit tënd; thërras k'shtu:* Le t'i këndojm' Perëndis', Çlirimtarit ton'.

Meqë jeta jote u gjet pa njoll',* ti u zbukurove me stoli priftërore plot* si dhe me shkëlqime dhe ndriçime* të profecis', o hyjfolës i lumur shum'.

Shiriti Ligjor përmbi kreun tënd*[14] të kishte lëvduar, Zaharia; hyjfolës ti* u dëfteve pra edhe thërrisje:* Le t'i këndojm' Perëndis', Çlirimtarit ton'.

Hyjlindësore

Këmish' gjer në këmbë veshe si prift*[15] sipas Aaronit dhe e prite Vajzën,[16] që ish* si lastar, nga rrënja e Jeseut,*[17] e cila mbante në bark Çlirimtarin ton'.

Ode III
Si i to steréoma

Kur sillje, o kryeprift,* temjanin e kombinimit[18] ti,* atëher' pra* e fitove lindjen* e Prodhromit, Pagëzorit ton'.

Ilyer ke qenë ti* me miro të shenjtë-

rimit, si* ka qen' më par'* Aaroni;[1] ndaj pe* një vegim engjëllor me lavd.

Profet Zaharia lind* Joanin, si një agim që shfaq* dhe parathot'* diellin mendor, pra* Shpëtimtarin, në botën ton'.

Hyjlindësore

Drejto jetën time krejt* dhe sjelljen time, Hyjnënë, Zonj'* e d'lirë, ti* që i dhe gaz shpis' së* Zaharias, kur shkove[16] pra.

Irmosi: Si i to steréoma

»Ti je përforcim për sa* me mall »përikin tek ti, o Zot;* dhe për sa jan'* »brenda errësirës,* je drit'; shpirti im »të himnon.

Ndenjësore Ting. Tërth. IV
To prostahthén mistikós

Si prift shërbeve tek Zoti sipas Ligjit;* profetizove* Krishtin ton'[3] nga Virgjëresha,* se ky do mishërohej* prej Shpirtit të Shenjtë;* u shfaqe k'shtu shtyllë drite tek bota ti;* për drit' nga lart flet, për lindjen* e drejtësis',* që në udh' paqeje drejton mir' këmbët tona,[19] o Zaharia, ky ësht' Zoti yn',* që shpëton gjithë njerëzin'.

Lavdi *I ngjashëm*

Meqen'se ditë e natë Zaharia* i drejt' studioi* Ligjin, siç e thonë Psalmet,* edhe e adhuroi* Zotin e të gjith've,* që ësht' në të lartat, siç tha Davidi mbret,*[20] i madh ndër profetët tan', ndaj* gjith' ne le të* lumurojm' birin e Varahis', që u ther më në fund[5] si dele e mir'pritur, si* holokaust i Perëndis'.[21]

Tani *Hyjlindësore*

O e hyjhirshme, e d'lirë, e bekuar,* bashk' me Fuqitë* që jan' lart dhe me profetët* dhe me gjithë shenjtorët,* lutju pa pushuar* atij që u lind prej teje për një shumic'* mëshirash, që të na jepet* ndreqje e mir'* para fundit dhe ndjesë e mëkateve, korrigjim i jetës dhe pendim i thell',* që të gjejmë ne përdëllim.

ose Kryqhyjlindësore

Duke u ruajtur përgjithmon' nga Kryqi* i Perëndisë,* Birit tënd, o Virgjëreshë,* zmbrapsim dinakëritë,* sulmet e demonit,*[22] sepse të himnojmë ty si Hyjlindëse* vërtet dhe të lumëron ty* çdo gjenerat'* me dëshir' të përflaktë, o e pacenuar, siç e profetizove;[23] ndërmjeto* dhe dhurona ndjes' fajesh ti.

Ode IV
Isakíkoa Kírie

Profeti yt, o Zot, të shërbente besnikërisht sipas tipeve të Ligjit dhe është

denjësuar me Hirin për të parë të vërtetën me dije.

Përfitove dritë më të fortë nga drita e dobët, sepse me të vërtetë përmes Ligjit u shtua tek ti edhe Hiri.

Gabrieli i hyjshëm që qëndron pranë Perëndisë,[8] u duk tek ti, o i lumur, duke ungjillëzuar zërin e Fjalës dhe Pararendësin.

Hyjlindësore

Meqë të ka gjetur Bërësi i Krijesës ty, o e Virgjër, banesë të pastër, ngriti tendë ai që zgjidhi shterpësinë e Elisabetës.

Ode V
Orthrízontes voomen si

Mitra u vu në kreun tënd, o profet, e cila kishte simbolin e Hirit në vulë,[24] o i lavdëruar.

Ngazëllohet Krijesa[25] për fëmijën tënd, o kryeprift, se ti lulëzove predikuesin e pendimit.[26]

Me modesti kalove jetën tënde; zbatove së bashku me Elisabetën të gjitha porositë e Zotit.

Hyjlindësore

Rregullohet gjuha jote për himn, o hyjfolës,[27] sepse ke parë të jetë me barrë ajo që s'kishte njohur martësë.[16]

Ode VI
Hitona mi parasku

Meqë u denjësua për të par'* mishërimin tënd[16] shërbëtori i Ligjit, pra* në err'sir',[28] o Zot, predikonte për hirin tënd.

E prite Fjalën e përjetshme, që* veshi mish, o prift Zaharia,[17] dhe kishe pra* pllakën e gjykimeve[29] si një zbukurim.

U duke brenda Tempullit të jesh* bashk' me Perëndin', o i hyjfrymëzuar krejt,*[30] njohës, prift dhe shërbëtor i çuditshëm fort.

Hyjlindësore

Kur mbajte brenda barkut, o Hyjnën'* Virgjëreshë, Fjalën e panisur për shpëtim,* profetesh' Elisabeta të njohu ty.[16]

Irmosi: Hitona mi parasku

»**M**ë jep këmish' të ndritëshme, o »Zot,* ti që vesh si rrob' të shkëlqye»shme dritën[31] krejt,* Perëndi mëshi»rëplotë, o Krishti yn'.

Kontaqi Ting. III
I Parthenos símeron

Sot profeti edhe prift* i Perëndis' të Shum'lartit,* prindi i Prodhromit ton'* pra Zaharia, ka shtruar* një trapez':*

Kujtimin e tij frym'zues për ne.* Sot dhuron* ver'[32] drejtësie për ne besnikët.* E lëvdojmë pra si njohës* të shenjt' të Hirit dhe të misterit hyjnor.

Shtëpia

Me zë engjëlli kryeprifti ka pranuar heshtjen e Ligjit, duke pranuar bashkë me Elisabetën shterpë dhe të mençur engjëllin e pranisë së Krishtit,[33] profetin dhe njohësin e mistereve. Kur lindi ai, u ripërtëri Hiri, çlirimi dhe pajtimi ynë mbarëbotëror;[34] se Qengjin,[35] Gatuesin dhe ripërtëritësin e natyrës,[36] i cili jep frytin nga beronja dhe na u shfaq si Bir i Virgjëreshës, profeti po e predikon si njohës të shenjt' të Hirit dhe të misterit hyjnor.

Sinaksari

Më 5 të të njëjtit muaj, kujtimi i Zaharias profet dhe atë i Pararendësit.
Vargje: Për hir të Qengjit hyjnor të Perëndisë,[35]/ Zaharia theret si një qengj në mes të Tempullit.[5]
Më 5 therën Zaharian në dyshemenë e Tempullit.[5]

Në të njëjtën ditë, shën Avdhei, pasi u godit me shkop gjembash mbaron.
Vargje: Avdhei martir duron gjemba shkopinjsh,/ duke nderuar Zotin që u kurorëzua me gjemba.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Medhimni, Urbani, Theodhori dhe i atyre që ishin bashkë me ta, i tetëdhjetë priftërinjve dhe levitëve, d.m.th. dhjakonëve.
Vargje: Thotë Medhimni: Pasi kalova siç thonë Psalmet,/ përmes uji dhe zjarri, arrij në çlodhje.[37]
Dhe Theodhori i madh bashkë me Urbanin/ kryen të njëjtën arritje me Medhimnin.
Të tetëdhjetë martirët e përkushtuar plotësisht/ rezistonin ndaj zjarrit dhe ujit.[37]

Në të njëjtën ditë, kujtimi i shën Petros në Athira.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i hieromartirit të shenjtë Athanasi në Brestin të Bjellorusisë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Pedhes Evreon

Kur zëri i atij që thërriste[38] doli nga shterpa, o Zahari, këputi prangat e gjuhës sate për të thirrur: I bekuar je, o Zot Perëndi, përjetë.

Nga shterpësi lindi miku i dhëndrit,[39] Pararendësi, duke paralajmëruar me qartësi fëmijën e Virgjëreshës tek ata që thërrasin besërisht: I bekuar je, o Perëndi, përjetë.

O Zaharia i lumur fort, u bëre i gjithi një instrument i hyjshëm i Shpirtit[30] dhe e parathoje si profet fëmijën tënd[3] duke thirrur: I bekuar je, o Zot, përjetë.

Hyjlindësore

Zaharia duke të parë ty, o Vajzë, si përmbushjen e Ligjit,[40] njohu plotësimin e tërë profecisë duke thirrur: I bekuar, o e tërëkulluar, është fryti i barkut tënd.

Ode VIII
Ton en ori ajio dhoksasthenta

U tregove folës i së vërtertës, se, o kryeprift i lumur, Joan Pararendësi duke paraprirë, përgatiti udhët e Krishtit,[38] të cilin e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Duke ligjëruar bekoje Zotin, i cili na ka dhënë shpëtim, atë që doli sipas mishit nga Davidi, Zotin e lavdisë,[27] që e përmbilavdërojmë në gjithë jetët.

O hyjshfaqës, u denjësove për dhunti të mëdha duke lindur Prodhromin, që është më lart se të gjithë[41] profetët, i cili himnon Zotin dhe e përmbilartëson në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Zaharia kryeprift dhe njëkohësisht hyjpredikues iu fal i gëzuar nënës dhe Virgjëreshës që mbante Zotin e Krijesës,[16] të cilën e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Irmosi: Ton en ori ajio dhoksasthenta

»**T**ë lëvduarin shum' në Mal të Shenj-»të,*[41a] dhe që shfaqi misterin e »Tër'virgjëreshës* tek Moisiu mu në »zjarr, në ferrë,[42] pra Zotin, e himnoni* »dhe e lartësoni përher' në gjithë jetët.

Ode IX
Kirios Theotokon

Të mbushi frymëzimi* i Ngushëllimtarit,*[30] prandaj përpiqeshe Zotin ta lavdërosh,*[27] o ti hyjnjohës, hyjmendës dhe i hyjlumur shenjt.

Meqë ke par' zbatime* fjalësh engjëllore,* o i shum'famshëm hyjfolës, lëvize në çast,* menjëher', gjuhën drejt himnit dhe drejt bekimit[27] ti.

I mëshiroi Bër'si* sa ishin të humbur* dhe dhiatën e Abrahamit kujtoi qart',* siç the kur profetizoje[27] i mbushur me Shpirt t' Shenjt'.[30]

Kurora priftërie* dhe martirizimi* si dhe ndriçim profetik të stolisën ty,* o Zaharia, dhe more pjes' në lavdin' e mir'.

Hyjlindësore

Meqë je enë drite,* më ndriço, o Vajzë,* shpirtin e errët për shkak të

pasioneve;* nga errësira e jashtme lutu që të shpëtoj.[43]

Irmosi: Kirios Theotokon

»Pohojm' se je Hyjlind'sja,* ne që u »shpëtuam* nëpërmjet teje, e shenjt', »Virgjëreshë e d'lir';* me koret e të »patrupve të madhështojmë ty.

Dërgimësore
Jinekes akutísthite

Si prift shërbeve pa njoll' krejt* te Perëndia i tër'fort'* pas Tipikonit të Ligjit,* o Zaharia profet ti;* kur temjanisje pra, u duk* një engjëll edhe tha: Do kesh* bir Pararend'sin e Krishtit,* që do të jet' ndërmjetues* në mes të Ligjit dhe Hirit.

Hyjlindësore

Kaluan, o nën' Virgjëresh',* sa brenda hijes bëheshin,* brenda pra Ligjit dhe tipit* të vjetër,[28] se linde dhën'sin* e Ligjit, Perëndinë ton',* pa far', që të shpëtohemi;* pra më mbështet në porosit'* e hyjshme, se shpesh lëkundem* për shkak të ligjit të fajit.[44]

Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

[1] Eks. 29.7-9

[2] Eks. 28.26; Num. 27.21

[3] Lluk. 1.76-77

[4] I Kor. 3.16; 6.19; II Kor. 6.16

[5] Matth. 23.35; Lluk. 11.51

[6] Apok. 14.17; 16.17

[7] Vep. 20.28

[8] Matth. 18.10; Tobit 12.15

[9] Lluk. 1.68

[10] Eks. 28.23,26

[11] Eks. 30.29

[12] Eks. 28.30

[13] Ps. 37(38).5

[14] Eks. 36.40

[15] Eks. 29.5

[16] Lluk. 1.39-56

[17] Is. 11.1

[18] Eks. 40.25

[19] Lluk. 1.78-79

[20] Ps. 1.2

[21] Lev. 9.2-3

[22] Ef. 6.11

[23] Lluk. 1.48

[24] Eks. 28.32-33,35

[25] Joan 5.35

[26] Matth. 3.2

[27] Lluk. 1.64,68-79

[28] Hebr. 8.5; 10.1

[29] Eks. 28.15

[30] Lluk. 1.67

[31] Ps. 103(104).2

[32] Fja. Urt. 9.2

[33] Mal. 3.1; Matth. 11.10; Mark. 1.3; Lluk. 7.28

[34] II Kor. 5.17-19

[35] Is. 53.7; Joan 1.29,36

[36] Gal. 6.15; II Kor. 5.17

[37] Ps. 65(66).12

[38] Is. 40.3; Matth. 3.3; Joan 1.23

[39] Joan 3.29

[40] Rom. 13.10

[41] Matth. 11.11; Lluk. 7.28

[41a] II Petr. 1.18

[42] Eks. 3.2-5

[43] Matth. 8.12; 22.13; 25.30

[44] Rom. 7.19-23

MË 6 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i çudisë që u bë në Kolasét, d.m.th. në Honet nga kryeengjëlli Mihail.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të kryeengjëllit. Lavdi i kryeengjëllit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i kryeengjëllit. Përlëshoret: ngjallësore, e kryeengjëllit dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, si zakonisht. Në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor dhe dy të kryeengjëllit. Dërgimësoret: ngjallësore, e kryeengjëllit dhe Hyjlindësorja e saj. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të kryeengjëllit. Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Duke qen' i ndriçueshëm* pran' Hyjnis' së tridiellshme,*[1] je i famshëm, o kryegjeneral i madh;*[2] tok me Fuqitë e sipërme thërret, Mihail, me gaz:* Je i shenjtë At' i madh,* je e shenjt' Fjal' bashk'pafillim,* je i shenjtë Shpirt,*[3] dhe të tre bashkë jeni një lavdi, një mbretëri dhe një Hyjni si dhe një fuqi mbi të gjitha krejt.

(2x)

Të përflakur e ke pamjen,* bukurin' të çuditëshme,* kryeengjëll Mihail, me natyr' pa lënd'* nëpër çdo anë të botës shkon, sepse ti zbaton plot'sisht* të gjith' urdh'rat e atij*[4] që ka bërë me fjal' Gjith'sin';* njihesh shum' i fort'* dhe e bën kishën tënde që nderojm' në emrin tënd, si një burim jetësor shërimesh, o gjeneral.

(2x)

Ti, o Zot, që bën engjëjtë* vërtet shpirtra, siç Shkrimi thot',* dhe k'ta që shërbejn' tek ti si një flak' e zjarrt',*[5] mes batalioneve qiellore shfaqe si kryetar*[2] Mihailin gjeneral,* që me bindje të plot' dëgjon* shenjat që ti bën,* dhe i cili thërret me frikë himnin trishenjtor[3] tek lavdi yt, o Fjal' dhe mbret, sundimtari yn'.

(2x)

Lavdi *Ting. Tërth. II*
I Bizantit

Gëzohuni bashkë me ne, ju gjithë brigadat e engjëjve, se prijësi juaj dhe mbrojtësi ynë, kryegjenerali i madh, sot duke u bërë i dukshëm çuditërisht në kishën e tij të respektuar, shenjtëron; pra siç i ka hije duke e himnuar,

le të thërrasim: Mbulona ne me strehën e krahëve të tu, o Mihail i tërëmadh, o kryeengjëll.

Tani *Hyjlindësore*

Gëzohuni bashkë me ne, ju gjithë koret e virgjëreshave, sepse mbrojtja jonë, ndërmjetësja, streha dhe përkija e madhe, sot me përkujdesjen e saj të respektuar dhe të hyjshme, ngushëllon të pikëlluarit; pra siç i ka hije duke e himnuar le të thërrasim: Mbulona ne me mbrojtjen tënde të hyjshme, o Zonjë Hyjlindëse e pacenuar.

Pasvargje
Ting. I Ton uranion tagmaton

O Mihail, të himnojm' ty me bes' si kryetar* i koreve në qiell* dhe si mbrojtës fuqie,* ruajtës dhe çlirimtar për të gjith'* që jetojmë në tok' këtu,* duke të lutur që të na çlirosh të gjith'* nga çdo dhimbje shkatërruese.

Varg: Ai që i bën engjëjt e tij frymëra dhe shërbyesit e tij flakë zjarri.

Ky gjeneral i Fuqive të hyjshme që jan' lart,* i fton sot gjithë koret* njerëzore, tok'sore.* Do që bashk' me engjëjt ne të festojm'* panair ngazëllues krejt,* mbledhjen e tyre të shenjtë, dhe njëkoh'sisht* ne të psalim himnin trishenjtor.[3]

Varg: Beko, o shpirti im, Zotin dhe gjithë të përbrendshmet e mia emrin e tij të shenjtë.

O Mihail, që je Mendje e hyjshme, mbana krejt* nën strehën që formojnë* krahët e tu të shenjtë;* na mbulo përjetë ne që të gjith',* sa përikim me bes' tek ti;* në çast të vdekjes qëndro pran' nesh ndihmëtar,* mirëdashës për të gjithë ne.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. IV
I Joan Monakut

Si taksiark, prijës dhe kryetar i engjëjve, o gjeneral, çliroji nga çdo nevojë dhe pikëllim, nga sëmundje[6] dhe mëkate të frikshme, ata që të himnojnë sinqerisht dhe të kërkojnë, o i lavdishëm; sepse si i palëndët shikon të palëndëtin[1] qartësisht dhe shkëlqen nga drita e paafrueshme e lavdisë së Zotit; se ai nga njeridashja mori prej virgjëreshe mish për ne, duke dashur të shpëtojë njerëzinë.

Përlëshore
Ting. IV O ipsothís en to stavró

O gjeneral i çdo ushtrie q'ellore,* përher' të lusim shum'* ne të padenjët:* Ngrina një mur rrethues përmes lutjes që bën;* mbrona nën strehën e krahëve* të lavdis' sate të palënd't,* ruajna; të falemi* dhe thërresim me

besë:* Nga çdo rrezik çlirona ne pra ti,* si taksiark i Fuqive të sipërme.

Në festat e të dy kryeengjëjve (në shumës)

O gjeneralë të ushtrive q'ellore,* përher' ju lusim shum'* ne të padenjët:* Ngrini një mur rrethues përmes lutjes suaj;* mbronani nën strehën e krahëve* të lavdis' suaj të palënd't,* ruanani; ju falemi* dhe thërrasim me besë:* Nga çdo rrezik çlironani ne pra,* si taksiark' të Fuqive të sipërme.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Misteri i fshehur prej jete dhe i panjohur ndër engjëjtë, u shfaq ndër të dheshmit me anën tënde o Hyjlindëse, Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzier dhe denjoi kryq për ne duke dashur, me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtrat tanë.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. IV O ipsothís en to stavró

Ne që qëndrojm' në kishën tënde të shenjtë,* të madhërojmë brenda saj ty me besë,* se je në krye rreshtash jolëndorë engjëjsh,* lutemi me shpres'tari dhe mall* tek ti, o gjeneral hyjnor:* Na çliro nga tiranit'* e armiqve të shumtë;* me ndërmjetimin tënd ti na shpëto* nga kërcënimi i ardhshëm, Gjehena pra.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Nuk do pushojmë asnjëher', o Hyjlind'se,* ne të pavyerit të flasim për forcat* që ke, se po të mos qëndroje para nesh ti* duke ndërmjetuar, kush nga ne* do shpëtohej nga çdo dëm pra?* Cili na ka ruajtur* të lir' deri tani; ndaj* nuk do largohemi aspak nga ti,* se shërbëtorët e tu i shpëton gjithnjë.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV O ipsothís en to stavró

O gjeneral i shërbëtorëve pa trup,* ti që qëndron përballë Zotit[1] në qiej* dhe që shkëlqen nga drita që gjithmon' del prej tij,* ngazëllo dhe shenjtëro ata* që me bes' të himnojnë ty,* si edhe çliroji nga* tirani e armikut;* kërko një jet' me paqe për të gjith',* për mbretin edhe për anët e botës son'.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Le të vrapojmë bashk' tani tek Hyjlind'sja* ne mëkatarët, dhe t'i biem në gjunjë,* dhe t'i thërrasim gjith' ne thellësisht edhe me pendim:* Zonj' e dhembshur, na ndihmo se po* shka-

tërrohemi nga shumic'* shkeljesh; pra nxito shum' shpejt* edhe bëhu përkrah'se;* njer'zit e tu mos i largo të zbraz't,* se ne të kemi ty shpresë të vetme krejt.

Kanuni: i Hyjlindëses dhe dy të kryeengjëllit. Nëse do, psal edhe Zbritësoret Ja gojën e çel tani.

Ode I
Kanuni i Hyjlindëses Ting. Tërth. IV
Irmosi: Igrán dhiodhefsas

»Pasi kish kaluar det si steré* edhe »u shpëtua nga inati egjiptian,* me »zë Izraeli po thërriste:* Le t'i këndojm' »Perëndis', Çlirimtarit ton'.

Imbytur prej ngasjeve si në det,* më ty po përikij dhe prej teje kërkoj shpëtim,* o nënë dhe Zonjë Virgjëreshë,* prej çdo rreziku dhe zie shpëtomë ti.*

Pësimet më mbushën me turbullim* dhe shpirtin ma mbytën me mërzitje dhe dëshpërim,* po ti qetësomë, Virgjëreshë,* me ngushëllimin dhe paqen e Birit tënd.*

Të lutem o Zonjë, o Shën Mari,* që linde Jisuin, ti shpëtomë nga çdo rrezik,* më ty po përikij dhe të lutem,* me tërë forcën e zemrës dhe shpirtit tim.*

Se shpirti dhe trupi keq m'u sëmur,* pra ti mëshiromë, edhe syrin mbi mua hidh,* kujdesu për mua Virgjëreshë,* e mirë vetë dhe nën' e të mirit Bir.*

Kanun i kryeengjëllit, që ka Akrostihidhë: "Himnoj të Parin e Mendjeve të patrup. Josif".

Ting. IV Anikso to stoma mu

Ndriço mendjen time që të të lëvdoj gjeneral i madh* ushtrie, që ndodhesh lart, se ti shkëlqen përgjithmon'* me ndriçim hyjnor,* kështu je për të gjithë* që rendin tek ti, fuqizim edhe mbrojtje pra.

Të ka shpallur Mendja, që është përpara nga çdo fillim,* si prijës të rendit të përmbinatyrshëm ty,* gjeneral me fam',* si lavd hyjnor i Kishës,* si dritë për gjith' ata që jan' në errësir'.

Po shkon ti përpara nga çdo Mendje në qiell shpirtërisht;* u dhe tek ne posht' si një fortifikim, Mihail,* si fuqi dhe shpat',* që ther të gjith' armiqtë* që zhduken, shfarosen, o i tër'shkëlqyeshëm.

Hyjlindësore

O Zonj' Virgjëreshë, që je hijeshia e engjëjve* dhe ndihmë për njerëzit, ti më ndihmo në çdo koh',* se lundroj në det,* në turbullir' mëkatesh,* sepse kështu un' rrezikoj, ndaj vrapoj tek ti.

Kanun tjetër Tingulli i njëjtë
Përsëri i Josifit: To odhijísanti pale

Le të himnojmë me ngazëllim kryetarin e engjëjve, diellin e ndritshëm, që ndriçon dheun me shkëlqimin e çudive dhe që e dëbon përherë mjegullën e ngasjeve.

O Zot, që bëre engjëjt flakë zjarri,[5] të cilët kryejnë fuqishëm vullnetin tënd[4] të tërëshenjtë, e tregove në mes tyre si yll që shkëlqen Mihail kryegjeneralin.

Të gjithë le të himnojmë Zotin e mirë, që na dhuroi si mur të pamposhtur nga armiqtë dhe mbështetje që gjithnjë nuk zmbrapset, Mihailin e hyjshëm, që na shpëton prej rreziqesh.

Me mbikëqyrjen tënde të shenjtë shtëpinë tënde e bën gjithmonë të hyjshme, falje për mëkatarë, strehim për ata që u bëhet padrejtësi, dëbim i gjithë sëmundjeve, o i pari i engjëjve të Perëndisë.

Dërrmoji bijtë e Agarës, o i lavdishëm, që ngrihen gjithmonë kundër nesh dhe çlirona nga synimet e tyre dhe pikëllimet,[6] që të të respektojmë ngaherë si mbrojtësin tonë të mirë.

Hyjlindësore

Çudi e pakuptueshme! Si u bashkua me të vdekshmit Perëndia i pakapshëm, duke lindur me hipostazë sipas mishit, duke më shpëtuar mua që iu nënshtrova prishjes, nëpërmjet vjedhjes së gjarpërit.

Ode III
E Hyjlindëses
Irmosi: Uranias apsidhos

»**P**erëndi që ke bërë apsid' në q'ell
»si çati,*[7] ti që je ndërtues i Kishës,[8]
»më siguro mua* në dashurin' tënde
»fort; je maja e çdo dëshire,* njerida-
»shës, edhe mbështetja për çdo
»besnik.

Si përkrahje dhe mbrojtje të jetës sime të kam,* ty o Virgjëresh' e kulluar, ti pra më qeveris* dhe në liman të më çosh, se ti na fal çdo të mirë,* ti besnikët përgjithmon' i mbron, Hyjlindëse.*

Po të lutem, o Zonjë, ma qetëso shpirtin tim* dhe pushoma shqotën e zemrës, se më bie zali,* se ti o Zonjë Mari, ke lindur Mbretin e Paqes,*[8a] Shpëtimtarin, Zotin Krisht, ti o Hyjlindëse.*

Mirëbërësin linde, që bëri çdo mirësi,* pasurisht të gjitha të mirat jepna të gjithëve,* se ti në dorë e ke, se ti ke lindur të fortin,* Shpëtimtarin, Zotin Krisht, ti o Hyjlindëse.*

Me sëmundje të liga dhe çfarëdo pasion,* dergjem un' i mjeri, o Zonjë, eja shëromë ti,* se s'të mungon asnjë gjë, i ke të gjitha të mirat,* je thesar për çdo shërim, ti o Hyjlindëse.*

E kryeengjëllit: Uq en sofia

Me forc' hyjnore,* gjeneral shum' i famshëm i engjëjve,* shkon përreth ti në çdo vend,* duke shpëtuar krejt nga çdo rrezik,* ne që e thërrasim fort emrin tënd plot me hir.

Si lajmëtari* edhe mbrojt'si i patur-përueshëm* i besnikëve je ti;* dhe udhëheqës për sa kan' humbur,*[9] je mësues gjithashtu, o gjeneral hyjnor.

Si një pasqyrë* shum' e pastër u bëre, e cila pret* madhërisht shfaqjet që vijn'* prej Shpirtit t' Shenjt' të nderuar fort,* Mihail me nam dhe i pari i engjëjve.

Hyjlindësore

Ai që bëri* me vullnetin e tij Mendjet që s'kan' lënd',* po banon vullnetarisht* në mitrën tënde lëndore, Zonj',* dhe në mish na shfaqet ai që nuk shihet dot.

Tjetri: O stereón vrontín

Qëndron pran' fronit të Trinis' së Shenjtë*[1] dhe hyjnizohesh prej andej,* edhe ndriçohesh shum' nga rrufe* që dërgohen që lartazi;* himnuesit e tu ndriço,* kryegjeneral zot'ror.

Sapo të pa Jisui të kesh një shpatë* në dorë, u çudit thell'sisht* nga pamja jote;[10] e zuri tmerr* dhe thërriste: Ç'urdhëron, Zot,* që të veproj tani në çast* un', pra shërbëtori yt.

Prej Perëndis' arkond i madh u bëre,* i kombit judaik[11] dikur,* por të krishterët i ndihmon,* kryegjeneral; çlirona* nga çdo shtrëngim si dhe nga çdo* nevojë që përballojm'.

Ejani, madhështim t'i japim Zotit;* na dha si mbrojtës shum' të madh* si edhe ndihmës në çdo shtrëngim* kryegjeneralin tonë;* pra nga barbarë të pabes',* me forc' na çliron gjithmon'.

Sa u rrëmbyen dhunshëm edhe janë* të robëruar mizorisht* në kombësi të huaja krejt,* t'i rikthesh shpejt, ti me lutjet* tek Perëndia, Zoti yn',* kryegjeneral i fort'.

Hyjlindësore

Si mal të madh të quan Danieli*[12] dhe Abakumi, si një mal* me çdo lloj hije[13] nga çdo virtyt,* i pleh'ruar, thot' Davidi,*[14] nga ku u mishërua Zoti,* që botën shpëton gjithnjë.

Irmosi: O stereón vrontín

»Forcon çdo bubullim', ndërton dhe »erën;*[15] forcomë pra, o Zoti im,* që »të himnoj ty sinqerisht* dhe të bëj

»dëshirën tënde,* se nuk ka një tjetër »shenjt* si ty, Perëndia[16] yn'.

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

Udhëheqës brigadash në qiell je;* shërbëtor i lavdisë së Perëndis'* u bëre ti denjësisht* me një urdh'r nga Krijuesi;* për të krishterët po ndërmjeton për shpëtim gjithnjë;*na nxjerr nga vështir'sitë me lavdin tënd jolëndor;* pra siç të ka hije* të lëvdojmë të gjithë;* himnojm' panairin tënd* madhështor dhe hyjnor me gaz,* Mihail kryegjeneral;* lutju Zotit Krisht Perëndi,* që të dhurojë pra ndjes' të* mëkateve* tek ata që kremtojn' çuditë e tua sot.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Urtësin'[17] edhe Fjalën ti e ke zën'* brenda barkut pa farë, pa djegie krejt;* e linde për botën ton'* sundimtarin e Gjithësis';* mban në pëqi atë që e mban fort çdo gjë në dor',* pra Krijimtarin si dhe ushqyesin botëror;* ndaj o Virgjëreshë e tër'shenjtë të lutem,* kur un' do qëndroj përball'* faqes së Krijimtarit tim,* të shpëtohem* nga çdo mëkat;* Zonj' e pastër dhe virgjëresh'* at'herë ndihmë dhe mbrojtje* ti më dhuro,* sepse, o e himnuar, mundesh të bësh sa do.

Ode IV
E Hyjlindëses
Irmosi: Isakíkoa Kírie

»Kam dëgjuar misterin qart'* të »ekonomis' sate dhe kuptova krejt* »vepra që ke bërë[18] dhe prandaj* »lavdërova un' hyjninë tënde, Zot.

Shën Mari o Hyjlindëse,* ti që linde Zotin, kapedanin ton',* zbute shqotën e pësimeve,* qetësoi valët e mëkateve.*

Ne të gjithë të lutemi,* dhembshurinë tënde tregona pa vones',* ti që linde njeridashësin,* Krishtin Shpëtimtarin e besnikëve.*

Për shumicën e dhuratave,* të falenderojmë ne mirënjohësit,* me këndime lavdëruese,* nënë virgjëreshë dhe Hyjlindëse.*

Ty të kemi përkrahëse* dhe fortesë të patundur dhe mbrojtëse,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* na shpëto përherë prej rreziqeve.*

E kryeengjëllit:
O kathímenos en dhoksi

Mendja e parë që krijoi Mendje të hyjshme vullnetarisht, në mes tyre ka bërë kryetar Mihailin, që ndriçohet me pjesëmarrjen e tërëpasur dhe shkëlqen me mendime të perëndishme.

O Mihail i tërëhimnuar, po thërret tek Trinia një himn të shenjtë[3] së bashku me Fronet, Autoritetet, Fuqitë, Pushtetet dhe Sundimet[19] e hyjshëm, duke na shpëtuar ne që të himnojmë.

Le të madhështojmë Krijuesin dhe Zotin e të gjithave, që nga dhembshuria na dha si roje tepër të madh, mur të parrëzueshëm dhe fortifikim, Mihailin, kryegjeneralin[2] e ndritshëm.

Hyjlindësore

Hyjtreguesi mësonte qëmoti mistikërisht dhe mendërisht në shpirt lindjen tënde paradoksale, o Virgjëreshë, duke të parë shumë qartë si mal plot me hije,[13] nga erdhi Perëndia i shenjtë i mishëruar.

Tjetri: Akíkoen o profitis

Siç e shtrive qëmoti përdhé popullin e madh të Senahirimit[20] me urdhër hyjnor, kështu dërrmoji ata të Agarës,[21] që luftojnë dhe sulmojnë kundër një populli besimtar, o Mihail kryegjeneral.[2]

Sa e tmerrshme pamja, sa e mrekullueshme bukuria, vërtet o Mihail, fort e shkëlqyeshme është lavdia jote, që u tregon të gjithë atyre që kanë mall për ty, duke bërë dukshëm çudi të panumërta.

Edhe pse ndodhesh në të lartat, zbret çdo herë poshtë në mënyrë të frikshme, duke nxjerrë nga shumë fatkeqësi, pikëllime dhe rreziqe gjithë ata që të ftojnë, o shërbëtor Perëndie.

Ja vendi i hyjshëm, ja strehimi i të pikëlluarve, ja shtëpia e tërëshenjtë, të cilën kryegjenerali vërtet i madh, e dëften liman i shumë të shpëtuarve .

U duke tek Arkipi hyjmendës si shtyllë zjarri, kur populli i paligjshëm nxitohej ta mbyste me ujëra të panumërta kishën tënde, o kryetar i Fuqive të sipërme.

Hyjlindësore

Gabrieli erdhi nga të lartat duke të thënë: Gëzohu, o e Tërëdëlirë![22] Pra bashkë me të thërrasim: Gëzohu, o portë, të cilën e kaloi vetëm Krishti Perëndi,[23] duke shpëtuar njerëzinë.

Ode V
E Hyjlindëses
Irmosi: Fótison imás

»**N**dritna ti, o Zot,* përmes urdhrave »të tua[24] ne,* si dhe me krahun tënd »shum' të fort', të lart',*[25] o njeridashës, »na jep paqen tënde[26] përgjithmon'.

Zemrën na e çel* me gëzim dhe ngazëllim o Zonj',* falna gazin e pasosur tani,* sepse ke lindur ti shkaktarin e gëzimeve.*

Zonjë na shpëto,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* prej helmeve si dhe rreziqeve,* se ti ke lindur[26a] Shpëtimtarin, paqeprurësin.[26b]*

Mjegullën largo* të mëkateve Hyjlindëse* me dritën tënde jetëdhënëse,* sepse ke lindur diellin e parajetëshëm.*

Zonjë na shëro,* nga pësimet e sëmundjeve,* na mëshiro edhe na vizito,* edhe shëndetin na dhuro me ndërmjetimin tënd.*

E kryeengjëllit: Asevís uk ópsonte

U shfaqe teksa paraprije Izraelin e vjetër, sipas urdhrave të atij që u duk tek të vdekshmit me trup lëndor, o Mihail i patrup, gjeneral i engjëjve.

Duke u hyjnizuar gjithmonë nëpërmjet ndriçimeve jolëndore nga pjesëmarrjet hyjnore, na furnizon edhe ne me shkëlqimin dritëdhënës, o i pari i engjëjve, që admirohesh në mënyrë të çuditshme.

Uzbukurua përmes Hirit kisha jote e hyjshme, se duke ardhur herë pas herë në të, e rrëfeve si det shërimesh dhe zmbrapsje pasionesh, o Mihail, i pari i engjëjve.[2]

Hyjlindësore

Të tregoi Perëndia më të lartë se engjëjt mendorë, duke u futur mistikërisht në mitrën tënde të paqortueshme, o e pacenuar; lutju atij gjithnjë të dhembshurojë ata që të himnojnë.

Tjetri: Anátilón mi Kírie

Predikuesit e Fjalës, duke i njohur që më parë çuditë që do të bëje në kishën tënde, o i pari i engjëjve,[2] i paralajmëruan tek të gjithë; dhe ne po shikojmë qartësisht përmbushjen e tyre.

Me këshillën tënde, o kryeengjëll, ngre shtëpi lutjeje në ujin që buron hirin, sepse pa shërimin e vajzës ai që më parë blasfemonte dhuratat.

Afrohuni, nxirrni[27] hir bashkë me përdëllim; para të gjithëve ndodhet burimi i pashtershëm i shërimeve, të cilin na e shfaqi kryegjenerali sipas shenjave hyjnore.

Në shtëpinë e hyjshme, o Mihail, i pari i engjëjve, dhënës i të mirave, u jepet të verbërve shikimi, të shurdhëve dëgjimi i pastër, gjithë të çalëve ecja e drejtë, memecëve të folurit e rregullt.[28]

Dërrmoje nxehjen e frikshme të barbarëve, që kërkojnë ta shfarosin grigjën tënde, o kryegjeneral, dhe çliroji robërit që u kapën prej tyre, që të të lavdërojnë gjithnjë tok me ne.

Hyjlindësore

Duke kapërcyer Fuqitë engjëllore dhe duke lindur Perëndinë e të gjithave dhe mbretin, o Virgjëreshë, bashkë me to lyp, o Zonjë e Tërëshenjtë, që të shpëtohemi.

Ode VI
E Hyjlindëses
Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»Do derdh lutjen* para Zotit Perë-»ndi* dhe atij do t'i tregoj hidhërimet* »që kam,[29] sepse* shpirti im është »mbushur* me çdo të keqe dhe jeta »po shkon në Hadh;*[30] pra si Jonai »lutem un':* Jetën time nga prishja, »ti ngrije, Zot.

Atij iu lut,* se prej vdekjes na shpë-toi,* si u dha nën thonjt' e vdekjes dhe vetë,* prapë tani* shpirtin tim ta shpëtojë,* nga shkatërrimi i vdekjes dërrmonjëse* dhe nga armiku ze-mërlig,* Biri yt, Zoti yt, o Hyjlindëse.*

Si mbrojtëse* ty të di dhe rojtëse,* të sigurt o Virgjëreshë për jetën,* ti i shpërndan,* gjithë ngasjet e liga* edhe veprime demonësh na i dëbon,* pra ty të lutem si gjithnjë:* Ti shpëto-më prej gjithë pësimeve.*

Fortes' e mur,* ty të kemi Zonja jon',* dhe shpëtim për shpirtrat tanë të plotë,* dhe ngushëllim* në mjerimet[30a] o Zonjë,* dhe n' errësirën me dritë na ngazëllon;*[30b] pra ti o Zonjë dhe tani,* nga pësimet, rreziqet ti na shpëto.*

Në shtrat tani* i sëmurë shtrirë jam* dhe për trupin tim shërim dot nuk gjendet,*[30c] vetëm pra ti,* që ke lindur për botën,* një Shpëtimtar dhe një mjek të sëmundjeve,* pra ty të lutem dhe tani:* Ti më ngri nga lëngatat Hyjlindëse.*

E kryeengjëllit:
Evóise protipón

Gëzohet shum'* tërësia shpres'tare dhe të himnon;* e lëvdojmë* Fjalën, Zotin, se na ka bashkuar ne,* edhe pse të vdekshëm,* Mihail, tok me engjëjt, se ësht' i mir'.

Shfaqeshe,* kampet e Izraelit shpë-tove ti*[20] dhe zbatoje* urdhërime hyj-nore, o gjeneral,* dhe armiqtë mpo-shtje* e i zhdukje krejt'sisht me triumf të madh.

T'u fal pra ty,* sapo bir i Naviut të pa me tmerr,*[10] pasi emrin* tënd, që ësht' i nderuar, e pyeti* i shtrënguar me frik'*[31] dhe me devotshmëri, taksiarku yn'.

Hyjlindësore

Ja, lum ai* popull që të lum'ron ty të

lumurën,* se ke lindur* Perëndinë e lumur absolutisht,* që i hyjnizoi* njer'zit me një bashkim që nuk shprehet dot.

Tjetri: Zali me lojismón

O kryeengjëll, me praninë tënde të frikshme ua prishe planet atyre që qëmoti deshën ta zhduknin me rrjedhje lumi ujin e bekimit që u dhe besnikëve.

Qëmoti Moisiu goditi një gur dhe rrodhën ujëra, por tani, o kryeengjëll hyjnor, pasi theve një gur, u gëlltitën rrjedhje lumenjsh, që deri tani dëshmojnë çudinë.

Ata që ishin të veshur qëmoti me maninë e idhujve dhe me errësirë feje të keqe, duke ardhur tek shtëpia jote e hyjshme, dritën e dijes merrnin plot shkëlqim nëpërmjet uratave të tua.

Pamja dhe natyra jote është e zjarrtë, i ndriçon nga një anë besimtarët, ndërsa nga ana tjetër i djeg[5] të pabesët, o kryegjeneral shërbëtorësh të hyjshëm, mbrojtës i atyre që të lavdërojnë me besë të sinqertë.

Duke imituar në të gjitha dhembshurinë hyjnore të Zotit, u shtrin dorën të përulurve dhe shëron dërrmime shpirtrash, i pushon dhembjet e atyre që vrapojnë tek ti.

Hyjlindësore

Të parapa ty profeti si libër ku u shkrua Fjala me gishtin e Atit,[32] o e Virgjër; atij lutju që të shkruhemi në librin e jetës,[33] ne që të lavdërojmë besërisht.

Irmosi: Zali me lojismón

»**P**asi më pushtoi turbullim mendi»mesh, më tërhoqi poshtë në fund »fajesh të panumërta; por ti, o »qeveritar i mirë, arri dhe shpëtomë.

Kontaqi
Ting. II Arhistrátije Theú

Gjeneral i Perëndis'* dhe shërbyes i lavdit,* udhëzuesi yn' je,* dhe kryetar engjëjsh të patrup,* përdëllim të madh për ne kërko,* për fitimin ton' shpirt'ror,* se je gjeneral i të patrupëve.

Shtëpia

The, o njeridashës, në Shkrimet e tua, se një shumicë engjëjsh gëzohen në qiell për një njeri që pendohet, o i pavdekshëm;[34] prandaj ne, duke qenë brenda paligjësish, o i pamëkatshëm, i vetëm zemërnjohës, guxojmë përditë të të përgjërohemi si i dhembshur, që të mëshirosh dhe t'u dërgosh poshtë të padenjëve kataniks, o Zot, duke na dhënë falje, se për të gjithë ne ndër-

mjeton pranë teje gjeneral i të patrupëve.

Sinaksari

Më 6 të të njëjtit muaj, kujtimi i çudisë paradoksale, që u bë në Kolosét të Frigjisë nga kryegjenerali Mihail.
Vargje: U shfaqe, o Mihail, Mendje, si djalë i ri në kishën tënde,/ duke e zhdukur në hon vërshimin e lumenjve.
Më 6, Mihaili prijës Mendjesh, fundosi në hon rrjedhën e lumenjve.

Në të njëjtën ditë, ndeshja e martirëve të shenjtë Evdhoksit, Zinonit, Romilit dhe Makarit.
Vargje: U prenë Evdhoksi, Romili, Zinoni/ dhe Makari; u lumuruan nga mbarimi.

Në të njëjtën ditë, të 1104 ushtarët e shenjtë dhe shën Kalodhota mbarojnë me shpatë.
Vargje: Të 1104 martirët/ mbarojnë së bashku me shpatë.
Kalodhota, duke ia prerë kokën me shpatë, qëndron pranë teje,/ dhënësit të të mirave, o Fjalë.

Në të njëjtën ditë, shenjtorët Fausti prift, Makari dhe Andrea murgj, Vivi, Qiriako, Dhionisi, Androniku dhe shenjtoret Andhropelagjia dhe Thekla; Theoktisti marinar dhe një tjetër Qiriako Qytetari mbarojnë me shpatë.
Vargje: Si la dheun me shpatë, Fausti u lartësua/ për ndriçimin e banesës së sipërme.
Duke vdekur me shpatë Makari, Andrea,/ udhëtuan bashkë rrugën e lumur.
Vivi mohon kurorën e virtytit,/ nëse nuk do të marrë edhe kurorën nga shpata.
Të dy ata që kishin një mendje me Dhionisin,/ i vrau së bashku me Dhionisin shpata.
Sa burrërore ishte Andhropelagjia/ para prerjes së kokës, si Thekla!
Theoktisti marinar drejton anijen e shpirtit/ në qiell, kur iu pre koka.
Qiriako Qytetar ishte, por përmes shpatës/ është anëtar i bashkësisë së martirëve.

Në të njëjtën ditë, ndodhi edhe përurimi i Hyjlindëses së Tërëshenjtë në Dhefteron, në shtëpinë e shën Irinit.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi mëshirona. Amin.

Ode VII
E Hyjlindëses
Irmosi: I ek tis Iudheas

»Tre Djem që nga Judea* përfundu»an si robër në Babilonë dikur,* me »besën e Triadhës kan' shkelur flakë »furre duke psalur me gaz e hir:* O »Perëndi atëror,* o Zot je i bekuar.

Për shpëtimin e botës,* në pëqi virgjëror ke banuar ti, o Jisu,* dhe nënën Virgjëreshë, e cila të ka lindur, na e bëre ne mbrojtëse.* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Birit plot me mëshirë,* që ke lindur, o nën' e kulluar, lutju për ne,* të na i ndjejë fajet dhe njollat shpirtërore, se thërresim me zë të madh:* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Thesarin e shpëtimit*[34a] dhe burimin e paprishjes ty Hyjlindësen pra,* kështjellën e përikjes dhe derën e pendimit ua shfaqe besnikëve.* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Sa po vijnë me shum' mall* edhe nën hijen tënde të gjithsigurtë, o Zonj',* denjo që të shërohen si shpirtrat e sëmurë k'shtu dhe trupat në vuajtje,* se Krishtin ton' shpëtimtar,* për ne ti e ke lindur.*

E kryeengjëllit: O dhiasosas en pirí

Duke vëzhguar Danieli, të pa të qëndrosh, o i lumur Gabriel, në formë rrufeje bashkë me të dhe ta urtësosh gjatë vizionit në Uval,[35] dhe pastaj Mihaili t'ia zbulojë atij.

Drejtuesit e engjëjve, Mihailin dhe Gabrielin hyjfaqës dhe dritëprurës, ngushëllimtarët tanë të mirë, mbrojtësit dhe ruajtësit, le t'i lavdërojmë me besë e me zë të lartë.

Meqë ishe i bukur, i tërëhijshëm dhe hyjfaqës, u bëre shpirtërisht udhëheqës i shërbëtorëve jolëndorë, o Mihail shumë i ndritshëm; pra së bashku me ta lutu për ne të gjithë.

Hyjlindësore

Gabriel kryeengjëlli duke e parë, o Vajzë, Fjalën e vërtetë dhe të përjetshme të Mendjes së madhe të banojë brenda teje në mënyrë të pashprehshme dhe të frikshme, thirri: Gëzohu, o fron i të Shumëlartit, o e bekuar.

Tjetri: Ti ikoni ti hrisí

Sapo të pa dikur Danieli të qëndrosh bashkë me të, i pushtuar nga frika, u tremb dhe duke iu afruar këmbëve të tua,[35] urtësohet qartësisht me zbulim misteresh të padukura, duke thirrur: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.

O kryegjeneral i Perëndisë, ata që me sulme kombesh rrëmbehen të lidhur në vende shumë të largëta dhe të thërrasin ty si mbrojtës, ti i rikthen duke thirrur me gëzim: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.

Koret e engjëjve duke të parë me mall të himnohesh nga koret e të vdekshmëve, mbushen me gaz të papërsëritshëm dhe lavdërojnë Perëndinë, i cili nga dhembshuria e tij e përbrend-

shme, i bashkoi mistikërisht të poshtmet me qielloret, o kryeengjëll Mihail.

Cili vend privohet nga çuditë e tua të panumërta? Cili qytet nuk të ka mbrojtës? Cili shpirt të munduarish nuk të fton si ndihmëtar ty, kryegjeneralin e Perëndisë, duke thirrur me hare: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.

Udhëzues i atyre që enden,[9] mbrojtës i atyre që pësojnë padrejtësi, ngushëllim i atyre që humbasin kurajën, liman shumë i qetë i atyre që mundohen nga erërat, garant mëkatarësh, vizitë e të sëmurëve, ndriçim i të errësuarve ti je, o kryeengjëll i Perëndisë.

Hyjlindësore

Meqenëse, o Zonjë e tërëdëlirë, ke lindur në mish Shpëtimtarin, Perëndinë, Çlirimtarin dhe Zotin, lutju atij gjithmonë, o e pacenuar, që të marrim zgjidhjen e të këqijave dhe faljen e mëkateve të shumta, duke himnuar dhembshuritë e tij të përmbimendshme.

Ode VIII
E Hyjlindëses
Irmosi: Ton Vasilea ton uranón

»Mbretin në qiejt,* që gjith' ushtrit' »engjëllore* e himnojnë edhe ju him»noni,* dhe e lartësoni gjithmon' në »gjithë jetët.

Mos i harro kurr',* o Virgjëresh' sa të luten,* të himnojnë me bes' e me shpresë,* dhe të lartësojnë me zë për gjithë jetët.*

Ti i shëron krejt,* përher' e pa u kursyer,* gjith' ata që të luten, o Zonjë,* dhe të lartësojnë që linde Zotin tonë.*

Ti më shëron krejt* nga gjith' sëmundjet e shpirtit* dhe nga dhembjet e trupit, o Zonjë;* të të lartësoj pra, o Virgjëresh' hirplote.*

Ti i largon krejt* sulmet dhe ngasjet e liga,* dhe pësimet, o Zonjë e virgjër,* pra të lartësojmë me zë për gjithë jetët.*

E kryeengjëllit: Litrotá tu pantós

Utregove gjeneral qeniesh mendore të patrup, ndërmjetues shpëtimtar i njerëzve, shërbëtor i hyjshëm Perëndie, o Mihail, duke psalur pa pushim: Të gjithë veprat, bekoni, himnoni Zotin.

O Mihail dhe Gabriel kryeengjëj, të dy ndriçues plot dritë, duke ndriçuar Krijesën me shkëlqimin e Hyjnisë së trindritshme, dëboni mjegullën e të këqijave.

Si kapitenë të mirë, o kryeengjëj, shpëtojeni tek limani i vullnetit hyjnor anijen time shpirtërore, e cila bie në turbullim mëkatesh dhe rrezikon.

Hyjlindësore

Kryeengjëlli i hyjshëm, kur të erdhi si një stolisës nuseje, të tha: Gëzohu, o nuse e panusëruar e Perëndisë, lavdia e engjëjve, shpëtimi dhe muri i fortifikuar i njerëzve.

Tjetri: Ji qe panta ta en aftí

Kalon nëpër dheun si rrufe, duke zbatuar vullnetin hyjnor, patrullon nëpër qiej, duke paraprirë engjëjt; lavdia jote është e madhe dhe përmbi mendje janë mrekullitë e panumërta, që bën në mënyrë të frikshme në të gjithë Krijesën.

Ata që panë me sytë e tyre, atë që u duk me trup mbi dhé për ne, Filipi i tërëlavdëruar dhe Theologu shumë i madh, me frymëzim hyjnor, parathonë plot urtësi hirin e vazhdueshëm të shërimeve të tua, o i pari i engjëjve.

Qëmoti me shkop Moisiu preu detin; dhe tani kryegjenerali i Perëndisë me fuqinë e padukshme të shfaqur si shkop, devijon si me hon drejt gurit ujërat që dyndeshin me tërbim.

Si qiell fort i madh tregohet shtëpia e respektuar e kryetarit të engjëjve, në të cilën me çuditë si yje ndriçohen gjithë zemrat e besimtarëve, duke lavdëruar përjetë Perëndinë mirëdhënës.

Ashtu si qëmoti pengove vrullin e paplogjikshëm të Valaamit me ndalimin e mençur dhe të frikshëm të kafshës së palogjikshme,[36] kështu bijtë e Agarës,[21] që lëvizin pa logjikë herë pas here kundër nesh, tregoi humbës me lutjet e tua, o gjeneral i engjëjve.

Hyjlindësore

Linde zjarr që nuk e flakëroi aspak barkun tënd, o Virgjëreshë; linde Fjalë Perëndie, që çliron nga çmenduria ata që iu bindën fjalëve të mashtruesit dhe nuk iu bindën Perëndisë njeridashës, që i kishte bërë.

Irmosi: Ji qe panta ta en aftí

»Toka dhe të gjitha në të, deti dhe »gjithë burimet, qiejt e qiejve, drita »dhe errësira, të ftohtit dhe vapa, bijtë »e njerëzve, priftërinj, bekoni Zotin dhe »e përmbilartësoni në gjithë jetët.[37]

Ode IX
E Hyjlindëses
Irmosi: Kirios Theotokon

»Pohojm' se je Hyjlind'sja,* ne që u »shpëtuam* nëpërmjet teje, e shenjt', »Virgjëreshë e d'lir';* me koret e të »patrupve të madhështojmë ty.

Shiko si qaj me lotë,* edhe mëshiromë,* se ti ke fshirë çdo lot prej fytyrave,*[37a] o Virgjëreshë dhe Zonjë që linde Zotin Krisht.*

Gëzoje zemrën time,* Zonjë Virgjëreshë,* se ti ke lindur gëzimin për njerëzit,* dhe zhduke çdo helm me ndjesën e gjith' mëkateve.*

Liman dhe mbrojtje bëhu,* Zonjë Virgjëreshë,* kështjell' e mur i patundur, Hyjlindëse,* përikje, ndihmë dhe mbrojtje e gjithë njerëzve.*

Me rrezet dhe me dritë* ndritna Virgjëreshë,* edhe largo errësirën e mendjeve* t' atyre që të lëçitin Zonjë Hyjlindëse.*

Shëromë Virgjëreshë,* se jam i përmbysur,* edhe po dergjem në shtratin e vuajtjes,* po eja ngremë dhe falmë shëndet edhe shpëtim.*

E kryeengjëllit: Eva men to tis parakoís

Kryeengjëll, ja ku hijeshia e shtëpis'* sate hyjshëm po shkëlqen më ty,* se je k'tu me prani të ndritshme;* lëshon dhe rrezet e mrekullive pra;* dëbon dhe errësirë sëmundjesh ti* herë pas here, dhe me hir hyjnor.

Si një çift i bukur dhe gazmor i Zotit ton'* urdh'rat e tij i shërbeni mir'* për ne, që jemi përmbi tokë* dhe na shpëtoni, o kryeengjëj, ne* nga ngasje; edhe dërgoni tek ne të gjith'* ndriçim shpëtimi krejt nga Shpirt i Shenjt'.

Sot së bashku me ne po gëzohen engjëjtë* e patrupë, Mendjet, se shikojn'* që përhimnohet nga të gjithë* i madhi, kryeengjëlli që gëzon* edhe që kërkon shpëtim për të gjithë ne,* edhe çlirim nga paudh'sit' që bëjm'.

Ju, o çift i shenjt' dhe rrezatues, Mihail* shum' i respektuar, Gabriel* i lavdëruar, kryeengjëj,* qëndroni pran' Trinisë së Shenjtë[1] bashk';* prandaj, na shpëtoni nga faj' mëkatesh ju* edhe nga Ferri i përjetëshëm.

Hyjlindësore

Zure me një zë të Gabrielit, engjëllit,*[22] Fjalën Perëndi, o Zonja jon',* që me një fjal' ka bër' ushtritë* e sipërme dhe jep fjalë tek ata* që e përhimnojn' but'sinë e tij për ne* mbi çdo logjikë, përmbi çdo mendim.

Tjetri: Epíise kratos

Ushfaqe tek njer'zit* sa i dhembshur je, o Krisht;* kështu ti u ke dhën' atyre engjëjt;*[9] i mbrojnë k'ta nga çdo dëm* edhe dhimbje gjithashtu;* dhe bashk' me ta Mihailin tënd;* pra nëpërmjet tij, o Zot,* lypim:[38] Na dhuro ne falje mëkatesh, larje.

Si forc' dhe fuqi ty* të ka mbreti shprehetar* dhe aleat ndaj kombesh armiq'sore,* që jan' gjakatare shumë,* dhe me ty, o gjeneral,* ai mposht çdo çmenduri gjithmon';* falenderime, himne* te Krijuesi dërgon përmes teje përher'.

Për ty me mall psalin* shpresëtarët përgjithmon',* për ty, që në të lartat pa pushim psal,* me mij'ra e mijëra,* tingull dhe himn trishenjtor;*[1] çlirona të gjith' nga çdo mundim,* nga fatkeqësi e zezë* dhe na sill drejt Perëndis', o i madh ndër engjëjt.

Kërce ti përpjetë,* o Krijesë, dhe himno* të madhin, kryeengjëllin e Zotit,* se ësht' udhëzuesi* për të humburit në rrug',*[9] liman për sa janë në tundim,* në fatkeq'si të tmerrshme* dhe burim çudish edhe një mjek në sëmundje.[6]

Eke shenjtëruar,* e ke bërë si burim* çudish pra këtë kishë të nderuar;* në të po qëndrojmë bashk'* dhe thërrasim besërisht:* Kërko, kryeengjëll, për të gjith'* prej Perëndisë falje* dhe çlirim nga fatkeq'si dhe qet'si të plotë.

Hyjlindësore

Uduke, o Zonjë,* më e gjer' se qiejtë;* e zure pa shpjegim ti Perëndinë,* dhe koret që nuk kan' trup* e himnojn' mistikërisht;* atij përgjëroju, o e d'lir',* që të shpëtojm' të gjithë* ne që po të lumërojm' pa fund me zë gazi.

Irmosi: Epíse kratos

»**E** bëri pushtetin* përmes krahut të »atij,* tiranët i rrëzoi krejt nga fro»net;* të mjer' lartësoi pra* Perëndia »i Judes'* dhe na vizitoi dhembshu»risht* ai që Lindje është* nga lart; »na drejtoi ne nëpër udh' me paqe.

Dërgimësore
Jinekes akutísthite

Ju mblidhuni dhe shihni qart',* e gjithë njerëzia jon',* një çudi paradoksale,* e cila u bë në Hones;* pra Mihaili i patrup* me një shkop gurin theu krejt* edhe lumenj i hodhi larg,* të cilët zbrisnin të çrregullt* ndaj ujit të shenjt', të hyjshëm.

Hyjlindësore E ngjashme

Uflaka tej ikonës, un'*[39] i mjeri, nga kjo që mora,* që Zoti më kishte dhënë,* pësova nga papërmbajtja;*[40] por Krisht, që je i dhembshur shum',* ke marr' pjes' pa ndonjë shpjegim* nga un' që kam natyr' të mjer',* dhe k'shtu më ke përtëritur* nga gjaku krejt virgjëror ti.

Lavdërime
Ting. I Ton uranion tagmaton

Një panair ne në botë si engjëj bëjm' me gaz* atij që ësht' mbi fronin* e lavdis',[41] Perëndisë,* le t'i th'rrasim himn: I shenjtë je ti,* Ati që je në qiejtë,* e shenjt' dhe Fjal' e përjetshme bashkë me të* edhe Shpirti i tër'shenjtë tok.[3]

(2x)

I pari në qielloret dhe me guxim të madh* dhe që qëndron pran' fronit* të lavdisë pa masë,*[1] sheh, o Mihail, dëshmor okular* gjeneral,[2] sa nuk shprehen dot;* me ndërmjetimet e tua shpëtona ne* jemi në rrezik, tundim, ngacmim.

Pa diskutim je i pari i të patrupëve* edhe epror, shërbyes,* dëshmitar okular ti,* njohës i ndriçimit t' shenjt'; na shpëto,* Mihail kryeengjëll,[2] ne* që të nderojmë çdo vit shpres'tarisht me mall,* dhe Trinin' himnojmë besërisht.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Kudo që do hijesojë hiri yt, o kryeengjëll, prej andej fuqia e djallit dëbohet,[42] se nuk duron të qëndrojë pranë dritës sate, eosfori që ra;[43] prandaj të kërkojmë, shigjetat e tij zjarrprurëse që lëvizin kundër nesh, shuaji, duke na çliruar me ndërmjetimin tënd nga skandalet e tij, o Mihail kryeengjëll, që meriton të himnohesh.

Tani

Ty të lumërojmë, o Hyjlind'se e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i parë Ode III, nga i dytë Ode VI.

Kungatore: Ai që i bën engjëjt e tij frymëra dhe shërbyesit e tij flakë zjarri.

CITIME

[1] Tobit 12.15; Matth. 18.10; Lluk. 1.19

[2] Jis. N. 5.14; Dan. 12.1; Juda 9; Apok. 12.7

[3] Is. 6.3

[4] Ps. 102(103).21; Dan. 10.11; Hebr. 1.14

[5] Ps. 103(104).4

[6] Tobit 12.14

[7] Gjen. 1.7; Is. 40.22

[8] Ef. 2.20-21

[8a] Is. 9.6

[9] Ps. 90(91).11; Tobit 5.17

[10] Jis. N. 5.13-15

[11] Dan. 10.21

[12] Dan. 2.34-35

[13] Abak. 3.3

[14] Ps. 67(68).15-17

[15] Amos 4.13

[16] I Mbret. [Sam.] 2.2

[17] I Kor. 1.24

[18] Abak. 3.1-2

[19] Kol. 1.16

[20] IV [II] Mbret. 19.35

[21] Gjen. 21.14

[22] Lluk. 1.28

[23] Jez. 44.2-3

[24] Is. 26.9

[25] Eks. 32.11

[26] Is. 9.6; Joan 14.27

[26a] I Kor. 1.30

[26b] Fil. 4.7

[27] Is. 12.3

[28] Matth. 11.5; Lluk. 4.18; 7.22

[29] I Mbret. [Sam.] 1.15; Ps. 141(142).3

[30] Ps. 87(88).4

[30a] II Mbret. [Sam.] 22.20; Ps. 4.2;
Ps. 117(118).5

[30b] Joan 5.35

[30c] Ps. 37(38).4,8

[31] Gjyq. 13.17-22

[32] Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10

[33] Apok. 3.5

[34] Lluk. 15.7,10

[34a] Is. 33.6

[35] Dan. 8.15-19

[36] Num. 22.21-35

[37] Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 28-67

[37a] Apok. 7.17; 21.4

[38] Tobit 12.12

[39] Gjen. 1.26-27; 5.1,3; 9.6; Urt. Sol. 2.23;
Sirak 17.3

[40] Gjen. 3.24

[41] Is. 6.1; Jez. 1.13-26; 10. 1-2;
Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 32; 7.9;
Apok. 4.2; 6.16; 7.15; 21.5

[42] Juda 9

[43] Is. 14.12

MË 8 TË TË NJËJTIT MUAJ

Lindja e Hyjlindëses sonë të Tërëshenjtë dhe Virgjëreshës Mari.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 Vargëzime ngjallësore dhe 6 të së kremtes. Lavdi dhe Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i së kremtes. Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes 2 herë.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e së kremtes dhe Himnet Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, nga 2 Ndenjësore ngjallësore dhe 1 e së kremtes. Pas Polieleit (Fjalë e mirë, Aliluia: Psalmi 44), Ndenjësore e tretë 2 herë. Menjëherë (Bekimtoret nuk thuhen) Përsëri dhe përsëri. Se i bekuar është emri yt. Ipakoia dhe Shkallesat e tingullit. Proqimeni i së kremtes. Çdo frymë. Ungjilli i së kremtes. Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 hima. Lavdi Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.Tani i njëjti. Përdëllemë dhe Idhiomeli i së kremtes. Kanunet: ngjallësor dhe dy të së kremtes me varg "E përmbishenjtë Hyjlindëse…". Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Ndenjësorja e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes dhe Sinaksari i ditës. Zbritësoret Një kryq vijosi. Në vend të Më të nderuarën, psalen të dy Kanunet e së kremtes. Dërgimësoret: ngjallësore dhe dy të së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes. Lavdi i së kremtes. Tani E Përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes, por me "… që u ngjalle së vdekurësh". Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i së Dielës para Lartësimit. Në Veçan për të Tërëshenjtën, Irmosi i dytë i Odes IX: E huaj është' virgjëria. Kungatore Kupë shpëtimi.

NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Vargëzime

Ting. I Ton uranion tagmaton

Joakimi dhe Ana bëjnë panair, sepse kanë lindur nisjen e shpëtimit tonë, Hyjlindësen e vetme. Me ta edhe ne festojmë sot së bashku, duke e lumuruar atë që doli nga kjo rrënjë e Jeseut,[1] Virgjëreshën e dëlirë.

Sot nga Ana mbiu shkopi,[1] bima e perëndidhënë, Hyjlindësja, shpëtimi i njerëzve. Prej asaj duke lindur mbi çdo mendim Krijuesi i të gjithave, si i

mirë pastron çdo mjerim të Adamit me mirësi.

Vajza perëndinxënëse dhe Hyjlindësja e kulluar, lavdia e profetëve, bija e Davidit, sot lindet nga Joakimi dhe Ana e mençur dhe kthen mbrapsht me lindjen e saj mallkimin e Adamit kundër nesh.

Dheu që ishte jopjellor, lind tokë pjellore dhe nga mitër jopjellore jep fryt të shenjtë dhe e ushqen me qumësht: Çudi e frikshme! Ushqyesja e jetës sonë, që pranoi bukën qiellore në bark, mëkohet nga gjiri.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. II*

Ejani të gjithë ju që doni virgjërinë dhe dëlirësinë, ejani prisni me mall mburrjen e virgjërisë, që buron nga gur i qëndrueshëm dhe nga beronja burimin e jetës,[2] ferrën e zjarrit jolëndor,[3] që pastron dhe ndriçon shpirtrat tanë.

Pasvargje
Ting. II Ikos tu Efratá

Fëmija e Joakimit dhe Anës, Virgjëresha, u duk te njerëzit për t'i çliruar të gjithë nga prangat e mëkatit.

Varg: Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule veshin tënd, dhe harro popullin tënd dhe shtëpinë e atit tënd, edhe do të dëshirojë mbreti bukurinë tënde.

Shterpësia e Anës u duk vërtet mal plot hije,[4] nga u dhurua shpëtimi për të gjithë besëmirët.

Varg: Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.

Duke thyer prangat e shterpësisë së Anës, Virgjëresha e tërëkulluar doli tek njerëzit duke dhënë si çmim faljen.

Lavdi *dhe* Tani *I ngjashëm*

Le të vijmë ne besnikët duke lavdëruar Vajzën, sepse u lind nga beronja duke e ripërtëritur natyrën tonë të shterpëzuar.

Përlëshore Ting. IV

Lindja jote, o Hyjlindëse.

NË MBRËMËSOREN E MADHE

Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit (Lum ai njeri), Thirrtoret: 6 Idhiomele

Ting. Tërth. II I Sergjit

Sot Perëndia që prehet në fronet mendore,[5] përgatiti për vete një fron të shenjtë mbi tokë. Ai që përforcoi me urtësi qiejt,[6] bëri me njeridashje një qiell të gjallë; sepse nga rrënjë e pafrytshme na nxori bimë jetëprurëse, nënën

e tij. O Perëndi i çudive[7] dhe shpresa e të dëshpëruarve, o Zot, lavdi më ty.

I njëjti

Kjo është ditë e Zotit, ngazëllohuni,[8] o popuj; se ja nusërorja e dritës[9] dhe libri i Fjalës së jetës doli nga barku; dhe pasi lindi porta që shikon nga lindja, pret hyrjen e Priftit të madh,[10] meqenëse vetëm ajo sjell vetëm Krishtin brenda në botë për shpëtimin e shpirtrave tanë.

I njëjti

Edhe pse me vullnet hyjnor, gra të shquara shterpa nxorën lastarë,[11] por Maria perëndishëm ndriçoi më tepër se të gjitha këto që lindën, sepse duke u lindur nga nënë e pafrytshme në mënyrë paradoksale, lindi në mish përmbinatyrshëm nga barku i pafarë Perëndinë e të gjithave. Është porta e vetme e Birit të Vetëmlindur të Perëndisë, të cilën pasi e kaloi, e ruajti të mbyllur.[10] Dhe duke i sistemuar të gjitha urtësisht, siç di ai, punoi shpëtimin për të gjithë njerëzit.

I njëjti I Stefan Ajiopolitit

Sot hapen dyert sterile dhe del porta[10] virgjërore e hyjnueshme. Sot fillon hiri të japë fryt duke i paraqitur botës nënë Perëndie, nëpërmjet së cilës tokësoret bashkohen me qiejt për shpëtimin e shpirtrave tanë.

I njëjti

Sot është paranisja e gëzimit botëror. Sot fryjnë fllade paralajmëruese shpëtimi. U shpërbë shterpësia e natyrës sonë, sepse beronja dëftehet si nënë e asaj që mbeti e virgjër pas lindjes së Krijuesit, nga e cila Perëndia nga natyra, adopton të huajën dhe me anë të mishit përgatit shpëtim për të mashtruarit, Krishti njeridashës dhe çlirimtari i shpirtrave tanë.

I njëjti

Sot Ana beronjë lind perëndibijën, që u parazgjodh nga gjithë gjeneratat për Krishtin Perëndi, mbretin e të gjithëve dhe Krijuesin, për banim, për përmbushje të ekonomisë hyjnore. Nëpërmjet asaj u rigatuam ne të dheshmit dhe u ripërtërimë nga prishja për jetë të pafundme.

Lavdi *dhe* Tani *I njëjti I Sergjit*

Sot Perëndia që prehet në fronet mendore,[5] përgatiti për vete një fron të shenjtë mbi tokë. Ai që përforcoi me urtësi qiejt,[6] bëri me njeridashje një qiell të gjallë; sepse nga rrënjë e pafrytshme na nxori bimë jetëprurëse, nënën e tij. O Perëndi i çudive[7] dhe

shpresa e të dëshpëruarve, o Zot, lavdi më ty.

Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës dhe Leximet.*

Këndimi i Gjenezës
(28.10-17)

Doli Jakovi nga pusi i betimit dhe shkoi në Harran dhe gjeti një vend dhe fjeti aty, sepse perëndoi dielli. Dhe mori një nga gurët e vendit dhe e vuri nën kokën e tij edhe fjeti në atë vend edhe pa një ëndërr. Dhe ja, një shkallë e mbështetur në tokë, maja e së cilës arrinte në qiell dhe engjëjt e Perëndisë ngjiteshin dhe zbrisnin mbi të, ndërsa Zoti po mbështetej mbi të, dhe tha: Unë *jam* Perëndia i Abrahamit, atit tënd dhe Perëndia i Isaakut; mos ki frikë. Toka mbi të cilën ti fle mbi të, ty dhe farës sate do t'ia jap. Dhe do të jetë fara jote si rëra e dheut dhe do të shtrihet në perëndim dhe në jug, dhe në veri, dhe në lindje. Dhe do të bekohen në ty dhe në farën tënde të gjitha fiset e tokës. Dhe ja, unë *do të jem* me ty, duke të ruajtur në çdo udhë ku do të ecësh. Dhe do të të kthej në këtë tokë, sepse nuk do të të braktis derisa të bëj gjitha ato që të thashë. Dhe u ngrit Jakovi nga gjumi i tij dhe tha: Se është Zoti në këtë vend, kurse unë nuk e dija. Dhe u frikësua dhe tha: Sa i frikshëm qenka ky vend! Nuk është ky, veçse shtëpi Perëndie dhe kjo *është* porta e qiellit.

Këndimi i profecisë së Jezekielit
(43.27; 44.1-4)

Do të jetë që nga dita e tetë dhe më pas, do të bëjnë priftërinjtë mbi altarin holokaustet tuaja dhe ato të shpëtimit tuaj. Dhe do t'ju pranoj, thotë Zoti. Dhe më ktheu drejt udhës së portës së jashtme të të Shenjtave që sheh nga lindja dhe ajo ishte e mbyllur. Dhe Zoti tha tek unë: Kjo portë do të jetë e mbyllur, nuk do të hapet dhe askush nuk do të kalojë nëpërmjet saj, se Zoti, Perëndia i Izraelit do të hyjë përmes saj dhe do të jetë e mbyllur, sepse ky prijës rri mbi të që të hajë bukë. Ai do të hyjë nga udha e portës së Elamit dhe nga udha e tij do të dalë. Dhe më futi nga udha e portës, *që ishte* drejt veriut përballë shtëpisë. Dhe pashë, dhe ja plot lavdi *ishte* shtëpia e Zotit.

Këndimi i Fjalëve të Urta
(9.1-11)

Urtësia ndërtoi për vete shtëpi dhe mbështeti shtatë shtylla. Theri viktimat e saj dhe përzjeu në kanë verën e saj dhe përgatiti tryezën e saj. Dërgoi shërbëtorët e saj duke ftuar me shpallje të lartë mbi kanë, duke

thënë ajo: Ai që është i metë le të kthehet tek unë. Dhe atyre që ishin të varfër nga mendja u tha: Ejani, hani bukën time dhe pini verën që ju kam përzier. Braktisni idiotësinë dhe do të rroni; dhe kërkoni urtësinë që të jetoni dhe që të arrini mençurinë me dije. Ai që edukon të keqij do të marrë për vete çnderim dhe duke kritikuar të pabesin do të qortojë veten e tij. Sepse kritikat për të pabesin *janë* plagë për atë. Mos kritiko të këqij, që të mos të të urrejnë; kritiko të urtin dhe do të të dojë. Jepi të urtit një shkak dhe do të jetë më i urtë; bëj të ditur tek i drejti dhe do të shtojë të pranojë. Fillim urtësie *është* frika e Zotit dhe mendim shenjtorësh *është* mençuria. Ndërsa dija e ligjit i përket mendjes së mirë, sepse në këtë mënyrë do të jetosh shumë kohë dhe do të të shtohen vite jete.

Në Liti
Ting. I I Stefan Ajiopolitit

Fillimi i shpëtimit tonë, o popuj, sot u bë; se ja, e paracaktuar nga gjenerata e lashtë, nëna dhe virgjëresha edhe enë e Perëndisë vjen që të lindet nga beronja. Doli lule nga Jeseu dhe nga rrënja e tij, shkop.[1] Le të dëfrehet Adami stërgjyshi edhe Eva le të ngazëllohet me hare; se ja, ajo që u ndërtua nga brinja e Adamit, lumëron dukshëm bijën dhe pasardhësen, sepse thotë: Më lindi çlirim, që përmes saj të çlirohem nga vargonjtë e Hadhit. Le të ngazëllohet Davidi duke i rënë kitarës[12] dhe le të bekojë Perëndinë; sepse ja, Virgjëresha del nga gur steril,[2] për shpëtimin e shpirtrave tanë.

Ting. II

Ejani të gjithë ju që doni virgjërinë dhe dëlirësinë, ejani prisni me mall mburrjen e virgjërisë, që buron nga gur i qëndrueshëm dhe nga beronja burimin e jetës,[2] ferrën e zjarrit jolëndor,[3] që pastron dhe ndriçon shpirtrat tanë.

I njëjti I Anatoliut

Cili është tingulli i kremtuesve? Joakimi dhe Ana bëjnë panair mistikërisht duke thënë: Gëzohuni bashkë me ne, o Adam dhe Eva, se qëmoti me një shkelje ju mbyllët Parajsën, sot juve ju dha fryt i lavdëruar fort Maria, duke e çelur hyrjen për të gjithë.

I njëjti

E paracaktuar tërëmbretëresha, banesë Perëndie, doli sot nga barku i pafrytshëm i Anës së lavdëruar, tempulli i hyjshëm i substancës së përjetshme, përmes së cilës Hadhi arrogant është shkelur dhe Eva strehohet me tërë gji-

ndjen në jetë të sigurt. Le t'i thërrasim asaj denjësisht: E lumur je ti në mes të grave dhe fryti i barkut tënd është i bekuar.[13]

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. IV I Sergj Ajiopolitit

Në ditën e shquar të së kremtes sonë, le të trumbetojmë me kitarë shpirtërore; sepse lindet sot ajo që është nga fara e Davidit, nëna e jetës, duke zgjidhur errësirën, rigatimi i Adamit dhe rithirrja e Evës, burimi i paprishjes dhe çlirimi nga prishja, nëpërmjet së cilës ne u hyjnizuam dhe u çliruam nga vdekja. Dhe le t'i thërrasim ne besimtarët bashkë me Gabrielin: Gëzohu, o e hirshme, Zoti është me ty,[13a] ai që nëpërmjet teje na fal përdëllimin e madh.

Pasvargje Idhiomele
Ting. IV I Gjermanoit patriark

Hareja botërore na lindi si diell nga të drejtët Joakimi dhe Ana, Virgjëresha e tërëhimnuar, e cila nga mirësia e skajshme bëhet tempull i gjallë Perëndie dhe vetëm ajo njihet Hyjlindëse me të vërtetë. Me ndërmjetimet e saj, o Krisht Perëndi, dërgo nga lart në botë paqen dhe tek shpirtrat tanë përdëllimin e madh.

Varg: Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule veshin tënd, dhe harro popullin tënd dhe shtëpinë e atit tënd, edhe do të dëshirojë mbreti bukurinë tënde.

Me parathënie engjëlli nga të drejtët Joakimi dhe Ana dole sot si fëmijë e gjithërespektuar, o Virgjëreshë, qiell dhe fron Perëndie dhe enë pastërtie, duke i paralajmëruar gëzimin gjithë botës, o arsyeja e jetës sonë, shfuqizim mallkimi, shpërblim bekimi; ndaj në lindjen tënde, o Vajzë e perëndithirrur, lutu për paqen dhe përdëllimin e madh për shpirtrat tanë.

Varg: Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.

Duke qenë Ana beronjë e pafrytshme, sot le të duartrokasë me ngazëllim, le të vishen me shkëlqim tokësoret, mbretër le të kërcejnë, priftërinj le të dëfrehen në bekime; le të kremtojë e gjithë bota, se ja mbretëresha dhe nusja e paqortueshme e Atit, mbiu prej rrënjës së Jeseut.[1] Gratë nuk do lindin më fëmijë në pikëllime, sepse lulëzoi gëzimi dhe jeta e njerëzve sillet brenda botës. Nuk kthehen më mbrapa dhuratat e Joakimit, sepse vajtimi i Anës u shndërrua në gëzim, ndërsa ajo thotë: Gëzohuni tok me mua tërë Izraeli i zgjedhur, sepse ja më ka dhënë Zoti pallatin e gjallë mbretëror të lavdisë së shenjtë të tij, për ngazëllim dhe hare të përbashkët dhe për shpëtimin e shpirtrave tanë.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. IV I Sergj Ajiopolitit

Ejani të gjithë besimtarët, le të vrapojmë te Virgjëresha, se ja lindet nëna e Perëndisë tonë, që u paracaktua para zënies, thesari i virgjërisë, shkopi i Aaronit që nxori filiza[14] nga rrënja e Jeseut,[1] predikimi i profetëve dhe lastari i të drejtëve, Joakimit dhe Anës. Lindet pra, dhe bota së bashku me të ripërtërihet. Lindet dhe Kisha stoliset fort me hijeshinë e saj, tempulli i shenjtë, ena e Hyjnisë, mjeti shpirtëror, dhoma mbretërore,[15] brenda së cilës u krye misteri paradoksal i bashkimit të pashprehur të natyrave që u bashkuan me njëra-tjetrën në Krishtin. Duke iu falur, himnojmë lindjen krejt të paqortueshme të Virgjëreshës.

Përlëshore

Ting. IV

Lindja jote, o Hyjlindëse, i lajmëroi gaz gjithë botës, se prej teje lindi dielli i drejtësisë, Krishti Perëndia yn'; dhe duke zgjidhur mallkimin, dha bekimin dhe duke shkatërruar vdekjen, na dhuroi jetën e amshuar.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore

Ting. IV Kateplaji Iosíf

Thirre, o David, me zë,* ç'të ka premtuar Zoti yn'?* Sa më ka premtuar, thot',* i ka zbatuar krejtësisht;* dha Virgjëreshën nga fryti i barkut tim, pra* lindësen e Krishtit; Krijues ësht',* mbret mbi fronin tim[16] dhe Adam i ri,*[17] sot mbretëron ai që ka mbret'rinë* e palëkundur, që s'tundet dot.* Beronja po lind* Mari Hyjlind'sen,* që ushqen jetën tonë.

Lavdi *dhe* Tani *Të njëjtën*

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
E ngjashme

Përtërihet bota jon'* për Zotin dhe ribëhet prap',* se Maria lindet sot,* që ësht' fëmij' i Perëndisë.* Na del nga rrënj' e Jeseut,[1] nga mes Davidi.*[18] Bashk'gëzohuni qiej edhe tok',* fise kombesh tok lavdërojeni.* Dëfrehet Joakimi edhe Ana* bën panair dhe thërret me gaz:* Beronja po lind* Mari Hyjlind'sen,* që ushqen jetën tonë.

Lavdi *dhe* Tani *Të njëjtën*

Pas Polieleit, Ndenjësore

Ting. Tërth. IV
To prostahthén mistikós

Le të dëfrehet toka, qiejt le të ken' gaz,* se përmbi dhenë* lindi qielli i

Zotit,* nusja e Perëndisë,* pra sipas premtimit.* Beronja i jep gji foshnjës, Marisë son',* gëzohet shum' Joakimi* për lindjen sot* duke thën': Më ka lindur shkop, nga doli lule[1] pra Krishti nga rrënj' e Davidit[19] mbret,* mrekulli që çudit vërtet.

Lavdi *dhe* Tani *Të njëjtën*

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni
Ting. IV

Do ta kujtoj emrin tënd në gjithë brezat e brezave.

Varg: Nxori zemra ime fjalë të mirë.

Çdo frymë. Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.
Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.
Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. IV

Hareja botërore na lindi si diell nga të drejtët Joakimi dhe Ana, Virgjëresha e tërëhimnuar, e cila nga mirësia e skajshme bëhet tempull i gjallë Perëndie dhe vetëm ajo njihet Hyjlindëse me të vërtetë. Me ndërmjetimet e saj, o Krisht Perëndi, dërgo nga lart në botë paqen dhe tek shpirtrat tanë përdëllimin e madh.

Kanunet: Në 8 të zotit Joan, së bashku me Irmoset; dhe 6 të zotit Andrea.

Ode I
Kanuni i zotit Joan
Ting. II
Irmosi: Dhefte laí

»Popuj të gjith',* ejani që t'i kë»ndojm' Perëndis'* pra Krishtit, që ka »ndar' një det dhe udhëhoqi popullin »që e çliroi* nga zgjedha e Egjiptit, »se u lëvdua fort.

Ejani ju,* çdo besnik me gaz të Shpirtit të Shenjt',* sot ta nderojm' me himne Vajzën, që ësht' përgjithmon' virgjëreshë dhe erdhi* nga shterpa për shpëtimin tonë, të njerëzve.

G'zohu, e thjesht',* nënë edhe shërbëtore e d'lir'* e Perëndisë, ti që u shkaktove njerëzve lumturinë e lashtë;* të gjith' të lavdërojm' me himne ty denjësisht.

Po lindet sot* ura e jetës; përmes saj të gjith'* ne morëm shfuqizimin e rrëzimit brenda Hadhit, pra ty Krishtin tonë,* jet'dhënësin, të cilin e lavdërojm' me himn.

Kanuni i zotit Andrea
Ting. Tërth. IV
Irmosi: To sintrípsanti polemus

»Le të psalim Perëndinë* që dërrmoi »luftërat.* Me fuqin' e krahut të tij e

»kaloi Izraelin përmes* Detit të Kuq.
»I këndojm' si çlirimtarit tonë të lavdi-
»shëm fort.

Hidhe vallen, o Krijesë,* dhe dëfre ti, o David,* se nga fisi yt si dhe nga fara jote doli shkop, i cili* kishte si një lule[1] Krishtin, çlirimtarin e gjithçkaje, Zotin ton'.

I dor'zohet foshnj' e shenjtë* Tempullit të shenjtë sot,* Hierores pra të shenjt', që të ushqehet nga dor' engjëllore;* ndaj le të festojm' të gjithë besërisht për lindjen e saj ne bashkë.

Ish beronjë e pafrytshme,* por për Zotin jo pa f'mij'.* U paracaktua para brezash nën' e Virgjëreshës së d'lir',* nga ka lulëzuar Krijimtari i Gjith'sis' në formë skllavi pra.

Të lëvdojm' të gjith' me himne* ty, që Ana të lind sot;* shqerrë e panjollëshme je, që ke nxjerr' nga barku dhe i ke dhën'* leshin vetëm Krishtit ti dhe i ofrove krejt substancën ton', o Zonj'.

Lavdi

Lavdëroj tri të panisshme,* tri të shenjta po himnoj,* tri të bashk'përjetëshme në një substancë po i shpall me besë.* Një pra Perëndi në Atin, Birin edhe Shpirtin e Shenjt' e lëvdojm'.

Tani *Hyjlindësore*

Kush ka parë një fëmijë,* që s'e mbolli at' aspak,* që ushqehet po me qumësht, ose ku u pa një nën' e virgjër,* o Hyjlindëse? Të dyja janë mbi mendim me të vërtet', o Zonj'.

Zbritësore: Stavrón haraksas

»Një kryq vijosi me shkop* Moisi »profeti* dhe Det' i Kuq u ça më dysh »dhe Izraeli shkoj përtej,* pastaj pra»më e bashkoj* me të njëjtin shkop dhe »kryq përsipër valëve* dhe forcat edhe »qerret Faraonit ia mbyti, pra Krishtin »këndojmë si* Perëndi dhe Zot me »brohori dhe gaz.*

Ode III
Irmosi: Steréoson imás

»Forcona, sigurona, o Zot, në ty,* pra »ti që ke vrarë me dru mëkatin,* edhe »frikën tënde mbillna ti* në zemrat »tona, që të lavdërojnë ty.

Përpara Perëndis' pa fare qortim* jetuan hyjmendësit, ati, nëna* e asaj që lindi Perëndin'* pra Krijimtarin. Na lindën shpëtimin ton'.

Nga shterpa nxori Zoti, që jet' buron,* për ne të gjith' sot virgjëreshën, Vajzën.* Denjësoi dhe u fut në të,* dhe të paprishur e ruajti kur u lind.

Himnojm' të gjithë frytin e Anës sot,* Marinë, e cila ka lindur rrushin* jetëprurës, pra Hyjlindësen,* që është mbrojtje dhe ndihmë për çdo njeri.

Irmos tjetër: Estereothi i kardhia mu

»**U** sigurua zemra ime në Perëndinë,* »m'u lartësua në Zotin briri.* Goja ime »u zgjerua kundrejt armiqve, kisha gaz »për shpëtimin tënd.[19a]

Ësht' i bekuar barku yt, Ana shum' e mençur,* se lulëzove lulen e virgjër,* që pa farë lindi, pra çlirimtar Jisun', ushqyesin e Krijesës son'.

Të lumëron çdo krijes' ty, o e Tërëvirgjër,* e lindur sot nga Ana e mençur,* që je shkop i pacenuar nga rrënja e Jeseut, që nxori lulen[1] Krisht.

Të paraqet ty më të lart' se çdo krijes' Biri,* o Zonj' Hyjlind'se e papërlyer;* madhëron pra lindjen tënde prej Anës dhe kështu na dëfren të gjithë sot.

O Virgjëreshë dhe Hyjlindëse e panjollshme,* u rrite në Hieror' të shenjtë;* u dëftove më e lartë se çdo krijes', se linde në mish Krijuesin.

Lavdi

Të falem ty, o At' i panisshëm në substancë,* himnoj dhe Birin tënd të pakohshëm;* respektoj dhe të përjetëshmin Shpirt të gjith', një Zot nga natyra, të tre bashk'.

Tani *Hyjlindësore*

Na u tregove, o Hyjlind'se e pacenuar,* thesar i jetës dhe port' e dritës* qiellore, se ke lindur drit'dhënësin, fillimin e gjithë njerëzve.

Zbritësore: Ravdhos is tipon

»**S**hkopi një herë si një simbol i mi»sterit na u shfaq,* se filizat na tregu»an priftërinë,* edhe për Kishën bero»një ja ku mbiu edhe lulëzoi* Kryqi »tani për forcë dhe për siguri.*

Ipakoia Ting. II

Profeti e quajti Virgjëreshën e shenjtë portë të pakalueshme, që ruhej vetëm për Perëndinë tonë. Nëpërmjet saj kaloi Zoti, nga ajo doli i Shumëlarti dhe përsëri e la të vulosur duke e çliruar nga prishja jetën tonë.

Nëse do, thua Ndenjësore
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Virgjëresha Mariam,* me të vërtet' Hyjlindëse,* si një re e ndritshme[20] sot* na ka shkëlqyer qartësisht* dhe nga të drejtët na vjen për lavdinë tonë.* Nuk dënohet kurrë Adami më,* Eva nga vargonjtë çlirohet krejt.* Tek Virgjëresha pra që ësht' e vetmja* e d'lirë, th'rrasim me shum' guxim:* I lajmëron gaz* gjith' botës sonë* lindja jote, o Zonjë.

Lavdi *dhe* Tani *Të njëjtën*

Ode IV
Irmosi: Isakíkoa Kírie tin akoín

»Kam dëgjuar dëgjimin e ekonomisë »sate Perëndi, Zot,* dhe të lavdërova, »o njeridashës ty.

Të himnojmë ty, o Zot, që u ke dhënë gjithë besimtarëve liman shpëtimtar, pra nënën tënde.

Krishti të ka treguar mburrje dhe fuqi ty, o Perëndinuse, tek të gjithë ata që himnojnë me besë misterin tënd.

O Zonjë pa përvojë martese, duke u çliruar me lutjet e tua nga fajet, të lumërojmë të gjithë me mirënjohje.

Irmos tjetër: Akíkoa Kírie

»Dëgjova dëgjimin tënd dhe u frik'- »sova,[20a] se me vullnet të pashpreh- »shëm, o Zoti im,* ndon'se Perëndi, »Zot i përjetshëm dole nga virgjëresh' »me mish;* lavdi lavdisë sate, »Krisht,* dhe lavdi pushtetit tënd.

Duke lavdëruar, o besnikë, me psalme dhe himne lindjen e tërënderuar të Perëndilindëses, le t'i falemi të pagënjeshtrit, i cili u betua më parë te Davidi,[16] se do t'i jepte një fryt nga mesi i tij.[18]

E hape, o Zot, mitrën e Sarës, duke dhënë një fryt në pleqëri, Isaakun; i njëjti ti edhe sot, o Shpëtimtar, i ke dhënë Anës besëmirë një fryt pjellor prej mitrës, nënën tënde të panjollshme.

Le të thotë Ana: E dëgjove, o Zot, lutjen time dhe më dhe sot fryt premtimi, atë që u paracaktua nga gjithë gjeneratat dhe gratë, nëna jote e pacenuar.

Bashkëgëzohet me ty, o Ana hyjmendëse, bota e tërë, se lulëzove nënën e Çlirimtarit të saj, e cila mbiu nga rrënjë e Davidit, porsi shkop fuqie, që ka lule[1] për ne Krishtin.

Lavdi

Të lavdëroj, o Trini e pafillim, e pandarë në substancë, duke thirrur si Keruvimet me gjuhën time prej balte: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë[21] je ti që mbetesh përgjithmonë një Perëndi i përjetshëm.

Tani

Në lindjen tënde, o e kulluar, janë plotësuar profecitë e hyjfolësit që të emëronin besërisht tendë,[22] portë,[10] mal mendor,[23] ferrë[3] dhe shkop i Aaronit,[14] që mbiu nga rrënjë e Davidit.[19]

Zbritësore: Isakíkoa Kírie tis ikonomias su

»Kam dëgjuar, o Zoti Krisht,* si e »rregullove këtë mister të madh,* i »kuptova veprat që ke bër'* dhe të »lavdërova, Perëndia im.*

Ode V
Irmosi: O skiógrafon ahlín

»Krisht, drejtona në ndriçim* ne, ti »që ke shpërndarë* çdo mjegull të »enigmave hijeplota* dhe përmes »Hyjlindëses* plotësove të vërtetën* »dhe kështu ke ndriçuar fort zemrën »ton' me besim.

Le të himnojmë, o popuj, arsyen e bërjes sipas nesh të atij që është arsyeja e të gjithave. Kur profetët denjësoheshin për parafigurimin e saj, gëzoheshin, duke fituar shpëtimin e saj të qartë.

Lastari i bastunit të palëng të priftit shfaqi parapëlqim tek Izraeli.[14] Dhe tani bija e tërëlavdishme ndriçon si me pishtar shkëlqimin e atyre që nxorën lastar çuditërisht.

Irmos tjetër: Kírie o Theós imón irinin dhos

»O Zot dhe Perëndia ynë, jepna paqe »ti;* O Zot dhe Perëndia yn', na ki ne »pron';* o Zot, përveç teje tjetër nuk »njohëm dot dhe emrin tënd thërrasim »me besim.[23a]

Lindja jote është e panjollshme, o Virgjëreshë e pacenuar; zënia dhe dhimbja e lindjes e pashprehshme; lindja jote është e pathënshme, o nuse e panusëruar, sepse ishte Perëndi që më veshi mua me plotësi.

Sot le të dëfrehen brigada engjëjsh; le të kërcejnë me këngë ata që u linden prej Adamit, sepse u lind shkopi që nxjerr lulen,[1] Krishtin çlirimtarin e vetëm të Adamit.

Sot Eva është zgjidhur nga dënimi, edhe Adami është zgjidhur nga mallkimi i lashtë, duke thirrur me rastin e lindjes sate, o e pacenuar: Më ty u çliruam nga prishja.

Lavdi ty që lavdërove shterpën sot, se lindi nga premtimi shkopin që lulëzon gjithmonë, prej të cilit doli si lastar Krishti, lulja[1] e jetës sonë.

Lavdi

Të falemi, o Trini e panisshme, e pandarë, e pandërtuar, e bashkëpërjetshme dhe e bashkëmbirë, që shpallesh gjithnjë në një substancë, me tri hipostaza mbi çdo mendim.

Tani *Hyjlindësore*

Barku yt u bë Tryezë e Shenjtë; mbeti dëlirësia jote e padëmtuar, si më parë, o Virgjëreshë, sepse Krishti, Dielli, u shfaq prej teje si dhëndër nga dhoma martesore.[15]

Zbritësore: O trismakáriston ksilon

»O dru i lumur tri herë, përmbi të cilin »u nde pra mbret' i lartë Zoti Krisht,*

»se prej teje u rrëzua djalli gjarpër* i »gënjyer tmerrësisht prej Zotit të »mbërthyer përmbi kryq,* q'u fal »shpirtrave* përdëllim dhe paqe »përgjithmon'.*

Ode VI
Irmosi: Pros Kírion ek qitus

»Nga peshk' i madh tek Zoti, Jonai »thirri fort me zë:* Nxirrmë ti sipër, »jasht'* pra nga fundi i Hadhit k'tu »posht',* lutem, që të flijoj* për ty, »Çlirimtarin tim,* me zë lavdi dhe »shpirt të vërtet' dhe bes'.

Tek Zoti thirrën prind'rit hyjmendës të Hyjnënës son'* të pikëlluar, se* ishin shterpë, pa ndonjë fëmij'.* E lindën k'shtu atë* për të gjithë kohërat,* për shpëtim të përbashkët dhe mburrje krejt.

Dhuratë qiellore, e perëndidenjë hyjnisht,* prind'rit, hyjmendësit* të Hyjnënës e pranuan krejt,* mbajtësen më të lart'* se çdo Keruvim, që ësht'* nëna, lind'sja e Fjalës, Krijuesit.

Irmos tjetër: Os ídhata thalasis filánthrope

»Si ujëra në det më shtrëngojn', o »Njeridashës, gjith' tallazet e jetës »k'tu,* prandaj dhe un' thërras* tek »ti: Si Jonan' Perëndi i tër'dhembshur, »nxirre nga prishja jetën dhe më »shpëto.

Himnojmë lindjen tënde të shenjtë dhe nderojmë zënien tënde pa farë krejt;* e virgjër pra ti je,* nuse Perëndie; kërcejn' bashk' me ne plot gaz rreshta engjëjsh dhe shpirtrat e shenjtë.

Meqë ke qën' e shenjta e t' shenjtëve, o e panjoll'shme, të dorëzuan ty* në Tempull në Sion* prindërit e mençur, të rritesh me thjeshtësi dhe të përgatitesh për nën' Zoti.

Beronja edhe nëna kërceni; dhe ju gratë jopjellore kini guxim,* kërceni pra me gaz,* se beronja lindi Marin', që do zgjidhë Evën nga dhimbjet, Adamin nga nëma.

Dëgjoj Davidin që psal për ty: Do sillen vajza mbrapa teje, do sillen pra* te Tempulli mbret'ror.* Edhe un' së bashku me të, të himnoj ty bijën e mbretit,[24] o Zonjë, nëna jon'.

Lavdi

Misteri i Trinisë himnohet, lavdërohet në ty, o e panjollëshme,* se Ati deshi k'shtu* edhe mes nesh Fjala fushoi[25] dhe Shpirt hyjnor hijesoi mbi ty, Hyjlindëse.[26]

Tani *Hyjlindësore*

Ubëre temjanicë e artë,[27] meqë zjarri

tash fushoi në barkun tënd* nga Shpirti i Shenjt', pra* Fjala; dhe u shfaq me një pamje njeriu si ne, o Perëndilindëse e d'lir'.

Zbritësore: Notin thirós en splahnis

»Në barkun e bishës në det, profeti »shën Jona kish hapur duart në form' »kryqi* dhe pësimin e Krishtit paratre- »gonte qart'sisht* pra i triditshmi jasht' »u hodh dhe ngjalljen e përmbinatyrë- »shme e paralajmëroj* të Jisuit të mbër- »thyer mbi kryq për ne,* që na e ndriti »Krijesën me ngritjen prej varreve.*

Kontaqi
Ting. IV

Joakimi dhe Ana prej përqeshjes së pafëmijësisë dhe Adami e Eva u çliruan prej prishjes së vdekjes, me lindjen tënde të shenjtë, o e pacenuar, të kremton dhe populli yt, se u shpërblye nga barr' e fajeve duke thirrur: Beronja lind Hyjlindësen dhe ushqenjësen e jetës son'.*

Shtëpia

Lutja dhe bashkë me të psherëtima e shterpësisë dhe e mospasjes fëmijë të Joakimit dhe Anës ishte mirëpritur; dhe ka ardhur në veshët e Zotit dhe nxorën një fryt jetëprurës për botën; sepse ai bënte lutje në mal, ndërsa ajo në kopsht mban turp. Por me gëzim, beronja lind Hyjlindësen dhe ushqenjësen e jetës son'.*

Sinaksari

Më 8 të të njëjtit muaj, Lindja e Zonjës sonë së Tërëshenjtës, Hyjlindëses dhe gjithmonëvirgjërës Mari.
Vargje: Vërtet, o Ana, ti fiton mbi të gjitha nënat,/ derisa bija jote do bëhet nënë.
Nxori në dritë Ana Hyjnënën më 8.

Në të njëjtën ditë, vëllezërit e shenjtë Rufi dhe Rufiani mbarojnë me shpatë.
Vargje: Rufiani, duke përkulur veten e tij tek shpata,/ thotë: "Të pres, o Ruf, mos ki ndrojtje, më ndiq".

Në të njëjtën ditë, shën Seviri mbaron me shpatë.
Vargje: "Jam gati që të mbaj çdo pësim",/ – tha Seviri – "pra për mua vetëm shpata?!"

Në të njëjtën ditë, shën Artemidhori mbaron me zjarr.
Vargje: Artemidhori tregon me vepër, edhe kur zjarri flakërohet,/ se kërcen përpjetë nga fuqia.
Martiri i ri i shenjtë Athanasi, që u martirizua në Selanik në 1774 mbaron me varje.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Sofroni i Ahtalisë në Gjeorgji.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Irmosi: Vatos en ori piráflektos

»Ferr' e padjegshme në mal[3] lart »edhe furrë vesëprurëse krejt në Kalde* »të parashkruan, o Hyjnuse qart';* se »e prite zjarrin jolëndor, të shenjtë ti* »në bark lëndor pa djegie;* thërrasim »pra tek ai që linde ti:* Ësht' i bekuar »Perëndia, Zot i etërve tan'.

Ligjvënësi i madh me shfaqjet e tua jolëndore pengohej të kuptonte misterin e madh, o e tërëthjeshtë, duke mësuar simbolikisht që të mos mendojë me zili për të poshtmet, kështu, si çuditej për mrekullinë thoshte: Ësht' i bekuar Perëndia, Zot i etërve tan'.

Kori i hyjshëm të paratha në një mënyrë të perëndishme mal,[23] portë qiellore dhe shkallë mendore;[28] sepse nga ti është prerë një gur, pa pësuar thikë burri;[23] dhe portë nëpërmjet së cilës kaloi Zoti i çudive,[10] Perëndia i etërve tan'.

Irmos tjetër: Ton Haldheon i káminos

»Edhe pse ndizej furra në Kalde me »zjarr qëmoti,* me pranin' e një fryme »Perëndie po freskohej;* pra psalnin »kështu tre Djemtë: I bekuar je, o Pe»rëndi i etërve tan'.

O e pacenuar, festojmë dhe i falemi besërisht lindjes sate të shenjtë nga premtimi, nëpërmjet së cilës u çliruam nga mallkimi i lashtë, kur u shfaq Krishti.

Tani Ana dëfren dhe thërret duke u mburrur: Megjithëse isha shterpë, kam lindur nënën e Perëndisë, nëpërmjet së cilës është zgjidhur dënimi i Evës dhe dhimbja e lindjes në pikëllime.

Adami është çliruar dhe Eva kërcen dhe thërrasin në shpirt tek ti, o Hyjlindëse: Me ty u çliruam nga mallkimi i lashtë, kur u shfaq Krishti.

Ju o shterpa të pafryt, shpirtra pa fëmijë, ejani me vrap, sepse Ana tani është plot me fëmijë dhe me dëfrim. O nëna, kërceni bashkë me nënën e Perëndisë dhe bashkëgëzohuni.

Lavdi

Le të lavdërojmë Atin, Birin edhe Shpirtin, në një njësi Hyjnie, Triadhën e Tërëshenjtë, të pandarë, të pandërtuar dhe të bashkëpërjetshme dhe të njëqenshme.

Tani

Ti vetëm linde Perëndinë, o e Virgjër pas lindjes; ti përtërite natyrën me lindjen tënde, o Mari; ti zgjidhe Evën nga mallkimi i lashtë, o Hyjlindëse e pastër.

Zbritërore: ´Eknoon próstagma

»Urdhër të çmendur dha tirani besë»lig, e tundi popullin,* botën e tmerroj »me blasfemi dhe paudhësi,* po të tre »Djemat nuk i tronditi dot* tërbimi i »egër as furra me zjarr,* dhe kur po fryn»te era vesëprurëse, këndonin brenda mu »në zjarr:* I përhimnuar je, Perëndi dhe »Zot i madh,* përjetë i bekuar.*

Ode VIII
Irmosi: En ti kamino ti ton Pedhon

»O Zot, e parafigurove qëmoti nënën »tënde qart' në furrën e Djemve, o Krisht,* »se simbol shpëtoi nga zjarri k'ta që »ecnin pa u djegur krejtësisht;* nënën »tënde pra e himnojmë,* që u shfaq nga »ti në gjith' botën sot* edhe në gjith' »jetët e përmbilartësojmë.

Tenda e paracaktuar për pajtimin tonë me Perëndinë, tani fillon të ekzistojë që të lindë Fjalën, e cila do të na shfaqet me peshë mishi. Fjalën e himnojmë ne që nga mosqenia e morëm qenien përmes asaj dhe e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Ndryshimi i shterpësisë shpërbëhu shterpësinë e të mirave në botë dhe tregoi fuqishëm çudinë, Krishtin të ardhur tek të vdekshmit. Atë e himnojmë ne, që nga mosqenia morëm qenien përmes atij dhe e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Irmos tjetër: O stegazon en ídhasi

»Ti të lartat e tua po strehon në ujëra »lart*[29] dhe ke vën' rër' si kufirin e »detit*[30] dhe e mban Gjithësin';* dielli »të himnon,* të lëvdon edhe hëna;* »çdo krijesë pra tek ti ofron himn* në »tër' jetët, se je ti Krijimtari i saj.[31]

Ti që bëre çudi në barkun e sterilizuar, që hape mitrën jopjellore të Anës dhe i dhe fryt, ti je Perëndi i shenjtë, ti je Bir i Virgjëreshës, ti more mish nga ajo, nga Virgjëresha gjithmonë e lulëzuar dhe Hyjlindësja.

Ti je ai që vulos avushën dhe e hap, që ngre ujin në retë dhe jep shi,[32] ti që dhe, o Zot, të lulëzojë nga rrënja e pafryt, nga Ana e shenjtë, frytin e pacenuar, shkopin,[1] Hyjlindësen.

Ti je ai që zgjidhe prangat e pazgjidhura të mospasjes fëmijë, ti je ai që i dhe shterpës lindje pjellore dhe fryt të lavdishëm, prej së cilës u bëre bir dhe dole lastar, ti je ai që e pate nënë sipas mishit në ardhjen tënde tek ne, o i dhembshur.

O bujk i mendjeve dhe mbjellës i shpirtrave tanë, ti je ai që tokën e pafrytshme e tregove të frytshme, ti je ai që arën, e cila ishte e thatë, e bëre pjellore, të frytshme e me shumë kallinj, Anën e shenjtë, që të lulëzojë një fryt të pacenuar, Hyjlindësen.

Lavdi

O Trini e përmbiqenshme, njësi bashkëpafillim, të himnon dhe dridhet prej teje shumicë engjëjsh, qielli dhe dheu, avusha frikësohen, njerëz të bekojnë, zjarr të shërben, të gjitha në Krijesë binden tek ti me frikë, o Triadhë e Shenjtë.

Tani *Hyjlindësore*

O dëgjim shumë i ri! Perëndia bëhet bir gruaje dhe ka nënë të paburrë, e cila lindi pa farë. Perëndi është ai që lindi. O pamje e frikshme! O zënie e huaj e Virgjëreshës! O lindje e pashprehur! Vërtet, të gjitha janë mbi mendje dhe teori.

Zbritësore: Evlojite pedhes

»**E** bekoni Djema* si Trinia nga nu»mëri, Atin q'ellor, të vetëmin Zot,* »himnoni* Fjalën që mbi dhenë zbriti* »dhe e bëri vesë zjarrin e furrave* dhe »e lartësoni ju Shpirtin e Tërëshenjtë,* »që u dhuroi që të gjith've jetën.*

Ode IX
Më të nderuarën nuk stihologohet
Irmosi: I ton pro iliu fostira

»**T**rupëzove ti Perëndinë,* para diellit »ndriçues ësht';* si diell lindi dhe na »erdhi trupërisht* nga një bark virgjë»ror me një mënyr' që nuk e shprehim »dot;* o e bekuar shum' e d'lir',* të »madhështojmë, o Hyjlindëse.

Ai që nga gur i thepisur* u buroi ujin popujve* që s'kishin bindje,[2] u dhuron gjith' kombeve* që kan' bindje fryt për gëzim nga barku shterp e jopjellor,* ty, o e pacenuar Zonj';* të madhështojmë denjësisht të gjith'.

Ti që shfuqizove dënimin* absolut, të lashtë dhe të prer',* je rimëkëmbja prapë e stërnënës sonë;* ti je shkaku për adoptimin ton' nga Perëndia yn';* je ura për Krijuesin,* të madhështojmë, o Hyjlindëse.

Irmos tjetër: Alótrion ton miteron

»**E** huaj ësht'* virgjëria për nënat, o »Zonj';* e huaj është lindja* për çdo »virgjëreshë;* në ty ekonomia hyjnore »i ka bër' të dyja,* pra gjithë fiset nëpër »botë, pa pushim të lumërojn', Mari.[33]

Fitove ti* short të denj', sipas d'lirësisë* që kishe, lindjen sipas* një premtimi, Hyjnën',* se je dhën' tek ish shterpa si fryt në një mënyr' hyjnore;*

ndaj gjithë fiset nëpër botë, pa pushim të lumërojn', Mari.[33]

U mbush tani* parathënia e një profeti;* sepse thot' se do ngre un'* tendën e rrëzuar* të Davidit të hyjshëm,[34] pra tendën që profetizon ti,* mjet, që e rigatove dheun njerëzor në trup për Perëndin'.

U falemi* ne shpërgënjve të tu, Hyjlind'se,* dhe lavdërojm' atë që* dha fryt tek ish shterpa* dhe që hapi çuditërisht mitrën e saj jopjellore,* se bën çdo gjë që dëshiron ai, se ësht' Zot me pushtet të plot'.

Ke nxjerr' lastar,* o hyjmendëse, lind'se-nuse,* nga mitër pa shpres' fare,* por nga një premtim ti,* fryt të virgjër me një bukuri të d'lir', të perëndishme;* pra ne të gjith' të lumërojm' Ana, si rrënj' të jetës son' vërtet.

Lavdi

I huaj ësht'* për ata që jan' të paligjshëm* himnimi i Trinisë* së shenjt' dhe pa nisje,* ky pushtet pra që nuk u ndërtua, Ati, Biri, Shpirti.* E gjithë bota u mbështet fort në një shenje të fuqis' së saj.

Tani *Hyjlindësore*

Në bark mbajte,* Virgjëresh' nënë, Krishtin, mbretin,* që ësht' një nga personat* e Trinis' së Shenjtë;* e himnon çdo krijesë, i kanë frik' Fronet në qiell;* pra lutju ti Jisuit, o Mari, që të shpëtohen shpirtrat tan'.

2 Zbritësore: Mistikós i Theotoqe dhe O dhiá vróseos tu ksilu

»O Hyjlindëse, parajsë mistike je,* »se pa lërim lulëzove Zotin Krisht,* që »mbolli përmbi dhé jetëprurësin Kryq* »që po lusim me besë,* se ky po lartë»sohet* dhe me anën e tij ty të madhë»shtojmë sot.*

»Mallkim i vjetër i stërgjyshit,* që »rrodhi prej helmimit të gjarpërit,* e »shkatërroi Kryqi i Zotit Krisht, bekimi »erdhi prapë për njerinë me Mari Hyjli»ndësen,* që na lindi Jisunë Çlironjë»sin, të gjitha pra fuqitë e lavdërojnë »në qiellin.*

Dërgimësore
Jinekes akutísthite

Çdo an' e botës po gëzon,* po ngazëllohet sot, sepse* ke lindur, o Vajz' dhe nënë* e Perëndisë, Mari, pra* nuse që s'njohe dasmë ti,* dhe me lindjen e zhduke krejt* turpin e rënd' të shterpësis'* së prindërve të tu edhe* nëmën e Evës në lindje.

Adam, ripërtërihu dhe* ti Eva, madhështohu prap'.* Bashkë kërceni profe-

të,* apostuj dhe ju të drejtë,* lindet Hyjlind'sja nga ata,* Joakimi dhe Ana sot;* pra në tër' botën ka gëzim,* i cili ësht' i përbashkët* për engjëjt edhe për njer'zit.

Lavdërime

Ting. I O tu paradhoksu thávmatos

O çudi paradoksale krejt,* se burimi jet'sor* lindet prej beronjës sot,* një hir i ndriçueshëm fillon të japë fryt.* Dëfre ti, o Joakim,* sepse u bëre pra prind i Hyjlindëses;* s'ka tjetër baba si ti* midis të vdekshmëve, atë perëndizën'*, sepse Vajza që pranoi* Krishtin, tenda e Zotit,*[22] mali i tërëshenjtë,*[23] nëpërmjet teje u dha tek ne.

(2x)

O çudi paradoksale krejt!* Fryti i beronjës* u ndriçua me një shenj'* që dha Krijimtari fuqiplot' i Gjithësis'.* Shpërbëri me plot fuqi* pafrytshmërin' e së mirës në botën ton'.* O nëna, kërceni ju* me gaz, me nënën e Zonjës Hyjnënë tok* th'rrisni: O e hirshme g'zohu,* bashk' me ty ësht' Zoti yn';* përmes teje mëshirën* më të madhe i jep botës son'.

Ana e lavdishme na u duk* shtyllë mençurie* krejt e gjallë edhe en'* e ndritur, që rrezaton me hirin. Lindi pra* të lartën me të vërtet',* atë që ësht' lulja e virgjëris' së d'lir',* që dukshëm dhuron dhuntin'* e bukurisë së virgjër tek gjith' ato* që jan' virgjëresha me mall* për dhuntin' e virgjëris';* ndërsa tek ne besnikët* të gjith', jep mëshir' dhe përdëllim.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. II

Kjo është ditë e Zotit, ngazëllohuni,[8] o popuj; se ja nusërorja e dritës[9] dhe libri i Fjalës së jetës doli nga barku; dhe pasi lindi porta që shikon nga lindja, pret hyrjen e Priftit të madh,[10] meqenëse vetëm ajo sjell vetëm Krishtin brenda në botë për shpëtimin e shpirtrave tanë.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i parë Ode III, nga Kanuni i dytë Ode VI.

Kungatore: Kupë shpëtimi.

Shënim: Kjo e kremte kremtohet 5 ditë, meqë afrohet e kremtja e Kryqit.

CITIME

[1] Is. 11.1

[2] Eks. 17.6; I Kor. 10.4

[3] Eks. 3.2-5

[4] Abak. 3.3

[5] Jez. 1.4-26

[6] Ps. 32(33).6

[7] Ps. 76(77).15(14)

[8] Ps. 117(118).24

[9] Matth. 22.1-13

[10] Jez. 44.2-3

[11] Gjen. 21.2; Gjyq. 13.24;
I Mbret. [Sam.] 1.19-20 etj.

[12] I Mbret. [Sam.] 16.23

[13] Lluk. 1.42

[13a] Lluk. 1.28

[14] Num. 17.23

[15] Ps. 18(19).5

[16] Ps. 131(132).11

[17] I Kor. 15.45

[18] Vep. 2.29-30

[19] Apok. 5.5; 22.16

[19a] I Mbret. [Sam.] 2.1

[20] Eks. 14.24; 16.10

[20a] Abak. 3.1

[21] Is. 6.3

[22] Hebr. 9.2

[23] Dan. 2.34-45

[23a] Is. 26.12-13

[24] Ps. 44(45).15-16

[25] Joan 1.14

[26] Lluk. 1.35

[27] Hebr. 9.4

[28] Gjen. 28.12-17

[29] Ps. 103(104).3

[30] Jer. 5.22

[31] Dan. kap. 3 Lutja e Azariut
dhe Himni i të Tre Djemve 39

[32] Ps. 134(135).7

[33] Lluk. 1.48

[34] Amos 9.11; Ps. 131(132).5; Hebr. 9.2

MË 9 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i Hyjprindërve të shenjtë dhe të drejtë Joakimit dhe Anës; dhe kujtimi i martirit të shenjtë Sevirian.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të të drejtëve (2 herë të parën). Lavdi i të drejtëve. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i të drejtëve. Përlëshoret: ngjallësore, e të drejtëve dhe e së kremtes (Lindja jote, o Hyjlindëse).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, në fund Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret ngjallësore, por në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Kanunet: ngjallësor dhe i të drejtëve. Pas Odes III, Ndenjësorja e të drejtëve (Joakimi dhe Ana). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Një kryq vijosi; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe e së kremtes (Adam, ripërtëritu). Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të të drejtëve (Hir ki, o Çlirimtar 2x etj. me vargjet e tyre). Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e të drejtëve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes, e të drejtëve edhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i së Dielës para Lartësimit.

Tipikoni i së Dielës pas së kremtes

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të së kremtes (paskremtore, të serisë). Lavdi i Litisë të së kremtes. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani: një i së kremtes. Përlëshoret: ngjallësore dhe (Lavdi dhe Tani) e së kremtes.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, në fund Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Përlëshoret: e tingullit (2x) dhe e së kremtes. Ndenjësoret: ngjallësore, por në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Kanunet: ngjallësor dhe i së kremtes. Pas Odes III, Ndenjësore paskremtore. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Një kryq vijosi; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe paskremtore. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 paskremtore. Lavdi Eothinoni. E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji. Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode IV e së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i së Dielës pas Lartësimit.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime të të drejtëve
Ting. IV ΄Edhokas simíosin

Ejani që të kërcejm' me këngë ju o besnikë tash,* të festojmë me bes' e gaz* kujtimin, të lavdërojm'* çiftin e nderuar,* Joakimin, Anën, se k'ta na lindën virgjëresh'* të tër'kulluar, Hyjlindësen Mari;* prandaj dhe u shpërngulën sot nga të përkohshmet për një banim* pa mbarim dhe të gjall' gjithnjë.* Përgjërojn' për shpëtimin ton'.

Sot bën panair me gaz e gjith' Krijesa, Hyjlindëse* e himnuar me çdo lavdi,* sepse me një mendje bën* bashkërisht kujtimin* e sivjetshëm për prindërit e tu, për Anën pra* dhe Joakimin e mrekullueshëm,* meqë gaz na shkaktuan, se të lindën jashtë çdo shprese ty;* jetën ton' ke ushqyer Zonj',* vezullove ti dritën ton'.

Ana ngazëllohet sot dhe shpirtërisht po kërcen me gaz,* dhe dëfrehet me çdo hare,* sepse ka arritur qart'* një dëshir' që kishte* për fëmij' të mirë dhe nxori pas premtimit kjo* sipas bekimit një fryt[1] të hyjshëm krejt,* Marin' e paqortueshme, që Perëndin' tonë lindi dhe* mbi të fjeturit në err'sir'* vezulloi pra diellin.[2]

I shenjtit Të ngjashme

Edhe pse keq priteshe në nerva dhe në dru vareshe,* dhe në mishrat ti çirreshe* me thonjtë prej hekuri* pa mëshir' për Krishtin,* edhe urdhëroheshe për të bërë një flijim* tek idhujt, nuk e mohove Zotin ton';* qortove pafuqinë edhe kotësinë e idhujve* me mundimet e tua pra,* o i famshëm, me engjëjt je.

Çoheshe i lidhur dhe për plagët që kishe mburreshe;*[3] nxitje sa të shikonin ty,* që ta imitojn'[4] të gjith' udhën tënde t' shenjtë* duke par' shpërblimet në qiejt,[5] që japin hare* të bollshme edhe gaz, që nuk prishen dot*[6] dhe mbeten përgjithmon' në përjet'si dhe trashëgimtarë kan'* shpresëtarët, që Krishtit ton'* i shërbejnë me përkushtim.

Thyheshe në nofulla me gurë edhe goditeshe* nëpër brinjë me shpatë keq,* i tër'lumur dhe me nam;* me një gur të madh shum'* thyheshe në qafë dhe këmbë, dhe cop'toheshe* krejt mizorisht në kyçe; pra theve k'shtu* ti kokën e dragoit[7] plot me trimëri dhe

durim të fort',* që nuk mundte ta thyente* çdo mundim i torturave.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. I I Efremit të Karies

O çift i lumur, ju u lartësuat mbi të gjithë prindërit, se lulëzuat atë që është më e lartë se çdo krijesë. Vërtet i lumur je, o Joakim, meqë ke qenë atë i një fëmije të tillë. E lumur mitra jote, o Ana, se mbiu nënën e jetës sonë; të lumur gjinjtë me të cilët e mënde[8] atë që ushqeu me qumësht ushqyesin e çdo frymë. Atij përgjërojuni, lutemi, o të tërëlumur, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Pasvargje
Ting. I Ton uranion tagmaton

Një panair bëjnë Ana dhe Joakimi bashk',* se kanë lindur nisjen* e shpëtimit ton', bijën:* është' Hyjlindësja e vetme; pra ne* tok me ta po festojmë sot* dhe lumërojm' Virgjëreshën e tërëd'lir',* që nga rrënja e Jeseut[9] vjen.

Varg: Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule veshin tënd, dhe harro popullin tënd dhe shtëpinë e atit tënd, edhe do të dëshirojë mbreti bukurinë tënde.

Vajza që mbajti Hyjninë, Hyjlindësja e d'lir',* e bija e Davidit,* që profetët lëvduan,* lindet pra nga Ana e mençur sot* edhe nga Joakimi bashk'* edhe përmbys krejt mallkimin adamian*[10] kundër nesh me Birin që lindi.

Varg: Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.

Toka që ish jopjellore lind dheun shum'pjellor,* dhe mitra e pafrytshme* jep një fryt fort të shenjtë.* Rrit atë me qumësht: Frik' dhe çudi!* Thith një Vajzë gji, që më von'* bukën e qiellit priti në bark;[11] u bë* pra ushqyese e jetës son'.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. IV

Ata që nga barku i pafrytshëm nxorën shkopin[9] e shenjtë, Hyjlindësen, prej nga lindi si diell shpëtimi në botë, Krishti Perëndia, çifti i shenjtë, bashkëmoshatarët e shenjtë Joakimi dhe Ana, pasi u shpërngulën në tenda qiellore tok me bijën e tyre, Virgjëreshën e tërëpacenuar, kërcejnë me engjëj duke bërë ndërmjetim për botën. Edhe ne, si u mblodhëm bashkë me ta, shpresëtarisht himnojmë duke thënë: Ju që nëpërmjet hyjfëmijës dhe të tërëkulluarës Mari u bëtë gjyshërit e Krishtit, ndërmjetoni për shpirtrat tanë.

Përlëshore
E të drejtëve Ting. II

Duke kremtuar kujtimin e Hyjprindër-

ve të tu të drejtë, o Zot, përmes tyre të përgjërohemi: Shpëto shpirtrat tanë.

E shenjtit
Ting. IV Tahí prokatálave

Përmes urtësisë së fjalëve të tua, ti* ushtrinë e hyjshme prej atletësh me fam' stërvite për mundje krejt të shenjt';* si i shpërfille lavdet* që po prishen, ti more* lavdin që s'prishet kurrë përmes martirizimit;* prandaj Sevirian, të lavdërojmë me himne sot.

Dhe e së kremtes



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. I Tu lithu sfrajisthentos

Nga dhembje shterp' u linde çuditërisht, o Vajzë,* dhe përmbinatyrshëm ke lindur nga mitër virgjërore;* u shfaqe lastar i bukur ti;* për botën lulëzove jetën ton';* pra të gjith' fuqit' e qiejve me një zë* thërrasin bashk', o Hyjlind'se:* Japim lavdi tek dalja jote sot,* te virgjëria jote, Zonj',* dhe tek shtatzënia jote; e vetmja që je pa njoll'.

Lavdi *dhe* Tani *Të njëjtën*

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Qielloret të gjitha gëzohen shum' tani,* edhe gjinia njer'zore bashkëkremton tok me to,* dhe profetët bashk'dëfrehen krejt mistikërisht,* se k'to që panë formalisht* nëpër breza në lasht'si si ferrë,[12] shtambë,[13] purtekë,*[9] re[14] dhe port',[15] gjithashtu dhe fron,[16] edhe mal[17] të madh, sot lindet me plot lavdi.

Lavdi *dhe* Tani *Të njëjtën*

Kanunet: i së Kremtes, i të drejtëve dhe i martirit

Ode I
Kanuni i të drejtëve, që ka Akrostihidhë: "O e Tërëkulluar, këndoj prindërit e tu bujarisht".

Ting. II En vithó katéstrose

Joakimi me fam' dhe me nam* bashkë me hyjmendësen, shoqen e tij,* madhështoheshin me ndriçim* prej virtyti, edhe u denjësuan për lindjen e llambadhes. Ajo* mishërisht dhe me shkëlqim ka lindur diellin mendor për ne.

Përqendroheshin me zemër, shpirt* krejt në Perëndinë edhe me kujdes* nuk largoheshin prej atij* vërtet, Joakimi i hyjpranuar dhe Ana shum' e shenjt'. Lindën pra* Zonjën, që ësht' përmbi çdo krijesë, falë shenjtëris' së saj.

Duke pasur jetë dhe virtyt* më të lartë dhe më të shkëlqyer ju* nga të gjith' prindërit mbi dhé,* keni qenë edhe më të mëdhenj se të vdekshmit, se lindët Zonjën ton';* nëpërmjet asaj vërtet u bëtë prindër Perëndie pra.

Kryetarët e shpëtimit ton',* Ana e lëvduar dhe i lumuri,* Joakimi, Hyjlindësen* lindën, të panjollëshme dhe të tërëkulluar edhe pa cen aspak.* E kan' marrë k'të shpërblim të shpres'-taris' së tyre besërisht.

E martirit
Ting. Tërth. IV Igran dhiodhéfsas

Sundonte dekreti pra kundër fes',* për t'iu therur idhujve që s'kishin frym' dhe dëgjim,*[18] por fitonte Krishti me durimin* edhe qëndresën e fort' të dëshmorëve.

Tërbohej Lisiu ndaj Krishtit ton';* pra sa besimtarë gjeti ta adhuronin k'të,* me çdo mjet përpiqej t'i dënonte,* por turpërohej, hyjmendës, kur ishit bashk'.

Habite përndjekësin, o i shenjt',* kur në stadium ti trimërisht hyre me guxim;* kritikove pafuqin' e kotë* dhe kalbësin' e hyjnive të tij pa shpirt.

Hyjlindësore

E mbajte në bark vetëm ti atë* që nuk e mbajn' qiejt; pra banoi në ty, o Vajz',* perëndishëm dhe e mori nga ti* natyrën edhe esencën e njerëzve.

Ode III
E të drejtëve: Tis písteos en petra me

Si shterpë keq privoheshe nga fëmijë;* me shum' lot përgjëroheshe para Zotit;* u denjësove k'shtu për të lindur ti të bekuarën e vetme, Ana; psalje pra,* se nuk ka të shenjt' përveç teje, Zoti[18a] yn'.

Ai që brenda kishte banues Hirin* e shenjtë, Joakimi hyjfolës, ati,* u denjësua që të kishte fëmij', shkakun e pendimit ton'. Tek kjo thërrasim ne,* se s'ka të panjollshme veç teje, Zonja jon'.

Me bes' bashk'moshatarët le t'i himnojmë;* prej k'tyre u ndriçua për ne Hyjlind'sja,* që është më e shenjtë se çdo krijesë, se lindi Perëndin'. Atij i th'rrasim ne,* se nuk ka të shenjt' përveç teje, Zoti[18a] yn'.

Prej turpit të shterp'sisë u arratis krejt,* dhe lindi Ana Hyjlindësen që zhduku* çuditërisht gjith' turpin e Evës,[19] pra tek ajo, Mari, ne po thërresim bashkërisht,* se s'ka të panjollshme veç teje, Zonja jon'.

E martirit: Si i to steréoma

Gaz kishe kur rriheshe* frikshëm për

Krishtin[3] tënd, o i urt',* se të sigurt* e kishe shpërblimin* e mundimeve për atë.

Kur shpesh po ndërroheshin* për të të rrahur fort me kamxhik* xhelatët ty,* si në trup të huaj,* fare s'ndjeje mundim, o shenjt.

Egjete shpërblimin pra,* more kuror' drejtësie[20] ti* prej Krishtit Zot,* o i urt'; shijove* edhe gaz që nuk shuhet kurr'.

Hyjlindësore

Ajo që pran' meje është'* e gjitha pa njoll', e bukur është';[21] k'shtu tha, o Zonj',* kur të parapa ty* Solomoni në Këngën pra.

Irmosi: Si i to steréoma

»**T**i je përforcim për ne* që po përikim »tek ti, o Zot';* për sa që jan'* errë»suar, je drit';* ndaj dhe shpirti im të »himnon.

Ndenjësore e martirit
Ting. I Ton tafon su Sotír

Me trimëri në shpirt* ishe i armatosur;* dor'zove veten pra në tortura të ndryshme* dhe digjeshe nga malli ti, o hyjmendës, për Krishtin tënd;* ndaj qortove rënd'* manin' që kishin tiranët* dhe kurorën që* nuk prishet prej Zotit more,* se dole fitues krejt.[22]

Lavdi *dhe* Tani *I së kremtes*

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Joakimi dhe Ana kan' panair, gëzim,* se denjësisht hir kan' gjetur prej Zotit dhe lindën k'shtu* si fryt tempullin që priti Perëndinë ton',* pra Virgjëreshën e tër'd'lir',* që është' nëna e të Lartit, e vetmja e bekuar.* Ndërmjeton ajo përherë, që të shpëtohen shpirtrat tan' me mëshir'.

Ode IV
E të drejtëve: Elílithas ek Parthenu

Joakimi hyjmendës dhe hyjpranuar merr i ngazëlluar nga sterilja Virgjëreshën, përmes së cilës u shpërbë sterilizmi i botës nëpërmjet lindjes virgjërore.

Stërati i Krishtit, Joakimi është tani para nesh për ngrënie shpirtërore, i tërëpasuri, që lindi Vajzën hyjnënë, të tërëpacenuarën.

Hiri paraqet atë që shpëton njerëzit nga vdekja dhe prishja, atë që do të bëhet nënë Perëndie, e cila do të pranojë Fjalën e amshuar, që do të mishërohet në mënyrë të pashprehshme.

Prej rrënjës së Jeseut u lindën bashkëmoshatarët, nga lulëzoi shkopi që sjell lulen,[9] e cila më kundërmon mua, njeriun e tërë, erë të këndshme me miron e Hyjnisë.

Më drejto, o Hyjlindëse, duke rregulluar perëndishëm jetën time, me

urdhëresat e Fjalës, që u mishërua prej teje, dhe udhëhiqmë drejt dritës, o hyjnënë, Mari Perëndinuse.

E martirit: Isakíkoa Kírie

Kur me plot lajka tirani thoshte se do të zbuste gjallërinë tënde dhe do të fitonte mbi ty, dukej sikur po shigjetonte qiellin.

I thërrisje tiranit, o i tërëfamshëm: Nuk e ndien ti, o i papërmbajtshëm, fuqinë e Krishtit të më forcojë ndaj dhimbjeve dhe mundimeve?

Seviriani thërriste: Nëse nuk do të më ishte dhënë fuqi nga lart, megjithëse jam mish, si do mundesha të duroja prerje gjymtyrësh?

Hyjlindësore

O e Tërëshenjtë Hyjnuse, ndihmomë me ndërmjetimet e tua, që të çlirohem nga i fëlliquri, që të të lavdëroj ty, shpresa ime.

Ode V
E të drejtëve: O fotismós

Çifti i mençur, Ana dhe Joakimi të hyjpranuar, të ndriçuar nga një vezullim pastërtie, na ka lindur atë që e zbukuron me shkëlqimin e hyjshëm të virgjërisë natyrën e shterpëzuar të njerëzve.

Lidhja bashkëshortore e nderuar e mençurisë dhe çifti hyjmendës, Ana dhe Joakimi të tërëfamshëm, kanë lindur fron virgjëror të hyjzbukuruar për atë që i mban në pëllëmbë të gjitha.[22a]

Hyjshikuesit, Joakimi i hyjshëm dhe Ana, duke jetuar hyjmendërisht, u denjësuan qartësisht të lindin portën[15] dritëprurëse të lindjes, që u shfaq që lartazi[22b] për udhëheqjen e atyre që kanë humbur udhën.

Sundimtari i të gjithave me një shenjë nga shterpësia skaliti tani si në një gur pllakën e hyjshkruar të Ligjit[23] të ri, në të cilën Fjala hyjnore shkroi që më parë zgjidhjen e mëkateve të Ligjit të vjetër.

Virgjëreshë hyjnënë, me shkëlqimin tënd jep shenjë që të ndriçohet mendja ime e errësuar nga mëkati, duke zhdukur zymtësinë e padijes dhe të shkeljeve, se nuk njoh tjetër roje përveç teje.

E martirit: Orthrízontes voomen si

Në dru u vare, o i himnuar, dhe u çore në trup me thonj për atë që i sundon të gjitha.

Thërrisje: O Perëndia im, forcomë që të mbaroj këtë ndeshje[24] të martirizimit, tani që po më çjerrin.

Kur të pa tirani, o i lavdëruar, të durosh i pamposhtur torturat, u shtang mjerani.

Hyjlindësore

O Hyjlindëse, shpresa, mbrojtja dhe streha ime, shpëtomë me ndërmjetimet e tua nga skandalet e gjarprit.

Ode VI
E të drejtëve: En aviso ptesmaton

Ana, edhe pse ishte më parë shterp',* priti farë shum' pjellore nga ndriçim hyjnor.* U denjësua, lindi pra* Virgjëreshën, sunduesen mbi të gjith'.

Kur një shterp' me vullnet Perëndie lind,* na bind të pranojm' një virgjëresh' që lindi pra* pa farë, pa vullnet mishor;*[25] Perëndia i njëjtë k'shtu deshi qart'.

U ndriçua në shpirt Isaia: Pa* Vajzën që ka dal' nga Joakimi dhe Ana,* si një volum të ri krejt, ku* Fjala, kur u mish'rua, u shkrua[26] qart'.

Një mister paraprin një tjetër mister:* Lindi shterpa, Ana që përkthehet hir, shkakun* e jetës son', që na u shfaq* nëpërmjet lindjes tër'virgjërore pra.

E martirit: Hitona mi parasku

I tmerrshmi të burgos në një qeli* edhe me uri të shtrëngon të mohosh Krishtin,* që e prite nga rinia, o i tër'lum'.

Kur çoheshe në burg, k'ta që të pan'* publikisht ty, o i urt', i këshillove qart',* i mësove që të mos ikin larg Krishtit.

Tirani çnjerëzor dhe i pamend,* të goditesh me shpat' urdh'roi, se s'bëje fli* para idhujve, por ishe indiferent.

Hyjlindësore

Me ndërmjetimin tënd, o e tër'd'lir',* bëmë që të vesh un' këmishë të ndritshme fort* gjatë Gjyqit; i shëmtuar jam; të himnoj.

Irmosi: Hitona mi parasku

»**M**ë jep këmish' të ndritëshme, o »Zot,* Krisht, ti që vesh dritën si rrob'[27] »të shkëlqyeshme,* Perëndi mëshirë»plotë, i dhembshur fort.

Kontaqi
Ting. II Ta ano zitón

Gëzohet tani* shum' Ana, se u zgjidh zinxhir* shterp'sie dhe kjo* ushqen të papik'luarën* dhe po mbledh të gjithë që ta himnojn' atë që dhuron tek ne,* se nga barku i saj na dha* të vetmen nën' që nuk njohu burrë aspak.

Shtëpia

Ajo që përmes lutjes u zgjidh nga prangat e mospasjes fëmijë më parë, na fton për të festuar së bashku çudinë dhe për t'i ofruar dhuratë të lindurës, duke bërë litani përpara saj me dëshirë të zjarrtë, si dikur virgjëreshat[28] e paraprinin shpejt me vrap, duke

kërcyer dhe duke thirrur: Ja, erdhi rithirrja e të gjithëve, ja Adami u çlirua, se Ana lindi frytin, të vetmen nën' që nuk njohu burrë aspak.

Sinaksari

Më 9 të të njëjtit muaj, Mbledhja e të drejtëve Joakimi dhe Ana.

Vargje: O Joakim, dëfre së bashku me bashkëshorten,/ meqë lindët të dy ngazëllim shpirtëror për Krijesën.
Dhe e nënta gjeti mbledhje prindërish Hyjnëne.

Në të njëjtën ditë, martiri i shenjtë Seviriani mbaron me një gur në këmbë i varur në ajër mbi murin rrethues.
Vargje: Seviriani, edhe pse ka dhimbje nga pesha e gurit,/ gëzohet i varur, sepse shkëput nga toka këmbët.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Theofan Omologjetit, që asketizoi para Dioklecianit.

Në të njëjtën ditë, shën Haritoni mbaron me shpatë.
Vargje: Ke shumë hir, o Hariton, martir i Krishtit,/ i prerë në qafë për hir të tij.

Kujtimi i Sinodit të Tretë të Shenjtë Ekumenik i dyqind Etërve hyjprurës, që u mblodhën gjatë mbretërisë së Theodhosit të Vogël në Efes dhe rrëzuan Nestorin besëkeq.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

E të drejtëve: Antítheon próstagma

Çifti i shenjtë, duke dalë nga rrënja e shenjtë e Davidit hyjmendës, ka lindur për botën shkopin e tërëhyjshëm, Virgjëreshën e papërlyer, e cila lind për ne pa farë, si diell, lulen[9] shumë hyjnore, Krishtin.

Ana e perëndishme, duke mbajtur si një kandil që vezullon si ari Hyjlindësen, llambadhen e shumëndritshme, e ndriçoi fort mbarë botën me dritë të hyjshme dhe me flakërime të shkëlqyeshme virgjërie.

O gjyshër të lavdëruar të tërëfuqishmit Perëndi, që u mishërua për hir të përdëllimit të pashprehshëm nga fëmija juaj hyjmendëse, tani që po përik unë tek ju, jepmëni si çmim zgjidhje fajesh.

Meqenëse ishit më të lartë nga të gjithë prindërit, e lindët atë që mbizotëron mbi gjithë krijesat, Marinë e pacenuar, që ka lindur Perëndinë që u vesh me të njëjtin mish krejt si ne nga dhembshuria e madhe.

E martirit: O en arhí tin jin

I pabesi e dërrmon trupin tënd me gurë të mëdhenj, ndërsa ti himnon publikisht Krishtin në mes të të paligjve; pasi arrite lavdinë e tij, tani kërcen shkëlqyeshëm.

Edhe pse u vare në murin rrethues, o athlofor, i lidhur nga pesha e gurëve, për shkak të marrëzisë së shumtë të gjykatësit, nuk e mohove Perëndinë e etërve tanë.

Oh, sa e fortë është rezistenca jote, o i lumur! O sa e ngrohtë është dashuria për Ndërtuesin! Për këtë të zbukuron ty me kurorën e paprishshme,[22] si luftove shkëlqyeshëm.

Hyjlindësore

Ti je drita ime, o Virgjëreshë Hyjlindëse, ti je hareja, streha dhe limani im, o e bekuar dhe ty të lavdëroj, se linde Perëndinë e etërve tanë.

Ode VIII
E të drejtëve: Ton en kamino tu pirós

Të pasuruar me shumicë virtytesh, Joakimi i respektuar dhe Ana e mençur, kanë lindur atë që është e zbukuruar larmishëm[29] me lavdi të hyjshme, mbretëreshën e virgjër, të cilën mbarë Krijesa e himnon si Hyjlindëse.

Na u dërgua shkop fuqie nëpërmjet jush, o miq Perëndie, nusja e tërëpaqortueshme, përmes së cilës mbizotërojmë me fuqi në mes të armiqve[30] të pabesë, duke shkelur makinacionet e tyre.

Nëpërmjet teje, o çift bashkëmoshatarësh tepër të shenjtë, na u dhurua nga Perëndia armë mirëdashjeje, me të cilën ne besëmirët tani e përgjithmonë kurorëzohemi[31] bukur, pra nëna virgjëreshë e dëlirë, që lindi Perëndinë.

O Zonjë e tërëkulluar, çifti fort i mirë i prindërve të tu, të shkëlqyer nga derdhja e dritës nga ai që u mishërua prej teje për hirin tonë, të lindën ty, shkaktaren e të mirave qiellore për ne.

Me fuqi Perëndie u çel barku i shteruar,[32] jep fryt dhe del portë[15] virgjërore e tërëndritshme, përmes së cilës, u erdhi Fjala atyre që janë mbi tokë, pasi u mishërua me logjikë të pashprehshme.

E martirit: Ton Vasilea ton uranón

Si i durove mundimet deri në fund, o ushtari i Zotit, u shpërngule i gëzuar në mbretërinë e sipërme, o i tërëlumur.

Nuk u turpërove të durosh tortura të ndryshme për Krishtin,[33] o trim në shpirt; prandaj lavdërohesh bashkë me të në jetët.

Duke kërcyer tani i kurorëzuar së bashku me atletët rreth Mbretit, kujtona ne që me besë bëjmë kujtimin tënd.

Hyjlindësore

O Hyjnënë, mbrojtja e të krishterëve, nxirrna nga çdo nevojë që të të himnojmë në gjithë jetët.

Irmosi: Ton Vasilea ton uranón

»Mbretin në qiejt,* që gjith' ushtrit' »engjëllore* e himnojnë edhe ju himno-»ni,* dhe e lartësoni gjithmon' në gji-»thë jetët.

Ode IX
E të drejtëve: Anarhu jenítoros

O ju, që një mendje kishit për virtytin dhe një shpirt,* at' dhe nën' të nderuar të Virgjëreshës son',* ne po bëjm' plot me zell kujtimin tuaj që ësht'* plot me famë dhe me lavdi, o të tërë-shenjt',* lutuni pra të shpëtohemi.

Pushuat sundimin krejt të vdekjes, sepse me shkëlqim* lindët nënën e jetës; pra keni shum' lavdi;* bija zhduku sulmet e vdekjes, prandaj u bë* kjo shkaktare shprese për jetë në pa-vdek'si,* përmes besës dhe devot-shmëris'.

Si diell i bukur Joakimi u bashkua me* Anën, hënën gjith' drit'prurëse dhe lindën k'shtu* rrezen virgjërore, përmes saj na ndriti ne,* i bashkuar pas hipostazës, agim hyjnor* i esencës së tër'hyjshme pra.

Me besë dhe mençuri jetuat,[34] o të lumur shum';* për shijim të pashpreh-shëm u denjësuat tash,* sepse ju arritët hyjshfaqjen e Krishtit ton',* që u duk në botë nga ju; përgjërohuni* të shpëtohen prej tij shpirtrat tan'.

E martirit: Kirios Theotokon

T'u sistemua trupi* edhe u varros nga* duart e k'tyre që të donin, se qe i shenjt';* buron dhe kroje shërimesh për lavd të Perëndis'.

Çudi! Si shërbëtori,* edhe pse i vde-kur,* u ngjall, kur rrugës takoi lip-sanin tënd, që* po çohej drejt varrit, o martir i shkëlqyer shum'.

Arrite mbretërinë* që ësht' e përjet-shme* dhe, o i lumur, qëndron pranë Zotit ton' Krisht;* pra lutju me ngroh-tësi për ne që të madhërojm'.

Hyjlindësore

Habiteshin brigada* engjëjsh duke parë* të jet' me mish dhe të mbahet prej teje ai* që bëri shekujt, çdo gjë, dhe të madhështonin shum'.

Irmosi: Kirios Theotokon

»Pohojm' se je Hyjlind'sja,* ne që u »shpëtuam* nëpërmjet teje, e shenjt' »Virgjëreshë e d'lir';* me koret e të »patrupve të madhështojmë ty.

Dërgimësore
E të drejtëve: Epesképsato imás

Lindet një fëmij' tani* nga pleq dhe jopjellor' krejt'sisht,* nga Joakimi, Ana që* hoqi mallkimin e Evës.*[19] K'të bashk' me engjëjt ne të gjith'* besni-

këtë, ta lëvdojmë* me himn siç i ka hije.

E martirit: Jinekes akutísthite

Trajner i të dyzetëve* me nam, fitues në liqen,* o Sevirian i tër'lumur,* ti ishe; me k'ta martirë*, të gjith' që bën' kujtimin tënd* dritëprurës dhe të lëvdojn'* me një dëshir' të zjarrtë krejt,* kujtoji, o athlofor ti,* martir i Krishtit me famë.

E së kremtes E ngjashme

Adam, ripërtërihu dhe* ti Eva, madhështohu prap'.* Bashkë kërceni profetë,* apostuj dhe ju të drejtë,* lindet Hyjlind'sja nga ata,* Joakimi dhe Ana sot;* pra në tër' botën ka gëzim,* i cili ësht' i përbashkët* për engjëjt edhe për njer'zit.

Pasvargjet e Lavdërimeve
Ting. II Ikos tu Efathá

Ki hir, o Çlirimtar* dhe kujdestar për çdo gjë,* ti që mirëdenjove* pashprehshëm, që të lindë* mbi çdo shpres' shterpa Zonjën ton'.

Varg: Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule veshin tënd, dhe harro popullin tënd dhe shtëpinë e atit tënd, edhe do të dëshirojë mbreti bukurinë tënde.

Ejani, që atë* të mbirë prej Davidit* dhe Judës, pra Marinë* Hyjlind'sen, prej nga erdhi* shpëtim, ta madhështojm' pa fund.

Varg: Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.

Sot lindet me lavdi,* çuditërisht prej Anës* e virgjëra pra, porta*[15] drit'mbajtëse. Kërceni* përpjet', o popuj, fise bashk'.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. II Símeron o Hristós en Vithleém

Sot e tër'panjollshmja* dhe e kulluara vjen prej steriles.* Sot çdo gjë dëfrehet dhe gëzohet* shum', sepse lindi ajo.* Tash nga prangat e tij po zgjidhet Adami* edhe Eva nga mallkimi çlirohet krejt.* Gëzohen të gjith' qielloret pra* dhe dhurohet tek njerëzit paqe prap';* dhe ne duke lavdëruar thërresim:* Lavdi Perëndis' që ësht' në më të lartat* dhe mbi dhenë paqe* dhe mbi njer'zit mirëdashje.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i së kremtes Ode III dhe i të drejtëve Ode VI.

Kungatore: Ngazëllohuni, o të drejtë, në Zotin; të drejtëve u ka hije lavdërim.

CITIME

[1] Rom. 9.9

[2] Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79

[3] Vep. 5.41; I Petr. 1.6

[4] I Kor. 4.16; 11.1

[5] Rom. 8.18

[6] I Petr. 1.4

[7] Gjen. 3.15

[8] Lluk. 11.27

[9] Is. 11.1

[10] Gjen. 3.17-19

[11] Joan 6.41-42, 48-51

[12] Eks. 3.2

[13] Eks. 16.33; Hebr. 9.4

[14] Eks. 14.24; 16.10

[15] Jez. 44.2-3

[16] Jez. 1.4-26;
Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 32

[17] Dan. 2.34-35

[18] Ps. 134(135).17

[18a] I Mbret. [Sam.] 2.2

[19] Gjen. 3.16

[20] II Tim. 4.8

[21] Kënga 4.7

[22] Apok. 2.10; I Kor. 9.25

[22a] Ps. 94(95).4

[22b] Lluk. 1. 78

[23] Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10

[24] II Tim. 4.7

[25] Joan 1.13

[26] Is. 8.1

[27] Ps. 103(104).2

[28] Ps. 44(45).10-15

[29] Ps. 44(45).10

[30] Ps. 109(110).2

[31] Ps. 5.13

[32] Gjen. 29.31; 30.22

[33] Mark. 8.38; Lluk. 9.26

[34] Tit. 2.12

MË 13 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i Shenjtërimit të Ngjalljes së shenjtë të Krishtit tonë dhe e Parakremtja e Kryqit të çmuar dhe jetëbërës, dhe i martirit të shenjtë Kornel Kryeqindëshit.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 vargëzime ngjallësore, 3 të Shenjtërimit dhe 3 të të parakremtes, ato të Mbrëmësores së Vogël të Lartësimit (Zot, kur ngriheshe). Lavdi i Shenjtërimit (Duke bërë kujtimin). Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet e Shenjtërimit. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani Ti je streha ime (shih pas Ungjillit Mëngjesor të së kremtes). Përlëshoret: ngjallësore, e Shenjtërimit dhe e së parakremtes (Kryqin jetëbërës).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Himne Triadike, Trishenjti, Përlëshorja e Shenjtërimit (O Zot, ashtu si hijeshinë). Në Mëngjesore, Ndenjësoret ngjallësore dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësore Hyjlindësore e Shenjtërimit. Bekimtoret etj. Kanunet: ngjallësor, parakremtor dhe i Shenjtërimit. Pas Odes III, Ndenjësorja e Shenjtërimit (Sot bëjm' shenjtërimin) një herë. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Një kryq vijosi; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe 2 të Shenjtërimit (Në mes të dheut Zoti yn'. Ty të thërresim me gëzim). Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të Shenjtërimit (Streha dritëprurëse) me vargjet: a) O Zot, desha hijeshinë e shtëpisë sate dhe vendin e tendës së lavdisë sate. b) Ty të ka hije himni, o Perëndi, në Sion dhe ty të shpagohet urim në Jerusalem. Lavdi Eothinoni. Tani E Përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket dhe Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të Shenjtërimit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së parakremtes (Kryqin jetëbërës), e Shenjtërimit (O Zot, ashtu si hijeshinë), e Shenjtit të Kishës dhe Kontaqi i Shenjtërimit (Qiell i shum'ndritëshëm), Apostulli dhe Ungjilli i së Dielës para Lartësimit.

Nëse bie e shtunë, Apostulli i së Shtunës para Lartësimit, Ungjilli i Shenjtërimit.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime Idhiomele të Shenjtërimit Ting. Tërth. II

Të nderohet shenjtërimi, është një ligj i vjetër dhe i mirë; por më tepër të nderohen të reja me shenjtërim;

sepse inagurohen ishuj tek Perëndia, siç thotë Isaia;[1] këto duhet t'i kuptojmë si Kishat nga kombe që tani bëhen, sigurohen dhe marrin stabilizim të bazuar tek Perëndia; prandaj edhe ne për këtë shenjtërim le të bëjmë panair shpirtërisht.

I njëjti

Ripërtërituni, o vëllezër, dhe duke hequr njeriun e vjetër, silluni në jetë të re[2] duke u vendosur fre të gjithë atyre nga vjen vdekja; le të edukojmë të gjithë gjymtyrët duke urryer çdo ngrënie dinake të drurit[3] dhe le t'i kujtojmë të vjetrat, vetëm për t'iu larguar atyre. Kështu ripërtërihet njeriu, kështu nderohet dita e shenjtërimit.

I njëjti I Anatoliut

E ke vënë pirg fuqie[4] Kishën tënde, o Krisht, Fjalë e parajetshme; sepse e themelove atë mbi gurin e besës,[5] pra mbetet e palëkundur përjetë duke të pasur ty, që në fund u bëre për atë njeri i pandryshueshëm; prandaj duke të falenderuar të himnojmë duke thënë: Ti je mbreti ynë i parajetshëm dhe i përjetshëm edhe përtej; lavdi më ty.

E shenjtit
Ting. IV Ἐdhokas simíosin

Krishti i pranoi mirëbërjet që ke bër', o Kornel,* edhe lutjet e tua pa;* ndaj engjëll të shenjt' ai* të dërgon, i cili* të ndriçon ty plot'sisht, pastaj apostullin e madh* dhe korifeun që të ripërtërit* ty, bashkë me familjen tënde, përmes ujit dhe Shpirtit t' Shenjt',* të mësoje misteret pra, përmes Hirit të Shpirtit t' Shenjt'.

O Kornel, i veshur me krezmim prift'ror,[6] udhëtove larg,* pasi deshe të predikosh* në kombet shpëtimin ton';* dhe çrrënjosje gjembat*[7] e mashtrimit edhe u mbillje shpirtrave kudo,* hyjmendës, besën e pagabueshme;* prandaj të lumërojmë ty, si hierark të pëlqyer shum'* nga Jisui dhe si martir* të pamposhtur, me plot gëzim.

Duke ndjekur sjelljen tënde të mir'sis', njerëz krejt pa mend* u treguan me mend pastaj;* kur vdiqe dhe ti sipas* ligjit të natyrës* ti në varr të lumur banove* burim çudirash të shumta, o Kornel* i urtë, i shëron ata që jan' sëmur' dhe dëbon shpirtra* ligësie me Shpirtin ti, o i hyjfrymëzuar krejt.

Lavdi *Ting. Tërth. II*
I Joan Monakut

Duke bërë kujtimin e përurimit, o Zot, të lavdërojmë ty, dhënësin e shenjtërimit duke u lutur që të shenjtërohen shqisat e shpirtrave me ndërmjetimet

e athloforëve të lavdëruar, o i Tërëfuqishëm.

Tani *I njëjti*

Sot një dru u zbulua, sot gjinia e hebrenjve humbi, sot përmes mbretërish besnikë besa shfaqet. Adami përmes drurit ra, dhe përsëri përmes drurit demonët u frikësuan. O Zot i Tërëfuqishëm, lavdi më ty.

Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës dhe Leximet.*

Këndimi i III i Mbretërve
(8.22-23,27-30)

Qëndroi Solomoni para faqes së altarit të Zotit, para çdo mbledhjeje të Izraelit dhe ngriti duart e tij drejt qiellit dhe tha: O Zot, Perëndia i Izraelit, nuk ka Perëndi si ti, lart në qiell dhe mbi tokën poshtë. Nëse qielli dhe qielli i qiellit nuk do të të mjaftojnë, veçse edhe kjo shtëpi që ndërtova në emrin tënd? Dhe do të mbikëqyrësh përgjërimin tim, o Zot, Perëndia i Izraelit, që të dëgjosh përgjërimin dhe lutjen, që shërbëtori yt lutet para teje, tek ti sot, që të jenë hapur sytë e tu në këtë shtëpi ditë e natë, në këtë vend që the: Do të jetë emri im atje, që të dëgjosh lutjen që lutet shërbëtori yt në këtë vend ditë e natë. Dhe do të dëgjosh përgjërimin e shërbëtorit tënd dhe të popullit tënd Izrael, ato që do të luten në këtë vend. Dhe ti do të dëgjosh në vend të banimit tënd në qiell dhe do të bësh dhe do të jesh i mëshirshëm.

Këndimi i Fjalëve të Urta
(3.19-34)

Perëndia nëpërmjet urtësisë e themeloi dheun dhe përgatiti qiejt me mençuri. Me urtësinë e tij u çanë avusha dhe nga re rodhi vesë. O bir, mos rrëshqit dhe mbaje këshillën dhe mendim tim që të jetojë shpirti yt dhe të ketë hir rreth qafës sate. Dhe do të ketë shërim në mishrat e tu dhe përkujdesje në kockat e tua; që të ecësh me siguri në paqe të gjitha udhët e tua, ndërsa këmba jote nuk do të pengohet; sepse nëse ulesh, do të jesh pa frikë, dhe në do flesh, do flesh ëmbëlsisht; dhe nuk do kesh frikë ndaj tmerrit që do të sulmojë, as nga vrullet e të pabesëve që sulmojnë, sepse Zoti do të jetë mbi gjithë udhët e tua dhe do ta mbështetë këmbën tënde që të mos lëkundesh. Mos u largo të bësh të mirën tek i varfri, kur do ketë dora jote që të ndihmojë. Mos thuaj: Kthehu, kur të vish prapë, dhe nesër do të të jap, megjithëse ke mundësi të bësh bamirësi, sepse nuk di se çfarë do të lindë e nesërmja. Mos ndërto të këqija ku-

ndër mikut tënd, që banon tek ti përkohësisht dhe beson tek ti. Mos duaj të armiqësohesh ndaj njeriu kot, që të mos bëjë tek ti diçka të keqe. Mos përvetëso turpe burrash të këqij, as mos ki zili për udhët e tyre, sepse *është* i papastër para Zotit çdo i paligj dhe nuk ulet bashkë mes të drejtëve. Mallkimi i Perëndisë *është* në shtëpi të pabesësh, ndërsa vilat e të drejtëve bekohen. Zoti u kundërvihet kryelartëve, ndërsa të përulërve u jep hir.

Këndim i i Fjalëve të Urta
(9.1-11)

Urtësia ndërtoi për vete shtëpi dhe mbështeti shtatë shtylla. Theri viktimat e saj dhe hodhi në kanë verën e saj dhe përgatiti tryezën e saj. Dërgoi shërbëtorët e saj duke ftuar me shpallje të lartë për kanë, duke thënë ajo: Ai që është i metë le të kthehet tek unë. Dhe atyre që ishin të varfër nga mendja u tha: Ejani, hani bukën time dhe pini verën që ju kam përzier. Braktisni idiotësinë dhe do të rroni; dhe kërkoni urtësinë që të jetoni dhe që të arrini mençurinë me dije. Ai që edukon të keqij do të marrë për vete çnderim dhe duke kritikuar të pabesin do të qortojë veten e tij. Sepse kritikat për të pabesin, *janë* plagë për atë. Mos kritiko të këqij, që të mos të të urrejnë; kritiko të urtin dhe do të të dojë. Jepi të urtit një shkak dhe do të jetë më i urtë; bëj të ditur tek i drejti dhe do të shtojë të pranojë. Fillim urtësie *është* frika e Zotit dhe mendim shenjtorësh *është* mençuria. Ndërsa dija e ligjit i përket mendjes së mirë, sepse në këtë mënyrë shumë kohë do të jetosh dhe do të të shtohen vite jete.

Pasvargje të Kryqit
Ting. Tërth. I Heris askitikón

Gzohu Kryq jetëmbajtës vërtet,* që je trofe i besës, ti që nuk mposhtesh dot;* dhe der' e Parajsës ti je, mbështetje për çdo besnik,* mur fortikimi je rreth Kishës son';* përmes teje u shfaros,* dhe u zhduk prishja krejtësisht,* dhe u gëlltit prap'* forca e vdekjes përgjithmon',* dhe u ngjitëm ne* lart në qiejt' nga toka posht';* o arm' e paluftueshme, armik i demonëve,* lavd i martirëve dhe zbukurim i gjith' oshënarëve,* liman i shpëtimit,* që dhuron në botë hir edhe përdëllim të madh.

Varg: Lartësoni Zotin Perëndinë ton'.

Gzohu, o Kryq i Zotit Jisu;* ti e ke zgjidhur krejt mallkimin e njerëzis';* je shenja e ngazëllimit, rrëzon armiqtë përdhé,* o i gjithnderuar, sa her' ngrihesh lart;* je ndihma për ne të gjith'* dhe fuqia e mbretërve;* të drejtët të

kan'* forcë, priftërinjt' hijeshi,* kur shënohesh ti* nga e keqja ne na çliron;* o shkop fuqie,[8] prej të cilit gjith'ne kullotemi,*[9] armë e paqes je, që e rrethojnë engjëj me frik' dhe tmerr,* lavdia e Krishtit,* që dhuron në botë hir edhe përdëllim të madh.

Varg: Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.

G'zohu, o mjek sëmundjesh, shëndet* dhe udhëzues i të verbërve; ngjallja je* e njer'zve që kanë vdekur, ti që na ngrite ne lart,* që në prishje kishim rën', o Kryq i shenjt';* me ty ësht' dërrmuar krejt* prishja dhe lulëzoi hir* edhe paprishje;* hyjnizohen k'shtu njerëzit* edhe krejtësisht* u rrëzua satani posht';* të shohim ty të ngritur lart nga dor' episkopi sot* dhe lavdërojmë ne k'të që u lart'sua në mes teje;* të falemi ty pra;* nxjerrim si prej pusi t'pasur një përdëllim të madh.

Lavdi *Ting. II I Anatoliut*

Duke bërë inagurimin e kishës së tërëhyjshme të Ngjalljes sate, të lavdërojmë, o Zot, që e shenjtërove atë dhe e mbarove me Hirin tënd të përsosur, dhe që ngazëllohesh me rite mistike dhe të hyjshme, të cilat celebrohen nga besimtarë, dhe pranon prej duarve të shërbëtorëve të tu flijime të pagjakshme dhe të pacenuara, dhe i shpërblen ata që ofrojnë drejt,[10] me pastrimin e mëkateve dhe përdëllimin e madh.

Tani *I njëjti*

Edhe pse i fshehur në tokë si thesar hyjnor, Kryqi i Jetëdhënësit, në qiej i tregohej mbretit shpresëtar, duke shfaqur me anë të skicimit mendor fitore kundër armiqve. Mbreti i shtyrë fort nga një nxitje e perëndishme për lartësimin e dukshëm të Kryqit, i gëzuar, me besë dhe mall, e zbuloi nga barku i tokës për çlirimin e botës dhe shpëtimin e shpirtrave tanë.

Përlëshore e Shenjtërimit
Ting. IV

O Zot, ashtu si hijeshinë e kupës së sipërme, e bashkëtregove edhe bukurinë e poshtme të tendës[10a] së shenjtë të lavdisë sate. Forcoje këtë në jetë të jetëve dhe prano përgjërimet tona, që ofrohen pa pushim tek ti brenda saj, me ndërmjetimet e Hyjlindëses, o jeta e të gjithëve dhe ngjallja[10b].

Lavdi *dhe* Tani *I Kryqit Ting. II*

Kryqin jetëbërës të mirësisë sate, që na e dhurove neve të padenjëve, o Zot, e blatojmë tek ty për ndërmjetim; shpëtoji mbretërit dhe qytetin tënd, duke u paqësuar nëpërmjet Hyjlindëses, o i vetëm njeridashës.

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. IV Tahí prokatálave

Të gjitha i shndriti krejt Krishti kur erdhi në tok',* me Shpirtin e tij hyjnor ribëri botën ton'; çdo shpirt ripërtërihet pra*; se u ofrua tendë* për lavdinë e Zotit,* ku Krishti Perëndia gjallëron tash gjith' zemrat* e njerëzve që besojnë, që t'i shpëtojë k'ta.

Lavdi *dhe* Tani *Të njëjtën*

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
E ngjashme

Arriti tek ne, pra të zgjedhurit e Krishtit ton',* sot dita festive e ripërtëritjes, o besimtarë; të gjith' na nxit* që të ripërtërijmë veten ton' dhe me pamje* shum' të gëzuar, këngë t'i këndojmë me besë* nga zemra jon' Zotit çlirimtar, që na përtërit.

Lavdi *dhe* Tani *Të njëjtën*

Kanunet: Parakremtor, i Shenjtërimit dhe i shenjtit
Ode I
Kanuni Parakremtor, që ka Akrostihidhë alfabetike pa Hyjlindësoret.
I Gjermanoit
Ting. IV
Irmosi: Tristatas krateús

»**K**arroc' me tre armiq,* pra tri pjesët »e shpirtit,* lutem, mbyti krejt në fund*[11] »pa vese, ti që lind* nga e Virgjëra, që »të psal* melodité triumfale* un' me »vrasjen e trupit tim* të mëkatshëm, »porsi me timban[12] mendor.

Dëfreu ti, o dhé,* dhe ti qiell gëzohu,*[13] Kryqi krejt i Tërëshenjt'* del dhe na shenjtëron* me hir ne që i falemi* si burim për shenjtërimin* dhe si shkak hyjnizimi, pra* për të gjith' besëmirët që e nderojn'.

Forcona ne në udh',* që të shkojmë në qiell* me besim, o Kryq i shenjt';* të falemi me mall,* që të shmangemi nga çdo kurth,* nga greminat e armiqve,* për t'u bërë pjes'marrësit* e lavdisë së hyjshme[14] me hir të madh.

O Kryq i Tërëshenjt',* i nderuar, u njohëm* përmes teje prej Hyjnis',*[15] Gatuesit; me shpirt* dhe me zemër të përqafojm'* përgjithmon', duke të parë* para nesh, dhe ndriçohemi* mendërisht e lëvdojm' Fjalën, Bërësin.

Hyjlindësore

Qytet i Perëndis'*[16] dhe thesar i nderuar,* dhe hyjpritëse e mir'* e tërëmbretit je,* o Hyjlindëse pa qortim;* ruaj trashëgimin tënd, që* të lëvdon përgjithmon' si dhe* lartëson me besim lindjen tënde, Zonj'.

Kanuni i Shenjtërimit
I Joan Monakut
Ting. IV Thalasis to erithreon

O Krisht, që* më par' udh'hiqje me një shtyll' popullin Izrael,*[17] o Zot, me larjen e pagëzimit ti* e ke mbjellë fort në Sion* Kishën e shenjtë që thërret:* Le t'i këndojm' këng' Perëndisë ton'.

Sot hiri* i ardhjes së lavdis' sate të paafruarshme* mbi kishën e ndërtuar për ty Zot,* e ka bërë si qiellin;* ndaj brenda saj bashk'psalim ne:* Le ti këndojm' këng' Perëndisë ton'.

Nuk është* e zbukuruar Kisha jon' nëpërmjet Ligjit, Zot,* dhe as me shtrirje duarsh robërisht,* por me hirin e Kryqit tënd;* duke u mburrur psal tek ti:* Le ti këndojm' këng' Perëndisë ton'.

Hyjlindësore

Pa farë,* por me vullnet të Atit, ti nga Shpirt Hyjnor ke zën'* Birin e Perëndis' dhe Zotin Krisht,* dhe e linde me mish atë* që është' nga Ati, po pa nën',* dhe nga ti, po pa at' për hirin ton'.

Kanuni i shenjtit, që ka Akrostihidhë:
"Unë psal lavdinë e mrekullive të tua,
o i lumur. Josif."

Ting. Tërth. I Ipon qe anavatin

O hierark i lumur nga Zoti yn' Perëndi,* me uratat e tua ndriço ata që bëjnë panair për kujtimin tënd* dhe për fjetjen tënde, që* është' e ndritshme dhe e shkëlqyeshme.

Bëje dhe para njohjes së saktë të Perëndis'* shum' lëmoshë dhe lutje të shpeshta, o Kornel i urtë dhe mjaft i pasur ti;* dhe kërkonte shpirti yt* i sinqert' Zotin e Gjith'sis', Krishtin.

Me një sinjalizim zot'ror, Petroja korife* të mësoi misteret e Krishtit ton', i cili nga mir'sia që s'matet dot* mori mishin tonë pra;* k'shtu mësove ti ligjin shpëtimtar.

Hyjlindësore

O Kryezonj' Hyjlind'se, tërhiq zemrën ton' në mall* të pangopur, që të lavdërojmë ty gjithmon', se je lavdi e besnikëve,* o e pacenuar Vajz',* se ke lindur ti Zotin e lavdis'.

Ode III
Parakremtore
Irmosi: Uq en sofia

»**S**'mburremi fare* për fuqi, urtësi,[18]
»as për pasuri,* por për ty, pra urtësin'*
»enipostate të Atit, o Krisht*[19] njerida-
»shës, se përveç teje s'ka tjetër shenjt.

Të lavdërojmë* me bes', se ishe lavdi i Zotit ton';* përqafimet e tua* të shenjta na lavdërojn', o Kryq* shum' i lavdëruar zot'ror, edhe na ndriçojn'.

O besimtarë,* pasi erdhëm me gaz,
le të marrim ne* si nga kroi i kristalt',*
nga Kryqi, rrjedhje me jet' gjithmon';*
të shpëtuar k'shtu të himnojm' Perëndinë ton'.

Ndon'se ish jeta* Krishti, kur mbi dru
kryqi u var, u vra.* Atë dhe tani me
bes'* e përqafojmë dhe shmangemi*
nga pasionet, shkaqet e vdekjes për
çdo njeri.

Hyjlindësore

Eja, dëboje* errësirën e shpirtit tim
dhe vargonjt'* e mëkateve[20] që kam,*
o Virgjëreshë e d'lir'; më shpëto* ti
që të tër'dhembshurin Krisht mbajte
pra në bark.

E Shenjtërimit: Efrénete epí si

E ke shenjtëruar Krisht* mbi tokë
Kishën tënde me Shpirt të Shenjt',*
se e ke mirosur sot* ti me vajin tënd
dhe me gaz të madh.[21]

Themel që nuk thyhet dot,* duke të
pasur ty, o Krisht Zoti yn',*[22] si me
kuror' mbretërish,* po kurorëzohet
me Kryqin tënd.

Qart'sisht e tregove ti* tendën e bër'
me dorën ton', o i Mir',* si shtëpi[23] e
lavdit tënd* mbi mend, pra me ekonomin' e shenjt'.

Hyjlindësore

O nënë e Perëndis',* për gjith' ata
që jan' mbi dhé vetëm ti* pra je
shkak për çdo të mir'* të përmbinatyrshme, gëzohu Zonj'.

E shenjtit: O piksas ep' udhenós

E more pjes'marrjen e ndriçimit të
Shpirtit t' Shenjt* edhe Hirin nga goja
e apostullit* me familjen tënde, kur
ai* erdhi dhe predikoi* qart'sisht besimin e hyjnueshëm* para jush, mësimet që jan' shpëtim.

Si kedër u lartësove[24] shum' me virtytin tënd* dhe na solle fryte me er'
të këndshme ti,* dhënien e mësimeve që dhe,* dhe hirin e çudive,* dhe
energjinë e shërimeve,* o Kornel i
lumur e hierark.

Me një lavd të madh u denjësove, o
shën Kornel;* bashk' me korifeun si
edhe me të tjer'* ke vrapuar që të
predikosh* kudo besën e hyjshme;*
me k'to mësime po ndriçohemi,*
errësir' padijeje s'na zapton.

Hyjlindësore

U bëre ti tendë d'lirësie e ndritëshme*
dhe e mban drit'dhënësin që u bë me
mish,* dhe u duk njeri si ne të gjith'*
për dashurin' e njer'zve* dhe e ka

zhdukur prishjen me fuqi,* Zonjë e paprishshme, rithirrja jon'.

Irmosi: O piksas ep' udhenós

»O Zot që mbi hiçin e mbështete fort »tokën ton',* ndon'se e ngarkuar, e »varur nëpër er',*[25] o Krisht, Kishën »tënde siguro* mbi gurin e patund- »shëm* të porosive që ke dhën' tek »ne,* ti vetëm i mirë, që do njer'zin'.

Ndenjësore e Shenjtërimit
Ting. Tërth. IV. To prostahthén mistikós

Krishti skicoi qart' çadrën e dëshmisë*[25a] dhe Moisiu* plot çudi në tok' e bëri;* shenjtëron me flijime* Solomoni Tempull* dhe ne si Davidi mbret së bashku të gjith'* me bes' në Jerusalem të ri le të shkojm';* le ti japim himn Krishtit, se* u kryqëzua për ne;* dhe le të lypim falje krejt* për çdo shkelje që kemi bër'.

E Kryqit
Ting. IV Epefanis símeron

Kryqi yt shkëlqen si drit',* o Krisht, dëbon k'shtu* tër' ushtrin' e frymrave* të errësirës; dhe gëzon* të gjith' besnikët që psalin bashk':* Mburrja e botës* është' Kryqi i Zotit ton'.

Lavdi *I shenjtit I njëjti*

Kisha të pranoi ty* porsi fillimin* fort të shenjt' të kombeve,* pra e ndriçon dhe ti atë* me vepra e me virtytin tënd,* njohës misteresh, Kornel, je hyjmendës ti.

Tani *Hyjlindësore*
Tahí prokatálave

Sot bëjm' shenjtërimin e kishës me bes' dhe hare,* o e pacenuar, Zonj' hirplote, shum' e himnuar dhe virgjëresh' e d'lir',* me gaz, sepse shpresojmë*[25b] tek ti, o e bekuar;* lutemi ndërmjeto pra* pa pushuar pran' Krishtit,* që u mishërua nga ti,* që të shpëtohemi.

Ode IV
Parakremtore
Irmosi: Dhi' agápisin iktirmon

»Për dashurinë e ikonës sate,[26] o i »dhembshur, qëndrove mbi Kryqin tënd »dhe u shkrinë kombe,[27] sepse ti je, o »njeridashës, fuqia dhe himnimi im.

Duke u parë Kryqi i Zotit me pamje dielli, falet nga njerëzit besimtarë. Duke e puthur, ndriçohemi në shpirt.

Duke u mishëruar u shfaq madhërisht Perëndia Zot[28] dhe pasi u lartësua në dru, ndriçon gjithnjë ata që i falen dhe i çliron nga peripecitë.

Jepna, o Fjala e Perëndisë, ndjesën dhe faljen e shkeljeve,[29] neve që i falemi me besim sot Kryqit tënd të çmuar, që është para nesh.

Hyjlindësore

Fjala, pa zbrazur gjirin atëror, u shtri në gjirin tënd si foshnjë, o Vajzë, duke dashur të më rigatojë mua që isha i nënshtruar në prishje.

E Shenjtërimit: Eparthenta se idhusa

Po spërkatet Kisha me gjak nga brinja jote* e çmuar, që buron jetën,* jo nga kafshë pa mend,* që i thernin njer'zit dikur.* Thërret pra me zë të madh:* O Zot, lavdërojmë pushtetin tënd.

Gjith' ata që dëshirojnë shum' të shikojnë* pa një mbules' lavdin' që del* nga faqja e Zotit,*[30] kanë dashur tendat e tij;*[31] thërresin pra me fuqi:* O Zot, lavdërojmë pushtetin tënd.

Kisha lyhet sot me Miro të shumëçmuar* dhe pasqyron k'shtu lyerjen* e popullit tënd, Zot,* që e kishe zgjedhur ti* dhe padukurisht po merr* Hirin hyjnor, prej Shpirtit të Tër'shenjt'.

Hyjlindësore

Pa martes' aspak ke lindur, o Virgjëreshë,* edhe mbas lindjes mbete ti* përsëri e virgjër;* pra me zëra që nuk pushojn',* Gëzohu, o Zonja jon',* të thërresim pa dyshim dhe me bes'.

E shenjtit: Tin thían enoísas su

Pasi pranove Hirin e Shpirtit, si një diell i ndritshëm kalove dheun, o Kornel, duke dëbuar errësirën e manisë së idhujtarisë, o i shumë famshëm.

Dole si një lum i madh duke ujitur të gjithë faqen e tokës[32] me mësime të hyjshme dhe duke i mbytur egjrat e politeizmit, o Kornel.

Si u bëre i vdekur për tërë botën,[33] e shpalle tek të gjithë ata që vdiqën nga pasionet, ngritjen hyjnore të atij që vdiq për ne, o i tërëlumur Kornel.

Hyjlindësore

U bëre, o Virgjëreshë e dëlirë, banesë e pastër e urtësisë së Atit në mënyrë mbimendore; nëpërmjet teje ne u çliruam tani nga shpikësi i së keqes.

Ode V
Parakremtore
Irmosi: Ton fotismón su Kírie

»Na dërgo nga lart, o Zot, ndriçimin »tënd dhe na zgjidh nga mjegulla e »shkeljeve, o i mirë, duke na dhuruar »nga qielli paqen tënde.[34]

Forcona kundër pësimesh që sjellin prishje ne që të nderojmë dhe që të

puthim, o Kryq i çmuar, simbol tepër i shenjtë i pësimit të shenjtë.

O besnikë, të ndriçuar sot në zemër e shpirt e me mendime për të mirat, le të vijmë dhe le t'i falemi drurit të nderuar dhe të hyjshëm të Kryqit.

Më përpara Moisiu ëmbëlson ujërat e Merasë me dru, duke të shenjuar ty, o Kryq i çmuar, që me dru u pikove njerëzve ëmbëlsi[35] shpëtimtare.

Hyjlindësore

Për ne përgjëroju Krishtit, që nga gjaku yt i kulluar veshi mish lëndor dhe rigatoi të vdekshmit, o Vajzë e tërëpacenuar.

E Shenjtërimit: Si Kírié mu fos

Qëmoti në Sina,* tendë që u bë krejt pa dor'* tregove tek Moisiu,*[10] hyjshikuesi, o Krisht, kështu skicove Kishën qart'.

Një tendë mbi dhé, ti* o Zot, na e ke bërë ne,* ti urdhërat qiellore* me grupime njer'zore bashkon pra me pushtetin tënd.

O Zot, si një burim* jetësor krejt të njohim ne;* ti, o i Shenjt, duke ardhur,* paqen ungjillëzove[36] tek Kisha jote, Perëndi.

Hyjlindësore

Arm' e pathyeshme* je, pra kundër armiqve të vem';* të kemi ty, o Hyjnuse* si spirancë dhe shpresë[37] shpëtimi për të gjithë ne.

E shenjtit: O anavalómenos

I përkushtuar i tëri tek i Gjithëpushtetshmi, o njohës misteresh, nuk i adhurove statujat e shurdhëra, megjithëse të nxitën njerëz kriminelë.

Thirre për një kohë të gjatë Perëndinë e Lartë, të padukshëm; dhe rrëzove tempull statujash të neveritshme, duke u admiruar shumë.

Meqenëse ruajte urdhrin e të Gjithëpushtetshmit, u burgose dhe durove pranga; dhe çlirove nga prangat e besimit të rremë të pamendët, o hyjurtë.

Hyjlindësore

Dërgomë si shi, o e tërëkulluar, ndjesë mëkatesh, më vizito mua që jam sëmurë dhe në furtunë, në mjerimet e jetës dhe pasionet e trupit.

Ode VI

Parakremtore

Irmosi: Ilthon is ta vathi tis thalasis

»**N**jë stuhi më zhyti edhe rashë në »thellësit' e detit,* një stuhi prej »shum' mëkatesh, shkeljesh,* por ti »si Zot,* o i shum'mëshirëshëm,* ma »ngri jetën ti nga fundi posht'.

Kur me shtiz' u shpua Krijimtari në brinjë, kur ish varur* mbi ty, duke dashur, o Kryq, zbraz shum'* gjak, uj'; me to* krejt u rigatuam gjith'* ne besnikët që të falemi.

O dhuratë jete dhe burim pavdekësie, Kryq i Zotit,* je ti çlirimtari i gjith' botës;* shpëtona ne* që të falemi porsi* rojen tonë, shpëtimtarin ton'.

Si një arm' që s'thyhet na u dhe, me të cilën krejt fitojmë* mbi të gjitha grackat e armiqve,* ne që me shpirt* të sinqert', të drejt', o Kryq,* po të puthim ty hyjnueshëm.

Hyjlindësore

Ishe tempull i shenjt' i atij që po prehet mbi shenjtorët,*[38] o Hyjlind'se, ndaj na shenjtëron ne* që besërisht* të himnojm', o Zonja jon'* virgjëreshë-nënë, me lavdi.

E Shenjtërimit: Thiso si metá fonís

Zoti mbret* e dëshiroi shum' bukurin' tani*[39] të Kishës së respektuar;* e dëfteu, shfaqi si nënë kombesh,* që nga skllavë* i adopton me Hirin e Shpirtit t' Shenjt.[40]

Kanë frik'* brigadat e demonëve të zinj korb* nga Kisha e Krishtit tonë,* që shënohet me shenj' të Kryqit të shenjt',* hijeson pra* nga Shpirt i Shenjt' shkëlqim që na shenjtëron.

Jo rërë,* por një themel ka Kisha e kombeve,* i cili është Jisui;* dhe kurorëzohet me bukurinë* e pakapshme,* që zbukuron kuror' mbretërore pra.

Hyjlindësore

O çudi,* që është më e re se çdo mrekulli,* se Virgjëresha në mitër* duke zën' pa burr' Krishtin Zot, i cili* mban në dorë* tër' Gjithësinë, nuk e ngushtoi dot.

E shenjtit: Menomenin klídhoni

Bëje lutje të sinqert',* kur pe dukshëm* engjëll zotëror;* të mësoi ty mistere të mëdha* dhe të zbuloi sa ndihmojn' për shpëtimin ton'.

I ndriçuar shpirtërisht* rrezatoje* si një yll i madh* dhe ndriçoje me shkëlqim të fortë shum'* çdo cep të botës, o hyjnjohës, Kornel i shenjt'.

Si e njohu Perëndin',* ndon'se më par'* qe në errësir'* të mashtrimit, zgjohet me kontaktin tënd,* o Petro, pret pastrim të shenjt' me familjen bashk'.

Hyjlindësore

Zoti i lavdis' u bë* mish nga gjaku* yt tër'virgjëror,* në mënyr', Zonj', që vetëm ai e di,* prej mirësis', o e himnuar, që të shpëtojm'.

Irmosi: Menomenin klídhoni

»Deti i pasioneve* me furtunë* shpirt-
»shkat'rruese* plot mani trazohet.
»Zbute ti, o Zot,* dhe k'shtu nga prishja
»nxirrmë, se je i dhembshur, Krisht.

Kontaqi i Shenjtërimit
Ting. IV Epefanis símeron

Qiell i shum'ndritëshëm* u shfaq qart' kisha* dhe ndriçon besnikët pra,* duke shkëlqyer për të gjith';* në të qëndrojm' dhe thërresim bashk':* K'të shtëpi, o Zot,* forcoje si Perëndi.

Shtëpia

Kur na erdhi trupërisht Fjala, fëmija i bubullimës[40a] thotë nga një anë duke shkruar: Pamë me ngazëllim lavdinë që kishte Biri nga Ati në hirin e së vërtetës; nga ana tjetër, ne që e morrëm këtë me besim, na u dha të gjithëve pushtet të bëhemi fëmijë Perëndie; ndërtuam këtë shtëpi lutjeje pasi u rilindëm, jo nga gjaku, as nga vullnet mishi,[41] por si u rritëm nga Shpirti i Shenjtë dhe thërrasim: K'të shtëpi, o Zot, forcoje si Perëndi.

Sinaksari

Më 13 të të njëjtit muaj, kujtimi i Shenjtërimit të Ngjalljes së shenjtë të Krishtit dhe Perëndisë tonë.

Vargje: Izraeli i ri, duke ruajtur Ligjin e vjetër,/ me përurim e nderon varrin tënd, për ty, o Fjalë.
U arrit inagurimi i Ngjalljes më 13.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i shën Kornel Kryeqindëshit.
Vargje: Nga jeta e pabesë nxjerr, o Krishti im,/ Kornelin, si fryt të kombeve besëtare.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Kronidhi, Leonti, Serapioni, Stratoni, Selefki, Makrovi, Gordhiani, Zotiku, Ili, Llukiani dhe Valeriani.

Ati ynë oshënar Petro në Agrea mbaron në paqe.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Aristidhi apologjet.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së madhe Katevana, mbretëreshës së Kahetës në Gjeorgji.

Oshënar Ierotheu i ri, murg i manastirit të Ivironit, mbaron në paqe në 1745.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Parakremtore
Irmosi: Nei tris en Vaviloni

»Tre Djem në Babiloni, si* llomotitje
»urdhëri* i mbretit, tiranit pra,* u dukej,
»mes flakës k'shtu th'rrisnin:* Je i be-

»kuar ti, o Zot,* Perëndia i etërve tan'.

Qëmoti në bekimet e fëmijëve të parafiguronte ty Jakovi,[42] o Kryq i çmuar; por ne duke t'u falur ty tani, nxjerrim ndriçim prej teje përherë.

Qëmoti, o Kryq, me purtekë të paraikonizon Moisiu i hyjshëm, duke prerë një det; ndërsa ne, duke t'u falur ty tani, përshkojmë deri në fund oqean të vështirë pësimesh pa u lagur.[43]

O Kryq i tërënderuar, duke të përqafuar tani me gojë e zemër, nxjerrim gjithmonë shenjtërimin, shëndetin, shpëtimin e shpirtit edhe të trupit.

Hyjlindësore

O Virgjëreshë e bekuar, ndërmjeto për ne që të lypim fort, se në ty shpresojmë të gjithë dhe të thërrasim: O Zonjë, mos e shpërfill grigjën tënde.

E Shenjtërimit: En ti kamino avramiei

Flaka e furrës* qëmoti, vesëprurëse krejt u duk;* por prej vaji, lyerje shpirtërore sot* shenjtëron sa po thërrasim fort:* Në kishën e lavdisë sate ti pra je i lëvduar, Zot.

Gjith' ne që jemi* nga Izrael i ri shpirtëror edhe* të freskuar në k'të tendë hyjprurëse* si në furrë, të thërresim fort:* Në kishën e lavdisë sate ti pra je i lëvduar, Zot.

Ju të plagosur* nga dashuri e shenjtë, e ëmbël shum',* ejani në k'të dhom' të mbretit, Krishtit ton',* të bashkohemi me[44] të edhe* të th'rrasim: O Zot i lavdisë, i bekuar je përgjithmon'.

Hyjlindësore

Ti që je tenda* e shenjtë dhe hyjnore e Zotit lart,*[45] g'zohu, sepse nëpërmjet teje u dha gaz,* o Hyjlindëse, atyre që* thon': E bekuar midis grave ti je,[46] o e panjollëshme.

I shenjtit: O iperipsúmenos

Ti u bëre fryti i parë i kombeve, o Kornel, se i pari pranove pagëzimin e shenjtë dhe Hirin e Shpirtit, si më par' hyjfolësit.

Duke bërë me hir hyjnor çudi kolosale, kape për besim ata që më parë ishin besëkëqij dhe i mësove ata të psalin: O Perëndi, je i bekuar.

Duke u fshehur në dhé e duke u mbuluar me një shkurre, me sugjerime hyjnore, o i urtë, u shfaqe duke buruar hir çudish dhe duke larguar sëmundje.

U tregove kitarë që këndoi dogma shpëtimtare dhe që ëmbëlsoi shpirtrat e të gjithëve, o Kornel, duke psalur: O Perëndi, je i bekuar.

Triadik

Të gjithë le të lavdërojmë Njësinë

trihipostate, Atin parapafillim, Birin e bashkëqenshëm dhe Shpirtin, duke psalur: O Perëndi, je i bekuar.

Hyjlindësore

Me lindjen tënde të hyjshme, o Virgjëreshë e tërëpaqortueshme, u shfaqe të hyjnizosh brumin njerëzor; prandaj ne besimtarët të lavdërojmë siç të ka hije.

Ode VIII
Parakremtore
Irmosi: Litrotá tu pantós

»**F**uqiplot', çlirimtar* për të gjithë ne, »tek të rinj zbrite, se* mbanin besën »fort* mes flakës; i freskove pra,* i »mësove të psalnin:* Ju gjithë veprat,* »e bekoni, himnoni shum' Zotin ton'.

Tani i falemi Kryqit të Zotit, i cili është përballë të gjithëve, pra armën shpëtimtare dhe të pathyeshme, ndihmën e gatshme të besnikëve, përkrahjen e fortë.

Mbi një dru Moisiu e vari tërthorazi gjarprin, siç është shkruar,[47] duke të paraikonizuar ty, o dru i gjithënderuar, nëpërmjet të cilit çlirohemi nga dëmi i gjarpërinjve mendorë.[48]

Je natyrisht ndriçimi i shpirtrave tanë, o Kryq dritëdhënës e i tërënderuar; sepse duke të përqafuar, zmbrapsim me fuqinë tënde hyjnore autoritetet dhe pushtetet e errësirës.[49]

Hyjlindësore

Le të nderojmë të kulluarën dhe Virgjëreshën, që mbajti në bark mbinatyrshëm Fjalën pa fillim dhe të pandërtuar për shpëtimin tonë; ne thërresim: E bekojmë, o e Virgjër, lindjen tënde.

E Shenjtërimit: Hiras ekpetasas
Dhaniíl

Kisha* jote, o Zot, një këmish' mendore, që u thur nga lart,[50] nga Hir i shenjt',* si nuse veshi stolisje mir';* edhe popujt e vet po i fton* për ngazëllim, që të këndojn'* edhe të psalin me zë të ëmbël:* Ju gjithë veprat, himnojeni Zotin ton'.

Krishti,* ky Adam i dyt',[51] na shfaqi ne porsi Parajsë mbimendore sot* k'të tendë të re, e cila mban* kundër drurit, pemës së dijes,*[52] pra armën jetëprurëse* të Kryqit, për ata që bashk'psalin:* Veprat e Zotit, bekoni ju Zotin ton'.

Triadik

Psalim* për ty duke respektuar një Hyjni shum' të përsosur, pa fillim* dhe të paprer', të njëqenëshme,* hipostazë të tre, pa trazim,* Birin nga Ati pa fillim* si edhe Shpirtin e Shenjt',

dhe themi:* Veprat e Zotit, bekoni ju Zotin ton'.

Hyjlindësore

Vetëm* ti në gjithë gjeneratat, o e pacenuar dhe Hyjlindëse,* u duke nëna e Perëndis'* dhe banes' hyjnore ti ke qen';* por pa u djegur dot nga zjarr* i paafrueshëm;[53] pra thërrasim:* Je e bekuar, Mari, nus' e Perëndis'.

E shenjtit: Si to panturgó

Ke kërkuar me shpirt e frymë të sinqertë vetëm Perëndinë, që u duk mbi dhé; prandaj u bëre, o hyjprurës, si flijim i çmuar frutash të parë i kombeve dhe enë e Shpirtit.

Me thëngjillin e fjalëve të tua të përflakta, o i lumur, e dogje lëndën e kotësisë; prandaj shkove tek drita e paperëndueshme, duke ndriçuar gjithë ata që të himnojnë me mall.

Si trashëgimi, pjesë,[54] ndihmë, shpëtues, fuqi,[55] himnim,[56] dritë dhe udhëzues u bë për ty Fjala, që i thërret të gjitha nga mosqenia,[57] o Kornel hyjmendës.

Triadik

Bekojmë Atin, Birin edhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin.

O Atë i shenjtë, o Fjalë e Shenjtë, o Shpirt, o Trini e Tërëshenjtë, e pandërtuar, e pandarë, shpëto ata që himnojnë me mall pushtetin tënd, mbretërinë dhe madhështinë tënde.

Hyjlindësore

Spërkatna si zakonisht me mëshirat e tua, o Vajzë e kulluar, dhe kërko faljen e të gjitha shkeljeve, që na ndodhin nga dija dhe padija e nga pakujdesia.

Irmosi: Si to panturgó

Himnojmë, bekojmë dhe i falemi Zotit.

»**D**jemat thurën kor mbar'bot'ror »brenda furrës* dhe psalnin për ty, pra »Bërësin e Gjithësis':* Ju gjithë veprat »e përmbilartësoni,* e himnoni Zotin »në jetë dhe përherë.

Ode IX
Parakremtore
Irmosi: O tokos su áfthoros

»**U** shfaq e paprishshme lindja jote; »nga barku yt doli Perëndia,* kur mbi »tokë[58] u pa me mish edhe u shoqërua »me njer'zit,[59] me ne;* pra, o Hyjlind'se,* »të gjith' ty të madhështojm' me shpirt.

Kur Krishti ish varur mbi ty, botën e rënë në fundin thell' të humbjes* vërtet, e lartësoi; ndaj, o Kryq i Zotit, të lavdërojm' me shum' mall* dhe të nderojmë* tani, edhe ne të falemi.

Me punë të mir', me këmbëngulje, të lajm' shpirtrat edhe zemrat, meqë* shohim drurin e Kryqit që të jet' në mes, përpara nesh; sjell shpëtim, ndaj* hyjmendërisht ne* me besim e mall t'i falemi.

Si diell i madh ata që jan' në err'sirë i shndrit dhe djeg demonët* përmes rrezeve, o Kryq shum' i bukur; ndaj na feks, llamburit të gjith' ne* që me besim thell',* me shpirt dhe me nder të falemi.

Hyjlindësore

Me dritën e hyjshme llamburitmë, se je, Virgjëresh', banesë drite;* k'shtu dëbo errësirën e pasioneve që kam, nat' vërtet të errët* epshesh, o Zonjë* e Tër'shenjt', Perëndilindëse.

E Shenjtërimit: Lithos ahirótmitos orus

Ejani me zemër të pastër, me sy të mendjes vigjilente,* le të shohim dhe madhështojm' bukurin'* e Kishës, që është bij' e Mbretit,* që po shkëlqen[60] përmbi çdo ar;* ta lavdërojmë plot me zë të madh.

G'zohu dhe dëfre ti, o nuse e Mbretit ton' të madh dhe Zotit,*[60] duke pasqyruar shum' qart' bukurin'* e dhëndrit tënd si dhe Shpëtimtarit;* me popullin tënd ti pra thirr:* Të madhështojm', o jetëdhënës ty.

O Zot, Shpëtimtari yn', jepi nga lart çdo mbrojtje Kishës sate*, pra se tjetër veç teje nuk njeh ajo,*[60a] por vetëm ty, që ke dhënë shpirtin*[61] dikur për hir dhe jet' të saj,* që me ndërgjegje po të madhështon.

Hyjlindësore

G'zohu ti, o nuse e hirshme[46] e mbretit ton' të madh[60] të botës,* sepse nëpërmjet teje ne të gjithë* shpëtuam nga çdo mallkim i Evës*[62] dhe, o e d'lirë, gjetëm jet'* nga lindja jote, që u bë pa burr'.

E shenjtit: Isaia hóreve

Panair të hijshëm bën* mbarë Kisha* në kujtimin tënd* të shenjt', o predikues i Krishtit ton';* u duke i barasvlefshëm me apostujt hirplot', të shenjt',* se ke fituar ti,* si ata Shpirtin e Tërëshenjt'.

Si klerik ke qen' njësoj* me ata që* për Zotin shërbejn';* me dogma bese u zbukurove mir';* lumenjt' e shërimeve buron gjithnjë, o i lumur shenjt'* edhe pushon kështu* ti sëmundje njerëzore krejt.

Duke u stolisur mir'* me një rrobë* shpëtimtare ti,* që thuri Krishti yn', kur u bë njeri,* tani me gëzim[63] shëtit në mbretërin' qiellore dhe* sheh shum' qart' bukurin'* që ka dhëndri; pra të lumërojm'.

Arka e lipsanit tënd* si një krua* po buron për ne* shpres'tarët çdo shërim dhe dëbon, Kornel,* demonët e ligj dhe gjithashtu ndriçon sytë e çdokujt* që të lëvdon me zell,* plot me besë dhe të admiron.

Hyjlindësore

Një ndriçim kërko për ne,* ti që linde* dritë që u ndrit* prej dritës dhe dëbo larg prej meje, Zonj',* err'sirën e ngasjeve edhe të epsheve gjithashtu,* o e panjollëshme,* mbrojtje e paturpëruar krejt.

Irmosi: Isaia hóreve

»Isaia vallëzo,* Virgjëresha,* Zonja »Shën Mari* na lindi Jisu Krishtin »Emanuel,* njeri edhe Perëndi; dhe »emër ka Lindjen që na ndrit.* Pra ma»dhështojm' atë,* lumërojmë dhe »Hyjlindësen.*

Dërgimësore
Tis mathités sinélthomen

Në Golgotha vullnetarisht* u lartësua Zoti* mbi kryq, punoi k'shtu shpëtim*[64] për ne, e rinovoi* të gjith' Krijesën, ndërkaq pas* futjes së tij në varrin* jet'prurës, u ngjall pas tri dit'sh* si Perëndi, pra bëjm' panair të ri* bashk' me rreshtat pa trup në q'ell, për ngritjen* e tij të shum' shkëlqyeshme* dhe të nderuar shumë.

Tjetër E ngjashme

Në mes të dheut Zoti yn'* dhe Perëndia bëri* me kryq shpëtim,[64] pasi lirisht* u mishërua për ne,* për përtëritjen e botës* dhe u vendos në varrin* dhe pas tri dit'sh u ngjall; kështu* ngritjen e tij e shfaqi paraprakisht* si fejesë jete, prandaj me engjëj* po bëjmë panair të ri* për Perëndin' me besë.

Hyjlindësore E ngjashme

Ty të thërresim me gëzim,* o Virgjëresh': Gëzohu;* g'zohu, çlirim nga nëma ti* je për Adamin, Evën;*[65] gëzohu se me ty u ngrit* esenca njerëzore* drejt lavdit të mbibotëshëm* të Perëndis' tënd dhe Birit, o Mari* Hyjnën' e himnuar, dhe adhurohet* përmes teje ai në q'ell* gjithnjë nga engjëj; g'zohu.

6 Lavdërimet e Shenjtërimit
Ting. IV 'Edhokas simíosin

Streha dritëprurëse hyjnore, e perëndishme fort,* streha që respektohet thell'* e ngjalljes së Krishtit ton'* me gaz përurohet.* Shpërndan nëpër botë varri i shenjt' jetën vërtet* edhe na jep kroin e pavdekëshëm,* buron rrëke sot Hir i shenjt' si edhe çurka çudie prap'* dhe shërim i dhuron ai* çdo njeriu që psal me bes'.

Çdo gjë po ndriçon shkëlqim edhe lavdi dritëshfaqëse,* që nga lart zbriti dhe shkëlqen;* ndaj le të nderojm' të gjith'* besërisht dhe ngjalljen* e Krishtit krijues; le të kremtojm' me himn të zjarrt'* dhe panairin e hyjshëm e të shenjt',* dhe jetëprurës gjithashtu, me brohori le të psalim[66] bashk'* që ta gjejm' të mëshirshëm krejt* Shpëtimtarin dhe Zotin ton'.

Duke dëshiruar fort ta shohim skeptrin e Kryqit ne,* që të ngrihet mes dheut[64] lart,* me drit' të ndriçohemi,* të pastrojmë mendjet* dhe le t'i shkëlqejmë, dhe me fuqi prej Perëndis'* të shum'ndriçuar le të himnojm' Jisun',* i cili shenjtërim na jep nëpërmjet drurit të tij të shenjt',* ne që e lavdërojm' me bes'* edhe psalim me ngrohtësi.

Dhe Idhiomelet e mëposhtme
Ting. I I Joan Monakut

Ripërtëritu, ripërtëritu o Jerusalem i ri, se erdhi drita jote dhe lavdia e Zotit shkrepëtiu mbi ty.[67] Këtë shtëpi Ati e ndërtoi; këtë shtëpi Biri e siguroi; këtë shtëpi e ripërtëriti Shpirti i Shenjtë, i cili ndriçon dhe mbështet dhe shenjtëron shpirtrat tanë.

I njëjti I Anatoliut

Qëmoti, duke inaguruar Tempullin Solomoni, ofronte flijime kafshësh të pamend dhe holokauste,[68] o Zot; por kur ti deshe mirë, o Shpëtimtar, të pushohen shenjimet nga një anë, nga ana tjetër të njihet e vërteta, skajet e botës therore të pagjakshme i ofrojnë lavdisë sate; meqenëse ti mbizotëron mbi të gjitha, i shenjtëron me Shpirtin tënd të Shenjtë.

Ting. IV I Joan Monakut

Ripërtëritet sot Kisha nga kombet me gjakun e çmuar dhe jetërrjedhës të brinjës së pacenuar dhe të tërëshenjtë të atij që u mishërua prej Virgjëreshës së shenjtë, Krishtit Perëndisë tonë; pra duke u grumbulluar ne, koret e besimtarëve, le të lavdërojmë Atin edhe Birin edhe Shpirtin e Shenjtë, një Hyjni që mban Gjithësinë.

Lavdi *Ting. III*

Kthehu tek vetja, o njeri, bëhu i ri nga i vjetër që ishe dhe kremto ripërtëritjen e shpirtit; përsa ka kohë, jeta le të rinovohet për ty, udha e çdo sjelljeje; të lashtat ikën, ja të gjitha u bënë të reja;[69] këtë fryt i jep festës, duke u tjetërsuar me ndryshimin e mirë; kështu ripërtëritet njeriu, kështu nderohet dita e inagurimit.

Tani *I njëjti I Joan Monakut*

O Krisht, Perëndia ynë, që denjove

kryqëzim vullnetar për ngjalljen e përbashkët të gjinisë së njerëzve, dhe me kallamin e Kryqit, pasi përgjake gishtërinjtë e tu me ngjyrë të kuqe, i firmose për ne me njeridashje si mbret amnistitë; mos na shpërfill ne që rrezikojmë përsëri ndarjen prej teje, por ki dhembshuri, o zemërgjerë, për popullin tënd në peripeci dhe ngrihu, lufto kundër atyre që na luftojnë si i tërëfuqishëm.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni Parakremtor Ode III, dhe i Shenjtërimit Ode VI

Kungatore: O Zot, desha hijeshinë e shtëpisë sate dhe vendin e tendës së lavdisë sate.

CITIME

[1] Is. 41.1; 45.16

[2] Ef. 4.22-24

[3] Gjen. 3.1-7

[4] Ps. 60(61).4

[5] Matth. 16.16-18

[6] Eks. 28.37; 29.7-9; 30.30; 40.13

[7] Jer. 1.10

[8.] Ps. 109(110).2

[9] Ps. 2.9

[10] Gjen. 4.7

[10a] Ps. 25(26).8

[10b] Joan 11.25

[11] Eks. 15.4

[12] Eks. 15.20

[13] Ps. 95(96).11; Is. 49.13

[14] I Petr. 5.1; II Petr. 1.4

[15] Gal. 4.9

[16] Hebr. 12.22; Apok. 3.12

[17] Eks. 13.21-22; Num. 14.14

[18] II Kor. 1.12; Fil. 3.3

[19] I Kor. 1.24; 1.30

[20] Fja. Urt. 5.22

[21] Ps. 44(45).8

[22] I Kor. 3.11

[23] Vep. 7.48; Hebr. 9.11

[24] Ps. 91(92).13; Sirak 24.13

[25] Jov 26.7

[25a] Eks. 25.8

[25b] Rom. 12.12

[26] Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3

[27] Ps. 96(97).5

[28] Ps. 117(118).27

[29] I Joan 2.2; 4.10

[30] II Kor. 3.14-18

[31] Ps. 83(84).1

[32] Gjen. 2.10

[33] Gal. 6.14

[34] Lluk. 24.36; Joan 14.27; 20.19,21,26

[35] Eks. 15.23-24

[36] Ef. 2.17

[37] Hebr. 6.18-19

[38] Is. 57.15

[39] Ps. 44(45).12

[40] Rom. 8.15

[40a] Mark. 3.17

[41] Joan 1.12-14

[42] Gjen. 48.13-16

[43] Eks. 14.15-29

[44] Ps. 18(19).6

[45] Ps. 45(46).5

[46] Lluk. 1.28

[47] Num. 21.9; Joan 3.14

[48] Gjen. 3.1-7; II Kor. 11.3; Apok. 12.9; 20.2

[49] Joan 16.11; Ef. 6.12

[50] Joan 19.23

[51] I Kor. 15.45

[52] Gjen. 2.17

[53] Eks. 3.2-5

[54] Ps. 15(16).5

[55] Ps. 17(18).2

[56] Ps. 117(118).14

[57] Rom. 4.17

[58] I Tim. 3.16

[59] Varuh 3.38

[60] Ps. 44(45).10-14; Apok. 21.2

[60a] Is. 26.13

[61] Joan 10.15,17

[62] Gjen. 3.16

[63] Is. 61.10

[64] Ps. 73(74).12

[65] Gjen. 3.16-17

[66] Ps. 94(95).2

[67] Is. 60.1; Vep. 7.49

[68] III [I] Mbret. kap. 8

[69] II Kor. 5.17

MË 14 TË TË NJËJTIT MUAJ

Lartësimi mbarëbotëror i Kryqit të çmuar dhe jetëbërës.

Nëse bie e diel, nuk psalim asgjë ngjallësore, por vetëm ato të së kremtes. Por në Mbrëmësore lexojmë Kathizmën e parë të plotë të Psaltirit (Lum ai njeri).

NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Vargëzime
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Zot kur ngriheshe në Kryq, ngrite me veten tënde tërë natyrën e rënë të Adamit; prandaj duke ngritur Kryqin tënd të pacenuar, o njeridashës, lypim fuqinë tënde nga lart duke thirrur: O i Shumëlartë, si Perëndi mëshirues, shpëto ata që nderojnë lartësimin e hyjshëm, të respektuar dhe ndriçues të Kryqit tënd.

(2x)

Me një mënyrë psalmike tani shohim nënkëmbësen e këmbëve të tua, o Zot, ku qëndruan këmbët[1] e tua të kulluara, të ngrihet sot me mallëngjim, pra Kryqi yt i çmuar; dhe duke e ngritur besërisht, të lypim e të thërresim: Si na shenjtëron të gjithë, o i Shumëlartë, me Kryqin tënd të hyjshëm, na trego pjesëmarrës të dhembshurisë sate të pashprehur dhe të Hirit.

Si një trofe të pamposhtur, si një mburojë të paluftueshme dhe si një skeptër të perëndishëm, i falemi, o Krisht, Kryqit të tërëshenjtë, nëpërmjet të cilit, bota është shpëtuar dhe vallëzon Adami; ne, sistemet e të dhélindurve, e nderojmë duke e lavdëruar me këngë, dhe duke bërë lartësimin e tij të hyjshëm, kërkojmë faljen.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. II

Ti je streha ime e fortë,[1a] o Kryq i tripjesë i Krishtit; shenjtëromë me fuqinë tënde që të të falem dhe të të lavdëroj me besë dhe mall.

Pasvargje
Ting. II Ikos tu Efratá

Sot ngrihet Kryqi i Krishtit, druri jetëprurës, në të cilin u gozhdua duke na rithirrur të gjithëve.

Varg: Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë, dhe faljuni nënkëmbëses së këmbëve të tij.

Duke parë drurin e Kryqit të lartësohet, le t'i japim madhështi Perëndisë të kryqëzuar në mish nga mirësia.

Varg: Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.

Gëzohu, o mur i paluftueshëm, ruajtje e hyjshme e besnikëve, Kryqi i Zotit, përmes të cilit u ngritëm nga toka.

Lavdi *dhe* Tani *I njëjti*

Le të puthim të gjithë me hare drurin shpëtimtar, mbi të cilin u tendos Krishti, çlirimi ynë.

Përlëshorja Ting. I

O Zot, shpëto popullin tënd.

NË MBRËMËSOREN E MADHE

Nuk lexohet Psaltiri (përveç të dielën)
Vargëzime
Ting. Tërth. II Olin apothémeni

Kryqi që po ngrihet tash,* e nxit Krijesën e tërë,* që të madhështojë fort* pra, pësimin e Krishtit që u ngrit mbi të,* se ka vrarë në kryq* atë që na kish vrar',* na ringjalli ne që kishim vdekur dhe na zbukuron* e na denjëson të jetojmë lart* në qiell, si i dhembshur krejt,* sipas mirësisë së tij të shumt';* le ta lartësojmë pra emrin e tij me gëzim të madh,* le ta himnojmë të gjithë ne* bashkëzbritjen e atij.

(2x)

Të përfytyroi qart',* o Kryq, kur ngriti lart duart* Moisiu, edhe k'shtu* triumfoi kundër tiranit Amalik;*[9] mburrje e besës je* dhe forcim martirësh,* zbukurimi i apostujve dhe për të drejtët je* mbrojtje; oshënarët të kan' shpëtim;* prandaj Krijesa ka gëzim* dhe bën panair, sepse të shikon* ty të lartësohesh dhe Krishtin lavdëron, sepse në ty* ai bashkoi të kundërtat* për shumicën e mir'sis'.

(2x)

Kryq, që respektohesh fort* edhe rrethohesh nga rreshta* engjëjsh, që gëzohen shum',* sot me aprovimin e Perëndis' ngrihesh;* na lart'son të gjith' ne* të dëbuarit larg,* se me ngrënie jemi vjedhur edhe kemi shkarë posht',* ty të përqafojmë me shpirt, me mall,* me buzë, me besim të plot',* nxjerrim si nga pusi jet', shenjtërim* dhe thërrasim: Pra lartësoni Krishtin, Perëndin' e mir',* duke iu falur nënkëmbëses* s' shenjt' të këmbëve të tij.[2]

(2x)

Lavdi *dhe* Tani
Ting. II

Ejani të gjithë kombet, le t'i falemi drurit[1] të bekuar, me të cilin u bë drejtësimi i amshuar; sepse ai që mashtroi Adamin, stëratin, me drurin, joshet dhe gënjehet me Kryqin. Dhe

bie përtokë me rënie të çuditshme[3] ai që sundoi me tirani krijesën mbretërore. Me gjak Perëndie helmi i gjarprit shpëlahet dhe mallkimi i dënimit të drejtë u zgjidh, kur i drejti u dënua me gjyq të padrejtë; se duhej të shërohej druri me dru dhe me pësimin e atij që është i papasionshëm, të zgjidheshin pësimet e fajtorit, që fajtoi përmes drurit. Por lavdi, o Krisht mbret, ekonomisë sate të frikshme për ne, nëpërmjet së cilës na shpëtove ne të gjithë, si i mirë dhe njeridashës.

Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës dhe Leximet.*

Këndimi i Eksodit
(15.22-27; 16.1)

Ingriti Moisiu bijtë e Izraelit nga Deti i Kuq dhe i udhëhoqi ata në shkretëtirën e Surit; dhe ecnin tri ditë në shkretëtirë dhe nuk gjenin ujë për të pirë. Dhe erdhën në Meranë dhe nuk mundeshin të pinin ujë nga Mera, sepse ishte i hidhur; prandaj emri i atij vendi u mbiquajt Hidhërim. Dhe murmuriste populli kundër Moisiut duke thënë: Ç'të pimë? Dhe thirri Moisiu tek Zoti dhe i tregoi atij Zoti një dru dhe e futi atë brenda ujit dhe u ëmbëlsua uji. Atje i vendosi atij të drejta dhe gjykime dhe atje e provoi atë dhe i tha: Nëse do ta dëgjosh me dëgjim Zotin, Perëndinë tënd dhe do t'i bësh ato që janë të pëlqyera para atij dhe do t'i vendosësh në vesh porositë e tij dhe do t'i ruash të gjitha të drejtat e tij, çdo sëmundje që e solla mbi egjiptianët, nuk do ta sjell mbi ty, sepse unë jam Zoti që të shëroj ty. Dhe erdhën në Elim dhe ishin atje dymbëdhjetë burime ujërash dhe shtatëdhjetë trungje feniksesh; dhe fushuan atje pranë ujërave. Dhe u ngritën nga Elimi dhe erdhi gjithë tërësia e bijve të Izraelit në shkretëtirën e Sinit, që është mes Elimit dhe mes Sinait.

Këndimi i Fjalëve të Urta
(3.11-18)

O bir, mos e lër pas dore edukimin e Zotit, as mos u shkurajo kur kritikohesh prej tij; sepse atë që do Zoti, e edukon dhe kamxhikon çdo bir të cilin e pranon. Lum njeriu që gjeti urtësi dhe i vdekshmi që njohu mençuri, se është më mirë ta tregtosh atë sesa thesare floriri dhe argjendi. Dhe më e vlefshme është se gurët e çmuar. Nuk i kundërvihet asaj asgjë e ligë. Ajo u bëhet e njohur lehtë të gjithëve që e duan, ndërsa çdo *gjë* e çmuar nuk është e denjë me atë; sepse *ka* jetëgjatësi dhe vite jete në të djathtën e saj, kurse në të majtën e saj, *ka*

pasuri dhe lavdi. Nga goja e saj del drejtësi, dhe ligj e mëshirë vesh mbi gjuhë. Udhët e saj janë udhë të mira dhe të gjitha rrugët e saj *janë* me paqe. Pemë jete është ajo për të gjithë ata që e mbajnë dhe për ata që mbështeten mbi të, *është* e sigurt si mbi Zotin.

Këndimi i profecisë së Isaisë
(60.11-16)

Këto thotë Zoti: Do të hapen portat e tua, o Jerusalem, përgjithmonë, ditë e natë nuk do të mbyllen, që të fusin tek ti fuqi kombesh dhe mbretërit e tyre të udhëhequr. Sepse kombet dhe mbretërit, të cilët nuk do të të shërbejnë ty, do të shfarosen dhe kombet do të shkretohen me shkretim. Dhe lavdia e Libanit tek ti do të vijë me qiparis, pishë dhe kedër, që të lavdërojnë së bashku vendin tim të shenjtë; dhe vendin e këmbëve të mia do ta lavdëroj. Dhe do të ecin drejt teje të frikësuar bijtë e atyre që të përulën dhe që të acaruan, dhe do t'u falen gjurmëve të këmbëve të tua të gjithë ata që të acaruan dhe do të quhesh Qytet Zoti, Sioni i të Shenjtit të Izraelit, sepse ishe bërë i braktisur dhe i urryer dhe nuk kishte kush të të ndihmonte ty. Dhe unë do të të vendos hare të amshuar, ngazëllim brez pas brezi. Dhe do të thithësh qumësht kombesh dhe pasuri mbretërish do të hash. Dhe do të njohësh se unë jam Zoti që të shpëtoj dhe që të çliroj, Perëndia i Izraelit.

Në Liti
Ting. I I Andrea Jerusalemasit

Sot, vërtet thënia hyjnore e Davidit u përfundua; sepse ja, dukshëm i falemi nënkëmbëses[2] së këmbëve të tua të kulluara; dhe duke shpresuar në hijen e krahëve të tu[4] të thërrasim, o i tërëdhembshur: U shënoftë mbi ne drita e fytyrës sate[5] dhe lartëso bririn[6] e popullit tënd orthodhoks me lartësimin e Kryqit tënd të çmuar, o Krisht i shumëmëshirshëm.

I njëjti

Druri i jetës së vërtetë, që u mboll në vend Kalvari, mbi të cilin punoi shpëtim mbreti i shekujve në mes të dheut,[7] duke u lartësuar sot, shenjtëron anët e botës dhe përurohet shtëpia e Ngjalljes. Ngazëllohen engjëj në qiell dhe dëfrehen njerëz mbi dhé, duke thirrur porsi Davidi dhe duke thënë: Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë dhe faljuni nënkëmbëses së këmbëve të tij, se është i shenjtë[2] ai që i jep botës përdëllimin e madh.

I njëjti

Duke e paraskicuar Kryqin tënd, o

Krisht, patriarku Jakov, kur ua dhuronte nipërve bekimin, vendosi duart mbi kokat në formë kryqi;[8] pra, o Shpëtimtar, duke e lartësuar ne atë, sot thërrasim: Dhuroji mbretit të devotshëm të Krishtit fitoren, si Konstandinit trofenë.

Ting. II I Theofanit

Edhe pse i fshehur në tokë si thesar hyjnor, Kryqi i Jetëdhënësit, në qiej i tregohej mbretit shpresëtar, duke shfaqur me anë të skicimit mendor fitore kundër armiqve. Mbreti i shtyrë fort prej një nxitje të perëndishme për lartësimin e dukshëm të Kryqit, i gëzuar me besë dhe mall, e zbuloi nga barku i tokës për çlirimin e botës dhe shpëtimin e shpirtrave tanë.

I njëjti I Qiprianit

Ndërrimi i duarve të patriarkut Jakov për bekimin e fëmijëve,[8] paradeklaroi simbolin e pushtetshëm të Kryqit, të cilin ne, duke e pasur si ruajtje të pathyeshme, dëbojmë plot me fuqi batalionet e demonëve; dhe duke rrëzuar me atë vetullën e beliarit, zmbrapsim ushtrinë tejet shkatërrimtare të armikut të madh Amalik. Tani që po lartësohet Kryqi, ne besimtarët, këtë ia blatojmë mirësisë sate, me mendje shpresëtare për falje mëkatesh, duke thirrur me zë shumë të fortë: Mëshiro, o Zot, që u mishërove prej Virgjëreshës; ki dhembshuri, o i mirë, për Krijesën e urtë të duarve të tua.

I njëjti I Leonit mbret

Ti je streha ime e fortë,[1a] o Kryq i tripjesë i Krishtit; shenjtëromë me fuqinë tënde, që të të falem dhe të të lavdëroj me besë dhe mall.

Ting. IV

Le të duartrokasim sot për panair këngësh dhe me fytyrë e gjuhë ngazëlluese le të thërrasim fuqishëm: Ti, o Krisht, që për ne pranove gjyq, pështymë, fshikullime, dhe që u veshe me mantelin e kuq dhe u ngjite në Kryq, kur të panë ty dielli dhe hëna fshehën ndriçimin, dheu tronditej prej frikës dhe kurtina e Tempullit u ça më dysh; edhe tani ti vetë dhurona Kryqin tënd të çmuar si ruajtës, mbrojtës dhe dëbues të demonëve, që të gjithë duke e përqafuar t'i thërrasim: Shpëtona, o Kryq, me fuqinë tënde; shenjtërona me shkëlqimin tënd, o Kryq i çmuar, dhe forcona me lartësimin tënd, sepse na u dhurove si dritë dhe shpëtim për shpirtrat tanë.

I njëjti I Anatoliut

Një shëmbëllim dritëshkëlqyer yjesh i paratregonte, o Kryq, trofe fitoreje mbre-

tit të madh shpresëtar; nëna e tij Eleni kur të gjeti, të bëri të dukshëm në botë; dhe duke të ngritur sot ne, koret e besnikëve, thërrasim: Ndriçona me shkëlqimin tënd, o Kryq jetëprurës, shenjtërona me fuqinë tënde, o Kryq i tërërespektuar dhe forcona me ngritjen tënde, duke u lartësuar për të na rreshtuar kundër armiqve.

Lavdi *dhe* Tani *I njëjti*
I Anatoliut

O Krisht, duke paratreguar Moisiu energjinë e Kryqit të çmuar, triumfoi kundër kundërshtarit Amalik në shkretëtirën Sina; sepse kur shtrinte duart, duke bërë shenjën e Kryqit, forcohej populli;[9] tani përfundimi i gjërave u përmbush tek ne. Sot Kryqi lartësohet dhe demonët largohen. Sot mbarë Krijesa u çlirua nga prishja,[10] sepse të gjitha dhuntitë na shkëlqyen nëpërmjet Kryqit, prandaj të ngazëlluar të gjithë biem para teje duke thënë: Sa u madhështuan veprat e tua, o Zot,[11] lavdi më ty.

Pasvargje
Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu Kryq jetëmbajtës vërtet,* që je trofe i besës, ti që nuk mposhtesh dot;* dhe der' e Parajsës ti je, mbështetje për çdo besnik,* mur fortikimi je rreth Kishës son';* përmes teje u shfaros,* dhe u zhduk prishja krejtësisht,* dhe u gëlltit prap'* forca e vdekjes përgjithmon',* dhe u ngjitëm ne* lart në qiejt' nga toka posht';* o arm' e paluftueshme, armik i demonëve,* lavd i martirëve dhe zbukurim i gjith' oshënarëve,* liman i shpëtimit,* që dhuron në botë hir edhe përdëllim të madh.

Varg: Lartësoni Zotin Perëndinë ton'.

G'zohu, o Kryq i Zotit Jisu;* ti e ke zgjidhur krejt mallkimin e njerëzis';* je shenja e ngazëllimit, rrëzon armiqtë përdhé,* o i gjith'nderuar, sa her' ngrihesh lart;* je ndihma për ne të gjith'* dhe fuqia e mbretërve;* të drejtët të kan'* forcë, priftërinjt' hijeshi,* që shënohesh dhe* nga e keqja ti na çliron;* o shkop fuqie,[11a] prej të cilit të gjith' kullotemi,*[11b] armë e paqes je, që e rrethojnë engjëj me frik' dhe tmerr,* lavdia e Krishtit,* që dhuron në botë hir edhe përdëllim të madh.

Varg: Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.

G'zohu, o mjek sëmundjesh, shëndet* dhe udhëzues i të verbërve; ngjallja je* e njer'zve që kanë vdekur, ti që na ngrite ne lart,* që në prishje kishim rën', o Kryq i shenjt';* me ty ësht' dërrmuar krejt* prishja dhe lulëzoi hir* edhe paprishje;* hyjnizohen pra njerëzit* edhe krejtësisht* u rrëzua sa-

tani posht';* të shohim ty të ngritur lart nga dor' episkopi sot* dhe lavdërojmë ne k'të që u lartësua pra mes teje;* të falemi ty dhe* nxjerrim si prej pusi t' pasur një përdëllim të madh.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. IV I Joan Monakut

Me simbolin që qëmoti Moisiu e parafiguroi tek vetja e tij, rrëzoi me triumf Amalikun,[9] dhe Davidi melodist duke thirrur, urdhëroi që t'i falemi, pra nënkëmbëses sate,[2] domethënë Kryqit tënd të çmuar, o Krisht Perëndi, sot ne mëkatarët i falemi me buzë të padenja, duke të himnuar ty, që pranove të gozhdohesh në të dhe të thërrasim: O Zot, bashkë me kusarin, bëna të denjë për mbretërinë tënde.

Përlëshore
Ting. I

O Zot, shpëto popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd,[12] dhuroju shpresëtarëve fitore mbi barbarët dhe ruaje shtetin tënd me anën e Kryqit tënd.* ***(3x)***

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. I Tu lithu sfrajisthentos

Meqen'se u gozhdove, o jeta e të gjith've,* përmbi Kryqin tënd, ne i falemi drurit të tij, o Zot;* Parajsën i hape, Shpëtimtar,* kusarit që të erdhi me besim* dhe u denjësua për një dëfrim të madh* se thirri: O Zot, kujtomë.* Ndaj si k'të pritna ne që të lëvdojm'* dhe themi: Mëkatuam pra;* për mir'sinë tënde, o njeridashës, mos na shpërfill.

Lavdi *dhe* Tani *I njëjti*

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore

Ting. Tërth. II

Vetëm sa u fiksua druri i Kryqit tënd, o Krisht, dhe themelet e vdekjes u lëkundën, o Zot, sepse atë që Hadhi gëlltiti me kënaqësi, e volli me tmerr; na tregove shpëtimin tënd,[13] o i Shenjtë, dhe të lavdërojmë ty, o Bir Perëndie; mëshirona.

Lavdi *dhe* Tani *I njëjti*

Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. Tërth. IV To prostahthén

Kur shtriu duart e tij në formë kryqi* Jisui, biri* i Naviut, o Zot, dikur,* e parafiguronte* në mënyr' mistike* ikonën e Kryqit tënd; dielli u shtang,* qëndroi sa i shfarosi* armiqt' e tu,* por tani ky u errësua se të pa mbi një kryq, që të shkat'rrosh forc' vdekjeje,* të plaçkitësh dhe Hadhin krejt.

Lavdi *dhe* Tani *I njëjti*

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV

Panë gjithë anët e dheut shpëtimin e Perëndisë tonë.
Varg: I këndoni Zotit një këngë të re.

Ungjilli. Ne që pamë ngjalljen *(në çfarëdo ditë kur do të bjerë e kremtja). Psalmi 50 hima.*

Lavdi *Ting. II*

Ti je streha ime e fortë,[1a] o Kryq i tripjesë i Krishtit; shenjtëromë me fuqinë tënde, që të të falem dhe të të lavdëroj me besë dhe mall.

Tani *I njëjti*

Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

O Kryq i Krishtit, shpresa e të krishterëve, udhëzues i të humburve, liman i dimëruesve, fitore në luftëra, siguri e botës, mjek i të sëmurëve, ngjallja e të vdekurve, mëshirona.

Kanuni, që ka Akrostihidhë: "Duke pasur guxim në Kryqin, them himn".
Poezi e zotit Kozma
Ting. Tërth. IV

Ode I
Irmosi: Stavrón haraksas

»**N**jë kryq vijosi me shkop* Moisi »profeti* dhe Det' i Kuq u ça më dysh »dhe Izraeli shkoj përtej,* pastaj »prapë e bashkoj* me të njëjtin shkop »dhe kryq përsipër valëve* dhe forcat »edhe qerret Faraonit ia mbyti,[13a] pra »Krishtin këndojmë si* Perëndi dhe »Zot me brohori dhe gaz.*

E parashfaqi dikur* midis dy shenjtorësh* vet'veten Moisiu si shenj' të pësimit zotëror,* pra kur u shndërrua ky* si një kryq me duart që kish shtrir', kish bër' trofe;* fuqin' e Amalikut shkatërrues shfarosi;[9] le t'i këndojm' Krishtit pra,* Perëndisë ton', se u lëvdua fort.

Vendosi lart mbi një shtyll'* ilaç Moisiu,* që asgjësonte çdo kafshim helmues dhe shkatërrimtar.* Në një dru që ish në shenj'* kryqi, lidhi gjarprin që zvarritej nëpër tok';* tërthoraz e kish lidhur, triumfoi ndaj vdekjes, le t'i këndojm' Krishtit pra,* Perëndisë ton', se u lëvdua fort.

Trofen' e Kryqit e dha* qielli te mbreti* hyjmendës, kreu pra i shpres'taris', ia shfaq, por jo të plot'.* Me të u rrëzua posht'* krenaria e armiqve shumë të vështir';* u kthye mbrapsht mashtrimi dhe gjithkund ësht' besimi, le t'i këndojm' Krishtit pra,* Perëndisë ton', se u lëvdua fort.

Zbritësore: Stavrón haraksas

Një kryq vijosi

Ode III
Irmosi: Ravdhos is tipon

»Shkopi një herë si një simbol i mi»sterit na u shfaq,* se filizat na tre»guan priftërinë,*[13b] edhe për Kishën »beronjë ja ku mbiu edhe lulëzoj* Kryqi »tani për forcë dhe për siguri.*

Kur kishte nxjerr' guri i thepisur uj', sapo u godit,* për një popull[14] të pabindur, zemërgur pra,* na paraqiti misterin e gjith' Kishës që u ftua prej* Zotit, e cila ka pushtet dhe forc' Kryqin.

Kur u plagos brinja e kulluar me shtizë, dolën bashk'* uj' dhe gjak, që pastrojn' çdo mëkat dhe ishte* si përurim i bes'lidhjes, sepse Kryqi është mburrja jon'* edhe pushtet, forcim për çdo mbret shpresëtar.

Zbritësore: Ravdhon is tipon

Shkopi një herë

Ndenjësore Ting. Tërth. IV
To prostahthén

Brenda Parajsës më par' druri më zhveshi,* armiku sjell pra* me shijimin e tij vdekje,* por u ngul mbi dhé druri,* Kryqi që na solli* këmishën e jetës edhe bota e tër'* u mbush me gëzim, hare dhe* me ngazëllim;* duke e par' të lartësohet, popuj, le t'i thërrasim Perëndis' me besë bashk':* Streha jote ësht' plot lavdi.[15]

Lavdi *dhe* **Tani** *I njëjti*

Ode IV
Irmosi: Isakíkoa Kírie tis ikonomias su

»Kam dëgjuar, o Zoti Krisht,* si e rre»gullove këtë mister të madh,* i kup»tova veprat që ke bër'* dhe të lav»dërova, Perëndia im.[15a]*

Moisiu shndërroi përmes drurit qëmoti në shkretëtirë burime që lindnin hidhërim,[16] duke parashfaqur shpërnguljen e kombeve tek shpresëtaria nëpërmjet Kryqit.

Jordani, që mbylli në gjirin e tij veglën prerëse, e ridha përmes drurit,[17] duke argumentuar prerjen e mashtrimit përmes Kryqit dhe pagëzimit.

Si një parafigurim sistemohet hyjnisht populli i ndarë në katër pjesë, kur shkon para Tendës së Dëshmisë,[18] duke u lavdëruar me rendet në formë kryqi.

Duke u shtrirë mrekullueshëm Kryqi, hodhi si shtizë rrezet diellore, dhe qiejt treguan lavdinë e Perëndisë tonë.[19]

Zbritësore: Isakíkoa Kírie tis ikonomias su

Kam dëgjuar

Ode V
Irmosi: O trismakáriston ksilon

»O dru i lumur tri herë, përmbi të cilin »u nde pra mbret' i lartë Zoti Krisht,* »se prej teje u rrëzua djalli gjarpër*[19a] »i gënjyer tmerrësisht prej Zotit të »mbërthyer përmbi kryq,* q'u fal shpir- »trave* përdëllim dhe paqe[19b] për- »gjithmon'.*

O dru i shumëkënduar, mbi të cilin u tendos Krishti, shpata që vringëllohej duke ruajtur Edenin,[20] kishte ndrojtje përpara teje, ndërsa Keruvimi i frikshëm u hoq para Krishtit që tek ti u gozhdua, dhe u jep shpirtrave tanë paqen.

Forca të nëndheshme, kundërshtare të Kryqit, i kanë frikë shenjës kur vijoset në ajër, ku ato lëvizin, por gjinia qiellore e të dheshmëve i gjunjëzohet Krishtit, që u jep shpirtrave tanë paqen.

I shfaqur me shkëlqime të pacenuara, Kryqi i hijshëm, si i ndriçon me dritën e hyjshme kombet e errësuara, ata që janë në mashtrimin dinak i familjarizon me Krishtin, i cili u gozhdua në të dhe u jep shpirtrave tanë paqen.

Zbritësore: O trismakáriston ksilon

O dru i lumur

Ode VI

Irmosi: Notiu thirós en splahnis

»Në barkun e bishës në det, profeti »shën Jona kish hapur duart në form' »kryqi* dhe pësimin e Krishtit para- »tregonte qart'sisht* pra i triditshmi »jasht' u hodh dhe ngjalljen e përmbi- »natyrëshme e paralajmëroj* të Jisujt »të mbërthyer përmbi kryq për ne,* që »na e ndriti Krijesën me ngritjen prej »varreve.*

Jakovi nga pleqëria i k'rrusur, vuante nga një sëmundje, por po ngrihej* për të shfaqur veprimin e Kryqit jetësor; pra* duart ai këmbeu. Përtëriti Perëndia që u kryqëzua, vjetër'sin'* edhe hijen e shkronjës së Ligjit, sepse* e shkroi prap' dhe dëboi sëmundjen mashtruese.

Pëllëmbët i vë mbi kokat e reja Izraeli në form' kryqi dhe k'shtu shpalli* se ish lavdi i vjetër, tash populli i vjetër;* pra ky mendoi se gaboi, por ai nuk e ndërroi shenjën jetëprurëse,* se thërriste që do të ket' përparësi* popull i ri zotëror, që ka Kryqin si mur të fort'.

Zbritësore: Notiu thirós

Në barkun e bishës

Kontaqi

Ting. IV O ipsothís

Ti që u ngrite përmbi Kryqin me dashje,* shtetit të ri të themeluar prej teje,* dhuroi kurdoherë, o Krisht Perëndi;* jepi forcë dhe gëzim popullit;* shtetit edhe të gjithëve* fali mundje dhe triumf* në çdo luft' mbi armiqtë;* të

paçim gjithënjë bashk'luftëtar,* armë për paqe, trofe që nuk mposhtet dot.*

Shtëpia

Duke qenë të dashuruar me Shkrimet, lexuat dhe njohët ç'shkruan tek Galatianët ai që u ngrit në Parajsë, pas qiellit të tretë dhe dëgjoi fjalë të pashprehshme[21] dhe të hyjnueshme. Thotë: Mos ndodhtë tek unë të mburrem, veç për Kryqin e Zotit vetëm, mbi të cilin ai vrau pasionet duke pësuar; prandaj edhe ne të gjithë e mbajmë me siguri si mburrje atë, Kryqin e Zotit, sepse ky dru është shpëtimtar për ne, armë për paqe, trofe që nuk mposhtet dot.

Sinaksari

Më 14 të të njëjtit muaj, Lartësimi mbarëbotëror i Kryqit të çmuar dhe jetëbërës.
Vargje: Krijesa, duke parë Kryqin të lartësohet,/ o Shpëtimtar, sjell lartësimet në laring.[21a]
Druri i Kryqit u lartësua më 14.

Në të njëjtën ditë, fjetja e atit tonë ndër shenjtorët Joan Gojartit, kryepiskop i Konstandinopojës, sepse në këtë ditë u preh, por për shkak të festës së Kryqit të çmuar u transferua festa e tij në muajin nëntor.

Kujtimi i Plakilës, mbretëreshës fort shpresëtare, që u bë bashkëshorte e Theodhosit mbretit të madh.
Vargje: Duke lënë kurorë të prishshme tokësore, Plakila/ gjeti në qiejt kurorë të paprishshme.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i Etërve tanë ndër shenjtorët, që u mblodhën në Sinodin e Gjashtë të Shenjtë dhe Ekumenik gjatë mbretërisë së Konstandin Pogonatit, bir i Justinianit të Dytë, të mbiquajtur "Hundëpreri", kur e drejtonte Sergji Kishën e Konstandinopojës dhe Agathoni të romakëve. Dhe u mbajt në kupolën e pallatit mbretëror që mbiquhej vezake dhe dënoi me anatemë Sergjin, Pirron, Petron dhe Pavlin, që ishin bërë episkopë të Konstandinopojës, Makrovin e Antiokisë, Kirin e Aleksandrisë, Honorin e Romës, Stefanin dhe Polikronin dhe ata që ishin me ta. Sinodi i Shenjtë u mblodh gjatë Konstandin Pogonatit, të lartpërmendur, por shpallja e Kanuneve është bërë gjatë Justinianit, birit të tij.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Papa.
Vargje: I vinte turp Papës të psherëtinte për shenjat e plagëve,/ se e kishte afër ndihmën, Perëndinë.

Në të njëjtën ditë, martiri i shenjtë Theokliu mbaron me shpatë.

Vargje: Edhe Theokliu erdhi tek thirrja e sipërme,/ duke pasur si karrocë prerjen nga shpata.

Në të njëjtën ditë, shën Valeriani, foshnjë, mbaron me shpatë.
Vargje: Perëndia i madh i ka dhënë Valerianit të vogël/ një kurorë shumë të madhe në qiell.

Oshënar, martir i ri i shenjtë Makari, që u martirizua në Selanik në 1527, i cili ka qenë edhe nxënës i patriarkut të Konstandinopojës Nifonit, vëllamit të Gjergj Kastriotit, mbaron me shpatë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Irmosi: ´Eknoon próstagma

»Urdhër të çmendur dha tirani besëlig, »e tundi popullin,* botën e tmerroj me »blasfemi dhe paudhësi,* po të tre »Djemat nuk i tronditi dot* tërbimi i »egër as furra me zjarr,* dhe kur po fryn- »te era vesëprurëse, këndonin brenda »mu në zjarr:* I përhimnuar je, Perëndi »dhe Zot i madh,* përjetë i bekuar.*

I pari mes të vdekshmëve kur shijoi dru, banoi në prishje, sepse duke u dënuar, i ngjiti gjithë gjinisë si një sëmundje epidemike trupvrasëse rënien e turpshme nga jeta.[22] Por ne të dhélindurit, duke gjetur rithirrje drurin e Kryqit, thërrasim: I përhimnuar je, Perëndi dhe Zot i madh, përjetë i bekuar.

Mosbindja prishi urdhër Perëndie dhe një dru prej të cilit hëngrëm në një kohë të papërshtatshme, njerëzve u solli vdekje; prandaj druri i jetës së fortnderuar kishte përpara një pengesë të fortë. E çeli atë mirënjohja e një të vdekuri, që pësoi vdekje të keqe, i cili netëve qëndronte në pritë për të plaçkitur; ai thërriste: I përhimnuar je, Perëndi dhe Zot i madh, përjetë i bekuar.

E përqafon cepin e bastunit të Josifit Izraeli,[23] që shikonte ato që do të bëheshin, duke deklaruar që më parë se Kryqi i fortlavdëruar do ta mbajë pushtetin e mbretërisë; se ai është krenari triumfale për mbretër dhe dritë për ata që thërrasin me besë: I përhimnuar je, o Perëndi dhe Zot i madh, përjetë i bekuar.

Zbritësore: ´Eknoon próstagma
Urdhër të çmendur

Ode VIII
Irmosi: Evlojite pedhes

»E bekoni Djema* si Trinia nga numëri, »Atin q'ellor, të vetëmin Zot,* himnoni* »Fjalën që mbi dhenë zbriti* dhe e »bëri vesë zjarrin e furrave,* dhe e

»lartësoni ju Shpirtin e Tërëshenjtë,*
»që u dhuroi që të gjith've jetën.*

Kur lartësohet druri që u spërkat me gjakun e Fjalës së Perëndisë të mishëruar, himnoni, o forca të qiejve, duke kremtuar rithirrjen e të vdekshmëve. O popuj, faljuni Kryqit të Krishtit, nëpërmjet të cilit erdhi në botë ngjallja përjetë.

O ju të dheshëm, administratorë të Hirit, me pëllëmbë lartësoni me hijeshi Kryqin, ku qëndroi Krishti Perëndi, dhe shtizën që shpoi trupin e Fjalës së Perëndisë. Le të shikojnë të gjithë kombet shpëtimin e Perëndisë,[24] duke e lavdëruar përjetë.

Ngazëllohuni, o mbretër besnikë të të krishterëve, që u zgjodhët me votën e hyjshme; mburruni për armën trofeprurëse, se fituat nga Perëndia si në short Kryqin e çmuar; sepse me të shpëndahen përherë fise luftënxitëse, që kërkojnë arrogancë.

Zbritësore: Evlojite pedhes

E bekoni djema

Ode IX
Më të nderuarën nuk stihologohet
Irmosi: Mistikós i Theotoqe

»**O** Hyjlindëse, parajsë mistike je,*
»se pa lërim lulëzove Zotin Krisht,* që
»mbolli përmbi dhé jetëprurësin Kryq*
»që po lusim me besë,* se ky po lartë-
»sohet* dhe me anën e tij ty të madhë-
»shtojmë sot.*

U gëzofshin të gjith' drutë e pyllit[25] sot.* U shenjtërua natyra e tyre* nga druri zotëror që u mboll në fillim,* se ai në të u nde;* përmes këtij që ngrihet*[26] madhështojm' Krishtin ton' edhe i falemi.

Bri i shenjt' u lartësua për çdo besnik,* kryqi që ësht' kreu i të gjithave.* Në të dërrmohen brirët e çdo shkelësi* dhe armiku mendor krejt;* përmes këtij që ngrihet*[26] madhështojm' Krishtin ton' edhe i falemi.

Irmos tjetër: O dhiá vróseos tu ksilu

»**M**allkim i vjetër i stërgjyshit,* që
»rrodhi prej helmimit të gjarpërit,*[19a]
»e shkatërroi Kryqi i Zotit Krisht, bekimi
»erdhi prapë për njerinë me Mari Hyjli-
»ndësen,* që na lindi Jisunë Çlironjë-
»sin, të gjitha pra fuqitë e lavdërojnë
»në qiellin.*

Duke mos lënë hidhërimin* e drurit[27] që të jet' shkatërrues, Zot,* me Kryqin e ke shuar ti krejtësisht; qëmoti prishi në Mera një dru hidh'rimin e gjith' ujrave;* parashfaqte kështu energjin' e tij, që forcat lart në qiell e madhështojnë atë gjithnjë.

Me Kryqin tënd na lartësove,* se ishim vazhdimisht, o Krisht Perëndi,* në errësirën thell' stërgjyshore, se natyra kishte rën' më parë pa frenim në një mashtrim; k'shtu sot* na ka ngritur prap' drita e Kryqit tënd ne bashkërisht; pra Kryqin të gjith' besnikët e madhërojm'.

Që të tregosh në botë shenjën* e Kryqit të lavdishëm përmbi çdo gjë* dhe për t'iu falur k'tij, e formove ti në qiell me një dritë të fort', të shkëlqyer dhe të famshme shum'* si një armë e pamposhtur për mbretërit. K'të armatim gjith' forcat në qiell e madhështojn' gjithnjë.

2 Zbritësore: Mistikós i Theotoqe dhe O dhiá vróseos tu ksilu

O Hyjlindëse Parajsë
dhe **M**allkim i vjetër

Dërgimësore
Ting. II Ton mathitón oronton se

Ja Kryqi, është ruajtës i tër' botës;* është' Kryqi bukuria e gjithë Kishës;* Kryqi është' forcim, pushtet' i mbretërve;* Kryqi, mbështetja e besës;* është' Kryqi lavd për çdo engjëll* dhe plagë është' për demonët.

(2x)

Tjetër: Jinekes akutísthite

Ja Kryqi lartësohet sot* dhe bota shenjtërohet krejt,* sepse, o Krisht, që bashk'ulesh* mbi fronin ti tok me Atin* edhe me Shpirtin, duart pra* në të i shtrive dhe ashtu* botën e tër' tërhoqe pran',* në njohjen tënde, lëvdoji* pra sa tek ti kan' besim.

Lavdërime
Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu thávmatos

O çudi paradoksale krejt! Kryqi i shenjt' tërësisht,* që është' pem' jetëprurëse* shfaqet dukshëm sot për ne,* meqë ngrihet në lartësi;* pra lavdërojnë anët e rruzullit* dhe frikësohen të gjith' demonët bashk'.* O ç'është kjo dhunti* e dhuruar tek të vdekshmit; me të ti,* o Krisht, shpirtrat na shpëto, sepse i dhembshur je.

(2x)

O çudi paradoksale krejt! Shohim të ngrihet lart sot* nga posht' Kryqi që Perëndin'* e ka mbajtur si një rrush,*[28] që është' mbushur me jetë plot.* Me të u ngjitën të gjith' drejt Perëndis'* dhe u gëlltit vdekja jon' përfundimisht.*[29] O dru pa fare njoll',* që na jep shijim të ngrënies që nuk vdes* dhe që ndodhet në Eden. Të lavdërojm', o Krisht.

O çudi paradoksale krejt! Kryqi e ka gjerësin'* dhe gjat'sinë të barabart'* me q'ellin, sepse me hir * shenjtëron

Gjithësin' e tër'.* Me të pushtohen kombe barbarësh mbar',* në të mbështeten skeptrat e mbretërve.* O shkall' e hyjshme ti!* Nëpërmjet asaj vrapojm' në qiell lart,*[30] duke ngritur Zotin Krisht me këngë dhe lavdi.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. II*

Sot del përpara Kryqi i Zotit dhe besimtarët e pranojnë me mall dhe marrin shërime shpirti, trupi dhe për çdo lëngatë. Le ta puthim atë me hare dhe frikë; me frikë për mëkatin, se jemi të padenjë, ndërsa me hare për shpëtimin që i jep botës, ai që u gozhdua në të, Krishti, Zoti, që ka përdëllimin e madh.

Dhoksologjia e Madhe
(në tingull "ájia")

Pas fundit të saj dhe kur fillon Trishenjtori Asmatik, prifti, duke marrë sipër kokës kryqin e çmuar mbi një dhisk me degë borziloku, del nga Hierorja dhe duke paraprirë eksapterët, llambadhet dhe temjanicat, e sjell në mes të kishës, ku pasi përfundon Asmatiku, thotë me zë të lartë: **"Urtësi, drejt".** *Dhe e vendos kryqin mbi një trapezë të vogël katërkëmbëshe, të sistemuar që më parë. Temjanis në formë kryqi rreth trapezës, duke psalur:* **O Zot, shpëto popullin tënd...** *një herë, të cilën e përsërisin të dy koret nga një herë tjetër secili. [Afër priftit qëndron kishtari ose dikush tjetër, duke i mbajtur librin që të mos bëjë gabime].*

Pastaj bën tri metani, në çfarëdo dite që do të bjerë, merr në duar kryqin e çmuar bashkë me degë borziloku dhe duke qëndruar para trapezës katërkëmbëshe nga lindja, thotë me zë të lartë që të dëgjojnë të gjithë:

Mëshirona, o Perëndi, sipas mëshirës sate të madhe, të lutemi dëgjo dhe mëshiro.

Dhe kori fillon 100-en e parë e "Mëshiro, o Zot" dhe prifti vulos (bën shenjën e kryqit) me kryqin e çmuar tri herë dhe përkul kokën gradualisht deri një pëllëmbë nga toka; dhe përsëri ngrihet dalëngadalë derisa të plotësohet 100-ja [dhe prapë vulos me kryqin tri herë].

Pastaj kthehet nga veriu i trapezës katërkëmbëshe dhe thotë:

Lutemi edhe për të krishterët shpresëtarë dhe orthodhoksë.

Dhe kori fillon 100-en e dytë, ndërsa prifti vepron si më parë.

Pastaj kthehet nga perëndimi dhe thotë:

Lutemi dhe për kryepiskopin tonë *(aksh)* **dhe për tërë vëllazërinë tonë më Krishtin.**

Dhe kori fillon 100-en e tretë.

Pastaj prifti kthehet nga jugu dhe thotë:

Lutemi edhe për çdo shpirt të krishterësh orthodhoksë, për shëndet dhe shpëtim dhe faljen e mëkateve të tyre.

Dhe kori fillon 100-en e katërt.

Pas lartësimit të katërt, prifti kthehet përsëri para trapezës katërkëmbëshe nga lindja dhe thotë:

Lutemi edhe për të gjithë ata që shërbejnë dhe shërbyen në këtë kishë *(ose manastir)* të shenjtë, për shëndet, shpëtim dhe faljen e mëkateve të tyre.

Dhe kori fillon 100-en e pestë.

Pas plotësimit të saj, ngre kryqin duke psalur Kondaqin: Ti që u ngrite përmbi kryq..., *pastaj vendos kryqin mbi trapezë dhe psal:* Kryqit tënd i falemi... *një herë dhe e përsërisin koret nga një herë dhe prifti i falet atij dhe pastaj i falen të gjithë duke u psalur Idhiomelet:*

Ting. II

Ejani, o besnikë, le t'i falemi drurit jetëbërës, në të cilin Krishti, mbreti i lavdisë, duke i shtrirë duart vullnetarisht na lartësoi tek lumërimi i lashtë ne që më parë armiku, duke na vjedhur përmes kënaqësisë, na ka bërë të jemi të internuar larg Perëndisë; ejani, o besnikë, le t'i falemi drurit, nëpërmjet të cilit u denjësuam t'i dërrmojmë krerët e armiqve[31] të padukshëm. Ejani të gjithë fiset e kombeve të nderojmë me himne Kryqin e Zotit. Gëzohu, o Kryq, që je çlirimi absolut i Adamit të rënë, më ty mbretërit tanë tepër besimtarë mburren, se me forcën tënde nënshtrojnë me fuqi popull ismailit; të krishterët, duke të puthur tani me frikë, lavdërojnë Perëndinë që u gozhdua në ty, duke thënë: O Zot, që u kryqëzove në të, mëshirona si i mirë dhe njeridashës.

Ting. Tërth. I

Ejani, o popuj, duke parë mrekullinë paradoksale, t'i falemi fuqisë së Kryqit; se një dru në Parajsë nxori si lastar vdekjen, ndërsa ky lulëzoi jetën, duke pasur Zotin e pamëkatshëm të gozhduar; nga ai ne, gjithë kombet, vjelim paprishje dhe i thërrasim: Lavdi ty, që nëpëmjet Kryqit shfarose vdekjen dhe na çlirove.

I njëjti

Zëri i profetëve të tu, Isaisë[32] dhe Davidit,[33] o Perëndi, u plotësua kur thoshte: Do vijnë të gjithë kombet dhe do të falen para teje; se ja, populli i mbushur me hirin tënd, o i mirë, është

në oborret e tua, o Jerusalem. Ti që durove kryq për ne dhe me ngjalljen tënde jep jetë, ruajna dhe shpëtona.

Ting. Tërth. II

Sot pema e jetës,[34] duke u ngritur nga barku i tokës, vërteton ngjalljen e Krishtit që u gozhdua në të; dhe duke u lartësuar me duar të hyjshme, shpall lartësimin e tij drejt qiejve, nëpërmjet të cilit, brumosja jonë, që nga rënia përdhé, jeton në qiej. Pra le të thërrasim gëzueshëm: O Zot, që u lartësove në të dhe që na bashkëlartësove ne përmes atij, denjësoi ata që të himnojnë për gëzimin qiellor.

I njëjti

Sot katër skajet e botës shenjtërohen, meqenëse lartësohet Kryqi yt që ka katër krahë, o Krisht Perëndia ynë, dhe bashkëlartësohet briri i mbretërve tanë besnikë, të cilët me këtë dërrmojnë brirët e keqdashësve;[26] i madh je, o Zot, dhe i çuditshëm në veprat e tua! Lavdi më ty.

I njëjti

Zërat e profetëve e paranjoftuan drurin e shenjtë, nëpërmjet të cilit Adami u çlirua nga mallkimi i lashtë i vdekjes. Krijesa sot, kur lartësohet Kryqi, ngre bashkë me të zërin, duke kërkuar mëshirën e pasur nga Perëndia. Por ti, që je i vetmi i pamasë në përdëllim, o Zot, bëhu për ne i butë dhe shpëto shpirtrat tanë.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. IV*

Zëri i profetit tënd Moisi u plotësua, o Perëndi, kur thoshte: Do të shikoni jetën tuaj të varur përballë syve tuaj.[35] Sot Kryqi lartësohet dhe rruzulli nga mashtrimi është çliruar. Sot ngjallja e Krishtit përurohet dhe anët e dheut ngazëllohen, duke të ofruar himn me cimbale davidiane dhe duke thënë: Punove shpëtim në mes të dheut, o Perëndi,[7] Kryqin dhe Ngjalljen, me të cilat na shpëtove, o i mirë dhe njeridashës; o Zot i tërëfuqishëm, lavdi më ty.

Në Liturgji, Antifonet.

Antifoni i parë

Varg a): O Perëndia im, vë re tek unë; pse më braktise?
Me ndërmjetimet e Hyjlindëse.

Varg b): Larg nga shpëtimi im *janë* fjalët e rënieve të mia.
Me ndërmjetimet.

Varg c): O Perëndia im, do të thërres ditën dhe nuk do të dëgjosh.
Me ndërmjetimet.

Varg d): Dhe ti në Shenjtërore banon, lavdërimi i Izraelit.
Me ndërmjetimet.

Lavdi *dhe* Tani

Me ndërmjetimet.

Antifoni i dytë

Varg a): Pse, o Perëndi, zmbrapse deri në fund?
Shpëtona, o i Bir i Perëndisë, që në mish u kryqëzove, ne që të psalim. Aliluia.

Varg b): Kujto sinagogën tënde, të cilën e fitove që nga fillimi.
Shpëtona.

Varg c): Ky mal Sion, tek i cili fushove.
Shpëtona.

Varg d): Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.
Shpëtona.

Lavdi *dhe* Tani

O i vetëmlindur Bir.

Antifoni i tretë

Varg a): Zoti mbretëroi, le të zemërohen popuj.
O Zot, shpëto popullin tënd.

Varg b): Zoti në Sion është i madh dhe i lartë.
O Zot, shpëto.

Varg c): Le ta lavdërojnë emrin tënd të madh.
O Zot, shpëto.

Hyrtore

Lartësoni Zotin Perëndinë tonë dhe faljuni nënkëmbëses së këmbëve të tij, se është i shenjtë. Shpëtona.

Pastaj Përlëshorja: O Zot, shpëto popullin tënd. *Dhe Kontaqi:* Ti që u ngrite.

Në vend të Trishenjtit: Kryqit tënd i falemi, o Zot, dhe ngjalljen tënde të shenjtë e lavdërojmë.

Në vend të Të meriton: O Hyjlindëse, Parajsë.

Kungatore: U shënua mbi ne drita e fytyrës sate, o Zot.

Në vend të Pamë dritën: O Zot, shpëto popullin tënd.

Në Mbrëmësoren e sotme, në vend të Proqimenit të ditës, psalet gjithmonë Proqimeni: Perëndia yn' në qiell edhe në dhé, të gjitha sa deshi i bëri, *së bashku me vargjet e tij.*

Në këtë të kremte shumë të respektuar, që është e barasvlefshme me të Premten

e Madhe dhe të Shenjtë, mbajmë kreshmë, por nëse do të bjerë të shtunën ose të dielën konsumohet verë dhe vaj.

Të shtunën, pas Lartësimit.

Në Mëngjesore, Më të nderuarën. Lavdërimet: Pasvargjet e Mbrëmësores së Vogël. Lavdi dhe Tani i tyre.

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes. Pas Hyrjes: Ejani t'i falemi…, që u kryqëzove. Apostulli dhe Ungjilli i së Shtunës pas Lartësimit.

Të dielën pas Lartësimit:

Të shtunën në Mbrëmësore: Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të së kremtes. Lavdi i së kremtes (Paskremtore). Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore, Lavdi dhe Tani i së kremtes (Paskremtore). Përlëshorja ngjallësore dhe e së kremtes një herë.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, Pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Himne Triadike, Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Përlëshorja ngjallësore dy herë dhe e së kremtes një herë. Ndenjësoret ngjallësore dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Bekimtoret etj. Kanunet: ngjallësor dhe i së kremtes. Pas Odes III, Ndenjësorja e shenjtit që do të bjerë dhe e së kremtes (Paskremtore). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Një kryq vijosi; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe të së kremtes (Paskremtore). Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes (Paskremtore). Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket dhe Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes dhe e kishës. Kontaqi Ti që u ngrite. Apostulli dhe Ungjilli pas Lartësimit. Të meriton. Kungatore Lavdëroni. Pamë dritën.

CITIME

[1] Ps. 131(132).7

[1a] Sirak 6.14

[2] Ps. 98(99).5

[3] Jov 18.12; 20.5

[4] Ps. 56(57).1

[5] Ps. 4.7

[6] Ps. 74(75).10; 88(89).17,24; 91(92).10; 111(112).9; 148.14

[7] Ps. 73(74).12

[8] Gjen. 48.13-14

[9] Eks. 17.12-13

[10] Rom. 8.22

[11] Ps. 103(104).24

[11a] Ps. 109(110).2

[11b] Ps. 2.9

[12] Ps. 27(28).9

[13] Ps. 49(50).23; 90(91).16

[13a] Eks. 14.22-29

[13b] Num. 17.16-28

[14] Eks. 17.6

[15] Is. 6.1

[15a] Abak. 3.1-2

[16] Eks. 15.23; Num. 33.8,9

[17] IV [II] Mbret. 6.5

[18] Num. kap. 2

[19] Ps. 18(19).1

[19a] Gjen. kap. 3

[19b] Lluk. 24.36; Joan 14.27; 20.19,21,26; Ef. 2.17

[20] Gjen. 3.24

[21] II Kor. 12.2;

[21a] Ps. 149.6

[22] Rom. 5.12

[23] Gjen. 47.31

[24] Ps. 97(98).2-3

[25] Ps. 95(96).12

[26] Ps. 74(75).10

[27] Gjen. kap. 3

[28] Num. 13.24

[29] I Kor. 15.54

[30] Gjen. 28.12

[31] Gjen. 3.15

[32] Is. 2.2-3

[33] Ps. 85(86).9

[34] Gjen. 2.9

[35] Ligji i Dytë 28.66

MË 17 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i martireve të shenjta Pistit (Besës), Agapit (Dashurisë) dhe Elpisës (Shpresës), dhe të nënës së tyre Sofisë (Urtësisë).

Tipikon

Nëse bie e diel (Pas Lartësimit), të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 Vargëzime ngjallësore, 3 të së kremtes (Paskremtore) dhe 3 të shenjtoreve. Lavdi i së kremtes (Paskremtore). Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. Proqimeni. Leximet e shenjtoreve. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtoreve. Tani i së kremtes (Paskremtore). Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtoreve dhe e së kremtes.

Të dielën në Mëngjesore, Ndenjësoret: ngjallësore dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes. Pas Polieleit, Bekimtoret, Ndenjësoret e shenjtoreve (që janë pas Polieleit), Shkallesat etj. Kanunet: ngjallësor, i së kremtes, i shenjtoreve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtoreve. Ndenjësoret: e shenjtoreve dhe e së kremtes (Paskremtore). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Një kryq vijosi; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e shenjtoreve dhe Hyjlindësore. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 3 të së kremtes, 2 të shenjtoreve (me vargjet e Pasvargjeve të shenjtoreve: I çuditshëm; Zoti bëri). Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

NË MBRËMËSORE

Vargëzimet e Kryqit
Ting. IV ΄Edhokas simίosin

Sot ndriçoi me shkëlqim, si diell që rrezaton shum' fort,* Kryqi yt i nderuar, Zot,* i cili mbështetet mu* në vend të Kalvarit;* pra ësht' lavdëruar edhe kështu, o Shpëtimtar,* me lartësimin e tij mbi malin tënd* të shenjt',[1] zbulon fuqishëm se na e ke ngritur natyrën ton'* nëpërmjet tij tek qiejtë,* o i mirë dhe fuqiplot'.

Shpallën ndër gjith' njerëzit lavdinë tënde sot qiejtë,* o Zot i pakuptueshëm;* se duke ndriçuar shum'* shenja jote, Kryqi,* me shkëlqim të pakapshëm, kritikoi krejt manin'* dhe barbarinë e gjith' hyjvrasësve;* prandaj ekonominë tënde njeridashëse e lëvdojm',* o i Tërëfuqishëm Krisht,* Shpëtimtar i besnikëve.

Kryqi i tër'shenjt', trofe i pakuptueshëm, na u shfaq* neve nga dheu ku kish' qen';* dhe del para si thesar;* më par' ishte fshehur* dhe që pa-

suron me rrezet e mirësis' së tij* mbar'botërore, të gjith' Krijesën sot;* prandaj ekonominë tënde njeridashëse e lëvdojm',* o i Tërëfuqishëm Krisht,* Shpëtimtar i besnikëve.

E shenjtoreve
I njëjtë: Os jeneon en mártisin

E paprekur ke mbetur ti* pas mundimit me zjarr të madh,* me fuqi zot'rore, atlete Pisti pra;* dhe e qortove mashtrimin e arkondit, të çmendurit,* me këshillën e nënës* dhe pësove si burr' i fort'* prerje gjinjsh tmerr'sisht;* edhe Zoti në qiell kokën tënde që u pre, kurorëzon me kurorë lavdi,[2] o Bes' e shenjt'.

Fshikullime pësove ti* dhe u fute në furr' me zjarr,* por asgjë s'pësove, Elpisa, plot me hir;* në një kazan fort të nxeht' u hodhe, në dru të varën ty;* trupi yt që vuajti,* shum' u ça me thonj hekuri,* Shpresë me durim;* dhe me shpat' u pre koka jote, pra në dhomë qiellore shkove, si fitimtare me shum' lavdi.

Të pabesët u shtangën krejt* nga fjalimi yt shum' i urt',* sepse kritikove besimin e tyre;* varesh në dru dhe goditesh ti me rripa prej lëkure* dhe në flakë, në një furr',* o e famshme, po hidhesh si* ar i çmueshëm;* dhe me një hell u shpua trupi yt dhe t'u pre koka, o Agapi, o Dashuri e shum'vuajtur.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Vezulloi sot kujtimi i respektuar i virgjëreshave tepër të urta, duke ngazëlluar besnikët dhe duke grumbulluar për panair tërësitë e orthodhoksëve. Ejani pra, ju kremtues, le të himnojmë me lavdërime këngësh athloforet e Krishtit duke thënë: Gëzohu, o Pisti, fitimtare e madhe, që durove burrërisht heqjen e gjymtyrëve dhe prerjen e gjinjve, dhe që rrëzove arrogancën e tiranit. Gëzohu, o Elpisa e shumëkënduar, që u arratise nga përkëdheljet helmuese të besëkeqit dhe solle veten tënde si flijim të pranueshëm nga Perëndia. Gëzohu, o Agapi famëmadhe, që i çudite me gjuhë të pabesët dhe që e dhe veten tënde në tortura të dhimbshme për dashurinë e Çlirimtarit tënd. Gëzohu ti, o trini e motrave, luftëtare të Trinisë së përmbindritshme dhe predikuese të flakta të dogmave orthodhokse; lutemi, mos pushoni së ndërmjetuari për ne, së bashku me Sofinë, nënën hyjmendëse, që të shpëtohen nga rreziqe, ata që me besë kremtojnë gjithnjë kujtimin tuaj të respektueshëm përherë.

Tani *I së kremtes I njëjti*

Zërat e profetëve pararrëfyen drurin e shenjtë, me të cilin Adami u çlirua nga mallkimi i lashtë i vdekjes, ndërsa sot Krijesa, duke u lartësuar ky, ngre

bashkë me ta zërin duke kërkuar mëshirën e pasur nga Perëndia. Por, o Zot, i vetmi i pamasë në mëshirë, bëhu i butë me ne dhe shpëto shpirtrat tanë.

Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës dhe Leximet.*

Këndimi i profecisë së Isaisë
(43.9-14)

Këto thotë Zoti: Gjithë kombet u mblodhën së bashku dhe do të mblidhen arkondë nga ato. Kush do t'i njoftojë këto? Ose *gjërat* që nga fillimi kush do t'ju njoftojë? Le t'i sjellin dëshmitarët e tyre, dhe le të drejtohen, dhe le të dëgjojnë, dhe le të thonë të vërteta. Bëhuni dëshmitarët e mi dhe unë dëshmitar, thotë Zoti Perëndia, dhe fëmija im që zgjodha; që të njihni dhe të besoni, dhe të kuptoni se unë jam. Përpara meje nuk u bë Perëndi tjetër dhe pas meje nuk do të jetë. Unë Perëndia dhe veç meje nuk është ndonjë që shpëton. Unë lajmërova dhe shpëtova, talla dhe nuk ishte në mes jush i huaj. Ju, dëshmitarë për mua dhe unë, Zoti Perëndia, ende nga fillimi dhe nuk ka njeri që të shpëtojë nga duart e mia. Do të bëj, dhe kush do ta kthejë mbrapsht këtë? Kështu thotë Zoti, Perëndia, që ju çliron, i Shenjti i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve *janë* në dorë Perëndie dhe nuk do t'i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre dhe ecja nga ne dërrmim, por ata janë në paqe; sepse edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre *është* plot pavdekësi; dhe pasi do të edukohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojë në ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të do të kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë me durim pranë tij, sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë dhe në Zotin *është* paga e tyre, dhe përkujdesja e tyre pranë të Shumëlartit. Për

këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë dhe kurorën e bukurisë nga dorë Zoti, sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do të marrë si armatim zellin e tij dhe do të mobilizojë me armë Krijesën për mbrojtje armiqsh. Do të veshë *si* korracë drejtësi, dhe do të veshë si helmetë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë *si* mburojë të pamposhtur oshënarí dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me atë bota kundër të marrëve. Do të ecin suksesshëm tek qëllimi predha rrufesh, dhe si nga një hark i plotë rrethi nga retë do të hidhen në shenjë dhe nga zemërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohet kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të përmbytin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë, dhe do të shkretojë gjithë dheun paligësi dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur, mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinasti nga i Shumëlarti.

Në Liti
Ting. I

Duke përbuzur shijimin e dëfrimit tokësor, duke urryer pasurinë dhe lavdinë, dëshiruat dhëndrin qiellor, o Besë, Shpresë dhe Dashuri, degë shumë të hyjshme të Sofisë së thjeshtë; sepse pasi u sollët para tiranit të pabesë dhe pasi hodhët poshtë dobësinë e natyrës, kritikuat burrërisht mashtrimin e tij duke përbuzur idhujt e tij, sepse ishin të privuar nga dëgjimi dhe s'kishin fjalë;[3] dhe meqë shpallët me guxim Krishtin, u dorëzuat në tortura të dhimbshme pa mëshirë dhe kur u prenë kokat tuaja, hytë së bashku me virgjëreshat e urta në nusëroren[4] qiellore të Krishtit duke vallëzuar tok me engjëj; dhe duke shëruar sëmundjet e besnikëve me energjinë e Shpirtit të Shenjtë, ndërmjetoni pa pushuar për shpirtrat tanë.

I njëjti

Emri yt është zbukuruar qartë sipas sjelljes sate, o hyjmendëse, sepse e kalove të gjithë jetën tënde me dashuri për urtësi,[5] o Sofi e lavdëruar, dhe u ndriçove me hire të hyjshme; prandaj edhe duke qëndruar te varri i treshes shumë të dashur për tri ditë, si dëshirove shumë, shpirtin e dorëzove tek Zoti dhe hyre së bashku me to në dhoma qiellore; pra duke pasur guxim para Perëndisë, lutu vazhdimisht për shpirtrat tanë.

Ting. II

Virgjëreshat e barabarta nga numri me Triadhën e respektuar, Pisti, Agapi dhe Elpisa, meqë digjeshin nga zelli i hyjshëm, kur mundoheshin në stadium, thoshin: Këto tortura janë të vështira, o gjykatës, por nuk i preferojmë aspak të dheshmet përpara qielloreve;[6] prandaj godite trupin, çirri mishrat tona dhe na dorëzo në zjarr; duke u ngazëlluar, ne po ikim për Krishtin dhëndër.[7] Lutjuni atij, ju përgjërohemi, o të tërëlavdëruara, të na dërgojë nga lart përdëllimin e madh.

Ting. III

Meqenëse u ndriçuat në shpirt me dritë shpresëtarie, në natyrën tuaj femërore dhe në moshë të vogël, turpëruat Goliathin[7a] mendor, i cili e kishte stërnënën si vegël për mëkat;[8] sepse pa ndryshuar dhe pa u trazuar Fjala e Atit, duke u mishëruar nga e Virgjëra, siç di vetëm ai, Krishti, Zoti i të gjithave, zgjidhi mallkimin e Adamit dhe Evës;[9] ky kurorëzoi denjësisht me kurorë të paprishur[2] virgjëreshat e barabarta nga numri me Trininë, Besën, Shpresën dhe Dashurinë, bijat e shkëlqyeshme të Sofisë, dhe nëpërmjet tyre i dhuron botës faljen dhe përdëllimin e madh.

Ting. IV

Të ndriçuara me bukuri virgjërie dhe të stolisura me kurorë martirësh, morën prej Krishtit denjësisht kurorë të dyfishtë bukurmundëse, Pisti, Agapi dhe Elpisa, bimë frytdhënëse të Sofisë modeste. Me ndërmjetimet e tyre, o Krisht Perëndi, dhuroji paqe botës dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Ejani që të madhështojmë me psalme, himne dhe ode shpirtërore[10] kujtimin e tërëlavdëruar të athloforeve të Krishtit, Besës, Shpresës dhe Dashurisë; sepse ato duke mos menduar aspak për natyrën e tyre femërore, qëndruan me guxim në podiumin e tiranit dhe duke marrë përsipër armatimin e Kryqit, u rreshtuan kundër të pabesit[11] dhe u ofruan si therore vullnetare te Perëndia, si atlete trimëresha për hir të besimit. Prandaj, dhe kur ua prisnin kokat, thërrisnin: Le të bëhet, o Zot, therorja e shpirtrave tanë e mirëpritur para teje, sepse, meqë të dëshiruam, e përbuzëm jetën e përkohshme. Me ndërmjetimet e tyre, o Krisht i tërëmirë, Perëndia ynë, dhuroji fitore mbretit shpresëtar kundër armiqve dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.

Tani *I së kremtes*

Ejani, o popuj, duke parë mrekullinë paradoksale, t'i falemi fuqisë së Kryqit; se një dru në Parajsë nxori si lastar vdekjen, ndërsa ky lulëzoi jetën, duke pasur Zotin e pamëkatshëm të gozhduar; nga ai ne, gjithë kombet, vjelim paprishje dhe i thërrasim: Lavdi ty, që nëpëmjet Kryqit shfarose vdekjen dhe na çlirove.

Pasvargje
Ting. IV O eks ipsistu

Trini virtytesh, ju vajza shum' të famshme,* zbukurimi keni qen' i virgjëreshave,* i athloforeve, me shndritjen* dhe me shkëlqimin* e urtësisë, o bija të Sofis';* luftëtare të Trinis' në mosh' të njom', të brisht',* e turpëruat krejt shkelësin* dhe e përbuzët* mashtrimin e tij me një guxim të madh;* pra u dor'zuat* në tortura të dhimbshme, ju që të tria, modeste pra,* edhe kur ua pren' kokat,* i fituat tri kurora[2] lart.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

E dëshiruat nga thellësi e zemrës* Krishtin; u plagosët ju me dashurinë e tij,* përbuzët, Shpresa dhe Besa, dhe* ti Dashuri bashk',* martire të famshme, gjërat k'tu në tok',* se jan' të përkohëshme edhe ato prishen leht',* edhe i kishit zili të fort* pes' virgjëreshat,* të urta[4] jeni pra bashkë me ato* dhe tok me engjëj* vallëzoni të zbukuruara; lutjuni Krishtit ton',* Zotit, që të shpëtohen shpirtrat tanë prej atij me hir.

Varg: Tek shenjtorët që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

Duke u veshur me armatim nga Krishti,*[11] Pisti dhe Elpisa, Agapi me emra pra* virtytesh, në stadium, sikur* një tjetër, jo ju,* po torturohej, thërrisnit: Asnjë shpat',* as shumicë zjarri, as prerje gjymtyrësh prap'* nga dashuria hyjnore ne* nuk na ndan kurrë.*[12] O bes' martiresh, o bukurmundëse!* Pra, dhe kurora* që nuk prishen fituan prej teje, o Perëndia yn',*[2] që dhuron te besnikët* përdëllimin e madh dhe shpëtim.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Le të bëjmë, sot, o besnikë, panair fort të shenjtë në kujtimin e përvitshëm të athloforeve të Krishtit, Shpresa, Besa dhe Dashuria, filiza të Sofisë; se duke stolisur veten e tyre me ngjyrë gjaku, të tri motrat, të quajtura me emra virtytesh, u bashkuan në mënyrë të paprishshme me Krishtin, përmes bukurisë së plotë. Tek ai ndërmjetojnë pa pushim për ne që kremtojmë me besë dhe mallëngjim kujtimin e tyre.

Tani *I njëjti* *I së kremtes*

Sot katër skajet e botës shenjtërohen, meqenëse lartësohet Kryqi yt që ka katër krahë, o Krisht Perëndia ynë, dhe bashkëlartësohet briri i mbretërve tanë besnikë, të cilët me këtë dërrmojnë brirët e keqdashësve;[13] i madh je, o Zot, dhe i çuditshëm në veprat e tua! Lavdi më ty.

Përlëshore
Ting. I

Le të himnojmë me himne të hyjshme të tria virgjëreshat, filizat e Sofisë, Besën, Shpresën dhe Dashurinë, sepse të forcuara me fuqinë e Kryqit, duruan tortura të dhimbshme dhe kur ua prenë kokat, u kurorëzuan me kurora martirike. Lavdi atij që i fuqizoi ato, lavdi atij që i lavdëroi ato, lavdi atij që punon përmes atyre shërime për të gjithë.

Lavdi *dhe* Tani *I së kremtes*

O Zot, shpëto popullin tënd.[14]

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. I *Ton tafon su Sotír*

O vajza, lavdërim* virgjëreshash modeste,* me Krishtin u bashkuat, me dhëndrin[7] e bukur,* meqen'se zbukuruat veten ju me shum' tortura pra;* ndaj himnoni sot* Trinin', që s'ka nisje fare,* tri lambadhe ju,* Pisti, Elpisa, Agapi,* dhe mburrja e shën Sofis'.

Lavdi *dhe* Tani *I së kremtes*

I shtrive duart ti* përmbi kryq, o i dhembshur;* ke mbledhur kombet që ishin larg teje, o Krisht;* i mblodhe që të lavdërojn' mirësin' tënde të madhe,* por shiko nga lart* mbi trashëgimin tënd, o Zot,* dhe rrëzo përdhé* armiqtë tanë me Kryqin* e çmuar dhe shum' të fort.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV *O ipsothís en to stavró*

Sa herë bëjmë ne kujtimin e shenjtë* të athloforeve të Krishtit, bëjm' mbledhje* dhe tek ato drejtojm' kërkesa, lutje me shpirt:* Lutuni tek Perëndia yn'* të shpëtojm' nga Gehena;* kemi mëkatuar rënd',* jemi mbushur me faje,* o Bes' dhe Shpresë, edhe Dashuri,* lavd i Sofisë, shkëlqim i martireve.

Lavdi *dhe* Tani *I Kryqit*

Më ke ringritur mua që në Parajsë* kisha rën' frikshëm, se dëgjova këshillën* e hidhur që më kish dhën' njerivrasësi[14a], pra* më ke ngritur në Kalvar,*

e shërove me drurin* k'të mallkim të drurit,[9] dhe e ke vrar' zvarranikun,* dhe më dhurove jetë, shenjtërim;* lavdi, o Krisht, kryqëzimit tënd shpëtimtar.

Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. IV Epefanis símeron

Bija të Sofis', Pisti,* Elpis', Agapi,* emrat e virtyteve* të ndritshme kishit ju, vërtet;* duke qen' pran' fronit zotëror,* lutuni shumë* për ne, o martire pra.

Lavdi *dhe* Tani *I Kryqit*

Kryqi yt, o Zoti Krisht,* shkëlqen si dritë;* errësirën e dëbon* dhe batalionet e saj krejt;* dëfren besnikët që psalin bashk':* Kryqi yt është* pra mburrja[15] e botës son'.

Shkallesat, Antifoni i parë i tingullit IV
Proqimeni
Ting. IV

I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

Varg: Në kisha e bekoni Perëndinë.

Ungjilli: Tha Zoti këtë paravoli: Mbretëri e qiejve i ngjau. *Kërkoje të shtunën e Javës së 17 të Mattheut.*

Psalmi 50. Lavdi. Me ndërmjetimet e athloforeve.
Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërthor II

Sot, ne turmat e besnikëve të mbledhur, le të bëjmë panair shpirtëror, sepse arriti kujtimi i përvitshëm i athloforeve të Krishtit, Besës, Shpresës dhe Dashurisë, duke na sjellë dhunti që na pasurojnë; prandaj me zë ngazëllimi dhe ndërgjegje të pastër, le të thërrasim duke thënë: Mos pushoni së ndërmjetuari vazhdimisht për ne, që me besë bëjmë kujtimin tuaj, gjithmonë të respektuar.

Kanunet: i së kremtes dhe
i shenjtoreve

Kanuni i shenjtoreve, që ka Akrostihidhë: "Unë psal këndshëm bijat e dalluara dhe të lavdëruara të Sofisë. I Theofanit".

Ode I
Ting. I Su i tropeuhos

Më dhuro ndriçimin e urtis'* që ke dhe ësht' mbi k'të botë, të pashprehshme,* Krisht, për të himnuar bijat e Sofis',* lastarët e shkëlqyeshëm* dhe të hirshëm, o Zot, martiret e lavdëruara.

O hyjmendëse, është e qart',* se jeta jote stolisi dhe emrin tënd,* se e ke kaluar gjithë jetën ti* me dashuri për urtësin';*[5] pra me hiret e urtësis' ndriçove, Sofi e shenjt'.

Fryti yt i shumëlumur krejt* po zbukurohet trefish përmes urtësis'* së tërëhyjnueshme, shkëlqeu plot* për hir të saj porsi në gar',* o Sofi, që emri yt do të thotë urti vërtet.

Pasi u pastruan si në trup* edhe në shpirt me virtytin të virgjërat,* të tria u sollën me martirizim* tek dhëndri krejt mendor,[7] që ësht'* Krishti, Dashuria dhe Shpresa, edhe me Besën bashk'.

Hyjlindësore

Mori pamjen time krejt ai* që më par' përfytyrohej veç në një form',* pra hyjnore, kur u fut në barkun tënd,* e përtëriti pamjen ton',* o e tër'kulluar; pra çdo besnik të lëvdon gjithmon'.

Zbritësore: Stavrón haraksas

Një kryq vijosi me shkop

Ode III
O monos idhós tis ton vrotón

Meqen'se dëgjuan zërin tënd,* që ftoje për një jet' të lart'* e pa pasione dhe të amshuar, Krisht,*[16] martiret dhe* virgjëreshat t' erdhën pas* për të thirrur: Ësht' i shenjt'* tempulli i gjall', që ka* lavdin tënd të kulluar, o mëshir'plot'.

Fuqi ju dhuroi Krishti yn',* sipas premtimit që kish dhën',* kur po qëndronit pran' bankës së gjyqit;* ju mbushi ky* me urti dhe frymëzim* hyjnor;[17] ju tregoi qart'* fitimtare me shkëlqim* virgjërie dhe hiri, o vajza ju.

Umposht krejt krenari i vështir'* nga ju, o virgjëresha pra;* e hodhët posht' vetullën e tij të lart'*[18] me shpirt të madh* kur luftuat kundër tij;* dhe me lumë gjakrash krejt* mbytët k'të që mburrej fort,* se do thante çdo det dhe çdo oqean.

Meqen'se e kishin me bollëk* urt'sin' e Krishtit ton' nga lart,* të bijat e Sofisë hyjmendëse,* të tria bashk',* arrogancën dhe manin'* e tiranit t' egër shum'* e turp'ruan, ndërsa po* ligjëronin mësimet e hyjshme fort.

Hyjlindësore

O tendë e shenjt' plot shenjtërim,* e linde shenjtërisht, o Zonj,* atë që është shenjti i shenjtëve,* pra Krishtin, që* në të shenjtat prehet[19] krejt.* I thërrasim: Ësht' i shenjt'* tempulli i gjall', që ka* lavdin tënd të kulluar, o mëshir'plot'.

Zbritësore: Rávdhos is tipon

Shkopi një herë

Ndenjësore e shenjtoreve
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

Shpirtin lidhët, sepse donit Krishtin shum';* flakët tej dhe harruat çdo bukuri* të gjërave që kalojn';* kishit vrar' çdo pasion më par'* me asketizëm, edhe pastaj ju luftuat fort,* u torturuat frikshëm, atlete dhe nxënëse* zotërore; Fjala ju dhuroi pra juve,* për dy ndeshjet tuaja,* nusërore[4] bashk' me kuror';* o martire* të lumura,* ndërmjetoni pran' Perëndis',* Jisuit Krisht, të na falë* mëkatet pra,* se kremtojmë kujtimin tuaj sot me dëshir'.

Lavdi *dhe* Tani *I së kremtes*
To prostahthén

Brenda Parajsës më par' druri më zhveshi,* armiku sjell pra* me shijimin e tij vdekje,* por u ngul mbi dhé druri,* Kryqi që na solli* këmishën e jetës edhe bota e tër'* u mbush me gëzim, hare, gaz* dhe me dëfrim;* kur e shohim të lartësohet, popuj, le t'i thërrasim Perëndis' me besë bashk':* Streha jote ësht' plot lavdi.[20]

Ode IV
Oros se ti háriti

Pasi u fuqizuan prej Hirit të hyjshëm, Besa, Dashuria dhe Shpresa bukurmundëse, turpëruan burrërisht kërcënimet e tiranëve, duke u djegur tërësisht me zjarr dhe duke iu blatuar dhëndrit Krisht.[7]

Pasi u forcuan me armatimin e Kryqit,[11] Pisti, Agapi dhe Elpisa, mundën të durojnë me fuqi plagët e dënimeve, duke rezistuar me forcë kundër mëkatit deri në gjak.

Me fuqi dhe mallëngjim për Triadhën, u forcuan Besa, Dashuria dhe Shpresa, virgjëreshat e barabarta në numër me Trininë e respektuar, dhe mundën të durojnë trysninë e vrullshme të dhimbjeve, vajzat shumë të thjeshta.

Edhe vajza të brishta e turpëruan me armën e Kryqit vetullën krenare[18] e të fëlliqur, dhe e rrëzuan përdhé triumfalisht atë që më parë mburrej pa masë, se do të pushtonte botën e tërë.[21]

Pisti, Agapi dhe Elpisa, tri llambadhet e shkëlqyera të urtësisë, duke u ndriçuar dukshëm nga ndriçimet e Trinisë, ndriçojnë me mbushulli Kishat për shpëtimin dhe përkrahje tonë.

Hyjlindësore

O e shenjta e të shenjtëve, Hyjlindëse e tërëhimnuar, pritja e kombeve dhe shpëtimi i besnikëve, prej teje lindi si diell çlirimtari, jetëdhënësi dhe Zoti, që të shpëtojmë ne që të himnojnë.

Zbritësore: Isakíkoa Kírie tis ikonomias su

Kam dëgjuar

Ode V
O fotisas ti elampsi

Me qëndresën e mendjes duruan torturat dhe duke folur mistere të urtësisë hyjnore, e turpëruan sundimtarin, të tri virgjëreshat hyjmbajtëse, duke qenë të lidhura midis tyre sipas besës dhe natyrës.

Ngazëllohet stërnëna duke parë tinëzarin, që e syrgjynosi nga Edemi, të mposhtet prej Elpisës, Pistit dhe Agapit, të bijat e Sofisë.

U arratisën nga përkëdheljet helmuese të tiranit dhe duruan vullnetarisht plagë torturash vashat modeste, sepse ishin të plagosura prej dëshirës dhe dashurisë sate[22] të hyjshme, o Krisht.

Hyjlindësore

Ngazëllohen Fuqitë qiellore kur të shohin, dëfrehen tok me to rendet e njerëzve, sepse me fëmijën tënd u bashkuan,[23] o Virgjëreshë Perëndilindëse; atë e lavdërojmë siç i ka hije.

Zbritësore: O trismakáriston ksilon

O dru i lumur

Ode VI
Ekíklosen imás

Dor'zuan në pëllëmbën tënde të hyjshme* me plot gaz shpresat e tyre* të tri vashat, o Zot; pra të tria bashk'* ishin* të nderuara, të lumura,* se kishin numrin e Triadhës dhe k'shtu krenoheshin.

Ndriçoheshin me bukurin' e virgjëris',* prandaj dhe u stolisën k'to* me kurorat e martireve; dhe k'shtu* morën* denjësisht kurorën e dyfisht'* nga lart prej Krishtit jetëdhënës edhe të tër'dhembshur.

Në tempullin e mbretit të të gjithave,* që ti je, Zot, u sollën k'to* si thesare virgjërore[24] me respekt,* për të* marrë pjes' në mbretëri me ty,* se ti je edhe dritë për ato edhe ngazëllim.

Hyjlindësore

Gëzohen më ty, Zonjën e panjollëshme,* stëretërit e njerëzve,* se Edenin kanë marrë prap' me ty,* që e* kishin humbur pas paligjësis';* se ti dhe para lindjes edhe pas lindjes je e d'lir'.

Zbritësore: Notiu thirós en splahnis

Në barkun e bishës

Kontaqi
Ting. I
Horós agjelikós (= Ton tafon su Sotír)

Si deg' të shenjta krejt* të Sofisë së thjeshtë* u dukën Besa, Shpresa si dhe Dashuria.* Me hir të madh hutuan k'to* urtësinë[25] e grekëve.* U dëftuan pra* atlete ngadhënjimtare* dhe e morën k'shtu* prej Zotit të Gjithësisë*[26] kurorën e paprishjes.[2]

Shtëpia

Kur anembanë doli dekreti i paligjshëm për t'iu flijuar idhujve, për të bërë libacione dhe për të hijesuar altare dhe tempuj demonësh për humbjen e njerëzve, atëherë të tërëfamshmet dhe virgjëreshat e hirshme, si yje ndriçuan duke larguar errësirën e ateizmit dhe injorancën; dhe duke ndezur shkëlqim shpresëtarie në zemrat e besnikëve, thërrisnin fuqishëm: Perëndi më i madh është ai që u kryqëzua vullnetarisht dhe u ngjall pas tri ditësh, me të cilin edhe ne krenohemi. Prandaj dhe denjësisht e morën prej Zotit të Gjithësisë kurorën e paprishjes.[2]

Sinaksari

Më 17 të të njëjtit muaj, kujtimi i martireve të shenjta dhe bukurmundëse Besës, Shpresës dhe Dashurisë dhe i nënës së tyre, Sofisë.

Vargje: Për besën tek ti, o Trini, Besa, Shpresa, Dashuria,/ të tria ulën qafën tek shpata.
Në të 17-n prenë Dashurinë, Shpresën, Besën.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së shenjtë Agathoklisë.
Vargje: Agathoklia ka zjarr mbi qafë, duke djegur/ qafën e keqe të mashtrimit të keq.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Maksimit, Theodhotit dhe Asklipiodhotës.
Vargje: I njëjtë ishte zjarri i zemrave/ për prerje, tek një grua dhe dy të rinj.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i shën Luçias dhe i Jeminianit, birit të saj martir.
Vargje: Shërbëtorja jote Luçia, o Krisht,/ shkoi me paqe në vend të paqtë.
I mbushur me guxim Jeminiani,/ me durim pësoi prerjen me shpatë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së shenjtë Theodhotës.
Vargje: Hiri i hyjdhënë e bën Theodhotën/ të gatshme për shpatën e mprehur.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i njëqind martirëve të shenjtë.
Vargje: Njëqind martirët egjiptianë,/ që kishin të njëjtën gatishmëri, ua prenë kokat.

Për nder të shenjtorëve Pileu dhe Nili episkopë:

Vargje: Pileu i eposit, si mund të jetë i madh krahasuar me Pileun,/ i cili hyri bashkë me Nilin në mes të zjarrit?

Për nder të 50 martirëve në Palestinë:
Vargje: Burrat hyjmendës, për hir të mendjes së mirë,/ përbuzën zjarrin falë guximit të mirë.

Për nder të shenjtorëve Patermuthit dhe Ilias:
Vargje: Patermuthi, duke rënë në furrë,/ e nxit Ilian për zell të barabartë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë, Harallambit, Pantoleonit dhe i shoqërisë së tyre. Mbledhja e tyre bëhet në martiriumin e tyre që është në të Dytën.
Vargje: Ishte i gëzuar për therjen, Harallambi;/ dhe Pantoleoni ishte luan para thikës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i hieromartirëve të shenjtë, Iraklidhit dhe Mironit, episkopë të Tamasit në Qipro.
Vargje: Kur i hodhën në zjarr Iraklidhin dhe Mironin,/ u ofruan tek Krishti si erë miroje.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Krisht Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Se noitín Theotoqe

Virgjëreshat e shkëlqyera dukshëm nga një hir unik, shumë i shkëlqyer, zgjidhën stuhinë e errët demoniake, duke theologuar për dritën trihipostate dhe duke kënduar: Perëndi i himnuar nga etërit dhe i përmbilavdëruar.

Duke pasur tani në qiejt dhomat nusërore, duke mbajtur llambadhe,[4] kërceni së bashku me engjëjt rreth Krishtit me gëzim, duke soditur së bashku lavdinë e përjetshme dhe duke kënduar: Perëndi i himnuar nga etërit dhe i përmbilavdëruar.

Duke treguar rezistencë dhe durim, shkelën zjarrin[27] burrërisht si Djemtë, se duke qenë të barabarta me ta në numër, hyjmbajtëset fituan moral të barasvlefshëm, duke lavdëruar gjithnjë Perëndinë e himnuar të etërve.

Hyjlindësore

Le t'u shpërndash o e dëlirë, faljen e shkeljeve, atyre që të himnojnë besërisht, duke i çliruar nga ngasjet dhe nga çdo shtrëngim, sepse tani të kemi ty strehim, o Hyjnuse, se mbajte në duar Perëndinë e himnuar të etërve.

Zbritësore: Éknoon próstagma

Urdhër të çmendur

Ode VIII
En kamino pedhes

Virgjëreshat e perëndishkëlqyeshme,

Pisti, Elpisa, Agapi, nga bukuria e shpresëtarisë shkëlqenin më pastër se ari, duke thënë: E bekoni gjithë ju veprat e Zotit; Zotin himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

O besnikë, virgjëreshat që janë bërë dukshëm të shkëlqyera dhe në formë drite nëpërmjet martirizimit, le t'i himnojmë duke thënë: E bekoni gjithë ju veprat e Zotit; Zotin himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Kutitë e lipsaneve të athloforeve burojnë gjithnjë rrëke shërimesh me bollëk të pashterur dhe pasurisht tek ata që me besë thërrasin: E bekoni gjithë ju veprat e Zotit; Zotin himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Hyjlindësore

U shfaqe dhé i shenjtë,[28] o e kulluar, duke lindur kallirin jetëprurës, shkaktarin e jetës së përjetshme, Krishtin, tek i cili thërrasim të gjithë: E bekoni gjithë ju veprat e Zotit; Zotin himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Zbritësore: Evlojite pedhes

E bekoni djema

Ode IX
Tipon tis agnís

Duke* qen' të tria plot me drit'* fort të shkëlqyer edhe me vezullim të shenjt',* të tria tani* kanë si emrat e tyre pra* emrat e tre virtyteve që vlejn' shum'.* O vajza, na forconi* të gjith' me besë, shpres' e dashuri.

O ju* virgjëresha plot me hir* dhe athlofore të pamposhtura, lutemi,* kërkoni përher',* që forca nga lart të zbusë krejt* k'të furtun' herezie, që ësht' tani,* edhe që të dhurojë* tek gjithë besimtarët një mendje.

Pasi,* o të tërëurta, ju* kaluat natën e k'saj jete, mbërritët tash* në ditën[29] që s'ka* kurr' perëndim; dhe gëzohuni* si martire dhe mburruni për një hir* të madh, për virgjërinë;* shijoni mbretërinë pa të met'.

Hyjlindësore

Oh, si* lindi virgjëresha Zonj'* atë që është Fjala vërtet me hipostaz',* si dhe reflektim*[30] i hipostazës së Atit lart,* mirëbërësin tonë dhe Zotin pra.* Na mishëroi Krishtin,* që madhështojm' të gjithë denjësisht.

2 Zbritësore: Mistikós i Theotoqe dhe O dhiá vróseos tu ksilu

O Hyjlindëse Parajsë
Mallkim i vjetër

Dërgimësore
O uranón tis astris

Vajzat që kishin zellin* e zjarrtë për

Trinin' e Shenjt',* duke mbetur pran' trinisë* së mirë të virtyteve,* ashtu siç kishin dhe emrat,* nuk i përfillën torturat.

O Virgjëreshë, linde* atë që bëri shekujtë*[31] dhe që e kan' engjëjt Zot, ndaj* lutju që të na shfaqë pra,* ne shërbëtorët e tu, si* pjes'tar' të pjesës së djathtë.[32]

Lavdërime
Ting. I Ton uranion tagmaton

Sofi, gëzohu dhe hidhu, se lulëzove ti* si një lugin' e hyjshme* tre zambak' erëkëndshëm,* Besën, Shpresën bashkë me Dashurinë,* luftëtaret e Shën Trinis',* se ua pren' kokat për të, prandaj ato* na u veshën me kuror' të shenjt'.

(2x)

Nuk kishin frik' nga torturat e Adrianit pra;* lavdin' dhe pasurinë* të kot' e llogaritën,* Pisti dhe Agapi, Elpisa bashk',* vajzat fort bukurmundëse,* që kishin emra virtytesh, kaluan k'to* keqtrajtime me durim të plot'.

Mburoj' të fort' ato kishin besimin, dashurin'* dhe shpresën; pra e morën* urtësinë nga Zoti* edhe k'shtu e mbyllën gojën e rrem' t' Adrianit, të çmendurit,* motrat të tria pas mishit, pra Besa dhe* Dashuria, Shpresa me guxim.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Ejani, o besnikë, që t'i këndojmë me një zë Perëndisë, mirëbërësit të të gjithave, himn falënderues, se edhe pse me natyrë femërore, Besa, Shpresa dhe Dashuria, trinia e martireve bukurmundëse, e mposhtën pushtetin e padukshëm të fuqisë kundërshtare.[33] Me lutjet e tyre, o Krisht, jepi popullit tënd paqen dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.

Tani *I së kremtes*
I njëjti

Sot pema e jetës,[34] duke u ngritur nga barku i tokës, vërteton ngjalljen e Krishtit që u gozhdua në të; dhe duke u lartësuar me duar të hyjshme, shpall lartësimin e tij drejt qiejve, nëpërmjet të cilit, brumosja jonë, që nga rënia përdhé, jeton në qiej. Pra le të thërrasim gëzueshëm: O Zot, që u lartësove në të dhe që na bashkëlartësove ne përmes atij, denjësoi ata që të himnojnë për gëzimin qiellor.

Në Liturgji, Apostulli i së shtunës së Javës së tretë të Kreshmëve të Mëdha (Vëllezër, bini ndër mend dit' e parë...). *Ungjilli i së Premtes së Javës së tretë të Mattheut (*U tha Zoti nxënësve të tij: Kushdo që të më rrëfejë...*).*

Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] II Petr. 1.18

[2] Apok. 2.10; I Kor. 9.25

[3] Ps. 134(135).16-17

[4] Matth. 25.1-10

[5] Urt. Sol. 8.2

[6] Rom. 8.18

[7] Matth. 9.15

[7a] I Mbret. [Sam.] kap. 17

[8] Gjen. 3.1-6

[9] Gjen. 3.16-19

[10] Kol. 3.16

[11] Ef. 6.11,13

[12] Rom. 8.35

[13] Ps. 74(75).10

[14] Ps. 27(28).9

[14a] Joan 8.44

[15] Gal. 6.14

[16] Mark. 8.34-35

[17] Lluk. 21.12-15

[18] Fja. Urt. 24.36 (Masor. 30.13); Is. 10.12

[19] Is. 57.15

[20] Is. 6.1

[21] Is. 10.14

[22] Kënga 2.5

[23] Kol. 1.20

[24] Ps. 44(45).15-16

[25] I Kor. 1.20

[26] I Tim. 6.14-15; Apok. 19.16

[27] Dan. 3.23

[28] Eks. 3.5

[29] Rom. 13.12-13

[30] Hebr. 1.3

[31] Hebr. 1.2

[32] Matth. 25.32-33

[33] Ef. 6.12

[34] Gjen. 2.9

MË 23 TË TË NJËJTIT MUAJ

Zënia e të nderuarit, të lavdëruarit profet, Pararendësit dhe Pagëzorit Joan.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të Pararendësit. Lavdi i Pararendësit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargje ngjallësore. Lavdi i Pararendësit. Tani ngjallësore (Zoti Krisht, bërësi). Përlëshoret: ngjallësore, e Pararendësit dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Të dielën në Mëngjesore, si zakonisht. Kanunet: ngjallësor dhe i Pararendësit. Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Dërgimësoret: ngjallësore, e Pararendësit dhe Hyjlindësorja e tij. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të Pararendësit. Lavdia Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Apostulli i Pararendësit. Ungjilli i së dielës.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime

Ting. IV O eks ipsistu klithís

Bënte shërbim priftëror shën Zaharia;* ishte brenda Tempullit duke ofruar ky* kërkesat që kishte populli* tek Perëndia,* mir'bër'si edhe i tërëdhembshuri.* Pa at'herë engjëll të hyjshëm, i cili tha* me zë të lart': Ki kurajë ti,* se lutja jote,* plak, u dëgjua; mos ji pa bes' tek un',* se do të kesh bir* Pararendësin, më të madh se ata që i lindën grat',* që do vij' para Krishtit,* si profet Ilia me fuqi.

(2x)

Ihuaj dukesh në pamje dhe mënyrë;* dukesh si i huaj në fjalët dhe në mesazh,* e kundërshton Zaharia k'të,* se un' kam ardhur* për të kërkuar shpëtim për popullin,* jo që un' të marr fëmij', siç ti më lajmëron;* të gjej ty kundër kërkesave,* ndaj dhe dyshoj shum',* se ti nuk je i sinqert' me mua sot;* si do dëftehet* kjo që the, se gjymtyrët gruaja i ka të vdekura,* gjithashtu mosha ime* mosbesim të plot' dëshmon qart'sisht.

(2x)

Pse, Zaharia, s'beson fjalët e mia,* duke thën' se ungjillëzimet jan' boshe krejt?* Jam kryeengjëll i Perëndis';* u urdhërova* të them ato që flas para teje tash;* por meqë s'besove, do jesh që tani si shurdh* edhe memec, gjer sa të shikosh* zbatim të shenjtë* të fjalëve që them dhe kur do lindë* Elisabeta* për ty zërin[1] e Fjalës,

profet të madh, Pararendësin,* do forcohet krejt gjuha*[2] të bekojë Perëndinë ton'.

(2x)

Lavdi *Ting. Tërth. II*
I Bizantit

Nga mitër e shterpëzuar lulëzoi sot fryt lutjeje, Joan Pararendësi. Ngazëllohu, o shkretëtirë[3] dhe kërceni, o njerëz; se ja predikuesi i pendimit fillon të mishërohet në bark nënor. Ejani ju, o kremtues, duke u ngazëlluar për zënien e tij të lavdëruar, le të kërcejmë duke thirrur: Ti, që je më i madhi mes të lindurve nga gratë, mos pusho së ndërmjetuari për ne që nderojmë me besë zënien tënde të hyjshme, që të gjejmë falje mëkatesh dhe përdëllimin e madh.

Tani *Hyjlindësore I njëjti*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se Biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit pa mot; gjith' ai lindi prej teje së pastrës, i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra papërzier. Atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Pasvargje
Ting. Tërth. II Olin apothémeni

Kur po shkonte shenjtërisht* një prift profet tek të shenjtat* e të shenjtave, i shenjt',* siç është' shkruar, engjëll i shenjt' i erdhi pran'* dhe i tha qartësisht,* duke iu drejtuar:* U dëgjua lutja jote dhe Elisabeta tash* zgjidhet nga shterp'sia, do lindë pra* për ty, o plak, Joanin bir,* porsi Pararendës edhe kandil*[4] diellor, profet i të Lartit edhe zë[1] i Fjalës Krisht,* i cili do lindë si diell* prej Hyjbijës virgjëresh'.

Varg: Edhe ti, o fëmijë, profet i të Shumëlartit do të quhesh.[5]

Më sqaro me çdo fuqi,* si do ta njoh un' k'të punë?* Përsëri tek engjëlli* tha i tërëlumuri, plaku pa fëmij';* se jam un', siç shikon,* plot me ditë moshe* dhe Elisabeta është shterpë, pra si thua ti* fjal' të mbinatyrshme? Mahnitem fort;* mendoj dhe them se ti nuk je* i sinqert' aspak, o njeriu im;* ik pra, sepse un' po kërkoj shpëtim për popullin tani,* dhe jo të bëhem me një fëmij',* gjë që nuk pranohet leht'.

Varg: Që të adhurojmë atë me oshënari dhe drejtësi.[6]

I patrupi flet kështu:* Ja, kryeengjëll i Zotit* të tërëfuqishëm jam,* Gabriel

e kam emrin un' në q'ell;* pra tani për tani,* ji si shurdh, ki heshtje,* se s'besove fjalët që kam thën', por kur do lindë pra* gruaja trumbetën e Fjalës Krisht,* at'herë do thërrasësh qart',* pasi gjuha jote do jet' e fort'*[2] nga Shpirti i Shenjtë: Profet ti i të Lartit, bir, me hir* do quhesh,[5] të përgatitësh mir'* udhët e tij[1] siç deshi.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Si një engjëll[7] nga dhimbje shterpësore të lindjes dole, o Pagëzor, dhe që kur ishe në shpërgënj, banove në shkretëtirë dhe u tregove vulë e të gjithë profetëve; sepse atë që ata e panë në shumë mënyra dhe e predikuan me enigma, u denjësove ta pagëzosh në Jordan; edhe dëgjove zë atëror nga qielli, që dëshmonte birësinë e tij; edhe pe Shpirtin në formë pëllumbi, i cili fliste mbi të pagëzuarin; por ti, o më i lartë se gjithë profetët, mos resht së ndërmjetuari për ne, që bëjmë besërisht kujtimin tënd.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë, që nxore frytin e jetës; të lypim ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Përlëshore
Ting. IV
Tahí prokatálave

Beronjë që s'lindje dot më par' dëfrehu[8] tani,* se ja, ti ke zën' kandil,[4] dritën e Diellit qart', që do të ndriçojë fort* më vonë tërë botën* e sëmur' nga verb'ria.* O Zahari, kërce dhe thirr me zë dhe krejt dukshëm:* Profet i të Lartit ësht' ai që do lindim ne.

Hyjlindësore

Misteri i fshehur

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Çlirim gjen nga shterp'sia Elisabeta sot,* por Virgjëresha do mbetet e virgjëra përsëri,* kur do jet' me barr' me zë nga Gabrieli pra.* Shën Pararendësi Joan* hidhet lart paraprakisht në bark,* se e njohu si Zot* Perëndinë që mishërohet në mitër vajze për shpëtimin ton'.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore E ngjashme*

G'zohu, mal[9] i tër'shenjt' ku shëtiti Zoti yn';* gëzohu, ferrë e gjallë dhe e

padjegur aspak;*[10] prap' gëzohu, ur' e vetme e gjith' botës son'* drejt Perëndisë, që na sjell* ne të vdekshmit për në jetën pra* që ësht' e përjetshme;* g'zohu vajzë e tër'kulluar, që linde pa burr' ti shpëtimin për ne.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV Tahí prokatálave

Si turtull që do shkretëtirën, Pag'zori ka qen',* pasi predikoi për pendim si dhe e tregoi Krishtin të bër' njeri* mbrojtës për mëkatarët,* për të gjithë, ësht' bërë,* edhe ndihmon përherë ata që dimërohen.* Shpëtoje, o Krisht, me ndërmjetimet e tij botën.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore E ngjashme*

Të vetëm ke lindur Bërësin, Krijuesin pra* të botës; ti vetëm ke stolisur njer'zit me lindjen tënde, o e dëlir';* nga kurthet e beliarit,* që ësht' tin'zar, shpëtomë,* më siguro mbi gurin[11] e vullnetit të Krishtit,* të cilin e trupëzove; lutju atij për ne.

Kanunet: një i Oktoihut dhe i shenjtit
Poezi e Joan Damaskinoit

Ode I
Ting. Tërth. II Os en ipiro

Ç'rrënjos mendimet e shpirtit tim që ësht' shterp,* se jan' të pafrytshme krejt,* o lastar i shterpësis',* dhe me vrull do të lëvdoj* në mitrën nënore ngjizjen tënde të shenjt', o Pag'zor.

Pa Zaharia i shenjtë, i drejt', dikë* kur tek Tempulli u fut,* pra një engjëll qiellor,* që e lajmëroi qart':* O prift, bir do kesh në pleqëri ti, Pararendësin.

Drita, kandili[4] i Diellit të lavdis'* brenda barkut jopjellor* të shkëlqejë po fillon; me të shuhet errësir'* pasionesh dhe zgjidhen prangat e shterp'sis', Pag'zori pra.

Hyjlindësore

Joani pa Perëndinë të mbahej fort* brenda barkut tënd nënor,* o Hyjlindëse e d'lir';* menjëher' u hodh përpjet',* shum' qartë, sepse ai qe Pararendësi i tij.

Zbritësore: Anikso to stoma mu

»Ja gojën e çel tani, i frymëzuar prej »Shpirtit[11a] Shenjt'* dhe këngë do t'i »këndoj nënës së madhe mbi fron;*[11b] »dhe do ta kremtoj* me valle buzëqe»shur,* me zë do t'i shpall kudo gjithë »çudit' e saj.*

Ode III
Uq estin ájios

Beronja fryt të shenjt' sot zë,* që më

pas do kositë* gjithë pafrytshmërin' e shpirtrave të njerëzve.* Me hir të hyjshëm, me kazm'*[12] jolëndore do ta presë ky profet.

Kur Zaharia u bë shurdh* në Tempullin ku lutej,* me një lajm shum' të tmerrshëm, po merr zërin[1] e Fjalës;* pra madhështon me shkëlqim* ky, i madhi, Perëndin' e dhembshur plot.

Me nxitje engjëlli u zu,* me vullnet Perëndie,* pa shpresuar ai pra, Pararendësi i madh,* që na tregoi një udh'* krejt të sigurt[1] për pendim[13] ndër njerëzit.

Hyjlindësore

Fëmija i steriles njeh* Krishtin përbrenda mitrës* virgjërore, kërcen përpjetë. Paralajmëron* gaz që në tokë do vij',* të çlirojë nga zymtia njerëzit.

Zbritësore: Tus sus imnologus

»**O** Zonjë dhe nën' e Perëndisë, burim »i pasosur jetësor,* ti siguroji gjith' »ata që të këndojnë plot me zell;* dhe »lart në q'ell ku mbretëron kurorëzoi »me çdo lavdi.*

Ndenjësore
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Zaharia temjanis* përbrenda Tempullit si prift;* Gabrieli i vjen pran'* nga qielli edhe i thot':* Në pleqërin' tënde fryt të shkëlqyer do kesh;* zgjidhet menjëher' shterpësia sot,* që Elisabeta më par' kishte,* mospasja pra fëmijë; do të zerë,* do lindë k'shtu predikuesin* dhe Pararend'sin.* Me ndërmjetimet* e tyre na shpëto, Zot.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Josifi u çudit,* gjë përmbi natyrën kur pa,* dhe at'herë merrte vesh* këtë shiun përmbi lëmsh*[14] në zënien tënde të pafarshme, o Hyjlindëse;* ferrën që në zjarr ish e padjegëshme,*[10] shkopin e Aaronit, që zu rrënjë e lulëzoj,*[15] i fejuari yt ruajtës dëshmoi* e u thërriste prift'rinjve:* Virgjëresha lind dhe* pas lindjes mbetet* prapë e virgjër.*

Ode IV
Hristós mu dhínamis

Zë engjëlli të paralajmëroi hyjshëm me të vërtetë ty, engjëllin e pranisë së Krishtit,[7] te prifti, se do të lulëzoheshe nga bark shterpë, o Prodhrom i lumur.

Oh, ti që ishe shterpë dhe beronjë që nuk lindje, tani gëzohu,[8] se Pagëzorin dhe Pararendësin e Krishtit jep si fryt të lavdishëm, o Elisabeta e admirueshme.

Me kazmën[12] e lutjes sate, o Pararendës, çrrënjosi gjembat e pasioneve të mia dhe pengesat e mendimeve, edhe bëje të frytshme mendjen time nëpërmjet virtyteve, o i tërëlumur.

Hyjlindësore

Të mbante mitra e Virgjëreshës ty, që i mban të gjitha, kur Pagëzori po mbahej brenda barkut, dhe t'u fal ty, o Krisht, dhe duke kërcyer përpjetë u ngazëllua.

Zbritësore: Tin aneksihníaston

»Të pagjurmësuarin plan perëndor,* »që po mishërohet i larti Zot* prej »Virgjëreshës,* Abakumi si profet e »pa dhe tha me zë të madh:* O Zot i »fuqishëm, lavdi më ty.*

Ode V
To thio fegji su

Kur hynte profeti brenda Hierores dhe i ofronte Bërësit adhurimet sipas Ligjit, iu duk engjëll i shenjtë, duke i lajmëruar ngjizjen e hyjshme të Pararendësit.

I tha Zaharia kryeengjëllit: Si do të bëhet kjo tek unë dukshëm? Se siç e shikon, jam i moshuar dhe e kam shterpë bashkëshorten; po më thua fjalë të kundërta me natyrën.

Shiko Sarën e Abrahamit; shih si ka lindur ajo në pleqëri Isaakun,[16] o njeri, dhe beso të thënat me drejtësi, i drejtohej plakut engjëlli i madh.

Hyjlindësore

Elisabeta thirri qartazi tek ti: E bekuar je ti mes grave, o e hirshme nga Perëndia,[17] sepse të njoha shtatzënë pa burrë ty, të vetmen që mbeti e paprishur pas lindjes.

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

»Të gjith' i habite ti me një çudi dhe »një lavdi,* ti, o Virgjëresh' e pamar»tuar;* Zotin e jetës që mbretëron lart »në q'ell si një bir e mbajte në pëqi,* »dhe shpëtim që lartazi* u dhurove »besnikëve.*

Ode VI
Tu viu tin thálasan

E kam mendjen time plot* me dyshim dhe nuk besoj tek fjalët e tua, i tha* kryeengjëllit prifti, se un' kërkoj shpëtimin e popullit* edhe jo fryt nga mesi im, fëmijë pra.

I kundërshton engjëlli* shërbëtor, se Bërësi i gjith' Krijesës, mbreti Zot* i gjith' engjëjve, deshi me mirësi të kesh bir, pra engjëllin* e pranis' së tij;[7] mos ji i pabes' tek un'.

Po, fjalët e tua jan'* të çuditshme si dhe pamja jote ësht' e frikshme shum',* dhe fytyra të ndrin ty si zjarr,[18] tha Zaharia tek engjëlli,* mir'po flet fjal' të mbinatyr'shme, s'të besoj.

Hyjlindësore

Kandili,[4] megjith'se ish* brenda tendës në err'sir', në mitër, njohu Diellin* që at'herë po fshihej në re[19] nënore, përbrenda barkut pra,* dhe kërceu përpjet', iu fal me plot hare.

Zbritësore: Tin thian taftin

»Këtë të kremte e lusim sot, për »Zonjën edhe nënën Hyjlindëse, gjithë »hyjmendësit,* eni trokisni pra duar-»të*[19a] dhe lavdëroni Zotin që lindi prej »asaj.*

Kontaqi

Ting.I Horós angjelikós (=Ton tafon su)

Dëfrehet me shkëlqim* Zaharia i madh tok* me bashkëshorten, Elisabetën me famë,* se zë kjo denjësisht Joanin, Prodhromin, Pag'zorin pra,* që një engjëll qart'* ungjillëzoi me plot gaz,* dhe ne njerëzit detyrimisht e nderojmë* si njohës të Hirit t' shenjt'.

Shtëpia

Le të hapim Ungjillin e Shenjtë, të cilin na e ka shkruar Llukai i hyjshëm dhe i mrekullueshëm dhe le të shikojmë ngjizjen e gëzueshme dhe të shquar të Pararendësit, sepse thotë se, sapo hyri Zaharia plak dhe i drejtë në të Shenjtat e të Shenjtave për të temjanisur, gjatë kohës së famullisë, i erdhi Gabrieli duke ungjillëzuar dhe thënë: Do kesh, o kryeprift, një bir në pleqëri, profet dhe Pararendës, zë,[1] predikues dhe kandil[4] gjithmonë i ndriçuar, pra njohës i Hirit t' shenjt'.

Sinaksari

Më 23 të të njëjtit muaj, Zënia e të shenjtit dhe të lavdëruarit profet, Pararendësit dhe Pagëzorit Joan.
Vargje: Nga kryeengjëlli iu tha orakull burrit profet,/ se do të lindte profet dhe disi më tepër se profet.[20]
Më 23, një bark mori përbrenda Prodhromin.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë, Andreas, Joanit, Petros dhe Andonit, që mbaruan në Afrikë.
Vargje: Për Fjalën që më parë u shpua me një shtizë,/ duke u shpuar, duroi Andrea shtiza të dyfishta.
Pasi vuri armiqësi kundër mashtrimit dhe u ther Joani,/ ther armikun dhe bashkë me të mashtrimin.
Andoni dhe Petroja, si gurë të fortë,/ kishin durim kur iu prisnin gjymtyrët.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së shenjtë Raidha e virgjër.

Vargje: Meqë përgjërohej Raidha të shihte bukuri Perëndie,/ e dorëzon bukurinë e mishit tek shpata.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i grave oshënare, Ksanthipi dhe Polikseni, motra.

Vargje: Motrat Ksanthipi dhe Polikseni,/ kore engjëjsh i marrin si bashk'banuese.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të ri të shenjtë Joani, ish musliman.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të ri të shenjtë Nikolla bakalli, që u martirizua në Konstandinopojë në vitin 1672; mbaroi me shpatë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Dhrosovolon men tin káminon

Meqenëse nuk i besove fjalëve të mia, merr dukshëm një farë shurdhësie, edhe kur do të shikosh zërin[1] e Fjalës të lindet, merr përsëri zë duke thirrur: I bekuar je, o Perëndi i Izraelit.

Zaharia si diell i shumëndritshëm, pasi u bashkua me hënën, Elisabetën, u bë me kandil[4] dritëprurës,[21] që shkëlqen për ne, të kapurit mizorisht në errësirën e pasioneve.

Pararendësi i madh i Krishtit, duke përdorur kërcimet si fjalë, t'u fal ty, që ishe në mitër virgjërore, ndërsa ai mbahej në barkun e Elisabetës, o Jisu, Perëndi i etërve.

Hyjlindësore

Hëna Elisabetë, duke mbajtur brenda yll të hyjshëm, Pararendësin, t'u fal, o Mariam, re e ndritshme,[22] që mbaje diellin, Krishtin, i cili po vishej me mish prej teje, për të na shpëtuar ne.

Zbritësore: Uq elátrefsan

»**N**uk u faleshin krijesave hyjmendë-
»sit, por Kryetarit lart* dhe kërcënimin
»me zjarr* e shkelën me trimëri, psal-
»nin me brohori:* Zot, lavdi më ty, o Pe-
»rëndi i etërve,* ti je vetëm i bekuar.*

Ode VIII
Ek flogós tis osiis

Miku i dhëndrit[23] përgatitet, zëri[1] i Fjalës pranon fillim dhe ushqehet tani në bark shterp, ushtari[24] i madh i mbretit të të gjithave.[25]

Lulëzoi bujku për zemrat shterpa; kazma[12] e pasioneve tashmë po farkëtohet; viçi i nderuar ushqehet[26] me vetëpërmbajtje, Pararendësi i madh. O popuj, ngazëllohuni.[4]

Siç zgjidhe qëmoti prangat e shterpësisë, kështu zgjidhe ngurtësinë e mendjes sime, o Pagëzor, edhe bëmë

që të nxjerr fryte pendimi[27] dhe që të jetoj përjetë.

Hyjlindësore

Sapo të pa shtatzënë, o Vajzë, Elisabeta, u gëzua hyjshëm, ndërsa brenda asaj embrioni kërceu, se njohu saktësisht Zotin e tij.

Zbritësore: Pedhas evajís

»Djemat* e dënuar për t'u djegur,
»prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit
»Krisht, si simbol në lashtësi;*[27a] dhe
»si një veprim tani,* dhe tërë botën
»po e mbledh për këng' e lavdërim:*
»Himnojeni ju veprat e Zotit* dhe e
»lartësoni përmbi të gjitha jetët.*

Ode IX
Theón anthropis idhín

Fushon në barkun nënor Joani tash* si në pallat mbret'ror,[28] pasi i hapi sot dyertë* e shterp'sis',[29] Pag'zori yt i madh dhe hyjnor,* që do të dalë si ushtar,[24] pararoja yt,* që të përgatisë udhët, për ty mbret i Gjithësis'.[25]

Profet i Zotit, o plak, kërce me gaz:* Një bir do kesh, Joanin, Pararendës të Krishtit ton';* nuk ka mes të vdekshmëve ndonjë më të madh* se biri yt. Elisabeta, kërce dhe ti,* ngazëllohu edhe silli himne Perëndis', Bër'sit.

Kujtona ne që tani të lavdërojm'* me bes' profet, Prodhrom i Zotit dhe Perëndisë ton',* duke na çliruar nga pasionet në shpirt,* duke shpëtuar nga rreziqe, drejtona ti* në udh'[1] qiellore hyjshëm, o i lumur përgjithmon'.

Hyjlindësore

Si nën' të d'lirë të njohu saktësisht* Elisabeta, sapo pa të jet' e çliruar krejt* nga zinxhir' shterp'sie dhe tek mbante në bark* vet' Pararend'sin e atij që kish si banes'* mitrën tënde, o Mari e virgjër si edhe hirplot'.

Zbritësore: Apas jijenís

»Gjithë njerëzit, kërceni me ngazë-
»llim tek drit' e Shpirtit Shenjt',* eni
»lavdërojeni;* engjëjt e q'ellit eni
»kremtojeni* këtë të shenjtë panair
»të kryezonjës Mari* dhe thërrisni:*
»Ti je më e lumura,* Virgjëresh' e ku-
»lluar Hyjlindëse.*

Dërgimësore
Tis mathités sinélthomen

Zënia e lavdërueshme* e Pag'zorit të shenjtë* paranjofton se do të lind'* nga Virgjëresha mbreti,* porsi Joani ka lindur* nga shterpa jopjellore* Elisabeta dhe at' plak,* pra prifti Zaharia i madh dhe shenjt.* O Zot, dhembshurona të gjith' me lutjet* e tyre, dhe

të Zonjës son',* dhe Pararend'sit, o Krisht.

Hyjlindësore E ngjashme

Me ngazëllim dhe me hare* thërrasim, o Hyjlind'se* dhe virgjëresh' e tërëd'lir',* ne që jemi çliruar* nga faji, nëma e lashtë*[30] nëpërmjet lindjes sate,* "Gëzohu" kryeengjëllor*[17] themi: G'zohu, çlirimi adamian;*[31] g'zohu ti, modeste, se na çlirove* nga vdekja; g'zohu se me ty* gjetëm mbret'rin' në qiell.

Lavdërime

Ting. I Ton uranion tagmaton

Krijesa po ngazëllohet[4] për ngjizjen tënde sot,* profet dhe Pararendës,*o Joan, dhe Pag'zor ti:* Lindja jote e shenjt' sinjalizon* tek ne lindjen e Zotit Krisht;* të lavdërojm' denjësisht si dhe bashkërisht* ne, të cilët po jetojm' mbi dhé.

(2x)

Meqen'se gjeti dëshmi të çuditshme engjëlli,* pra zënien nga një shterpë,* tek Maria e solli;* e ka sjellë k'të si një vërtetim;[32] ndaj dhe ne le t'i lavdërojm',* Elisabetën që ish jopjellore dhe* burrin Zaharia, dhe birin.

Kandili[4] i hyjndërtuar i dritës që s'pushon,*[21] i Diellit të lavdit,* miku, shoku i dhëndrit,*[23] dritëprurësi i madh gjithashtu,* zëri frymor[1] i Fjalës Zot,* Prodhromi para pranis' zotërore qart'* zihet me një zë të engjëllit.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. IV*

Elisabeta zuri Pararendësin e Hirit, ndërsa Virgjëresha Zotin e lavdisë.[33] Përqafuan njëra-tjetrën nënat dhe embrioni kërceu përpjetë, sepse përbrenda shërbëtori e himnonte Zotin. Meqenëse e ëma e Prodhromit u habit, filloi të thërrasë: Nga më ngjau kjo, që të vijë nëna e Zotit tim tek unë? Ai që ka përdëllimin e madh, do të shpëtojë një popull të dëshpëruar.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i Pararendësit, Ode III dhe IV.

Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23

[2] Is. 35.6

[3] Is. 35.1

[4] Joan 5.35

[5] Lluk. 1.76

[6] Lluk. 1.75

[7] Mal. 3.1; Matth. 11.10; Mark. 1.3; Lluk. 7.28

[8] Is. 54.1

[9] Dan. 2.34-45

[10] Eks. 3.2

[11] Ps. 39(40).3

[11a] Ps. 44(45).2; 118(119).131; Jez. 3.27

[11b] Ps. 44(45).10

[12] Matth. 3.10; Lluk. 3.9

[13] Matth. 3.2

[14] Gjyq. 6.38

[15] Num. 17.23

[16] Gjen. 21.2

[17] Lluk. 1.28

[18] Ps. 103(104).4

[19] Eks. 19.9; 34.5; Num. 11.25; Ligji i Dytë 31.15

[19a] Ps. 46(47).2

[20] Matth. 11.9

[21] Joan 1.4; 8.12

[22] Eks. 14.24; 16.10

[23] Joan 3.29

[24] II Tim. 2.3

[25] I Tim. 6.14-15; Apok. 19.16

[26] Lluk. 15.23

[27] Lluk. 3.8

[27a] Dan. 3.25

[28] Lluk. 7.25

[29] Gjen. 30.22

[30] Gjen. 3.16-19

[31] Gjen. 3.15

[32] Lluk. 1.36

[33] I Kor. 2.8

MË 26 TË TË NJËJTIT MUAJ

Shpërngulja e apostullit të shenjtë, të lavdëruar dhe ungjillor Joan Theologut.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Kathizma e parë si zakonisht. Thirrtoret: 4 Vargëzime ngjallësore dhe 6 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrja. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet (dhjaku thotë: Le të vëmë re - Urtësi - Le të vëmë re, si në çdo rast kur leximet janë nga Dhiata e Re, dhe jo Urtësi - Le të vëmë re, kur leximet janë nga Dhiata e Vjetër). Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i ungjillorit. Tani ngjallësor (Zoti Krisht, bërësi). Përlëshoret: ngjallësore, e ungjillorit dhe Hyjlindësorja e tij.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e ungjillorit dhe Himnet Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e ungjillorit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, nga një Ndenjësore ngjallësore dhe nga një e ungjillorit bashkë me Hyjlindësoret e tyre. Pas Polieleit, Ndenjësore e ungjillorit bashkë me Hyjlindësoren e saj. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe i ungjillorit. Pas Odes III, Kontaqi ngjallësor dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Ndenjësorja e ungjillorit bashkë me Hyjlindësoren e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit ngjallësor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe e ungjillorit bashkë me Hyjlindësoren e tij. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e ungjillorit. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Kungatore Në gjithë dheun.

NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Vargëzime
Ting. II
Ote ek tu ksilu se nekrón

Ejani, o besnikë, të kurorëzojmë sot me himne të perëndishme avushën e urtësisë dhe shkrimtarin e dogmave orthodhokse, Joanin e lavdëruar dhe të dashur; sepse ai gjëmoi: Fjala ishte në fillim. Prandaj ai i famshmi, u dëftua si kumbues, meqë shkroi për botën Ungjillin plot urtësi.

(2x)

Në fakt, ti u shfaqe vërtet një mik i madh, që re mbi kraharorin e Krishtit Mësues; se re mbi kraharorin prej nga nxore ti dogmat e urtësisë, me të cilat pasuron të gjithë botën si hyjfolës i Perëndisë; prandaj dhe Kisha e hijshme e Krishtit, duke i pasur këto, ngazëllohet dhe dëfrehet.

Gëzohu, o Theolog, me të vërtetë; gëzohu, o bir fort i dëshiruar i nënës së Zotit, se duke qëndruar ti pranë Kryqit të Krishtit, ke dëgjuar zërin e perëndishëm të Zotit të të thërriste ty: Ja tani, nëna jote; pra të gjithë ne të lumërojmë denjësisht si një apostull i madh dhe i dashur i Krishtit.

Lavdi *Ting. II*

O Theolog i virgjër, nxënës i dashur i Shpëtimtarit, lutemi, shpëtona me ndërmjetimet e tua nga çdo dëm se jemi grigja jote.

Tani *Hyjlindësore*

Si një ulli të shumëfrytshëm[1] Virgjëresha të nxori ty, frytin e jetës,[2] që i jep botës si fryt përdëllimin e madh dhe të pasur.

Pasvargje
Ting. Tërth. II
Triímeros anestis

Le të himnojmë, o besnikë, denjësisht kujtimin e nxënësit të respektuar të Krishtit, mbretit tonë, sepse ai predikoi tek të gjithë kombet shumë qartë diturinë e Trinisë.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij.

Apostulli i Krishtit, turbullimin e mëparshëm të mashtrimit të idhujve, e ktheu në qetësi, duke udhëhequr botën në besimin orthodhoks; edhe tani ndërmjeton për ne të gjithë.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

O Krisht, u dhurove efesianëve si përkrahës shumë të madh ungjillorin tënd, Theologun e urtë dhe të hyjshëm; këtë edhe ne e lavdërojmë tani si banues dhe mbrojtës të Efesit.

Lavdi *dhe* Tani *I ngjashëm*

O Trini e fuqishme pa kufi, Njësi trihipostate, me ndërmjetimet e Theologut të respektuar dhe të Perëndilindëses së vetme dhe gjithmonë të virgjër, shpëtona ne që të himnojmë.

Përlëshore
Ting. II

O apostull i dashur i Krishtit Perëndi, nxito, shpëto një popull të pambrojtur; të pranon të gjunjëzohesh, ai që denjoi t'i biesh mbi kraharor; atij përgjëroju, o Theolog, që të shpërndajë një re kombesh këmbëngulës, duke kërkuar për ne paqen dhe përdëllimin e madh.

NË MBRËMËSOREN E MADHE

Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit
(Lum ai njeri)
Vargëzime
Ting. I
Ton uranion tagmaton

Shkroi Ungjillin, ai që ish folës shum' i madh* misteresh Perëndie,* që jan' lart dhe shikues* pamjesh dhe zbulimesh, që s'shprehen dot,* biri i Zevedheut pra;* dhe na mësoi kështu të theologojm'* Atin, Birin, Shpirtin e Tër'shenjt'.

(2x)

Harpa, kitara e këngëve qiellore krejt* që luan Zoti, goja* me frym'zim Perëndie,* shkruan pra mistere edhe këndon* ëmbël këngën e këngëve.*[3] Lëviz dhe buzët si korda, gjuhën si tast;* ndërmjeton që të shpëtohemi.

(2x)

Me gjuhën si bubullimë, ti përgjithmon' thërret* me forc' sekretet, fjalën* e urtisë së Zotit,* o i dashur nga Hyjnia, thërret* duke hapur ti buzët shpesh:* Në fillim Fjala qe. K'shtu si pishtar ndriçon* çdo njeri për dijen e Zotit.

(2x)

Lavdi *Ting. II*
I Gjermanoit. Sipas të tjerëve i Bizantit.

Birin e bubullimës, themelin e fjalëve të hyjshme, kryetarin e theologjisë dhe të parin predikues të urtësisë së vërtetë të dogmave të Perëndisë, të dashurin Joan dhe të virgjërin, ne, gjinia e njerëzve, le ta lavdërojmë siç i ka hije, sepse ai duke patur brenda vetes pa mbarim Hyjninë, tha: Në fillim ishte Fjala. Dhe përsëri foli për pandashmërinë e Birit nga Ati dhe pastaj për barazinë me esencën e Atit, duke na treguar me anën e tij, orthodhoksinë e Triadhës së Shenjtë; dhe na tregoi se është bërës bashkë me Atin dhe se sjell jetë dhe dritë të vërtetë. O çudi që shtang dhe gjë mahnitëse! Sepse duke qenë plot me dashuri, u bë plot edhe me theologji, me lavdi, nder dhe besë, duke qenë themeli i besimit tonë pa mangësi, nëpërmjet të cilit, le të arrijmë të mirat e amshuara në ditën e Gjykimit.

Tani *I njëjti*

Shkoi hija e ligjës[4] siç erdhi hiri, se sikundër ferra nuk digjej me gjith' që nxirrte flakë,[5] ashtu dhe ti virgjëreshë linde dhe virgjëreshë mbete; në vend kolonë zjarri,[6] lindi diell drejtësie, në vend të Moisiut, Krishti shpëtim i shpirtrave tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës dhe Leximet.*

Këndimi i letrës së parë katholike të Joanit
(3.21-4.6)

Dhjaku: Le të vëmë re. Urtësi. Le të vëmë re *[dhe në të dy të tjerat e mëparshme]*.

Të dashur, nëse nuk na akuzon zemra jonë, kemi guxim tek Perëndia. Edhe çfarëdo që të lypim, e marrim nga ai, sepse ruajmë porositë e tij, dhe bëjmë ato që i pëlqejnë atij. Edhe kjo është porosia e atij: Të besojmë në emrin e Birit të tij, Jisu Krisht dhe të duam njëri-tjerin, siç na dha porosi. Edhe ai që ruan porositë e tij, mbetet tek ai dhe ai tek ky, dhe nga kjo e njohëm se mbetet tek ne, nga Shpirti që na dha. Të dashur, mos i besoni çdo shpirti, por provoni shpirtrat nëse janë nga Perëndia, sepse shumë profetë të rremë kanë dalë në botë. Nga kjo e njihni Shpirtin e Perëndisë; çdo shpirt që pohon se Jisu Krishti ka ardhur në mish, është nga Perëndia. Edhe çdo shpirt që nuk pohon se Jisu Krishti ka ardhur në mish, nuk është nga Perëndia; dhe ky është *shpirti* i antikrishtit, për të cilin keni dëgjuar se vjen, dhe që tashmë është në botë. Ju fëmijë, jeni nga Perëndia, dhe i keni mundur ata; sepse ai *që është* ndër ju është më i madh se ai *që është* në botë. Ata prej botës janë; prandaj prej botës flasin dhe bota i dëgjon ata. Ne jemi nga Perëndia; ai që njeh Perëndinë, na dëgjon.

Këndimi i letrës së parë katholike të Joanit
(4.11-16)

Të dashur, nëse na deshi kështu Perëndia, edhe ne kemi detyrë ta duam njëri-tjetrin. Asnjë s'e ka parë Perëndinë ndonjëherë. Nëse duam njëri-tjetrin, Perëndia mbetet tek ne dhe dashuria e tij është e përsosur te ne. Nga kjo e njohëm, se mbetemi tek ai, dhe ai te ne, sepse na ka dhënë nga Shpirti i tij. Edhe ne e kemi parë dhe dëshmojmë se Ati dërgoi Birin Shpëtimtar të botës. Ai që të pranojë se Jisui është Biri i Perëndisë, Perëndia mbetet tek ai, dhe ai tek Perëndia. Edhe ne e kemi njohur dhe e kemi besuar dashurinë që ka Perëndia për ne. Perëndia është dashuri; dhe ai që mbetet në dashuri, mbetet në Perëndinë dhe Perëndia në atë.

Këndimi i letrës së parë katholike të Joanit
(4.20-5.5)

Të dashur, në thëntë ndonjë se dua

Perëndinë, dhe urren vëllanë e tij, është gënjeshtar; sepse ai që s'do të vëllanë, të cilin e ka parë, si mund të dojë Perëndinë të cilin s'e ka parë? Edhe këtë porosi e kemi prej tij: Ai që do Perëndinë, të dojë edhe të vëllanë. Kushdo që beson se Jisui është Krishti, ka lindur prej Perëndisë; dhe kushdo që do atë që e ka lindur, do edhe atë që ka lindur prej tij. Nga kjo e njohëm se duam të bijtë e Perëndisë, kur duam Perëndinë dhe ruajmë porositë e tij. Sepse kjo është dashuria e Perëndisë, të ruajmë porositë e tij. Edhe porositë e tij nuk janë të rënda. Sepse çdo gjë që ka lindur prej Perëndisë e mund botën, dhe kjo është fitorja që mundi botën: besimi ynë. Cili është ai që mund botën, veç atij që beson se Jisui është i Biri i Perëndisë?

Në Liti
Ting. I I Gjermanoit

Lumenj theologjie nga goja jote e çmuar buruan,[7] o apostull; prej këtyre Kisha e Perëndisë, duke u vaditur, i falet orthodhoksisht Trinisë së bashkëesencshme; i kërko asaj edhe tani, o Joan Theolog, të mbështeten dhe të shpëtohen shpirtrat tanë.

I njëjti I Andrea Pirit

Bima e dëlirësisë, miroja erëkëndshme, sërish na lindi në këtë festë, që t'i thërrasim ne: Ti që re mbi krahanorin zotëror dhe që i hodhe si shi botës fjalën, o Joan apostull, që e ruajte Virgjëreshën si beben e syrit, kërko për ne nga Krishti përdëllimin e madh.

I njëjti

Onxënës i Shpëtimtarit, i virgjër dhe Theolog, tek ti si të virgjër, Virgjëreshën dhe Perëndilindësen e dorëzoi Krishti, Perëndia, kur kryqëzohej; dhe e ruajte si beben e syrit; prandaj ndërmjeto që të shpëtohen shpirtrat tanë.

I njëjti

Si shikues i mistereve të pathënshme thërrisje duke gjëmuar, se Fjala e parajetëshme ishte në fillim pranë Perëndisë dhe ajo ishte Perëndi, o Joan apostull, mik kraharori dhe i sinqertë i Krishtit, kënaqësia e Trinisë, mbështetja e patundur e Efesit dhe e Patmosit, ndërsa për ne ndihmë; ndërmjeto, o Theolog i tërëlumur, që të çlirohet nga armiq keqbërës, mendorë dhe të ndjeshëm, populli që e kryen gjithnjë besërisht kujtimin tënd.

Ting. II I Theofanit

Majën e apostujve, trumbetën e theologjisë, gjeneralin shpirtëror, që ia nënshtroi botën Perëndisë, ejani,

o besnikë, ta lumërojmë Joanin e kënduar, i cili zhvendoset nga dheu dhe s'largohet prej tij, por rron dhe pret ardhjen e dytë të frikshme të Zotit.[8] Përgjëroju që ta presim pa dënim, ne që me dëshirë të madhe kryejmë kujtimin tënd, o mik mistik i kraharori të Krishtit.

Lavdi *Ting. IV I Bizantit*

Kur re në kraharorin e Krishtit Mësues, gjatë darkës së Zotit, o nxënës i dashur, nga atje njohe të pathënshmet, edhe u gjëmove të gjithëve zërin qiellor: Në fillim ishte Fjala, dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi, drita e vërtetë që ndrit çdo njeri që vjen në botë, Krishti Perëndia dhe Shpëtimtari i shpirtrave tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Biri që lavdërohet bashkë me Atin dhe Shpirtin në më të lartat nga Kerubimet, duke dashur të rigatuajë të parëgatuarin, e zbrazi gjithë veten e tij,[8a] në mënyrë të pashprehshme në mitrën tënde, o Perëndilindëse e gjithëhimnuar, dhe duke lindur prej teje si diell, ndriçoi mbarë botën[9] me Hyjninë, duke e shpëtuar nga mania e idhujve; dhe duke e hyjnizuar në veten e tij njerëzinë, e bashkëngriti në qiejt, Krishti Perëndia dhe Shpëtimtari i shpirtrave tanë.

Pasvargje
Ting. IV O eks ipsistu

Theologove ti Birin e të Lartit* se ësht' i bashk'pafillim dhe bashk'esencëshëm* dhe drit' nga drita njësoj plot'sisht* dhe karakteri* i hipostazës së prindit, që u ndrit* jashtë kohe, pa pësim nga ai, Bërësi* dhe sundimtari, zot'ruesi* mbi gjithë jetët;* dhe o i dashur, e shpalle nëpër bot'* atë që nxjerr drit'* nga err'sira,[10] pra Perëndinë ton' Krishtin dhe Zotin ton';* lypi që të shpëtojë,* të ndriçojë shpirtrat tan' gjithnjë.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij.

Pranove dritën ti nga Ngushëllimtari;* kjo të ndriti ty, ndaj kur theologove, the:* Ai del prej Atit dhe përmes* Birit po duket* në njerëzin'; ësht' i bashk'nderuar pra* dhe i bashkëfronëshëm, i bashk'substancëshëm* me Atin, i cili s'ka fillim,* si dhe me Fjalën* e shenjt'; i dashur, e predikove qart'* në gjithë botën;* si themel të shenjt' të besimit me himne të lavdërojm';* k'shtu të patundur mbaje* përmes lutjes sate tek Zoti.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

I hipur përmbi theologjin' e lartë* njohe ti misteret e fshehta të Zotit ton':* Hyjnia ka vetëm një substanc',* një mbretëri pra,* një zotërim, si edhe

lavdi prap' një;* ndahet kjo në tri hipostaza, megjithatë* është' e pandarë po në substanc'* edhe bashkohet* në një bashkim tër'hyjnor dhe pa trazim;* k'shtu lavdërove dhe e shpalle, o Theolog, qart' Trininë që s'ndahet dot;* lutju që t'i shpëtojë dhe ndriçojë shpirtrat tan' gjithnjë.

Lavdi *Ting. Tërth. II*
I Joan Monakut

O apostull i Krishtit, ungjillor Joan, duke u bërë njohës i të pathënshmeve, dogmat e pathënshme të urtësisë na i kumtove duke e shpallur fuqishëm tek besimtarët këtë: "Në fillim ishte"; dhe duke e përjashtuar tjetrën: "Nuk ishte". Pra i zmbrapse fjalët e heretikëve duke u shfaqur mik kraharori i dashur, si Isaia me zë shumë të madh dhe Moisiu Perëndishikues; meqë ke guxim te Perëndia, lutju ti gjatë për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Zoti Krisht, bërësi dhe shpërblyesi im, o e gjithëpastër, si lindi prej teje i veshur si unë,[11] çliroi Adamin prej mallkimit të parë, prandaj, o e gjithëpastër, të thërresim pa pushuar si nënë Perëndie dhe virgjëreshë me të vërtetë përshëndetjen e engjëllit: Gëzohu, o Zonjë, mbrojtje dhe strehë, dhe shpëtim i shpirtrave tanë.*

Përlëshore
Ting. II

O apostull i dashur i Krishtit Perëndi, nxito, shpëto një popull të pambrojtur; të pranon të gjunjëzohesh, ai që denjoi t'i biesh mbi kraharor; atij përgjëroju, o Theolog, që të shpërndajë një re kombesh këmbëngulësh, duke kërkuar për ne paqen dhe përdëllimin e madh.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Të gjitha përmbi mendim, të gjitha të përmbilavdishme, misteret e tua, o Hyjlindëse. E vulosur me pastërti dhe e ruajtur me virgjëri, u njohe nën' e vërtetë duke lindur Perëndin' e vërtetë. Atij iu lut të shpëtohen shpirtrat tanë.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

U mbiquajte bir bubullime ti,* se shurdhove krejt veshët e pabesis';* më ëmbël se një trumbet'* tingëllove qart' o i urt',* në zemra me drejt'si[12] mishërimin e Fjalës Zot,* edhe në gjoksin e tij si mik i sinqert' ke rën';*

nga atje e nxore thellësinë e njohjes,* pra e predikove fort* të bashk'panishëm me Atin,* o apostull* Joan i madh,* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Hyjlindësore

Urtësin'[13] edhe Fjalën ti e ke zën'* brenda barkut pa farë, pa djegie krejt;* e linde për botën ton'* sundimtarin e Gjithësis';* mban në pëqi atë që e mban fort çdo gjë në dor',* pra Krijimtarin si dhe ushqyesin botëror;* ndaj o Virgjëreshë e tër'shenjtë të lutem,* kur un' do qëndroj përball'* faqes së Krijimtarit tim,* të shpëtohem* nga çdo mëkat;* Zonj' e pastër dhe virgjëresh'* at'herë ndihmë dhe mbrojtje* ti më dhuro,* sepse, o e himnuar, mundesh të bësh sa do.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
E njëjtë

E lë detin, peshkimin dhe me kallam* kryqin kape si peshqit, madje përjet',* të gjith' kombet, Theolog,* o i tër'famshëm, dhe siç tha* qart' Krishti, u tregove ti një peshkatar njer'zish,* aspak për vdekjen, por për një jetë me shpres'tari;* pra e mbolle dijen thell' të Fjalës së Atit;* me fjalët e tua, k'shtu* e fitove ti Patmosin* dhe Efesin,* o apostull;* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Hyjlindësore

Më kujtohet Gjykimi edhe kam frik',* se kam bërë veprime të denja krejt* për turp, un' kam rënë posht',* o Hyjlind'se; të lutem pra,* përpara se të vijë nat' vdekjeje më mëso,* më kthe në udh' pendimi ti, o e himnuar fort,* që me kënaq'si të falem dhe të himnoj shum'* fuqin' tënde të pamas'* edhe ndihmën e hyjshme krejt,* e Tër'shenjtë,* hyjnuse Zonj';* të lyp, ndërmjeto tek yt Bir,* pra Krishti yn', Perëndia,* të më japë* falje fajesh dhe përdëllimin e madh, shpëtim.

Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

Meqë kishe guxim porsi nxënës ti,* kishe rënë mbi gjoksin e Krishtit ton',* dhe pyete: Kush është* tradhëtari yt, o Jisu?* Edhe meqen'se ishe i dashur, o apostull,* tek ti ky u tregua përmes bukës qartësisht;* pra u bëre njohës i të pathënshmes gjithnjë,* në botën e tër' mëson* mishërimin e Fjalës Zot,* Theolog i* lëvduar fort;* ndërmjeto

tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Hyjlindësore

O e virgjër dhe nënë e Perëndis,'* e Tër'shenjtë, pasionet e egra shum'* të shpirtit tim më shëro,* lutem, dhe falje jep tek un'* për shkeljet që kam bërë marr'zisht, se e ndota krejt* si shpirtin k'shtu dhe trupin, mjerani un'. Oh, ç'do bëj* gjatë asaj ore, ndërsa engjëjt do ndajnë* nga trupi im shpirtin tim* të pandreqshëm, të rënë posht'.* Pra at'herë,* o Zonja jon',* bëhu ndihma ime e fort'* dhe mbrojtëse shum' e ngrohtë* me shum' fuqi,* sepse un' shërbëtori yt të kam shpresë ty.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV

Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e apostullit. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II

O Theolog i virgjër, nxënës i dashur i Shpëtimtarit, me përgjërimet e tua na shpëto, lutemi, prej çdo dëmi, sepse jemi grigja jote.

Kanunet: e Hyjlindëses dhe dy të apostullit
Ode I

Kanuni i Hyjlindëses, që ka Akrostihidhë alfabetike të përmbysur.
I Theofanit Ting. II

Irmosi: En vithó katéstrose poté

»**G**jith' ushtrin' e mbretit Faraon,* »forca që ësht' mbi çdo arm', mbi çdo »armik,* thell' e shtriu në fund dikur.* »Kur u mishërua pra Fjala, fshiu mëka»tin plot me ankth, e tër' keq,* Zoti i »lëvduar, se u lavdërua me shum' »lavdërim.

Të ka zgjedhur Perëndia ty* midis gjithë grave si të bukur shum',* të panjollshme, me hire plot;*[14] dhe në barkun tënd të panjoll' banoi, o e panjollshme; lutju atij,* të shpëtojmë ne himnuesit e tu nga çdo njoll' krimesh pra.

Psalmi thot': Qëndron si mbretëresh'* në të djathtën e atij, i cili prej* barkut tënd na ndriçoi, pra* mbretit;[15] lutju k'tij, që të më tregojë në krah të djathtë në atë dit',* kur çdokush do të shpaguhet sipas veprave të tij,[16] o Vajz'.

Po, natyra jon' u bë e djerr'* nëpërmjet gabimesh, por, o Zonja jon',* përtërite atë të gjith',* kur e linde shiun q'ellor, të lutem, ti bëje fryt'dhënëse, të mir',* brazdën[17] e tër' shpirtit tim djerr, o Hyjnuse dhe Hyjlindëse.

Kanuni i shenjtit, që ka Akrostihidhë: "Do ta lavdëroj në mënyrë të pëlqyeshme tek Krishti, birin e bubullimës. I Theofanit".

Ting. II I ngjashëm

Mbretërin' e qiejve, Joan* që e predikove, e ke marrë ti;* duke qen' shoqëruesi* qiellor i Fjalës, me ndërmjetimet e tua ruajna gjithë ne,* që besojmë në theologjin' dhe predikimin tënd të shenjt'.

Ke treguar një moral të fort',* gjërat tokësore i shpërfille pra* edhe lidhjet fisnore ti;*[18] dhe bashkë me Fjalën, o i tër'urt', duke qenë me mençuri, logjik',* k'ta që ishin bër' të palogjikshëm i çlirove prej marr'zis'.

Diturin' e qielloreve* more dhe e shpalle theologjikisht* me fuqi Fjalën Perëndi,* po nga Perëndia; the: "Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pran'* prindit, edhe ishte Perëndi", ungjillëzove, o i urt'.

Hyjlindësore

Një kor vajzash të hyjshme këndon* perëndishëm edhe thot': E bukur je* ti mes grave,[19] Hyjlind'se, Zonj',* e stolisur nëpërmjet zbukurimesh hyjnie, se linde mbi logjik'* Fjalën që bën çdo gjë plot me bukuri dhe i stolis të gjith'.

Kanun tjetër i shenjtit, që ka Akrostihidhë: "Unë i sjell lutjen e gjashtë njohësit të mistereve të Perëndisë. Josifi".

Ting. Tërth. II
Os en ipiro pezefsas

E ule në thellësitë e Shpirtit ti* mendjen, kur ndriçim të shenjt'* prite dhe na shpalle ne* lindjen e frikshme dhe the* se Fjala e Perëndis' o Theolog, që në fillim.

Mori ngacmimesh, pasionesh, mjerimesh bashk',* dallgë, valë vështir'sish* na përkulën; pra tek ti,* Theolog, përikim ne* me bes', bëhu ndihmësi i shërbëtorëve të tu.

Shëro sëmundjen e shpirtrave tan' të mjer* shum' të rëndë, o i urt',* si një mjek i famshëm ti,* nga dënimi na çliro,* nga zjarri që s'fiket kurr' me ndërmjetimin tënd të fort'.

Hyjlindësore

Ti që ke zën' Perëndin' që u bë njeri* për ne njer'zit, lutu fort* tek ai, o e tër'd'lir',* që në ditën e Gjyqit* të na dhembshurojë ne, se mëkatuam ndaj atij.

Zbritësore: Anikso to stoma mu

Ja gojën e çel tani
(shih në 23 shtator fq.155)

Ode III
E Hyjlindëses
Irmosi: Eksínthisen i érimos

»**U** lulëzua si zambak* shkretëtira, »Kisha pra e kombeve që ishte shterp',* »me pranin' tënde, Perëndia im;* në »të u sigurua zemra ime fort.

Nga barku yt del Bërësi,* kur më veshi mua[11] pra, o e gjithëpanjollëshme,* edhe dha një stoli paprishjeje* tek ne, të zhveshur krejt prej shkeljesh, mangësish.

E linde Fjalën Perëndi,* që ësht' mbi çdo lavd, o Zonjë; lutju k'tij gjithmonë ti*, që ta ket' përdëllimin shpirti im,* të zymtë nga çdo epsh dhe ligësi mjerisht.

Shëro plagët e shpirtit tim,* o e pacenuar; zemrën time të mjerueshme,* të helmuar me helm nga gjarpëri*[20] mjekoje me ilaç të fort' dhe më shpëto.

E shenjtit I njëjti

Misterin e Trinis', që ësht'* mbi çdo mendje, gjuha jote e tër'urtë na e shfaq,* o i lumur Joan, apostull, shenjt;* me të u sigurua zemra ime fort.

Ja gjuha jote është bër'* si kallam i shkruesit[21] të Shpirtit të Tër'shenjtë, Zot,* e dikton pra me shkrim prej Perëndis'* Ungjillin e nderuar dhe hyjnor krejt'sisht.

Pafundësin' e urtësis'*[22] e himnove, o i urt', kur me guxim hyjmendës krejt* re ti përmbi burimin e urt'sis';* prandaj ke qen' hyjpredikuesi i saj.

Hyjlindësore

Ty, o e paqortueshme,* virgjëresh' e vetme edhe nën', të respektojmë, ne* se u bëre shkaktare për shpëtim;* çliron me ndërmjetimin tënd gjith' botën, Zonj'.

Tjetër
Uq estin ájios os si

Me Fjalën bisedove shum',* o Theolog i lumur,* me një mendje të pastër, të shkëlqyer dhe nga kjo* ti shpirtëroret i njeh* dhe Krijesën e tër' e ndriçon me forc'.

Më zgjidh nga pranga dhe vargoj,* o i gjith'lum, nga fajet* edhe lidhmë me dashurin' e Zotit, Perëndis',*[23] të

cilin deshe nxeht'sisht* dhe prandaj u bëre Theolog i tij.

U dhe tek ne si mbrojtës ti,* ndërmjetues, shpëtues,* përfaq'sues tek Zoti edhe bërës mrekullish,* o Theolog, dhe burim* i shërimeve; pra të lëvdojm' me shpirt.

Hyjlindësore

Kur Fjala, pa asnjë shpjegim* pas mishërimit nga ti,* mbi dru ngrihej në kryq, Hyjlind'se, të besoi ty* si virgjëresh' tek ai,* nxën'si që ka qen' i virgjër dhe i d'lir'.

Zbritësore: Tus sus imnologus

O Zonjë dhe nën' e Perëndisë

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

Meqë re përmbi gjoksin e urtësis',* e mësove mir' dijen e Fjalës Zot;* kumtove me hyjshmëri:* "Në fillim ishte Fjala", Krisht;* e shkrove bukur lindjen pa kohë, i pari ti,* dhe shpalle tek të gjith' mishërimin e Perëndis';* pra me gjuhë joshe, kape në rrjetë kombe,*[24] dhe Hirin e Shpirtit t' Shenjt'* e mëson në gjith' anët qart',* o apostull* dhe Theolog,* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Hyjlindësore

Meqë linde, o Zonjë e Gjithësis',* Fjalën përdëllimtare, që mëshiron,* të gjithë na mëshiro* sa përikim tek ti me bes',* dhe na çliro nga ngasje, sëmundje, nga çdo mundim* si dhe nga flaka, që kurr' nuk shuhet përjetësisht,* që me çdo pëlqim ta lavdërojm' pasurinë* e tër' dhembshurive, Vajz',* dhe mëshirën tënde pa mas',* se gjithmonë* të th'rresim ty:* Ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që denjësisht himnojm' lindjen tënde, Zonj'.

Ode IV
E Hyjlindëses
Irmosi: Elílithas ek Parthenu

»**K**e ardhur nga e virgjëra jo si ndër»mjetues, jo si engjëll, por erdhe vetë »ti, o Zot i mishëruar, dhe më shpëtove »mua, njeriun e tërë; prandaj të thërras »ty: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

O Zonjë, hidh si shi mbi mua pikë kataniksi, e cila largon gjithë vapën[25] e zemrës sime dhe ndalon përmbytjet dëmtuese të plogështisë.

Mos më shpërfill mua që u plagosa nga shpata e epshit dhe jam i shtrirë, i vrarë, o e pacenuar, por shëromë me shtizën dhe gjakun e Birit tënd dhe

Perëndisë tonë, që u kryqëzua.

Ti që je pasuruar me zotërimin e gjithë Krijesës, mua që u varfërova keq më denjëso për hir të hyjshëm, që të të madhështoj ty, si mbrojtësen time të mir', o e tërëpaqortueshme.

E shenjtit I njëjti

Fjala të tregoi denjësisht theolog, duke të treguar misteret e hyjnisë së saj, o i tërëshkëlqyer, dhe duke të mësuar ekonominë e pathënshme për njeriun.

Meqë fitove mendje të perëndishme dhe trup të virgjër, u bëre tempull i gjallë,[26] frymor, o i lavdishëm, dhe banesë e Triadhës[27] së tërëhimnuar, o fort i shenjt'.

Je i nderuar me birësinë nga Virgjëresha, o i virgjër, i lumur, dhe je treguar vëlla i atij që të zgjodhi dhe të bëri nxënës theolog.

Hyjlindësore

Duke shëruar shkeljen e lashtë të Evës, Mbiperëndia banoi në ty, në të tërëpaqortueshmen dhe të Tërëshenjtën, duke më riformuar mua, tërë njeriun, që rashë.

Tjetër
Hristós mu dhínamis

Ujite me pika të Fjalës, o i lavdëruar, mbarë planetin,[28] pasi i thave besërisht ujërat e turbullta të pabesisë, prandaj të lavdërojmë.

Lutem, ngjish me fuqi dhe pushtet[29] shpirtin tim të paralizuar nga çdo lloj fatkeqësish të keqdashësve të fëlliqur, unë që përik në strehën tënde, o i tërëurtë.

Meqë u bëre tempull i Shpirtit të Shenjtë,[30] ata që gjithmonë vijnë shpesh në tempullin tënd të hyjshëm me besë, tregoji tempuj Perëndie,[26] me ndërmjetimin tënd, o Theolog.

Hyjlindësore

Le të himnojmë tempullin e hyjshëm të Perëndisë, le ta lumërojmë të gjithë[31] dukshëm Virgjëreshën e shenjtë ne, që u hyjnizuam nëpërmjet saj dhe çlirohemi nga të këqijat.

Zbritësore: Tin aneksihníaston

Të pagjurmësuarin

Ode V
E Hyjlindëses
Irmosi: Mesitis Theú

»Je bërë ndërmjetës midis Perëndisë »dhe njerëzve, o Krisht[32] Perëndi, »sepse nëpërmjet teje, o Zot, u afruam »nga nata[33] e padijes tek Ati yt i parë»ndritshëm.

Ti që linde udhën e jetës,[34] o e pacenuar, udhëhiqmë në udhë të drejtë[35] mua, që tani rrëzohem pa mend edhe në të përpjeta, edhe në gremina rëniesh të thella.

Pasi e bëra veten të huaj me mendje mosmirënjohëse ndaj Perëndisë, jetova si plangprishës duke u endur më kot në një vend të largët[36] pasionesh; por kthemë, shpëtomë me përgjërimet e tua.

Me rrëketë e tua jetëburuese vaditmë mua shërbëtorin tënd, që digjem nga flakë[25] mëkatesh dhe flakërohem nga sulmet e demonëve, o Virgjëreshë e pacenuar.

E shenjtit I njëjti

U shfaqe mendje qiellore përmes Hirit, o Theolog, duke u bërë i gjithi dritë nëpërmjet afrimit tënd me të parëndritshmin dhe duke u hyjnizuar përmes prirjes sate të fortë drejt atij.

Me mendje të pastër dhe buzë të shenjta, o i hyjfrymëzuar, dhe me gojë të tërëdëlirë, e predikove ungjillin tënd dhe ke vënë para të gjithë shpresëtarëve shpëtimin e përbashkët.

Duke banuar bashkë me Krishtin, që nga foshnjëria[37] je treguar prej tij mjet i Hirit, duke u stërvitur në theologji dhe duke njohur mistikisht lavdinë e Trinisë në mënyrë të përmbimendshme.

Hyjlindësore

Ngaqë na kujtohen fjalët e tua, të lumërojmë[31] tani ne që u pasuruam vërtet me anën tënde, o e tërëpaqortueshme, me lumërimin e pashprehur dhe jetën e pafishkur.

Tjetër
To thio fegji su agathé

Si agim shkëlqeve tek të dheshmit, duke shpallur lindjen mendore që erdhi me trup tek bota, o apostull, dhe që zgjidhi errësirën e politeizmit.

Me theologjitë e tua të shenjta vadite me bollëk çdo shpirt, o apostull predikues; prandaj të thërras: Ujit tërë zemrën time, që u bë djerr nga mëkatet.

U godita nga shigjetat e armikut; lutem, më shëro mua të gjithin, o i urtë, me mbikëqyrjen tënde dhe në udhët e Perëndisë më drejto mua,[38] që endem i humbur gjithnjë në të përpjeta.

Hyjlindësore

Kur qëndrove së bashku me nxënësin e dashur tek Kryqi i Birit tënd, o e gjithëpaqortueshme, rënkoje e përlotur dhe çuditeshe me dhembshurinë e tij të shumtë për njerëzit.

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

Të gjith' i habite ti

Ode VI
E Hyjlindëses
Irmosi: En aviso ptesmaton

»Irrethuar prej pafundësis' së thell'* »të mëkatit, th'rras pafundësinë tënde »pra* të pagjurm'suar të mir'sis';* lu»tem, nxirrmë nga prishja, o Zoti im.

Mos më shfaq mua gaz të demonëve*[39] në gjykimin që do bëhet në të ardhmen Zonj',* por lutu tek gjykatësi,* Biri yt, të më shohë me mirësi.

Me mendimet si dhe me veprimtarin'* djallëzore, të paligjshme që kam, Zot, të nxeh;* pra sjell për të të zbutur ty* nënën tënde; shpëtomë, më mëshiro.

Prej dënimit shpëtomë mua, o Zonj',* se prej shum' mëkatesh jam vetëdënuar rënd',[40] se linde ti gjykatësin,* o e famshme, pra Zotin e Gjithsësis'.

E shenjtit I njëjti

Zoti dhe Perëndia, Jisui im,* ka pranuar d'lirësinë absolute tok* me pastërtinë tënde, pra* v'lla të tij të ka bërë, o Theolog.

Meqë kurorëzove me shenjtërim* jetën tënde, k'shtu ke rën' mbi gjoksin e urt'sis'* me vet'besim dhe prej andej* nxore Hirin, o i lavdëruar fort.

Tash pishtarët e hyjshëm dhe të mëdhenj* të theologjisë sate e ndriçuan gjer'* gjith' botën, o Joan, me drit'* diellore të trefisht' shkëlqyen fort.

Hyjlindësore

Ky që qiellin shtriu[41] vullnetarisht,* tash zgjeroi tjetër qiell tokësor, pra ty,* Hyjnënën e kulluar krejt* dhe nga ti lindi si diell dhe u shfaq.

Tjetër: Tu viu tin thálasan

Vërtet me theologji* kishe gjuhën si kallam të stenografit;[21] shkruaje* bukur ligjin e ri, dijen e vërtet' në pllakat[42] e zemrave* o Joan Theolog dhe ungjillor i madh.

I fishke nga rrënja ti* bimët e besës së rrem'* si bujk i tër'shkëlqyeshëm;* pra në shpirtin tim mbill[43] frikë Perëndie, o i lëvduar fort,* që do ket' frytëdhënien e virtyteve.

Ty, bir të së Virgjërës* të ka quajtur ai që doli prej asaj; pra bashk'* me Marin' lyp që me birësim bij Perëndie të bëhemi* të gjith', duke bër' të pëlqyerat,[44] o shenjt.

Hyjlindësore

Në form' mishi[45] doli bir* nga ti, o e papik'luar, dhe u njoh nga njerëzit* Perëndi; këtij lutju gjithmon' të vrasë

mentalitetin ton'* mishor edhe shkat'rrues,[46] o e Tërëshenjt'.

Zbritësore: Tin thian taftin

Këtë të kremte

Kontaqi
Ting. II

Madhështitë e tua, o i virgjër, kush do t'i tregojë? Sepse buron çudi, gurron shërime dhe ndërmjeton për shpirtrat tanë, si theolog dhe mik i Krishtit.

Shtëpia

Është e guximshme dhe e pakapshme të mësosh lartësitë qiellore dhe të hulumtosh thellësitë e detit. Sikurse pra s'është e mundur t'i numërosh yjet dhe rërën e bregut të detit,[47] kështu nuk je i aftë dot të flasësh për Theologun; sepse me shumë kurora e kurorëzoi Krishti, të cilin e deshi dhe në kraharorin e të cilit ra dhe hëngri bashkë në darkën mistike, si theolog dhe mik i Krishtit.

Sinaksari

Më 26 të të njëjtit muaj, Shpërngulja e apostullit të shenjtë, të ungjillorit të lavdëruar, të të virgjërit, të dashurit Joan Theologut, miku që ra në kraharorin e Krishtit.

Vargje: Qëndrove pranë Fjalës së dashur të Atit,/ o i dashur, më shumë se gjithë nxënësit.
Më 26 shkoi te Perëndia fëmijë bubullime.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i të drejtit Gjedeon Gjykatësit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i një martireje të shenjtë vejushë.

Me ndërmjetimet e shenjta të Ungjillorit dhe shenjtorëve të tjerë, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
E Hyjlindëses
Irmosi: Antítheon próstagma

»**U**rdhri i një tirani të paligjshëm ku»ndër Perëndisë, fryu flakën lart; por »shtriu mbi Djemtë besnikë vesën e »Shpirtit Krishti, që është i bekuar dhe »i përmbilavdëruar.

Duke qenë, o Zonjë, fuqia ime, himnimi dhe shpëtimi i sigurt,[48] dhe përkrahja, dhe muri i paluftueshëm, lufto gjithnjë demonët që më luftojnë,[49] duke kërkuar që të më vrasin.[50]

O Virgjëreshë, hyjnizove njeriun duke trupëzuar Perëndi prej gjakut tënd virgjëror; prandaj çliromë me ndërmjetimet e tua mua, që ndotem tepër nga pasionet dhe prishem fort[51] nga tinëzitë e armikut.[52]

Furra parashfaqte lindjen tënde, o e tërëpaqortueshme, sepse nuk dogji Djemtë,[53] sikurse as mitrën tënde zjarri i pakufizueshëm; prandaj të lyp, shpëtoje shërbëtorin tënd nga zjarri i amshuar.

E shenjtit I njëjti

Duke u ndriçuar nga derdhja e hyjshme e dritës, theologove fuqishëm për Shpirtin e Shenjtë, që buron prej Atit të panisshëm dhe që prehet tek Biri, pa u larguar si i bashkësubstancshëm.

Në ty, o i lumur, vendosi tendë Dielli i drejtësisë,[54] ai që të bëri qiell lëvizës gjithmonë dhe që predikohej prej gjuhe theologu, Krishti i përmbilavdëruar, o i dashur.

Zëri i hyjnueshëm, fuqia e fjalëve të tua doli, o i tërëlumur, i admirueshëm, dhe ungjilli yt mbibotëror përqafoi tërë tokën[55] përmes madhështisë së dogmave.

Hyjlindësore

Vetëm ti tregove ngjizje të tërëpacenuar, lindje të paprishur duke mbetur e virgjër, sepse zure Perëndinë, që është mbi të gjithë, o e kulluar, i cili bëhej njeri për shpëtimin dhe çlirimin e besimtarëve.

Tjetër: Dhrosovolon men tin káminon

Le të himnojmë bubullimën që gjëmoi anembanë botës, Theologun, nëpërmjet të cilit, me të vërtetë, çdo mendje e shtangur u ngrit nga toka; dhe madhërohet Krishti, Bërësi i gjithçkaje.

Hijeshia kudo e dukshme e shtëpisë sate[56] ngazëllon çdo mendim; në të duke u mbledhur gjithmonë hyjshmërisht, himnojmë Bërësin e të gjithave dhe të lavdërojmë besërisht ty, sepse je mbrojtësi ynë.

Duke të ditur si yll ndriçues, lutemi që të ndriçohemi nga shkëlqimet e tua llamburitëse, o nxënës i Krishtit, duke u shpëtuar nga errësira e pasioneve dhe prej ngasjesh të shumëllojshme me ndërmjetimin tënd.

Hyjlindësore

Të bekojmë, o e tërëpaqortueshme, sepse linde Zotin e bekuar, i cili kurorëzoi me bekime hyjnore natyrën e mallkuar të të vdekshmëve dhe na ripërtëriti ne që u vjetëruam nga prishja.

Zbritësore: Uq elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII
E Hyjlindëses
Irmosi: Káminos poté pirós

»Një furrë zjarri dikur në Babilonë »ndante energjitë me urdhrin hyjnor, »duke i shkrumbuar kaldenjtë e duke »freskuar besnikët që psalnin: E beko- »ni Zotin gjithë veprat e Zotit.

Ki zili të mirat, duke u larguar nga të këqijat me zell për punë të hyjnueshme, o shpirti im, duke pasur Hyjnënën, mbrojtjen e paturpëruar të të gjithëve, që ndërmjeton për ty si përdëllyese dhe njeridashëse.

O Hyjlindëse, zgjidhe njeriun nga prangat e dënimit të vjetër; prandaj të lyp që të zgjidhësh çdo lidhje të së keqes[57] së zemrës sime, o e papërlyer, duke më lidhur me dashurinë e hyjnueshme të Gatuesit.

Ti që linde rrezatimin e lavdisë së Atit[57a], zemrën time të zymtë nga poshtërsi shkeljesh ngazëlloje, o Hyjlindëse, dhe tregomë pjesëmarrës lavdie të përhershme, që të të lavdëroj me besë.

E shenjtit I njëjti

Si rrufe drite që përshkon globin u duke,[58] o i lumur, duke e ndriçuar fort botën me shkëlqim dëlirësie dhe ndriçim virgjërie si dhe dogma shpresëtarie, o i dashur prej Krishtit Perëndi.

I pastruar në trup, shpirt dhe mendje,[59] ungjillëzove Ungjillin qiellor të Krishtit dhe duke jetuar bashkë me engjëjt në qiej, thërret tani: E bekoni gjithë ju veprat, Zotin.

U bëre statujë ngazëlluese, ofertë e hyjshme tempulli[60] qiellor, fron ndërgjegjësimi,[61] banesë urtësie dhe mjet theologjie duke psalur: E përmbilartësoni gjithë ju veprat, Zotin.

Që të zhdukësh mallkimin e mëparshëm dhe dënimin për vdekje të stërnënës së vjetër, ke lindur prej Hyjnëne Virgjëreshë, o Fjalë Perëndie, duke dhuruar tek të gjithë pavdekësi të paprishshme.

Tjetër
Ek flogós tis osiis

U pasurove me gjuhë oratorie, o i lumur, dhe gjallërove gjithë të vdekurit nga e keqja, të cilët pranuan predikimin tënd të hyjnueshëm; prandaj të lavdërojmë si njohës të të pathënshmeve.

Si një tjetër Parajsë na u tregua shtëpia jote e hyjshme nëpërmjet mrekullish, duke kënaqur shpirtrat e të gjithëve si me lule, o apostull, dhe duke dëbuar duhmën e pësimeve.

O Perëndi, Perëndia im, vë re[62] dhe shpëtomë nga armiqtë që më sul-

mojnë përditë, dhe dërrmojnë zemrën time të përulur,[63] duke pasur ti nxënësin tënd të hyjshëm, që të përgjërohet.

Hyjlindësore

Kërko nga Jisui Shpëtimtar, që trupëzove nga gjaku yt i kulluar, o e Hyjhirshme, që të na dhembshurojë ne, shërbëtorët e tu dhe që të na rrëmbejë nga Ferri i amshuar.

Zbritësore: Pedhas evajís

Djemat e dënuar

Ode IX
E Hyjlindëses
Irmosi: Anarhu jenítoros

»**B**ir prindi pa nisje, Perëndi dhe Zot »tek ne u shfaq* me lavdi nga e virgjëra »të ndriçojë krejt* tash të errësuarat[64] »dhe që të mbledh' të gjith'* të shpër»ndarat;[65] ndaj madhështojmë Hyjli»ndësen* e tërëhimnuar dhe me nam.

Adami shijoi ngrënie që nuk duhej dhe kështu* voli vdekje nga druri me hidhërim të thell';* por kur në një dru u gozhdua fëmija yt,* na buroi, Zonj', ëmbëlsin' e pavdekësis';* o e pacenuar, të lëvdojm'.

U bëre mbret'reshë, meqë linde mbretin, Zotin ton',* mbi logjikë, i cili shpërbëu, Zonja jon',* mbretërit' e Hadhit; k'tij lutju ti vazhdimisht,* të na denjësojë ne që të nderojm', o Vajz',* pra për mbretërin' e sipërme.

O Zonj', ji mir'bërëse për zemrën time që u ul,* që përmbytjet e epshit e keqtrajtuan shum',* se e tëra je ti e mirë, të mirin pra* linde, edhe futmë në dyer pendimi, që* jan' të mira dhe shpëtomë k'shtu.

E shenjtit I njëjti

Po je denjësuar krejt jo për enigmë, por tani* faqe për faqe[66] sheh ti përroin qiellor* të kënaqësis'[67] edhe lumin e paqes[68] bashk'* dhe burimin e pavdek'sis', nga vaditesh ti;* ndaj shijon shum' hyjnizim me gaz.

Kërkove një fron tok'sor nga Krishti,[68a] Perëndia yt,* por ai të dhuron vetë gjoksin zotëror,* mbi të cilin kur u përkule, o Theolog,* pasurove fronin e sigurt, të mir' gjithnjë,* o stolisja e apostujve.

E shove ti ateizmin e urtisë greke, the:* Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pran'* Perëndis' dhe ishte vërtet Fjala Perëndi;* nëpërmjet asaj u bën' gjithë të dukurat,* o i urt', dhe të padukurat.

Hyjlindësore

Në natën e jetës son' u gjete si mëngjes, agim,*[69] i ndriçuar me rrezet e virgjëris' përqark,* duke na zbuluar ti lindjen e diellit* të drejt'sis',[69a] i cili ësht' diell mendor plot'sisht,* o Hyjnën' e respektuar thell'.

Tjetër
Theón anthropis idhín adhínaton

Shpërblyesi, ndon'se zotëronte krejt* çdo orë si edhe çdo koh',[69b] në mesditë varej lart* mbi një dru; prandaj Marin' e virgjër gjithmon'* tek ti të virgjërin ai e besoi pra*; të ka dhën' k'shtu famë të përhershme, të të madhështojm'.

Ti je me forcat e hirshme që jan' lart* dhe bashkë me ata thërret psalmim të hyjnueshëm;* pra këta që janë në shtëpin' tënde dhe* psalin si dhe himnojn' të Tër'mirin i shpëto,* o apostull i Jisuit, përmes ndërmjetimit tënd.

Shpëtona ne që të lutemi me bes'* nga çdo rrezik, i lum Joan apostull, pra na drejto* shpirtërisht në ecjet tona drejt Perëndis'* dhe udhëhiqna nëpër udh' paqeje,[70] që jan'* udhë porosish të të Fuqishmit krejt, o Theolog.

Hyjlindësore

Le të ofrojmë një zë mir'njohjeje* ne madhërisht te nëna e Jisuit, e Perëndis',* të thërrasim: G'zohu ti, o fron shum' i lart'*[71] i Perëndisë, g'zohu, re drite,[6] g'zohu ti,* o parajsë; se na denjësove për Parajs', shijim.

Zbritësore: Apas jijenís

Gjithë njerëzit

Dërgimësore
Jinekes akutísthite

Je bër' bir bubullime ti;* tek ne theologove qart',* se në fillim ishte Fjala,* Joan apostull, se ke rën'* me bes' mbi gjoksin zotëror;* nga atje nxore çurka* theologjie dhe me k'to* vadit Krijesën e tërë*[28] për njohjen që sjell shpëtimin.

Kryqhyjlindësore

Qëndroje pranë Kryqit ti* të Zotit tënd, o e tër'd'lir',* bashk' me Joanin e virgjër,* dhe Bërësin e dëgjove:* Grua, ja biri yt ky ësht'.* Pastaj k'shtu' tha te nxënësi:* Ja nëna jote ësht' ajo.* Dhe tok me shenjtin të gjithë* të përhimnojm', Virgjëreshë.

Lavdërime
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

O Joan i gjithëurt', i lum, meqen'se kishe bollëk* dashurie për Krishtin tënd,* më shum' se gjith' nxënësit*

ti u deshe, madje shum' fort* nga Fjala tërëshikuese sakt'sisht,* që gjith' planetin gjykon me drejtësi,* se u ndriçove plot* si në trup edhe në shpirt me pastërti,* bukuri dëlirësie, o i lumur shenjt.

Nxore çurkat e theologjisë, ndërsa kishe rën' ti* përmbi gjoksin e urtësis',* dhe vadite botën[28] krejt,* o Joan i shkëlqyeshëm,* me diturin' e Trinis', kur thave krejt* detin e pabesis' dhe u bëre shtyll'* dhe re frymore bashk',* që drejton[6] të gjithë ne në trashëgim* qiellor të Mbretëris' së Perëndisë ton'.

Le ta përhimnojmë ne me këngë shpirtërore tani* shërbëtorin e Krishtit ton',* pra Joanin, se ka qen'* lulëzimi i virgjëris',* si dhe banesë mikpritëse e mir'* dhe e nderuar virtytesh, gjithashtu* vegla e urtësis',* tempulli i Shpirtit,[30] goja me shkëlqim,* hir edhe sy plot me drit' i Kishës së Zotit.

Nëpër botë ti ndriçove kur ungjillëzove, o bir* bubullime, o ungjillor,* i mahnitshëm, mbretërin'* e patundshme,[72] burimin pra* të çdo të mire, jetën që nuk shteron* dhe ngazëllimin që s'shprehet dot,[73] edhe* shijimin qiellor* e të hyjshëm, dhe dhuntit' e Krishtit Zot* me bollëk, që tejkalojn' mendimin njerëzor.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

O ungjillor Joan, i barabartë me engjëjt, o i virgjër, Theolog i hyjmësuar, e shpalle orthodhoksisht te bota brinjën e pacenuar, që buronte gjak dhe ujë, brenda të cilit pasurojmë shpirtrat tanë me jetën e amshuar.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanunet, Odet III dhe VI.

Kungatore: Në gjithë dheun.

CITIME

[1] Ps. 51(52).10

[2] Joan 4.36

[3] Jehona e Këngës

[4] Hebr. 8.5; 10.1

[5] Eks. 3.2-5

[6] Eks. 13.21

[7] Joan 7.38

[8] Joan 21.22

[8a] Fil. 2.7

[9] Joan 1.4; 8.12

[10] Ps. 111(112).4; Is. 42.16

[11] Rom. 13.14; Gal. 3.27

[12] Vep. 8.21

[13] I Kor. 1.30

[14] Kënga 4.7

[15] Ps. 44(45).10

[16] Matth. 25.31-33

[17] Ps. 64(65).11

[18] Matth. 4.22; Mark. 1.20

[19] Kënga 1.8; 5.9,17 (6.1)

[20] Apok. 20.2

[21] Ps. 44(45).2

[22] Rom. 11.33

[23] II Kor. 5.14

[24] Lluk. 5.9-11

[25] Lluk. 16.24

[26] I Kor. 3.16; 6.19; II Kor. 6.16

[27] Joan 14.23

[28] Gjen. 2.6

[29] I Mbret. [Sam] 2.4; Ps. 17(18).33

[30] I Kor. 3.16; 6.19

[31] Lluk. 1.48

[32] I Tim. 2.5

[33] Is. 26.9

[34] Joan 14.6

[35] Ps. 106(107).7

[36] Lluk. 15.13

[37] II Tim. 3.15

[38] Ps. 5.9

[39] Sirak 18.31

[40] Tit. 3.11

[41] Ps. 103(104).2

[42] Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10

[43] Jer. 1.10

[44] Hebr. 13.21

[45] Fil. 2.7

[46] Rom. 8.6

[47] Gjen. 13.16; 22.17

[48] Ps. 117(118).14

[49] Ps. 34(35).1

[50] Ps. 36(37).32

[51] Ef. 4.22

[52] Ef. 6.11

[53] Dan. kap. 3

[54] Ps. 18(19).6; Mal. 4.2

[55] Ps. 18(19).5

[56] Ps. 25(26).8

[57] Is. 58.6

[57a] Hebr. 1.3

[58] Matth. 24.27; Lluk. 17.24

[59] II Kor. 7.1

[60] Ps. 143(144).12

[61] Fja. Urt. 12.23

[62] Ps. 21(22).2

[63] Ps. 9.14

[64] Is. 9.2; 42.16

[65] Is. 56.8

[66] Eks. 33.11; I Kor. 13.12

[67] Ps. 35(36).9

[68] Is. 48.18

[68a] Mal. 4.2(3.20)

[68b] Matth. 20.21; Mark. 10.37

[69] Kënga 6.10(9)

[69a] Vep. 17.26

[70] Lluk. 1.79

[71] Is. 6.1; Jez. 1.4-26; Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 32

[72] Hebr. 12.28

[73] I Petr. 1.8

MË 29 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtim i atit tonë oshënar Qiriako Anakoretit.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime: 3 të Oktoihut dhe 3 të shenjtit:

Ting. Tërth. IV
Ti imás kalésomen

Kur ti triumfove mbi çdo pasion,* vet'përmbajtjen kishe fre, e veshe trupin me stoli* të shkëlqyer o Qirjako,* çudibërës me shum' fam',* dhe zhveshe dinak'rin e atij, që më par'* i zhveshi krejt stëretërit qëmoti pra;* tani banon në Parajsë lart,* dëfren përherë atje me gaz;* për ne lutu* të shpëtohen shpirtrat tan', o at'.

Duke mbajtur kryqin mbi supin tënd,* ndoqe Krishtin[1] me urti, vendim që s'kishte kthim aspak,* o Qirjako, i shpërfille* kënaq'sit' e jetës krejt,* pasione trupi me kreshmim i vrave ti* si dhe me agripni dhe lutje vazhdimisht;* ndaj Hirin k'shtu e fitove plot,* sëmundje pra mrekullisht shëron;* për ne lutu* të shpëtohen shpirtrat tan', o at'.

O osh'nar, banove në shkretëtir';* kishe për ushqim një bim' të hidhur o Qirjako, at';* trupin pra e hidhërove;* i çrrënjose kënaq'sit'* e mishit, o i lumur, dhe i preve k'to;* prandaj të priti ty shijimi qiellor,* kur fjete ti në mosh' shum' të gjat'* pas një jete engjëllore[2] krejt;* për ne lutu* të shpëtohen shpirtrat tan', o shenjt.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Turmat e murgjëve të nderojnë ty, profesorin, o Qirjako, ati ynë, sepse nëpërmjet teje ne mësuam të ecim në udhë vërtet të drejtë;[3] i lum je, se i shërbeve Krishtit dhe triumfove mbi fuqinë e armikut[3a], o shok engjëjsh, që banon në të njëjtën tendë me oshënarë dhe të drejtë; tok me ta ndërmjeto te Zoti që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Ti imás kalésomen

Kush përiku nën strehën tënde, Zonj'* e panusëruar, e gjithmonëvirgjër dhe e d'lir',* dhe nuk merr çlirim të shpejtë* nga shtrëngimi, edhe kush* s'të ka ty ndihmë të paturpëruar krejt* dhe mbrojtje, edhe kullë që nuk çahet dot?* Ti ndërmjeto, o Hyjlindëse* e panjollshme dhe përkrahja jon',* që të shpëtojn'* shpirtrat e gjith' të krishterëve.

ose Kryqhyjlindësore

Qengjin që e lindi delja e pa,* e pa Birin e vet të gozhduar sipër Kryqit keq;* atëherë u plagos thell'* nga një shpatë shpirtërisht.*[4] I therte shpirti fort, thurte vajtime plot;* i mbushnin zemrën pikëllimet, vuajtjet.* Thërriste: Mjer' un' Zot, Biri im,* si, o zemërgjer', pëson këto;* lëvdoj tek ti* zemërgjerësinë për të gjith'.

Pasvargje të Oktoihut

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O atë oshënar, në gjithë tokën doli zëri[5] i arritjeve të tua, prandaj në qiejt gjete shpërblim[6] për lodhjet e tua; asgjësove batalionet e demonëve, arrite brigadat e engjëjve, jetën e të cilëve e kishe zili në mënyrë të paqortueshme; duke pasur guxim ndaj Zotit, kërko paqe për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Triímeros anestis

Shkaktare për dhunti të mëdha* u bë pik'risht për ne të gjith'* lindja pa burr* e së Virgjërës Mari,* se Zoti yn' natyrën e prishur njerëzore* e përtërit, na rigatuan prap'.

ose Kryqhyjlindësore

O Krisht, kur të shikonte mbi kryq* të kryqëzoheshe ajo* që të lindi,* po thërriste: Biri im,* ç'ësht' ky mister i huaj që shoh? Si vdes në mish ti* mbi dru i varur, o jet'dhënës Zot?

Përlëshore

Ting. I Tis erimu politis

Qytetar shkretëtire dhe një engjëll me trup ke qën'* dhe mrekullibërës u shfaqe ati yn' hyjmbajtës Qirjako;* me kreshmë, agripni dhe lutje ti* dhuntitë qiellore i ke marr';* të sëmurët i shëron mir' dhe shpirtrat e atyre që vrapojn' tek ti;* lavde atij që të ka dhën' fuqi,* lavde atij që të ka vën' kuror',* lavde atij që bën shërime tek të gjith' përmes teje.#

Kjo është një nga përlëshoret që përdoret për oshënarë (burra).

Tjetër: Tahí prokatálave

Endoqe ti Krishtin Zot, pasi braktise çdo gjë* tok'sore dhe krejt jet' barasengjëllore jetove, o at', si i patrup,* se nëpër shkretëtirë* nga dëshira e hyjshme* futeshe dhe me bim' të hidhur zmbrapsje shijimin* e vjetër, e hidhur, o Qirjako, me shumë nam.

NË MËNGJESORE

Stihologjia e zakonshme dhe Kanunet, dy të Oktoihut dhe të shenjtit, që ka Akrostihidhë (pa Hyjlindësore): "O Qirjako, bëhu për mua mbrojtës para Perëndisë". Poezi e Stefan savaitit (sipas të tjerëve e Theofanit).

Ode I
Ting. Tërth. IV
Asma anapémpsomen laí

Jep tek un', o Krisht, ndriçim dhe njohuri të hyjshme edhe hir,* që ta himnoj Qirjakon oshënar siç duhet;* me lutjet e tij m'i jep,* se ti je arkëtari* i doktrinës së urt' përmbi mendje.

O Qirjako, prite dashamirësisht himnimin tim tani* dhe lutju Krishtit tonë të marr pjes' un' në lavd* të hyjshëm dhe qiellor* dhe në shkëlqim të lumur,* të arrij në shpëtim të vërtetë.

Duke u forcuar prej fuqis' së madhe të Jisuit Zot,* ti mposhte, o Qirjako, o i lumur, krerë* err'sire[7] me shum' triumf;* ndoqe dhe gjurmët e tij,*[8] k'shtu arrite në prehje të lartë.

Ke treguar konkurrenc' të barabart' me engjëjt' përmbi dhé,* pasi nënshtrove ti mentalitetin mishor*[9] tek Shpirti jet'prurës krejt,* pra, o hyjprurës, tashmë* me ata po kërcen nëpër qiej.

Hyjlindësore

Ti u duke shkall' mendore, që ka par' Jakovi patriark,*[10] i zgjedhur krejt prej Zotit, shkall' nga zbriti me fjal'* që s'thuhen ai që s'kish* mish, se deshte të bëhej* mish[11] mbi mendje nga ti, o Hyjlind'se.

Ode III
Uq estin ájios os o Kírios

Kalove jetën pa dembelizëm, ti* se nga foshnjë[12] deshe fort Zotin, o oshënar;* e kërkoje me etjen që ka sorkadhja, kur në burim vrapon.[13]

Zbatove urdhërat që u shkruan qart'* me një gisht të Zotit në pllakat[14] e shpirtit tënd;* ishe libër i gjall' porosish hyjnore, o i mahnitshëm ti.

Me kreshmë mbajte gryk'sin' e barkut tënd,* vrave edhe epshet, që jan' nën bark, ti o shenjt;* me d'lir'sin' bashk'jetove në jetë, o sundimtar pasionesh, at'.

Me gaz u bëre një tempull i Trinis',*[15] sepse ti pastrove krejt mendje, trup edhe shpirt;*[16] k'shtu u bëre një en' drite diellore e trefisht', o i lum.

Hyjlindësore

Mari Hyjlind'se, e virgjër linde ti* pa

përvojë dasme dhe mbete e virgjër prap',* nën' e panusëruar; pra lutju Krishtit që të shpëtohemi.

Irmosi: Uq estin ájios os o Kírios

»S'ka tjetër t' shenjtë si është Zoti »yn'* dhe nuk ka të drejtë si ësht' »Perëndia yn'.*[16a] K'të himnon çdo »krijesë. S'ka asnjë shenjt tjetër »përveç teje, Zot.

Ndenjësore Ting. IV
Tahí prokatálave

Meqë dëshiroje ti jetën e sipërme,[17] at',* dhe mbitokësore, lë çdo gaz të botës, se ikën, o oshënari yn';* pra nëpër shkretëtirë* dhe në shpellë[18] banove;* u duke qytetar i një qyteti qiellor[19] lart;* atje duke qenë, na kujto ne që të kremtojm'.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Eripërtërite, Zonj', me lindjen tënde të shenjt'* substancën e vdekshme krejt të të dhélindurve, që u prish në pasione keq;* na ngrite ne prej vdekjes* për një jet' të paprishshme;* pra ty të lumërojm', siç të ka hije të gjith' ne,* sipas profecisë sate, o Virgjëresh'[20] me nam.

ose Kryqhyjlindësore

O nënë e Zotit tonë, Krishtit, o Virgjëresh',* një shpat' e kaloi shpirtin tënd[4] të tër'shenjt', kur pe tët Bir edhe Perëndin'* të kryqëzohej mbi dru* me vullnetin e tij krejt;* o e bekuar, mos pusho së luturi atë,* që të na dhurojë ndjesë, o e panjollëshme.

Ode IV
Si mu iskís Kírie

Ufrikësua dielli për vetëpërmbajtjen dhe qëndrueshmërinë tënde, se për vite të tëra nuk mundi të të shikojë të inatosesh ndonjëherë dhe as të hash ushqim gjatë ditës, o oshënar, që këndoje plot me gjallëri në agripni pa mbarim: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

Duke studiuar në ligjet e Dhiatës së Re dhe të Vjetër[21] me mençurinë e burrave të shenjtë, o i urtë, i lumur, thithje çdo lloj virtyti, duke e pasur zili mënyrën e bletës së urtë,[21a] dhe pasi u bëre enë e zgjedhur,[22] thërrisje: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

O Krisht Perëndi, u bëre thesar kënaqësie, mburrje dhe ngazëllim i oshënarëve;[23] prandaj duke të dëshiruar Qirjakoja në mënyrë të zjarrtë, të gjitha gjërat e pëlqyeshme në botë i llogariti si mbeturina;[24] pra edhe në shkretëtira të pashkelura kënaqej, si një i dashuruar pas bukurisë sate.[25]

Dimë se dikur profeti ëmbëlsoi çurkat e Merasë,[26] por ti, o Qirjako, duke ndryshuar ushqimin e hidhur të bimës në shije të ëmbël, shfaqe qartësisht guximin tënd drejt Zotit, i cili vërtet lavdëron shërbyesit e tij me pushtet të hyjshëm.

Ti, nxënësi dhe imituesi i Krishtit Zot, shëron për hir të dhembshurisë me anë të lutjes birin e atij që u lut tek ti, i cili vuante nga epilepsia, pasi pranove për këtë arsye hirin për të dëbuar sëmundjet dhe për të larguar fuqishëm hordhitë e demonëve[27] me shenjën e Kryqit të shenjtë.

Hyjlindësore

Ti je krenaria e besnikëve, o e panusëruar, je mbrojtje, je edhe strehë të krishterësh, mur dhe liman, sepse sjell lutje te Biri yt, o e tërëpapërlyer, dhe shpëton nga rreziqe ata që me besë dhe dëshirë nga zemra të njohin si Hyjlindëse të kulluar.

Ode V
Ina ti me aposo

Pasi prite nga Krishti Hirin e pamposhtur të Shpirtit, nga një anë ke rrëzuar me forcë sunduesin[7] e tmerrshëm të botës, nga ana tjetër duke fituar pasione shpirtërore, o Qirjako, u kurorëzove shkëlqyeshëm me kurorën e papasionshmërisë.

U tregove i fuqishëm, duke duruar lodhjet e asketizmit me qëndrueshmëri, duke mbetur i paepur deri në pleqëri shumë të thyer, o oshënar, duke jetuar me shumë hare në shkretëtira, njësoj si në dhoma oborresh mbretërore.

Duke bërë, o i lumur, agripni tërë natën, duke u shpërngulur te Perëndia,[28] pa u shpërqëndruar, nëpërmjet lutjes flisje me Mendjen jolëndore dhe prite rreze të shkëlqyeshme, dritëdhënëse, o Qirjako, duke u ndriçuar në mendje.

Gjuha jote e respektuar, pasi u mbush me fjalë dritëprurëse profetike, paratha rrëzimin absolut dhe të plotë të sëmundjes paranojake dhe shpirtprishëse të Origjenit, e cila tiranizonte dikur.

Hyjlindësore

Shoqëria e profetëve i njohu mendërisht misteret e tua, sepse Zoti të tregoi portë qielli,[29] o e pacenuar, dhe duke u mishëruar prej teje, o Virgjëreshë, lindi diell drejtësie[29a] tek ata që ishin në errësirë.

Ode VI
Ilásthití mi Sotír

U bëre ti perëndi* pra me adoptim dhe hyjnizim* të Krishtit, që me natyr'* është' Zot; ndreqe cene shum' të dhimbshme natyre, at'* dhe me forc' largoje* mjaft demonët dhe sëmundjet[27] shpesh.

Eshmange pra çdo nderim* dhe lavdërim bosh njer'zor, të keq* dhe në përrenj të frikshëm* prap' shkove, sepse nga shqetësimi largoheshe* që turmat shkaktonin,* kur drejt teje vinin k'to, o at'.

Si ëndërr që prishet keq* shikoje lavdin e botës tër',* deshe kështu, o i urt',* të bëhesh pjes'marrës i lavdisë së mir' përher',* pra i ligjit zot'ror;* dhe u denjësove për këtë.

Hyjlindësore

E prite si ark' e gjall'*[30] ti Fjalën që s'ka fillim; porsi* altar i shenjt' e ke nxën'* Krijuesin; dhe si fron në form' zjarri ti e mban* Zotin,[31] o Hyjnënë,* o Mari, e Gjithësis' së tër'.

Irmosi: Ilásthití mi Sotír

»**M**ëkatet që kam jan' shum',* ndaj »le të të vijë keq, o Zot,* për mua; »lutem, më nxirr* nga fundi i vrereve, »sepse thirra fort tek ti* dhe dëgjomë »mua,* Perëndia i shpëtimit tim.

Kontaqi
Ting. Tërth. IV
Ti ipermaho

Ti luftëtar je,* dhe përkrahës i fuqishëm krejt;* pra lavra e shenjt'* të nderon gjithnjë dhe e kremton* në çdo vit kujtimin tënd; por meqen'se ke ti* para Zotit ton' Krisht, mbrona prej armiqve ne,* se sulmojnë kundër nesh dhe na shpëto, të gjith'* të thërresim k'shtu:* G'zohu, o i tër'pasur at'.

Sinaksari

Më 29 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë oshënar Qirjako Anakoretit.
Vargje: Me hidhërimin e bimës së hidhur zmbraps shijimin e ëmbël,[32]/ përmes të cilit u dënove të vdesësh.
Më 29, Qirjakoja, ngrënësi i hidhërimit u varros.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i njëqind e pesëdhjetë martirëve të shenjtë në Palestinë; dhe i martirëve të shenjtë Trifonit, Trofimit dhe Dhorimedhonit; dhe i martires së shenjtë Petronias.
Vargje: Pasi përkule kryen te shpata, o Petronia,/ mbështet syrin e shpirtit tek guri[33] i hyjshëm.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së shenjtë Gudhelias.
Vargje: Tek ti, kreu i të gjithëve, o Krisht,/ e solli Gudhelia kryen me anë të shpatës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Kasdhout dhe Kosdhoas.
Vargje: Atletizojnë me dy mënyra Kasdhou dhe Kasdhoa,/ i pari duke u goditur me shpatë, e dyta duke u dërrmuar me dru.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Dhadhit dhe Govdhelaut, bir i Saporit, mbret i persianëve.
Vargje: I prerë copë-copë me shpatë në gjithë trupin,/ shpëton shpirtin, o Dhadh, o martir i të Shumëlartit.
Govdhelau ngulet në kallama,/ sepse respekton Krishtin që u godit me kallam.

Martirja e shenjtë Petronia, mbaron me shpatë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Pedhes Evreon

Me studim ligjesh dhe fjalësh të hyjfrymëzuara,[21] e ëmbëlsoi laringun më shumë se mjalti[34] shërbëtori yt tepër besnik duke kënduar: I bekuar je, o Zot, përjetë.

O i lumur, i hyjfrymëzuar, me ndërmjetimet e tua le t'i blatosh Perëndisë ata që të himnojnë, tashmë të pastruar nga balta e pasioneve, dhe që thërrasin: I bekuar je, o Zot, Perëndi, përjetë.

O Krisht, Qirjakoja e priti brenda tij përgjithmonë tërë Hirin e Shpirtit, sepse ishte i dashuruar me gjithë shpirt me dritën tënde të pashprehshme, duke thirrur: O Perëndi, je i bekuar.

Danieli u lavdërua kur u arratis nga ashpërsia e luanëve, ndërsa Qirjakoja i urdhëronte dhe i përdorte ata si shërbëtorë duke thirrur: O Perëndi, je i bekuar.

Duke i shtuar praktikës teorinë, e shpalle trihipostate substancën, në Atin dhe Birin dhe Shpirtin, o Qirjako perëndimarrës, duke thirrur: O Perëndi, je i bekuar.

Hyjlindësore

Shuaje flakën e pasioneve të mia dhe qetësoje turbullirën e herezive, o Hyjnënë, sepse ty të kemi mbrojtëse dhe pararojë ne të krishterët dhe të përhimnojmë me besë.

Ode VIII
Niqité tiranu qe flogós

Me rrëketë e lotëve vadite me kataniks të hyjnueshëm shpirtin tënd të shenjtë, o i lumur, dhe e tregove tepër frytdhënës, duke kënduar: Të gjithë ju vepra, bekoni Zotin dhe e përmbilartësoni në jetët.

Qëmoti Thesviti me thatësirë thau

plotësisht pika shirash,[35] ndërsa ti zbret reshje shiu në piskun e verës, o i lumur, duke kënduar: Bekoni ju vepra Zotin dhe e përmbilartësoni në jetët.

Ti kritikove me përpjekje burrërore mashtrimin e nxënësve besëkeq të Origjenit llafazan dhe përrallëtar, duke kënduar besërisht: Bekoni Zotin e gjithë Krijesa dhe e përmbilartësoni në jetët.

Me shumë shpresëtari na e mësove, o atë, substancën e Trinisë, pikërisht si një lavdi dhe shkëlqim në tre diej, duke thënë besërisht: Bekoni Zotin e gjithë Krijesa dhe e përmbilartësoni në jetët.

Hyjlindësore

Nga një anë u duke, o Hyjlindëse, bija e Adamit të rënë; nga ana tjetër nënë e Perëndisë, që më përtëriti substancën; atë e himnojmë gjithë ne veprat si Zot dhe e përmbilartësojmë në jetët.

Irmosi: Nikité tiranu qe flogós

»Mundën një tiran dhe flak' me hirin »tënd Tre Djemtë, që me forcë* mbanin »porosit' e tua shpres'tarisht dhe me »zemër thërrisnin:* E bekoni Zotin »gjith' veprat, e mbilartësoni k'të.

Ode IX

Éfrikse pasa akoí

Shpella të priti, o i urt',* ty që prite një burim që dha Zoti, kur bëri çudi ati* i shenjt' Hariton si Moisiu,[36] o Qirjako, edhe je bër' porsi mur i patundshëm, rojë krejt i sigurt pra* ti për grigjën e tij, ndaj qethe shumë murgj.

Ngrite mbi supe kryqin tënd,*[1] sepse kishe dashurinë për jetën e vërtet', e bëre pra* ti jetën si studim vdekjeje, Qirjako, ndaj tani që u shpërngule në kënaq'sin' pa cen, që nuk njeh mpakje kurr',* po kërcen me engjëjt rreth Perëndis' në drit'.

Shndrite i flakëruar ti* prej lavdis' së Shpirtit, prandaj u duke te koret e sipërme* i ngazëlluar; por mendjen time e ndriço ti, o i lum, me drit' mendore, të tër'shkëlqyer të hyjnisë dhe* më shpëto me lutjen tënde nga çdo mëkat.

Pran' Perëndis' që është lart,* o Qirjako dhe Hariton i lumur, të hyjfrymëzuar bashk'* qëndroni[37] me kurora fitoreje mbi kryet; dhe tani mbik'qyrni ju grigjën tuaj, që ua kremton me gaz* plot kujtimin tuaj, na nxirrni nga fajet.

Hyjlindësore

Përpara bëj me çdo sukses,* mbretëro,[38] o bir hyjnëne, dhe mposhte një popull ismailit*[39] që na lufton nën mbretin që do Jisun', me ndërmjetimet e asaj e cila të lindi pa përvojë burri kurr',* ne të lutemi, se je Perëndi i mir'.

Irmosi: Éfrikse pasa akoí

»Frika ka zënë çdo dëgjim* nga »denjimi i pashprehshëm i Zotit ton'; »pra si i Shum'larti* vullnetarisht »ësht' ulur në trup, pasi u bë njeri prej »barku virgjëror dhe të papik'luar; pra »Hyjlindësen* e panjollshme, ne bes»nikët e madhërojm'.

Dërgimësore
Jinekes akutísthite

Me shum' lavdi qëndron ti pran'* të tër'fuqishmit Perëndi*[37] me Haritonin e hyjshëm,* Qirjako hyjpredikues;* ndaj, o i shenjt', kujtona ne,* që kujtimin tënd plot me drit'* po e kremtojm' dhe të nderojm'* me një dëshirë të madhe* si shërbëtor, at', të Krishtit.

Hyjlindësore

Pohojmë se je kryesisht* Hyjlindëse, o Zonja jon',* ne që me ty u shpëtuam,* se linde pashprehshëm Zotin;* ky e shfarosi vdekjen krejt* përmes Kryqit të tij të shenjt'* edhe tërhoqi drejt atij* çdo shoqëri oshënarësh;*[40] bashkë me ta të lëvdojmë.

Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

[1] Matth. 16.24; Mark. 8.34; Lluk. 9.23

[2] Matth. 22.30; Mark. 12.25; Lluk. 20.35

[3] Is. 40.3 ; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23; Vep. 13.10

[3a] Kol. 2.15

[4] Lluk. 2.35

[5] Ps. 18(19).5

[6] Matth. 5.12; Lluk. 6.23,35

[7] Ef. 6.12

[8] I Petr. 2.21

[9] Rom. 8.6-7

[10] Gjen. 28.12

[11] Joan 1.14

[12] II Tim. 3.15

[13] Ps. 41(42).2

[14] Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10

[15] Joan 14.23

[16] II Kor. 7.1

[16a] I Mbret. [Sam.] 2.2

[17] Kol. 3.2

[18] Hebr. 11.38

[19] Hebr. 13.14

[20] Lluk. 1.48

[21] Ps. 1.2; 118(119).24,77,92,97,99, 143,174

[21a] Fjal. Urt. 6.8a-c

[22] Vep. 9.15

[23] Ps. 131(132).9

[24] Fil. 3.8

[25] Jehona e Këngës

[26] Eks. 15.23-25

[27] Matth. 10.8

[28] II Kor. 5.8

[29] Gjen. 28.17

[29a] Mal. 4.2(3.20)

[30] Eks. 25.9-20; 38.1(37.1)

[31] Jez. 1.13-26; 10.1-2; Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 32

[32] Gjen. 3.6

[33] Matth. 7.24; Lluk. 6.48

[34] Ps. 18(19).11

[35] III [I] Mbret. 17.1-7

[36] Eks. 17.6

[37] Lluk. 1.19

[38] Ps. 44(45).5

[39] Gjen. 21.9-13

[40] Ps. 49(50).5



MUAJI TETOR

QË KA 31 DITË

3 TETOR

Kujtim i hieromartirit të shenjtë Dhionis Areopajitit.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime:
3 të Oktoihut dhe 3 të shenjtit:

Ting. I
Panéfimi mártires

Në grepin e Hirit urtësisht* Pavli i hyjnueshëm,* kur ligjëroi[1] të kapi ty që di mistere shum';* të kish bër' shikues* të sekreteve, sepse të pa si en' të zgjedhur;[2] me të bashk' lutu, o Dhionis i shenjt'* dhe hyjfolës, të shpëtohemi* ne që të himnojmë me dëshir' të zjarrt'.

Dhionis, bëre mendjen tënde ti* nëpërmjet virtytit tënd* të barabart' me të engjëjve; rrëfeve, o i urt',* nëpër libra të shenjt'* rregullin e mirë mbitok'sor; sipas atij sistemove edhe rendet e Kishës* duke imituar qiellin,* domethën' hierarkin' e engjëjve.

Dhionis, nëpërmjet filozofis'* i përngjave, o i lum,* sa ësht' e mundur për njerëzit, ti Perëndisë tënd* dhe e shfaqe me bes'* mistikisht përmbajtjen e hyjnueshme të emrave tepër të shenjt' bashk' me kombinim* shum' të mir; dhe dijen mbi logjik'* e mësove dhe tek bota e mëson.

Lavdi *Ting. II*

I Andrea Jerusalemasit. Sipas të tjerëve i Bizantit.

Ejani, o besnikë, që të lavdërojmë me një zë kujtimin e përvitshëm të hierarkëve Dhionis dhe Qiprian, sepse

i pari, pasi neveriti filozofët stoikë dhe mësoi pranë enës së zgjedhur,[2] u bë njohës i mistereve të pathëna; tjetri, pasi u ndriçua në mendje nëpërmjet të virgjërës së tërëbukur Justina, u arratis nga mashtrimi i demonëve dhe kur shfarosi me zjarr librat e magjisë,[3] u bë predikues i Ungjillit; prandaj dhe ne mëkatarët, duke lavdëruar Shpëtimtarin, i cili i lavdëroi, le të thërrasim: O Krisht Perëndi, që i kurorëzove me lavdi athloforët e tu, me përgjërimet e tyre, shpëto shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Ote ek tu ksilu

G'zohu,* çdo krijesë po thërret* tek ti, o Hyjlind'se e virgjër dhe skeptër krejt davidian;* g'zohu ti, që nxore vilen, rrushin mistik pra;* g'zohu, port' qiellore,[4] ferr' e padjegur fare;*[5] g'zohu, drit' mbar'botërore; g'zohu, ngazëllim* për të gjithë; g'zohu, lavdia* e apostujve; g'zohu, ndihmë;* g'zohu, mbrojtje për ata që të lëvdojn'.

ose Kryqhyjlindësore

Kur pa* shqerra e panjollëshme* të zvarritej qengji i saj për në therje, vajtonte thell'* dhe me klithma therrëse thërriste: O im bir* shum' i ëmbël, ç'shpërblim të dha populli buk'shkalë,* që shijoi, ah, shumic' dhuratash prej teje;* si pra ta duroj unë dhimbjen,* se të gjitha k'to i pëson ti* me vullnetin tënd tani, o biri im.

Pasvargje të Oktoihut

Lavdi *Ting. IV*

Le të të quajmë thellësi që nuk shikohet e dijes qiellore,[6] o martir i Krishtit, fort i ndritshëm; sepse të përhimnojmë, o i urt', si ushtar dhe përluftar të fortë të Kishës, se pasi shkëlqeve me zjarr shumë të pastër, u denjësove së bashku me rreshtat ushtarake të sipërme të vishesh me rrobë të ndritshme, me Krishtin,[7] dhe të shkëlqesh në mendje me lavdinë e Shpirtit, o Dhionis; prandaj, duke bërë panair për kujtimin tënd mbarëbotëror, lavdërojmë besërisht Zotin, i cili të lavdëroi.

Tani *Hyjlindësore*

Os jeneon en mártisin

Nga çdo dhimbje dhe çdo lëngim* i shum'llojshëm, nga çdo shtrëngim* dhe nga çdo e keqe, edhe nga çdo ngacmim* prej gjithë anësh si dhe nga çdo skandal që i dhimbshëm ësht',* edhe vjen nga njerëzit* që urrejtje ndaj meje kan'* me demonët bashk',* dhe kërkojn' çdo dit' shkatërrimin tim, o Zonj', çliromë mua, ty të kam mbrojtje, me ndërmjetimin tënd.

ose Kryqhyjlindësore

Kur të pa përmbi Kryqin ty* nëna jote e virgjër, Zot,* pra të varesh thoshte duke vajtuar keq* me zi e klithma: Ata që kan' shijuar dhurata plot* nga ti, çfar' shpërblimi dhan'* tek ti, o Perëndia im;* por të lutem shum':* Mos më lër mua vetëm në k'të botë, por nxito të ngjallesh, duke bashk'ngjallur dhe paraetërit.

Përlëshore
Ting. IV

Pasi mësove mirësinë dhe ishe me gatishmëri në të gjitha, duke veshur ndërgjegje të mirë,[8] të denjë për një prift, nxore nga ena e zgjedhur[2] misteret e pathënshme; dhe pasi ruajte besimin, ke bërë udhën[9] e drejtë,[10] o hieromartir Dhionis; ndërmjeto tek Krishti Perëndi, që të shpëtohen shpirtrat anë.#

Kjo është një nga përlëshoret që përdoret për hieromartirët.

Tjetër
Ting Tërth. I
Ton sinánarhon Logon

Predikimi i Pavlit të kapi ty si gjah* dhe u dëfteve mësues dhuratash mbi çdo logjik'* me një mendje shum' të lart', të zbukuruar, at';* se na mëson misteret ti,* kryetarët e substancave jolëndore, se ti* njeh të fshehtat, je dhe tregues i urtësis', Dhionis, martir episkop.

NË MËNGJESORE

Stihologjia e zakonshme dhe Kanunet e Oktoihut dhe të shenjtit, që ka Akrostihidhë: «Lavdëroj mendjen e mësimeve të urta».

Poezi e Theofanit

Ode I
Ting. Tërth. IV
Igrán dhiodhefsas

Mësove pran' Pavlit të hyjshëm krejt,* që ka qen' shikues qiellоresh;[11] u bëre pra* menjëherë njohës qiellor ti,* njohës misteresh, hyjfolës, o at', Dhionis.

Undrite prej Hirit Hyjnor, të Shenjt';* na ndrit shpirtrat tanë, o i lum, ne që të himnojm'* pra, për të kuptuar mësimdhëniet* e tua plot hyjfrym'zim, o Dhionis i shenjt'.

I pastër në mendje ishe në shpirt;* pra u denjësove të mësosh shndritje, rrezatim* zbukurimesh qiellore dhe pe* koret e engjëjve o ati yn' Dhionis.

Hyjlindësore

U duke, hyjnën', nusërore ti,* dritëprurëse e mishërimit mbi çdo koncept* të Krijuesit të gjith' Krijesës,* i cili veshi nga ti mishin ton', o Zonj'.

Ode III
Uranias apsidhos

Mbi apsidën e qiellit ti u ngrite, o at';* edhe deklarove tek ne të gjithë përmes urt'sis'* së shenjt' të fjalës sate* të shumëlartë, të hyjshme,* rendet dhe ushtrit' mbibot'rore të ndritëshme.

Meqë ishe përbrenda një teorie të lart',* na theologove thell' gjith' zhvillimin e emrave* të hyjshëm; dhe je bër' ti* një theolog triadik pra* përmes Hirit, o i lëvduar, i lumur shenjt.

Pasi intensivisht ishe i stërvitur, o at',* me filozofi edhe vdiqe për të tanishmet përmes* dashuris' për Jisun',*[12] je instrumenti hyjmbajtës* i dhuratave jetëbërëse, për ne ti.

Hyjlindësore

O e virgjër, i dhe si fryt Zotit të Gjithësis'* trup, me kultivimin e Shpirtit të Shenjt', gjith'bërës; në k'të trup dënoi vërtet* mëkatin[13] mbar'botëror ky* dhe buroi jet' të përhershme në qiell lart.

Irmosi: Uranias apsidhos

»**P**erëndi që ke bërë apsid' në q'ell »si çati,*[14] ti që je ndërtues i Kishës, »më siguro mua* në dashurin' tënde »fort;* je maja e çdo dëshire,* njerida»shës, edhe mbështetja për çdo besnik.

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

Duke qen' reflektim dhe ikon' e shenjt'* ti e enës së zgjedhur[2] me të vërtet',* misteret hyjnore krejt* na mëson përmes Shpirtit t' Shenjt';* me hirin e shkëlqimit të hyjshëm u ndrite plot;* pastaj na qartësove fort rendet e engjëjve;* pra le mendërisht dogmat e tua të hyjshme* te bota dhe çdo njeri* e ndriçove së tepërmi,* o hyjnjohës,* Dhionis i urt';* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

E panjollshme, e papikëluar krejt,* o e tër'pacenuar, ti je vërtet;* ti reja e diellit* tër'mendor, gjithashtu kandil* me dritë ari dhe plot shkëlqim dhe hir, shpirtin tim* të errësuar edhe të verbër prej veseve,* ti ndriçoje me drit', pa pasione; dhe laje* me lot prej pendimit dhe* kataniks zemrën time,

Zonj',* dhe pastromë* nga çdo ndyr'si;* lutju për k'të Birit tënd, nën';* që të më japë ky ndjesën* e fajeve* mua, që po i falem Krishtit tënd besërisht.

ose Kryqhyjlindësore

Kur bariun[23] dhe qengjin e pa mbi kryq,* ku po varej, e d'lira përbrenda saj* plagosej, thërriste fort* dhe me klithmë si nënë kjo:* Mjer' un', o drit' e botës,[24] o Zot, Perëndia im,* përse vullnetarisht ti pëson k'to tani, o bir?* Do ikonën tënde[26] që u prish rëndë, njer'zit,* patjetër ti t'i shpëtosh*[25] dhe t'i çosh në një jet' të shenjt';* pra pësime* ke vuajtur,* se ke dhembshuri ti në shpirt;*[27] me k'to shërove çdo dhimbje,* pra çdo njeri;*[28] ndaj mundimet e tua i madhëroj me mall.

Ode IV
Si mu iskís Kírie

Rregullove hijeshinë e Kishave, sepse pikturove në to, o atë, me veprim pedagogjie të shenjtë, format e dukshme të Forcave pa formë; nëpërmjet këtyre mëson të fshehta dhe ndriçohen tërësitë hyjmendëse të shpresëtarëve.

Çurkat e theologjisë sate, o perëndimarrës, ujitën së tepërmi luginat e arsyeshme përherë të blerta e të mbjellura mbi[15] saktësinë e dogmave, sepse monarkinë e respektueshme e shpalle një substance në trini personash.

Dëshirën e përflaktë, dashurinë intensive të hierarkisë engjëllore për Perëndinë dhe prirjen e padevijueshme drejt lartësive hyjnore dhe të pakuptueshme ua mësove mençurisht atyre që thërrasin me besë: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

Hyjlindësore

Meshëtar i shpëtimit për të gjithë ata që të himnojnë, udhëzues, dritëprurës, drejtësi dhe çlirim u bë biri yt,[16] o Virgjëreshë; prandaj besëmirët të lavdërojnë me një zë si të vetmen Perëndilindëse me të vërtetë.

Ode V
Ina ti me aposo

Zëri i fjalëve të tua si tingëllim qiellor që sillej,[17] u kumtoi mendjeve ateiste fjalët e Hirit dhe ndriçoi zemrat e besimtarëve me vezullime shumë të shkëlqyeshme.

Ngjave me tregtarin që kërkon margaritarët; dhe pasi gjete margaritarin unik, vërtet të çmuar[18] dhe kur u mahnite nga drita e rrezatimeve të tij hyjbërëse, pohove Perëndinë, o hierark.

Me filozofi të skajshme e deshe shumë burimin e urtësis', o at', dhe duke lëvizur ti brenda dëshirës dhe dashurisë së saj,[19] u bëre i madh dhe buron përherë rrëke lumenjsh të hyjshëm,[20] o perëndimarrës.

Hyjlindësore

Si e hirshme pranove hijeshinë bukuribërëse,[21] që i bëri të gjitha vetëm me vullnet[22] dhe na zbukuroi me bukurinë e hyjshme dhe me ndriçimin e besimit të saktë, o nënë e Perëndisë.

Ode VI
Ilásthití mi Sotír

Si filozof ligjërisht* fitove dhuntit' e urtësis';* theologoje hyjnisht,* kështu pra le dogma orthodhokse ti, o i lum,* që shijojn' besnikët* me dëfrim; të lumërojmë pra.

I zbukuruar, o at'* hyjmendës, me mençuri të hyjshme, ule veshin[23] ti tek* mësuesi i shenjt' i mistereve mbi logjik'* dhe ky të zbuloi* urtësin' e përmbibot'shme krejt.

E kishe jetën çudi* dhe fjalën më të çuditshme, dhe gjuhën tënde me drit',* dhe gojën që nxirrte zjarr, Dhionis, at' i lumur fort,* ndërsa mendja jote* ish me form' hyjnore dhe të shenjt'.

Hyjlindësore

Thërrasim ne besërisht* me zërin e Gabrielit tok:* Gëzohu, sepse u lind* pashprehshëm prej teje Kryetari i jetës son'* dhe u shoqërua* me ne njerëzit,[23a] njeridashësi.

Irmosi: Ilásthití mi Sotír

»Mëkatet që kam jan' shum';* pra »le të të vijë keq, o Zot,* për mua; lu»tem, më nxirr* nga fundi i vrereve, »sepse thirra fort tek ti* dhe dëgjomë »mua,* Perëndia i shpëtimit tim.

Kontaqi
Ting. Tërth. IV
Ti ipermaho

Pasi kalove* dyer qiellore shpirtërisht,* meqë mësove* pran' apostullit të madh, të shenjt',* që arriti mbi tre qiej,[11] u pasurove,* o Dhionis, me gjitha dijet që nuk shprehen dot,* ndrite k'shtu sa flinin më par' në err'sir' të thell';* të thërrasim pra:* G'zohu, o at' mbar'botëror.

Shtëpia

Dhionisi i madh, si u bë engjëll nga njeri për hir të virtyteve, e mësoi mendërisht njohurinë qiellore të fshehtë, sikur të ishte bërë me krahë. Prandaj le ta nderojmë me këngë si engjëll,

duke i thirrur kështu:

Gëzohu ti, që njohe Krishtin nëpëmjet Pavlit; gëzohu ti, që i ktheve shumë njerëz te Krishti.
Gëzohu, shkatërrues tendash politeizmi; gëzohu, vrojtues vullneti i njohjes së perëndishme.
Gëzohu, libër i gdhendur nga Perëndia,[24] thesar misteresh; gëzohu, tabelë e hyjformuar dhe dylbi qielli.
Gëzohu, se pe qartësisht pësimin e Zotit; gëzohu, se po theresh për atë gatishmërisht.
Gëzohu, burim që nxjerr ndjesë; gëzohu, pikë që gërryen pamendësi.[25]
Gëzohu, udhë e pagabueshme shpëtimi; gëzohu, pritë për kalimtarë të pabesë.
Gëzohu, o at' mbar'botëror.

Sinaksari

Më 3 të të njëjtit muaj, kujtimi i hieromartirit të shenjtë Dhionis Areopajitit.
Vargje: Pritesh në kokë dhe të tejskajshmet janë të mëdha!/ Duke e ngritur kokën, o Dhionis, vrapon.
O Dhionis, duke u prerë më 3, vrapoje duke mbajtur kokën.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Rustiki dhe Elefteri.
Vargje: Shpata, Elefterin dhe Rustikin,/ i çliron edhe nga tokësoret.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Theoktistit.
Vargje: Meqë i dha Theoktisti respekt Krijuesit dhe jo Krijesës,/ duron i gëzuar heqjen e kryes.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i hieromartirit të shenjtë Dhionisit dhe i tetë martirëve bashkë me të.
Vargje: Dhionisi bashkë me tetëshen e shokëve të tij atletë,/ pasi u shpërngul nga errësira, banon në vend drite.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Theajenit.
Vargje: Sapo erdhi te lëkura e zjarrit Theajeni,/ u fut në të duke mos u tronditur prej pamjes.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Theoteknit.
Vargje: "Një herë u godita me gurë", thotë edhe Theotekni,/ siç tha Pavli duke u shkruar korinthianëve.[26]

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Avdhaktit.
Vargje: Meqë vdiqe nga shpata, Avdhakt, martir i Zotit,/ jeton me martirë dhe sheh Perëndinë e gjallë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Joan Hozevitit, episkopit të Qesarisë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin

Ode VII
Theú singatávasin

Mësimdhëniet e tua si shi qiellor në tokën e etur,[27] plehërojnë zemrat e besnikëve, që gjithmonë dëshirojnë dhe i mësojnë që të thërrasin pa pushim: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Me mendim hyjmendës përshkrove mendjet e patrup dhe duke u bërë i perëndishëm, edukove Kishën për të kënduar himnimet e tyre: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

U duke ena e mirërregulluar e Shpirtit të Tërëshenjtë dhe duke i parathënë fort profetikisht frymëzimet dhe shfaqjet e tij, thërrisje i ngazëlluar: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Hyjlindësore

Ja, që tani është mbushur parathënia e Isaisë, sepse pate në bark, o Virgjëreshë, Fjalën Perëndi dhe ke lindur[28] jetëdhënësin, tek i cili thërrasim të gjithë: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Ode VIII
Eptaplasios káminon

Pasi u bërë si një pasqyrë e shndritshme, o Dhionis, dhe pasi e bëre me anë të virtyteve mendjen tënde të mbante shfaqjet e pastra, o i tërëpasur, duke pranuar vezullimet e shkëlqimeve mbimendore, thërrisje: O priftërinj, e bekoni, popull, e përmbilartësoni Krishtin përjetë.

U derdh në buzët e tua hir[29] me bollëk, prandaj na dorëzove mësimdhëniet e perëndishme, duke na parashtruar mbimendërisht kuptimet e tyre, duke i shpallur dhe i zhvilluar me largpamësi tek ata që këndojnë besërisht: O priftërinj, e bekoni, popull, e përmbilartësoni Krishtin përjetë.

Është bërë më e njohur nëpërmjet teje, o Dhionis, mitropolia e tërëlavdëruar e Athinës, sepse të ofroi te Krishti, mbreti i të gjithave, si një flijim frutash të parë[30] të tërëhyjshëm, ty që këndove gjithnjë: O djem, e bekoni, priftërinj, e përhimnoni, popull, e përmbilartësoni Krishtin përjetë.

Hyjlindësore

O nënë e tërëpaqortueshme, shlyeji traumat e shpirtit tim dhe shenjat e plagëve të mëkatit, sepse linde Bir, që ka pushtet t'i zgjidhë lehtësisht nga prangat e pazgjidhshme ata që janë të lidhur me vargonjtë[31] e shkeljeve, pra linde ti mirëbërësin e vetëm dhe jetëdhënësin e vetëm.

Irmosi: Eptaplasios káminon

»**E** dogji furrën shtatë her'* në Kalde »një tiran i saj* me mani për Djemtë*

»që nderonin Zotin shum';* por kur të »shpëtuar krejt* i pa nga një fuqi më »e fort',* k'shtu thërriste ky:* Po Çli- »rimtarin dhe bër'sin,* ju Djema, e »bekoni,* ju prift'rinj, e himnoni,* ju »popull, lartësoni atë për gjithë jetët.

Ode IX
Eksesti epí tuto

U denjësove të jesh shikuesi* i apostujve dhe u mundove ti* bashkë me ta,* dhe je bër' pjes'marrës lavdie,[32] ndaj* dhe bashk' me k'ta nxitove shum'* për të parë trupin, pra që vërtet* filloi jetën tonë,* Hyjlindësen e vetme* të fort'nderuar, që e madhështojm'.

Je bër' trashëgimtar mbretërie ti* lart në qiell,[33] që është e tërëshenjt',* si një atlet* i pamposhtur, si kryeprift ligjor,* që lidhe gjakun martirik* me krezmim prift'rie;[34] prandaj ke marr'* kurorë të dyfishtë* shum' denjësisht, Dhionis at',* njohës misteresh që jan' fshehur krejt.

Meqen'se ke guximin ndaj Perëndis',* o Dhionis, kryeprift dhe i urtë shum',* ndërmjeto ti* gjithmon' për shpëtimin nga çdo ngacmim* të k'tyre që të përhimnojn'* besërisht ty, o njohës teorish* të pashprehshme, si shfaqës* të shenjtash mirësie,* të perëndishme dhe të fshehura.

Hyjlindësore

Tregoje triumfuese Kishën ton'* të nderuar përmbi herezi gjithnjë;* k'të Biri yt,* Krishti, si i mir' e fitoi krejt* me gjakun shum' të çmueshëm,*[35] që për ne e derdhi, e Tër'shenjt';* dhe na shpëto, Hirplote,* nga çdo rrezik; çlirona* nga shtangia që na ka shtrënguar fort.

Irmosi: Eksesti epí tuto

»**U** shtang dhe u shastis qielli për »k'të,*[36] u habitën dhe anët e botës »mbar',* se Perëndi* trupërisht u »duk[37] tek të vdekshmit qart'* dhe »barku yt u bë, o Zonj',* më i gjer' se »qiejt dhe se çdo vend;* pra, o Perë- »ndilind'se,* grupimet njerëzore* dhe »engjëllore të madh'shtojnë ty.

Dërgimësore
Tis mathités sinélthomen

Meqë mësove pran' Pavlit,* që është korifeu* shum' i nderuar, o Dhionis* i tërëpasur, prej tij* ti more dije të fshehtash,* ndaj si ndriçues të vë* në Kishën e athinasve,* pasi të dorëzoi si hierark* të qytetit shpresëtar, që ta ruash* përherë orthodhoks atë* me ndërmjetimin tënd, at'.

Hyjlindësore

Kur fjete, o e Tërëshenjt'* e virgjër,

dhe Dionisi* ishte prezent atë dit' tok* me Jerotheun edhe* me Timotheun e hyjshëm* dhe me të tjer' apostuj bashk';* dhe çdo njeri këndonte himn* të përshtatshëm për rastin, kujtimin tënd;* me këta tani çdo gjuh' njerëzore* të përhimnon Hyjlindëse,* mbrojtje e tërë botës.

Pasvargje të Oktoihut

Lavdi *I Gjermanoit*

Ting. Tërth. IV

Meqë u dallove mes priftërinjsh dhe martirësh, o oshënar, u dëfteve bari besnik, pasi pive potirin e Krishtit;[38] prandaj, meqë i pëlqeve atij në të dyja, ndërmjeto për ne të gjithë, duke qenë tani në oborre me dritë, bashkë me meshëtarët lart.

Tani *Hyjlindësore*

O tu paradhoksu thávmatos

Flake jasht', o Zonj, çdo shthurrje, papërsosmëri, plogështi,* dembeliz'm, imoralitet* si edhe idiot'si,* kundërshtimin e shpirtit tim* të mjer'; largo edhe shkelje porosish* të Ngush'llimtarit, të Shpirtit të Tër'shenjt'* dhe bashk' me gjithë k'to,* sjelljen që s'ka dhembshuri, lakmin' e marr',* pandërgjegjshmërin', edhe shpëtomë ti.

ose Kryqhyjlindësore

Kírie i qe kritirio

O Fjalë pa fillim e Atit, e bashk'fronëshme me Shpirtin, o Biri im,* si i shtrive duart e tua* të papikëluara mbi dru;* o fort i mir', sa i madh* ësht' varfërimi yt tani*[39] në kryqëzimin tënd, k'shtu thërriste* e panjollshmja, që të rrinte pran'.

Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

[1] Vep. 17.22-31

[2] Vep. 9.15

[3] Vep. 19.19

[4] Gjen. 28.17

[5] Eks. 3.2-5

[6] Rom. 11.33

[7] Rom. 13.14; Gal. 3.27

[8] I Tim. 1.19

[9] II Tim. 4.7

[10] Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23

[11] II Kor. 12.2-4

[12] Gal. 2.20

[13] Rom. 8.3

[14] Gjen. 1.7; Is. 40.22

[15] Ps. 1.3

[16] I Kor. 1.30

[17] Vep. 2.2

[18] Matth. 13.45-46

[19] Urt. Sol. 8.2

[20] Joan 7.38

[21] Gjen. 1.4,8,13,18,21,25,31

[22] Gjen. 1.3,6,9,14,20,24; Ps. 148.5

[23] Ps. 44(45).11

[23a] Varuh 3.38

[24] Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10

[25] Jov 14.19

[26] II Kor. 11.25

[27] Ligji i Dytë 32.2; Jov. 29.23

[28] Is. 7.14

[29] Ps. 44(45).3

[30] Eks. 22.29(28); 35.5

[31] Ps. 101(102).21; 145(146).7

[32] I Petr. 5.1

[33] Matth. 25.34

[34] Eks. 28.37; 29.7-9; 30.30; 40.13

[35] Vep. 20.28

[36] Jer. 2.12

[37] I Tim. 3.16; Kol. 2.9

[38] Matth. 20.23; 26.39; Mark. 10.38; 14.36; Lluk. 22.42; Joan 18.11; I Kor. 10.21; 11.27

[39] II Kor. 8.9

TË DIELËN PAS DATËS
10 TETOR (11-17)

Kujtimi i Etërve të Shenjtë të Sinodit të VII Ekumenik.

Tipikon

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 Vargëzime ngjallësore dhe 6 të Etërve. Lavdi i Etërve. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngallësore. Lavdi i Etërve. Tani Hyjlindësorja e tij.

Të dielën në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Lavdi i Litisë së Etërve dhe Tani i tyre. Himnet Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e Etërve. Në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor dhe i Etërve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Ndenjësorja e Etërve me Hyjlindësoren e saj. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Etërve. Sinaksari i ditës dhe i Etërve. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Dërgimësoret: ngjallësore, e Etërve dhe Hyjlindësorja e saj. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të Etërve. Lavdi i Etërve. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të Etërve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Etërve dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Apostulli dhe Ungjilli i Etërve (i IV-t i Llukait).

Shënim: Tri herë në vit bëjmë publikisht kujtim Etërish të Shenjtë:

1. Etërit e Sinodit të I në të dielën e VII të Pashkës.

2. Etërit e Sinodit të IV-t në të dielën midis datave 13-19 korrik.

3. Etërit e Sinodit të VII sot.
Çdo rast ka ungjillin e vet.

NË MBRËMËSORE

Vargjëzime
Ting. Tërth. II
I apegnosmeni

Ja, të shtat' Sinodet e Etërve tan',* që u mblodhën në kohëra të ndryshme,* në një koh' i mblodhi dhe në një kanun, në k'të pra,* shum' mirë patriark Gjermani* i Ri, duke i shkruar* dogmat e tyre, njëkoh'sisht dhe* duke i përforcuar.* I tregon ata si ndërmjetues* të pagjum' para Perëndis' për shpëtimin ton' dhe bashk'barinj të kopes' së mir'.

Për ata që mbi hijen jan' bazuar* dhe e adhurojn',[1] për bijt' e hebrenjve,* o

Etër, të cilët na treguat dogmë bese,* shkronja e Ligjit e vendosi* javën si gjë të çmuar;*[2] javën shtat'ditëshe e bëtë* më të vyer, o Etër,* kur u mblodhët në të shtat' Sinodet* me aprovim nga Bër'si i Gjithësis' në gjashtë ditë; bekoi të shtatën.[3]

Ju Trinin' që është sipas çdo fakti* shkaku i krijimit të gjithë botës,* na e dorëzuat ju, o Etër, shum' të lumur,* sepse formuat për arsye* fort mistike Sinodet* tre edhe katër, dhe u shfaqët* dukshëm mbrojtës të fjalës* orthodhokse, edhe i treguat* të katër elementet si dhe Trinin' që i ndërtoi dhe bëri botën ton'.

I mjaftonte thjesht vetëm një përkulje* që t'i frymëzonte jetë fëmijës* së shtrirë të k'saj që i shërbente mir' profetit,* pra Eliseut shum' të shquar;* por u ngrit ky shtat' herë* dhe u përkul mbi të,[4] sepse k'shtu* si profet, parathoshte* mbledhjet tuaja; ndaj dhe shfarosët* ju vdekjen e Perëndis', Fjalës, meqë e vratë Ariosin bashk' me shokët.

Me urti këmishën e Krishtit tonë,*[5] që ish ndar', e shqyer nga qent' që lehnin,* e qepët, o Etër të nderuar, se s'duronit* dot ju të shihnit zhveshjen e tij,* si Jafethi dhe Simi* nuk panë zhveshjen e babait* dikur, në koh' të vjetër;*[6] Ariosin, me emër manie,* at'vrasësin, e turpëruat dhe bashk' me të ata që njësoj mendonin pra.

Si barinj me bes' të vërtet', jasht' grigjës* së Çliruesit i dëbuat me forc',* të zhveshur nga rroba e lesht', Makedhonët si dhe* Apolinarët, dhe Nestorët,* Savelisevirjanët* edhe Eftikët, Dhioskorët,* sepse ujq shum' të egër*[7] u dëftuan me lëkurë qengji;*[8] këta të gjith' u katandisën në një mjerim të madh; pra ju lumërojm' me shpirt.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Trumbetat mistike të Shpirtit, Etërit hyjmbajtës, le t'i himnojmë sot, ata që kënduan në mes të Kishës melodi harmonike theologjie, një Triadhë pa asnjë ndryshim në substancë dhe hyjni, rrëzuesit e Ariosit dhe mbrojtësit e orthodhoksëve, që ndërmjetojnë gjithmonë te Zoti, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore dogmatike*

Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës dhe Leximet.*

Këndimi i Gjenezës
(14.14-20)

Sapo dëgjoi Abrahami se u robërua Loti, vëllai i tij, numëroi ata që kishin lindur në shtëpinë e tij, *pra* treqind e tetëmbëdhjetë veta dhe shkoi prapa atyre deri në Dan. Dhe u hodh mbi ta natën, ai dhe shërbëtorët e tij bashkë me të, dhe i goditi e i ndoqi deri në Hoval, që është në të majtë të Damaskut. Dhe e ktheu gjithë kalorësinë e Sodomëve dhe Lotin, vëllain e tij dhe gjithë plaçkat e tij, dhe gratë, dhe popullin. Dhe doli mbreti i Sodomëve në ndeshje me të, pasi ky u kthye nga therja e Holodhogomorit dhe e mbretërve që ishin me të në luginën e Saviut (kjo ishte fushë mbretërish); dhe Melkisedeku, mbreti i Salimit nxori bukë dhe verë dhe ishte prift i të Shumëlartit. Dhe e bekoi Abrahamin dhe tha: I bekuar *qoftë* Abrahami prej Perëndisë së Shumëlartë, i cili ndërtoi qiellin e dheun dhe i bekuar *qoftë* Perëndia i Shumëlartë, i cili të dorëzoi armiqtë e tu *të jenë* të nënshtruar tek ti.

Këndimi i Ligjit të Dytë
(1.8-10; 15-17)

Utha Moisiu bijve të Izraelit: Shikoni, e dorëzova para jush dheun; pasi të futeni, trashëgoni dheun, për të cilin Zoti iu betua etërve tanë, Abrahamit, dhe Isaakut, dhe Jakovit, se do t'ua jepte atyre dhe farës së tyre pas këtyre. Dhe iu fola juve në atë kohë, duke u thënë: Nuk do të mundem t'ju sjell unë vetëm. Zoti, Perëndia ynë ju shumoi dhe ja jeni sot si yjet e qiellit përsa i përket numrit. Zoti, Perëndia i etërve tanë ju shtoftë juve, si jeni, një mijë herë dhe ju bekoftë, sikundër ju foli juve. Dhe mora prej jush burra të urtë, dijetarë dhe të mençur, dhe i vura që të udhëheqin mbi ju, kryemijësha dhe kryeqindësha dhe kryepesëdhjetësha dhe kryedhjetësha dhe prokurorë te gjykatësit tuaj. Dhe i porosita gjykatësit tuaj në atë kohë duke u thënë: Dëgjoni midis vëllezërve tuaj dhe gjykoni drejt midis burrit dhe midis vëllait të tij dhe midis proselitit të tij. Nuk do të njohësh fytyrë në gjykim. Sipas të voglit dhe sipas të madhit do të gjykosh. Nuk do të ulësh fytyrë njeriu, sepse gjykimi është i Perëndisë.

Këndimi i Ligjit të Dytë
(10.14-18; 20-21)

Utha Moisiu bijve të Izraelit: Ja, i Zotit, Perëndisë tënd *është* qielli dhe qielli i qiellit, dheu dhe të gjitha sa janë në të. Por Zoti parapëlqeu që t'i dojë etërit tanë dhe zgjodhi nga të gjitha kombet farën e tyre pas këtyre, juve, në këtë ditë. Dhe do rrethpritni

zemërngurtësinë tuaj, dhe qafën tuaj nuk do ta ashpërsoni më. Sepse Zoti, Perëndia juaj, ky Perëndi perëndish dhe Zot zotërish, Perëndia i madh, i fuqishëm dhe i frikshëm, i cili nuk admiron fytyrën, që nuk do të marrë dhuratë, që bën gjykim për proselitin dhe jetimin, dhe të venë, dhe e do proselitin, ka për t'i dhënë atij bukë dhe veshje. Zotin, Perëndinë tënd do ta kesh frikë dhe atë vetëm do të adhurosh dhe tek ai do të ngjitesh dhe në emrin e tij do të betohesh. Ai *do të jetë* krenaria jote dhe ai *do të jetë* Perëndia yt, që të bëri gjëra të mëdha dhe të lavdishme, këto që i panë sytë e tu.

Në Liti
Tropari i parë i Litisë së shenjtit të kishës.
Pastaj:
Lavdi *Ting. III*

Jeni bërë, o Etër të Shenjtë, ruajtës të saktë traditash apostolike;[9] sepse meqenëse dogmatizuat orthodhoksisht njëqenshmërinë e Trinisë së Shenjtë, rrëzuat sinodikisht blasfeminë e Ariosit; bashkë me të, pasi kritikuat si kundërshtarë të Shpirtit Makedhonin, dënuat Nestorin, Eftikun dhe Dhioskorin, edhe Savelin edhe Sevir Aqefalin; lutemi që të ruani jetën tonë pa njollë brenda besimit, që të shpëtojmë nga mashtrimi i tyre.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, mbrojtja e të gjithëve sa luten, tek ti guxojmë, tek ti mburremi, tek ti është gjithë shpresa jonë; ndërmjeto tek ai që u lind prej teje për shërbëtorët e tu të pavyer.

Pasvargje të Oktoihut

Lavdi *Ting. IV*

Le ta kremtojmë sot besërisht ne, tërësitë e orthodhoksëve, duke mbajtur besimin e mirë, kujtimin e përvitshëm të Etërve hyjmbartës, që u mblodhën nga e gjithë bota në qytetin e shkëlqyer të nikeasve; sepse ata shembën me mendje besëmirë dogmën ateiste të Ariosit të tmerrshëm dhe sinodikisht e dëbuan jashtë Kishës katholike, dhe Birin e Perëndisë e mësuan fuqishëm tek të gjithë që ta pohojnë atë në Simbolin e Besës si të bashkëqenshëm dhe të bashkëpërjetshëm, i cili është para jetëve, duke e parashtruar këtë saktësisht dhe besërisht te Simboli; prandaj dhe ne, duke ndjekur dogmat e tyre të hyjshme, duke besuar me siguri, adhurojmë bashkë me Atin dhe Birin edhe Shpirtin e Tërëshenjtë, Triadhën e bashkëqenshme në një Hyjni.

Tani *Hyjlindësore*

Ulu te lutjet e shërbëtorëve të tu, o

e panjollëshme, duke pushuar kryengritjet e mjerimeve tona; duke na shpëtuar nga çdo hidhërim, se ty vetëm të kemi spirancë të saktë e të sigurt[10] dhe kemi mbrojtjen tënde; mos u turpëro fshim, o Zonjë, duke t'u lutur; shpejto në lutjet e atyre që të thërrasin besërisht: Gëzohu, Zonjë, ndihma e të gjithëve, gazi, mbrojtja dhe shpëtim' i shpirtrave tanë.*

Përlëshore ngjallësore

Lavdi *I Etërve*
Ting. Tërth. IV

I përmbilavdëruar je, o Krisht Perëndia yn', që i themelove mbi dhen' si yje Etërit tanë dhe me anën e tyre u hoqe udhën të gjith've tek besa e vërtetë, i shum'mëshirshëm, lavdi më ty.*

Tani *Hyjlindësore*

Ti që linde për ne prej Virgjëreshës dhe durove kryqëzim, o i mir'; që plaçkove vdekjen me vdekje dhe rrëfeve ngjalljen si Perëndi, mos i zhvështro ata që gatove me dorën tënde; trego njeridashjen tënde, o mëshirplot'; prit Hyjlindësen që të lindi të ndërmjetojë për ne dhe shpëto, o Shpëtimtari ynë, një popull të dëshpëruar.*

NË MËNGJESORE

Stihologjia e zakonshme. Në vend të të Panjollshmit, themi Polielein. Kanunet e Oktoihut dhe të Etërve të shenjtë në 6.

Kanuni i Etërve, që ka Akrostihidhë: "Himnoj mbledhjen e shtatë të të lumurve".
Poezi e Theofanit

Ode I
Ting. Tërth. IV Armatilatin Faraó

Ja, dëshiroj tani që ta himnoj un' mbledhjen e shtat', o Zoti im!* Më jep mua mbledhjen* e të shtat' dhuntive të Ngushëllimtarit, Shpirtit t' Shenjt',*[11] që me gjuhë të zjarrta[12] i urtësoi, pushoi k'shtu* çdo llafazan'ri edhe blasfemi.

Që nga fillimi ka qen' numri shtatë më i madh, meqen'se pushim* në ditën e shtatë* na u dha si shembull ne pas bërjes së Krijesës, që* bëri Zoti;[3] dhe tash herezit' të gjitha mbarojn' përmes* Mbledhjes që e ka numrin po njëlloj.

Kur në Nikea mposhti krejt më par' perëndikundërshtarin e keq,* Ariosin, kori* i gjith' Etërve me shkopin baritor udh'hoqi[13] me* dogma orthodhoksie drejt Kishën, dhe turpëroi tash* gjith' ikonoklastët me trimëri.

Hyjlindësore

Si na mësuan me besim të saktë Etërit, pohojm' shpres'tarisht* se një bark i virgjër* lindi krejt pa dhimbje mishërisht atë që s'kishte mish;* e skicojmë fytyrën e tij, i falemi thell' me nder* dhe e puthim me shum' devotshmëri.

Ode III
O stereosas kat' arhás

Ju edukoi Krishti yn',* që të mos tundet dot Kisha* e pathyeshme e tij, o Barinjt' tan';* pra ju tundët fort nga vendi, flakët jasht' besnikëve* sa donin që ta tundnin,* se ishin të antikrishtit k'ta.

Kan' nxjerrë si nga një burim* shpëtimi[14] dhe e kan' ngopur* me rrëke plot mësimdhëniesh një popull,* pra besnikët e krishter' që kishin etje;[15] dhe kan' thar'* Et'rit përrenj të turbullt* dhe i pastruan nga balta krejt.

Mbledhja e besëmirëve,* e shtata kundër atyre* që qortonin të krishterët dhe ishin* të urryer shum', vërtet u bë në Nikea, qytet* shndritës, me mbrojtës mbret'rit* Irinin dhe Konstandinin, pra.

Hyjlindësore

Le të largohet çdo njeri* me bes' të keqe, i cili* s'respekton ikonën hyjlindësore* dhe nuk shpall se lindi Krishtin si njeri dhe Perëndi* Zonja jon'; e dërgoftë* te zjarri, që digjet pa pushim.[16]

Ndenjësore
Ting. IV Tahí prokatálave

O Etër të lumur hyjfolës, u shfaqët në bot'* ndriçues,[17] shkëlqyes shum' të fortë të së vërtetës, se shkritë herezit'* edhe llafazan'rinë,* blasfemitë; bashk' ju shuat* rrëmujë dhe trazira njerëzish me fam' të keqe;* pra si hierarkë, ndërmjetoni që të shpëtojm'.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Arri sa më shpejt, Virgjëresh'-nën' e pastër, e d'lir';* çlirona ne prej armiqve, që ty të blasfemojnë dhe nuk të falen dot;* thyej llafazan'rinë* e të gjith' herezive* dhe le ta njohin se vetëm ti je hyjnën', o Zonj';* që me ndërmjetimin tënd shpëton orthodhoksët krejt.

Ode IV
Si mu iskís Kírie

Duke pasur fjalën e Perëndisë si shigjetë dhe thikë,[18] Etërit me fytyrë

të hyjshme, të gjithë së bashku, i thernin me shenjën e Kryqit keqdashësit që nuk respektonin njëlloj ikonën e Krishtit, të Perëndilindëses dhe të gjithë shenjtorëve.

Ashtu si shtatë trumbetat rrëzuan muret e Jerikosë në rrotullimin e shtatë,[19] kështu edhe shtatë Sinodet, çdo hordhi që lartësohej kundër Perëndisë e gremisën[20] në kaos gjatë mbledhjes së shtatë të trumbetave të mirëtingëllueshme të Shpirtit.

Bashkësia atërore, duke dëftuar një gjallëri rinore[21] dhe duke u djegur nga zelli i hyjnueshëm i Ilias,[22] në një farë mënyre vrau priftërinjtë e turpit;[23] prandaj me guxim dogmatizoi të falurit relativ të ikonës së Krishtit.

Hyjlindësore

Ti je shpresa ime, o e tërëpastër, ti je edhe himnimi, ti je limani im, ti je edhe qeverisja, ti, e cila mbete me barrë pa bashkim trupor dhe trupëzove Fjalën Perëndi të Atit; prandaj i falem pa ngurrim ikonës sate i forcuar prej fuqisë sate.

Ode V
Ina ti me aposo

Pasi menduan bashkërisht me një mendje të lartë Etërit e respektuar, i anatemuan ikonomakët, sepse menduan trille ekstravagante, të trazuara dhe vendosën hyjnisht që të nderojnë skicën e Krishtit siç ishte e natyrshme.

Tani është kohë ngazëllimi; ja u shfaq dukshëm ditë shpëtimi.[24] Le të ngazëllohemi pra dhe le t'i thërrasim Krishtit me hare:[25] Jep paqen tënde[26] me përgjërimet e Etërve të Sinodit të shtatë, o njeridashës.

Hyjlindësore

Për hir të dhembshurisë, Biri i Perëndisë është lindur pa ndryshuar nga Virgjëresha, duke mbajtur të huajin si të vetin, dhe shfaqet vullnetarisht që të mund të përshkruhet me formën e tij, ai që është i papërshkrueshëm në substancë.

Ode VI
Ilásthití mi Sotír

Le të spërkatin gëzim* dhe plot ëmbëlsi tër' malet,[27] se ja u dëbua tani* hordhi heretike; me hidh'rim hidhte helm ajo,* mosnderimin e keq* të ikonave të shenjta pra.

Le të kremtojn' me një shpirt* si qielli edhe toka bashkë, madhështin' dhe lavdin'* e bijës së Perëndis', se mposht k'ta që e zvog'lojn',* edhe

k'shtu shkëlqehet,* madhërohet, lartësohet shum'.

Hyjlindësore

Bir nëne është ai,* që Bir Ati më par' ishte pa nën', dhe ka lindur dikur* siç duhej hyjnisht pa at' dhe më ka rilindur krejt;* pra e pikturoj k'të* bashk' me nënën dhe ikonën puth.

Kontaqi
Ting. II
Hirógrafon ikona

Biri që shkëlqeu nga Ati në mënyrë të pashprehshme, u lind nga një grua, i dyfishtë në natyrë. Duke ditur këtë, nuk mohojmë skicimin e formës, por duke e pikturuar besërisht e respektojmë; prandaj Kisha, duke mbajtur besimin e vërtetë, puth ikonën e trupëzimit të Krishtit.

Shtëpia

Perëndia i tërëdhembshur, duke dashur që të na nxisë gjithmonë drejt kujtimit të përsosur të trupëzimit të tij, këtë çështje e dorëzoi te njerëzit, që nëpërmjet pikturimit të ikonave të riprodhojmë fytyrën e respektuar; kështu që, duke e pasur para syve, të besojmë këto që kemi dëgjuar me fjalë, duke ditur qartësisht punën, emrin, fytyrën dhe arritjet e burrave të shenjtë, e të njohim Krishtin kurorëdhënës, që u jep kurora[28] atletëve të shenjtë edhe martirëve. Nëpërmjet tyre Kisha tani, duke mbajtur edhe më fuqishëm besimin e vërtetë, puth ikonën e trupëzimit të Krishtit.

Sinaksari i ditës dhe më pas i Etërve:

Në të njëjtën ditë bëjmë kujtimin e Etërve të shenjtë dhe të lumur, që u mblodhën në Nikea për herë të dytë, në kohën e mbretërve shpresëtarë dhe besnikë, Konstandinit dhe Irinit, kundër atyre që thanë me besë të rreme nga padituria dhe mendjelehtësia se Kisha e Perëndisë ishte idhujtare dhe që hidhnin poshtë ikonat e shenjta. *Vargje:* Luftëtarë me armë fjalësh, për ty, o Fjalë,/ mposhtën armiqtë e ikonave të respektuara.

Me ndërmjetimet e Etërve të shenjtë, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Theú singatávasin

U përmbytën kryetarët e herezive përmes dogmave të burrave hyjfolës, që përshtatën korrektësisht respektin e skicave me prototipat, pikërisht siç tha Vasili i Madh. I bekuar qoftë Perëndia i etërve tanë.

Kishat stolisen dhe zbukurohen tani me ikona hijeshuese; prandaj dhe bota në kisha psal bashkë me ata që psalin tek i bukuri, i shkëlqyeshëm më shumë se të gjithë të vdekshmit:[29] I bekuar qoftë Perëndia i etërve tanë.

Ka lindur drita, larg është errësira,[29a] jashtë ndodhen besëkëqijtë, prandaj të gjitha të mbushura me dritë, himnojnë me gëzim Krishtin dritëdhënës dhe thonë: I bekuar qoftë Perëndia i etërve tanë.

Hyjlindësore

Zonja e tërëkulluar, shpresa unike e shpëtimit, që ka lindur frikshëm mbretin e mbretërve,[30] Krishtin, duke e mbajtur atë në përqafim si foshnjë në skicë, falet bashkë me atë, siç thanë Etërit.

Ode VIII

Eptaplasios káminon

Shoqëria e Etërve, nga njëra anë vendos ligj të shkëlqyeshëm te besëtarët, pra faljen relative dhe ringritjen e ikonës së hyjshme të Krishtit, ndërsa nga ana tjetër ne shpresëtarët, si fëmijë të bindur bëjmë kujtimin e përvitshëm të tyre dhe puthim me mallëngjim dhe dëshirë ikonën e Krishtit.

Shtatë herë mendjemëdhenjtë i përkulën të përulurit dhe i penguan vrullet e të virtytshmëve me pengesa që futnin në veprat e tyre të hyjnueshme; por Etërit e Sinodit të shtatë, që u mblodhën në Nikea, vetullën e tyre[31] e rrëzojnë menjëherë, më tepër se shtatë herë.

Plagët dhe kamxhikët e atyre që kanë mendje foshnje bëhen psalmikisht[32] shigjeta foshnjash tek ata që kanë urtësi pleqsh, ndërsa me fuqinë e hyjshme, dobësohen gjuhët e shumta të atyre që flasin blasfemi në lartësi[33] dhe çdokush njeh Atin, Birin dhe Shpirtin, një Perëndi, shkakun unik të të gjithave.

Hyjlindësore

Vullnetarisht Krijuesi bëhet foshnjë nga dhembshuria prej gjakut tënd të dëlirë dhe të ruan ty pas lindjes të gjithën të pastruar, o e kulluar, dhe pastron ikonën[34] e ndotur; prandaj në ikona bashkëpikturohet me ty, pasi është bërë njeri në natyrë edhe pse është gjithashtu Perëndi në natyrë.

Ode IX

Eksesti epí tuto

O Perëndi i vetëm, me plot fuqi,* mbret i fort' dhe arkond i të gjithave,* që mban çdo gjë,*[35] i pakonceptueshëm dhe i madh* në forcë edhe në mendim,*[36] Kishën na forco, ruaje

atë* përmes orthodhoksisë,* të luten Et'rit me lavd,* që fen' e keqe e kan' bër' rezil.

U denjësuat ju për çdo lavdërim* mbi dhé, o qiellmendës, shenjtorë, se* relativisht* e nderuat skicën e Krishtit ton';* tani që keni vën' mënjan'* hijen[37] dhe mbulesën[38] e mishit krejt,* atë personalisht ju* e shihni në fytyrë*[39] të denjësuar[40] pra për të mëdha.

Dërrmoje arrogancën, manin' ndaj nesh,* o Zot, vrullin e ashpër që kan' armiqt',* pra një ushtri,* një kalorësi plot me barbari,* që ti e nxite me qëllim* urtësimin' ton';[41] dhe bashkëlufto* me mbretin që ka shpresë* në ty, me ndërmjetimin* plot me guxim të k'tyre që kujtojm'.

Hyjlindësore

Mendimi njerëzor nuk arrin aspak* të kuptojë misterin e frikshëm krejt* të shtatzënis'* sate, as mendim engjëllor në q'ell,* se Perëndin' e linde ti,* që u mishërua mbi çdo logjik';* të njohim pra Hyjlind'se;* të piktu-rojm' së bashku* me të dhe bashk' ju madhështojmë ne.

Dërgimësore
En Pnévmati to ieró

O Etër qiellmendës ju,* të Sinodit të Shtatë,* ofroni drejt Trinis' së Shenjt'* përgjërim sa më shumë,* që k'shtu nga gjith' herezitë* të shpëtojmë, po ashtu* nga gjyqi i përjetshëm,* edhe të arrijm' mbret'rin'* qiellore ne që po* himnojmë Mbledhjen e hyjshme.

Hyjlindësore

Me lutje, ndërmjetim, o Zot* i tër'-mirë, të nënës* dhe Etërve të mbledhur bashk'* në shtat' Mbledhje bot'-rore,* na siguro Kishën edhe* forco besën; na trego* pjes'marrës të mbretërisë* qiellore kur të vish* mbi tok', që të na gjykosh* të gjithë ne dhe Krijesën.

Lavdërime
4 ngjallësore dhe 4 të Etërve:
Ting. Tërth. II
Olin apothémeni

Et'rit e hyjnueshëm,* pasi formuan çdo shkencë* shpirtërore dhe pas-taj,* kur menduan bashkë me Shpir-tin e Tër'shenjt',* shkruan hyjnisht[42] të gjith'* me një frym' Simbolin* qiellor dhe të nderuar; në të na më-sojnë ne* shumë qart', se Fjala ësht' gjithashtu* bashk' pa fillim si prindi At'* dhe të njëjt' subtancën e ka ai.* Et'rit e lëvduar, të tërëpasur dhe në të vërtet'* hyjmendës, shkojn' pas mësimeve* të apostujve sakt'sisht.

(2x)

Varg: I bekuar je, o Zot, Perëndia i etërve tanë.

Duke marrë një shkëlqim* mendor, me hyjfrymëzim pra* shpallën gjith' hyjthëniet bashk'* që diktoi Shpirti. Folën me fjalë shkurt* dhe me shum' mençuri* dogma ungjillore* dhe tradita bese kryetarët, predikuesit* e Jisuit, Zotit, të lumurit,* meqen'se kishin marr' nga lart'* qartësisht zbulimet e dogmave.* Për pasojë k'ta u ndriçuan dhe u denjësuan fort* dhe paraqitën besimin ton',* që Hyjnia na mëson.

Varg: Mblidhini atij oshënarët e tij.

Mblodhën çdo eksperienc'* nga pimantika dhe vunë* në lëvizje tash inat* shum' të drejt', siç duhej,[43] prandaj dëbuan larg* ujqit shfarosës shum'* dhe të rënd'.[7] I flakën* me hoben e Shpirtit t' Shenjt' jasht'[44] tërësis' së Kishës son',* se k'ta kishin rënë për vdekje krejt,* sepse k'ta u sëmurën keq* pa shërim. K'shtu bënë barinjt' e shenjt',* posi shërbëtorë vërtet të Krishtit tonë, Perëndis',* dhe njohës fort të hyjnueshëm,* predikues të fshehtash.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Kori i Etërve të shenjtë, mbledhur prej anëve të dheut, dogmatizoi një substancë dhe natyrë të Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; edhe misterin e theologjisë ia dorëzoi me fuqi Kishës. Ata, duke i lavdëruar me besë, le t'i lumërojmë duke thënë: O ushtri e hyjshme, luftëtarë hyjfolës të rreshtimit të Zotit, yje shumëndriçues të kupës mendore, kështjella të parrëzueshme të Sionit mistik, lule erëkëndshme të Parajsës, gojë të tërëarta të Fjalës, mburrja e Nikeas, lavdia e botës, ndërmjetoni pa pushim për shpirtrat tanë.

Tani

E përmbibekuar.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të Etërve.

Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] Hebr. 8.5; 10.1

[2] Lev. 23.3

[3] Gjen. 2.3

[4] IV [II] Mbret. 4.35

[5] Joan 19.23

[6] Gjen. 9.23

[7] Vep. 20.29

[8] Matth. 7.15

[9] I Kor. 11.2; II Thes. 2.15

[10] Hebr. 6.19

[11] I Kor. 12.4; Apok. 1.4; 3.1

[12] Vep. 2.3

[13] Ps. 22(23).1,4

[14] Is. 12.3

[15] Is. 55.1

[16] Matth. 3.12; Mark. 9.43-47

[17] Fil. 2.15

[18] Hebr. 4.12

[19] Jis. N. 6.15-20

[20] II Kor. 10.5

[21] IV Makk. 5.30; 7.13

[22] III [I] Mbret. 19.10,14

[23] III [I] Mbret. 18.40

[24] Is. 49.8; II Kor. 6.2

[25] Ps. 117(118).24-25

[26] Joan 14.27

[27] Amos 9.13; Joel 4(3).18

[28] Urt. Sol. 5.5-16; I Petr. 5.4; Apok. 2.10

[29] Ps. 44(45).3;

[29a] Is. 58.10; 60.1

[30] I Tim. 6.15; Apok. 19.16

[31] Fja. Urt. 24.36 (Mas. 30.13); Is. 10.12

[32] Ps. 63(64).8

[33] Ps. 72(73).8

[34] Gjen. 1.26-27; 5.1,3; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3

[35] Est. 4.17b; Jov 9.19

[36] Jer. 39(32).19

[37] I Kron. 29.15; Jov 8.9; Urt. Sol. 5.9; Kol. 2.17

[38] II Kor. 3.13,16

[39] Eks. 33.11; I Kor. 13.12

[40] II Kor. 3.18

[41] Is. 41.25

[42] Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10

[43] Ps. 4.5

[44] I Mbret. [Sam.] 17.49-51

MË 18 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i apostullit të shenjtë dhe ungjillorit Lluka.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i ungjillorit dhe Tani i tij. Përlëshoret: ngjallësore, e ungjillorit dhe Hyjlindësorja e tij.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës si zakonisht, por në fund Përlëshorja e ungjillorit. Në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor dhe i ungjillorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit. Ndenjësorja e tij dhe Hyjlindësorja e saj. Të tjera si zakonisht. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Dërgimësoret: ngjallësore, e ungjillorit dhe Hyjlindësorja e tij. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e ungjillorit. Apostulli dhe Ungjilli i ungjillorit. Kungatore Në gjithë dheun.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime
Ting. IV Ti imás kalésomen

Si do të të quaj, o apostull?* Qiell, se e ke treguar mir' lavdin' e Perëndis',*[1] a rrufe, se gjithë botën* me shkëlqime e ndriçon,*[2] a re, e cila derdh si shi p'rrua të shenjt',* a kup' e perëndishme me shum' urtësi,* që na buron ver',[3] dhe zemrën ton'* dëfren dhe na ngazëllon me hir;* të lutemi,* lutu të shpëtohen shpirtrat tan'.

Si do të të quaj ty, o i shenjt'?* Lum, i cili nga Parajsa na del edhe na vadit,*[4] arkë dhiate,[5] që na ka vën'* Krishti për shpëtimin ton',* ndriçues,[6] që me drit' mendore na shkëlqen,* kandil që vezullon edhe shndrit[7] Kishën ton',* trapez' e shenjt',[8] bukë jete[9] krejt* dhe kupë të hyjshme pijeje;*[10] të lutemi,* lutu të shpëtohen shpirtrat tan'.

Si do të të them hyjshikues shenjt?* Famulltar tepër të gjall' misteresh që dha Zoti Krisht,* arkitekt të urtë tende,*[11] që kuptohet mendërisht,* që pret e përpunon pllaka hiri aft'sisht,* që shkrove ligjin[12] shum' të ri, që na ka nxjerr'* Sioni;[13] k'të ti e predikon,* e shpall dhe me të po udhëheq;* të lutemi,* lutu të shpëtohen shpirtrat tan'.

Si do të të quajm', Lluka me nam?* Pra thesar[14] të sigurt shum' dhuntish nga lart, nga qielli,* mjek të saktë shpirtrash, trupash,* madje me shum' frytshmëri* dhe bashk'pun'tor, bashk'udhëtar i Pavlit ti,* që Veprat e Apostujve na parashtron;* virtyti yt, o Lluka, ka bër'* shum' emër për ty me hir të madh;* të lutemi,* lutu të shpëtohen shpirtrat tan'.

O hyjfolës, si të të quajm' ne?* Nxënës, se ungjillëzove Krishtin, Shpëtimtarin ton',* mjek, se ti shëron pasionet* që mundojnë shpirtrat tan',* kandil, i cili feksi drit'[7] mendore fort,* themel dhe bazament besimi të tër'shenjt';* sepse për ne e vijose ti* Ungjillin e respektuar krejt;* të lutemi,* lutu të shpëtohen shpirtrat tan'.

Si do të të quajm' o shenjt i madh?* Ty shikues mësimdhëniesh urtësie pa gabim* dhe shkrimtar praktik doktrine,* që apostuj na kan' dhën'* dhe shtyllë të patundshme të besës së sakt',* dhe kullë që nuk shembet dot e Kishës son';* të shumta jan' përpar'sit', mirëpo* jan' më të mëdha dhuntit' që ke;* të lutemi,* lutu të shpëtohen shpirtrat tan'.

Lavdi *I Anatoliut*

Ting. Tërth. II

O apostull i Krishtit, shkrimtar i dogmave të hyjshme dhe bazament i Kishës,[15] ti me të vërtetë, zemrat që ishin në errësirën e paditurisë dhe të vithisura në fundin e katastrofës, pasi i tërhoqe me hyjthënie, i shpëtove si nga një turbullirë furtune, duke u bërë simpatizuez i enës së zgjedhur, Pavlit,[16] por edhe imitues;[17] prandaj kërkojmë prej teje, o Lluka i admirueshëm, bukuria e antiokasve, ndërmjeto tek Shpëtimtari, Perëndia, për ata që bëjnë besërisht kujtimin tënd të denjë për t'u respektuar.

Tani *Hyjlindësore*

Triímeros anestis

Trini që ke fuqi pa kufi,* njësi trihipostate pra,* përmes lutjes,* ndërmjetimit shum' të shenjt'* të nxën'sit të nderuar, apostullit dhe gjithmonë Virgjëreshës, shpëto sa të himnojn'.

Pasvargje

Ting. Tërth. I Heris askitikón

Hir të ësht' derdhur prej buzëve,* nga goja[18] përmes gjuhe zjarri,[19] o shën Lluka;* prandaj u tregove gjuhë e zjarrtë që rrezaton* fjalë drite, lavdi* mbi sa jan' të denj'* pra për predikimin tënd,* ndërsa djegin sa dëshirojn'* err'sirën; janë* si shigjeta që flakërojn',*[20] duke shkruar dhe* predikuar ungjillin tënd;* je erë jete për ata që

duan jetën, siç tha* Pavli, mësuesi yt, erë vdekjeje[21] për sa s'duan jet';* por jepna ti paqe,* llamburitje edhe jetë, dhe përdëllim të madh.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij.

Njohëm si the, nga fjalët që dhe,* vërtetësin' e fjalës që ke vën' para nesh,* se more përsipër, hyjnjohës, që të shkruash për ne* gjërat që mësove,* siç t'i kishin dhën'* ata që më par' kan' qen'* dëshmitar' okularë krejt;*[22] me k'ta u bëre* dhe ti vetë i barabart',* shërbëtor je pra, i mish'rimit të Fjalës Zot;* k'të ti e pe në Emaus pas Ngjalljes së tij me lavd* dhe me një zemër që digjej, tok me Kleopën bashk' hëngrët ju;* na mbush shpirtrat tanë* me ngroht'sin' e shenjt' të Krishtit, se të nderojmë ty.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

G'zohu, se vetëm ti shkrove pra* për ne me plot gëzim, "Gëzohu"-n e shën Maris',* pra ungjillëzimin, lajmin e mir' të saj,[23] dhe që ish* për Joan Pag'zorin kjo Zotlindëse;*[24] dhe shkrove ngjizjen e tij*[25] dhe mish'rimin e Perëndis'* dhe ngasjet, fjalët,* mrekullit' dhe pësimin prap',* Kryqin, vdekjen, por edhe ngjalljen e tij me lavd;* shkrove dhe ngritjen lart që pe, dhe zbritjen e Shpirtit t' Shenjt',* vepra apostujsh dhe më shum' të Pavlit; ke qën' bashk'udhëtar* i tij, o mjek, njohës* dhe ndriçuesi i Kishës, atë ti ruaje.

Pastaj Idhiomelin e mëposhtëm:

Varg: U derdh hiri në buzët e tua.

Ting. IV I Vasilit

Duke gjurmësuar fundin e detit[26] mendor me kallamin peshkatar të urtësisë, i kape të gjallë shpirtrat e besnikëve nga fundi vdekjeprurës, o Lluka i tërëlumur; prandaj, pasi mësove prej Pavlit, pastrove gjithë zemrën tënde përmes flakërimit të Shpirtit; dhe pasi fekse kombet me dogmat e tua, shërove me çudi sëmundjet e pësimeve, duke përgjëruar gjithnjë Krishtin, Perëndinë për ne, që të shpëtojë shpirtrat tanë.

Lavdi Ting. Tërth. II

O peshkatar i tërëurtë, nxënës i shenjtë, punëtor i Shpëtimtarit dhe shpallës i pësimeve të tij, që vrapove në tërë Krijesën për hir të besës dhe mblodhe kombet e mashtrimit dhe ia blatove Perëndisë si temjan të mirë, udhëtove suksesshëm në qiejt; prandaj, duke qëndruar pranë Gjykatësit, ndërmjeto që të shpëtohemi ne nga paligjësitë tona dhe që të çlirohemi nga ndëshkimi në ditë gjykimi.

Tani *Hyjlindësore*

Zoti Krisht, bërësi dhe shpërblyesi im, o e gjithëpastër, si lindi prej teje i veshur si un',[27] çliroi Adamin prej mallkimit të parë. Prandaj, o e gjithëpastër, të thërresim pa pushuar si nënë Perëndie dhe Virgjëreshë me të vërtetë përshëndetjen e engjëllit: Gëzohu, o Zonjë, mbrojtje dhe hije, dhe shpëtim i shpirtrave tanë.*

Përlëshore
Ting. III

O apostull i shenjt' dhe ungjillor Lluka, lutju Zotit ton' Jisu Krisht, t'u falë shpirtrave tanë ndjesën e mëkateve.* #

Kjo është përlëshorja që përdoret dhe për ungjillorët Matthe dhe Mark.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Ti që ndërmjetove për shpëtimin e gjindjes son', të përhimnojmë, o Hyjlindëse Virgjëreshë, se duke denjuar pësimin e Kryqit me trupin që mori prej teje Biri yt dhe Perëndia ynë, na çliroi prej prishjes si njeridashës.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së zakonshme,
Kanunet: i Oktoihut dhe i ungjillorit:
Poezi e Theofanit

Ode I
Ting. Tërth. IV I qekomeni

Meqë e njohim të gjith' gojën tënde si një kup' urt'sie[28] të lart',* o apostull me shum' fam'* Lluka, e cila pasuron dhe ka thesarin e pashprehshëm e të madh të Hirit pra,* e nxjerrim me gatishmëri* dhe i psalim Zotit, se me lavd ësht' lavdëruar shum'.

Kur të mësonte misteret e qiellit dhe hapi Krishti për ty* drejtpërdrejt Shkrimin e Shenjt',*[29] ty të tregoi njohës gjërash që jan' fshehur, predikues dogmash mbi mendim, o shën* Lluka i urt', thërrisje pra:* Le t'i psalim Zotit, se me lavd ësht' lavdëruar shum'.

Të dorëzon, o Lluka i tër'lum, bashk'udhëtar të Pavlit të madh* Kisha e Jisuit Krisht,*[30] se shndriteshe me hirin e tij drejt dhe ndiqje gjurmët, jetën e tij,[31] madje me gjith' shpirt* dhe bashk' me të thërrisje fort:* Le t'i psalim Zotit, se me lavd ësht' lavdëruar shum'.

Hyjlindësore

Na qartësove mënyrën e ngjizjes së pashprehshme dhe të tër'shenjt'* të së d'lirës, pra Maris',* Lluka apostull; dukshëm Shpirt' i Tërëshenjtë erdhi mbi atë dhe Fjala, Zoti yn',* e hijesoi Zonjën ton';*[32] tek ai bashk' psalim, se me lavd ësht' lavdëruar shum'.

Ode III
Si i to steréoma

Ungjilli yt, o Lluka* i mrekullueshëm, shfaq qart'sisht,* tek njer'zit, se* na ka vizituar* nga lart lindja e Diellit.[33]

Përshkrove shkëlqyeshëm* në Shkrimet me një trajtim të fort'* ti besërisht* Veprat, që kan' bërë* shum' apostuj me hyjshmëri.

Ka bër' Pavli i tër'lumur* fillimin e lavdërimeve* për ty[34] prandaj,* dhe pasi të thuri* lavde, para nesh i ka vën'.

Hyjlindësore

Ty të lavdëron tani,* siç e ke profetizuar sakt',* çdo gjererat'* njerëzore, o Zonj',*[35] se shpëtohen tani me ty.

Irmosi: Si i to steréoma

»**T**i je përforcim për ne* që po përikim »tek ti, o Zot;* për sa që jan'* brenda »errësirës,* je drit'; shpirti im të »himnon.

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

U dallove si bashk'udhëtar besnik* i apostullit Pavël;[30] durove pra* rreziqe të ndryshme ti,* o apostull i Zotit Krisht'* me fam', dhe si atlet ke bër' udhën e besës[36] son'* dhe bashk' me të dëfrehesh në qiell lart, o i lum;* edhe predikove nëpër botë Ungjillin* e Krishtit dhe ndrite k'shtu* tërë dheun, Lluka me nam,* i nderuar* së tepërmi;* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Hyjlindësore

Malin e tëreshenjtë[37] le ta himnojm'* dhe Parajsën mendore, kthimin e mir'* të Evës dhe arkën[38] si* edhe portën[39] e qiellshme,* ren' shum' të ndritshme,[40] ferrën që digjej, por s'prishej dot,*[41] thesarin, pasurinë e madhe të botës son';* falje e mëkateve të lashta për ne ësht';* shpëtimi nga krimi yn'* u punua përmes asaj.* I thërrasim* pra me mall'ngjim:* Ndërmjeto te Zoti, yt Bir,* që ndjesë shkeljesh të jepet* me dorën plot,* për ata që i falen lindjes sate me bes'.

Ode IV
Epevis ef ipus

Kur u duke i shndritur nga vezullimi i Shpirtit, u denjësove t'i formulosh shkëlqyeshëm me duart e tua ligjet e tij për miqtë e Perëndisë që këndojnë: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Hiri i Ngushëllimtarit, pasi të gjeti ty tendë, u derdh në buzët e tua[18] pasu-

risht dhe të dalloi ty si predikues paqeje tek të gjithë që këndojnë besërisht: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

O i lavdëruar, u shfaqe me Pavlin pjesëmarrës në luftë dhe u denjësove drejtësisht për kurorat e mbretërisë, ku tani bashkë, të ngazëlluar thërrisni me një zë: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Duke gjetur Zoti bukurinë e mendjes sate që shndriste hirshëm[42] nga rrezja e hyjshme, të hirotonis predikues tek ata që këndojnë besërisht: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Hyjlindësore

Rrëzoi të fuqishmit prej froneve Zoti, siç tha Virgjëresha dhe nëna, ndërsa të uriturit i mbushi me të mira[43] të hyjnueshme, të cilët këndojnë besërisht: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Ode V
Fótison imás

Duke pritur dritë mendore në zemrën tënde, pasi u pastrove nga njollat e mëparshme, ua përhape, o Lluka, të gjithëve, për hir të ligjit të dashurisë.

O i tërëpasur Lluka, i ndriçuar tepër nga shkëlqimet e Hirit, u shfaqe qartë të flasësh perëndishëm me gjuhë të zjarrtë.[19]

Dëshirove shumë të shoqërosh Pavlin e urtë, sepse u mbiquajte i dashur,[34] si shërbëtor i Hirit, o ungjillor.

Hyjlindësore

Gëzohu vërtet, o thesar i virgjërisë, rithirrja e stërnënës dhe zgjidhja e mallkimit të stëratit.

Ode VI
Tin dhéisin ekheó

Ke ngjitur ti* mal virtytesh, apostull,* edhe flisje me atë që fort doje,* edhe më pas* prite si Moisiu* pllakat e shkruara me gisht të Shpirtit[12] t' Shenjt',* Lluka, mësues botëror,* pllakat që kishin qen' të dyfishta pra.[44]

Ndriçove fort* me mësimin tënd të Shenjt'* gjithë botën tonë, o oratori* i Kishës son',* se ti fekse me dritat* e shën Triadhës, që nuk u krijuan kurr';* prandaj u bëre si një yll,* si pishtar, që shkëlqen gjithë rruzullin.

Tani shëron,* o i hyjfrym'zuar ti,* çdo sëmundje shpirti si më par' trupat;* me mir'besim* u dhurua nga q'elli* lart kjo dhurat' tek ti; ke hirin pasurisht,* se Pavli për ty e dëshmon,* se ti je mjek[34] me Hirin e Shpirtit t' Shenjt'.

Hyjlindësore

Ka hedhur syt'* mbi ty Zoti,[35] kur ai* përtërinte gjith' esencën njer'zore,* siç ti ke thën',* o hyjnën' e panjollshme,* kur bënte ky madhështit' si i fortë shum';*[45] nga prishja më shpëton ai* përmes teje si Zot, njeridashësi.

Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»Do derdh lutjen* para Zotit Perë»ndi* dhe atij do t'i tregoj hidhërimet* »që kam,[46] sepse* shpirti im është »mbushur* me çdo të keqe dhe jeta »po shkon në Hadh;*[47] pra si Jonai »lutem un':* Jetën time nga prishja, »Zot, ngrije ti.

Kontaqi
Ting. IV
Epefanis símeron

Kur u bëre nxënës ti* i Fjalës, Zotit,* bashk' me Pavlin botën fort* na e ndriçove, o Lluka,* dhe e dëbove krejt mjegullën,* duke na shkruar Ungjillin e Krishtit ton'.

Shtëpia

Si mjek dhe nxënës i dashur, o Lluka, shëro me kirurgji mistike pasionet e shpirtit tim dhe bashkë me to edhe të trupit tim; më jep gjendje të mirë shëndetësore në çdo fushë dhe bëmë që të lavdëroj i gëzuar panairin tënd të famshëm dhe ta njom shumë trupin tënd të respektuar dhe të tërënderuar me shira lotësh në vend të mirove; sepse si shtyllë jete e shkruar brenda Kishës së mrekullueshme të Apostujve, u thërret të gjithëve, sikurse ti në fillim, duke na shkruar Ungjillin e Krishtit ton'.

Sinaksari

Më 18 të të njëjtit muaj, kujtimi i apostullit të shenjtë dhe ungjillorit Lluka.
Vargje: "Edhe pse më parë pengohesha të të shikoja në Emaus,[48]/ tani të shikoj fort, o Krisht,"[49] thotë Lukai.
Më 18 Llukai ngjëroi fund jete.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Marinit plak.
Vargje: Plaku Marin, i ri në guxim,/ kritikon mashtrimin plak dhe mbaron me shpatë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Julianit në Efrat.
Vargje: Juliani i gëzuar kapërcen/ jetën që kalon si ëndërr.

Shën Mnasoni, episkop i Qipros dhe 40 fëmijët e shenjtë mbarojnë me shpatë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i etërve tanë oshënarë Simeonit dhe Theodhorit, ndërtuesit e Manastirit të Shpellës

së Madhe në Peloponez, edhe oshënares Efrosina bareshë.

Kujtimi i martirëve të shenjtë që u shfaqën së fundmi, Gabrielit dhe Kirmidholit, që u martirizuan në Egjipt më 1522.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Pedhes Evreon

Oh, si Zoti iu shfaq nga varri Llukait dhe Kleopës! Sepse, pasi u ngjall, i mësonte ata[50] të thërrisnin: I bekuar je, o Zot Perëndi, në jetët.

Duke kaluar shpejt udhën e jetës, gjete, o i lumur, Fjalën të bashkudhëtonte,[51] i cili të hapi[29] dyer tendash qiellore ty që thërrisje: I bekuar je, o Perëndi, në jetët.

U dëfteve kitarë e Shpirtit, e cila nxirrte melodi nga Perëndia, duke ndriçuar, o Lluka, njerëzit që thërrisnin: I bekuar je, o Zot Perëndi, në jetët.

Hyjlindësore

Gëzohu, o Mari Perëndilindëse, të thërriste ty i patrupi, o Virgjëreshë; dhe bashk' me të ne besëtarët të thërrasim në lindjen tënde: I bekuar është, o e tërëkulluar, fryti i barkut tënd.

Ode VIII
Ton en ori ajio

Pasi i kemi pranuar librat e tu si pllaka të hyjshkruara,[12] shijojmë shumë dhe besërisht ndriçimin e Hirit, o i tërëpasur, duke himnuar dhe përmbilartësuar Zotin në gjithë jetët.

Shpirti, duke përdorur si instrument gjuhën tënde, i ndriçon njerëzit duke u zbuluar dogmat e Hirit atyre që himnojnë Zotin dhe e përmbilavdërojnë në gjithë jetët.

U lidhe me Pavlin hyjfolës, o Lluka hyjfolës, dhe u dëftuat dyshe e gjithënderuar, duke himnuar Zotin dhe e përmbilartësuar në gjithë jetët.

Me rrjetën e fjalëve të tua të thurur hyjshëm, o predikues i perëndishëm, i kape në jetë për ndriçimin e besës ata që mbaheshin në mashtrim, të cilët himnonin Zotin dhe e përmbilartësonin në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Elisabeta, kur mbante Pagëzorin dhe Pararendësin, duke u treguar profeteshë, të përshëndeste si nënë Zoti[24] dhe thërriste: Zotin himnoni dhe e përmbilartësoni në jetët.

Irmosi: Ton en ori ajio

»**K**'të që mbi mal të shenjt' u lavdë-

»rua*[37] dhe në ferrën me zjarr[41] i »shfaqi Moisiut* misterin e gjithmo- »nëvirgjëreshës, pra Zotin e lëvdoni,* »dhe e lartësoni atë në gjithë jetët.

Ode IX
Orus parilthes

Qëndrove, o Lluka, tek dëshira, pasi mbërrite në skajin e të dashurve, dhe arrite qartësisht në fundin e lumur, pasi u zgjidhën pasqyrat[52] me shfaqjen e së vërtetës.

Pasi shndrite në botë si dielli,[53] qëndron pranë Trinisë hyjshmërisht bashkë me Pavlin hyjshikues, o Lluka i tërëfamshëm; tok me atë që shfaq hyjnoret, të madhërojmë pa pushim.

Përgjëroju, o Lluka, që të kënaqen me lavdinë tënde dritëprurëse himnuesit e tu, dhe dhuroji botës paqen, o i tërëlumur, që të të madhërojmë pa pushim, o hyjfolës.

I gëzuar, o Lluka, tani qëndron pranë mbretit të të gjithave, i stolisur me stemën e hijeshisë së hyjshme dhe të bukurisë;[54] prandaj, o hyjfolës, të madhërojmë pa pushim.

Hyjlindësore

E pranove Fjalën pa mish, që donte të rigatuante natyrën time, dhe atë kur u mishërua ti e ke lindur; prandaj, o Perëndilindëse, të madhërojmë pa pushim.

Irmosi: Orus parilthes

»**K**apërceve kufijtë e natyrës, duke »zënë Bërësin dhe Zotin dhe je bërë »portë shpëtimi për botën; prandaj, o »Hyjlindëse, të madhërojmë pa »pushim.

Dërgimësore
Tis mathités sinélthomen

Mësues kombesh,[55] o Lluka,* apostulli i Krishtit,* njohës misteresh na je ti;* me Pavlin korife tok* dhe gjithashtu bashk' me Zonjën,* ikonën e së cilës* e bëre nga dëshir' e zjarrt',* hyjshikues, ti lutu për ne të gjith',* që nderojmë fjetjen tënde të shenjtë* si dhe të lumërojm' gjithnjë,* o i tër'urt' hyjfolës.

Hyjlindësore

Nëpër rreziqe ti mbërri,* o Zonj' tër'- mbretëreshë,* në pikëllime ti mbërri,* pran' qëndro, kur do kemi* nevoj' në ditën e fundme,* të mos na marrë djalli,* satani, Ferri, humbja krejt,* por ne le të qëndrojm' pa faj, pra pa ankth* para podiumit të frikshëm, tmerr'sisht* të Birit tënd, se si hyjnën'* e d'lir', arrin sa ti do.

Lavdërime
Ting. I
Nefelin se fotós

Shkrimtarin e tër'urt' të ungjillit, ikonën* shum' të bukur, të gjall', të shenjt', të enës së zgjedhur[16] dhe* nxënësin e Krishtit, lavdërimi shpirtëror* i të cilit në çdo Kish' ësht',[34] ne, o besnik', le ta nderojmë apostullin Lluka, se na predikoi shum' mrekulli me Hir* të habitshëm të Zotit, ndaj ndriti të vdekshmit mbi dhé e kudo,* me rreze theologjie, pra nëpërmjet Hirit.

U frymëzove nga urtësia e Zotit* edhe duke mësuar mir' mjek'si shpirtrash më shum' se* mjekësin' e trupave, u shqove mrekullisht* në të dyja, dhe k'shtu i shëron shpirtrat, trupat me urt'sin' zotërore, o Lluka, dhe për dije fton; u jep krah' ti njer'zve për* dashurinë e Zotit; i ngre ata drejt qiellit, drejt lavdis'* dhe ndërmjeton për të gjithë që të lëvdojn' me zell.

Pasi i ke tërhequr në dijen e hyjshme* dhe si peshq me një grep mendor, ata që në thellësi,* pra në injoranc' u futën, si ushqim të mir',* o i lumur, i çove tek Krishti,[56] pasi k'shtu morën çmim shum' të vyer, jetë të pacenuar, të përhershme; prandaj je bër'* ti apostull i Zotit, shkrimtar Veprash, që Hiri i Shenjt' ka bër',*[57] dhe ungjillor i urt', dhe predikues plot sukses.

Pastaj këtë Idhiomel:

Ting. Tërth. IV
I Leonit Mjeshtër

Eja, e tërë Krijesa, le ta lavdërojmë me këngë Llukain e dëgjuar, mjekun vërtet shpirtëror dhe nxënësin e Shpëtimtarit, sepse ai e shëroi sëmundjen e ateizmit me pomadën e kolimvithrës së Krishtit; dhe nga goja e tij vaditi pasurisht vende frymore me lumenj[58] çurkash, që buruan hyjnisht nga Ungjilli; prandaj doli sipas profecisë zëri i tij nëpër botë[59] dhe ndërmjeton që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Lavdi *I njëjti*

Duke u mbledhur, o besnikë, le t'i thërrasim me këngë Llukait, oratorit mistik të Fjalës, me mënyrën e Davidit: Gjuha jote u dëftua kallam shkruesi, pra i Krishtit, shkruesit të shpejtë,[60] duke zbukuruar fytyrat e kombeve për njohjen e dijes së hyjnueshme e të saktë, brenda së cilës predikove me fuqi Ungjillin dhe shkrove Veprat e bashkapostujve të tu; prandaj duke qëndruar pranë Trinisë, Perëndisë, ndërmjeto për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i ungjillorit, Odet III dhe IV.

Kungatore: Në gjithë dheun.

CITIME

[1] Ps. 18(19).1

[2] Matth. 24.27; Lluk. 17.24

[3] Fja. Urt. 9.1-3

[4] Gjen. 2.10

[5] Eks. 31.7; 39.15; Num. 10.33; 14.44; Ligji i Dytë 10.8; 31.9, 25 etj.

[6] Fil. 2.15

[7] Eks. 35.16; 38.13; Num. 4.9

[8] Eks. 25.29; 39.18; 40.21; Lev. 24.6

[9] Joan 6.35,51

[10] Matth. 26.27-28; Lluk. 22.20; I Kor. 11.25 etj.

[11] Eks. 31.2-4; 35.30-32

[12] Eks. 31.18; Ligji i Dytë 10.1

[13] Is. 2.3

[14] Kol. 2.3

[15] I Tim. 3.15

[16] Vep. 9.15

[17] I Kor. 4.16

[18] Ps. 44(45).3

[19] Vep. 2.3

[20] Abak. 3.11; Zah. 9.14

[21] II Kor. 2.16

[22] Lluk. 1.1-3

[23] Lluk. 1.28

[24] Lluk. 1.43

[25] Lluk. 1.24

[26] Ps. 106(107).23-24

[27] Rom. 13.14; Gal. 3.27

[28] Fja. Urt. 9.1-2

[29] Lluk. 24.32

[30] II Kor. 8.19

[31] I Petr. 2.21

[32] Lluk. 1.26-35

[33] Mal. 4.2; Lluk. 1.78

[34] II Kor. 8.18; Kol. 4.14

[35] Lluk. 1.48

[36] II Tim. 4.7

[37] II Petr. 1.18

[38] Ligji i Dytë 10.2; Hebr. 9.4

[39] Gjen. 28.17

[40] Eks. 13.21-22; Num. 9.15

[41] Eks. 3.2-3

[42] Ps. 44(45).4

[43] Lluk. 1.52-53

[44] Eks. 19.20-24; II Petr. 1.18

[45] Lluk. 1.49

[46] I Mbret. [Sam.] 1.15; Ps. 141(142).3

[47] Ps. 87(88).4

[48] Lluk. 24.16

[49] Lluk. 24.31

[50] Lluk. 24.27

[51] Lluk. 24.15

[52] I Kor. 13.12

[53] Matth. 13.43

[54] Is. 62.3

[55] I Tim. 2.7; II Tim. 1.11

[56] Joan 21.5,10

[57] Veprat e Apostujve

[58] Joan 7.38

[59] Ps. 18(19).5

[60] Ps. 44(45).2

MË 23 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i Jakovit, vëlla i Perëndisë, apostull dhe hieromartir.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime
Ting. IV ´Edhokas simíosin

Eni të nderojm' kujtimin e vëllait të Perëndis'* shenjtërisht, o hyjmendës ju,* se priti me plot dëshir'* zgjedhën e Jisuit*[1] edhe është bër' predikues' i mir'sis së tij* dhe mbretëris', edhe i besoi k'tij* ekonomin' e tij,[2] që s'mund ta shprehë me fjal' asnjë njeri.* O i tërëpushtetshëm Zot,* përmes tij faljen na dhuro.

(2x)

Fjala, zëri yt gjëmoi në gjith' anët e botës[3] son'* dhe ushtoi jehona larg;* me to po ndriçohemi* në të gjith' idetë* e virtytit, edhe ne udhëhiqemi me bes'* drejt njohuris' së shenjt' të Trinis' së Shenjt';* të lusim ty si hierark, lutju për ne njeridashësit,* Krishtit, që të shpëtojnë krejt* shpirtrat tanë me dhembshuri.

(2x)

Duke parë jetën edhe sjelljen tënde nga larg, por qart',* o Jakov, të ka marr' si v'lla* Jisui i tërëurt',* që njeh çdo gjë më par',* dhe të dorëzoi zbulues gjërash të hyjshme,* kryebari të Jerusalemit pra* për kryerjen e çdo misteri të shenjt' dhe të pashprehshme ty;* lutu tash edhe përgjithmon',* të shpëtojn' shpirtrat tan' përjet'.

(2x)

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Me gjakun e martirizimit e stolise priftërinë, o apostull hieromartir; sepse duke qëndruar në buzë të çatisë së Tempullit,[4] predikove Fjalën Perëndi, se ka qenë Bërësi i gjithçkaje; prandaj, kur u hodhe poshtë prej judenjve, u denjësove për dhoma qiellore; o vëlla Perëndie Jakov, përgjëroju Krishtit Perëndi, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Triímeros anestis

Çdo shpresë timen vë un' tek ti,* o Zonjë, Virgjëresh' e dëlir';* mos më hidh tej,* por nxito të më shpëtosh* shpejt, o e mir', nga vese që më shqet'sojn' përditë dhe më luftojn' me ashpërsi gjithnjë.

Pasvargje
Ting. Tërth. IV
Kírie i qe kritirio

O Zot, megjithëse Jakovi qëndroi

majë çatisë së Tempullit,*[4] ty të predikoi me forcë,* Perëndinë edhe Fjalën Zot,* krijues të Gjithësis',* që erdhe brenda botës son';* të përgjërojm', jep me ndërmjetimin* e tij tash ndriçim tek shpirtrat tan'.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij.

O Zoti ynë, edhe pse në një dru është thyer koka e v'llait tënd,* por u soll tek druri i jetës* në Parajsë[5], për gëzimin tënd,* sepse pasi ky u zgjidh* nga të përkohshmet, ka hare* të amëshuar;[6] dërgoji Kishës* paqen tënde, siç të lutet ty.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

O Zot, meqen'se të pohoi si Bir të të Lartit me trimëri yt v'lla,* u gëzua thell', sinqerisht pra,* o Jisu, v'llai i njohur shum',* dhe i shkat'rroi me turp* armiqtë me nam fort të keq* dhe si atlet u martirizua* dhe qëndron pran' teje me hare.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Duke u bërë vëlla dhe pasardhës i kryebariut Krisht[7] dhe i shquar midis apostujve,[8] deshe vdekjen për hir të tij dhe nuk u turpërove nga martirizimi,[9] o Jakov i lavdëruar; atij përgjëroju pandërprerë që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Kírie i qe kritirio

Shih psherëtimat, o hyjnuse, të zemrës që ësht' dërrmuar, dhe priti ti,* o Mari e virgjër krejt, ngritjet* lart të duarve;[10] mos më dëbo,* o e kulluar, e d'lir',* se ti je dashamirëse,* që të himnoj dhe të lavdëroj un'* Krishtin që e madhështon njer'zin'.

Përlëshore
Ting. IV

Si dishepull i Zotit, o i drejtë, more përsipër Ungjillin;[11] ke durimin e patundur si dëshmor; ke guximin si vëlla i Perëndisë; ke ndërmjetimin si kryeprift; pra lutju Krishtit Perëndi, të shpëtohen shpirtrat tanë.

NË MËNGJESORE

Stihologjia e zakonshme dhe Kanunet e Oktoihut dhe të apostullit në 6 tropare.
Poezi e Theofanit

Ode I
Ting. IV

Thalasis to erithreon

Shum' qart' ti* mëson tek ne, se çdo

dhënie e mir' dhe çdo dhurat'* e shenjtë, e përsosur, o Jakov,* zbret nga Ati i dritave*[12] te njer'zit; ne që të himnojm', lutu të marrim pjes' në to me gaz.

U fekse* ti prej lavdis' së Shpirtit t' Shenjt dhe bashk' me të vendos* dhe ligjet, o Jakov, dhe sistemon* si apostull i Krishtit ton'* pra Kisha kombesh, o i tërëlumur dhe hyjshfaqës, shenjt i madh.

Ti korin* e nxënësve, i tërëlumur, zbukurove qart',* meqë u bëre kryeprift i par';* nga vet' duart e Fjalës ke marr'* krezmim porsi apostull, predikues shum' mistik si dhe hyjv'lla.

Hyjlindësore

Të kemi* porsi burim shërimesh, ku ne marrim çdo shërim* për shpirtrat, rifitim trupi je ti,* se burimi i jetës u lind* prej teje, o Hyjlindëse e tër'himnuar, e lavdishme shum'.

Ode III
Efrénete epí si

Ja fisi i Judës sot* më ty dëfrehet, se të sheh të shkëlqesh* nga drita e v'llait tënd,* pra nga llamburitjet e Zotit ton'.

Ja Kisha e kombeve*[13] të ka ty predikues plot me lavdi,* yll fort të shkëlqyeshëm,* pra ndriçohet prej teje si pishtar.

Në Kishën e Krishtit ton'* e vure ligjin jetësor dhe të shenjt',* duke folur edhe marr'* ligj prej Shpirtit[14] t' Shenjt', jetëbërës krejt.

Hyjlindësore

Atë që u lind nga ti* me mish, o Virgjëresh', dhe që nga Ati* feksi,[15] porsi Perëndin'* e Gjith'sis' e shpallte Jakovi, qart'.

Irmosi: Efrénete epí si

»**D**ëfrehet në ty, o Krisht,* dhe të thë»rret ty Kisha jote me gaz:* Streha, për»forcimi im* dhe fuqia ime je ti, o Zot.[16]

Ndenjësore
Ting. I
Ton tafon su Sotír

O hyjvëlla i urt',* o Jakov ti, martir trim,* i lumur apostull okular i Jisuit,* ata që besërisht festojnë kujtimin tënd me respekt,* ti çliroi krejt* nga fajet që i shtrëngojnë,* për ne ndërmjeto* tash që shëtit nëpër qiejt,* me forcën e Shpirtit t' Shenjt'.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Tin sofian qe Logon

Farefisi i Krishtit ke qen' në mish;*

nga ai pra ke marrë hir me bollëk,* ndriçimin dhe dijen bashk'* të shum' urt', o apostull ti,* dhe k'to ua përçove të gjithëve, o Jakov,* edhe çrrënjose krejt'sisht mashtrimin e idhujve;* k'shtu dhe kryetarët e err'sirës[17] së kobshme* të vranë padrejtësisht,* ndërsa po predikoje qart'* Shpëtimtarin;* thërresim pra:* Ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonj', nuse e tër'pacenuar je*[18] e Krijuesit, nën' pa aspak përvoj'* martese, na linde ti* Çlirimtarin; ti je një en'* e Shpirtit t' Shenjtë Ngushëllimtar; por un' jam vërtet* bodrum i turpshëm paligjësish, jam me dijeni* lodër djalli, o e tër'himnuar, nxito pra,* shpëtomë nga çdo dhunim,* që më bëjn', edhe bëmë ti* një banesë* të ndritëshme* të virtytit edhe dëbo* çdo re pasionesh prej meje;* më denjëso* të marr pjes' në lart'si, në dritën që s'perëndon.

Ode IV
Dhi agápisin iktirmon

I hipe në det kuajt e tu,[19] pra apostujt, o Shpëtimtar, dhe i ndriçuan kombet duke i tërhequr drejt njohjes sate, o Zot.

Pasi u tregove si një pasqyrë e panjollshme[20] dhe kur pranove me përpikmëri rrezet parakrijuese të Triadhës së pandërtuar, u ndrite të gjithëve.

Profecia të sheh si gur të shenjtëruar, që rrokulliset dhe dërrmon[21] kotësi të kalbur mashtrimi me fuqinë e Shpirtit.

Hyjlindësore

Fjala e parajetshme, që u lind në mënyrë të pashprehshme nga Ati, pasi u fut në barkun tënd, o Nënë Virgjëreshë, Jakovin e tregon si apostull.

Ode V
Si Kírié mu fos

Ti, o Zot, e paraqite Jakovin si rrufe drite që flakëron dhe i çliron të vdekshmit nga injoranca dhe mashtrimi.

Ty të predikoi, o Zot, zëhapur vëllai yt i drejtë dhe kur e vranë, u bë imitues i pësimit tënd.

Cila mendje njerëzore do të mund që të të blatojë një himn lavdërimesh, o Jakov, që shndrite me hiret e virtytit?

Hyjlindësore

Pasi të gjeti ty banesë vërtet të hyjnueshme, banoi në ty, o Virgjëreshë, Fjala, duke paramenduar shpëtimin tonë.

Ode VI
Thiso si metá fonís

Një stoli* shum' më të mir' se petku ligjor të vesh,* stoli të çmuar më tepër* se dikur stolia e Aaronit,*[22] të tregon ty* pra hierark ai që të bëri v'lla.

Je bërë* një vegël që të luajnë energjit'*[23] e Shpirtit, edhe çdo mendje* e tërheq shkëlqyeshëm; dhe i çon ti* Perëndisë,*[24] sa shpëtuan nga një robëri plot tmerr.

Kishe ti* etje dhe çurka jete ke pirë mjaft;* lumenj hyjthëniesh buron mir',* që kërcejn' dhe dalin prej barkut[25] tënd qart'* për të gjithë* me hir prej Shpirtit t' Shenjt', o Jakov i madh.

Hyjlindësore

Mosbindja* e Evës lindi vdekjen, por Zonja jon'* Hyjlind'se zuri dhe lindi* jetën që nuk plaket kurr', edhe shleu* për të gjith' k'shtu* një borxh, të cilin kishim qëmoti ne.

Irmosi: Thiso si metá fonís

»Do flijoj* me zë himnimi, Kisha thë»rret tek ti,* o Zot, sepse përmes gja»kut,* që nga brinja jote për përdëllim »rrjedh,* u pastrua* nga çdo pisllëk »prej gjakrash demonësh kjo.

Kontaqi
Ting. IV
O ipsothís en to stavró

Perëndi Fjala, që ësht' i vetëmlindur* nga Ati, kur erdhi tek ne, k'tu në ditët* e fundme, të tregoi ty mësues, bari,* episkop të parë në Sion* dhe administrator besnik*[2] hiri dhe misteresh krejt* shpirtërore; prandaj ne,* o shën Jakov i mrekullueshëm,* të gjith', apostull, me shum' respekt të nderojm'.

Shtëpia

Të përhimnojmë besërisht me himne lavdërimi ty, fëmijën e Josifit edhe hierarkun e parë të Jerusalemit, edhe vëllain e Zotit, o Jakov hyjpamës, dhe thërrasim besnikërisht: Na dhuro një dhuratë të përsosur nga Ati i dritave[12] dhe dëbo pikëllimin që po vjen dhe tashmë është i pranishëm nga shumicë shkeljesh; sepse armiqtë e ngritën kundër nesh thembrën[26] dhe na rrethuan ismailitë; thyei shpejt harqet[27] e tyre, o hyjzbulues, që të gjith', apostull, me shum' respekt të nderojm'.

Sinaksari

Më 23 të të njëjtit muaj, kujtimi i hieromartirit të shenjtë dhe apostullit Jakov, hyjvëllait.
Vargje: Pasi u quajte vëlla i të dënuarit me dru,/ vdes për të, o i gjithëlumur,

i goditur me dru.
Hyjvëllanë e famshëm e goditën me dru më 23.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Ignatit, patriarkut të Konstandinopojës.
Vargje: Pasi u shpërngule, gjete vlerën e vjetër,[28]/ o Ignat, kryetar i Romës së Re.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Makarit romak.
Vargje: Deshe të banosh në shkretëtirë, o i tërëlumur,/ për të folur i vetëm me Perëndinë e vetëm.

Ati ynë oshënar Niqifori, themeluesi i manastirit në Harsianin dhe oshënar Petroni mbarojnë në paqe.

Dy fëmijë të shenjtë, pasi u detyruan të vraponin mbi zjarr përtokë, mbarojnë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
En ti kamino

Duke u përflakur në katin e sipërm, si në furrë, nga prania e Shpirtit Hyjnor[29] mistikërisht, Jakovi thirri: I bekuar je në Tempullin e lavdisë sate, o Zot.

Era e vrullshme nga lart me gjuhët zjarrformëshe[29] e bëri Jakovin të thoshte madhështitë e Perëndisë.[30] I bekuar je në Tempullin e lavdisë sate, o Zot.

Duke ekspozuar ti një pllakë me teori praktike, si nga një kuti shpirtërore, i udhëhoqe drejt virtytit njerëzit duke thirrur: I bekuar je, o Perëndia im dhe Zot.

Hyjlindësore

Ai që rigatoi botën brenda mitrës sate, o hyjnuse, e dëfton bërës shërbimi të hyjnueshëm Jakovin, që thërret: E bekuar je ti në mes të grave, o e paqortueshme.

Ode VIII
Hiras ekpetasas Dhaniíl

Duke ngritur duart e fuqishme, o Shpëtimtar, bekove apostujt e tu kur ktheheshe, o Zot, tek Ati yt[31] pa fillim dhe i bëre që të thërrasin me ngazëllim: Bekoni gjithë ju veprat e Zotit, Zotin.

Siç premtove pa gënjeshtër, u dërgove apostujve të tu Shpirtin;[32] Jakovi i ndriçuar, o Zot, nga shkëlqimi i tij, ndriçon fort me llamburitje e me hijeshi botën dhe thërret: Gjithë ju vepra, himnoni Zotin.

Urtësinë enipostate, o Jakov i urtë, e kishe mësues,[33] e cila të udhëhiqte në mistere të pathëna dhe të pashpreh-

shme; dhe nxite popuj drejt shpresë-tarisë duke kënduar: Bekoni gjithë ju veprat e Zotit, Zotin.

Hyjlindësore

Profeti të sheh ty, o Virgjëreshë e papikëluar, të dukesh qartë mal mendor, sepse prej teje një gur i prerë i përmbiçmuar shpëtoi me të vërtetë botën[21] që psal perëndishëm: Bekoni gjithë ju veprat e Zotit, Zotin.

Irmosi: Hiras ekpetasas Dhaniíl

»Duke* ngritur duart Danieli mbylli »gojët e luanëve në grop';* dhe shuan »forcën e zjarrit krejt* kur u ngjeshën »me virtyt Djemtë,* pra miqtë e shpre-»sëtaris',* duke bashk'thirrur me gaz: »Bekoni* ju gjithë veprat e Zotit, pra »Zotin ton'.

Ode IX
Lithos ahirótmitos orus

Ejani që të madhështojmë të gjith' me himne të shum'hyjshme* hierar-kun që ish i pari në fron,* ndriçuesin pra të Kishës sonë,* që e thërrisnin qart' i drejt',* dhe ishte predikues shum' i mir'.

Ne të madhërojm', se u duke pjes'-marrës mbretërie pa fund* dhe të hyj-shme,[34] që kishe shortin të jesh* vëlla Perëndie dhe që jetën* e kishe vër-tetuese* ti sipas emrit tënd, o shën Jakov.

Pranë fronit të Shën Trinisë qëndron dhe je kurorëzuar;* lut pra Zotin tonë që sa të nderojn'* me bes' dhe dëshi-rë, të shijojnë,* o kryeprift i lumur shum',* çmimet që s'kan' të met', Jakov me nam.

Hyjlindësore

Ti të fshehtën na e mëson, se ësht' Perëndi ai që lindi* nga e virgjër pa burr', hyjshfaqës i qart',* pra Fjala e mishëruar në trup.* Atë ne e besojmë shum',* e madhështojmë denjësisht tani.

Irmosi: Lithos ahirótmitos orus

»Si një gur i prer' pa vën' dorë nga »mali yt i palatuar,* Virgjëresh', ësht' »prerë gur[21] qosheje ky,*[35] pra Krishti, »i cili i bashkoi* natyrat krejt të ku-»ndërta;[36] ndaj me gëzim të madhë-»shtojmë ty.

Dërgimësore
Tis mathités sinélthomen

Si hierark i par' me fam'* i Dhiatës son' të Re dhe* si një apostull shum' i madh,* si një profetmësues* i urt' dëshmon të vërtetën;* je pasuruar më

shum'* se cilido me grad' të lart',* v'llazërinë[5] e Zotit; edhe tani* që me gurë vritesh, shpërngulesh pran' tij;* për ne ti nga ai kërko* ndjesë dhe falje shkeljesh.

Hyjlindësore

Përpara dyerve qëndron,*[37] ja dita më e madhe* edhe e frikshme[38] e gjyqit,* o shpirti im, shiko, ki* gatishmëri edhe kujdes;* bjer para Virgjëreshës,* që është' hyjnënë vetëm kjo,* dhe thërriti me lot ti: Të lutem shum',* më shpëto nga çdo ndëshkim, o e d'lirë,* dhe bashk' me qengjat më vendos* djathtas,[39] pran' Birit tënd, Zonj'.

Lavdërime
Ting. I
Ton uranion tagmaton

O turma të besimtarëve, duke bër' tani* me gaz kremtim të hyjshëm,* të gjith' të brohorasim,* duke lavdëruar hyjv'llan' me bes',* me psalmime, me këngë sot.* Ka qen' dhe nxënës i Zotit, dhe përgjithmon'* ndërmjeton që të shpëtohemi.

(2x)

Ti u tregove vëlla i Jisuit mishërisht* kur mbi dhé, o i urtë,* erdhi; je dëshmitar ti,* që ke par' mistere, edhe me të* në Egjipt u mërguat tok,* dhe me Josifin dhe nënën e Krishtit ton';*[40] me k'ta lutu të shpëtohemi.

Të zgjodhi ty bashkësia apostolike qart'* të bësh i pari punën* priftërore në vendin* shum' të shenjt' Sion dhe të adhurosh* Krishtin mir'bërës si vëlla,* kur lindi pas mishit, të jesh bashk'udhëtar* nëpër gjurmët e tij,[41] o Jakov.

Lavdi *Ting. I*

I Bizantit

Kur u ndriçove brenda shkëlqimit të zjarrtë të Shpirtit të Shenjtë, u duke plot me perëndishmëri, i zellshëm në shpresëtari, o Jakov hyjvëlla;[42] prandaj ai që të pranoi në vëllazëri për përdëllim, të veshi stoli më të çmuar se kjo e priftërisë ligjore e Aaronit të vjetër;[22] lyp tek ai, o i lavdishëm i apostujve,[8] që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Meqë pranon lutjet e mëkatarëve dhe nuk shpërfill rënkimin e të pikëlluarve, ndërmjeto tek ai që lindi nga barku yt i dëlirë, që të shpëtohemi, o Hyjlindëse e virgjër.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i apostullit, Odet III dhe VI. Apostulli nga Letra e Galatianëve: Vëllezër, u bëj ta

dini ju se ungjilli; *Kërkoje në të dielën e 20. Ungjilli sipas Markut:* Në atë kohë erdhi Jisui në dheun e tij; *Kërkoje në të martën e javës së 15 të Mattheut.*

Kungatore: Në gjithë dheun.

CITIME

[1] Matth. 11.29

[2] Lluk. 12.42; I Kor. 4.2; 9.17

[3] Ps. 18(19).5

[4] Matth. 4.5; Lluk. 4.9

[5] Gjen. 2.9; 3.22,24

[6] II Kor. 4.18-5.1; Fil. 1.23

[7] I Petr. 5.4

[8] Vep. 12.17; 15.13; 21.18; Rom. 16.7; Gal. 2.9

[9] II Tim. 1.8,12

[10] Ps. 140(141).2; I Tim. 2.8

[11] Gal. 2.2

[12] Jak. 1.17

[13] Rom. 16.4

[14] Rom. 8.2

[15] Hebr. 1.3

[16] Ps. 17(18).2

[17] Ef. 6.12

[18] Kënga 4.7-8

[19] Abak. 3.15

[20] Urt. Sol. 7.26

[21] Zah. 9.16; Dan. 2.34-35,44-45

[22] Eks. 28.2-3

[23] II Mbret. [Sam.] 6.14

[24] I Petr. 3.18

[25] Joan 7. 38

[26] Ps. 40(41).10; Joan 13.18

[27] Ps. 45(46).10

[28] Gjen. 2.15

[29] Vep. 2.2-4

[30] Vep. 2.11

[31] Lluk. 24.50-51

[32] Joan 14.16,26; 15.26; 16.7; Vep. 2.38-39

[33] Fja. Urt. 24.(Mas. 30.3); Urt. Sol. 7.21

[34] II Petr. 1.4

[35] Is. 28.16; Ef. 2.20; I Petr. 2.6

[36] Rom. 5.10-11; II Kor. 5.18-19; Ef. 2.17-18

[37] Apok. 3.20

[38] Joel 2.1,11; 3.4(2.31); Sof. 1.14

[39] Matth. 25.33

[40] Matth. 2.13-19

[41] I Petr. 2.21

[42] Vep. 21.18-20

MË 26 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i martirit të madh të shenjtë Dhimitër Mirovlitit dhe kujtimi i tërmetit.

Tipikon

Nëse bie e shtunë, në të njëjtën ditë, pra të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të shën Nestorit. Lavdi Sot na mbledh. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi Shpirti yt tepër i hyjnueshëm dhe Tani i tij. Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe Hyjlindësore Ti që ndërmjetove. Në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor dhe i pari i shenjtit. Pastaj të gjitha të së dielës vetëm.

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 vargëzime ngjallësore dhe 6 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtit. Tani O Zonjë e Tërëshenjtë (e Vargëzimeve). Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe e tërmetit në vend të Hyjlindësores.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, Pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e shenjtit dhe Himne Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret: nga një ngjallësore dhe nga një e shenjtit bashkë me Hyjlindësoren e saj. Pas Polieleit, Ndenjësoret e shenjtit. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat e tingullit dhe Proqimeni. Kanunet: ngjallësor, i tërmetit dhe i parë i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Ndenjësoret e shenjtit dhe të tërmetit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Dërgimësoret: ngjallësore, e shenjtit dhe Hyjlindësore e saj. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të shenjtit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e tërmetit, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Apostulli i shenjtit. Ungjilli i së dielës.

NË MBRËMËSORE

Stihologojmë Stancën e parë të Psaltirit (Lum ai njeri).

Vargëzime
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

O çudi paradoksale krejt'sisht! Nëpër qiell dhe dhé* ka shkëlqyer një gaz i

madh* për kujtimin madhështor* të Dhimitrit, martir i shenjt'.* Nga njer'-zit pret këngë dhe prej engjëjve* kurorëzohet me lavdërime plot.* Sa mir' luftoi ky;* si në ndeshje doli fitimtar? Prandaj* ra armiku nga ai, fitoi Krishti yn'.

O çudi paradoksale krejt'sisht! Ndrit Dhimitri martir* anembanë planetit ton'* me çudit' që rrezatojn'* më shkëlqyer se dielli;* nga drit' që s'njeh mbrëmje ky ndriçohej plot* dhe ngazëllohej me drit' që s'perëndon.* Me flakërim prej tij* u përzunë ret' barbare përgjithmon',* u dëbuan dhe sëmundje, djajtë munden krejt.

O çudi paradoksale! U shpua me shtizë shum' keq* shën Dhimitri për Krishtin ton'* dhe gjithmon' u duk si shpat'* me dy presa[1] për çdo armik,* që krenarin' armiq'sore ky e korr* dhe arrogancë demonësh e rrëzon.* Le t'i thërrasim pra:* O Dhimitër, shenjt' me fam', mbulona ne* që lëvdojm' kujtimin tënd të vyer me respekt.

Je treguar si një kullë shpres'tarie me bazament* përmbi gurin e besës son'* sigurisht, që në ngacmim* s'bie dhe nuk lëkundesh dot* gjatë rreziqesh, se vrull, furtun' e fort'* nga ateistët dhe dallgë kanë rën',* përplasen, por aspak* nuk e mposhtën sigurinë[2] tënde kurr',* ngaqë deshe zbukurim, kurorë si martir.

Ke marr' energji çudish prej Krishtit Zot, sepse me pësim* imitove pësim zot'ror,* o Dhimitër athlofor,* dhe çliron nga rrezik e tmerr* dhe i shpëton sa vrapojn' tek ti me mall,* se ke guxim të pëlqyeshëm pik'risht* prej Krishtit Shpëtimtar,* o i lavdëruar, pran' të cilit ti* po qëndron dhe mbushesh tash me shum' lavdi dhe gaz.

Gjaku yt pikonte, kur u solle tek Jisui, që jep* jet' dhe zbrazi për hirin tënd* gjakun e paçmueshëm* dhe të bëri pjes'tar në lavd*[3] në mbretërinë e tij në qiell lart,* se triumfove me forc' dhe me shkëlqim ndaj të fëlliqurit* dhe krejt'sisht e shove çdo makinacion* shkatërrues që ky thur, Dhimitër athlofor.

Lavdi *I Bizantit*

Ting. Tërth. II

Sot na mbledh panairi botëror i athloforit, prandaj ejani kremtimdashës, që të bëjmë me ngazëllim kujtimin e tij duke thënë: Gëzohu ti, që grise këmishën e pabesisë përmes besës dhe e veshe veten me burrërinë e Shpirtit; gëzohu ti, që shfuqizove mendimet e të paligjve me fuqinë që u dha tek ti nga Perëndia; gëzohu ti, që kur u shpove me shtizë në gjymtyrë, na

pikturove përsëri shpirtërisht pësimin e lumur të Krishtit; atij përgjëroju, o Dhimitër, bukuri e atletëve, që të çlirohemi nga armiq të dukshëm dhe të padukshëm dhe që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*
Foverós i Kírie

O Zonjë e Tërëshenjtë, ndihmë e botës dhe shpresë e të krishterëve, ty tani të përgjërojmë dhe të lypim, o e mirë, për ne që kemi mëkatuar dhe jemi dëshpëruar; Birin tënd dhe Zotin bëje të butë, o Perëndilindëse, sepse e ke mundësinë, duke përdorur tek ai guximin tënd nënor; arri, o e papikëluar, arri, ndërmjeto dhe shpëto popullin tënd nga kërcënimi i tanishëm; për dhembshurinë tënde, mos shpërfill himnuesit e tu.

Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni. Leximet.*

Këndimi i profecisë së Isaias
(63.15-64.5,8,9)

Ktheu nga qielli, o Zot, dhe shiko nga shtëpia jote e shenjtë dhe nga lavdia. Ku është shumica e mëshirës sate dhe e dhembshurive të tua? Se na durove, o Zot, sepse ti je ati ynë, se Abrahami nuk na njohu dhe Izraeli nuk na diti, por ti, o Zot, ati ynë, shpëtona; që nga fillimi emri yt është mbi ne. Pse na bëre të endemi jashtë udhës sate? Ashpërsove zemrat tona që të mos kemi frikë prej teje? Ktheu për shërbëtorët e tu, për fiset e trashëgimit tënd, që të trashëgojmë pak malin tënd të shenjtë, kundërshtarët tanë shkelën shenjtëroren tënde. U bëmë si në fillim, kur nuk na kryesoje, as nuk u mbiquajt emri yt mbi ne. Nëse do të hapësh qiellin, tmerr do t'i kapë malet prej teje dhe do të shkrihen siç shkrihet qiriu nga faqe zjarri dhe zjarri do të djegë plotësisht kundërshtarët dhe do të jetë i dukshëm emri yt te kundërshtarët. Prej fytyrës sate kombe do tronditen. Kur do të bësh të lavdishmet, tmerr do t'i kapë malet prej teje. Që prej jete nuk dëgjuam, as sytë tanë nuk panë perëndi veç teje dhe veprat e tua, që do t'u bësh atyre që presin me durim mëshirë; sepse do t'u takojë atyre që bëjnë të drejtën dhe do t'i kujtojnë udhët e tua. Dhe tani, o Zot, ati ynë ti je, ndërsa ne *jemi* baltë, punë e duarve të tua, të gjithë ne. Mos u zemëro së tepërmi kundër nesh dhe mos kujto mëkatet tona në kohë. Dhe tani hidh syrin, sepse ne të gjithë *jemi* populli yt.

Këndimi i profecisë së Jeremias
(2.1-12)

Këto thotë Zoti: Kujtova mëshirën e

rinisë sate dhe dashurinë e përsosmërisë sate që ta ndiqje shenjtin e Izraelit, thotë Zoti, i shenjti i Izraelit. Tek Zoti *është* fillimi i prodhimeve të tij. Të gjithë që e hanin do të mëkatojnë, të këqija do të vijnë mbi ta, thotë Zoti. Dëgjoni fjalë Zoti, o shtëpia e Jakovit dhe çdo fis shtëpie Izraeli. Këto thotë Zoti: Ç'mëkat gjetën etërit tuaj tek unë që ikën larg meje dhe shkuan pas kotësive dhe u bënë të kotë? Dhe nuk thanë: Ku është Zoti që na ngriti nga toka e Egjiptit, që na udhëhoqi në shkretëtirën, në tokë të paanë dhe të pashkelshme, në tokë pa ujë dhe të pafrytshme, në tokë në të cilën nuk kaloi dot në të burrë dhe nuk banoi atje bir njeriu? Dhe ju udhëhoqa në Karmil, që të hani frytet e tij dhe të mirat e tij; dhe hytë dhe molepsët tokën time dhe trashëgimin tim e vutë për neveri. Priftërinjtë nuk thanë: Ku është Zoti? Dhe ata që merreshin me ligjin nuk më njihnin, dhe barinjtë bënin pabesi tek unë, dhe profetët profetizonin për Baalin dhe shkuan pas të padobishmit. Prandaj përsëri do të gjykohem me ju, thotë Zoti, dhe do të gjykohem me bijtë e bijve tuaj. Pra, kaloni në ishuj Hetiim dhe shikoni, dhe në Qidhar dërgoni dhe kuptoni së tepërmi dhe shikoni nëse u bënë gjëra të tilla; nëse kombet do ndërroj-në perënditë e tyre, dhe ata nuk janë perëndi. Ndërsa populli im ndërroi lavdinë e tij nga e cila nuk do të ketë dobi. U shtang qielli për këtë dhe u frikësua tepër fuqishëm, thotë Zoti.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve *janë* në dorën e Perëndisë dhe nuk do t'i prekë mundim. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre dhe dërrmim ecja nga ne, por ata janë në paqe; sepse edhe nëse ndëshkohen para faqes së njerëzve, shpresa e tyre *është* plot pavdekësi; dhe pasi do të ndëshkohen me pak mundime, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj dhe do të mbretërojë në ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të do të kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë pranë tij, sepse *ka* hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Në Liti

Ting. I I Gjergj Siqeliotit

Dëfreu më Zotin, o qytet i Selanikut, ngazëllohu dhe kërce i veshur me shkëlqim besërisht, sepse zotëron në gji si thesar Dhimitrin, atletin e tërëlavdëruar dhe dëshmorin e së vërtetës; shijo çuditë duke parë shërimet; dhe shikoje atë të rrëzojë arrogancat e barbarëve dhe i thirr Shpëtimtarit me falënderim: O Zot, lavdi më ty.

I njëjti I Anatoliut

Me ngazëllimin e këngëve le të mbushim me hare ditën e sotme dhe le të brohorasim për garat e martirit; sepse gjendet para nesh për lavdërim Dhimitri i madh; se duke preferuar burrërisht fatkeqësitë e tiranëve, vrapoi me gatishmëri te stadiumi; dhe pasi i ngriti fitoret lavdishëm, i lutet Shpëtimtarit që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Lavdi *Ting. II I Gjermanoit*

Në tendat mbibotërore shpirtin tënd, o Dhimitër martir i urtë, Krishti Perëndia e mori të pacenuar; se ti u bëre luftëtar i Trinisë, duke luftuar në stadium burrërisht si diamant i fortë; dhe pasi u shpove në brinjën tënde të papërlyer, o i tërënderuar, duke imituar atë që u tendos mbi dru për shpëtimin e gjithë botës, ke marrë energjinë e mrekullive dhe u jep njerëzve shërime me bollëk; prandaj sot tek kremtojmë fjetjen tënde, lavdërojmë denjësisht Zotin, i cili të lavdëroi.

Tani *Hyjlindësore*

O mister tepër i madh! Duke parë unë çuditë, shpall hyjninë, pa mohuar njerëzinë; sepse Emanueli, nga një anë hapi dyer natyre si njeri, por nga ana tjetër nuk theu brava virgjërie si Perëndi, por doli nga mitra ashtu si hyri nëpërmjet dëgjimit;[5] edhe u mishërua siç u zu. Pa pësim hyri, pashprehimisht doli, sipas profetit që thotë: Kjo derë do të jetë mbyllur, askush nuk do të kalojë përmes asaj, përveç Zotit, Perëndia i Izraelit,[6] që ka mëshirën e madhe.

Pasvargje Idhiomele të tërmetit
Poezi e Simeon Thavmastoritit

Ting. II

Kur toka tundet prej frikës së zemërimit tënd, kodra dhe male bashkëlëkunden, o Zot;[7] por pasi të hedhësh mbi ne sy dhembshurie, mos u zemëro në inatin tënd kundër nesh;[8] ndaj duke pasur dhembshuri për gatimin e duarve të tua, çlirona nga kërcënimi i frikshëm i tërmetit si i mirë dhe njeridashës.

Ting. Tërth. II

Varg: E tunde tokën dhe e trondite atë.

Ifrikshëm je, o Zot, dhe kush do durojë zemërimin tënd[7] të drejtë? A kush do të përgjërojë, a kush do të lypë, o i mirë, për popull që mëkatoi dhe është i dëshpëruar? Brigadat qiellore: Engjëj, Arkondë, Pushtete, Frone, Zotërime,[9] Keruvime dhe Serafime, të thërrasin ty për ne: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je, o Zot.[10] Punët e duarve të tua mos i shpërfill,[11] o i mirë; nga dhembshuria, shpëto një qytet që rrezikon.

Varg: Ai që mbikëqyr mbi tokë dhe e bën të dridhet.

Ninevitët për shkak të shkeljeve dëgjonin futjen thellë në dhé nga kërcënimi[12] i tërmetit, por ndërkaq me çudinë ndërmjetuese të peshkut të madh, përmes Jonait pendimi nxit për ringritje.[13] Por ashtu si i dhembshurove, i pranove ata me bërtitjen e popullit tënd, me foshnja dhe kafshë;[14] le të të vijë keq edhe për ne që mundohemi dhe mëshirona me ngjalljen tënde të triditshme.

Lavdi *I shenjtit*

Ting. Tërth. IV I Anatoliut

Shpirti yt tepër i hyjnueshëm dhe i panjollshëm, o Dhimitër i kënduar, ka banesë Jerusalemin qiellor,[15] muret e të cilit janë pikturuar në duart e pacenuara të Perëndisë[16] të padukshëm; ndërsa trupi yt tepër i nderuar dhe atletik ka këtë kishë të famshme si arkë të pavjedhshme mrekullish, dëbuese sëmundjesh, tek e cila kur vrapojmë nxjerrim shërimet; ruaje, o i tërëfamshëm, qytetin që të madhëron nga sulmet e kundërshtarëve, meqenëse ke guxim ndaj Krishtit, i cili të lavdëroi.

Tani *Hyjlindësore*

Virgjëresh' e panusëruar që zure trupërisht Perëndinë pa tregim, nën' e Perëndisë së lartë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu, o e gjith'panjollëshme, ti që u fal të gjith've paqësim mëkatesh; prit lutjet tona tani dhe lutu që të shpëtohen shpirtrat tanë.*

Përlëshore e shenjtit
Ting. III
Thias písteos

Përluftar të madh* nëpër rreziqe,* të ka gjetur ty* bota e tërë,* se i theve ti paganët, o athlofor;* pra siç e shtrive Lieun fodull përdhé,* kur e forcove dëshmorin Nestor në stad,* k'shtu, o shën Dhimitër, lut Jisu Krishtin Perëndi,* të na dhurojë neve përdëllim të madh.*

(Në Mëngjesore, tek Perëndia është Zoti psalet 2 herë)

Tjetër: E tërmetit
Ting. Tërth. IV

Ti që sytë i hodhe mbi tokë dhe e bën të dridhet,[17] shpëtona nga kërcënimi i frikshëm i tërmetit, o Krisht Perëndi, dhe dërgo mbi ne mëshirat e tua të pasura,[18] me ndërmjetimet e Perëndilindëses, o i vetëm njeridashës.

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. IV Tahí prokatálave

Kujtimi yt, o Dhimitër, o martir me lavdi* tek Kisha e Krishtit ka dhën' sot gëzim dhe na mblodhi ne të gjith' me një zë,* që të të lavdërojmë,* o hyjmendës, me këngë* denjësisht se ushtar je dhe rrëzues armiqsh ti;* ndaj me ndërmjetimin tënd shpëtona prej ngasjeve.

Lavdi *I ngjashëm*

O mburrje atletësh, Dhimitër dëshmor, Krishtin ton'* e veshe[19] dhe k'shtu luftove me triumf ndaj armikut, që s'ka fuqi aspak,* se me Jisun' shfarose* çdo mashtrim të paligjësh;* je bërë për besnikët një trajner për besimin;* pra bëjm' panair ne për kujtimin tënd me respekt.

Tani *Hyjlindësore*

O shpres' që nuk turpëron, sa tek ti kanë besim,* ti vetëm e mbajte gjatë shtatzënis' sate me mish Krishtin dhe Perëndin';* lutju atij së bashku* me apostujt e shenjtë,* t'i japë botës falje edhe paqe dhe ndreqje* të jetës të gjith've para fundit ton', Zonja jon'.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. Tërth. I
Ton sinánarhon Logon

Me bes' pa hezitim i ka mposhtur burrërisht* sot athlofori i Krishtit gjith' arrogantët përdhé,*[2] pra tiranët dhe në mundje mundi me fuqi* djallin dhe priti si një çmim* për mundimet mundësi shërimesh nga Zoti, që shpall* garat vetëm ky. Tek ai ndërmjeton atleti të shpëtohemi.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Gëzohu, o der' e Zotit e pashkuar; gëzohu, o mur dhe mbrojtje e atyre që ikin tek ti; gëzohu, o liman i padimëruar dhe e pamartuar; ti që linde trupërisht bërësin tënd dhe Perëndin', mos rresht së ndërmjetuari për ata që përhimnojnë dhe adhurojnë Birin tënd.*

Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. III Tin oreótita

Dëshmor Dhimitër je* një shenjt i dhembshur shum'* i Krishtit ton', me bes'* të lutemi, me shpirt,* shpëtona ti nga çdo rrezik, i cili vjen kundër nesh shpesh;* plagët që ka shpirti yn'* edhe trupi yn' i shëro,* thyej kërcënim, frik'sim* armiq'sor, o martir i madh,* dhe jetën tonë ti paqësoje,* që të himnojmë ty përherë.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*

O e hyjlumur Vajz',* e panus'ruar nën',* shpirtin e kam sëmur',* lutem shëromë krejt,* sepse shtrëngohem brenda shumë shkeljesh keq, o Hyjlind'se;* ndaj me psherëtim' thërras* thell' prej zemrës tek ti, Mari,* pritmë ti që s'ke dot njoll'* mua që mëkatova rënd',* që të thërras tek ti me guxim un':* G'zohu, o Zonja jon' hirplote.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni
Ting. IV

I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

Varg: **Tek shenjtorët që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.**

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e athloforit.

Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II

Në tendat mbitokësore shpirtin tënd, o Dhimitër, martir i urtë, Krishti Perëndia e pranoi të paqortuar, sepse ti je bërë luftëtar i Triadhës kur luftove në stadium burrërisht si diamant i fortë; dhe kur u shpove në brinjën e papërlyer, o i tërërespektuar, duke imituar atë që u tendos mbi dru për shpëtimin e të gjithë botës, more energjinë e mrekullive, dhe u jep me bollëk njerëzve shërimet; prandaj sot, duke festuar fjetjen tënde denjësisht, lavdërojmë Zotin që të lavdëroi.

Kanunet: I tërmetit së bashku me Irmoset 6 dhe të dy të shenjtit në 8
Ode I
Kanuni i tërmetit, që ka Akrostihidhë: "O Krisht, lëkundjen e tokës pushoje shpejt. Josif".

Ting. Tërth. II
Irmosi: Os en ipiro pezefsas

»Si në steré Izraeli kaloi leht'* dhe »më këmbë, duke par'* Faraonin, ndje»kësin* mbrapa gjurmëve të tij,* të

»zhytej;* thërriste pra: Zotit ne le t'i »këndojm' këng' mundëse.

Zem'rimi yt sa i tmerrshëm ësht', Perëndi,*[7] por na ke çliruar ti* duke mos zhytur në dhé* çdo shtat, çdo njeri dhe gjë;*[20] prandaj të lëvdojmë me kënaqësi gjithmon', o Zot.

Meqë gëzohesh çdo ditë për ndreqjen ton'* të gjith'anshme, Zoti yn',* si një gjethe pa vler' hiç* tërë tokën ti e tund,* k'shtu ne besimtarët, ti në frikën tënde na mbështet.

O Zot, shpëto nga tërmeti i rënd' të gjith'* edhe mos lejo aspak* trash'gimia të humbas'*[21] gjer në fund, edhe pse kjo* me shum' ligësi të inatos ty që je zemërgjer'.

Hyjlindësore

Të th'rrasim në një mënyr' lutjeje, o Zonj,* nën' e Perëndis': Trego* dhembshurin' që zakonisht* ti e ke për popullin,* qytetin; çliro nga prishja, nga tërmeti shum' i rënd'.

Kanuni i parë i shenjtit, që ka Akrostihidhë: "Drejtohem tek Dhimitër bukurmundësi". I Theofanit

Ting. IV Thalasis to erithreon

Kurorën* e hyjshme si martir e veshe dhe kërcen tani* pran', rreth Hyjnis'; andej shkëlqen shum' fort* nga ndriçimet, dhe mbushesh me hir,* me llamburitje, o Dhimitër, që u bëre këngë edhe psalm.

Meqë je* martir për të vërtetën dhe luftove gjer në gjak* me çdo durim ti, o i lumur shum',* Zoti të ka pranuar, sepse* ti ke treguar forcë, qëndrueshmëri dhe trimëri të rrall'.

Përtokë,* Dhimitër shtrive shpikësin e të këqijave,* pasi me shtizën martirike posht'* e rrëzove, sepse për këtë* me forcat mbimendore të mir'sis' së Zotit je forcuar shum'.

Hyjlindësore

Më parë* si Zot, ish pa nën'; tash u bë si ne pa at' aspak* ai që mori, o Hyjlind'se, mish* nga ti me një bashkim përmbi mend* dhe përmbi çdo logjikë, o e tër'himnuar, e kulluar Zonj'.

Kanuni i dytë, që ka Akrostihidhë: "Pasi u bashkëthure me miro mendore, bëhesh miro"; ndërsa në Hyjlindësoret: "I Filotheut". Është poezi e patriarkut ekumenik dhe shumë të shenjtëruar zotit Filothe, dhe ka miron e tij të hyjnueshme si temë lavdërimesh dhe lutjesh.

Tingull i njëjtë
Anikso to stoma mu

U bëre, Dhimitër, pjesa ime edhe

lavdi e shenjt',* se edhe un' jam një qengj i vathës sate që do;* ndaj prano himnim,* o i kurorëzuar,* që të brohoras sot për hirin e miros pra.

U fute, Dhimitër, në një stadium për martirë ti* me shum' shkëlqim, kur me vaj virtytesh leve shpirtin,* dhe çuditërisht* kur bie, ti fiton qart'* dhe trupin tënd trim e tregon një burim mirosh.

Të lutem, fshih rrjedhje balte edhe erë të keqe prej* pasionesh të ndyra, o Dhimitër, dhe më miros* me një er' të mir'* shkëlqyeshëm, dhe bëmë* një tendë të denjë për miron e Krishtit ton'.

Si miro e quajti në Shpirtin e Shenjt' Davidi mbret* i hyjshëm bashkimin v'llazëror që sjell ngazëllim,*[22] ndërsa miroja,* Dhimitër, mbledh Krijesën* e re në bashkimin për miro dhe më të mir'.

Hyjlindësore

U duke si vazo alabastri, o e panjollshme Zonj',* e miros[23] hyjnore, en' e zgjedhur me kundërmim* e Jisuit, pra* të lutem, më çliro ti* nga balta e fajit dhe duhma e veseve.

Zbritësore: Anikso to stoma mu

Ja gojën e çel tani

Ode III
E tërmetit
Irmosi: Uq estin ájios os si

»**N**uk ësht' i shenjt' ndonjë si ti,* Zoti »im, Perëndia,* që e ngrite lart briri[23a] »e besnikëve të tu* dhe na forcove të »gjith',* o i mir', mbi gurin e pohimit »tënd.

Meqë të çrregullt jemi, Zot,* edhe gjithmon' e nxisim* kundër nesh nervozizmin tënd, ja rrihet me kërbaç* terreni, toka,[24] o mbret* i Gjith'sis', por të të vijë keq për ne.[25]

Pasi e tunde tokën, Zot,* prapë e sigurove,[26] dhe na ktheve ne, duke këshilluar si ti do,* o i tër'mir', ta forcosh* dobësinë ton' përmbi fuqin' tënde.

O v'llezër, le të ikim larg* nga ligësit' që lindin* shum' tërmete[24] të rënd', dhe vdekje plot të hidhura,* dhe plagë që nuk durojm';* nëpërmjet pendimit Zotin ta zbutim.

Hyjlindësore

Meqë e mir' je vetëm ti,* Fjalës së tërëmirë* përgjëroju gjer'sisht që të shpëtojm' të gjith', o Zonj',* Hyjlind'se pa njoll' aspak,* nga inati i tërmetit ne tani.

E shenjtit Kanuni i parë
Efrénete epí si

Nuk more dot parasysh* ti urdh'rim

të tiranit, se Perëndin'* Fjal' e preferove qart'* mbi të gjitha gjërat që ekzistojn'.

Je bërë si një kandil* plot dritë brenda tendës, që quhej pra* e dëshmive,[27] o dëshmor,* me ndriçim të hyjshëm, o athlofor.

Hyjlindësore

Nga ti, o e tërëd'lir',* me pamjen ton' të kalbur vishet Jisu* njeridashësi; shëron* k'të plot'sisht dhe pse mbeti siç ishte.

Kanuni i dytë
Tus sus imnologus

Ungrite mbi çurkat jetëdhënës, pasi u pastrove me Pag'zim* të shenjt'; u lave, o Dhimitër, me gjak martirik, edhe* përzjerje të re bëre, sepse ti burimi i miros je.

O rojë i madh i Selanikut, si lumi i madh i Zoti ton',* po ngazëllon qytetin tënd shkëqyeshëm me vrullet pra* të miros dhe Gjith'sin' e shenjtëron si tendë të hyjshme ti.

Qyteti yt duket si një krua rrëkesh jetësore, o dëshmor;* si çurka[28] me bollëk, si lum' rrjedh miro dhe një det të tër'* me herezi dhe vese na e mbyt si dhe e përmbys plot'sisht.

Në shpirtin tënd rrodhi mendërisht miro, Krishti, Dhimitër; dhe u derdh* si burim mirosh prej gjymtyrësh si prej buzësh[29] dhe kështu* dëfteu se je tend' e respektuar hiri prej Shpirtit t' Shenjt.

Hyjlindësore

Ja ku Virgjëresha i thërret Birit, Zot i të gjithave: Je ti,* o dhëndri im, i bukur je,[30] i pashëm je; do të vrapoj* me shum' nxitim pas teje, të nuhas, o Krisht, miron tënde[31] un'.

Zbritësore: Tus sus imnologus

O Zonjë dhe nën' e Perëndisë

Ndenjësore e shenjtit
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

Pate një pasuri sjelljesh besëplot'* dhe e mposhte mashtrimin e pabesis';* dhe shkele fort, o martir,* arroganca tiranësh krejt* dhe i përflakur në mendje nga një dëshir' e shenjt',* gënjeshtrën idhujtare e zhyte në kaos thell';* pra siç duhej si çmim për përpjekjet e tua* pranove çuditë ti* na buron pra shërime plot,* o Dhimitër,* o athlofor,* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Lavdi *Tjetër e shenjtit*

Duke qen' i pëlqyer tek mbreti yn',* mbret i jetës,[32] u shmange nga çdo dëshir'* mbret'rore që s'kishte ligj,* dhe s'flijove tek idhujtë,* o i lavdishëm; e solle veten si një flijim* tek Fjala që u ther, dhe luftove me forc' të plot',* k'shtu me shtiz' u shpove ti në brinjë; shëron pra* pësimet e njerëzve* që tek ti vijn' me bes' të thell',* o Dhimitër,* o athlofor,* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Tani *I tërmetit*
Ting. IV
O ipsothís en to stavró

Kur nervozizmi yt i fort' na sulmoi,* dhe nuk duronim dot,[7] tregove qart' detin* e njeridashjes, se na mëshirove, o Krisht;* na shpëtove, dhe mësuam ne* shmangien e të këqijave*[33] që na vrasin; pra të gjith'* ty të falënderojm' tash;* por hidh syt' edhe përdëllena, Zot; * o Shpëtimtar; nëna jote k'shtu lyp për ne.

Ode IV
E tërmetit
Irmosi: Hristós mu dhínamis

»Fuqia ime, Krishti Perëndia ësht',* »psal me mendje të pastër edhe »thërret* siç e meriton pra Zoti, Kisha »e nderuar fort* dhe feston në Krishtin »me hare.

Tunde tokën, o Zot, duke dashur që ne të gjithë, që lëkundemi nga sulmet e armikut tinëzar, të mbështetemi mbi bazamentin e së vërtetës.

Me sinjalizimin tënd hyjnor lëkundi të gjitha,[17] dhe tund zemrat e atyre që janë mbi dhé, o Zot; pra përmbaji valët e zemërimit tënd të drejtë, o Perëndi.

Me lëvizjen e tërë tokës na frikëson ne që nuk e kemi fare në mend frikën tënde, o i vetëm që na do, por trego mbi ne përdëllimet e tua të çuditshme[34] si zakonisht.

Hyjlindësore

Duke të ditur ty, o Zonjë, tempull Perëndie,[6] në tempullin tënd ngremë duar[35] të mjera për përgjërim; shiko lëndimin tonë dhe jep ndihmën tënde.

E shenjtit Kanuni i parë
Eparthenta se idhusa

Fjala tepër e tejlartë e Perëndisë, duke të parë ty të kesh fituar mbi gënjeshtrën e pabesisë, të kurorëzoi me lavdi,[36] o Dhimitër, ty të psal: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

I udhëhequr nga pëllëmba jetëprurëse, arrite në limane shumë të qeta,

ku tani i ngazëlluar thërret, o Dhimitër: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Pasi ngrite trofe kundër mashtrimit, ke marrë kurorë fitoreje drejtësie, o Dhimitër, duke thirrur tek Ndërtuesi yt: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Hyjlindësore

Vetëm ti u denjësove të bëhesh nënë Perëndie si më e hyjnueshmja se të gjitha krijesat, sepse kur e linde, ndriçove botën me hirin e hyjdijes.

Kanuni i dytë
Tin aneksihníaston

Si një rrush i pjekur, o i lumur, pasi të vjel Krishti nga vreshti i hyjnueshëm, të shtyp në torket e martirizimit, ndërsa mushtin, i cili rrodhi poshtë, e bëri krua të hyjshëm miroje.

Ku banon, o dhëndri im? Ku e vendose tendën tënde në mesditë?[37] I thërriste i kurorëzuari Krishtit; nën erën e mirove të tua do të vrapoj[31] që të marr miro.

O Dhimitër, lutem, pasi mbyte rrjedhë mashtrimi të tmerrshëm me rrymën e shërimeve të tua, thaj përsosmërisht lumenjtë e mëkateve dhe pasioneve të mia me rrjedhjet e mirove të tua.

Hyjlindësore

Më thuaj, o dhëndri im, thuaj fuqishëm: Ku vallë kullot delet e tua? I thërret nusja dhëndrit dhe birit; sepse era e mirove të tua i tërhoqi[31] gjithë ata që të duan.

Zbritësore: Tin aneksihníaston

Të pagjurmësuarin

Ode V
E tërmetit
Irmosi: To thio fegi su agathé

»Me drit' hyjnore, ti o i mir',* shpirtrat »e atyre që po mëngojnë[38] me mall për »ty shndriti krejt,* të të njohin ty, Fjal' »e Perëndis', Zot vërtet,* që na rith'rret »nga mjegulla e mëkateve.

Dhe ti, o zemër, tundu tani, duke parë kërcënimin e Perëndisë të jetë mbi ty, dhe thirr: Le të të vijë keq për popullin tënd, o mjeshtër Zot,[25] dhe ndalo inatin tënd të drejtë, o i dhembshur.

Kur tund tokën me tërmet[26] të frikshëm, mos i jep humbjen popullit dhe qytetit, që veçanërisht e fitove me gjakun tënd, o Jisu;[39] të përgjëron kori i apostujve.

O Zot, kur devijojmë nga udhët e tua të drejta me mendim të shtrembër,[40] të shtyjmë në indinjatë ty, ti që nuk

mban mëri dhe që ke dhembshuri; ndaj bëhu i butë, o i dhemshur, për shërbëtorët e tu.

Hyjlindësore

Tani erdhi kohë ndihme, tani është nevoja për pajtim,[41] o e kulluar, me Birin tënd dhe Zotin për të na dhembshuruar ne që u përplasëm dhe për të na çliruar nga zemërimi që po afrohet.

E shenjtit
Kanuni i parë

Si Kírié mu fos

Meqenëse prite në zemër zjarr malli të perëndishëm, shove zjarrin e manisë ateiste të idhujve, o Dhimitër, që u bëre këngë.

Duke na shpëtuar nga rreziqe, me lutjet e tua shfaqu, o Dhimitër, duke strehuar ata që me besë dhe mallëngjim të lavdërojnë.

Ata që vrapojnë besërisht drejt kishës sate, o Dhimitër, çlirohen shpejt nga sëmundje dhe pësime shpirtprishëse.

Hyjlindësore

Fjala e Perëndisë e bashkëqenëshme me Atin bëhet, o Hyjnënë, Biri yt i bashkëqenëshëm mbi mendje dhe logjikë.

Kanuni i dytë
Eksesti ta símpanta

I madhi ndër dëshmorët, Dhimitri, pasi përzjeu djersët e ndeshjeve me gjakra, na bëri miro[42] të hyjshme, duke e zier mirë në zjarrin e Shpirtit, ilaç për pastrim të ri shpirtrash.

Traumat e trupave dhe të shpirtrave, o Dhimitër, i pastron me miro nga varri yt, ashtu si me ilaç drastik, duke larë helmin mendor me pikat nga gjaku yt me zellin për Zotin tënd.

Më energjike se zjarri miroja jote, o Dhimitër, duke përshkuar të gjithë Kishën, gurron, buron, vlon dhe vepron mistikërisht tek ata që vrapojnë me besë, duke djegur sëmundjet dhe duke dëbuar demonët.

Hyjlindësore

Kur Fjala fushoi në mitrën tënde, o Vajzë, e ka bërë vazo miroje të re; prandaj, o Virgjëreshë, shpirtra shenjtorësh të hyjshëm vrapuan pas teje[43] me ngrohtësi, duke thirrur: Je e bukur, je e bukur,[44] Zonjë, vajzë.

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

Të gjith' i habite ti

Ode VI
E tërmetit
Irmosi: Tu viu tin thálasan

»Ja detin e jetës tash* e shikoj të »ngrihet prej furtune ngasjesh ashpë»risht,* ndaj vrapoj te limani yt shum' »i qet' dhe po të thërras: Ma ngri* »shpirtin tim, o i shum'mëshirshëm, »nga prishja.

Ne nuk kemi dot, o Zot,* as guxim të lutemi te lartësia jote, ndaj* vemë engjëjt e zgjedhur[45] për përgjërim të ngroht' ne të ultit krejt;* përmes tyre çlirona nga inati yt.

Mësuam tash se na do,* o Zot,[46] dhe s'na mbyte dot nën dhé përmes rrëshqitjeve* të tmerruara, meqen'se kishim shumë faje, paligjësi;* pra me zë ty të madhërojm' nga zemra jon'.

Urdh'ron që të tunden thell'* tër' themelet tokësore, që gjith' ne të varfërit* të pushojm' së lëkunduri, dhe në baz' virtyti të mbetemi,*[47] të mbështetemi fort në frikën tënde, Fjal'.

Hyjlindësore

Hyjnuse e shenjt', tani* dhembshuroje popullin tënd që në rrug' pa krye ësht',* dhe ndrysho sa më shpejt indinjatën që ka kundër nesh Zoti yn';* ndërmjeto për k'të ti si nën', të lutemi.

E shenjtit Kanuni i parë
Thiso si metá fonís

Ne të mbledhur, o Dhimitër, bashk' me një zë himnojm'* kujtimin tënd të shum'ndritshëm,* dhe plot me çuditë dhe me dhuntitë* që jep Shpirti* i Shenjt' i gjith'nderuar, o i tër'lum.

O Dhimitër, zgjidh vargonjt' e mëkateve që un' kam,*[48] me lutjen tënde; guxim ke* si martir i pamposhtur para Zotit* edhe bëhu* mbulesë e përikje dhe mbrojtës ti.

Hyjlindësore

Fjala, Zoti, dhëndri ç'na fushoi në barkun tënd,* sepse të gjeti si lule* ndër lugina, si një zambak[49] pa njollë,* shum' të pastër* mes gjembash, o hyjnënë e tërëshenjt'.

Kanuni i dytë
Tin thian taftin

U leve, o i dëgjuar shum', me miro të paçmuar të Shpirtit t' Shenjt' me larjen në Pag'zim;*[50] k'të e ke ruajtur krejt pa njoll',* pra bëri miro gjakun tënd Shpirt' i Tërëshenjt'.

Afrohu, ngrihu dhe eja pranë,[44] thotë Krishti dhëndër tek shpirti i Dhimitrit, le të hyjm'* brenda shtëpis' valeriane bashk'*[51] dhe le të marrim erën e miros[31] sime ne.

Thërret te ti, o Dhimitër, Krishti dhëndër: Jan' të reja sa bëhen; dimri u shpërbë krejt'sisht;* eja, lul'zon[52] trëndafili tash;* vrapo si mik drejt erës së miros[31] sime, ti.

Po thot' i dashuri: Dhëndri im, vrapoj un' me nxitim mbrapa teje,[31] sepse është më e lart'* se çdo er' era që ke, miro,*[53] që miro e ka bër' gjakun tonë martirik.

Hyjlindësore

Me vdekje, vdekja u prish krejt dhe nga varri lindi me lindjen tënde pra të huaj, Zonja jon';* ligje natyre pushuan k'shtu* dhe gjaku i martirëve miro është bër'.

Zbritësore: Tin thian taftin

Këtë të kremte

Kontaqi
Ting. II

Me rrjedhjen e gjakut tënd, o Dhimitër, leu Kishën si me purpur Perëndia, i cili të dha ty fuqinë e pamposhtur dhe kujdeset që të jetë qyteti yt i pacenueshëm, sepse je mbështetja e tij.

Shtëpia

Të gjithë ne besëmirët, duke u mbledhur me një zë le ta nderojmë të madhin ushtar të Krishtit dhe martir, me këngë dhe himne duke i thirrur Zotit dhe Ndërtuesit të botës: Shpëtona nga nevoja e tërmetit, o njeridashës, me ndërmjetimet e Perëndilindëses dhe të gjithë martirëve; se më ty shpresojmë të shpëtojmë nga rreziqe dhe pikëllime, sepse je mbështetja jon'.

Sinaksari

Më 26 të të njëjtit muaj, kujtimi i martirit të madh, të shenjtë, të lavdëruar dhe çudibërës Dhimitër Mirovlitit.
Vargje: Shtiza shpojnë Dhimitrin, o Krishti im,/ i cili e ka zili pësimin e brinjës shtizëshpuar.
Shtiza vranë Dhimitrin më 26.

Në të njëjtën ditë, martirët e shenjtë Artemidhori dhe Vasili mbarojnë me shpatë.
Vargje: Artemidhori, për të cilin vendimi i mbarimit ishte shpata,/ e kishte bashkatlet në shpatë Vasilin.

Në të njëjtën ditë, martirja e shenjtë Leptina, duke u zvarritur përdhé, mbaron.
Vargje: Pasi u zvarrit në dhé nga duar besëkëqijsh,/ lë në dhé Leptina peshën e mishit.

Në të njëjtën ditë, martiri i shenjtë Glikoni mbaron me shpatë.
Vargje: Duke shtrirë nën shpatë, o martir Glikon, qafën tënde,/ derdh gjakun tënd për Krishtin, si flijim i ëmbël.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i tërmetit të madh dhe të frikshëm.
Vargje: E tunde, por e shpëtove prapë dheun, o Fjalë,/ se tepron dhembshuria më shumë se zemërimi yt.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona nga çdo kërcënim. Amin.

Ode VII
E tërmetit
Irmosi: Dhrosovolon men tin káminon

»Engjëll bëri vesëprurëse një ferr' për »tre Djem oshënarë, ndërsa kaldenjt'* »me një urdhër që* Perëndia dha, u »dogjën krejt.* Tirani u bind k'shtu të »thërras':* Je i bekuar ti, o Perëndi i »etërve tan'.

Je i përmbihimnuar, o Zot zemërgjerë, sepse nuk i vrave shërbëtorët e tu me tundjen dhe lëkundjen e frikshme të tokës, por i frikësove duke kërkuar që të largohemi nga të këqijat dhe të jetojmë të gjithë ne.[54]

Le të lëshojmë drejt lart psherëtimë nga zemra dhe le të derdhim lot që ta gjejmë të qetësuar Zotin Krisht, i cili kërcënon trembshëm, se do të na shuajë ne të gjithë me tërmet për shumicë fajesh.

T'ia nisim vajit, le të thërrasim dhe le të ngremë duart drejt Perëndisë[35] të Shumëlartit dhe le të pushojmë së bëri ligësi më;[55] ja ku Shpëtimtari i indinjuar tund tokën e tërë, sepse do që të na mbështesë.

Hyjlindësore

Mirato, o e pacenuar, që të shpëtojmë nga kërcënimi që na sulmoi tani ne shërbëtorët e tu, të cilët kemi për të humbur në zemërimin e Perëndisë dhe në inatin e madh e të frikshëm, për shkak të shumicës së mëkateve tona pa fund.

E shenjtit Kanuni i parë
En ti kamino

I shndritur nga lavdia e hyjnueshme dhe Hiri, o dëshmor athlofor, llamburit shkëlqyeshëm dhe ndriçon ata që thërrasin: I bekuar je në Tempullin e lavdisë sate, o Zot.

Duke u zbukuruar me gjakun tënd si me purpur, duke pasur në vend të skeptrit, o i lavdishëm, kryqin, bashkëmbretëron tani me Krishtin duke thirrur: I bekuar je, Perëndia im dhe Zot.

Hyjlindësore

O e lavdëruar, e ndriçuar, nënëvirgjëreshë, duke qenë e bekuar ti mes grave,[56] o Zonjë, ruaji të gjithë ata që të nderojnë ty, Perëndilindësen e tërëvërtetë.

Kanuni i dytë
Uq elátrefsan

Shërbeve si prift, o Dhimitër, duke e bërë flijim gjakun tënd tek mbreti i gjithçkaje, o i tërëshkëlqyer, dhe u shpove me shtizë në brinjë duke e imituar; prandaj ai jep shpërblimin e meritуar, duke të treguar miro tek të tjerët.

U mishërua miroja qiellore, Krishti Zot, për miqësinë me të vdekshmit. Meqë Dhimitri e deshi atë shkëlqyeshëm, bëhet i mirë, pasi u lye me miro të re dhe buron miro nga mishi.

Pasi më krezmoi me miro ngazëllimi[57] Krishti, më zgjidhi nga robëria dhe tirania e hidhur, por prapë u skllavërova[58] në vepra shumë të turpshme. O i shenjtë, çliro nga robëria e turpshme, pasi të më vajosësh me miron tënde.

Hyjlindësore

Si të zgjodhi ty dhëndri i bukur, o Zonjë Virgjëreshë, nga fisi i të dhélindurve të vuri në të djathtën e tij[59] shkëlqyeshëm duke thënë: Eja, nusja ime nga Libani, eja nusja[60] ime dhe nënë.

Zbritësore: Uq elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII
E tërmetit
Irmosi: Ek flogós tis osiis

»**V**es' burove prej flakës tek oshëna»rët ti,* dhe e dogje flijimin e një të »drejti[61] shum';* vetëm me vullnetin »tënd, o Krisht, bën çdo gjë;*[62] ne në »gjithë jetët të përmbilartësojmë.

Kur na sulmoi zemërimi yt i drejtë befasisht, u tronditëm dhe u shtrënguam nga një dëshpërim i plotë, duke të parë të indinjoheshe kundër nesh.

Le të ngremë, o besnikë, duar[35] dhe sy drejt Zotit,[63] të vetmit që mund të shpëtojë,[64] duke thirrur: O Krisht, ktheje mbrapa nesh zemërimin tënd[65] shpejt, meqë je njeridashës.

Mijëra engjëj, shoqëri dëshmorësh, profetësh, apostujsh, oshënarësh, hierarkësh, kor i shenjtë të lyp, o Zot: Kurseje popullin tënd të poshtëruar.

O i dhembshur, që e di dobësinë tonë dhe lehtësinë e madhe prej së cilës rrëshqasim dhe bëhemi të pandreqshëm, lëri zemërimet dhe qetëso turbullimin, dhe me përdëllimin tënd dhembshuro botën.

Hyjlindësore

O Hyjlindëse përdëllyese, që linde Shpëtimtarin mëshirues, shiko lëndimin dhe psherëtimën e popullit tënd,

dhe shpejto të lypësh që të dhembshurohemi.

E shenjtit Kanuni i parë
Hiras ekpetasas

Errësove, o i lavdëruar, çdo mani dhe mundje të armikut, duke u ngjeshur me fuqinë e pamposhtur të Krishtit,[66] dhe kur dole fitimtar, o dëshmor Dhimitër, thërrisje: Gjithë ju veprat, himnoni Zotin.

Pasi u dëfteve qëndrueshmëri dëshmorësh, pate lavdi martirësh, o Dhimitër, duke u larë me banjë të shenjtë,[50] që nuk njolloset përsëri me sulme mëkatesh; kur shpoheshe ti me shtizë thërrisje: Gjithë ju veprat, himnoni Zotin.

Shumica e mrekullive paraqet tek ne të gjithë, o i lavdishëm, dhuratën përmbimendore që të dha Krishti; dhe hiri i terapive shpall qartësisht hirin tënd përmbi logjikë tek ne që thërrasim: Gjithë ju veprat, himnoni Zotin.

Hyjlindësore

Le ta përhimnojmë nënëvirgjëreshën e vetme në të gjitha gjeneratat dhe Hyjlindësen e pastër, sepse ajo është për ne arsye shpëtimi, meqenëse lindi Shpërblyesin e botës, Fjalën, tek e cila thërresim: Gjithë ju veprat, himnoni Zotin.

Kanuni i dytë
Pedhas evajís

Pasi e lartësove Krishtin në Kishë,[67] laringu yt[68] studioi[69] të vërtetën; goja jote ka folur fjalët e urtësisë;[70] u shfaqën nofullat e tua shishe aromash,[71] prandaj Krishti të dëfteu tek bota krua miroje të hyjshme.

Kundërshtari yt, o i kurorëzuar, duke pasur frikë nga fuqia e fjalëve të tua, si shigjeta e të fuqishmit, që me duart[72] e tua hidhen nga larg, e shpoi brinjën tënde me shtizë shumë të madhe, e cila duke buruar dete mirosh, e zhyt si egjiptianët.[73]

Roja i madh i Selanikut, shpëtimtari i jashtëzakonshëm në rreziqe, luftëtari shumë i fortë i Kishës mbarë, si atë i dhembshur u jep fëmijëve thithë rritëse e shpirtushqyese, brinjën që jep miro si qumësht.

O Dhimitër shumë i madh, shpëtove me ujitjet e miros sate nga sëmundjet dhe lëngimet e rënda si dhe nga keqdashja e demonëve shtëpinë tënde atërore, që e deshe duke nderuar virtytin e prindërve,[74] me të cilët na bashkofsh ne që himnojmë hirin tënd.

Duke të pasur ty, o Hyjlindëse, si pasuri të përbashkët dhe lavdi, ne të gjithë që të nderojmë, vrapojmë me besim tek ti duke lypur me përgjërim,

që të na çlirosh nga çnderimi i ardhshëm, duke na denjësuar për shijimin e amshuar dhe lavdinë në tendë të drejtësh.[75]

Zbritësore: Pedhas evajís

Djemat e dënuar

Ode IX
E tërmetit
Irmosi: Theón anthropis

»**N**uk munden njer'zit të shohin Perën»dinë',*[76] se nuk guxojn' brigada »engjëjsh që ta vështrojn' me sy;* por »nga ti, e d'lir', u duk tek njer'zit njeri,* »Fjala e mishëruar;[77] e madhështojmë »ne,* ndërsa të lum'rojmë ty bashk' »me fuqit' e engjëjve.

Ja, që të gjith' bëmë faje me shumic',* dhe toka, edhe pse s'ka bër' gabim, po ndëshkohet rënd'.* E tund fort të tërën njeridashësi yn';* do urtësimin ton' k'shtu, pra të kuptojmë mir'* dhe le të kujdesemi me mendje për shpëtimin ton'.[78]

Meqë je Zot orësh, stinësh, kohërash,*[79] në një çast shërbëtorët e tu do t'i shfarosësh krejt;* por prej dhembshurisë sate, o Perëndi,* je i penguar; si nuk kemi justifikim,* të falënderojmë, o i vetëm njeridashës, Zot.

O Krisht, shpëtoje qytetin tënd si dhe* çdo vend t'atyre, o i dhembshur, që të himnojn' me bes',* nga çdo thik', tërmet, pushtim i hidhur dhe sulm,* nga an' barbarësh me shum' tmerr dhe çdo befasi,* nga epidemi dhe nga uri, nga çdo e keqe pra.

Thërret pa gjuh' dheu, por me psherëtim':* Përse më ndotni, o ju njerëz, me të këqija shum',*[80] dhe meqë i vjen keq Zotit për ju, më tund* mua të tër', më kamxhikon;[80a] pra kuptoni mir'* edhe zbutni Perëndinë me pendim të thell' dhe lot.

Hyjlindësore

Gjat' lindjes prishjen ti s'e pësove dot;* prandaj shpëto të gjithë ne nga çdo prishje, nga tërmet* shum' i rëndë dhe nga çdo shtrëngim, Virgjëresh',* duke pushuar indinjatën e Zotit ton'* me pajtimin tënd nënor, o Zonjë e hyjhirshme krejt.

E shenjtit Kanuni i parë
Lithos ahirótmitos orus

Thyej pranga paligjësish[48] të atyre që të përhimnojnë,* athlofor, pusho sulme vesesh krejt'sisht* dhe zgjidh çdo furtunë herezish ti* edhe qet'so pra çdo stuhi* ngasjesh me ndërmjetimin tënd të shenjt'.

Grigjën tënde të shumëshenjtë drejtoje për në udh' të drejtë,*[81] që në mbretërin' qiellore[82] të çon,* Dhimitër martir kurorëmbajtës,* drejt pjesës shpëtimtare pra* edhe drejt vendit të përjetëshëm.

Hyjlindësore

Duke qen' të gjithë të bindur, o Virgjëreshë, se je rrënja,* shkaku dhe burim i paprishjes për ne,* me mburrje të lartësojm', lëvdojmë,* sepse na ke buruar ti* pavdekësin' enipostate krejt.

Kanuni i dytë
Apas jijenís

Qiell edhe dhé çuditen me veprën tënde, o Dhimitër shenjt,* se e zbukurove mir',* me shum' virtyte jetën në mish, në tok';* prandaj i more me shkëlqim "sipas ikonës" ti,*[83] ndërsa trupin,* gjaku yt e leu, pra* u krezmove me miro si mbret i madh.[84]

O Dhimitër, dëshirove fort rrobën[85] që kish zhveshur ati yn',* pra Adami që më par',*[86] ndaj veshe[19] ti Adamin e ri,[87] Jisun';* lëkurën mishërore ti e hodhe posht', me gaz,* k'shtu fejohet* me ty mbretëri e lart'* përmes miros, kurorave, o i shenjt'.

Mendja nuk arrin, as çdo lloj logjike njerëzore të rrëfej'*[88] lavdërimet përmbi mend* si dhe nderimet që ke fituar ti,* martir i lumur, duke mbretëruar pa pushim* bashk' me Krishtin;*[4] prova është shum' e qart':* miro plot hir që prej dheut tënd buron.

Grigjën që ka bler' me gjakun e tij Krishti,[39] e ke forcuar ti* bashk' me të me gjakun tënd,* me ligje dhe me fjalë të hyjshme krejt,* por dhe që tash po e ushqen me mirot dhe çudit',* përgjithmonë* ruaje pa fare plag'* herezish të rrezikshme, o shum' i madh.

Hyjlindësore

Priti lutjet, himnet tona të thjeshta dhe pa art, o Zonja jon';* dhe shfaros re fatkeqësish,* si personale dhe kolektive pra,* dhe ver në gjum' furtunën, o e d'lir', të Kishës son',* dhe shpërndaje çdo ushtri barbarësh larg,* dhe çliro nga ndëshkimi i ardhshëm ti.

Zbritësore: Apas jijenís

Gjithë njerëzit

Dërgimësore
Tis mathités sinélthomen

Sikundër mposhte ti dikur* me hir të hyjshëm vetull* dhe fodullëk,[89] dhe arroganc'* kali që kish Lieu,* kur e

forcove Nestorin,* djalin trim e me besë* në stadium, me shum' fuqi* që ka Kryqi, Dhimitër martir, ashtu* më forco dhe mua me lutjen tënde* ndaj djajve, athlofor, si dhe,* ndaj veseve që prishin.

Hyjlindësore

Hyjnën' e pacenuar, Zonj',* kurr' mos pusho t'i lutesh* Zotit që mori mishin tënd* nga gjaku yt i d'lirë* për shërbëtorët e tu, ne;* duam të gjejmë hirin* dhe ndihmën e përshtatëshme,*[90] pra në ditë nevoje për njerëzin'* dhe nga kërcënime tërmeti të rënd';* na përjashto nga çdo rrezik* me ndërmjetim nënor ti.

Lavdërime
Ting. Tërth. I

Heris askitikón

Eja, martir i Krishtit pran' nesh;* na nevojitet një vizitë plot dhembshuri,* pra eja, shpëtona ne, që nga kërcënim armiq'sor* vuajm' dhe mania* heretike shum';* prej k'saj po përndiqemi* dhe ndërrojmë përher' mjerisht* vend me një tjetër,* porsi robër të zhveshur, ja* tek po endemi* nëpër male, në shpella thell';*[91] ndaj dhembshurona, o i famshëm, jepna pak lehtësim,* pusho tallaze dhe shuaje indinjatën e Zotit ton',* pasi do t'i lutesh* Perëndisë, që i jep botës përdëllim të madh.

(2x)

Mur i fortifikuar u dhe* tek ne, pa frik' makinacioni armiqësor,* që çdo agresion barbarësh e shfuqizon, gjithashtu* dhe simptom' sëmundjesh* të shum'llojshme krejt;* baz' e parrëzueshme* dhe themel i pathyeshëm,* edhe përkrahës,* luftëtar edhe mbrojtës bashk'* për qytetin tënd,* o Dhimitër je bërë ti;* ky tashmë u çlirua me mir'dashjen e Zotit ton';* me ndërmjetimet e tua shpëto atë, që të jet' i lir'* gjithmon', duke lypur* për k'të Krishtin, që i jep botës përdëllim të madh.

Kori i athloforëve tan',* pasi fitoi çdo virtyt, u dallua fort;* prandaj trashëguan shum' denjësisht shijim edhe gaz* jete të përsosur* dhe të lumur plot.* Mes tyre dallohesh ti,* o Dhimitër, që admirojm';* për imitimin* e Jisuit krenohesh thell'* edhe mburresh me* barazinë e shtizës[92] prap';* gjer'sisht kërko për ne që të nderojmë, çlirimin ton',* që të shpëtojm' nga pësime të frikshme, nga çdo peripeci* përmes lutjes sate* të ngroht' drejt tij, që i jep botës përdëllim të madh.

Lavdi *Ting. IV*
I Andrea Jerusalemasit

Atë që me heshtë trashëgoi hirin e brinjës shpëtimtare të shpuar me shtizë, prej së cilës Shpëtimtari na buron rrëke jete dhe paprishjeje, le të nderojmë Dhimitrin tepër të urtë në mësimdhënie dhe të kurorëzuarin ndër martirët, që me gjak bëri udhën[93] e atletizmit dhe me mrekulli u ndriçua në gjithë botën, admiruesin e Zotit dhe mikun e të varfërve me përdëllim, që shumë herë dhe në shumë rreziqe të tmerrshme ka qenë në krye të selanikasve. Duke lartësuar kujtimin e tij të përvitshëm, lavdërojmë Krishtin Perëndi, i cili nëpërmjet tij kryen shërime tek të gjithë.

Tani *Hyjlindësore*

Shpëtona prej nevojave tona, o nënë e Krishtit Perëndi, ti që linde Bërësin e të gjithave, që të të thërrasim të gjithë: Gëzohu ti, mbrojtja e vetme e shpirtrave tanë.

Dhoksologjia e Madhe

Jepet edhe miro e shenjtë nga shenjti, duke psalur Idhiomelet e tij.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i tërmetit Ode III, dhe nga Kanuni i dytë të shenjtit Ode VI.

Kungatore: **Në kujtim të përjetshëm.**

CITIME

[1] Ps. 149.6

[2] Matth. 7.24-25; Lluk. 6.48

[3] I Petr. 5.1

[4] Apok. 1.6; 5.10

[5] Lluk. 1.35

[6] Jez. 44.1-3

[7] II Mbret. [Sam.] 22.8; Judith 16.15; Ps. 17(18).8; Ps. 45(46).7; Ps. 59(60).3-4; Naum 1.5-6; Is. 13.13; Jez. 38.19

[8] Ps. 6.2; 29(30).6; 37(38).2

[9] Kol. 1.16

[10] Is. 6.3

[11] Ps. 137 (138).8

[12] Jona 3.4

[13] Jona 3.10

[14] Jona 3.7-8

[15] Apok. 3.12

[16] Is. 49.16

[17] Sirak 16.18-19; Ps. 103(104).32; 113(114).7; Abak. 3.6; Is. 29.6

[18] Ef. 2.4; I Petr.1.3

[19] Rom. 13.14; Gal. 3.27

[20] Gjen. 7.4,23

[21] Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 10

[22] Ps. 132(133).1-2

[23] Matth. 26.7; Mark. 14.3; Lluk. 7.37

[23a] I Mbret. [Sam.] 2.1-2

[24] Ps. 81(82).5

[25] Est. 4.17e; Joel 2.17

[26] Ps. 59(60).4

[27] Eks. 35.16; 38.13; 40.22; Num. 4.9

[28] Ps. 45(46).5

[29] Ps. 44(45).3

[30] Kënga 1.16

[31] Kënga 1.4

[32] I Tim. 1.17

[33] Ps. 33(34).15; 36(37).27

[34] Ps. 16(17).7

[35] Ps. 27(28).2; 140(141).2; I Tim. 2.8

[36] I Petr. 5.4; Hebr. 2.7

[37] Kënga 1.7

[38] Is. 26.9

[39] Vep. 20.28

[40] II Petr. 2.15

[41] Is. 49.8; II Kor. 6.2

[42] Sirak 49.1

[43] Ps. 44(45).15

[44] Kënga 1.15; 2.13

[45] I Tim. 5.21

[46] Ps. 40(41).12

[47] II Thes. 2.2

[48] Fja. Urt. 5.22

[49] Kënga 2.1-2

[50] Ef. 5.26; Tit. 3.5

[51] Kënga 1.12; 2.4; 4.13-14

[52] Kënga 2.11-12

[53] Kënga 1.3

[54] Jez. 33.11

[55] Is. 1.16

[56] Lluk. 1.28

[57] Ps. 44(45).8

[58] Gal. 5.1

[59] Ps. 44(45).10

[60] Kënga 4.8

[61] III [I] Mbret. 18.33-38

[62] Gjen. 1.3,6,9,11,14,20,24; Ps. 148.5

[63] Ps. 122(123).1-2; IV Makk.6.26

[64] Hebr. 5.7

[65] Ps. 84(85).5

[66] Lluk. 24.49

[67] Ps. 106(107).32

[68] Ps. 149.6

[69] Jov 6.30

[70] Ps. 48(49).4

[71] Kënga 5.13

[72] Ps. 126(127).4

[73] Eks. 14.27

[74] Eks. 20.12; Matth. 15.4; 19.19; Mark. 7.10; 10.19; Lluk. 18.20; Ef. 6.2

[75] Ps. 117(118).15

[76] Eks. 33.20; Joan 1.18

[77] Joan 1.14

[78] Fil.2.12

[79] Vep. 17.26

[80] Gjen. 4.10-11;

[80a] Jer. 28(51).29

[81] Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23

[82] Matth. 3.2; 4.17; Mark. 1.15

[83] Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6

[84] I Mbret. [Sam.] 16.13

[85] Lluk. 15.22

[86] Gjen. 3.11

[87] I Kor. 15.45-47

[88] Sirak 18.5; 42.17

[89] Fja. Urt. 24.36 (Mas. 30.13); Is. 10.12

[90] Hebr. 4.16

[91] Hebr.11.37-38

[92] Joan 19.34

[93] II Tim. 4.7



MUAJI NËNTOR

QË KA 30 DITË

1 NËNTOR

Kujtimi i Anargjendëve të shenjtë Kozma dhe Damian.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të shenjtëve. Lavdi i shenjtëve. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtëve. Tani ngjallësor (Zoti Krisht, bërësi). Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtëve dhe Hyjlindësore ngjallësore (Ti që linde për ne).

Të dielën në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor dhe i shenjtëve. Pas Odes III, Ndenjësoret e shenjtëve dhe Hyjlindësorja e saj. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e shenjtëve dhe Hyjlindësorja e saj. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të shenjtëve. Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket dhe Lumurimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e shenjtëve. Apostulli i shenjtëve. Ungjilli i së dielës.



NË MBRËMËSORE

Vargëzime
Ting. Tërth. II
Olin apothémeni

Ngaqë lart në qiejtë* depozituan çdo shpresë*[1] dhe thesar që s'vidhet dot,* pasuruan veten shenjtorët me lavdi.*[2] Falas kan' marr' këta,* edhe falas japin* terapit' tek të sëmurët;[3] nuk fituan as argjend,* as ar, siç Ungjilli e thot' qart'sisht.*[4] Tek kafshët dhe tek njerëzit* ata transmetuan mir'-bërje shum',* që të bëhen bindës të Krishtit në çdo gjë, ndaj me guxim* të ndërmjetojnë për ne të gjith',* të shpëtohen shpirtrat tan'.

(2x)

Çifti v'llazëror plot hir,* bashkëbanues, me një shpirt,* me një mendje, sjellje krejt,* domethën' shenjtorët, e neveritën thell'* çdo gjë, lënd' përmbi dhé,* ngaqë prishet, u bën'* k'shtu si engjëj,[5] qytetarë qiejsh,[6] edhe pse me mish.* Japin terapi tek sa vuajnë,* lëndohen; dhe mir'bërjen po* falas e dhurojn' tek sa kan' nevoj'.* Ne le t'i himnojm' denjësisht në festa, përvjetore k'ta,* që ndërmjetojnë me shum' guxim* të shpëtohen shpirtrat tan'.

(2x)

Çifti i dëgjuar shum',* Damiani edhe Kozmai* gjith'hyjmendës kishin marr'* brenda tyre, bashkë të dy Trinin' e Shenjt'* si banore[7] dhe k'shtu* na burojn' si kroje* rrjedha terapish nga një gufim jet'sor. Shëron edhe* prekja e lipsaneve çdo pësim.*[8] Sëmundjet e të vdekshmëve* i dëbojn' dhe emrat e tyre larg.*[9] Janë shpëtimtarë në Krishtin për të gjithë që u vijn'* dhe ndërmjetojnë me shum' guxim* të shpëtohen shpirtrat tan'.

(2x)

Lavdi *Ting. Tërth. II*
I Anatoliut

Hiri që shenjtorët morën nga Krishti është pa mbarim. Prandaj edhe lipsanet e tyre veprojnë gjithmonë përmes çudish nga fuqia e hyjshme.[8] Edhe vetëm emrat e tyre kur thërriten me besë shkarkojnë nga dhembje të pashërueshme.[9] Me anën e tyre, o Zot, na çliro edhe ne nga pësimet e shpirtit dhe të trupit si njeridashës.

Tani *Hyjlindësore*
Olin apothémeni

O Hyjnuse, gjakftoht'sisht* rrëshqita keq dhe u bëra* robi i tiranit un'* me mashtrim; përiki i mjeri pra tek ti,* Vajzë e Tërëshenjt',* te mëshira jote* e çuditshme shumë dhe te lutja jote

fort e ngroht';* ndaj çliromë mua nga çdo shtrëngim,* nga ngasje, dhe shpëtomë, Zonj'* e tër'pacenuar, nga sulm dhe vrull* satanik, dhe k'shtu të të falem ty me mallëngjim me shpirt,* të të lëvdoj, të të përhimnoj,* të të madhëroj me zell.

ose Kryqhyjlindësore

Siç tha Simeoni plak,* o Virgjëreshë Hyjlind'se,* depërtoi shpirtin tënd* shpat',[10] kur pe atë që ka shndritur, Zonj', nga ti* në mënyr' që s'shprehet,* që të ngrihet mbi kryq* i dënuar rënd' nga të paligjtë; të ujitet ky* me vrer dhe me uthull, të shpohet thell'* në brinj' dhe të gozhdohet keq,* pa mëshir' në këmb' dhe në duar bashk';* dhe duke vajtuar, bërtisje, pra si nën' thoje me zë:* O Biri im fort i ëmbël, ja* ç'është ky mister i ri?

Pasvargje Idhiomele
Ting. II

Burimi i shërimeve mjekonte vetëm një çdo vit.[11] Tenda e anargjendëve mjekon gjithë turmën e të sëmurëve, sepse pasuria e shenjtorëve është pa mbarim dhe nuk i nevojitet asgjë. O Krisht, me lypjet e tyre mëshirona.

I njëjti I Theofanit

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

Pasi vepruat praktikisht me dëshirë të zjarrtë e të hyjnueshme dhe me dashuri për të ardhshmet, përshkuat udhët shpëtimtare; prandaj, pasi e ruajtët të panjollshme pastërtinë e shpirtit, u larguat krejtësisht nga materialet; dhe meqenëse u veshët me ar, pra me Shpirtin Hyjnor, u jepni të sëmurëve kurime pa ar, o çift i shenjtë, vëllezër ndriçues, dyshja e shkëlqyer dhe e hyjshme, o anargjendë, që na vizitoni ne në pikëllime dhe sëmundje, dhe shëroni pa argjend sëmundjet e shpirtrave tanë.

I njëjti I Gjermanoit

Varg: Tek shenjtorët që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

O të tërëlumur, megjithëse u denjësuat për dhurata të mëdha, vepruat mbi dhé me përulësi jete, dhe duke kaluar gjithkund shëronit falas pësimet e të sëmurëve, dhe u dukët shokë engjëjsh,[5] o Kozma së bashku me Damianin e urtë, o vëllezër ngazëllues; mjekoni me lutjet tuaja edhe pësimet tona.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Duke pasur gjithmonë Krishtin si veprues brenda jush, o anargjendë të shenjtë, bëni çudi në botë duke shë-

ruar të sëmurë,[3] sepse dhe klinika juaj është burim i pasosur; sa më shumë marrim prej tij,[12] aq më shumë gufon, dhe kur derdhet, tepron; çdo ditë boshatiset dhe shumëfishohet duke u dhënë të gjithëve pa shteruar; dhe ata që nxjerrin prej tij, nginjen me terapi dhe i pasosur mbetet ai; pra si t'ju quajmë? Doktorë, shërues shpirtrash dhe trupash, mjekë pësimesh të pashërueshme, që i shëroni të gjithë falas, që keni marrë dhunti prej Krishtit Shpëtimtar, i cili na jep përdëllimin e madh.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[13] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostujt dhe gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

ose Kryqhyjlindësore
Triímeros anestis

Kur shihte nëna jote e d'lir',* e virgjër, popullin e keq,* të paligjshëm* të të ngulte ty në dru* padrejtësisht, siç profetizoi Simeoni,* përbrenda saj plagosej hidhërisht.[10]

Përlëshore
Ting. Tërth. IV

O anargjendë të shenjtë dhe çudibërës, vizitoni sëmundjet tona; falas morët, falas na e jepni.[3]*

NË MËNGJESORE

Stihologjia e zakonshme dhe Kanunet: një i Oktoihut dhe dy të shenjtëve.

Ode I
Kanuni i parë i shenjtëve, që ka Akrostihidhë: "Me himne lavdëroj anargjendët e urtë".
Poezi e Joan Damaskinoit
Ting. I Ásomen pantes laí

Duke ndriçuar prej Hirit të Trinis' eprore,* shenjtët, çifti i çuditshëm me shum' respekt,* buron gjithnjë shërime për sa afrohen me besim të thell'.* U japin mjekime të shumta të gjithëve.

Duke udh'hequr në fsheht'si përmes fjalësh jete,* si ndriçues nëpër botë[14] shkëlqyen fort.* Me ngrohtësin' e besës shpërbënë mjegullën e veseve* leht'sisht anargjendët e lumur shum' dhe me hir.

Duke u bindur tek ligji i Jisuit, hoqën* çdo epsh mishi,[15] k'shtu ndriçuan me çdo virtyt* dhe dukshëm shpirtrat, zemrat e tyre; ndaj u shquan në çdo vend* ata, anargjendët e vyer për admirim.

Hyjlindësore

Duke fushuar në mitrën tënde, o Hyjnënë,* Bir i përmbiperëndishëm, që krejt pa koh'* ndriçoi lart prej Atit, u vesh me tër' njeriun mistikisht.* K'të le ta himnojmë, se është' lavdëruar fort.

Kanuni i dytë, që ka Akrostihidhë: "Më shpëtofsh, o çifti i anargjendëve të urtë. Josif".

Ting. IV Tristatas krateús

O çift plot me shkëlqim* i shëruesve pa lek,* anargjend' të urt', me gjith'* të zgjedhurit qëndron* pran' Trinis' që ka shum' nderim,* lutu të ndriçohen sa bëjn'* sot kujtimin tënd dritëplot'* me ndriçimet e hyjshme të Shpirtit t' Shenjt'.

Pasi treguat mend* më të lartë se çdo lënd',* flakërimin jolëndor* të Shpirtit, o të urt',* e pranuat ju, o të shenjt';* pra shpërbëni errësirën* e sëmundjeve përgjithmon',* me vizitat që bëni, o anargjend'.

Përgjumje s'kishte dot* syri juaj shpirt'ror, k'shtu* zgjoni për shëndoshjen ju* me hir sa flenë gjum'* prej sëmundjesh, që të zbatojn'* porositë zotërore,*[16] o hyjmbajtës me shum' lavdi* dhe me shum' simpati, anargjendët tan'.

Hyjlindësore

Nga gjaku yt i d'lir'* trupëzove ti Zotin,* Shpëtimtarin, o e d'lir';* tregoi ky tek ne* shpirtërisht mjekë që shpëtojn'* nga pasionet çdo njeri dhe* na përkrahin ngroht'sisht me zell,* anargjendët e tër'respektueshëm.

Ode III

Kanuni i parë: Steréosón me Hristé

Burimet për çdo shërim* dhe tubacionet e çdo dhurate* të hyjshme, dhe enët tepër të ndritëshme* të drit'simit jolëndor, le t'i himnojm' të gjith'.

O shenjtë që respektojm',* meqë shëroni pasione trupi* dhe shpirti, po i kuroni sëmundjet krejt* tek sa tash ju vijn' me zell, o mirëbërës ju.

Kur u stolisën plot'sisht* me tër' virtytet e frytshme, kështu* spostuan larg çdo shijim jete që prishet.* Me këmb'ngulje shihnin ata bukurin' e shenjt'.

Hyjlindësore

Me pamjen tonë në mish,* ai[17] që ishte më par' pa formë,* u pa, kur edhe Hyjnia në barkun tënd*[18] të tër'shenjtë erdhi, o hyjnuse dhe hyjnën'.

Kanuni i dytë: Uq en sofia

Miro të këndshme* kisha juaj e shenjt' hyjshmërisht buron* si një shi prej Shpirtit t'Shenjt';* kjo është miro shërimesh, që lan* përgjithmon' pësime me erë të kalbur pra.

Duke banuar* lart përherë në tendat e qiellit,*[5] e tregoni përgjithmon'* burim shërimesh[19] ju tendën tuaj* me hir, o shenjtor' të të Gjithëpushtetëshmit.

Me fre, përmbajtje,* gjith' pasionet e mishit i hodhët posht';* k'shtu pranuat pasurisht* shkëlqimet prej Shpirtit t' Shenjtë nga lart,* pasuroni botën me shum' lloj shërimesh pra.

Hyjlindësore

Zoti të zgjodhi* më të bukurën mes grave,[20] o e d'lir',* dhe nga mirëdashja, po* prej teje lindi në mish biri yt,* Krishti, që ndër shenjtët e tij prehet shpirtërisht.[21]

Irmosi: Uq en sofia

»**S'**mburremi fare* për fuqi, urtësi, »as për pasuri,* por për ty,[22] pra »urtësin'* enipostate të Atit, o »Krisht*[22a] njeridashës, se përveç teje »s'ka tjetër shenjt.[22b]

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

Keni marrë prej Krishtit çuditërisht,* që nga qiejtë lart një dhurim të madh,* shërime; shëroni k'shtu* gjith' pasionet, madje përher',* sepse në ju u pa Hir' i Shpirtit të Shenjtë qart'* duke ju falur forc' terapish të hyjnueshme,* ndaj dhe i fituat përmes besës shumicë* të mirash me mendje, shpirt* që s'përfillte argjend aspak,* anargjendë* hyjmbajtës shenjt';* ndërmjetoni tek Zoti Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tuaj të shenjt' me mall.

Lavdi *I ngjashëm*

Udëftuat tek ne të gjith' si flak'rim,* llamba, mrekullibërës, dhurues, drit',* shërime me an' çudish,* përmes Hirit të Shpirtit t' Shenjt',* sepse freskoni flakë pësimi të rënd' me bes',* me hir mjekoni mentalitetin e njerëzve,* ndaj meqë e keni kishën tuaj të hyjshme* klinikë për shpirtin ton',* drejt kësaj po përikim ne,* anargjendë* hyjprurës, shenjt';* ndërmjetoni tek Zoti Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tuaj të shenjt' me mall.

Tani *Hyjlindësore*

O besnikë të gjith', ejani me zë* të himnojm', të madh'shtojm' nënën e tër'shenjt'* të Bërësit të Gjith'sis',* mbretëreshën, t'i th'rrasim k'shtu:* Shkaktare e gëzimit, shpëtona sa të nderojm',* o Virgjëresh' e tërëhimnuar, dhe na mbulo;* nën' e Zotit ti je, dhe guxim disponon shum'* për falje, me dhembshuri* na shëron nga sëmundjet ne* përmes lutjes* që bën; prandaj* të thërrasim: Ti ndërmjeto* tek Biri yt, Zoti ynë* për ndjesën ton',* se i falemi lindjes sate pa far' me bes'.

ose Kryqhyjlindësore

Kur bariun[23] dhe qengjin e pa mbi kryq,* ku po varej, e d'lira përbrenda saj* plagosej, thërriste fort* dhe me klithmë si nënë kjo:* Mjer' un', o drit' e botës,[24] o Zot, Perëndia im,* përse vullnetarisht ti pëson k'to tani, o bir?* Do ikonën tënde[26] që u prish rëndë, njer'zit,* patjetër ti t'i shpëtosh*[25] dhe t'i çosh në një jet' të shenjt';* pra pësime* ke vuajtur,* se ke dhembshuri ti në shpirt;*[27] me k'to shërove çdo dhimbje,* pra çdo njeri;*[28] ndaj mundimet e tua i madhëroj me mall.

Ode IV
Kanun i parë: Katenóisa pantodhíname

Duke shkuar pas thënies hyjnore, nuk fituat flakërime ari, as argjendi,[4] o të hyjnueshëm.

Të shkëlqyer me çudi të hyjshme, anargjendët u bëjnë mirë të gjithëve duke falur hir.

U paraqitët doktorë të urtë, duke afruar tek dhimbjet e sëmundjeve duar që dëbojnë të keqen.

Hyjlindësore

Le të qëllohen tani fytyrat e atyre që nuk të pohojnë si Perëndilindëse, o Zonjë e tërëkulluar.

Kanuni i dytë: O kathímenos en dhoksi

Me veprimtari jetëprurëse dhe me arritje të përsosur shëroni sëmundjet vdekjeprurëse të të dhélindurve, o shtylla tepër të ndritshme, kulla të palëkundshme, degë[29] të hyjshme të hardhisë të së vërtetës.[13]

Le të himnohen me melodi ngazëllluese gjinjtë e Kishës, që derdhin qumështin e terapive, anargjendët e ndriçuar, që na ushqejnë të gjithë me gjellë të hyjshme.

Kisha juaj, o shenjtorë, u dëftua klinikë, liman i papërmbytur dhe shpëtimtar i të dimëruarve, në të cilën kur vrapojmë, marrim të gjithë butësinë dhe çlirimin nga tmerret.

Hyjlindësore

Na denjëso për dhembshurinë tënde, o Virgjëreshë, që linde Fjalën, të vetmen që ka me të vërtetë simpatinë supreme dhe që i tregoi shenjtorët mirëdashës mjekë dhe çudibërës anembanë tokës.

Ode V

Kanuni i parë: Ek niktós orthrízontes

Si kroje hyjrrjedhëse u buroni besëmirëve çurka mirëbërjeje, duke shëruar sëmundjet e shpirtit dhe të trupit, o anargjendë të lavdishëm.

Pasi zhvulosni për të gjithë burimin e Hirit, o anargjendë të respektuar, u shpërndani shëndoshje atyre që tani rendin tek ju me besim dhe me mallëngjim.

Na llamburitin pa pushim yjet e shkëlqyeshëm dhe të tërëurtë, që tokën dukshëm e bënë qiell me imitimin e shkëlqimit të engjëjve.

Hyjlindësore

U duke më e lartë, o Nënë virgjëreshë, se zure dhe linde për botën shpëtimtarin dhe Zotin, atë që është bërësi i të gjithave dhe i bashkëpafillim me Atin.

Kanuni i dytë: Eksesti ta símpanta

Duke shkëlqyer dukshëm prej ndriçimeve të hyjshme, vini rrotull në tërë botën dhe shndritni fort të gjithë njerëzit,[30] duke përzënë errësirë pasionesh dhe duke shporrur demonë,[3] o anargjendë hyjmbajtës.

Si dy ndriçues të lëvizur nga Shpirti shkëlqeni planetin,[31] o hyjmbajtës, duke ardhur përreth gjithë Krijesës dhe duke vizituar ata që janë në shtrat dhimbjeje,[32] dhe duke nxjerrë nga vështirësi.

Meqenëse jepni pa argjend shërimin tek të sëmurët dhe çlirimin nga pësimet, u shfaqët mbrojtësit më të mëdhenj të të gjithëve, ndihmësit e të gjithëve pas Perëndisë, përkrahësit e të gjithëve, o anargjendë hyjmbajtës.

Hyjlindësore

O Perëndilindëse e virgjër, e pacenuar, pate në bark urtësinë e Perëndisë enipostate,[22a] që i tregoi të tërëurtë shenjtorët, nëpërmjet të cilëve ra arroganca dhe intrigat e tmerrshme të atij që bën sofizmat e së keqes.

Ode VI

Kanuni i parë: Ton profitin dhiésosas

Mjekët që na shpëtojnë ne,* mirëbër'sit hyjmendës krejt,* Kozman' dhe Damianin të hyjshmit,* me zell t'i nderojm' të gjith'.

Mençurinë e mbajtën fort,* me urti u stolisën krejt *[33] Kozmai, Damiani të hyjshmit;* me Krishtin gëzohen tok.

Me një shpirt bashk'banuat ju* edhe asketizuat tok;* të dyve ju është besuar* çdo dhënie shërimesh prap'.

Hyjlindësore

Linde drit' që s'afrohet dot,*[34] dhe pse me mish, o e tër'd'lir';* kjo shndrit tërë botën[35] me dritë* hyjnie dhe udhëzon.

Kanuni i dytë: Thiso si metá fonís

Jo mjesht'ri* nga ana njerëzore, por hir të shenjt'* po dispononi; pastroni* me këtë sëmundjet e njer'zve;[3] ndaj ju* lumërojmë,* ju lëvdojmë siç kemi detyrë ne.

Miqësisht* me Krishtin ton' u lidhët hyjmbajtës ju,* dhe për pasojë shpërbëni* po me hir të shenjt' çdo të keqe, grackë* djallëzore;* ndaj panairin tuaj e bëjmë ne.

Duke qen'* lastarët e hardhis' së hyjnueshme,*[29] qerasni me ver'[36] shërimesh* gjith' të zymtët, të mjerët nga pasionet;* tek ne eni* me gaz, o anargjendë, na mbushni plot.

Hyjlindësore

Si tempull* të pastër të ka bërë ty, Zonja jon',* pra Fjala tepër e pastër,* që me mrekulli dhe çudi përherë* madhështon krejt* shtëpin' e shenjtë të anargjendëve.

Irmosi: Thiso si metá fonís

»**D**o flijoj* me zë himnimi, Kisha »thërret tek ti,* o Zot, sepse përmes »gjakut,* që nga brinja jote për »përdëllim rrjedh,* u pastrua* nga »çdo pisllëk, prej gjakrash demonësh »kjo.

Kontaqi

Ting. II

Ju që keni marrë hirin e terapive,[19] shtrini fuqinë tek ata që janë në nevojë, o doktorë çudibërës të lavdishëm; dhe me vizitën tuaj mposhtni arrogancat e armiqve, meqë shëroni botën me çuditë.

Shtëpia

Fjala e mjekëve të urtë është mbi çdo mençuri dhe urtësi, sepse pasi morën Hirin e të Shumëlartit, u dhurojnë të gjithëve padukurisht shëri-

min; prandaj edhe mua më kanë dhuruar hir rrëfimi, që t'i himnoj si hyjmbajtës, të pëlqyer nga Perëndia dhe shërues, që japin me mbushulli kurime, se i çlirojnë të gjithë nga dhimbja, meqë shërojnë botën me çuditë.

Sinaksari

Muaji nëntor, që ka 30 ditë. Dita ka 10 orë dhe nata 14 orë.

Më 1 të të njëjtit muaj, kujtimi i anargjendëve të shenjtë dhe çudibërës Kozma dhe Damian, bijtë e Theodhotës nga Azia.
Vargje: Megjithëse kaluan prej dheut, të dy anargjendët/ e mbushin përsëri si më parë dheun me çudi.
Më 1 të nëntorit, mjekët-dritë fluturuan nga dheu.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martireve gra Kirienës dhe Julianës.
Vargje: Edhe Kiriena jep frymën në zjarr,/ meqenëse nderonte Zotin e çdo fryme.
Meqë ishte djegur nga dashuria jote, o Shpëtimtar,/ Juliana duron djegie prej zjarri.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Qesarit, Dhasit dhe pesë të tjerë.
Vargje: Miqtë e gënjeshtrës presin Qesarin/ tok me 6 bashkatletë, miqtë e së vërtetës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i hieromartirëve të shenjtë Joan episkopit dhe Jakov presviterit.
Vargje: Bashkë me Jakovin, flijuesin e Krishtit,/ duroi shpatë Joani, flijuesi i Krishtit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Erminigjeldit.
Vargje: Erminigjeldi, pasi u la nga ngjyrë mashtrimi,/ duke pësuar therje, lyhet me porfir guackeje.

Martirët e shenjtë Qipriani dhe Juliana mbarojnë me zjarr.

Kujtimi i oshënarit, martirit të ri Jakov dhe të dy nxënësve të tij Jakov dhjakut dhe Dhionis kallogjerit, që mbaruan me varje në 1520.

Ati ynë oshënar Davidi, i cili asketizoi në Evia, mbaron në paqe.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i virgjëreshës martire Eleni.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Ode VII
Kanuni i parë: Se noitín

Të gjithë ju u dukët hyjmendës, të gjithë të aftë për të nxënë Perëndi; sepse braktisët gjithë botën për Perëndinë[37] duke ndjekur gjurmët e Shpëtimtarit,[38] o të tërëlavdëruar, dhe

duke madhëruar fort hyjnisht Perëndinë e etërve.

O mjekë shumë të shkëlqyer, shëroni në mënyrë mbimendore të gjitha plagët e të sëmurëve me kirurgji mistike, duke nxjerrë ilaçe shpëtimtare nga thesaret e hyjnueshme dhe duke himnuar Perëndinë e përmbilavdëruar.

Me kurorën e mbretërisë sate, o Zot, dhe me stemë të shkëlqyer[39] stolise hijshëm ata që deshën fort hijeshinë e pakapshme të bukurisë sate, o Krisht, dhe i tregove mirëbërës të përbashkët për të gjithë besimtarët.

Hyjlindësore

U paraqite, o e tërëkulluar, portë[40] e tërëhijshme dhe plot e ndritshme e lindjes së shfaqur nga lart[41] mbi dhé, dhe shkëlqen ti botën me llamburitje pastërtie dhe u dërgon përherë besëmirëve vezullime çudish.

Kanuni i dytë: En ti kamino

Duke zhvulosur burimin e dhenë prej Perëndisë, o shenjtorë, gufoni për të gjithë lumenj[42] shërimesh të kulluar, dhe lani ndotje pësimesh dhe ligësi shfarosëse të demonëve.

Çifti i anargjendëve të tu, i vyer për lavdërim, o Fjalë Perëndie, urtësi dhe fuqi,[22a] i gjallëruar nga Hiri forcues i Shpirtit, u jep gjithmonë fuqi të sëmurëve.

I shenjtë vetëm ti je, që lavdëron shenjtorët e tu;[43] nëpërmjet tyre çliron botën nga vështirësitë dhe i ndriçon ata që thërrasin: I bekuar je, në tempullin e lavdisë sate, o Zot.

Hyjlindësore

Mbive si shkop nga rrënja e Jeseut dhe nxore lule,[44] Krishtin, o Mariam, i cili zbukuroi me mrekulli si me lule shërbëtorët e tij anargjendë.

Ode VIII

Kanuni i parë: En kamino pedhes

Pasi vdiqët për kënaqësitë e botës[45] dhe si pretë sëmundjen e argjenddashjes, u quajtët të urtë, anargjendë për të gjithë ata që thërrasin: Gjithë veprat e Zotit, himnoni Zotin dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.[45a]

U bëtë dukshëm pjesëmarrës jete të amshuar, sepse braktisët kënaqësitë e jetës që prishet, duke thirrur bashkë: Gjithë veprat e Zotit, bekoni Zotin, himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.[45a]

Shpëtoji të gjithë, o Zoti Krisht, nga sëmundje të rënda, me ndërmjetimet e anargjendëve dhe denjësoi për të thirrur së bashku gjithmonë: Gjithë

veprat e Zotit, bekoni Zotin, himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.[45a]

Hyjlindësore

Të gjithë ne besnikët që u çliruam me lindjen tënde, o nënë e virgjër, të gëzuar dhe të forcuar nga Hiri, thërrasim pa pushim: Gjithë veprat e Zotit, bekoni Zotin, himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.[45a]

Kanuni i dytë: Hiras ekpetasas Dhaniíl

U dukët, o shenjtë, të zhveshur nga çdo e keqe e armikut përmes Shpirtit Hyjnor, dhe u bëtë rrobë shpëtimi,[46] veshje ndjeseje dhe sosje shtrëngimesh për ne që thërrasim: Gjithë veprat, himnoni Zotin.

O Damian dhe Kozma, si u bëtë me besë bij Perëndie, sipas kungimit që patët, gjetët tani trashëgimin atëror,[47] shijimin qiellor dhe energjinë vërtet të gëzueshme të çudive, dhe thërrisni: Gjithë veprat, himnoni Zotin.

Me pikat tuaja të perëndishme lani ndotjen tonë shpirtërore, o shenjtorë, përzëni sëmundjet e dhimbshme dhe dëboni vrullet e demonëve, si shëruesit tanë tepër të dhembshur.

Si zambakë, si lule mendore, si trëndafila[48] na u treguat, o shenjtorë, të zbukuruar prej Shpirtit, duke lëshuar erë të këndshme dhe duke përzënë erën e keqe të pasioneve tona tek ne që thërrasim: Gjithë veprat, himnoni Zotin.

Hyjlindësore

Vritet vdekja në ty, sepse linde jetën enipostate, Krishtin Zot, o e pacenuar, i cili i tregoi mjekët anargjendë si mbrojtësit e jetës sonë, për ne që thërresim: Gjithë veprat e Zotit, bekoni Zotin.

Irmosi: Hiras ekpetasas Dhaniíl

»Duke* ngritur duart Danieli mbylli »gojët e luanëve në grop';* e shuan »forcën e zjarrit krejt* kur u ngjeshën »Djemtë me virtyt,* pra miqtë e »shpresëtaris',* duke bashk'thirrur »me gaz: Bekoni* ju gjithë veprat e »Zotit, pra Zotin ton'.

Ode IX

Kanuni i parë: Se ti fainín lambadha

Le ta madhërojm' me himne* pa pushim çiftin e urt'* të shkëlqimit mendor krejt,* se feks me çdo lavdi dhe u transmeton fort* të gjithëve ndriçim të madh.

Ngaqë jepni forc' shëndeti* shpirtëror te çdo besnik* edhe jeni besuar*

që të shëroni trupat si shpëtimtarë,* siç duhet ju himnojm' gjithnjë.

Pa pushim i shndritën qiejt* mendërisht të Kishës son',* që ësht' e respektuar,* lëshojnë si pishtarë tani ndriçim pra* ndriçuesit me hyjshkëlqim.

Duke u forcuar çifti* i hyjftuar prej Trinis'* së Shenjt' dhe të nderuar,* buron, derdh terapi tek të gjith' që me mall* vërtet e lumërojn' atë.

Hyjlindësore

Ne të madhërojm' me himne,* o Hyjlindëse, se je* ark'[49] e shenjt', re ndriçimi*[50] si edhe port'[40] e tër'ndritshme, e shkëlqyer* e diellit mendor,[51] Krishtit.

Kanuni i dytë: Eva men to tis parakoís

Ç'gjë ka më të mirë a më të pëlqyeshme,* sesa bashkë të banojn' tani* v'llezër[52] me një mendje në vendet* që drit' lëshojn', në tendat e qiellit,* përbrenda lavdis' që s'vyshket dot;[53] pra këta* le t'i lum'rojmë denjësisht me hir.

Sa e madhe ësht' kjo kishë që krenohet shum'* me çudit' që bëhen k'tu çdo dit',* ku ju gjithmon' na vizitoni,* Kozma, Damian, të vyer për dashuri;* u jepni mjekim atyre që kan' nevoj',* ndaj denjësisht ju lumërojm' me gaz.

O të lumur, engjëj sot gëzojnë tok me ne* dhe apostuj, dhe profetë bashk',* dhe oshënarë, dhe të drejtë,* gjith' shenjtët për kujtimin tuaj që bëjm';* me k'ta dhe ju jeni tash në një gaz të madh,* lypni për botën pranë Krishtit ton'.

Çift i hyjshëm, drit'lëshues, anargjendët tan',* pra hyjmbajtës me nderim të fortë,* lypni për sa ju lumërojmë* përherë, falje shkeljesh dhe korrigjim* jetese, si dhe çlirim nga çdo vuajtje* dhe fatkeq'si, kemi besim tek ju.

Hyjlindësore

Ti je bër' banesa e ndriçimit, që gjer'sisht* i ndriçoi të gjith', o e d'lir',* dhe i tregon tani shenjtorët* drit'prurës, që dëbojnë larg errësir'* pasionesh që prishin; Shpirti vepron në ta,* o Zonj', e vetme e himnuar shum'.

Irmosi: Eva men to tis parakoís

»Eva nga sëmundja e mosbindjes
»mori keq* si banues brenda saj mall-
»kim,* por, o Hyjlind'se virgjëreshë,*
»ti nëpërmjet lastarit të shtatzënis'*
»për botën e lulëzove bekimin krejt;*
»ndaj ne të gjith' të madhështojmë ty.

Dërgimësore
En Pnévmati to ieró

O anargjendë shum' të lum',* morët hir terapie* nga Zoti,[19] Perëndia yn'* dhe shëroni sëmundje;* mjekoni gjith' sa vrapojnë* për në kishën tuaj plot* me besë; pra lumërojmë* me një mendje bashkërisht* sot kujtimin tuaj ne* me mjaft respekt dhe siç duhet.

Hyjlindësore

E kishe gjatë shtatzënis',* o e tër'pacenuar,* gjith' Fjalën Zot të Perëndis',* Perëndin' që vepronte* tër' urtësi për shpëtimin* botëror, ekonomin'* shkëlqyese; të himnojm' pra* denjësisht, se ndërmjeton* tek ai që të shpëtojm'* nga çdo rrezik dhe sëmundje.

Lavdërime Idhiomele
Ting. I I Anatoliut

Meqë morët hirin e terapive prej Perëndisë,[19] pa argjend shëroni pësimet e shpirtrave dhe të trupave tanë, o anargjendë të të gjithë botës; prandaj Krishti, duke u dhuruar shpresëtarëve shëndoshjen e sigurt me anën tuaj, ju tregon ndriçues të pagabuar tek bota; ndërmjetoni tek ai që të shpëtohen shpirtrat tanë.

I njëjti

Meqë nxorët avushën e mjekimeve nga furnizimi i sipërm, u buroni të gjithë besëmirëve terapitë, o anargjendë, sepse përmbinatyrshëm shëroni pësimet e të sëmurëve me kirurgji mistike, duke u shtuar të pafuqishmëve ilaçe shpëtimtare nga thesaret e Shpirtit; rrjedhimisht, si u bëtë tempull i nderuar i Triadhës, që kryeson jetën dhe e bëri dukshëm banesën brenda jush,[7] ndërmjetoni tek ajo që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Ting. II I Gjermanoit

Ngazëllohet kori i shenjtorëve përjetë, sepse trashëguan mbretëri qiejsh.[47] Toka kur pranoi lipsanet e tyre lëshoi aromë. U bënë shërbëtorë të Krishtit,[54] duke fushuar në jetë të amshuar.

I njëjti

O mjekë të të sëmurëve, thesare të shërimeve, shpëtimtarë të besnikëve, anargjendë të tërëlavdishëm, ata që bërtasin në nevoja dhe vuajnë, i shëroni duke i lypur bashkë me Theodhotën Perëndisë të mirë, që të çlirohemi nga kurthet e armikut.

Lavdi *Ting. IV I Theofanit*

Duke patur burim shërimesh, o shën anargjendë, dhurojuni shërimet gjithë atyre që kanë nevojë, se u bëtë të

denjë për dhurata shumë të mëdha prej burimit të pashterur të Krishtit Shpëtimtar; se Zoti ju thotë si zelltarë të njëjtë me apostujt: Ja, ju kam dhënë fuqinë kundër shpirtrash të ndyrë, që të nxirrni dhe të shëroni çdo sëmundje dhe çdo dobësi; prandaj, pasi keni jetuar mirë sipas porosive të tij, falas morët, falas jepni, duke shëruar pasionet e shpirtrave dhe të trupave tanë.*

Tani *Hyjlindësore*
Édhokas simósin

G'zohu, strehë dhe përikje për kristianët si dhe forcim;* g'zohu, shkall' qiellore[55] krejt;* gëzohu, thesar i madh* i d'lir'sis' së virgjër;* g'zohu, ark'[49] logjike, Perëndilind'se, g'zohu shum';* je krenari, lavdi i hyjnueshëm,* mbështetëse e botës dhe rithirrja e të rrëzuarve,* tenda[56] e tërëndritëshme,* e tër'bukur, e shenjtë plot.

ose Kryqhyjlindësore

Kur e pa të kryqëzohej dhe të shpohej në brinjë thell'* nga një shtiz', e Kulluara,* Jisu njeridashësin,* qante duke thirrur:* Ç'është kjo, o biri im? Çfarë të shpërblejnë ty* për gjith' të mirat që bëre për këta,* për popull mosmir'njohës, dhe nxitohesh të më lësh pa fëmij',* o i ëmbël; habitem pra* për kryq'zimin tënd vullnetar.

Pasvargje të Oktoihut
Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Kush nuk do të mahnitet? Kush nuk do të lavdërojë? Kush nuk do të himnojë besërisht mrekullitë e anargjendëve të urtë dhe të lavdëruar? Sepse, edhe pas shpërnguljes së tyre të shenjtë, u japin të gjithëve që rendin tek ata shërimet pasurisht; edhe lipsanet e tyre të nderuara dhe të shenjta burojnë hirin e terapive.[8] O çift i shenjtë! O krye të çmuara! O urtësi dhe lavdi e Hirit që ju dha prej Perëndisë! Prandaj le t'i këndojmë Perëndisë mirëbërës, i cili i dëfteu mjekë të shpirtrave dhe të trupave tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

ose Kryqhyjlindësore
I mártirés su Kírie

S'duroj dot, o bir, të të shoh ty që u jep të gjith've vigjilencë,* mbi dru të flesh gjum'[57] me qëllim t'u japësh gatishmëri shpëtuese* dhe të shenjt' të fjeturve në koh' të lasht';* vdiqën[16] prej mëkatit, shkeljes nga një frut.*[58]

E virgjëra k'shtu thoshte duke vajtuar rëndë; e madhështojm' atë.

Në Liturgji, Tipiket dhe Ode III nga Kanuni i parë i shenjtëve dhe Ode VI nga Kanuni i dytë.

Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] Kol. 1.5

[2] Matth. 6.20; 19.21; Mark. 10.21; Lluk. 12.33; 18.22

[3] Matth. 10.8

[4] Matth. 10.9; Vep. 3.6

[5] Matth. 22.30; Mark. 12.25; Lluk. 20.35-36

[6] Fil. 3.20

[7] Joan 14.23

[8] IV [II] Mbret. 13.21

[9] Vep. 3.6; 19.13

[10] Lluk. 2.35

[11] Joan 5.2-4

[12] Is. 12.3

[13] Joan 15.1

[14] Fil. 2.15

[15] Matth. 10.38; 16.24; Mark. 8.34; Lluk. 9.23; 14.27; Gal. 5.24

[16] Rom. 13.11-12; I Kor. 11.30

[17] Fil. 2.7-8

[18] Lluk. 1.35

[19] I Kor. 12.9

[20] Kënga 1.8; 5.9; 6.1

[21] Is. 57.15

[22] I Mbret. [Sam.] 2.10; Jer. 9.23(22)

[22a] I Kor. 1.24,30

[22b] I Mbret. [Sam.] 2.2

[23] Joan 10.11,14

[24] Joan 8.12; 9.5; 12.46

[25] Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3

[26] I Tim. 2.4

[27] Kol. 3.12

[28] Is. 53.4-5

[29] Joan 15.5

[30] Ps. 18(19).7

[31] Gjen. 1.16

[32] Ps. 40(41).4

[33] Urt. Sol. 8.7

[34] I Tim. 6.16

[35] Joan 1.9

[36] Fja. Urt. 9.2

[37] Is. 52.11; II Kor. 6.17

[38] I Petr. 2.21

[39] Urt. Sol. 5.16

[40] Jez. 44.2-3

[41] Lluk. 1.78

[42] Gjen. 2.10

[43] Ps. 15(16).3

[44] Is. 11.1

[45] Gal. 6.14

[45a] Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 34

[46] Is. 61.10

[47] Matth. 25.34

[48] Sirak 50.8

[49] Eks. 25.9-20; 38 (37).1

[50] Eks. 14.24; 16.10; Num. 9.15

[51] Mal. 4.2 (Mas. 3.20)

[52] Ps. 132(133).1

[53] I Petr. 1.4

[54] Ef. 6.6

[55] Gjen. 28.12

[56] Ps. 131(132).5; Hebr. 9.2

[57] Lluk. 23.46; Joan 19.30

[58] Gjen. 3.4-6

MË 8 TË TË NJËJTIT MUAJ

Mbledhja e kryeengjëjve Mihail dhe Gabriel dhe të Fuqive të tjera të patrup.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 Vargëzime ngjallësore dhe 6 të kryeengjëjve. Lavdi i kryeengjëjve. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i kryeengjëjve. Përlëshoret: ngjallësore, e kryeengjëjve dhe Hyjlindësore ngjallësore (Misteri i fshehur).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e kryeengjëjve dhe Himne Triadike. Trishenjti. Përlëshore e kryeengjëjve. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, Ndenjësoret: nga 1 ngjallësore dhe nga 1 e kryeengjëjve së bashku me Hyjlindësoret e tyre. Pas Polieleit, Ndenjësoret e kryeengjëjve. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat e tingullit dhe Proqimeni. Kanunet: ngjallësor dhe i dytë i kryeengjëjve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Ndenjësoret e kryeengjëjve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e kryeengjëjve dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore dhe e kryeengjëjve me Hyjlindësoren e saj. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të kryeengjëjve. Lavdi i kryeengjëjve. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të dytë të kryeengjëjve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e kryeengjëjve, e kishës dhe Kontaqi i Hyrjes në Tempull. Apostulli i kryeengjëjve dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore Ai që i bën engjëjt e tij frymëra.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime Ting. IV
I Mihailit: Os jeneon en mártisin

Duke qen' i ndriçueshëm* pran' Hyjnis'[1] së tridiellshme,* je i famshëm, o kryegjeneral i madh;*[2] tok me Fuqitë e sipërme thërret, Mihail, me gaz:* Je i shenjtë At' i madh,* je e shenjt' Fjal' bashk'pafillim,* je i shenjtë Shpirt,*[3] dhe të tre bashkë jeni një lavdi, një mbretëri dhe një Hyjni, si dhe një fuqi mbi të gjitha ju.

Të përflakur e ke pamjen,* bukurin' të çuditëshme,* kryeengjëll Mihail,

me natyr' pa lënd';* nëpër çdo anë të botës shkon, sepse ti zbaton plot'-sisht* të gjith' urdh'rat e atij*[4] që ka bërë me fjal' Gjith'sin';* njihesh shum' i fort'* dhe e bën kishën tënde që nderojm' në emrin tënd, si një burim jetësor shërimesh, o gjeneral.

Ti, o Zot, që bën engjëjtë* vërtet shpirtra, siç Shkrimi thot',* dhe k'ta që shërbejn' tek ti si një flak' e zjarrt',*[5] mes batalioneve qiellore shfaqe si kryetar*[2] Mihailin gjeneral,* që me bindje të plot' dëgjon* shenjat që ti bën,* dhe i cili thërret me frikë himnin trishenjtor[3] tek lavdi yt, o Fjal' dhe mbret, sundimtari yn'.

I Gabrielit: Ἐdhokas simíosin

Mendja që ësht' para jete, drit' të dytë të bëri ty* me pjes'marrje të hyjshme krejt,* o engjëll arkond, epror,* që të shndritësh botën* dhe të na zbulosh ti misterin shum' të madh hyjnor,* të tërëlashtë vërtet, të bëhet pra* njeri me trup, o Gabriel, në bark të virgjër Jisui Krisht,*[6] domethën' i patrupi Zot,* për shpëtimin e njerëzve.

Pranë fronit tër'hyjnor, tridiellor po qëndron[1] dhe k'shtu* pasurisht flakërohesh plot* me shndritjet e hyjshme krejt,* nga ku po lëshohen* pa pushim; dhe ne që formuam përmbi dhé një kor * e të lëvdojmë me gaz, çlirona ti* nga mjegull vesesh dhe shkëlqena me ndriçim ne, o Gabriel,* kryeengjëll, ambasador,* ndërmjetues për shpirtrat tan'.

Thyej arrogancat e pasardhësve të Agarës ti,* që sulmojn', Gabriel gjithmon',* me vrull grigjën tënde, dhe* skizmat brenda Kishës* shpejt pushoji; na zbut furtuna ngasjesh të pafund;* çliro ata që të lavdërojn' me mall* dhe rendin poshtë strehës sate, nga rreziqe dhe çdo shtrëngim,* kryeengjëll ambasador,* ndërmjetues për shpirtrat tan'.

Lavdi *Ting. Tërth. II I Bizantit*

Gëzohuni bashkë me ne, ju gjithë brigadat e engjëjve, se prijësi juaj dhe mbrojtësi ynë, kryegjenerali i madh,[2] sot duke u bërë i dukshëm çuditërisht në kishën e tij të respektuar, shenjtëron. Pra siç i ka hije duke e himnuar, le të thërrasim: Mbulona ne me strehën e krahëve të tu, o Mihail i tërëmadh, o kryeengjëll.[2]

Tani *Hyjlindësore*

Gëzohuni bashkë me ne, ju gjithë koret e virgjëreshave, sepse mbrojtja jonë, ndërmjetësja, streha dhe përikja e madhe, sot me përkujdesjen e saj të respektuar dhe të hyjshme, ngushëllon të pikëlluarit. Pra siç i ka hije

duke e himnuar le të thërrasim: Mbulona ne me mbrojtjen tënde të hyjshme, o Zonjë Hyjlindëse e pacenuar.

Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës dhe Leximet.*

Këndimi i Jisuit të Naviut
(5.13-15)

Ndodhi që, siç ishte Jisui në Jeriko, duke parë lart me sytë e tij, pa një njeri që qëndronte përballë tij dhe *kishte* shpatë të zhveshur në dorën e tij, dhe pasi u afrua Jisui, i tha: Je nga tanët, a nga kundërshtarët? Dhe ai i tha: Unë *jam* kryegjeneral i ushtrisë së Zotit, tani kam mbërritur. Dhe Jisuit ra me fytyrë përtokë dhe i tha: O Zotëri, çfarë i urdhëron shërbëtorit tënd? Dhe tha kryegjenerali i Zotit tek Jisui: Zgjidhe sandalen nga këmbët e tua, sepse vendi ku qëndron ti mbi këtë është i shenjtë. Dhe bëri Jisui kështu.

Këndimi i Gjyqtarëve
(6.6,11-24)

Ndodhi që në atë ditë dhe mbizotëroi Madhiami mbi bijtë e Izraelit dhe ata thirrën drejt Perëndisë; dhe ja një engjëll i Zotit mbërriti dhe u ul nën valanidhin e Joasit që ishte në Efratha; dhe Gjedeoni, biri i tij, rrihte me shkop grurë në tork dhe nxitohej të ikte nga fytyra e Madhiamit. Dhe iu pa atij një engjëll Zoti dhe tha tek ai: Zoti i fuqishëm në forcë *është* me ty. Dhe tha tek ai Gjedeoni: Në mua, o Zotëria im? Dhe nëse Zoti *është* me ne, pse na gjetën këto të këqija? Dhe ku janë të çuditshme të gjitha të tijat, sa na treguan etërit tanë duke thënë: Nuk na ngriti nga Egjipti Zoti? Dhe tani na shtyu dhe na dorëzoi në dorën e Madhiamit. Dhe mbikëqyr tek ai engjëlli i Zotit dhe i tha: Ec në këtë fuqi tënden dhe do të shpëtosh Izraelin nga dora e Madhiamit; ja të dërgova ty. Dhe tha tek ai Gjedeoni: Në mua, o Zotëri. Me çfarë do ta shpëtoj Izraelin? Ja, mijëshja ime *është* më e përulura në Manas, dhe unë jam më i vogli në shtëpinë e atit tim. Dhe tha tek ai engjëlli i Zotit: Zoti do të jetë me ty dhe do ta godasësh Madhiamin si një burrë. Dhe tha tek ai Gjedeoni: Në qoftë se gjeta hir në sytë e tu dhe do të bësh sot gjithçka që flet me mua, pra mos u ndaj prej këtej deri sa të vij unë drejt teje dhe të sjell theroren time, dhe të flijoj para teje. Dhe tha: Unë jam; do rri deri sa të kthehesh. Dhe Gjedeoni hyri dhe bëri një kec dhish dhe një ifi mielli të pambrujtur. Dhe mishrat i vuri në shportë, dhe lëngun e vuri në tenxhere, dhe i nxori tek ai poshtë valanidhit dhe u afrua. Dhe tha tek ai engjëlli i Zotit: Merr

mishrat dhe bukët e pambrujtura dhe vëri afër atij guri, dhe lëngun derdhe pranë. Dhe bëri kështu. Dhe shtriu engjëlli i Zotit majën e bastunit *që ishte* në dorën e tij, dhe preku mishrat dhe të pambrujturat, dhe u ndez zjarr nga guri, dhe hëngri tërësisht mishrat dhe të pambrujturat; dhe engjëlli i Zotit iku nga sytë e tij. Dhe pa Gjedeoni se është engjëll Zoti dhe tha Gjedeoni: Mjerë, o Zot, o Zot! Sepse pashë engjëllin e Zotit faqe për faqe. Dhe i tha Zoti: Paqe në ty, mos u frikëso, nuk do të vdesësh. Dhe ndërtoi atje Gjedeoni një altar për Zotin dhe e quajti Paqe Zoti deri në atë ditë.

Këndimi i profecisë së Danielit
(10.1-21)

Në vitin e tretë të Kirit, mbretit të persianëve, një fjalë iu zbulua Danielit, emri i të cilit u mbiquaj Valtasar; dhe *është* e vërtetë fjala, dhe fuqi e madhe, dhe mençuri iu dha në vegim. Në ato ditë, unë Danieli isha në zi për tri javë ditësh. Dhe bukë dëshirash nuk hëngra, dhe mish dhe verë nuk u fut në gojën time, dhe me lyerje nuk u leva deri në mbushjen e tri javë ditësh. Dhe në ditën e njëzetekatërt të muajit të parë në vitin e tretë, unë isha pranë lumit të madh, ky është Tigri. Dhe ngrita sytë e mi dhe pashë, dhe ja një burrë i veshur me vadhinë dhe brezi i tij *ishte* i ngjeshur me ar Ofazi, dhe trupi i tij si Tharsis, dhe fytyra e tij si pamje vetëtime, dhe sytë e tij si llambadhe zjarri, dhe krahët e tij edhe këmbët si pamje bronxi që vezullonte, dhe zëri i fjalëve të tij si zë turme. Dhe e pashë vetëm unë Danieli vegimin dhe njerëzit *që ishin* me mua nuk panë, veçse një shtangie e madhe ra mbi ta dhe ikën me frikë. Dhe unë mbeta vetëm dhe pashë këtë vegim të madh, dhe nuk mbeti brenda meje fuqi, dhe lavdia ime u kthye në prishje, dhe nuk mbizotërova mbi forcën. Dhe dëgjova zërin e fjalëve të tij, dhe kur dëgjova zërin e fjalëve të tij isha dërrmuar mbi fytyrën time përtokë. Dhe ja, një dorë që më prekte dhe më ngriti mbi gjunjët e mi dhe trinat e duarve të mia. Dhe tha tek unë: O Daniel, burrë dëshirash, kupto fjalët e mia të cilat unë flas tek ti dhe qëndro mbi qëndrimin tënd, sepse tani u dërgova tek ti. Dhe kur foli ai tek unë këtë fjalë, u ngrita i tmerruar. Dhe tha tek unë: Mos u frikëso, o Daniel, se që nga dita e parë në të cilën e dhe zemrën tënde të kuptosh dhe të mundohesh përpara Zotit, Perëndisë tënd, u dëgjuan fjalët e tua dhe unë erdha në fjalët e tua. Dhe arkondi i mbretërisë së persianëve qëndronte përballë meje njëzet e një

ditë; dhe ja Mihaili, një nga arkondët e parë erdhi për të më ndihmuar dhe e lashë atje me arkondin e mbretërisë së persianëve. Dhe erdha të të urtësoj për sa do t'i ngjasin popullit tënd në ditët e fundme, sepse vegimi në ditët *është* edhe më tepër. Dhe kur foli ai me mua sipas këtyre fjalëve, dhashë fytyrën time mbi dhé dhe u dërrmova. Dhe ja, një si ngjashmëri biri njeriu preku buzët e mia, dhe hapa gojën time dhe fola, dhe thashë tek ai që qëndronte përballë meje: O Zot, në vegimin tënd m'u rrotulluan të brendshmet e mia brenda meje dhe nuk kisha fuqi. Dhe si do të mundet shërbëtori yt, o Zot, të flasë me këtë Zotin tim? Dhe që tani nuk do të qëndrojë brenda meje fuqi, dhe frymë nuk mbeti brenda meje. Dhe shtoi, dhe më preku një si pamje njeriu dhe më forcoi dhe më tha: Mos u frikëso, o burrë dëshirash, paqe në ty; burrërohu dhe fuqizohu. Dhe kur foli ai me mua, u forcova dhe thashë: Le të flasë Zoti im, sepse më forcove. Dhe tha: Nëse ti e di se erdha tek ti? Dhe tani do të kthehem për të luftuar me arkondin e persianëve; dhe unë ikja, dhe arkondi i helenëve vinte. Por që të të lajmëroj atë që është radhitur në shkrim të së vërtetës dhe s'ka një që të më ndihmojë për këto, veçse Mihaili, arkondi juaj.

Në Liti
Vargëzime Idhiomele

Ting. I I Qiprianit

Kryegjeneralë të Fuqive mendore, që qëndroni pa pushim pranë fronit zotëror,[1] ndërmjetoni tek Zoti që t'i dhurojë botës paqe dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.

I njëjti I Arsenit

Taksiarku i Fuqive të sipërme, Mihaili, eprori i brigadave të hyjnueshme,[2] sot na mblodhi për panair ky, që përditë ec bashkë me ne dhe i ruan të gjithë nga çdo vështirësi e djallit. Ejani pra, o kremtimdashës dhe krishtdashës, pasi i korrëm lulet e virtyteve me mendje të pastër dhe ndërgjegje të harmonizuar, le të nderojmë Mbledhjen e kryeengjëllit; sepse ai duke qëndruar pa ndërprerje pranë Perëndisë[1] dhe duke kënduar himnin trishenjtor,[3] ndërmjeton që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Ting. II I Studitit

Duke kryesuar substancën jolëndore të Fuqive mendore dhe duke ndriçuar botën me vezullimet e lavdisë tridiellore, o kryegjeneralë, me zë pa mbarim këndoni himnin trishenjtor;[3] prandaj ndërmjetoni që të shpëtohen shpirtrat tanë.

I njëjti I Arsenit

Duke rrethuar fronin jolëndor, o substancë mendore, o të Patrup të hyjnueshëm,[7] i këndoni Perëndisë kryetar me buzët e përflakta oden trishenjtore:[3] Shenjt Perëndi, Atë i panisshëm; Shenjt i Fuqishëm, Bir i bashkëpanisshëm; Shenjt i Pavdekshëm, Shpirt i bashkësubstancshëm, që bashkëlavdërohet tok me Atin dhe me Birin.

I njëjti I Anatoliut

Me buzë të patrupa dhe gojë mendore, rreshtat e engjëjve himnin që nuk pushon e ofrojnë tek Hyjnia jote e paafrueshme, o Zot; dhe mendjet e pastra dhe shërbyesit e lavdisë sate të lavdërojnë, o Zot; dhe së bashku me ta Mihaili i patrup dhe eprori i Fuqive të sipërme, kryegjenerali i engjëjve,[2] na ka shtruar sot drekë, duke na nxitur që t'i këndojmë lavdisë sate të paafrueshme, o njeridashës, këngët e të Patrupëve, që të ndërmjetojë pa pushim për shpirtrat tanë.

Ting. IV I Efremit të Karies

Pasi shkëlqeni fort nga rrezet diellore të dritës hyjnore, o kryegjeneralë, ndriçoni fort brigadat e të palëndëve; të veshur me të bardhë si dritë në të lartat, shndritni me reflektim zjarrin e Hyjnisë së paafrueshme; prandaj edhe himnin trishenjtor me buzë të përflakta e këndoni pa pushim: Shenjt, Shenjt, Shenjt je,[3] o Perëndia ynë, lavdi më ty.

Ting. Tërth. II

Engjëjt e tu, o Krisht, duke qëndruar me frikë pranë fronit të madhështisë[1] dhe duke u ndriçuar gjithmonë nga derdhja e dritës sate, himnuesit e tu në të lartat[8] dhe shërbyesit e vullnetit tënd, të dërguar prej teje,[4] shpërndajnë ndriçim tek shpirtrat tanë.

Lavdi *Ting. IV*

Me buzë të përzjarrta të himnojnë Keruvimet, o Krisht Perëndi, ndërsa me gojë të patrup të lavdëron pa pushim ty kori i kryeengjëjve;[8] dhe Mihaili, kryegjenerali i Fuqive të sipërme,[2] himnin triumfal i ofron pa pushim lavdisë sate; sepse ai sot na shkëlqeu për panair gazmor, që psalmikisht e denjësisht të duartrokasim[9] himnin trishenjtor[3] me buzët e balta, sepse të gjitha u mbushën nga himnimi yt[10] dhe i jep botës nëpërmjet atij përdëllimin e madh.

Tani *I njëjti Hyjlindësore*

Sot tempulli hyjnxënës,[10a] Hyjlindësja, tek Tempulli i Zotit sillet dhe Za-

haria e mirëpret atë. Sot të Shenjtat e të Shenjtave[11] ngazëllohen dhe kori i engjëjve bën panair mistikërisht. Tok me këta, duke kremtuar edhe ne sot, le të thërrasim bashkë me Gabrielin: Gëzohu, o hirplote, Zoti është me ty,[11a] ai që ka përdëllimin e madh.

Pasvargje
Ting. I Ton uranion tagmaton

Një panair ne në botë si engjëj bëjm' me gaz* atij që ësht' mbi fronin* e lavdis',[12] Perëndisë,* le t'i th'rrasim himn: I shenjtë je ti,* Atë që je në qiejtë,* e shenjt' dhe Fjal' e përjetëshme tok me ty* edhe Shpirti i tër'shenjtë bashk'.[3]

Varg: Ai që i bën engjëjt e tij frymëra.

I pari në qielloret dhe me guxim të madh,* dhe që qëndron pran' fronit* të lavdisë pa mas',[1] sheh,* o dëshmues okular Mihail* gjeneral,[2] sa nuk shprehen dot;* me ndërmjetimet e tua shpëtona, se* jemi në rrezik, tundim, ngacmim.

Varg: Beko, o shpirti im, Zotin.

Pa diskutim je i pari i të patrupëve* edhe epror, shërbyes,* dëshmitar okular ti,* njohës i ndriçimit t' shenjt'; na shpëto,* Mihail kryeengjëll,[2] ne* që të nderojmë çdo vit shpres'tarisht me mall,* dhe Trinin' himnojmë besërisht.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. IV*
I Joan Monakut

Si taksiark, prijës dhe kryetar i engjëjve, o gjeneral,[2] çliroji nga çdo nevojë dhe pikëllim, nga sëmundje[12a] dhe mëkate të frikshme, ata që të himnojnë sinqerisht dhe të kërkojnë, o i lavdishëm; sepse si i palëndët shikon të palëndëtin[1] qartësisht dhe shkëlqen nga drita e paafrueshme[13] e lavdisë së Zotit; se ai nga njeridashja mori prej virgjëreshe mish për ne, duke dashur të shpëtojë njerëzinë.

Përlëshore Ting. IV
O ipsothís en to stavró

O gjeneralë të ushtrive q'ellore,* ne të padenjët krejt* po ju lusim shumë:* Ngrini një mur rrethues përmes lutjes suaj;* mbroni nën strehën e krahëve* të lavdis' suaj të palënd't,* ruani; ju falemi* dhe thërrasim me besë:* Nga çdo rrezik çlironani ne pra,* si taksiark' të Fuqive të sipërme.

Lavdi *dhe* Tani

Misteri i fshehur prej jete dhe i panjohur ndër engjëjtë, u shfaq ndër të dheshmit me anën tënde o Hyjlindëse, Perëndia që u mishërua me bashkim

të papërzier dhe denjoi kryq për ne duke dashur, me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtrat tanë.*



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. IV

O ipsothís en to stavró

O gjeneral i shërbëtorëve pa trup,*[2] ti që qëndron përballë Zotit[1] në qiej* dhe që shkëlqen nga shkëlqimi që del prej atij,* ngazëllo dhe shenjtëro ata* që me bes' të himnojnë ty,* si edhe çliroji nga* tirani e armikut;* kërko një jet' me paqe për të gjith',* për mbretin edhe për anët e botës son'.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Nuk do pushojmë asnjëher', o Hyjlind'se,* ne të himnojm' me shpirt, shërbyesit e tu,* dhe me gëzim mëshirat që na jep, Zonja jon',* duke thirrur edhe duke thën':* Virgjëresh' e Tër'shenjtë, ti* shpejt arri dhe na çliro* nga armiq që nuk duken* edhe që duken, nga çdo kërcënim,* se na shpëton gjithnjë nga çdo e keqe krejt.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV
O ipsothís en to stavró

Ja Serafimet[14] me shum' sy,[15] Kerubimet,*[16] ushtrit' e Kryeengjëjve, shërbëtorët,* si dhe Pushtetet, Fronet, Zotërimet, Engjëjt,* Forcat, Autoritetet[17] bashk',* luten tek ti, pra Bërësi,* Perëndia, Zoti yn';* mos shpërfill përgjërim ti* nga popull që ka mëkatuar rënd',* o Krisht i shumëmëshirshëm, me plot mir'si.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*
Tahí prokatálave

Arri ti shpejt, para se të skllavërohemi ne* nën zgjedhë armiqsh, që ty të blasfemojn' dhe na kërcënojnë, o Zoti yn',* dhe asgjëso me Kryqin* të gjith' sa na luftojnë;* ta dijn' se i mund besa orthodhokse e fortë,* o Krisht, përmes ndërmjetimeve të Hyjlindëses.

Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. Tërth. IV
To prostahthén

O kryetarë dhe prijës të çdo force* pra qiellore,* të mbifronshme dhe të frikshme* të lavdisë hyjnore,* Mihail, Gabriel,* me gjith' shërbëtorët pa

trup të Zotit ton',*[4] për botën ton' ndërmjetoni,* lutuni shum'* që të marrim ne ndjes' fajesh që bëjm', të gjejm' përdëllim[18] dhe hir në dit' gjykimi, ju* gjeneralë shum' të mëdhenj.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

O e bekuar, e d'lir', o hyjhirplote,* atij që lindi* nga ti për mir'si të brendshme,* bashk' me forcat në qiell* dhe me kryeengjëjt,* dhe gjith' të patrupët, lutju ti pa pushim* për ne, që të na dhurohet* falje, mëshir',* ndjes' e çdo faji, edhe ndreqje jete para se të na vijë fundi, që të gjejm'* përdëllim[18] të sigurt, shpëtim.

Shkallesat.
Antifoni i parë i tingullit IV
Proqimeni
Ting. IV

Ai që i bën engjëjt e tij frymëra dhe shërbyesit e tij flakë zjarri.

Varg: Beko, o shpirti im, Zotin.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e të patrupëve.
Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.
Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II I Arsenit

Duke rrethuar fronin jolëndor, o substancë mendore, o të Patrup të hyjnueshëm,[7] i këndoni Perëndisë kryetar me buzët e përflakta oden trishenjtore:[3] Shenjt Perëndi, Atë i panisshëm; Shenjt i Fuqishëm, Bir i bashkëpanisshëm; Shenjt i Pavdekshëm, Shpirt i bashkësubstancshëm, që bashkëlavdërohet tok me Atin dhe me Birin.

Kanunet: i Hyjlindëses me irmoset në 6 dhe të dy të të patrupëve në 8.

Ode I
E Hyjlindëses
Ting. Tërth. IV
Irmosi: Igrán dhiodhefsas

»**P**asi kish kaluar det si steré* edhe »u shpëtua nga inati egjiptian,* me »zë Izraeli po thërriste:* Le t'i kën»dojm' Perëndis', Çlirimtarit ton'.

I mbytur prej ngasjeve si në det,* më ty po përikij dhe prej teje kërkoj shpëtim,* o nënë dhe Zonjë Virgjëreshë,* prej çdo rreziku dhe zie shpëtomë ti.*

Pësimet më mbushën me turbullim* dhe shpirtin ma mbytën me mërzitje dhe dëshpërim,* po ti qetësomë, Virgjëreshë,* me ngushëllimin dhe paqen e Birit tënd.*

Të lutem o Zonjë, o Shën Mari,* që linde Jisuin, ti shpëtomë nga çdo rrezik,* më ty po përikij dhe të lutem,* me tërë forcën e zemrës dhe shpirtit tim.*

Se shpirti dhe trupi keq m'u sëmur,* pra ti mëshiromë, edhe syrin mbi mua hidh,* kujdesu për mua Virgjëreshë,* e mirë vetë dhe nën' e të mirit Bir.*

Kanuni i parë i të patrupëve
Poezi e Joan Monakut
Ting. Tërth. IV

Asma anapémpsomen laí

Le ta përhimnojm' Trinin' e pandërtuar ne besnikët tër',* e cila i drejton brigadat jolëndore* të koreve që jan' lart;* o Zot i tër'pushtetshëm,* th'rrasim: I Shenjt', i Shenjtë, i Shenjt' je.[3]

Vure si fillimin e krijesave të tua, Zoti yn',* esencën e patrup pra, që qëndron rreth fronit* tënd, Bërës i engjëjve,* ty, o Zot i pushtetshëm,* të thërret: I Shenjt', i Shenjt', i Shenjtë.[3]

G'zohu, o udh'zues i misterit të mish'rimit zotëror,*[6] ti Gabriel, dhe Mihail që je në krye* brigadash pa lënd';[2] gjithnjë* te Zot' i gjith'pushtetshëm,* th'rrisni: I Shenjt', i Shenjtë, i Shenjt' je.[3]

Hyjlindësore

Eva pra stërnëna vuri krejt qëmoti nën mallkim të rënd'* gjinin' e njerëzve me shkeljen që ka bërë,*[19] por prapë e ktheve ti* hyjnuse Virgjëreshë* në bekim kur na e linde Zotin.

Kanuni i dytë, që ka Akrostihidhë: "Te Taksiarkët e Mendjeve të patrup", ndërsa në Hyjlindësoret: "I Klementit".

Tingull i njëjtë
Armatilatin Faraó

Le të formojm' të gjith' një kor dhe ejani të lavdërojm' me psalmim* koret engjëllore* të patrup edhe mendore, si shërbyes shum' të shenjt';*[4] pa ndërprerje ata ndërmjetojn' për ne, për shpëtimin ton'* dhe gëzohen bashk' me pendimin ton'.[20]

Eprorët, taksiarkët e pëlqyeshëm të të gjith' engjëjve,* mendjet e patrup pra* sot i mbledhin për veprim'tari festive dhe me gaz*[21] për kujtimin e tyre që shndrit. Me k'ta bashk'gëzohen thell'* njer'zit dhe ofrojn' te Trinia himn.

Le të gëzohemi, o njerëz, bashk' me engjëjt me hare shpirtërisht;* Gabrieli prapë* na ungjillëzon[6] tani bashkimin e gjith' Kishave* dhe gremisjen e çdo herezie që kundërshton besën,* se festojm' kujtimin e tyre sot.

Hyjlindësore

E mban në bark atë që ësht' përmbi

natyrë, o e tër'çiltër, Vajz',* Fjalën pra të Atit,* që në Shpirtin Shenjt' fushoi brenda teje; ka ai* dy natyra, vullnete dy, por në një hipostazë ësht'* pa trazim; dhe puthim pamjen e tij.

Zbritësore: Anikso to stoma mu

»Ja gojën e çel tani, i frymëzuar prej »Shpirtit[21a] Shenjt'* dhe këngë do t'i »këndoj nënës së madhe mbi fron;*[21b] »dhe do ta kremtoj* me valle buzëqe- »shur,* me zë do t'i shpall kudo »Hyrjen tek Tempulli.*

Ode III
E Hyjlindëses
Irmosi: Uranias apsidhos

»Perëndi që ke bërë apsid' në q'ell »si çati,*[22] ti që je ndërtues i Kishës,[22a] »më siguro mua* në dashurin' tënde »fort; je maja e çdo dëshire,* njerida- »shës, edhe mbështetja për çdo »besnik.

Si përkrahje dhe mbrojtje të jetës sime të kam,* ty o Virgjëresh' e kulluar, ti pra më qeveris* dhe në liman të më çosh, se ti na fal çdo të mirë,* ti besnikët përgjithmon' i mbron, Hyjlindëse.*

Po të lutem, o Zonjë, ma qetëso shpirtin tim* dhe pushoma shqotën e zemrës, se më bie zali,* se ti o Zonjë Mari, ke lindur Mbretin e Paqes,*[22b] Shpëtimtarin, Zotin Krisht, ti o Hyjlindëse.*

Mirëbërësin[22c] linde, që bëri çdo mirësi,* pasurisht të gjitha të mirat jepna të gjithëve,* se ti në dorë e ke,[22d] se ti ke lindur të fortin,* Shpëtimtarin, Zotin Krisht, ti o Hyjlindëse.*

Me sëmundje të liga dhe çfarëdo pasion,* dergjem un' i mjeri, o Zonjë, eja shëromë ti,* se s'të mungon asnjë gjë, i ke të gjitha të mirat,* je thesar për çdo shërim, ti o Hyjlindëse.*

Kanuni i parë i të patrupëve:
Ton fovon su Kírie

Ata që gjithmonë qëndrojnë pranë teje në të lartat,[1] i bëre me fuqi, o i Pavdekshëm, të fortë, sepse kryejnë vullnetin tënd të tërëshenjtë.

Pranoji ata që luten për ne, o Krisht, të parët e engjëjve, njohësit e misterit të njerëzimit tënd[23] dhe të ngritjes sate të respektuar.[24]

Vure engjëj si roje për njerëzit,[25] si i dhembshur, dhe i tregove shërbyes të shpëtimit të shërbëtorëve të tu, o Krisht.

Hyjlindësore

E zure në mënyrë të pathënë Zotin shpëtimtar, o Hyjnuse, që na çliron nga mjerime ne që të thërrasim me të vërtetë.

Kanuni i dytë i të patrupëve:
Si i to steréoma

U duke, o Mihail,* krejt si i pari i engjëjve*[2] dhe drit' e dyt'* e Trinis' së Shenjtë* tek ne që të lëvdojm' me bes'.

Me drit' Hiri qiellor,* besnikërisht Gabrieli shenjt* dheun e tër'* mbushi, duke shpallur* zbritjen e Perëndis' në mish.[6]

O çift jolëndor, me fam'* dhe me shkëlqim, që për ju psalet,* sa bëjn' me bes'* sot kujtimin tuaj,* shfaqni dritat e Perëndis'.[26]

Hyjlindësore

Profet Isaia psal* për shtatzënin' tënde mbi mendim;*[27] këndoj dhe un'* që pastrimin e tij*[28] ta arrij si ky, o e d'lir'.

Zbritësore: Tus sus imnologus

»**O** Zonjë dhe nën' e Perëndisë, burim »i pasosur jetësor,* ti siguroji gjith' »ata që të këndojnë plot me zell;* <u>në</u> »<u>Hyrjen tënde që nderojm'</u> kurorëzoi »me çdo lavdi.*

Ndenjësore Ting. Tërth. IV
To prostahthén

Ne të mbidheshmit, që duam të lëvdojmë* koret e patrup,* le ta imitojm' sa mundet* shenjtërinë e tyre*[29] duke vrar' gjymtyrët* të gjithë[30] të mishit,[31] duke kërkuar fort* nga k'ta që jan' përluftarë* dhe rojet tan'* të çlirojn' nga dredhitë e armikut që është i padukshëm ne që i himnojm',* që të gjejm' përdëllim[18] të madh.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

O e kulluar, ty të falënderojmë,* të madhërojmë* dhe të falemi gjithmonë,* dhe himnojm' lindjen tënde,* o hirplote; th'rrasim* të gjith' pa pushim: Shpëtona, o Virgjëresh'* e tërëmëshirshme, Vajzë,* se je e mir',* dhe rrëmbena shpejt nga hetim i tmerrshëm djajsh, dhe në or' shqyrtimi të mos kemi turp,* ne shërbyesit e tu, Zonj'.

Ode IV
E Hyjlindëses
Irmosi: Isakíkoa Kírie tis ikonomias su

»**K**am dëgjuar misterin qart'* të »ekonomis' sate dhe kuptova krejt* »vepra që ke bërë[18] dhe prandaj* »lavdërova un' hyjninë tënde, Zot.

Shën Mari o Hyjlindëse,* ti që linde Zotin, kapedanin ton',* zbute shqotën e pësimeve,* qetësoi valët e mëkateve.*

Ne të gjithë të lutemi,* dhembshu-

rinë tënde tregona pa vones',* ti që linde njeridashësin,* Krishtin Shpëtimtarin e besnikëve.*

Për shumicën e dhuratave,* të falënderojmë ne mirënjohësit,* me këndime lavdëruese,* nënë virgjëreshë dhe Hyjlindëse.*

Ty të kemi përkrahëse* dhe fortesë të patundur dhe mbrojtëse,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* na shpëto përherë prej rreziqeve.*

Kanuni i parë i të patrupëve:
Epevis ef ipus

Hipe mbi engjëj si mbi kuaj, o njeridashës, dhe prite në duart e tua frerët e tyre; dhe shpëtim është bërë kalorësia jote[32] për ata që thërrasin pa pushim: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Virtyti yt mbulon engjëj, o njeridashës, dhe anët e tokës u mbushën, o i pafillim, me himnimin tënd[10] të lavdëruar dhe të hyjnueshëm; ajo të thërret së bashku me ata: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Dole, o Krisht i dhembshur, për shpëtimin e popullit tënd,[33] dhe i bashkëfton Fuqitë e tua mike; dhe hare është[34] bërë prania jote tek ata që të thërrasin ty besërisht: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Hyjlindësore

U pe virgjëreshë dhe nënë përmbinatyrshëm, o e Tërëdëlirë, sepse linde Perëndi, dhe të njëjtin edhe njeri, Krishtin, tek i cili thërrasin me frikë rreshtat e engjëjve: Lavdi fuqisë sate, o Krisht.

Kanuni i dytë i të patrupëve:
Si mu iskís Kírie

Tek Jisui i Naviut[35] që luftonte, u pa në Jeriko qëmoti një kryegjeneral Fuqie duke korrur fitore si përluftar, Mihaili i madh, i pari i të patrupëve. Pasi mori shërbyesi i Zotit forcën prej atij, pushtoi me armë kështjellën.[36]

Një arkond Fuqish të patrup u pa dikur tek Zaharia prift duke sjellë ungjillëzime për fëmijë, pra Gabrieli[37] i madh, kryeengjëlli vërtet i hyjnueshëm. Prandaj kur u lind zëri i Fjalës, Joani,[38] i rijep atit zërin.[39]

Gëzohen me hare sot gjithë anët duke kremtuar kujtimin e mbarë kryeengjëjve të tu, o Perëndi, pra të Mihailit të hyjshëm dhe Gabrielit hyjmendës; dhe bashkëgëzohet i gjithë rendi i engjëjve, sepse shpëtohet bota me mbulesën e tyre.

Hyjlindësore

Ke qenë e dëlirë e vetme edhe pas lindjes; u pe e vetme pa burrë që mëndje Fjalën e vërtetë të Atit, që në

Shpirtin e Shenjtë mori formë robi si ne,[40] o Hyjlindëse e virgjër; duke nderuar pamjen e tij, respektojmë ngjasimin e faqes.

Zbritësore: Tin aneksihníaston

»Të pagjurmësuarin plan perëndor,* »që po mishërohet i larti Zot* prej Vir»gjëreshës,* Abakumi si profet e pa »dhe tha me zë të madh:* O Zot i »fuqishëm, lavdi më ty.*

Ode V
E Hyjlindëses
Irmosi: Fótison imás

»Ndritna ti, o Zot,* përmes urdhrave »të tua[41] ne,* si dhe me krahun tënd »të fort' dhe të lart',*[42] o njeridashës, »na jep paqen tënde[22b] të sigurt.

Zemrën na e çel* me gëzim dhe ngazëllim, o Zonj',* falna gazin e pasosur tani,* sepse ke lindur ti shkaktarin e gëzimeve.*

Zonjë na shpëto,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* prej helmeve si dhe rreziqeve,* se ti ke lindur[43] Shpëtimtarin, paqeprurësin.[44]*

Mjegullën largo* të mëkateve Hyjlindëse* me dritën tënde jetëdhënëse,* sepse ke lindur diellin e parajetëshëm.*

Zonjë na shëro,* nga pësimet e sëmundjeve,* na mëshiro edhe na vizito,* edhe shëndetin na dhuro me ndërmjetimin tënd.*

Kanuni i parë i të patrupëve:
Ton ek niktós agnosias

Me mallëngjim të pakthyeshëm, Fuqitë e engjëjve të prirura përherë përpjetë drejt teje, o Krisht, që je më i dëshiruar nga të gjitha të dëshiruarat, të lavdërojnë pa pushim.[8]

Ti vure, o Krisht, himnues të madhështisë sate engjëjt e tu,[8] mendorë në substancë, të paprishshëm me anën e Hirit tënd, pasi i krijove sipas ikonës,[45] o i pakuptueshëm.

Iruajte shërbyesit e tu nëpërmjet afrimit pranë teje,[1] o Krisht, jo të prirur drejt së keqes, sepse duke qenë ti burim mirësie, i bën të mirë ata që të adhurojnë denjësisht.

Hyjlindësore

O Mari e papikëluar, e dëlirë, pa përvojë dasme, e vetmja e virgjër pas lindjes, ankorona në limanin tënd duke na nxjerrë nga rreziqe dhe duke na drejtuar në shpëtimin e përjetshëm.

Kanuni i dytë i të patrupëve:
Ina ti me aposo

Engjëlli, që në një ngushticë u duk

përmes gomarit tek magjistari Valaam, i cili s'i bindej qëmoti një çudie të pashprehshme dhe hyjnore, e kritikoi frikshëm, dhe pasi e tregoi me logjikë kafshën, këmbeu tiparin e natyrës.[46]

Një engjëll i Perëndisë u pa te Petroja, i cili ishte kapur dhe priste në burg, duke e çliruar nga duart e Irodit, nga pranga dhe vdekje;[25] prandaj ejani të gjithë, le të nderojmë kryeengjëjt e urtë si roje të hyjshëm të shpirtrave.

Me ndërmjetimet tuaja të përhershme drejt Perëndisë zgjidhni kryengritjet e luftrave, herezitë e Kishës dhe të gjitha skandalet, o engjëj, kryeengjëj, Fuqi të hyjnueshme të Perëndisë, dhe na ruani në paqe.

Hyjlindësore

Të njohim ty në dy substanca, në dy energji dhe vullnete, një Perëndi të patrazuar të Krijesës, Birin e Perëndisë, që more mish prej gruaje, pamjen e së cilës e nderojmë në piktura.

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

»Të gjith' i habite ti me një çudi dhe »një lavdi,* ti, o Virgjëresh' e pamar»tuar;* që brenda Tempullit zotëror »hyre drejt* si një tempull shum' i »pastër pra,* dhe shpëtim që lartazi* »u dhurove besnikëve.*

Ode VI
E Hyjlindëses
Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»Do derdh lutjen* para Zotit Perë»ndi* dhe atij do t'i tregoj hidhërimet* »që kam,[47] sepse* shpirti im është »mbushur* me çdo të keqe dhe jeta »po shkon në Hadh;*[48] pra si Jonai »lutem un':* Jetën time nga prishja, »ti ngrije, Zot.

Atij iu lut,* se prej vdekjes na shpëtoi,* si u dha nën thonjt' e vdekjes dhe vetë,* prapë tani* shpirtin tim ta shpëtojë,* nga shkatërrimi i vdekjes dërrmonjëse* dhe nga armiku zemërlig,* Biri yt, Zoti yt, o Hyjlindëse.*

Si mbrojtëse* ty të di dhe rojtëse* të sigurt, o Virgjëreshë, për jetën,* ti i shpërndan,* gjithë ngasjet e liga* edhe veprime demonësh na i dëbon,* pra ty të lutem si gjithnjë:* Ti shpëtomë prej gjithë pësimeve.*

Fortes' e mur,* ty të kemi Zonja jon',* dhe shpëtim për shpirtrat tanë të plotë,* dhe ngushëllim* në mjerimet,[49] o Zonjë,* dhe n' errësirën me dritë na ngazëllon;*[49a] pra ti, o Zonjë, dhe tani,* nga pësimet, rreziqet ti na shpëto.*

Në shtrat tani* i sëmurë shtrirë jam* dhe për trupin tim shërim dot nuk

gjendet,*[49b] vetëm pra ti* që ke lindur për botën,* një Shpëtimtar dhe një mjek të sëmundjeve,* pra ty të lutem dhe tani:* Ti më ngri nga lëngatat Hyjlindëse.*

Kanuni i parë i të patrupëve:
Ton Ionán en to qiti

Hyjnisht pa fjal',* o Zot, nga mosqenia ti[50] substancën e Fuqive gjith'* që s'vdesin dhe krejt qiellore krijove,[51] dhe i ke bër'* me form' drite dhe me lavdi.

Ju jeni bër'* të patrup dhe të nderuar, njohës mistikisht himni* tek Zoti,[8] qytetarë[52] tende të hyjshme në qiell,[53] dhe* adhuroni vërtet Bër'sin.

Të përhimnojn',* o Bir, para çdo fillimi, Fjal' e Perëndisë, Zot;* gjithmon' të lavdërojn'[8] si bër'sin, Krijuesin e Gjith'sis',* tër' Fuqit', rreshtat e patrup.

Hyjlindësore

O e dëlir',* të bashk'fronëshmin,[54] bashk'pafillim me Atin qiellor,* u denjësove që ta shtrish ti në prehër; bëje të but'* për shërbyesit e tu, Zonj'.

Kanuni i dytë i të patrupëve:
Ilásthití mi Sotír

Le të nderojm' me këndim,* me buzë lëndore dhe me frik' ata që jan' jolëndor',* me ngritjen e mendjes son' nga prishja lëndore krejt,* meqë të patrupët* jan' si zjarr, si flak'[5] edhe si drit'.

Stuhit' e veseve që* ne kemi, o kryeengjëj, vritini, pushoni me to* skandalet e gjitha të besimit, se jeni ju* kryegjeneralë*[29] të shenjt', faqezjarrtë[5] të Trinis'.

O kryeengjëj zot'ror',* të parët e të patrupëve, shpëtonani me fuqin'* që keni ju, nga çdo herezi, Mihail eprori*[2] edhe Gabriel bashk',* kryegjeneralë me guxim.

Hyjlindësore

U shfaqe vullnetarisht* prej barku që s'kish përvojë burri ti, që si Perëndi* je pa mish, u mishërove,[55] o Krisht, je bër' njeri* me trup. Ne besnikët,* pikturimin tënd po e nderojm'.

Zbritësore: Tin thian taftin

»Këtë të kremte e lusim sot, për »Zonjën edhe nënën Hyjlindëse, gjithë »hyjmendësit,* eni trokisni pra duar»të*[9] dhe lavdëroni Zotin që lindi prej »asaj.*

Kontaqi
Ting. II
Arhistrátiji Theú

Gjeneralë të Zotit,* shërbëtorë lavdie,* udhëzues për njer'zit,*[56] krye-

tar' engjëjsh pa trup,* përdëllimin e madh kërkojeni* dhe dobi shpirt'rore ju,* porsi gjeneral' të të patrupëve.

Shtëpia

The, o njeridashës, në Shkrimet e tua, se një shumicë engjëjsh gëzohen në qiell për një njeri që pendohet, o i pavdekshëm;[20] prandaj ne, duke qenë brenda paligjësish, o i pamëkatshëm, i vetëm zemërnjohës, guxojmë përditë të të përgjërohemi si i dhembshur, që të mëshirosh dhe t'u dërgosh poshtë të padenjëve kataniks, o Zot, duke na dhënë falje, se për të gjithë ne ndërmjetojnë pranë teje, porsi gjeneral' të të patrupëve.

Sinaksari

Më 8 të të njëjtit muaj, Mbledhja e kryegjeneralëve Mihail dhe Gabriel, dhe i brigadave të tjera të shenjta, të patrup dhe qiellore.
Vargje: Doja, o Mihail, që të të këndoja ty një këngë të përshtatshme,/ por nuk kam ndonjë të tillë të palëndët.
E teta lavdëron kryetarë rendi qiellor.

Në Mbledhjen e të nëntë brigadave, Serafime, Keruvime, Frone, Zotërime, Pushtete, Autoritete, Fuqi, Kryeengjëj dhe Engjëj:
Vargje: Cili fëmijë nëntë muajsh do të fliste/ diçka të denjë për nëntë brigadat?

Me ndërmjetimet e kryeengjëjve të tu, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
E Hyjlindëses
Irmosi: I ek tis Iudheas

»Tre Djem që nga Judea* përfunduan »si robër në Babilonë dikur,* me »besën e Triadhës kan' shkelur flakë »furre duke psalur me gaz e hir:* O »Perëndi atëror,* o Zot je i bekuar.

Për shpëtimin e botës,* në pëqi virgjëror ke banuar ti, o Jisu,* dhe nënën Virgjëreshë, e cila të ka lindur, na e bëre ne mbrojtëse.* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Birit plot me mëshirë,* që ke lindur, o nën' e kulluar, lutju për ne,* të na i ndjejë fajet dhe njollat shpirtërore, se thërresim me zë të madh:* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Thesarin e shpëtimit*[56a] dhe burimin e paprishjes ty Hyjlindësen pra,* kështjellën e përikjes dhe derën e pendimit ua shfaqe besnikëve.* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Sa po vijnë me shum' mall* edhe nën hijen tënde të gjith'sigurtë, o Zonj',* denjo që të shërohen si shpirtrat e sëmurë k'shtu dhe trupat në vuajtje,*

se Krishtin ton' shpëtimtar,* për ne ti e ke lindur.*

Kanuni i parë i të patrupëve:
Pedhes Evreon

Atij që i qëndrojnë pranë duke i shërbyer[1] pa pushim me mijëra engjëj,[57] duke mos i rezistuar shikimit të fytyrës,[7] i thërrasin: I bekuar je, o Zot Perëndi.

E tregove dritë, o i dhembshur, substancën jolëndore të engjëjve të tu, që mbushen me dritë[58] pa pushim dhe thërrasin: I bekuar je, o Perëndi në jetët.

Pasi krijove me Fjalën tënde enipostate[59] shumicën e engjëjve[21] dhe të shenjtërove me Shpirtin Hyjnor, e mësove që të theologojnë Triadhën, o Perëndi, në jetët.

Triadik

Duke konsideruar tri hipostaza, besojmë substancë të papërshkrueshme, Atin, Birin dhe Shpirtin, duke thirrur: I bekuar je, o Zot, Perëndi në jetët.

Kanuni i dytë i të patrupëve:
I ek tis Iudheas

Bashkë me koret e të patrupëve, ejani, o gjinia e njerëzve, të duartrokasim[9] duke kremtuar ditën e mbarë të kujtimit të kryeengjëjve të urtë[60] të Krishtit dhe duke thirrur: I bekuar je, o Perëndi i etërve.

Qëmoti Abrahami hyjshikues[61] dhe Loti i lavdëruar si mikpritës, mikpritën engjëj[62] dhe gjetën shoqëri duke thirrur tok me engjëjt: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.

Tek Manoe[63] trim dhe Tobiti i tërëurtë[64] u dukën engjëj duke i shpërblyer me çmime sipas vlerës së jetës; dhe engjëlli i Djemve dikur shoi vërtet flakën e zjarrit në furrë.[65]

Hyjlindësore

Shpallim, o Jisu, se e more tërë natyrën tonë nga e virgjër, pa ndërrim, dhe je i dyfishtë për sa u përket natyrave, por një në hipostazë, figurimin e së cilës, pasi e stampojmë, e nderojmë besërisht.

Zbritësore: Uq elátrefsan

»Nuk u faleshin krijesave hyjmendë»sit, por Kryetarit lart,* dhe kërcënimin »me zjarr* e shkelën me trimëri, psal»nin me brohori:* Zot, lavdi më ty, o »Perëndi i etërve,* ti je vetëm i bekuar.*

Ode VIII
E Hyjlindëses
Irmosi: Ton Vasilea ton uranón

»Mbretin në qiejt,* që gjith' ushtrit'

»engjëllore* e himnojnë edhe ju him-
»noni,* dhe e lartësoni gjithmon' në
»gjithë jetët.

Mos i harro kurr',* o Virgjëresh', sa
të luten,* të himnojnë me bes' e me
shpresë,* dhe të lartësojnë me zë për
gjithë jetët.*

Ti i shëron krejt,* përher' e pa u kur-
syer,* gjith' ata që të luten, o Zonjë,*
dhe të lartësojnë që linde Zotin tonë.*

Ti më shëron krejt* nga gjith' së-
mundjet e shpirtit* dhe nga dhembjet
e trupit, o Zonjë;* të të lartësoj pra, o
Virgjëresh' hirplote.*

Ti i largon krejt* sulmet dhe ngasjet
e liga,* dhe pësimet, o Zonjë e vir-
gjër,* pra të lartësojmë me zë për
gjithë jetët.*

Kanuni i parë i të patrupëve:
Ton en ori ajio

Le të kemi zili jetën e engjëjve dhe
le të fluturojnë mendjet tona[66] në
lartësi, dhe së bashku me ta le t'i kën-
dojmë Zotit në mënyrë jolëndore,
duke e himnuar dhe e përmbilartësuar
në gjithë jetët.

Anëtarë kori qiellor, engjëj që rre-
thojnë fronin e lavdisë,[14] duke lëvizur
gjithmonë rreth Perëndisë, e himnoj-
në dhe e përmbilartësojnë[8] në jetët.

I falemi Trinisë, e cila i bën flakë zjarri
jolëndor ata që lart pa pushim shër-
bejnë dhe engjëjt i tregon frymëra.[5]
Atë e lavdërojmë në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Atë, pranë të cilit qëndrojnë[1] me
tmerr mijëra dhe mijëra engjëj,[57] krye-
engjëj, u denjësove ta mbash në pre-
hër; tek ai ndërmjeto, o Perëndilin-
dëse, që të shpëtojnë ata që e lav-
dërojnë në jetët.

Kanuni i dytë i të patrupëve:
Eptaplasios káminon

Arkond engjëjsh është Mihail
kryeengjëlli,[2] dhe bashkë me të lavdë-
rohet tepër shkëlqyeshëm njohësi i
misterit të Hirit dhe lajmësi i res-
pektuar i Virgjëreshës, denjësisht
gjeneral i të patrupëve, Gabrieli, duke
paralajmëruar gaz[6] për ata që thë-
rrasin: O popull, përmbilartësoni
Krishtin në jetët.

Jezekieli, pasi pa brigadat e engjëjve
me pamje të shumëllojshme,[67] duke
shkruar më përpara, i shpallte. Në
mes tyre qëndronin Serafimet me
gjashtë krahë[14] dhe Keruvimet me
shumë sy[15] rrethonin. Bashkë me ta
shikonte kryeengjëjt të ishin qelibar,[68]
që lavdëronin Krishtin në gjithë jetët.

Duke zbuluar Danieli ardhjen e dytë të frikshme me zbritjen tënde, parathoshte se frone u vendosën dhe një i vjetër u ul; dhe paraqet mijëra engjëj të qëndrojnë[69] me frikë dhe t'i thërrasin me zëra pa heshtur Trinisë në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Fjala e bashkësubstancshme me Atin dhe me Shpirtin u pa edhe nga Virgjëresha vullnetarisht i një forme me ne, duke mos ngatërruar elementet e bashkimit të frikshëm njëri me tjetrin; sepse një dhe i njëjti tregohet në të dyja, në dy substanca dhe në një hipostazë; konizmës së formës së saj, tani i falemi.

Zbritësore: Pedhas evajís

»**D**jemat* e dënuar për t'u djegur, »prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit »Krisht, si simbol në lashtësi;*[69a] dhe »si një veprim tani,* dhe tërë botën »po e mbledh për këng' e lavdërim:* »Himnojeni ju veprat e Zotit* dhe e »lartësoni përmbi të gjitha jetët.[69b]*

Ode IX
E Hyjlindëses
Irmosi: Kirios Theotokon

»**P**ohojm' se je Hyjlind'sja,* ne që u »shpëtuam* nëpërmjet teje, e shenjt', »Virgjëreshë e d'lir';* me koret e të »patrupve të madhështojmë ty.

Shiko si qaj me lotë,* edhe mëshiromë,* se ti ke fshirë çdo lot prej fytyrave,*[70] o Virgjëreshë dhe Zonjë që linde Zotin Krisht.*

Gëzoje zemrën time,* Zonjë Virgjëreshë,* se ti ke lindur gëzimin për njerëzit,* dhe zhduke çdo helm me ndjesën e gjith' mëkateve.*

Liman dhe mbrojtje bëhu,* Zonjë Virgjëreshë,* kështjell' e mur i patundur, Hyjlindëse,* përikje, ndihmë dhe mbrojtje e gjithë njerëzve.*

Me rrezet dhe me dritën* ndritna Virgjëreshë,* edhe largo errësirën e mendjeve*[70a] t' atyre që të lëçitin Zonjë Hyjlindëse.*

Shëromë Virgjëreshë,* se jam i përmbysur,* edhe po dergjem[70b] në shtratin e vuajtjes,* po eja ngremë dhe falmë shëndet edhe shpëtim.*

Kanuni i parë i të patrupëve:
Orus parilthes tis físeos

Të madhështojmë pa pushim ty, o Krisht, që i bashkove në mënyrë të pashprehshme të përmbidheshmet me qielloret, dhe që bëre një Kishë engjëjsh dhe njerëzish.

O Engjëj dhe Kryeengjëj, Frone,

Pushtete dhe Zotërime, Autoritete dhe Fuqi, Keruvime dhe Serafime,[17] lypni bashkë me Perëndilindësen për botën.

Meqë dëfteheni, o Mihail bashkë me Gabrielin, mbrojtës të të gjithëve, vizitoni ata që me dëshirë të flaktë nderojnë kujtimin tuaj tërëkremtues dhe që himnojnë besnikërisht që të shpëtohen nga gjithfarë peripecish.

Hyjlindësore

O Virgjëreshë, prite Fjalën e panisshme, që deshte ta rigatuante natyrën time, dhe e linde atë kur u mishërua; prandaj, o Hyjlindëse, të madhërojmë pa pushim.

Kanuni i dytë i të patrupëve:
Kirios Theotokon

U dukët luftëtarë* dhe shpëtoni sa jan'* në luft', nevojë, furtunë, sëmundje të mjer',* o Mihail, Gabriel, të parët e engjëjve.

O Gabriel, meqë je* njohës Perëndie* dhe gjeneral engjëjsh, kërcen me kore Fuqish* dhe Fronesh; tek Shpëtimtari na ndërmjeto gjithmon'.

Si rojat e gjith' botës* dhe të tërë Kishës,* o taksiarkë të forcave që janë lart,* ju për shpëtimin ton' lutjuni Shpëtimtarit Krisht.

Hyjlindësore

Me simfoni të gjith' ne* të lëvdojm', Hyjlind'se,* se na çliron prej pasionesh, rreziqesh; madje* na plotëson me të mira lutjet, kërkesat ti.

Zbritësore: Apas jijenís

»Gjithë njerëzit, kërceni me ngazë»llim tek drit' e Shpirtit Shenjt',* eni »lavdërojeni;* engjëjt e q'ellit eni krem»tojeni* sot Hyrjen e hyjnueshme të »kryezonjës Mari* dhe thërrisni:* Ti »je më e lumura,* Virgjëresh' e kulluar »Hyjlindëse.*

Dërgimësore
En Pnévmati to ieró

Si përluftar dhe kryetar* i gjinis' njerëzore,* me shum' triumfe të mëdha* Perëndia dhe Bër'si* të shfaqi ty dhe pashprehshëm* të nderoi me lavdi* që t'i këndosh i paepur* Himnin trishenjtor,[3] të shenjt',* triumfal, ti o epror* dhe gjeneral qiellor lart.[2]

Tjetër Jinekes akutísthite

Pashprehëshëm ndriçohesh ti,* si prej pishtari plot shkëlqim,* nga lavd hyjnor i Triadhës* së tërëndritshme; kalon k'shtu* tërë Krijesën si shkreptim'*[71] dhe zbaton, kryeengjëll,* urdh'rin hyjnor, o Mihail,* me faqe si vetëtim', dhe* sa të himnojn' ruan, strehon.

Tjetër Tis mathités sinélthomen

Të emëroi Zoti yt* të parin, prijës Fronesh,* Engjëjsh dhe Kryeengjëjsh bashk',* Zotërimesh, Pushtetesh,* Fuqish, Autoritetesh,*[17] o kryegjeneral ty* i shum'lavdishëm Mihail;*[2] prandaj duke qëndruar pran' fronit lart,*[1] që s'e nxë Gjith'sia, na ruaj, mbrona,* shpëtoi gjith' sa të lëvdojn',* mbrojtës i tërë botës.

Hyjlindësore

Pa krahasim e çmuar je,* më shum' se Keruvimet* e lavdëruar; ke lavdi* më shum' se Serafimet* e frikshëm, dhe më e shenjtë* se të gjith' engjëjt e shenjt',*[29] o e himnuar, e tër'd'lir',* se ke lindur pashprehshëm krejt trupërisht* Krijimtarin absolut, o Hyjlind'se;* për shërbëtorët e tu, ti* lutju atij për faljen.

Lavdërime Ting. I
Ton uranion tagmaton

O Mihail, të himnojm' ty me bes' si kryetar* i koreve[2] në qiell* dhe si mbrojtës fuqie,* ruajtës dhe çlirimtar për gjith' ne* që jetojmë në tok' këtu,* duke t'u lutur që të na çlirosh me hir* nga çdo dhimbje shkatërruese.

(2x)

Ky gjeneral i Fuqive të hyjshme[2] që jan' lart,* i fton sot gjithë koret* njerëzore, tok'sore.* Do që bashk' me engjëjt ne të festojm'* panair[21] ngazëllues krejt,* mbledhjen e tyre të shenjtë, dhe njëkohësisht* që të psalim himnin trishenjtor.[3]

O Mihail, që je Mendje e hyjshme, mbana krejt* nën strehën që formojnë* krahët e tu të shenjtë;* na mbulo përjetë ne që të gjith'* sa përikim me bes' tek ti;* në çast të vdekjes qëndro pran' nesh ndihmëtar,*[72] mirëdashës për të gjithë ne.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Kudo që do hijesojë hiri yt, o kryeengjëll, prej andej fuqia e djallit dëbohet,[73] se nuk duron të qëndrojë pranë dritës sate, eosfori që ra;[74] prandaj të kërkojmë, shigjetat e tij zjarrprurëse[75] që lëvizin kundër nesh, shuaji, duke na çliruar me ndërmjetimin tënd nga skandalet e tij, o Mihail kryeengjëll, që meriton të himnohesh.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlind'se e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që nuk çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanunet, Ode III e Kanunit të parë të të patrupëve dhe Ode VI e Kanunit të dytë. Shpëtona, o i Bir i Perëndisë, o i çuditshëm ndër shenjtorët.

Kungatore: **Ai që i bën engjëjt e tij frymëra.**

CITIME

[1] Tobit 12.15; Matth. 18.10; Lluk. 1.19

[2] Jis. N. 5.14-15; Dan. 12.1; Juda 9; Apok. 12.7

[3] Is. 6.3

[4] Ps. 102(103).21; Dan. 10.11; Hebr. 1.14

[5] Ps. 103(104).4; Hebr. 1.7

[6] Lluk. 1.26-33

[7] Is. 6.2

[8] Ps. 102(103).20; 148.2; Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 36,38

[9] Ps. 46(47).2

[10] Abak. 3.3

[10a] Jez. 44.1-4

[11] Num. 4.19; Hebr. 9.3

[11a] Lluk. 1.28

[12] Is. 6.1; Jez. 1.26; Dan. 7.9; Apok. 4.2; 6.16; 7.15; 21.5

[12a] Tobit 12.14

[13] I Tim. 6.16

[14] Is. 6.2,6

[15] Jez. 1.18

[16] Jez. kap. 10 etj.

[17] Rom. 8.38; Ef. 1.21; 3.10; Kol. 1.16; 2.10; I Petr. 3.22

[18] II Tim. 1.18; Hebr. 4.16

[19] Gjen. 3.6-16

[20] Lluk. 15.7-10

[21] Hebr. 12.22

[21a] Ps. 44(45).2; 118(119).131; Jez. 3.27

[21b] Ps. 44(45).2,10

[22] Gjen. 1.7; Is. 40.22

[22a] Ef. 2.20-21

[22b] Is. 9.6; Joan 14.27

[22c] Vep. 10.38

[22d] Mark 1.40

[23] Matth. 1.20; 2.13; Lluk. 1.26-33; 2.9,13

[24] Matth. 28.2; Lluk. 24.23; Joan 20.12

[25] Vep. 12.6-12

[26] Fil. 2.15

[27] Is. 7.14

[28] Is. 6.7

[29] Tobit 11.13; Jov 5.1; Matth. 25.31; Lluk. 9.26; Vep. 10.22; Apok. 14.10

[30] Kol. 3.5

[31] Gal. 5.24

[32] Abak. 3.8

[33] Abak. 3.13

[34] Lluk. 15.9

[35] Jis. N. 5.13-14

[36] Jis. N. 6.20

[37] Lluk. 1.11-19

[38] Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23

[39] Lluk. 1.64

[40] Fil. 2.7

[41] Is. 26.9

[42] Eks. 32.11 etj.

[43] I Kor. 1.30

[44] Fil. 4.7

[45] Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3

[46] Num. 22.21-35

[47] I Mbret. [Sam.] 1.15; Ps. 141 (142).3

[48] Ps. 106(107).26

[49] II Mbret. [Sam.] 22.20; Ps. 4.2; 117(118).5

[49a] Joan 5.35

[49b] Ps. 37(38).4,8

[50] Rom. 4.17

[51] Ps. 32(33).6-9

[52] Fil. 3.20

[53] Eks. 25.8(9),40; 26.30; Hebr. 9.24

[54] Dan. 7.13-14; Vep. 7.55-56

[55] I Tim. 3.16

[56] Tobit 5.4-6

[56a] Is. 33.6

[57] Dan. 7.10; Matth. 26.53; Lluk. 2.13; Juda 14

[58] (II Kor. 11.14)

[59] Joan 1.3

[60] II Mbret. [Sam.] 14.20

[61] Gjen. 18.1-7; Hebr. 13.2

[62] Gjen. 19.1-3; Hebr. 13.2

[63] Gjyq. 13.2-21

[64] Tobit kap. 6,11,12

[65] Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 25-26

[66] Kol. 3.2

[67] Jez. kap. 1 etj.

[68] Jez. 1.4,27; 8.2

[69] Dan. 7.9-10

[69a] Dan. 3.25

[69b] Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 34

[70] Is. 25.8; Apok. 7.17; 21.4

[70a] Ef. 4.18

[70b] Ps. 43(44).20

[71] Matth. 24.27; Lluk. 17.24

[72] Juda 9

[73] Apok. 12.7-8

[74] Is. 14.12

[75] Ef. 6.16

MË 9 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët, Nektarit në Egjina, mitropolit i Pentapojës, dhe të nënave tona oshënare Matrona dhe Theoktista.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të hierarkut. Lavdi i hierarkut. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i hierarkut. Përlëshoret: ngjallësore, e hierarkut, e oshënareve dhe Hyjlindësore.

Të dielën në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor, dhe të dy të shenjtorëve. Dërgimësoret: ngjallësore dhe të shenjtorëve. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të hierarkut. Lavdi Eothinoni. Tani E Përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Apostulli dhe Ungjilli i së dielës.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime të hierarkut
Ting. II
Piis efimión

Me çfar' kurora, himn edhe nder* hierarkun ta kurorëzojmë?* E shkëlqen në kohët e fundit tash* dhe e dëfren shumë botën ton',* Kishën me ndriçime shpres'tarie,* stoli;* zbukurim i ri i orthodhoksëve* në zell,* ish i njëjtë me dhespotët e vjetër;* shkoi pas sjelljes së tyre* mençurisht dhe sakt'sisht,* k'shtu pra e lavdëron Krishti,* që u jep të gjithëve* përmes tij mëshirën e madhe.

Me çfarë kënge melodikisht* ta himnojm' hierarkun e Krishtit,* shërbëtorin e shum'hyjnueshëm* të Perëndis', arkën, thesarin* e virtytit. Për theologjinë* ka qen'* si kitarë dhe buroi për Kishën* nektar* qiellor besnikërie me fjalën* e hyjshme të Hirit vërtet,* pra nga goja, buzët* me urt'si. Priti prej Zotit* dhuratën e çudisë,* Nektarin hyjmarrës e lëvdojm'.

Me çfarë fjale shpirt'rore, ty* hierark, do të të lumërojmë;* ke jetuar ti në bot' ashtu siç do* me të vërtet' Zoti, me sjellje* dhe me punë, vepra oshënare;* prandaj* themelove manastir të shenjt', të mir',* si port* pa furtun' për shpirtrat në një ishull pra* që quhet Egjina, o at';* pa pushim e mbroje* me Dhionisin hyjmendës bashk',* që ish profesor i saj,* Nektar, oshënar i Krishtit ton'.

Të oshënares Matrona: Os jeneon en mártisin

Kryengritjet e mishit tënd* me mjaft

filozofi dhe pun'* asketizmi, me lodhje, i nënshtrove krejt* edhe pas Krishtit, Matrona, shkove edhe banove tok* me asketët denjësisht* duke shuar çdo epsh, pasion* që ndez zjarr në mish,* me tër' shirat e lotëve e ndizje dhe më shum' dëshirën, mallin për Krijimtarin, atlete nën'.

Kishe ngritur një fondacion* shpirtëror të hyjnueshëm* për dobin' e shum' njerëzve, për nder zot'ror,* se ishe tempull i Shpirtit[1] me d'lir'sinë e shpirtit tënd,* udhëhoqe popuj pra* në plot gara të lodhshme, shum'* asketike, ti,* dhe si prikë i solle të shpëtuar tek Jisui, o e tër'urt'; të lavdërojmë ty bashk' me ta.

Vajzat pritën Jisuin Krisht,* dhëndrin,[2] Zotin, meqenëse* ishin bindur tek mësimdhënia jote krejt,* dhe duke zmbrapsur në Shpirt tër' plogështinë e mishit ton',* me gatishmëri të fort'* kishin mbizotëruar, nën',* mbi çdo ves, pasion,[3]* ndaj u futën me ty në nusëroren[4] qiellore, o Matrona, e dhëndrit, ku kan' dëfrim gjithmon'.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Sot feksi gëzueshëm si një yll i ri, panairi i ri i hierarkut Nektar, që shkëlqen tërë Kishën. Ejani pra, turmat e orthodhoksëve, me zë hareje[5] le t'i thërrasim atij: Gëzohu ti, që skicove në karakterin tënd jetën e oshënarëve të vjetër në ditë dinake,[6] kur dashuria e të shumtëve u ftoh,[7] siç tha Shpëtimtari; gëzohu ti, që bashkove virtytin me arsimin dhe që me fjalën e urtësisë sate ngazëllove shpirtrat e besimtarëve; gëzohu, bukuria e kryepriftërinjve, mbrojtësi i Egjinës dhe përkrahësi tepër i ngrohtë i manastirit tënd; prandaj, o Nektar, duke qëndruar pranë fronit të madhështisë,[8] lyp pa pushim për ata që bëjnë me besë kujtimin tënd gjithmonë të respektuar.

Tani

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier. Atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Pasvargje të oshënares Theoktista
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Si e virgjër pa fare cen* u fejove me Krishtin Zot* me një dashuri të hyjnueshme, o nën',* që prej rinis', dhe

e ngrite zgjedhën e tij, e ndoqe k'të,*[9] por armiku ziliqar* kundër teje të sjell ngacmim,* të bën ty robinj',* Theoktista, barbarësh, por u turpërua me qëndresën tënde,* me shpirtin tënd burrëror dhe trim.

Kur të pa, oshënare, ty,* me mir'dashjen e Zotit Krisht* si të patrup, por me mish brenda kishës s'shenjt'* të dedikuar tek Hyjfëmija, mbeti, u shtang në shpirt* pra gjahtari shpresëtar* dhe si gjah të shkëlqyeshëm,* qiellor, ka vën'* para botës, o Theoktista, ndeshjen tënde të përmbinatyrshme* gjat' jetës sate mahnitëse.

Si një lule me er' të mir'* lulëzove në Lesvos, nën',* dhe në Paros ti kundërmimin asketik* pas e lëshove në Shpirt, o oshënare e barabart'* me të patrupët, ndërkaq* dhe lipsanin tënd si dhurat'* qiellore dhe * krejt të çmuar tek ishull Ikaria e dhurove, Theoktista,* e barasvlefshme me engjëjt lart.

Lavdi *I hierarkut*
Ting. Tërth. IV

Shpirtin tënd të shenjtëruar e ka Jerusalemi qiellor[10] së bashku me shpirtrat e shenjtorëve, o Nektar që të këndojmë; ka edhe ishulli i Egjinës lipsanet e tua hirburuese, si pasuri e hyjdhënë dhe klinikë falas për sëmundje të shumëllojshme dhe për çdo pikëllim; sepse ata që vuajnë duke vrapuar tek ato gjithandej, marrin shërimet dhe kërkesat për shpëtim, dhe me zë falënderimi lavdërojnë Zotin që të lavdëroi; lutemi, tek ai ndërmjeto për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Virgjëresh' e panusëruar që zure trupërisht Perëndinë pa tregim, nën' e Perëndisë së lartë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu, o e gjith'panjollëshme, ti që u fal të gjith've paqësim mëkatesh, prit lutjet tona tani dhe lutu që të shpëtohen shpirtrat tanë.*

Përlëshore
E hierarkut Ting. I
Tu lithus sfrajisthentos

Besnik', le të nderojm' lastar nga Silivria,* mbrojtës, ndihm' të mir' të Egjinës, Nektarin e virtytit,* shërbyes me shpirt të Krishtit ton',* siç Zoti Perëndia do gjithmon',* se buron çdo lloj shërimi tek ne të gjith'* që th'rrasim me shpres'tari pra:* O Krisht, lavdi ty që e lavdëron,* lavdi ty që e madhëron,* dhe lavdi se na shëron ne të tërë përmes atij.

E oshënares Matrona
Ting. IV
Tahí prokatálave

Meqen'se burimin e çdo gjëje, pra Krishtin ton'* e deshe fort, jetën engjëllore e kishte ti zili, ndon'se kishe mish,* se dashurin' për burrin* e shpërfille me mendje,* dhe turpërove djallin urtësisht, o Matrona,* ndaj u denjësove për lavdin' që nuk prishet kurr'.

E oshënares Theoktista
Ting. III
Tin oreótita

Si një filiz të shenjt'* Lesvosi të ka ty,* u shenjtërua dhe* Parosi me mundjet* e tua dhe lipsani yt është' për Ikarin' thesar krejt;* ndaj si oshënare dhe* virgjëresh' të lëvdojmë ty* me zë fort të lart', kërkojm'* mbrojtjen tënde të ngrohtë shum';* atë u jep atyre që th'rrasin:* G'zohu, o nënë Theoktista.

Hyjlindësore

Ti që ndërmjetove për shpëtimin e gjindjes son', të përhimnojmë, o Hyjlindëse Virgjëreshë, se duke denjuar pësimin e Kryqit me trupin që mori prej teje Biri yt dhe Perëndia ynë na çliroj prej prishjes si njeridashës.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore e hierarkut
Ting. I Ton tafon su Sotír

Si diell me shkëlqim* ti në kohët e fundit,* Nektar, për ne ke lindur me jet' oshënare;* për lavd dhe për himnim të Krishtit, që është' Zoti i Gjith'sis',* na ke nxitur tër',* o oshënar, për Jisuin,* që të shfaqi ty* të lavdëruar, o atë,* me forc' çudibërëse.

E oshënares Theoktista
I njëjti

Dëfren mistikërisht,* oshënare e Krishtit,* kujtimi yt i shenjt' çdo shpirt, zemër besnikësh;* në të pasi u mblodhëm ne, të lum'rojmë me këngë ty,* lavdërojmë bashk'* Fjalën që të lavdëroi;* lutju ti asaj* përherë, o Theoktista,* për ndjesën e shpirtrave.

Hyjlindësore

Në tempullin e shenjt'* të Hyjlind'ses së d'lirë,* pasi ditë e nat', nën', qëndroje gjithmonë,*[11] u bëre ti mistikërisht tempull tepër i shenjt', i d'lir'* i Trinis' së Shenjt',* shkëlqeve ti me veprime* shum' të shenjta, pra* me gjuh', shpirt, mend madhështoje* të pastrën, të Virgjërën.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore e hierarkut
Ting. III
Tin oreótita

Dëlirësin' e plot'* të jetës sate bashk'* me drejtësin' e sakt'* të sjelljes sate, sot* e priti Zoti si ofert' shpirt'rore dhe të tregoi* ty si krua terapish* nëpër Egjin' për sa vrapojn',* rendin me besim të thell'* te lipsanet e tua, at',* të cilat u shpërndajnë të gjith've* er' qiellore me aroma.

E oshënares Theoktista
Ting. IV
Kateplaji Iosíf

U habit gjahtari krejt* me të vërtet', sapo të pa* që të fryhesh si një tis* nga frymë ajri, o e thjesht',* përbrenda kishës së shenjtë të Zonjës sonë;* edhe u tmerrua kur mori vesh* jetën tënde me mundje shum' të fort';* u shenjtërua kur të preku, o nën',* kjo falë hirit që kishe marr';* ndaj Theoktista,* lyp për të gjith' ne* që me mall të nderojmë.

Hyjlindësore

Duke marr' vesh mistikisht,* o e Hyjhirshme e dëlir',* shndritjet e lavdis' që ke,* nën' Theoktista shum' e shenjt',* duke qëndruar gjithmonë në kishën[11] tënde,* fort duronte çdo gjë të lodhshme, pra* jetën asketike të ashpër krejt,* dhe madhëronte e gëzuar në shpirt* gjith' madhështimet e tua, Zonj';* të th'rriste: G'zohu,* o e bekuar,* o përikje e njer'zve.

Kanunet: i së Tërëshenjtës në 6 dhe dy të shenjtëve në 8
Ode I
E Hyjlindëses
Irmosi: Igrán dhiodhefsas

»Pasi kish kaluar det si steré* edhe »u shpëtua nga inati egjiptian,* me »zë Izraeli po thërriste:* Le t'i kën»dojm' Perëndis', Çlirimtarit ton'.

I mbytur prej ngasjeve si në det,* më ty po përikij dhe prej teje kërkoj shpëtim,* o nënë dhe Zonjë Virgjëreshë,* prej çdo rreziku dhe zie shpëtomë ti.*

Pësimet më mbushën me turbullim* dhe shpirtin ma mbytën me mërzitje dhe dëshpërim,* po ti qetësomë, Virgjëreshë,* me ngushëllimin dhe paqen e Birit tënd.*

Të lutem o Zonjë, o Shën Mari,* që linde Jisuin, ti shpëtomë nga çdo rrezik,* më ty po përikij dhe të lutem,* me tërë forcën e zemrës dhe shpirtit tim.*

Se shpirti dhe trupi keq m'u sëmur,* pra ti mëshiromë, edhe syrin mbi mua

hidh,* kujdesu për mua Virgjëreshë,* e mirë vetë dhe nën' e të mirit Bir.*

Kanuni i hierarkut, që ka Akrostihidhë: "Lavdërim tek Nektari hyjfolës. I Gjerasimit"

Ting. I Odhín epiníkion

Nektar çudibërës, shpërbë errësirën nga mendtë e mia me ndriçim prej ndërmjetimit tënd, edhe më jep fjal'* që të himnoj me gaz kujtimin tënd të hyjshëm krejt.

Në vitet tani në fund, linde si diell që s'ka perëndim, edhe me shndritjen e veprimtarisë ti na tregon,* at', dritën e Ungjillit anembanë botës son'.

Ke ndjekur ti gjurmë dhespotësh të vjetër, Nektar oshënar, me pastërtin' e jetës sate, me ta i barabart',* pjes'marrës në lavdin' e tyre u dëfteve qart'.

Hyjlindësore

Natyrën që s'ka kufi fare e mbajte në bark edhe nuk u dogje, dhe e linde me mish pa ngat'rrim e ndryshim* pra Krishtin, bër'sin e Gjith'sis', o Virgjëresh' pa cen.

Kanuni i oshënares Matrona, që ka Akrostihidhë: "Këndoj përzemërsisht lavdinë e Matronës. Josif".

Ting. Tërth. IV
Ásomen to Kirio

Duke qen' bashk' me rendet* qiellore,[12] hyjnizohesh ti gjithnjë* me pjesëmarrje të shenjt';* ndërmjetimi yt të na shpëtojë ne.

Duke u djegur plot'sisht* nga dëshira e hyjnueshme, shove* me shira asketizmi* djegie kënaqësish krejt shpirtprishëse.

E oshënares Theoktista

Poezi e përkthyesit, përveç Hyjlindësoreve

Hyre në mosh' të njomë* dhe jetime në një manastir; më von'* u kape nga piratë* në qytet, por kujdesej Ati nga lart.

Hyjlindësore

Ti që për botën linde* qart' shpëtim hyjnor si dhe rithirrje krejt,* shpëto ata që rendin* me besim tek ti, o e panjollëshme.

Zbritësore: Anikso to stoma mu

»Ja gojën e çel tani, i frymëzuar prej »Shpirtit Shenjt'*[12a] dhe këngë do t'i »këndoj nënës së madhe mbi fron;*[13] »dhe do ta kremtoj* me valle buzë»qeshur,* me zë do t'i shpall kudo »Hyrjen tek Tempulli.*

Ode III

E Hyjlindëses
Irmosi: Uranias apsidhos

»Perëndi që ke bërë apsid' në q'ell
»si çati,*[14] ti që je ndërtues i Kishës,[15]
»më siguro mua* në dashurin' tënde
»fort; je maja e çdo dëshire,* njerida-
»shës, edhe mbështetja për çdo
»besnik.

Si përkrahje dhe mbrojtje të jetës
sime të kam,* ty o Virgjëresh' e kulluar, ti pra më qeveris,* dhe në liman
të më çosh, se ti na fal çdo të mirë,*
ti besnikët përgjithmon' i mbron,
Hyjlindëse.*

Po të lutem, o Zonjë, ma qetëso
shpirtin tim* dhe pushoma shqotën
e zemrës, se më bie zali,* se ti o Zonjë Mari, ke lindur Mbretin e Paqes,*[16]
Shpëtimtarin, Zotin Krisht, ti o
Hyjlindëse.*

Mirëbërësin[17] linde, që bëri çdo mirësi,* pasurisht të gjitha të mirat jepna
të gjithëve,* se ti në dorë e ke,[18] se ti
ke lindur të fortin,* Shpëtimtarin,
Zotin Krisht, ti o Hyjlindëse.*

Me sëmundje të liga dhe çfarëdo pasion,* dergjem un' i mjeri, o Zonjë, eja
shëromë ti,* se s'të mungon asnjë
gjë, i ke të gjitha të mirat,* je thesar
për çdo shërim, ti o Hyjlindëse.*

E hierarkut:
Stereothito i kardhia mu

Që nga rinia jote, ati yn',* me një
dashuri të hyjnueshme krejt* ishe formuar shenjtërisht; preferove ta ndjekësh ti* Krishtin;[19] u largove pra
urt'sisht,* Nektar, prej kot'sis' në bot'.

Sa ëmbëlsi dhe hir nga qielli* po
pikon nga fjalët e buzëve, at',* përbrenda zemrave dhe shpirtrave tan',
se pranojm' çdo gjë* që ke thën', dhe
drejt të mirave* me bes' edukon
mendjet.

Lavdi i ri i hierarkëve* ti u paraqite,
Nektar kryeprift,* i veshur me një
shenjtërim të vërtet', me çdo pastërti* jete, oshënar, prandaj dhe ne,* at',
të lavdërojmë ty.

Hyjlindësore

Tendë[20] e Fjalës së shum'çmuar dhe*
shenjtërim lavdie e hyjshme u pa,*
dhe qiell gjith'mendor nga lindi për
botën ton' dielli,* drit' për jetën që nuk
perëndon,* Hyjlind'sen pra e himnoj.

E oshënares Matrona:
Si i to steréoma

Me shkop të hyjnueshëm* bese, ke
prerë det vesesh krejt;* e para ti*
bëre udh' të drejtë* për shum' shpirtra[21] të hyjshëm, nën'.

Uduke si zbukurim,* o e tër'thjesht', për murgesha ti,* se kishe jet'* pa qortim, të pastër* kallogjerësh, Matronë nën'.

E oshënares Theoktista

Gjat' udhës për skllavërim* u arratise në Paros ti,* në ishull që* ish i shkatërruar* nga barbarë të egër shum'.

Hyjlindësore

Gatuesi, o e d'lir',* ishte bashkuar në barkun tënd* me mish, veçse* mbeti po siç ishte;* k'shtu na dha ne një jet' të re.

Zbritësore: Tus sus imnologus

»**O** Zonjë dhe nën' e Perëndisë, burim »i pasosur jetësor,* ti siguroji gjith' »ata që të këndojnë plot me zell;* në »Hyrjen tënde që nderojm', kurorëzoi »me çdo lavdi.*

Kontaqi i oshënares Matrona
Ting. II Ta ano zitón

Ti mishin ke shkrir',* gjith' trupin tënd me kreshm', ushtrim;* banove në mes* të burrave, Matronë nën';* përkushtoje veten tek lutja, i shërbeve krejt Zotin ton',* për të cilin e le çdo gjë,* meqen'se e shkove jetën me asketiz'm.

Shtëpia

Çele gojën time, o Krishti im, për të himnuar dhe për të thënë luftrat e oshënares sate, o njeridashës; se pasi i braktisi të gjitha dhe aspiroi vetëm për ty, dhëndrin,[2] i konsideroi të gjitha gjërat mbi tokë si të prishshme; dhe si formoi në vete tipin e Kryqit jetëprurës, asgjësoi arroganca demonësh dhe i zhduku ata absolutisht, meqen'se e shkoi jetën me asketiz'm.

Ndenjësore e hierarkut
Ting. Tërth. I
Ton sinánarhon Logon

E përshkove, o at', udhën e virtyteve;* pra u shpërngule tek jeta që s'plaket kurrë dhe je* pjesëmarrës i shenjtorëve, o oshënar;* tok me këta ti ndërmjeto* përgjithmon' tek Zoti, mbreti yn', që të japë tek ne* që po lusim kujtimin tënd, falje fajesh si edhe shpëtim shpirtëror.

Ndenjësore e oshënares Matrona
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

Burrërisht u shpëtove krejt fshehtazi* nga intrigat e djallit, armikut ton';* drejt jetës së Shpirtit t' Shenjt'* ti vërtet rende me gëzim,* dhe meqë bëre udhën tër' pa devijim, o nën'* hyjmendëse, pranove nga Krishti hir

shpirtëror;* ndaj derdh çurg shërimesh tek ata që me mall'ngjim* lëvdojnë kujtimin tënd,* o e famshme, o krenari* për murgeshat* në maturi;* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Ndenjësore e oshënares Theoktista
I njëjti

Asketiz'm mbi natyrë ke bër' mbi dhé;* u lëvdove në qiejt pra denjësisht,* në ishull të shkret' plot'sisht* ti fushove, hyjmbajtëse* nën', edhe adhuroje Jisun' e veçuar krejt,* dhe ishe e padukshme, e panjohur për të gjith';* ndaj në fund të luftës, kur u njohe nga njer'zit* habiti ushtrimi yt,* asketizmi paradoksal,* Theoktista* si një engjëll;* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Hyjlindësore

Meqë zure krejt pa prishje Perëndin',* dhe e linde në trup, Virgjëresh' e d'lir',* pas lindjes ke mbetur prap'* e paprishur, e qashtër ti;* Adamin e dënuar nga prishja shpëtove qart',* meqë e linde pafundësin' e bekimit, Vajz';* ndaj të lutem, shpirtin tim çliro nga keqdashje* armiku dhe jep tek un'* mençuri,[22] o e pastër shum',* të veproj siç* do Zoti yn',* Krishti, biri yt, Perëndi,* dhe që të marr ndjes' mëkatesh* dhe të arrij* jetën e amëshuar, un', shërbëtori yt.

Ode IV

E Hyjlindëses
Irmosi: Isakíkoa Kírie
tis ikonomias su

»Kam dëgjuar misterin qart'* të »ekonomis' sate dhe kuptova krejt* »vepra që ke bërë[23] dhe prandaj* »lavdërova un' hyjninë tënde, Zot.

Shën Mari o Hyjlindëse,* ti që linde Zotin, kapedanin ton',* zbute shqotën e pësimeve,* qetësoi valët e mëkateve.*

Ne të gjithë të lutemi,* dhembshurinë tënde tregona pa vones',* ti që linde njeridashësin,* Krishtin Shpëtimtarin e besnikëve.*

Për shumicën e dhuratave,* të falënderojmë ne mirënjohësit,* me këndime lavdëruese,* nënë virgjëreshë dhe Hyjlindëse.*

Ty të kemi përkrahëse* dhe fortesë të patundur dhe mbrojtëse,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* na shpëto përherë prej rreziqeve.*

E hierarkut:
En Pnévmati provlepon

Pasi e përshkove shenjtërisht jetën tënde mbi tokë, u duke bashkëbanues me të gjithë shenjtorët në qiej, ndërsa kutia e lipsaneve të tua buron shenjtërim dhe shpëtim tek ata që janë në sëmundje dhe pikëllime.

Shërbeve me përkushtim, o i urtë, dhe me pastërti si prift i mirëpritur nga Krishti gjithëbërës, dhe si flijim të pastër i solle atij jetën tënde të panjollshme, o hierark, prandaj je lavdëruar pas vlerës.

Koka jote e tërëshenjtë shëron çuditërisht sëmundje të shumëllojshme dhe pasione të vështira, sepse Hirin hyjnor, i cili banon në të, vepron me mënyra të shumëllojshme tek ata që vijnë, sipas masës së besës.

Hyjlindësore

U lind prej barkut tënd me formë si ne, ai që më parë ishte jolëndor, duke mbetur ai që ishte, Perëndi, dhe pasi rigatoi Adamin[24] nga mallkimi,[25] i tregon fëmijë Perëndie[26] në besim ata që të lavdërojnë si Hyjlindëse.

E oshënares Matrona:
Isakíkoa Kírie tis ikonomias su

Me pikat e lotëve të tu vadite zemrën dhe kultivove kalli virtytesh njëqind herë më tepër,[27] me Hir hyjnor, o Matrona.

Duke mbështetur bazat e mendjes tek Krishti, nuk u ktheve mbrapsht nga ndikimi i demonëve dinakë.

E oshënares Theoktista

Asketizove në kishën e famshme të Hyjlindëses tridhjet e pesë vite pa takuar njeri; ti vetëm me Krishtin, o Theoktista.

Hyjlindësore

Duke mos lënë qielloret, o e papërlyer, zbrazet Perëndi[28] në mitrën tënde dhe matet i pamatshmi, duke zgjidhur shkeljet e mia pa masë.

Zbritësore: Tin aneksihníaston

»Të pagjurmësuarin plan perëndor,*
»që po mishërohet i larti Zot* prej Vir-
»gjëreshës,* Abakumi si profet e pa
»dhe tha me zë të madh:* O Zot i fuqi-
»shëm, lavdi më ty.*

Ode V
E Hyjlindëses
Irmosi: Fótison imás

»Ndritna ti, o Zot,* përmes urdhrave
»të tua[29] ne,* si dhe me krahun tënd
»të fort' dhe të lart',*[30] o njeridashës,
»na jep paqen tënde[16] të sigurt.

Zemrën na e çel* me gëzim dhe ngazëllim, o Zonj',* falna gazin e pasosur tani,* sepse ke lindur ti shkaktarin e gëzimeve.*

Zonjë na shpëto,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* prej helmeve si dhe rreziqeve,* se ti ke lindur[31] Shpëtimtarin, paqeprurësin.[32]*

Mjegullën largo* të mëkateve Hyjlindëse* me dritën tënde jetëdhënëse,* sepse ke lindur diellin e parajetëshëm.*

Zonjë na shëro,* nga pësimet e sëmundjeve,* na mëshiro edhe na vizito,* edhe shëndetin na dhuro me ndërmjetimin tënd.*

E hierarkut:
Tin sin irinin dhos imín

Me urtësinë e Shpirtit dhe me fjalë jete[33] rregullon zemrat e besëmirëve, o Nektar, drejt sjelljes me të mirë, si predikues i urtë i Ungjillit.

Pasi u stolise, o i urtë, me rrobë kryepriftërie, e zbukurove atë me punë të virtytshme si hierark shumë i perëndishëm dhe administrator i mistereve hyjnore.

Duke u dalluar urtësisht për mençuri dhe butësi, mblodhe virgjëresha oshënare perëndishëm dhe i udhëhoqe ato drejt Krishtit edhe me fjalë, edhe me vepra jete të paqortueshme.

Hyjlindësore

Me llamburitjen tënde, o e pacenuar, shkëlqeje si mirëdashëse, o e kulluar, shpirtin tim të errësuar me errësirë pasionesh, dhe ngulmë të tërin në frikën[34] e hyjshme.

E oshënares Matrona:
Orthrízontes voomen si

Kur veshe skimën e shenjtë, o Matrona, e veshe armikun e fëlliqur me shëmtim.

Shkëmbeve të rrjedhshmet me të qëndrueshmet, dhe bashkëshortin me të fejuarin e pavdekshëm, dritëdhënësin e shpirtrave tanë.

E oshënares Theoktista

U frikësua, o Theoktista, gjuetari që të takoi ty flokëbardhë, si skelet me lëkurë të zezë, se s'kishe rroba.

Hyjlindësore

Meqë linde sunduesin e të vdekurve dhe të të gjallëve,[35] vrit, o e tërëpaqortueshme, pasionet e mishit tim.

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

»Të gjith' i habite ti me një çudi dhe »një lavdi,* ti, o Virgjëresh' e pamar-

»tuar,* që brenda Tempullit zotëror
»hyre drejt* si një tempull shum' i
»pastër pra,* dhe shpëtim që lartazi*
»u dhurove besnikëve.*

Ode VI
E Hyjlindëses
Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»Do derdh lutjen* para Zotit Perë-
»ndi* dhe atij do t'i tregoj hidhërimet*
»që kam,[36] sepse* shpirti im është
»mbushur* me çdo të keqe dhe jeta
»po shkon në Hadh;*[37] pra si Jonai
»lutem un':* Jetën time nga prishja,
»ti ngrije, Zot.

Atij iu lut,* se prej vdekjes na shpë-
toi,* si u dha nën thonjt' e vdekjes
dhe vetë,* prapë tani* shpirtin tim ta
shpëtojë,* nga shkatërrimi i vdekjes
dërrmonjëse* dhe nga armiku zemër-
lig,* Biri yt, Zoti yt, o Hyjlindëse.*

Si mbrojtëse* ty të di dhe rojtëse,*
të sigurt, o Virgjëreshë, për jetën,* ti
i shpërndan,* gjithë ngasjet e liga*
edhe veprime demonësh na i dëbon,*
pra ty të lutem si gjithnjë:* Ti shpë-
tomë prej gjithë pësimeve.*

Fortes' e mur,* ty të kemi Zonja jon',*
dhe shpëtim për shpirtrat tanë të
plotë,* dhe ngushëllim* në mjeri-
met,[38] o Zonjë,* dhe n' errësirën me
dritë na ngazëllon;*[39] pra ti, o Zonjë,
dhe tani,* nga pësimet, rreziqet ti na
shpëto.*

Në shtrat tani* i sëmurë shtrirë jam*
dhe për trupin tim shërim dot nuk
gjendet,*[40] vetëm pra ti,* që ke lindur
për botën* një Shpëtimtar dhe një
mjek të sëmundjeve,* pra ty të lutem
dhe tani:* Ti më ngri nga lëngatat
Hyjlindëse.*

E hierarkut:
Ton profitin Ionán

Si një yll i ri na shndrite mistikërisht,
Nektar,* tash në kohërat e fundit, dhe
ndeze zemrat e besnikëve* për mallë-
ngjim të hyjshëm, o ati yn'.

Ti u solle përmbi dhé urtësisht, hyj-
mendërisht* brenda ditëve dinake[6]
siç Pavli i urt' tha, Nektar, prandaj*
prej Zotit je lëvduar shkëlqyeshëm.

Ti në frikë Perëndie mbështete në
fuqi* manastirin tënd; prandaj e
dallove si gji deti pa furtun',* që të
shpëtohen shpirtra, Nektar me nam.

Hyjlindësore

Ti që linde mishërisht Bërësin e
Gjithësis'* dhe mallkimin e Adamit
qëmoti e ke zhdukur, më çliro* nga
errësir' pasionesh, o e dëlir'.

E oshënares Matrona:
Tin dhéisin ekheó

Si zog në pyll* asketizmi me një zë* shum' të ëmbël cicëroje, dhe ftoje;*[41] tërhoqe k'shtu* një shumic' grash të hyjshme* si një thëllëzë mendore, se ike larg,* u arratise nga çdo grack'* e armikut, Matrona, në Shpirt të Shenjt'.

I zbutje ti* veset, oshënarja jon';* me filozofi pra mbizotëroje* mbi mishin tënd;* bukurin' e shum'-këndshme* të shpirtit e sistemoje për Krishtin ton'* krejt dukshëm, ndaj u njohe qart'* si e bukur, e hijshme, Matronë nën'.

E oshënares Theoktista

S'arrin askush* që të flasë për ty, nën',* si kalove në uri, në të ftohtë,* me lutje, pra* në kungim bashk' me Zotin,* që ësht' plot'simi i gjith'[42] aspiratave,* e mbushur plot me ngrohtësin',* Theoktista, që vinte nga Shpirt' i Shenjt'.

Hyjlindësore

Natyra jon'* ishte robëruar rënd'* nga mëkati, por atë e çlirove* nga skllavëri* shum' dinake, Hyjlind'se,* sepse në bark kishe Zotin e Gjithësis',* që na tregoi ne të gjith'* hyrje jete, o nën' e panjollëshme.

Zbritësore: Tin thian taftin

»Këtë të kremte e lusim sot, për »Zonjën edhe nënën Hyjlindëse, gjithë »hyjmendësit,* eni trokisni pra duar-»të*[42a] dhe lavdëroni Zotin që lindi prej »asaj.*

Kontaqi i hierarkut
Ting. Tërth. IV Ti ipermaho

Le ta nderojmë* yllin që u shfaq në Kish' në fund;* fortifikimin që u ngrit tash për Orthodhoksin';* me dëfrim në zemër ne le ta lartësojmë,* se me energjin' e Shpirtit u lëvdua gjer',* dhe buron me mbushulli hir terapish tek ne* që thërrasim bashk': * G'zohu, o at' Nektar me fam'.

Shtëpia

U dallove nëpër botë njeri qiellmendor, o Nektar, hierark i Krishtit, se pasi përshkove një jetë oshënare, u bëre në të gjitha i plotë, o oshënar dhe hyjmarrës, prandaj dëgjon prej nesh:

Gëzohu ti, përmes të cilit besimtarët lartësohen;/ gëzohu ti, përmes të cilit armiqtë shastisen.
Gëzohu ti, i barabartë me Etërit oshënarë;/ gëzohu ti, mësues i hyjshëm i orthodhoksëve.
Gëzohu ti, shtëpi e tërëshenjtëruar e energjisë së perëndishme;/ gëzohu ti,

libër i hyjshtypur i sjelljes së re.
Gëzohu, se para pak kohësh konkurrove me shenjtorët;/ gëzohu, se u ndave mençurisht nga materia.
Gëzohu ti, trofe i shndritshëm i besimit;/ gëzohu ti, instrumenti i respektuar i Hirit.
Gëzohu ti, përmes të cilit Kisha kërcen;/ gëzohu ti, përmes të cilit ishulli i Egjinës gëzohet.
Gëzohu ti, o atë Nektar me fam'.

Sinaksari

Më 9 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Nektar çudibërësit, mitropolit i Pentapojës.
Vargje: Duke pirë nektarin e jetës së përjetshme,/ buron, o Nektar, çurg shërimesh.
Brenda së nëntës, iu ngrit shpirti Nektarit nga gjymtyrët.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i nënës sonë oshënare Matrona.
Vargje: Denjësohet për jetën e ardhshme Matrona,/ sepse e kaloi jetën denjësisht për atë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i nënës sonë oshënare Theoktista nga ishulli Lesvos.
Vargje: Fëmija e Lesvosit, Theoktista e virgjër,/ shkoi te Krijuesi Perëndi si nuse e tërëbukur.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Onisiforit dhe Porfirit.
Vargje: Duke rendur me kuaj drejt Perëndisë, o Onisifor,/ e ke bashkëkalorës edhe shërbëtorin.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i grave të shenjta Efstolia dhe Sopatra.
Vargje: E gjitha e bukur[43] ti shkon drejt Fjalës Perëndi,/ e stolisur me stoli shpirtërore, o Efstolia.
Qëndroi Sopatra pranë fronit të Atit, Shpirtit dhe Fjalës,/ pasi i dha mishin dheut.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Andon gurprerësit.
Vargje: Andonin e hyjnueshëm e vrasin me dru/ mashtruesit, që nderojnë drurin si Perëndi.

Në të njëjtën ditë, shën Kristofori dhe Mavra mbarojnë me shpatë.
Vargje: Errëson mashtrimin Mavra, pasi ia prenë kokën,/ ndërsa Kristofori kur u pre, shikon dritën e Krishtit.

Në të njëjtën ditë, oshënar Joan Kolovosi mbaron në paqe.
Vargje: Një vend i vogël toke e fshehu Joanin,/ i cili edhe pse i shkurtër në trup, ishte i madh në vepër.

Në të njëjtën ditë, oshënar Eladhi mbaron në paqe.
Vargje: Edhe pse u shpërngule, o Eladh, nga jeta,/ mbete katalog virtytesh për ata që janë në jetë.

Ati ynë oshënar Simeon Metafrasti mbaron në paqe.

Etërit tanë oshënarë dhe hyjprurës Efthimi dhe Neofiti, themeluesit e Manastirit të respektuar të Dhohiariut në Malin e Shenjtë, mbarojnë në paqe.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
E Hyjlindëses
Irmosi: I ek tis Iudheas

»Tre Djem që nga Judea* përfunduan »si robër në Babilonë dikur,* me »besën e Triadhës kan' shkelur flakë »furre duke psalur me gaz e hir:* O »Perëndi atëror,* o Zot je i bekuar.

Për shpëtimin e botës,* në pëqi virgjëror ke banuar ti, o Jisu,* dhe nënën Virgjëreshë, e cila të ka lindur, na e bëre ne mbrojtëse.* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Birit plot me mëshirë,* që ke lindur, o nën' e kulluar, lutju për ne,* të na i ndjejë fajet dhe njollat shpirtërore, se thërresim me zë të madh:* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Thesarin e shpëtimit*[43a] dhe burimin e paprishjes ty Hyjlindësen pra,* kështjellën e përikjes dhe derën e pendimit ua shfaqe besnikëve.* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Sa po vijnë me shum' mall* edhe nën hijen tënde të gjith'sigurtë, o Zonj',* denjo që të shërohen si shpirtrat e sëmurë k'shtu dhe trupat në vuajtje,* se Krishtin ton' shpëtimtar,* për ne ti e ke lindur.*

E hierarkut: Tus en kamino

Meqë i shërbeje me dëshirë të sinqertë dhe me zemër të pastër Krishtit, mbretit të të gjithave, pranove në shpirtin tënd ndriçimin e Ngushëllimtarit, o oshënar, duke thirrur: I bekuar je, o Perëndi i etërve.

Pasi na linde mendërisht si diell i gjithëndritshëm në vitet e fundit, shkëlqen mendjet e besëmirëve me dritën e punëve të tua, o Nektar i shenjtë, bukuria e hierarkëve.

Tërësia e lipsaneve të tua, si një tjetër klinikë e çuditshme, u jep gjithmonë shërim shpirti dhe trupi atyre që vrapojnë besërisht dhe me devotshmëri të madhe tek manastiri yt i dëlirë.

Hyjlindësore

Si nënë e Shpëtimtarit dhe Perëndisë, o Virgjëreshë e paqortueshme, me syrin tënd të dhembshur shih mundimin e shpirtit tim të mjerë dhe çliromë nga zakoni dinak e i dhunshëm i pasioneve shkatërruese.

E oshënares Matrona:
Pedhes Evreon

Si një turtulleshë shumë e bukur e ruajte për Perëndinë mençurinë, o e lumur, meqë me sterilizim pasionesh u pasurove vërtet me bija të mira, që shpëtoheshin nëpërmjet teje.

Pasi braktise me gjakftohtësi të perëndishme, o modeste, botën dhe ato që janë në të, trashëgon shortin e përmbibotshëm tani, duke qenë vërtet zbukurim murgeshash, o Matrona.

E oshënares Theoktista

E mbuluar, o Theoktista, me pallton e gjuetarit që të gjeti, ia tregove të gjitha, dhe i parathe se do vinte prapë në ishull, e iu lute të sillte Kungatën e Shenjtë.

Hyjlindësore

Duke zgjidhur mallkimin e Evës,[25] o Virgjëreshë e tërëpatëmetë, linde Perëndinë e të gjithave, pasi e zure pashprehshëm dhe kishe në barrë shpëtimin për njerëzit.

Zbritësore: Uq elátrefsan

»Nuk u faleshin krijesave hyjmen»dësit, por Kryetarit lart,* dhe kërcë»nimin me zjarr* e shkelën me trimëri, »psalnin me brohori:* Zot, lavdi më »ty, o Perëndi i etërve,* ti je vetëm i »bekuar.*

Ode VIII
E Hyjlindëses
Irmosi: Ton Vasilea ton uranón

»Mbretin në qiejt,* që gjith' ushtrit' »engjëllore* e himnojnë edhe ju him»noni,* dhe e lartësoni gjithmon' në »gjithë jetët.

Mos i harro kurr',* o Virgjëresh', sa të luten,* të himnojnë me bes' e me shpresë,* dhe të lartësojnë me zë për gjithë jetët.*

Ti i shëron krejt,* përher' e pa u kursyer,* gjith' ata që të luten, o Zonjë,* dhe të lartësojnë që linde Zotin tonë.*

Ti më shëron krejt* nga gjith' sëmundjet e shpirtit* dhe nga dhembjet e trupit, o Zonjë;* të të lartësoj pra, o Virgjëresh' hirplote.*

Ti i largon krejt* sulmet dhe ngasjet e liga,* dhe pësimet, o Zonjë e virgjër,* pra të lartësojmë me zë për gjithë jetët.*

E hierarkut: Pedhas evajís

Duke dashur Zoti të njoftojë tek ata që janë në tokë lavdinë që të ka dhënë ty në qiej, o i urtë, i dëfteu lipsanet e tua të hyjshme, si burim

terapish dhe mrekullish të shumta, o i tërëlumur.

U dukën nga dheu si zambakët e arës[44] kockat e tua të respektuara, sapo u hap varri yt i nderuar, o atë Nektar, duke lëshuar tek të gjithë erë pavdekësie.

Lyp që të shpëtojë manastiri yt i respektuar, i dorëzuar tek dashuria jote atërore, nga çdo shtrëngim, dëm dhe mëri, se me ty krenohet, o hierark i Krishtit.

Hyjlindësore

Pa farë zure Bërësin e të gjithave, dhe meqenëse e linde atë me mish, shpëtomë mua, shërbyesin tënd të mjerë, nga prishje mendimesh mishore, o Virgjëreshë.

E oshënares Matrona:
Nikité tiranu

Si e zbukurove shpirtin me sjellje përkushtimi, o Matrona e tërëthjeshtë, i ofrove Krishtit kor të hyjshëm virgjëreshash që këndonin: E bekoni të gjithë veprat Zotin dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.[44a]

Shirat e djersëve të tua me hir të hyjnueshëm thajnë shirat e turbullta të pasioneve, o Matrona, dhe përherë ujitin zemrat e atyre që vijnë tek ti me besim, prandaj të nderojmë në gjithë jetët.

E oshënares Theoktista

U bë siç profetizove, o oshënare, dhe u kungove sipas dëshirës sate të përzjarrtë; dhe me lot thërrisje si Simeoni: Tani më përlësho, o Zot; ndaj kur u kthye nga gjuetia njeriu, i hidhëruar të gjeti të mbaruar.

Hyjlindësore

Ja ku Virgjëresha, siç thotë Isaia në Shpirt, kishte në bark atë që nga barku i Hadhit na shpëtoi ne që thërrasim besërisht: E himnoni Zotin dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.[44a]

Zbritësore: Pedhas evajís

»Djemat* e dënuar për t'u djegur,
»prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit
»Krisht, si simbol në lashtësi;*[45] dhe
»si një veprim tani,* dhe tërë botën
»po e mbledh për këng' e lavdërim:*
»Himnojeni ju veprat e Zotit* dhe e
»lartësoni përmbi të gjitha jetët.[44a]*

Ode IX
E Hyjlindëses
Irmosi: Kirios Theotokon

»Pohojm' se je Hyjlind'sja,* ne që u
»shpëtuam* nëpërmjet teje, e shenjt',
»Virgjëreshë e d'lir';* me koret e të
»patrupve të madhështojmë ty.

Shiko si qaj me lotë,* edhe mëshiromë,* se ti ke fshirë çdo lot prej fytyrave,*[46] o Virgjëreshë dhe Zonjë që linde Zotin Krisht.*

Gëzoje zemrën time,* Zonjë Virgjëreshë,* se ti ke lindur gëzimin për njerëzit,* dhe zhduke çdo helm me ndjesën e gjith' mëkateve.*

Liman dhe mbrojtje bëhu,* Zonjë Virgjëreshë,* kështjell' e mur i patundur, Hyjlindëse,* përikje, ndihmë dhe mbrojtje e gjithë njerëzve.*

Me rrezet dhe me dritë* ndritna Virgjëreshë,* edhe largo errësirën e mendjeve*[47] t' atyre që të lëçitin Zonjë Hyjlindëse.*

Shëromë Virgjëreshë,* se jam i përmbysur,* edhe po dergjem[48] në shtratin e vuajtjes,* po eja ngremë dhe falmë shëndet edhe shpëtim.*

E hierarkut: Tin zoodhohon pijín

Kuror' lavdie ti prite prej Zotit tënd,* që të lëvdoi shkëlqyeshëm, o Nektar,* se si oshënar ke bër'* udhën[49] tënde shenjtërisht;* i barabart' me shenjtorët na u duke,* bashk' me të cilët për sa të nderojn' lutu.

Stolin' kryepriftërore e veshe[50] mir'* dhe më të shenjt' e tregove me çdo luftim,* me çdo lodhje, o asket,* dhe me jetën mjaft të d'lir'* e thithe shndritjen e etërve të vjetër,* o at' i kohëve tona të turbullta.

Më jep një er' qiellore arome ti,* aromë jete[51] nga kreu yt, oshënar;* i dhuro pra shpirtit tim* mendërisht dhe prite, at',* si kundërmim dhe si miro himnin e thjesht'* që thura, o shenjt, me plot mall dhe me dëshir'.

Hyjlindësore

Je më e lart' se Fuqitë e sipërme* pa krahasim, më e ndritshme se dielli;* dhe si linde po me mish* Diellin e lavdit pra* Jisunë Krisht, dritëdhënësin, ndriçon fort* ata që të madhërojnë me admirim.

E oshënares Matrona:
´Efrikse pasa akoí

Si pëllumbesh' e hyjshme krejt* dhe me krahë që i kishe të veshur plot me[52] ar virtytesh ti* Matrona e lëvduar, e lehtë fluturove dhe u prehe tash ku janë brigada oshënarësh dhe koret* e të drejtëve me gaz pa tregim përjet'.

E ke pranuar diellin* që asnjëher' s'perëndon, që u lind nga të përbrendshmet për mëshir'* nga grua; e përshkove leht', o e thjesht', tër' rrugën plot lav' edhe të vështir' asketike, duke djegur djajtë shkrumb,* dhe k'shtu zbute ti pasionet e mishit krejt.

E oshënares Theoktista

O Theoktista, nëna jon',* që jetove përmbi dhenë si engjëll, mir'po tash në qiej je* e barabart' me engjëjt absolutisht, si thotë fjala zotërore,[12] dhe Perëndinë e himnon me ta; lutu* për sa thurën himne edhe të lavdërojn'.

Hyjlindësore

O vajz', në duar sjell atë* që me një shenj' sjell të gjitha, çliromë pra me ndërmjetimin tënd* nga dora e të huajit dhe ndriçoje mendjen time me ndriçimin tënd, dhe të huaj bëmë nga pasionet tër'* që luftojnë kundër meje pa pasur turp.

Zbritësore: Apas jijenís

»**G**jithë njerëzit, kërceni me ngazë-
»llim tek drit' e Shpirtit Shenjt',* eni
»lavdërojeni;* engjëjt e q'ellit eni
»kremtojeni* sot Hyrjen e hyjnueshme
»të kryezonjës Mari* dhe thërrisni:*
»Ti je më e lumura,* Virgjëresh' e
»kulluar Hyjlindëse.*

Dërgimësore
E hierarkut
O uranón tis astris

Gëzohu Kish' e shenjtë,* këndo një këngë ti të re* për Nektarin mblesin, lajmës* i hyjshëm nusesh, birin tënd;* lëvdo atë që pak më par'* i shenjtëruar u duk qart'.

E oshënares Matrona
E ngjashme

Meqë e lartësove* mendjen mbi çdo kontakt tok'sor,* ece pa kthim, o Matrona* hyjmendëse, udhën e drejt'* të porosive të Zotit,* prandaj për ne lutu shumë.

E oshënares Theoktista
E ngjashme

Çudit, o oshënare,* jeta që bëre çdo dëgjim,* se luftove fort gjithmonë* me shpirt durues, Krishti pra* të lavdëron, Theoktista,* shkëlqyeshëm edhe dukshëm.

Hyjlindësore

Hyjnënë Vajzë, mbrojtja* e çdo besniku, na shpëto* të gjith' ne nga çdo dëmtim, kurth,* nga çdo komplot armiqësor,* dhe paraqitna tek yt Bir,* o Virgjëresh', të shpëtuar.

Lavdërime të hierarkut
Ting. I Ton uranion tagmaton

Të mbledhur një panair le të bëjm' me këngë ne,* sepse ësht' sot kujtimi* i Nektarit të hyjshëm,* që u lavdërua prej Krishtit ton'* para pak,

tashmë, me dhunti* shërimesh çuditërisht për hir dhe dobi* të besnikëve, se ish si drit'.

Si pellgu i Siloamit na duket, o Nektar,* kutia që ka brenda* pra lipsanet e tua,* se pushon sëmundje pa mjekim, at',* dhe përherë shpërndan çlirim* edhe shëndet tek ata që afrohen pran'* përmes energjis' së Shpirtit t' Shenjt'.

Kush do himnojë fuqitë e tua,[53] Shpëtimtar* Zot, siç e meriton ti,* se i dhe Kishës sate,* si një shtyll' të fortë dhe bazament* që nuk thyhet, Nektarin tënd* vërtet hyjfolës, i cili me përkushtim* të ka adhuruar sinqerisht.

Më shum' se era e arës së gjer', siç Krishti na tha,*[44] del kundërmim i mirë* nga lipsanet e tua* tepër të nderuara dhe dëfren* shqisat e besimtarëve,* Nektar i lumur, prandaj Egjina si sheh* hirin tënd të hyjshëm, të lum'ron.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

O atë oshënar, duke e bërë jetën studim të ligjit hyjnor, stampove në karakter jetën e shenjtorëve të vjetër; se pasi ia nënshtrove shpirtit mentalitetin e mishit,[54] bëre mirësi[55] dhe veshe oshënari[56] si hierark i hyjurtë dhe punëtor i vërtetë virtyti; prandaj u lavdërove shkëlqyeshëm prej Perëndisë, dhe krua terapish u duk tërësia e lipsaneve të tua me hijesimin e Ngushëllimtarit nga lart; ndaj, o Nektar i lumur, spërkati shpirtrat tanë me nektarin e hirit tënd dhe ndërmjeto pranë Zotit që të na japë përdëllimin e madh.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlind'se e virgjër dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që nuk çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanunet e hierarkut, Ode III dhe e oshënareve Ode VI. Apostulli i 12 dhjetorit dhe Ungjilli i 10 janarit.

Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] I Kor. 3.16; 6.19

[2] Matth. 9.15; 25.1; Mark. 2.20; Lluk. 5.35; Joan 3.29

[3] IV Makk. 1.7, dhe në të gjithë librin

[4] Matth. 25.10

[5] Ps. 41(42).5

[6] Ef. 5.16

[7] Matth. 24.12

[8] Hebr. 8.1

[9] Matth. 16.24; Mark. 8.34; Lluk. 9.23

[10] Apok. 3.12; 21.2,10

[11] Lluk. 2.37

[12] Lluk. 20.36

[12a] Ps. 44(45).2; 118(119).131; Jez. 3.27

[13] Ps. 44(45).2,10

[14] Gjen. 1.7; Is. 40.22

[15] Ef. 2.20-21

[16] Is. 9.6; Joan 14.27

[17] Vep. 10.38

[18] Mark. 1.40

[19] Matth. 10.38

[20] Ps. 131(132).5; Hebr. 9.2

[21] Eks. 14.16,21-22

[22] II Tim. 2.7

[23] Abak. 3.1-2

[24] I Kor. 15.45

[25] Gjen. 3.14-19

[26] Joan 1.12 etj.

[27] Matth. 13.8,23; Mark 4.8,20

[28] Fil. 2.7

[29] Is. 26.9

[30] Eks. 32.11 etj.

[31] I Kor. 1.30

[32] Fil. 4.7

[33] Fil. 2.16

[34] Ps. 118(119).120

[35] Rom. 14.9

[36] I Mbret. [Sam.] 1.15; Ps. 141(142).3

[37] Ps. 106(107).26

[38] II Mbret. [Sam.] 22.20; Ps. 4.2; 117(118).5

[39] Joan 5.35

[40] Ps. 37(38).4,8

[41] Jer. 17.11

[42] Ef. 1.23

[42a] Ps. 46(47).2

[43] Kënga 4.7

[43a] Is. 33.6

[44] Matth. 6.28; Lluk. 12.27

[44a] Dan. Kap. 3 Lutja e Azariut 34

[45] Dan. 3.25

[46] Apok. 7.17; 21.4

[47] Ef. 4.18

[48] Ps. 43(44).20

[49] I Tim. 4.7

[50] Eks. 40.11

[51] II Kor. 2.16

[52] Ps. 67(68).14

[53] Ps. 105(106).2

[54] Rom. 8.6-7

[55] (Ps. 13(14).1,3; 52(53).4; Rom. 3.12)

[56] Ef. 4.24

MË 11 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i martirëve të shenjtë Minait, Viktorit dhe Vikentit, edhe i martires së shenjtë Stefania; edhe i atit tonë oshënar dhe omologjet Theodhor Studiti.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani Hyjlindësorja dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi O besnikë, duke u mbledhur (Lavdi e Pasvargjeve të Lavdërimeve). Tani Hyjlindësore Ja ku u mbush parathënia. Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtorëve dhe Hyjlindësorja ngjallësore Misteri i fshehur. (Shërbesa e oshënarit psalet në Pasdarkë).

Të dielën në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor dhe i shenjtorëve. Pas Odes III, Ndenjësorja dhe Hyjlindësore e shenjtorëve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e shenjtorëve dhe Hyjlindësore e saj. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të shenjtorëve (Pasvargjet e Mbrëmësores, duke përsëritur të parën). Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e shenjtorëve. Apostulli i shenjtorëve. Ungjilli i së dielës.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime të martirëve
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

Duke imituar, o Mina, pësimin e Krishtit tënd,* që ësht' mbi çdo pësim, e dhe* veten si qengj për flijim* me vet'dashje, o athlofor;* nuk kishe frik' nga inat arkondësh kurr',* në letargji nuk re nga torturat pra;* sa rezistenc' të fort'* gjatë luftës sate kishe, përmes saj,* o martir, ke hedhur posht' përtok' fodullin[1] krejt.

Edhe pse me fshikullime shum' u çorre, edhe mbi dru* u tendose keq, si më par'* Zoti, dhe nga hekurat* brinjët kishe të thyera* në çdo an', nuk e mohove Krishtin ton',* emrin e tij, se shikoje tek ai* lart qëllimisht; dhe k'shtu* kur e shihje me këmb'ngulje k'të,[2] Mina,* o i lum, duroje dhimbjet ti në mishin tënd.

O Mina dëshmor, që psalesh shum' kudo, braktise plot'sisht* errësirën e

idhujve,* mjegullën e botës son',* bashk'jetesën me të pafe,* si dhe ushtrinë e kot' për dashurin'* e Krishtit ton'; u mobilizove[3] pra* tok me të zgjedhurit* e tij dhe u duke i paepur krejt,* o martir, vërtet, kur ti luftoje për këtë.

Të oshënarit Të ngjashme

O at', sipas emrit tënd vërtet prite dhurata mbi mend* lart nga qiejt, pastaj i dhe,* i përçove besërisht* tek sa donin, o Theodhor;* k'shtu shum'-fishove talentin, o i lum,* prandaj dëgjove zë të bekuar qart'* të të thërriste ty* brenda[4] nusërores[5] ku shëtit tani* dhe pran' fronit të të Gjith'-pushtetshmit dukesh ti.

At' i etërve, blatove turmë kallogjerësh me zell* tek Jisui, o Theodhor,* shkak shpëtimi ti ke qen',* Krishtin e imitove pra;* me mësimdhënie shum' lavdëroheshe* dhe me drejtim shpirtrash zbukuroheshe;* gojë e Krishtit ti* u dëfteve, o i urt', profetikisht;*[6] pran' atij tani qëndron, atje kujtona ne.

Hir i Shpirtit me bollëk u derdh, o njohës misteresh, shenjt,* përmbi buzët e tua[7] dhe* nga ti nxori një burim* mësimdhëniesh, o Theodhor;* të paraqiti ty si burim, ushtar* të së vërtetës dhe mbrojtës për besën,* shtyllë dhe bazament*[8] të besimit orthodhoks, kanun të sakt'* jete monakale, o i tërëurtë at'.

Lavdi *Ting. Tërth. II*
I Bizantit

Përsëri na lindi kujtimi i përvitshëm i ndriçuesve të botës,[9] Minait, Viktorit dhe Vikentit, duke ndriçuar zemrat e besnikëve me ndeshjet e kryqit të tyre për Krishtin; prandaj, le ta nderojmë me himne Krishtin Perëndi, i cili i kurorëzoi me lavdi dhe nder.[10]

Tani *Hyjlindësore*
Triímeros anestis

U denjësove, o Virgjëresh'* e d'lirë dhe e vetmja nën'* Perëndie,* për dhurata të mëdha,* se linde në mish një prej Trinis', Jisun' që jep jet'* pra, për çlirimin dhe shpëtimin ton'.

ose Kryqhyjlindësore

Kur shihte nëna jote e d'lir',* e virgjër, popullin e keq,* të paligjshëm* të të ngulte ty në dru* padrejtësisht, siç profetizoi Simeoni,* përbrenda saj plagosej hidhërisht.[11]

Pasvargje të martirëve
Ting. IV
Os jeneon en mártisin

O Mina, nuk mohove dot* emrin tër'shpëtimtar, të madh* të Jisuit, kur

shpoheshe me gjemba thell',* kur fshikulloheshe me kërbaçë, kur prisheshe në trup* me zjarr; s'u nënshtrove dot* në mendim, nuk flijove kurr'* tek statujat ti,* por u bëre therore duke dashur, dhe flijim perfekt, i pastër[12] tek Zoti yt, o martir me nam.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

Ti u shpove në sy tmerr'sisht* dhe u vare mbi dru mjerisht,* me llambadhe gjithkund të përvëluan ty,* nga ashpërsi e gjykatësit u preve në nerva keq* më pas prenë kreun tënd,* por, o Viktor, gëzoheshe,* o atlet me lavd* i Çliruesit, që mbi çdo rreshtim armiqësor ti ke fituar me bashk'punimin e Shpirtit t' Shenjt'.

Varg: Tek shenjtorët që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

Me kurorën e hireve* Zoti të zbukuroi ty,*[13] o atlete në shumë gara, Stefani,* se duke dashur e dorëzove veten në torturim* me një trimëri të gjall'* dhe u lidhe në dy hurma,* dhe u ndave krejt;* fluturove tek Perëndia k'shtu si harabel[14] dhe le në duart e gjuetarëve mishin tënd.

Lavdi *Ting. Tërth. II*
I Bizantit

O atë oshënar, në gjithë tokën doli zëri[15] i arritjeve të tua, prandaj në qiejt gjete shpërblim[16] për lodhjet e tua; asgjësove batalionet e demonëve, arrite brigadat e engjëjve, jetën e të cilëve e kishe zili në mënyrë të paqortueshme; duke pasur guxim ndaj Zotit, kërko paqe për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*
Triímeros anestis

Ja syt' e zemrës sime i shtrij* tek ti, un',[17] o Zonj', mos shpërfill* psherëtimë* shum' të hidhur; në orën* kur do gjykojë Biri yt botën, pra at'herë* për mua ji ndihm' edhe streh' e ngroht'.

ose Kryqhyjlindësore

O Krisht, kur të shikonte mbi kryq* të kryqëzoheshe ajo* që të lindi* po thërriste: Biri im,* ç'ësht' ky mister i huaj që shoh? Si vdes në mish ti* mbi dru i varur, o jet'dhënës Zot?

Përlëshore e martirëve

Dëshmorët e tu, o Zot, në ndeshjen e tyre, fituan kurorën e mosprishjes prej teje, Perëndisë tonë; se duke pasur fuqinë tënde, i mposhtën tiranët dhe thyen ambicjet e pafuqishme të demonëve; me lutjet e tyre, o Krisht Perëndi, shpëto shpirtrat tanë.*

ose Tahí prokatálave

Atletët e grupit trinisor të Zotit' ton'

Krisht,* të gjith' ne me simfoni le t'i nderojmë si shkatërrues të djallit krejt,* pra me Minan' e famshëm* dhe Viktorin, Vikentin;* bashk' me k'ta Stefanin' e hyjshme le ta lëvdojmë.* Me lutjet e tyre, o Krisht, na mëshiro gjithnjë.

E oshënarit
Ting. Tërth. IV

O udhëzues i Orthodhoksis', mësues shpresëtarie edhe thjeshtësie, ndriçues i botës,[9] zbukurimi i hyjfrymëzuar i monakëve, o Theodhor i urt', me mësimdhëniet e tua i ndriçove të gjithë, kitarë e Shpirtit; ndërmjeto te Krishti Perëndi që të shpëtohen shpirtrat tanë.*#

Përdoret për Etër mësues të Kishës.

ose Ting. III Thias písteos

U dëfteve qart'* pjes'tar dhuratash* të paprishura;* dhurat' që s'vidhet* je për Kishën, Theodhor, sipas emrit tënd;* meqen'se shkoje pas dogmave të hyjshme,* ndriçues omologjie u bëre ti;* pranë Krishtit Perëndi lutu, atë oshënar,* të na dhurohet neve përdëllim i madh.

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së zakonshme, Kanunet: një i Oktoihut dhe dy të shenjtorëve.

Ode I
Kanuni i martirëve, që ka Akrostihidhë: "Të nderojmë ty, o Mina martir, me fjalë besimi. I Theofanit".

Ting. IV Anikso to stoma mu

Tani që kujtimin tënd po e nderoj, o Mina me fam',* së bashku me luftrat që ke bër' me shum' trimëri,* lutu që nga lart* të më dërgohet dritë,* shkëlqim që përzën re padijeje larg nga un'.

Meqen'se dëshirë kishe të shikosh pavdek'sin' e plot'* të ardhshme, ti deshe me ndëshkim të vdesësh, martir;* imitove k'shtu* pësimin e atij që* rrëzoi me vdekje po vdekjen, Mina i urt'.

Meqen'se s'duroje të shikosh Jisuin të shahej rënd',* në male të largëta jetoje[18] dhe bëje mir'* ti stërvitjen pra* për luftë dhe për ndeshje;* prandaj me qëndres' të fort' i përballove k'to.

Hyjlindësore

E zë si tryez' të gjall', o Zonjë, bukën[19] e jetës son',* megjith'se e mbajte

zjarrin, nuk u dogje si ferr';*[20] dhe si një hardhi* që nuk vaditet, nxjerr ti* bistakun e pakultivuar, o e tër'd'lir'.

Kanuni i oshënarit, që ka Akrostihidhë: "Theodhorin e lavdishëm me këto këngë e lavdëroj. I Theofanit".

Ting. Tërth. IV
Armatilatin Faraó

Nga llamburitjet dritërrezatuese të Shpirtit kishe ndriçim* dhe u bëre shtyllë* e tër'shndritur duke udhëhequr,[21] o at' Theodhor,* sa nxitoheshin drejt tokës së premtuar[22] hyjmendërisht,* o hyjfolës, o i mahnitëshëm.

Ishe shpërngulur krejtësisht me pririe të paepur drejt Perëndis'* para vdekjes sate,* pra u pe i veshur ti me vdekjen jetëprurëse,*[23] oshënar, dhe tani jetën që nuk plaket fitove qart',* si i denj', hyjmbajtës at' Theodhor.

Pasi fitove, o i lumur, ti mbi hovet e pasioneve* dhe diskreditove,* si i ri në mosh', të gjitha vrullet e tiranëve,* me një shpirt guximtar thoje të nderojnë ikonat thell',* Theodhor, që kan' Krishtin dhe çdo shenjt.

Meqë në Shkrimet e hyjfrymëzuara[24] thelloheshe shumë shpesh* me mendim të pastër,* o i tër'urt', mblodhe pasuri virtytesh, dogma bashk',* që ka besa e drejtë, dhe teori me shkëlqim në jet';* shndrite praktikisht dhe teorikisht.

Hyjlindësore

E paqortueshme, Hyjlind'se, linde me mish Fjalën Zot, Perëndin',* të patrup më parë,* që mbi mend si Perëndinjeriu kishte shoqëri* brenda botës;[24a] prandaj ne të gjithë të lavdërojmë ty;* je pas Perëndis' mbrojtëse për ne.

Ode III
E martirëve: Uq en sofia

Pa pik' mëshire* dhe me nerva të forta kau, të rreh* ty tirani, që u zmbraps* me fjalët e urtësisë që the;* kot mendonte, o Mina, se do përkuleshe.

Duke vëzhguar* ti drejt Zotit me sytë mendorë[2] krejt,* e durove çdo tortur',* mundim të ashpër në mishin tënd* me vendosmëri trimërisht, o Mina me nam.

S'u frikësove* nga mundime të tmerrshme torturash ti,* rrezatoje zell hyjnor;* në ndeshje hyre, thërrisje fort:* Erdha i paftuar, megjith'se s'kërkohem un'.

Hyjlindësore

O e panjollshme,* vdiqa unë nga

ngrënie dinake, nga* një dru;[25] më ka nxjerrë jasht'* derës së Hadhit[26] ai që ka marr'* mish nga ti, kur vdekjen e priti vullnetarisht.

E oshënarit: O stereosas kat' arhás

Me armatim prej Krishtit tënd,* o i tër'urt', i forcuar,*[27] i pësove dhimbjet, plagët prej rrahjesh* çnjerëzore me kamxhik dhe pranga në err'sir', në burg;* more pjes' në pasion ti,* more pjes' dhe në mbret'rin' e tij.[28]

Hyjmbajtës ishe qartësisht,* pishtar i ndezur prej zellit;* mësimdhëniet e përdhosura pa mend* i shpërbëve me doktrinën tënde, o i tërëurt',* o Theodhor, i pasur* me hir të Zotit dhe Krishtit ton'.

Në teori njeri praktik* dhe theolog në veprime* qart' ke qen', o Theodhor at', asket ti* didaktik dhe hieromartir i lavdërueshëm,* shtyll' e Orthodhoksisë,* bazë e fortë e Kishës son'.[8]

Hyjlindësore

Meqë të gjeti më të shenjt',* o Hyjnën', ty se çdo gjë tjet'r, * Fjala, Zoti, Perëndia pa nisje* bashk' me Atin dhe me Shpirtin, pasi donte rinovim* të bënte tek stërati,* e mori prej teje në substanc'.

Irmosi: O stereosas kat' arhás

»**T**i që formove në fillim* me mençuri »dhe mend qiejt,*[29] dhe mbi ujëra »bazove fort dheun,*[30] më forco mbi »gurin,[31] Krisht, të porosive që ke »dhën',* o njeridashës, sepse* veç »teje tjetër të shenjt' nuk ka.[31a]

Kontaqi i oshënarit
Ting. II Ta ano zitón

Atlet asketik,* me mundje zbukurove ti* gjith' jetën tënde* të barabart' me engjëjtë* dhe u duke bashk'banues me ta,[32] o i lumur Theodhor;* lutju tok me ta Perëndis',* gjithmon' ndërmjeto për ne pran' Krishtit, o at'.

Ndenjësore e martirit
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

O Hyjmendës, Egjipti, që rob më par'* brenda prangash err'sirë të tmerrshme ish,* pa dije pra, o Mina,* o martir, të ka lindur ty* si një ndriçues për botën mbar',[9] që dëbon tej larg* me rrezet e luftimit të hyjshëm që ti ke bër',* natë ateizmi; ndaj festojm' ditën tënde* drit'prurëse me respekt* dhe thërrasim tek ti me gaz:* Zbukurim i* atletëve,* ndër-

mjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Lavdi *I oshënarit*
Ting. III
Thias písteos

Me sakt'si dogmash* u pasurove* dhe shpëtove krejt* besimin tonë* orthodhoks, si pararojë në çdo rrezik;* pësove, o Theodhor, internime ti* dhe fshikullime, durove burgime keq;* lutju Krishtit Perëndisë, o atë oshënar,* të na dhurojë neve përdëllimin e madh.

Tani *Hyjlindësore*

Je bër' Virgjëresh',* tendë e hyjshme*[33] krejt për Fjalën Zot,* e d'lir' e vetme;* epërsin' në pastërti e ke mbi engjëjt;* i ndyrë jam më shum' se gjithë njerëzit,* me shum' mëkate mishore,[34] pastromë pra,* me rrëke të ndërmjetimeve pranë Birit tënd;* më jep ti përdëllimin e madh, o e thjesht'.

ose Kryqhyjlindësore

Shqerra e panjoll'* e Fjalës, Zotit,* Virgjërnëna krejt* e pacenuar,* duke parë të varej mbi kryq ai* të cilin e lulëzoi pa dhimbje dot,* siç bëjnë nënat thërriste me klithm' e vaj:* Mjer', o Biri im, si vuan, se do që të shpëtosh* njeriun nga pasione shum' të turpshme[35] ti.

Ode IV
E martirëve: O kathímenos en dhoksi

Me spërkatjen e gjakut tënd u shojtën qymyrët e politeizmit, batalion demonësh u vithis[36] dhe u vadit Kisha e Krishtit, o athlofor i tërëlumur, Mina i admirueshëm.

Me varjen në dru ikonizon pësimin e Kryqit, i cili vrau gjarprin e hidhur,[37] o dëshmor, ndërsa duron çjerrje që të shkaktojnë ty shijime në qiejt, o trim i madh.

O atlet, përjetove dhimbje të mbinatyrshme, sepse dashuria hyjnore që mbizotëroi në natyrën tënde bënte që t'i harroje, o Mina, duke të nxitur që të jepesh i ngazëlluar në mundime.

Hyjlindësore

Linde Perëndinë, që u mishërua në mënyrë të papërshkrueshme nga gjaku yt, duke ndërtuar shtëpi për vete,[38] i cili njihet në dy substanca dhe vullnete, siç duhet për Hyjninë, o Nuse pa përvojë dasme.

E oshënarit: Si mu iskís Kírie

Je dhënë si dhuratë Perëndie tek

bota, o Theodhor, sipas emrit tënd, duke feksur me hire të pasura, sepse ke vërtet burimin e vezullimeve që dalin prej andej; prandaj u denjësove të kërcesh bashkë me tërësitë e mësuesve, asketëve dhe martirëve.

O rezistenca jote e fortë dhe e dureshme! Me atë ke shkelur arrogancë tiranësh; me atë qartësisht pushtove ti lumturinë e skajshme mbimendore të epërsisë së mirësisë, o hyjmendës, duke bashkëpsalur me të patrupët: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

Pasi banoi tepër dukshëm në ty fjalë Perëndie,[39] o Theodhor i tërëurtë, buron me bollëk lumenjtë e dogmave; duke i shijuar ne nxënësit e tu këto, o i hyjfrymëzuar, thërrasim me kënaqësi me zëra pa heshtur: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

Hyjlindësore

Ripërtërit në ty njeriun e tërë, duke u bashkuar i tëri me të tërin, o e Tërëkulluar, ai që nuk e braktisi kraharorin atëror[39a] dhe denjoi të banojë në barkun tënd, ai që u varfërua vullnetarisht nga pasuria e dhembshurisë dhe pasuroi botën[40] me hyjni.

Ode V

E martirëve: Asevís uk ópsonte

Shkëlqeve hijshëm me llamburitje martirizimi duke errësuar ateizmin e zymtë, o i tërëurtë, dhe ndriçove së tepërmi tërësitë e besimtarëve, o Mina, atlet i tërëfamshëm.

Uzhduk çdo dredhi armiqsh me anën e durimit tënd të fortë; as uri, as kamxhikime,[41] as djegie, as mundim gjembash nuk e errësoi gatishmërinë tënde.

Hyjlindësore

Duke u lindur prej teje mbinatyrshëm Çliruesi, më ripërtërit mua që u prisha, duke më çliruar nga mallkimi i vjetër,[25] o Hyjnënë e papikëluar; atij lutju që të shpëtohemi.

E oshënarit: Inatí me aposo

Mendjen, shpirtin dhe trupin pasi i pastrove me logjikë, u shndërrove në tempull të tërëçmuar të Perëndisë[42] të të gjithave, o atë Theodhor, dhe i ofrove tërë veten tënde Krishtit si flijim erëkëndshëm,[43] duke u bërë prift dhe therore.

Duke u shndritur, o i lum, me lavdinë e Shpirtit, flakërove tek të gjithë me gjuhë theologu llamburitjen e papërlyer të Trinisë, edhe misterin e pathënë të mishërimit mbimendor të Fjalës Perëndi, o atë.

Duke u shoqëruar tani me engjëjt

mendërisht,[32] përgjëro Krishtin që të shpëtohen nga pasione dhe rreziqe ata që të lumërojnë dhe nderojnë kujtimin tënd të tërëlavdëruar dhe të hyjshëm, o atë Theodhor, i vyer për lumërim.

Hyjlindësore

Pasi banoi në ty me një mënyrë të pashprehshme, o Virgjëreshë, bëhet njeri ai që shkëlqeu para jetëve nga Atë, e çliron njeriun nga prishja dhe e rikthen drejt jete dhe paprishjeje, si i vetëm njeridashës.

Ode VI
E martirëve: Evóise protipón

Pa dhembje je,* edhe pse konsumohesh prej zjarrit ti,* dhe me lecka* qimesh prej dhish gërvishtesh në brinjët rrept',* sepse Hir i hyjshëm* duke qen' pranë, të fuqizonte ty.

Qëndroje fort* në tribunë tiranësh në gjyqe[44] ti;* kritikoje, o Mina i këndu-ar, mashtrimin k'shtu,* ndaj e jepje veten* tek besnikët si shtyll' bese pa tundim.

O athlofor,* djersa jote na thau mashtrim të keq* idhujsh pa zë*[45] edhe veten e nd'rrove, e ngrite si* tempull të Triadhës*[46] së nderuar, Mina i mahnitshëm fort.

Hyjlindësore

Shëroje ti,* o e tër'paqortueshme, çdo pasion* që s'mjekohet,* që mundon shpirtin tim, me fashën e bardh'* nga mir'sia që ke,* sepse linde për ne shpëtimtar të mir'.

E oshënarit: Ilásthití mi Sotír

O Theodhor, o i lum,* me shum' mençuri kalove jetën tënde, me drejtësi,* me mendje, me trimëri;[47] për veten ndërtove ti* një karroc' të hirshme* me virtyte, o hyjmendës at'.

Lëshojnë er' me arom'* fjalimet e tua të hyjshme që the për dogmat; na nxjerr* nga fundi i herezive ne të gjith', o i urt',* dhe na lartëson k'shtu* për në majën e Orthodhoksis'.

Ka lindur drita për ty* dhe shoku i saj gëzimi,[48] o at', qart' tani, se si pem',* si hurmë, u lulëzove, o Theodhor i urt',* dhe u shum'fishove* si një kedër,[49] pra të admirojm'.

Hyjlindësore

Me ty shpëtofshim, Hyjnën'* e tër'paqortueshme, dhe le të gjejmë me të vërtet'* hir drite të hyjshme, o Hyjlind'se pa njoll' aspak,* nga ai që mori* mish prej teje, Bir' i Perëndis'.

Irmosi: Ilásthití mi Sotír

»**M**ëkatet që kam jan' shum',* ndaj

»Ie të të vijë keq, o Zot,* për mua;
»lutem, më nxirr* nga fundi i vrereve,
»sepse thirra fort tek ti,* dhe dëgjomë
»mua,* Perëndia i shpëtimit tim.

Kontaqi i martirit
Ting. IV Epefanis símeron

Athlofor Mina i madh,* të ka rrëmbyer* nga ushtri e kot', pa vler'* dhe të tregoi pjesëtar* të një ushtrie që s'prishet[3] dot,* Krishti, kurora pa cen e martirëve.

Shtëpia

Kujtimi i martirëve është shkak hareje të madhe për ne, sepse me hir të hijshëm dhe butësi omologjie shfaq burrëri kundër pasioneve dhe arritje kundër armiqve. Ejani pra, o kremtimdashës, të gjithë le të dëfrejmë në të me ngazëllim më të mirë dhe më të përsosur se ai i përkohshëm, duke bërë kujtimin e atletit Mina dhe duke marrë dhuratë zgjidhjen e veseve. Pra dhënës i atyre është Perëndia yn', Krishti, kurora pa cen e martirëve.

Sinaksari

Më 11 të të njëjtit muaj, kujtimi i martirit të madh e të shenjtë Mina në Kotiajin.

Vargje: Në qoftë se Egjipti lind, lind vërtet diçka të madhe,/ këtë e dëfton si të vërtetë Minai, pasi u pre.
Më 11 pësoi shpatë Minai, një zemër e gëzuar.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Viktor.
Vargje: Nuk frikësohej as Viktori para shpatës,/ pasi e vuri diku larg nga zemra frikën.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Vikenti, dhjak.
Vargje: Kur u hodh në burg Vikenti, duroi,/ ndërsa kur u zgjidh nga burgimi mishor, rendi lart.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së shenjtë Stefania.
Vargje: Kur u lidh Stefania në pemë palmash,/ u lulëzua si feniks[49] në mes të martirëve.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Theodhorit, igumen i Studiut.
Vargje: Shumë shpërblime, o Theodhor tri herë i lumur, prit,/ pasi u largove nga jeta, se jetove mirë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë të lumur, oshënar Maksim rusit, i marrë për Krishtin, mrekullibërës në Moskë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
E martirëve:
O dhiasosas en pirí

I zhveshe ti bashkë me plagët këmishat prej lëkure të mëkatit[50] dhe u veshe me stoli që nuk pranon vjetrim më, o i lumur, të cilën e thuri Hiri kur u shfaq.[51]

Me djegien e luftërave të tua të shumta dhe të respektueshme, o dëshmor, shkrumbohet ateizmi dinak me gjemba,[52] dhe me rrjedhjet e gjakut shuhet zjarri brambullitës i injorancës, o i tërëlumur.

Duke pasur dhurata të bollshme, buron edhe çudi tek ata që bëjnë të kremten tënde të respektuar, o Mina, i denjë për admirim, dhe bashkëpunon me ata që psalin: O Perëndi i etërve, je i bekuar.[52a]

Hyjlindësore

I bekuar është fryti i barkut tënd të bekuar,[53] të cilin e bekojnë Fuqitë e qiejve[54] dhe sistemet e të vdekshmëve; ai na çliroi prej mallkimit të lashtë,[25] o e bekuar.

E oshënarit: Theú singatávasin

Paranjohësi duke parë pastërtinë e mendjes sate, të tregon ty, o atë, udhëheqës qengjash mendorë; atij tani, o i tërëlumur Theodhor, i thërret: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[52a]

O Theodhor tri herë i lumur, i faleshe vazhdimisht ikonës së hyjshme të trajtës njerëzore të Krishtit, duke i kundërshtuar perëndiluftuesit deri në vdekje[55] dhe duke psalur: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[52a]

Fjala jote, o Theodhor, u duk me shije e me kripë,[56] dhe jeta jote, o atë, e shkëlqyer nga lavdia e Shpirtit; me të duke feksur thërret i gëzuar: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[52a]

Hyjlindësore

Ja ku u mbush parathënia e hyjshme e Davidit të hyjnueshëm; me të vërtetë bëjnë litani para faqes sate, o Hyjlindëse e kulluar, ata që zotërojnë pasurinë[57] e Hirit[58] dhe bekojnë Perëndinë e etërve tanë.

Ode VIII
E martirëve: Pedhas evajís

U shfaqe si bukë që piqej në mes të zjarrit që digjej, si flijim pa të metë,[59] si therore e përsosur, si sakrifikim i gjallë, duke u bërë holokaust dhe duke lëshuar erë të këndshme dhe të hyjshme, të cilën e nuhati Perëndia,[43] o Mina, shërbyes i Perëndisë.

Kur zvarriteshe, o martir, dhe kur

shpoheshe me gjemba të mprehtë, dërrmove thumbat e të fëlliqurit, ndërsa kur priheshe me shpatë, si në ekstazë, i preve me armë besimi kokat[60] e të paligjve, o athlofor, duke kënduar: E bekoni Krishtin përjetë.

Pasi u zgjidhe nga mishi me goditjen e shpatës, u lidhe më me përsosmëri në dashurinë e Zotit tënd, o dëshmor; dhe tani e shikon faqe më faqe,[61] duke u hyjnizuar, o Mina, dhe i këndon: Zotin e himnoni vepra dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Banon në barkun tënd përmbi mend, ai që me fjalë krijoi të gjithë Krijesën;[62] dhe shfaqet foshnjë që lindet prej teje, ai që përpara jetëve, o e pacenuar, lindi prej Atit, të cilin e bekon dhe e lavdëron çdo krijesë, o Perëndilindëse, në gjithë jetët.

E oshënarit: Eptaplasios káminon

I tregove të zmbrapsur shpikësit e herezive të besë së keqe, o Theodhor hyjmbajtës, dhe na mësoje t'i falemi me nder ikonës së papërlyer të Krishtit, ta respektojmë dhe ta nderojmë hyjmendërisht, dhe t'i këndojmë Zotit: O priftërinj, e bekoni, popull, e përmbilartësoni në gjithë jetët.[62a]

Gjatë gjithë jetës sate, o Theodhor hyjprurës, u bëre udhëheqës i Orthodhoksisë, ndriçues tepër i shkëlqyer, mësues me pamje të hyjshme, model monakësh dhe ligjshkrues i saktë, duke na mësuar që të këndojmë: O priftërinj, e bekoni, popull, e përmbilartësoni Krishtin përjetë.[62a]

Mbi dhé luftove dhe u bëre mësues i besës së mirë dhe mbrojtës jo i gënjeshtërt i së vërtetës, o i tërëlumur, ndërsa në qiej je dhuratë e Perëndisë; veshe kurorat e drejtësisë, pasi kreve udhën dhe ruajte besimin,[63] meqë e lavdërove Krishtin në gjithë jetët.

E ndriçove mendjen përmes njohurisë, dëshirën përmes mençurisë dhe ndjenjën e ngjeshe me burrëri,[47] duke i drejtuar, o Theodhor i tërëurtë, me drejtësi fuqitë e tua shpirtërore, siç u ka hije priftërinjve, dhe këndoje me harmoni: O priftërinj, e himnoni, popull, e përmbilartësoni Krishtin në jetët.[62a]

Hyjlindësore

O Zonjë e bekuar, traumat e shpirtit tim dhe shenjat e plagëve të mëkatit shuaji, ti që në bark virgjëror dhe pa eksperiencë dasme e mbajte gjatë shtatzënisë Perëndinë që është mbi të gjitha,[64] o Vajzë e pastër; atë Djema e bekojnë, priftërinj e himnojnë, popuj e përmbilartësojnë në gjithë jetët.[62a]

Irmosi: Eptaplasios káminon

»**E** dogji furrën shtatë her'* në Kalde »një tiran i saj* me mani për Djemtë* »që nderonin Zotin shum';* por kur të »shpëtuar krejt* i pa nga një fuqi më »e fort',* k'shtu thërriste ky:* Po Çli»rimtarin dhe bër'sin,* ju Djema, e »bekoni,* ju prift'rinj, e himnoni,* ju »popull, lartësoni atë për gjithë jetët.

Ode IX

E martirëve: Eva men to tis parakoís

O i lumur, toka trupin tënd të fort' tani* që mbaroi luftën e mbulon,* por shpirtin tënd e mbajnë qiejt* së bashku dhe me shpirtra martirësh lart;* gëzohet me lavdi dhe shkëlqen nga drit';* pra ne të gjith' të lumërojmë ty.

Bashk' me engjëjtë banon në drit', se zgjodhe ti* jet' të barabart' me engjëjtë;*[32] sheh përmes mendjes së pastruar* drejt hijeshis' së Zotit, Mina me nam;* ndriçohesh pra pasurisht i shkëlqyer fort* me drit' që derdhet prej andej, martir.

Ke par' Krishtin që ti aspiroje, dhe shijon* hyjnizimin, o i famshëm shum';* kape dëshirën, se arrite* në majën e dëshirave, o Mina;* kujtona ne që me mall bëjm' kujtimin tënd,* festën që është e hyjnueshme.

Hyjlindësore

Mbajte Fjalën Perëndi në shtatzëni për ne,* në substanc', në mish, o Virgjërnën';* pra duke shpallur me gjuh', zemër,* se ti absolutisht je Hyjlindësja,* ja zërin e Gabrielit të themi ty,* th'rrasim: Gëzohu, Zonj'[65] e Gjithësis'.

E oshënarit: Eksesti epi tuto

Me çurga lotësh ti si asket i madh,* me burimet e gjakut bashk', si martir për Krishtin tënd,* je ndriçuar, feks me të dyja bashk';* ke veshur drejtësi si prift*[65a] edhe në pallatin e hyjshëm tash* kërcen brenda me plot gaz* në qiejtë,[66] o atë,* rreth Perëndisë ton', o Theodhor.

Vrapove tërë udhën tënde, o at',* shenjtërisht dhe në tendat e shenjtëve tash po banon,* dhe ke marr' kurorë paprishjeje*[67] dhe petkun mbretëror të shenjt'* edhe madhështor; ndaj dhe me këto* je lavdëruar ndritshëm,* qëndron pran' Zotit tënd ti* me shum' hare, o Theodhor i lum.

U denjësove, o Theodhor martir,* mirësin' dhe burimin e saj ta shikosh, se vërtet* ti e ke kaluar tër' jetën mir'* dhe perëndishëm, pra kështu* përmes sjelljes autentike krejt* çlirove mendjen tënde* nga lidhjet

botërore;* ndaj shfaqesh me kuror' shkëlqyeshëm.

Dhuratë Perëndie ësht' zëri yt* edhe fjalët e tua jan' si bubullim', o i urt'* Theodhor, dëgjohen gjer' në çdo an'* të botës;[15] dhe porsi lumenj* na buron doktrina mësimi yt;* prandaj dhe si hyjfolës* të hyjshëm dhe të hirshëm* të lumërojm' tani ty denjësisht.

Hyjlindësore

U shfaqe nënë Zoti, o Virgjëresh',* mbi natyrë, kur linde me trup dhe mish Fjalën e mir',* që nga zemra Ati e nxori[68] tër'* përpara gjithë jetëve,* se ishte dhe është gjithmon' i mir';* k'të e konsiderojmë* se dhe tani ësht' më tej* se çdo trup, edhe pse ka veshur trup.

Irmosi: Eksesti epi tuto

»U shtang dhe u shastis qielli për »k'të,*[69] u habitën dhe anët e botës »mbar',* se Perëndi* trupërisht u »duk[70] tek të vdekshmit qart'* dhe »barku yt u bë, o Zonj',* më i gjer' se »qiejt dhe se çdo vend;* pra, o Perë- »ndilind'se,* grupimet njerëzore* dhe »engjëllore të madh'shtojnë ty.

Dërgimësore e martirëve
O uranón tis astris

Yjet të gjithë qiejt* i zbukurojnë,[71] o i Mir',* ndërsa Kishën e stolisin* shën Stefania, Viktori,* Vikenti edhe Minai;* përmes atyre shpëtona.

E oshënarit E njëjtë

Durove çdo shtrëngim ti,* torturë, edhe internim,* k'to të gjitha për ikonat* e hyjshme; ndaj pranove k'shtu* kuror' të dyfisht' nga dora* e djatht', o at', e të Lartit.[72]

Hyjlindësore

Më ty, o Vajz' e kulluar,* me të vërtet' u shfaqën qart'* ecjet zotërore;[73] njer'zit,* ne na drejtojn' aty ku jan'* ushtrit', të gjith', kore engjëjsh* edhe shenjtorësh së bashku.

Pasvargje të Oktoihut
Pastaj:

Varg: Tek shenjtorët që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

Idhiomeli Ting. II

Ejani atletëdashës, le ta nderojmë korin me ndriçim të trefishtë të martirëve Mina, Viktor dhe Vikent, sepse dhanë gjakun dhe blenë jetën e amshuar; prandaj edhe i kundërshtonin me durim zbuluesit e të këqijave duke thënë: Nuk i preferojmë të prishshme para të paprishshmeve; nuk mobilizohemi për një mbret tokësor të

vdekshëm, por rreshtohemi për Mbretin e gjallë, i cili u thërret gjithnjë besnikëve: Ai që beson tek unë, edhe nëse do të vdesë, do të jetojë.[74]

Lavdi *Ting. I*
I Anatoliut

O besnikë, duke u mbledhur le ta lavdërojmë me lartësime martirike dhe këngë shpirtërore[75] Minain e kënduar, triumfuesin e Krishtit, sepse ai u fut në luftë kundër armiqsh të padukshëm dhe pasi luftoi sipas rregullave, pranoi denjësisht çmimin e fitores.[76] Dhe tani që në qiej kërcen tok me engjëj kërcimin e pandalur, kërkon për botën paqen dhe përdëllimin e madh.

Tani *Hyjlindësore*
Panéfimi mártires

Banesë e dritës, o e d'lir',* e atij që shndriti fort* nga Ati, ke qenë vetëm ti; prandaj ty të thërras:* Shpirtin tim të errët* nga pasionet ma gëzo me dritën e virtytit; vendose k'të në tendat që i ke* të tër'ndritshme, n' atë dit', të lyp,* kur do bëhet gjyqi botëror, o Zonj'.

ose Kryqhyjlindësore

Ndërsa therjen tënde të padrejt'* e shikonte, Krishti im,* Zonja e virgjër vajtonte dhe thërriste: Biri im* shum' i ëmbël, si po* vuan padrejt'sisht? Mbi dru si varesh ti që vare mbi ujërat tër' tokën?[30] Mos më lër* mua vetëm, shërbëtoren dhe* nënën tënde, o i shum'mëshirëshëm.

CITIME

[1] Sof. 3.6

[2] Vep. 7.55

[3] II Tim. 2.4

[4] Matth. 25.14-21

[5] Matth. 25.10

[6] Jer. 15.19

[7] Ps. 44(45).3

[8] I Tim. 3.15

[9] Fil. 2.15

[10] Ps. 8.6

[11] Lluk. 2.35

[12] Gjyq. 20.26

[13] Fja. Urt. 1.9

[14] Ps. 123(124).7

[15] Ps. 18(19).5

[16] Matth. 5.12; Lluk. 6.23,35

[17] Ps. 122(123).2

[18] Ps. 54(55).8

[19] Eks. 25.29; 39.18; 40.20-21; Lev. 24.5-6; Hebr. 9.2

[20] Eks. 3.2

[21] Eks. 13.21

[22] Hebr. 11.9

[23] II Kor. 4.10

[24] II Tim. 3.16

[24a] Varuh. 3.38

[25] Gjen. 3.6,19

[26] Urt. Sol. 16.13

[27] Ef. 6.13

[28] II Kor. 1.7

[29] Ps. 32(33).6

[30] Ps. 135(136).6

[31] Ps. 39(40).3

[31a] I Mbret. [Sam.] 2.2

[32] Matth. 22.30; Lluk. 20.35-36

[33] Ps. 131(132).5; Hebr. 9.1-2

[34] Juda 23

[35] Rom. 1.26

[36] Matth. 8.30-32; Mark. 5.9-13; Lluk. 8.30-33

[37] Apok. 12.9; 20.2

[38] Fja. Urt. 9.2; I Kor. 1.24

[39] Kol. 3.16

[39a] Joan 1.18

[40] II Kor. 8.9

[41] Rom. 8.35

[42] II Kor. 6.16

[43] Lev. 1.9,13; Ef. 5.2; Fil. 4.18

[44] Matth. 10.18; Lluk. 21.12

[45] Ps. 134(135).15-16

[46] Joan 14.23

[47] Urt. Sol. 8.7; IV Makk. 1.6,18

[48] Ps. 96(97).11; Is. 58.10; Joan 5.35

[49] Ps. 91(92).13

[50] Gjen. 3.21

[51] Tit. 2.11

[52] Ps. 117(118).12

[52a] Dan. Kap. 3 Lutja e Azariut 28

[53] Lluk. 1.42

[54] Ps. 148.1-2

[55] II Makk. 13.14; Sirak 4.28

[56] Kol. 4.6

[57] Ps. 44(45).13

[58] Ef. 1.7; 2.7

[59] Lev. 22.21-24; Num. 28.31 etj.

[60] Abak. 3.14

[61] Eks. 33.11; I Kor. 13.12

[62] Gjen. 1.3,6,9,11,14-15,20,24; Ps. 148.5

[62a] Dan. Kap. 3 Lutja e Azariut 61 - 65

[63] II Tim. 4.7-8

[64] Rom. 9.5

[65] Lluk. 1.28

[65a] Ps. 131 (132). 9

[66] Ps. 131(132).9

[67] I Kor. 9.25; I Petr. 5.4 etj.

[68] Ps. 44(45).2

[69] Jer. 2.12

[70] Joan 1.14; I Tim. 3.16; Kol. 2.9

[71] Sirak 43.9

[72] Urt. Sol. 5.16

[73] Ps. 67(68).25

[74] Joan 11.26

[75] Ef. 5.19; Kol. 3.16

[76] II Tim. 2.5

MË 12 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Joan Përdëllimtarit, edhe i atit tonë oshënar Nil Mirovlitit.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të hierarkut. Lavdi i hierarkut. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i oshënarit. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Zoti Krisht, bërësi(. Përlëshoret: ngjallësore, e hierarkut, e oshënarit dhe Hyjlindësorja e tij. (Pjesa tjetër e shërbesës së oshënarit psalet në Pasdarkë).

Të dielën në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor dhe i hierarkut. Pas Odes III, Ndenjësorja e hierarkut dhe Hyjlindësorja e saj. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e hierarkut dhe Hyjlindësorja e saj (O ëmbëlsi). Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të hierarkut (Pasvargjet e Mbrëmësores duke përsëritur të parën). Lavdi Eothinoni. Tani E Përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e hierarkut. Apostulli i hierarkut. Ungjilli i së dielës.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime të hierarkut
Edhokas simíosin

Dhe, shpërndave bukën tënde tek të varfrit, o shën Joan* i çuditshëm, se doje fort* mëshirën e Zotit Krisht,* që ka dhembshuri plot,* ti ta imitoje; në jetët mbetet[1] pra vërtet* kujtimi yt, o at' oshënar me fam',* dhe ne që e festojm' me bes', me ndërmjetimin tënd na shpëto* nga çdo ngasje dhe pikëllim,* o i tër'pasur hierark.

Sjelljen e hyjnueshme me pastërtinë dhe drejtësin'* e mendimit, ai që sheh* të fshehtat,[2] i pa sakt'sisht,* ndaj në fron të madh shum'* ty të lartëson, si të leu ty me miro krejt* dhe të përsosi,[3] o shën i tërëurt';* dhe tek ti i dor'zoi qart' timonet e grigjës, o Joan,* që drejtove për në liman,* tek vullneti i Zotit ton'.

Zoti çdo kërkes' që kishte zemra jote, e dha[4] tek ti,* se çdo legjislacion të mir'* shpëtues e mbajte fort,* se e doje plot'sisht* Perëndinë edhe të

afërmin, o at' i lum,* i mrekullueshëm, posi veten ti;*[5] mbulove dhe nevojat e atyre që ishin në nevoj';*[6] ndaj ne të lavdërojmë sot,* o Joan, shembull i mir'sis'.

E oshënarit : Os jeneon en mártisin

Oshënar Nil, si en' e denj'* ti e Shpirtit edhe si shtyll'* e gjall' jete, më e mir' se çdo tjetër jet',* të lavdërojmë ty dhe me aspiratë kremtojmë ne* sot kujtimin tënd të shenjt'* me respekt, dhe thërrasim bashk':* Meqë ke guxim* para Zotit, Krijuesit, gjithmon' lyp për të gjithë ne që të lavdërojm' me shpirt, me devotshmëri.

Krishtin që prej rinisë ti* në çdo pikë e deshe fort* edhe shkove pas gjurmëve të tij[7] me zell* në vendin tënd fillimisht; pastaj në Athos jetove, at',* jetë baras me engjëjt;*[8] dashuria e hyjshme krejt* ishte shkak për k'të;* dhe u shfaqe si mirovlit i shquar, shum' i famshëm, se u mbushe plot me dhuratat e qiellit.

Me një zë le ta lavdërojm'* Nilin e madh me gaz, se ësht'* mburrje e Greqisë dhe zbukurim i shenjt'* për Malin Athos, thesar i hyjshëm ere të mir', të fort'* që lëshohet prej Shpirtit* dhe burim që për ne gufon,* jep çuditërisht* miro edhe aromë që mbyt çdo të keqe, kalbësin' e djallit, pra Nilin ta lartësojmë ne.

Lavdi *Ting. II*
I Anatoliut

Burimi i mëshirës i përmbyt të vobektët me dhembshuri dhe simpati, Joani, imitues i Krishtit, bariu i madh dhe ndriçues i aleksandrianëve. Ejani të ngopemi ne të varfrit në mendje duke imituar hijeshinë e tij; se meqë mikpriti me dashuri përdëllyese Krishtin nëpërmjet të varfërve,[9] si qëmoti Abrahami,[10] u denjësua për lumërim[11] dhe ndërmjeton me guxim që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*
Óte ek tu ksilu se

Çfarë* të të sjell i mjeri un',* Zonj' e botës, veçse burimet e lotëve dhe rrëfim* për ato që tashmë bëra; mir'po me syrin tënd* butësisht ma mbik'qyre nga lart, Vajz', dobësinë* shpirtërore që më skllavëron, ndaj zgjidhi krejt* rrjetat e pasioneve që kam;* mua shërbëtorin tënd, lutem,* më çliro nga mjegulla që më pushton.

ose Kryqhyjlindësore

O Krisht,* kur të shihte ty të jesh* ngritur përmbi drurin e Kryqit ajo që të lindi ty* pa përvoj' burri, qante

shum' dhe thoshte k'shtu:* Biri im shum' i ëmbël, pse e le nënën vetëm,* o ndriçim i paafrueshëm i Atit tënd* para çdo fillimi? Nxito pra* dhe lëvdohu, që të lëvdohen* sa lëvdojn' hyjnisht pësimin tënd hyjnor.

Pasvargje të hierarkut
Ting. Tërth. I
Heris askitikón

G'zohu, ndriçues i Kishës son'* dhe krenari mahnitëse e gjith' rruzullit,* lavdi e Aleksandrisë, themel i Orthodhoksis',* pikë referimi për çdo asketiz'm;* për sa turbullohen shum'* je liman, dhe çlirim, shpëtim,* gjatë rreziqesh,* kullë force,[12] dhe ruajtës* i sigurt, dhe ligj* me akt, det i bamirësis',* dhurues me çdo hijeshi,[13] që ndan me sa vijn' tek ti* gjëra që jan' të nevojshme, o i tër'urt', madje pasurisht;* i lyp Krishtit tonë,* që të japë përdëllimin e madh tek shpirtrat tan'.

Varg: E çmuar është para Zotit vdekja e oshënarëve të tij.

G'zohu, ushqyesi i uris',* je shum' bujar me gjith' sa jan' në nevoj', shtrëngim,* je krua i simpatisë, burim mëshire, dhe ndihm'* e atyre që jan' të munduar keq,* dhe mbrojtje vejushash ti,* dhe vizit' gjat' sëmundjeve,* rrobë e sigurt* për ata që të zhveshur jan',* ngritje shum' e shpejt'* e atyre që bien posht';* o at' i përmbiqiellshëm, me syrin tënd shum' të but'* vë re nga lart edhe lutu pran' Krishtit të na dërgojë ne,* të na transmetojë* gjith' filantropin' tek shpirtrat dhe përdëllim të madh.

Varg: Me çfarë do ta shpërblejmë Zotin për të gjitha që na shpërbleu?

G'zohu, o udhëzues për sa* nuk kan' shikim, je pedagog për rinin', o at',* bastun pleqërie edhe bari për të humburit,* korrigjim për njer'zit që mëkate bëjn',* lugin' plot me er' të mir',* dhe kutia e miros s' mir'* të Shpirtit t' Shenjtë,* lum i pafund me bamir'si,* dhe banes' e shenjt'* e Triadhës së Shenjtë[14] je;* ne që të përhimnojmë na kujto edhe na shpëto* nga pikëllim dhe sëmundje, rrezik, ndëshkim i përjetëshëm* me lutjen që bën ti* tek Jisui, që i fal botës përdëllim të madh.

Lavdi *Ting. Tërth. II*
I Bizantit

O atë oshënar, në gjithë tokën doli zëri[15] i arritjeve të tua, prandaj në qiejt gjete shpërblim[16] për lodhjet e tua; asgjësove batalionet e demonëve, arrite brigadat e engjëjve, jetën e të cilëve e kishe zili në mënyrë të

paqortueshme; duke pasur guxim ndaj Zotit, kërko paqe për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë[16a] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me hierarkun dhe gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

ose Kryqhyjlindësore
Triímeros anestis

O Krisht, kur të shikonte mbi kryq* të kryqëzoheshe ajo* që të lindi,* po thërriste me vajtim* si nën': Fëmija im, Zoti im, bir fort i ëmbël,* si ti duron pësim të turpshëm k'shtu?

Përlëshore e hierarkut
Ting. Tërth. IV

Me durimin tënd fitove[17] shpërblimin tënd, o atë oshënar, pasi durove në lutjet pa ndërprerje,[18] si i deshe të varfrit dhe ua plotësove të nevojshmet; prandaj ndërmjeto tek Krishti Perëndi, o Joan përdëllimtar i lumur, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Lavdi *I oshënarit*
I njëjti

Me lot të derdhur si rrëke shkretëtirën e that' e vadite për lërim dhe me vajtim dhe psherëtim' gjer njëqind herë pemë mblodhe për çdo mundim. U shfaqe pra si yll dhe e ndriçove botën me çdo çudi Joan i shenjtë, at' oshënar, lutju Zotit Krisht Perëndi të shpëtohen shpirtrat tanë.*

ose Ting. I
Tis erimu politis

Ke qen' murg ti në Athos me një jet' të pëlqyeshme* para Perëndis', që kërkoje*[19] përmes lutjesh dhe kreshmësh,[20] at';* u bëre en' e pastër e Shpirtit,* lëshoje nga virtyti vetëtim'* me të cilën po ndriçon besimtarët, ne,* o Nil, që të thërrasim ty:* Lavde për Krishtin, që të lavdëron,* lavde atij që të bëri shenjt,* lavde atij që jep tek ti shërime për të gjithë ne.

Hyjlindësoret (sipas tingujve të Përlëshoreve)

Ti që linde për ne prej Virgjëreshës dhe durove kryqëzim, o i mir', që plaçkove vdekjen me vdekje dhe rrëfeve ngjalljen si Perëndi; mos i zhvështro ata që gatove me dorën tënde, trego njeridashjen tënde, o mëshir'plot'. Prit Hyjlindësen që të lindi të ndërmjetojë për ne dhe shpëto, o Shpëtimtari yn', një popull të dëshpëruar.*

ose

Gabrieli kur të tha: Virgjëreshë gë-

zohu, bashkë me zërin mishërohej Zot' i Gjithësisë, tek ty arka e shenjtë, siç tha Davidi i drejtë.[21] U rrëfeve më e gjerë se qiejtë duke mbajtur krijuesin tënd. Lavdi atij që ndenji tek ti, lavdi atij që lindi prej teje, lavdi atij që na çliroi[22] me lindjen tënde.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së zakonshme, një Kanun i Oktoihut dhe të dy të shenjtorëve.

Ode I
Kanuni i hierarkut, që ka Akrostihidhë në Oden IX: "I Josifit".

Ting. Tërth. IV
I kekomeni tin átomon

Me simpati i ndriçuar në mendje dhe i ndezur me dashurin'* për Jisun', o at' i shenjt',* i shndritur me shkëlqime nga lëmosha, je bër' enë shum' e pastër ti për Perëndin',* të vetmin përdëllyes pra,* o Joan; prandaj të lumërojm' dhe të himnojm' me gaz.

Duke shqyrtuar me mendje të urtë sa qëndrojnë që në fillim* edhe përgjithmon', o at',* të prishshmet i shkëmbeve ti me të paprishshmet, dhe tani shëtit me gaz në qiejt lart,* këndon me koret e patrup:* Zotit t'i këndojmë, se me lavd është' lavdëruar fort.

O oshënar, Perëndia dhe dhënësi i përdëllimit dha hir* tek logjika jote, krejt* që më par' ishte përdëllyese; shum' njerëz përdëllehen përmes teje vërtet, pra* u bëre ngushëllim për ta,* për të varfrit furnizim, hyjmendës i tër'urt' Joan.

Hyjlindësore

Për të bashkuar të poshtmet së bashku me të lartat, Zoti që është'* Perëndia i Gjith'sis'* i vetmi, hyri brenda mitrës pa përvojë dasme dhe u duk në formë mishi krejt,* dhe murin e armiqësis'* e rrëzoi. Dha si ndërmjetues paqe,[23] jet', çlirim.

Kanuni i oshënarit, që ka Akrostihidhë: "Melodi të Nil Mirovlitit. I Gjerasimit".

Ting. IV Anikso to stoma mu

Me shndritjen e Shën Trinis', që e ke pritur, o at' i shenjt',* me lutjet e tua mendjen time ti e ndriço,* që të psal, o Nil,* kujtimin tënd të hirshëm,* arritjet e jetës dhe sjelljes që pate ti.

U shfaqe hyjmarrës krejt që nga rinia, o oshënar,* se shihje me sy hyjmendës ti të lartat përher';*[24] rre-

gullove pra* gjith' hovet brenda shpirtit* me frikën e Zotit, o Nil, at' i lumur shum'.

Pasi u largove ti prej lidhjes farefisnore, Nil,* e ndoqe Jisuin me një shpirt të prusht', oshënar;* vendin tënd e le,* sepse, at,' imitove* jetesën e etërve me përkushtim dhe zell.

Hyjlindësore

Pallat mbretëror i të Shum'lartit si dhe banes' me drit'* u shfaqe ti, o e paqortueshme, se në mish* linde Krishtin ton'* ku bindet Gjithësia;* prandaj madhështojm' madhështin' tënde, o Mari.

Ode III
E hierarkut: Uranias apsidhos

Si një vajzë e hijshme u duk prej teje, o shenjt,* hijeshia përdëllimtare e Zotit tonë, Krisht;* kjo ty të solli kuror'* të bër' me gjethe ullinjsh dhe* k'shtu të joshi ty drejt mëshirës hyjnore krejt.

At' Joan i lëvduar, u ule mbi fron të lart'* ti me votën e Perëndisë edhe u solle k'shtu* porsi një engjëll me mish,* edhe blatoje tek Zoti* i tër'dhembshur sakrifikim paqësor, o shenjt.[25]

Ishërbeje me shum' simpati të dhembshurit Krisht,* Zotit ton' që u varfërua[26] me përdëllim në mish;* kështu të varfërve, at',* u jepje mjaft,[6] dhe e merrje* çdo të huaj pa strehim,[27] përmbushje porosit'.

Hyjlindësore

Mbi ty, o e Tër'shenjt', shkaku i çdo gjëje, për shkak* përdëllimi hiperbolik, fushoi vullnetarisht,* dhe shenjtëroi ai* substancën ton' njerëzore,* që rrëshqiti më par' në shkelje,[28] thell' në mëkat.

E oshënarit: Tus sus imnologus

Meqen'se dëgjove porositë e Zotit, e vrave mishin[29] tënd,* me asketiz'm dhe luft', o at', ndërsa shpirtit i dhe jet'* me ngjitje[30] të hyjnueshme, o Nil, vërtet mik i Krishtit ton'.

Meqë aspiroje ti të merrje përsipër siç duhej për Jisun'* sjelljen e oshënarëve të vjetër, kape Athosin* si dre i etur[31] dhe shijon në të rrëke hiri, o at' Nil.

Me zell, asketizëm serioz ecje udhën që ka gjithkund mundim,*[32] o Nil, banove brenda shpellës si një i patrup gjithmon'* edhe banes' e hyjshme e Ngushëllimtarit je bër' vërtet.

Hyjlindësore

Kandil me shtat' drita[33] dhurëtish

krejt hyjnore u duke, Virgjëresh',* edhe në formë mishi[34] gjatë shtatzënis' e mbajte ti* zdritjen e Atit[35] pa tregim për përdëllim dhe çlirimin ton'.

Irmosi: Tus sus imnologus

»O Zonjë dhe nën' e Perëndisë, burim »i pasosur jetësor,* ti siguroji gjith' »ata që të këndojnë plot me zell;* dhe »lart në q'ell ku mbretëron kurorëzoi »me çdo lavdi.*

Kontaqi i oshënarit
Ting. Tërth. I
Ti ipermaho

Si e pastrove* veten tënde me zell asketik,* me lodhje, en' me miro e Ngushëllimtarit tënd,* shërbëtor i shenjtëruar i Zotit tonë* u tregove; për ne lutu pa pushim, at' Nil,* të shpëtojm' të gjith' nga ngasje edhe nga shtrëngim,* se të th'rrasim k'shtu:* G'zohu, o oshënar me nam.

Shtëpia

U duke si engjëll me trup në Malin e Shenjtë, pasi jetove si i patrup, o atë; dhe tani duke qenë bashkë me kore engjëjsh, tok me ta përgjëro Zotin, që të shpëtojnë nga çdo lëndim ata që të thërrasin kështu:

Gëzohu, model i hyjnueshëm i oshënarëve; gëzohu, shtëpi frymore e Shpirtit.

Gëzohu, luginë me erë tepër të këndshme papasionshmërie; gëzohu ti, i plotë me erën e Hirit.

Gëzohu, zambak që rrezaton kënaqësi dhe mundime asketike; gëzohu, miro e çmuar e virtyteve shpirtërore.

Gëzohu, se rrjedh miro shumë erëkëndshme; gëzohu, se buron rrëke Hiri hyjnor.

Gëzohu, erë pastërtie morali; gëzohu, limani ynë i patrazuar.

Gëzohu, aromë mistike e Krishtit;[36] gëzohu, mbrojtje simpatike e besimtarëve.

Gëzohu, o oshënar me nam.

Ndenjësore e hierarkut
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

Meqë more mendim, shpirt përdëllimtar,* u dallove dhurues me simpati;* u jepje të varfërve* dhe,[6] mbuloje nevojat krejt;* u pasurove pra me një emër të duhur ti,* me veprën tënde më shum', Joan, se çdo tjetër shenjt;* dhënësi i Hirit ty të ka përdëllyer* së tepërmi, me mëshir'* të stolisi, o hierark* i tër'pasur,* hyjmendës at';* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Lavdi *I oshënarit*

U pastrove nga gjëra lëndore krejt* përmes lutjes dhe kreshmës gjithmon';[37] vërtet* u duke një enë ti* shum' e çmuar për Hirin dhe* kuti që kishte miro të gjall' të mir'sis' së shenjt',* dhe kopsht me kundërmim pastërtie morali bashk';* ndaj dhe pas mbarimit buron miro të shumta,* që mbytin armiqt' në fund,* por besnikët i shenjtërojn',* o Nil, atë* i lumur thell';* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Tani *Hyjlindësore*

Kur nga gjaku yt shum' i dëlir', o Zonj',* për ne u mishërua ai që dha* tek ne të gjith' qenie, jet'* dhe çliroi Adamin ton',* të par'gatuarin nga mallkimi,[38] një udh' të re,* na hapi për çlirimin e botës son', që e lut* lindjen tënde që nuk ka tregim, Vajz' e çiltër;* ata që shpëtuan krejt* përmes teje, të lavdërojn'* me shpirt, me goj',* zemër dhe zë:* Ndërmjeto tek biri yt Zot,* që të më japë ai ndjesën* e fajeve,* mua që po i falem Birit tënd besërisht.

ose Kryqhyjlindësore

Po thërriste me klithma shqerra, kur pa* Shpëtimtarin, bariun, qengjin mbi kryq* përlotej, vajtonte keq,* me hidh'rim edhe thoshte k'shtu:* Nga një an' bota ka gaz, sepse sot pranon çlirim,* por brendësia ime nga tjetër an' digjet se* shoh un' kryqëzimin që duron dhembshurisht ti,* o Zot, që nuk mban mëri,* Perëndi mbi çdo mirësi.* Le t'i th'rrasim* asaj me bes':* Përdëllena, o Virgjëresh',* dhe ndjesë fajesh dhurona,* të lutemi,* që pësimit të tij i falemi besërisht.

Ode IV
E hierarkut: Isakíkoa Kírie tis ikonomias su

U duke strehë e pastër e Trinisë së Shenjtë,[14] o oshënar, thesar tempulli të hyjshëm dhe majë kryepriftërinjsh.

Duke vënë re simpatinë tënde të shumtë, Zoti edhe më i dhembshur, e shenjtëroi shpirtin tënd, o Joan, atë shumë i hyjnueshëm.

U bëre punëtor i paturpëruar[40] i porosive të të Tërëdhembshurit, dhe u mbushe me të mirat e tij duke qenë në tenda shenjtorësh.

Hyjlindësore

O Vajzë, më shëro traumat e zemrës dhe drejtoji mirë lëvizjet e shpirtit tim në vullnetet e Perëndisë, o Virgjëreshë.

E oshënarit: O kathímenos en dhoksi

Luftove mbinatyrshëm me moral tepër të fortë dhe u denjësove për dhunti të mbinatyrshme, o atë; sepse u dëftua varri yt burim mirosh erëkëndshme në Shpirt, o Nil oshënar.

E shërove, o oshënar, të sëmurin nga prishja e shpirtit dhe e trupit, sapo erdhe; prandaj na çliro edhe ne nga mania e të fëlliqurit, o Nil, me lutjet e tua drejt Krishtit.

Arriti, o hyjmbajtës, kujtimi yt i shenjtë duke shenjtëruar besnikët me mbiardhjen e Shpirtit; duke ardhur në kishën tënde të hyjnueshme për këtë kujtim, madhërojmë Zotin i cili të lavdëroi.

Hyjlindësore

Barku yt u rrëfye i lumur,[41] o e Tërëpacenuar, sepse priti Shpëtimtarin dhe Perëndinë e të gjithave dhe e nxori atë trupmbajtës, o Vajzë, për rigatimin e atyre që të përhimnojnë besërisht.

Ode V

E hierarkut: Ton ek niktós agnosias

Duke imituar vdekjen vullnetare të atij që vdiq nga dhembshuria,[42] u kryqëzove për botën[43] dhe pasionet,[29] dhe u denjësove për jetë mbitokësore, o atë i urtë, që meriton admirim.

Meqë u bëre i butë, i dhembshur, paqësor, bukë falas për të uriturit, dhënie tek të vobektët dhe veshje për të zhveshurit,[44] u denjësove për lumërim.[45]

Duke u zbukuruar fuqishëm, o atë, me pjesëmarrje të hyjnueshme pikërisht si engjëll, i shërbeve si prift Perëndisë duke ndriçuar plotësisht besëmirët me mësimdhëniet e tua të shenjta.

Hyjlindësore

Shpirtin tim që u errësua nga epshet e jetës, o e kulluar e gjithëpanjollshme, shkëlqeje atë me dritën tënde ti që linde Krishtin, dritën që shpërbën errësirën e paditurisë.

E oshënarit: Eksesti ta símpanta

Jetove në vitet e fundme si engjëll, o Nil hyjprurës e mirovlit, dhe pasi përmblodhe brenda teje përpjekjet e qëndrueshme të oshënarëve, meritove lumturinë dhe hirin e tyre.

Pasi i shkëlqeve sytë e shpirtit tënd,[46] o atë oshënar, me asketizëm këmbëngulës, edhe pse gjendeshe ende në mishin[47] tënd, pe lavdinë e pakuptueshme të Krishtit,[48] të cilën e arrite me gaz pas ikjes.

Kockat burojnë çurka shërimesh me shi qiellor, o atë oshënar, dhe kisha jote e hyjnueshme shpërndan ngazëllim dhe hare për ata që rendin tek ajo dhe kërkojnë hirin tënd.

Hyjlindësore

Meqenëse kishe në bark Shpëtimtarin dhe Çliruesin që shpëtonte Adamin nga dënimi i vjetër, mbretin Krisht dhe Zotin, çliromë nga mania e armikut dhe udhëhiqmë drejt rrugës së shpëtimit, o Vajzë.

Ode VI
E hierarkut: Tin dhéisin ekheó

Meqë gjithmon'* luteshe, kreshmoje mjaft,* i pafjetur mbeteshe[20] duke lypur* Jisunë Zot,* ti u bëre i vyer* për shum' vizione, vegime, hyjmendës, at',* dhe njohe dije përmbi mend,* o i pasur, i urt', me pastrim mendor.

Si engjëll ti* me mish përmbi dhé ke qen',* ke vepruar duke sjellë therore* paqeje,[25] pra* pa gjak, me bes', me zemër*[5] edhe me shpirt të dërrmuar, i lumur at'* Joan, tek Bërësi i Madh* me gëzim, me hare dhe me përkushtim.

Ka feksur krejt* jeta jote më shum' se* dielli, lëshoi rreze mëshire* që i dëbojn'* nga të varfrit gjith' retë,* pra errësirën e skamjes, i pasur shum',* dhe ngrohin sa jan' kapur keq* nga të ftohtët, mjerimet, hyjmendës at'.

Hyjlindësore

Kuptuan krejt* thellësin', o Virgjëresh',* të misterit tënd profetët hyjfolës;* profetikisht* e paralajmëruan* këtë, të shndritur nga Shpirti i Tërëshenjt';* besojm' dhe ne si pam' qart' tash* tër' zbatimin e fjalëve që kan' thën'.

E oshënarit: Tin thian taftin

Banoi miro nga qielli në zemrën tënde, o oshënar, dhe të tregoi ty si en'* me er' të mir' hiri shenjtërisht* dhe mirovlit të madh, o i urt' hyjmbajtës Nil.

U duke shok engjëjsh[49] kur banoje brenda shpellës si engjëll ti në trup edhe u mundën krejt* nga asketizmi yt shum' i rrept'* brigadat e demonëve, pra u mposhtën tër'.

Si një liman që s'përmbytet dot e kemi kishën tënde, o Nil i lumur, dhe nga çdo furtun',* çdo hidhërim ne çlirohemi* nën hijen tënde duke të përhimnuar ty.

Hyjlindësore

Çliroi botën nga prishja edhe të tregoi

ty der' shpëtimi, o Zonj', Vajz', ai që lind* nga gjaku yt i kulluar krejt,* pra Zoti Krisht, i përmbisubstancshëm, me mir'si.

Irmosi: Tin thian taftin

»Këtë të kremte e lusim sot, për »Zonjën edhe nënën Hyjlindëse, gjithë »hyjmendësit,* eni trokisni pra duar-»të*[50] dhe lavdëroni Zotin që lindi prej »asaj.*

Kontaqi i hierarkut
Ting. II Ta ano zitón

E dhe pasurin'* që kishe tek të varfrit ti,*[1] dhe more tani* në qiell pasuri, Joan* i tër'urt'; prandaj të gjith' të lëvdojmë duke bër' panair* për kujtimin tënd, ti që ke* një emër të njëjt', të barabart' me mëshir'.

Shtëpia

Meqenëse fute bukuri të veçantë në shpirtin tënd, pra dashurinë autentike dhe simpatinë e bukur ke parë pa gënjeshtër gjatë natës, o Joan, një vajzë të stolisur bukur me degë ulliri, lëmoshën, e cila të fliste me hijeshi: Në qoftë se do të më fitosh si mikeshë dhe bashkëbanuese, do të të udhëheq përpara mbretit Krisht; dhe duke iu bindur nuk e humbe qëllimin, o i njëjt', i barabart' me mëshir'.

Sinaksari

Më 12 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Joan Përdëllimtarit, kryepiskopit të Aleksandrisë.
Vargje: Joani, pasi dha dhe shpërndau tek të vobektët,/ oh, çfarë merr tani duke qëndruar pranë Krishtit!
Iku më 12 Përdëllyesi skamës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Nilit në Malin e Shenjtë, që pas vdekjes u bë mirovlit dhe shëroi shumë të sëmurë.
Vargje: Nili nuk u shfaq duke rrjedhur ujë,/ por miro erëkëndshme, mirobërës i të cilit është Hiri.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Nil i Urtë dhe Asket.
Vargje: Egjiptin e vadit Nili, por edhe Krijesën/ e ujit me fjalë, edhe pse i vdekur, Nili i madh.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Martin çudibërësit, episkop i Fragisë.
Vargje: Bota nuk ishte e denjë për ty,[51] o Martin;/ atë pasi e braktise, ike në botën e madhe.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i profetit të shenjtë Ahiaut.
Vargje: Jerovoami, bir i Navatit, është dëshmitar/ se Ahiau ishte profet para se të vdiste.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Martinit, episkop i Taraqinës. *Vargje:* Martini, meqë ishte i veshur me përdëllim,/ ka marrë lavdi tepër të fortë nga Perëndia.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Andoni dhe sa ishin me atë. *Vargje:* Një shpatë i dëften fitimtarë Zevinasin,/ Gjermanoin, Niqiforin dhe së bashku me ta Andonin.

Patriarku i shenjtë i Konstandinopojës Leon Stipi mbaron në paqe.

Martiri i ri i shenjtë Sava Nigdeli Samoladhai, i cili dëshmoi në Konstandinopojë në 1726, mbaron me shpatë.

Martiri i ri i shenjtë Nikolla, i cili u martirizua në Konstandinopojë në 1732, mbaron me shpatë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
E hierarkut: Pedhes Evreon

I verifikove me vepra fjalët e Shpëtimtarit dhe u rreshtove me korin e atyre që lumërohen, sepse ke qenë përdëllimtar dhe i pastër në mendje, o Joan hyjmbajtës.

Shije shumë e ëmbël mjalti u transformua në ar të kulluar, sepse duke vënë re Bërësi gatishmërinë tënde të pasur, të jep ty shpërblime të pasura.

Duke shkëlqyer nga llamburitja e Trinisë që s'perëndon, o shërbyes i Trinisë, ndriçon ata që të nderojnë tani dhe këndojnë: I bekuar je, o Zot, Perëndi në jetët.

Hyjlindësore

Ti vetëm linde njërin e Trinisë në dy substanca, që shfaqet me një hipostazë, o Virgjëreshë, të cilit i këndojmë: O Zot, Perëndi je i bekuar.

E oshënarit: Uq elátrefsan

Pasi more forcë nga lart, o Nil i lumur, e luftove fuqishëm armikun e patrup, edhe pse në dobësi mishi, dhe u duke i barasvlefshëm vërtet, o i shenjtë, me ata që u lavdëruan në asketizëm.

Luginë erëmirë u duk varri yt i hyjshëm, duke na buruar mirot erëkëndshme të Hirit Hyjnor, që dëfrejnë, o Nil i lumur, mendjen e atyre që nderojnë me ode dhe këngë luftërat e tua.

Ashtu si më parë u shfaqe me vizitë shumë të mirë në shpellën tënde, o i lumur, kështu dhe tani shfaqu në lartësi jolëndore dhe bekona ne që u mblodhëm në kishën tënde, o atë Nil.

Hyjlindësore

U duke, o e Tërëpaqortueshme, tokë e palëruar, që nxore përmbi mendim mbjellësin e jetës; prandaj të lyp, shkul me rrënjë nga zemra ime çdo gjemb pasioni me kazmën e ndërmjetimeve të tua.

Ode VIII

E hierarkut: Nikité tiranu qe flogós

Si të tregoi ty Krishti yll të ndritshëm në lartësinë e Kishës, o atë, ndriçon përmes teje ata që me besë psalin: E bekoni gjithë veprat Zotin dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.[51a]

U duke përdëllimtar, i butë, i mëshirshëm, i patëkeq, o atë, pasuri e të varfërve, stoli dhe veshje e të zhveshurve, duke psalur: E bekoni vepra Zotin dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.[51a]

Zbukurove shenjtërisht fronin e Markut me vepra të perëndishme, veçanërisht, o atë, me lëmoshë dhe dhembshuri; prandaj u quajte Përdëllimtar mbi të gjithë shenjtorët që shkëlqyen me simpati.

Hyjlindësore

U duke, o e Tërëshenjtë, tenda e rrymës së gjallë, prej së cilës pasi pimë ne të vrarët, trashëgojmë jetën duke thirrur: E bekoni gjithë veprat Zotin dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.[51a]

E oshënarit: Pedhas evajís

Fekse në Athos, o atë Nil, si një yll i ndriçuar i asketizmit të hyjshëm dhe me dritën e jetës sate asgjëson errësirë pasionesh, ndërsa me çurkat e mirove të tua si me vrulle e dëfren[52] Kishën e Krishtit, e cila përhimnon lodhjet e tua të hyjnueshme.

Me fuqinë e armatimin të Kryqit shëmbe fodullëkun e sunduesit të botës[53] dhe vrave[29] mentalitetin tokësor të mishit[54] duke nxituar për jetën mbitokësore, në të cilën arrite pasi e bëre udhën,[55] o Nil hyjmbajtës, bashkëqytetar engjëjsh.[49]

Të gjithë që vijnë me besë tek kisha jote e hyjshme, o shën Nil, mbuloji dhe shpëtoji nga çdo vështirësi, dhe kujdesu për grigjën tënde të vogël[56] duke e shpëtuar pa cen nga dëmi tepër i madh i njerivrasësit.[56a]

Hyjlindësore

O tendë e shenjtëruar e Perëndisë, më e shenjtë se shenjtorët e tërëbekuar, dhe tempull tepër i shkëlqyer i atij që i ndërtoi të gjitha, i cili doli nga gjaku yt, o e pacenuar, pastroje nga pasione të papastra shpirtin tim të njollosur, o Perëndilindëse.

Irmosi: Pedhas evajís

»Djemat* e dënuar për t'u djegur,
»prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit
»Krisht, si simbol në lashtësi;*[56b] dhe
»si një veprim tani,* dhe tërë botën
»po e mbledh për këng' e lavdërim:*
»Himnojeni ju veprat e Zotit* dhe e
»lartësoni përmbi të gjitha jetët.[51a]*

Ode IX
E hierarkut: Kirios Theotokon

Ja ku pas vdekjes sate* në mes të merr çifti* i shenjt' i etërve përbrenda varrit të tij* e k'shtu të bën, o at', der' të hyjnueshme.

Si një agim, si dritë,* at' Joan, ndriçoi* sot fjetja jote që ka një shkëlqim me lavd'* na llamburit të gjith' ne që të lumërojm' me bes'.

O atë, u bashkove* tok me kore engjëjsh,* apostujsh edhe profetësh, kryepriftërinjsh;* me k'ta kujto sa të përhimnojnë devotshmërisht.

Kutia, ku është' shtrirë,* o Joan, lipsani* i shenjtë dhe i hyjnueshëm, është pik'risht* burim çudirash për sa vrapojnë tek ti me mall.

Hyjlindësore

O Virgjëresh', u pe ti* më e gjer' se qiejt;* zgjero mendimin tim shum' të ngushtuar, dhe k'shtu* si enë bëje, që mban dhunti të hyjnueshme.

E oshënarit: Apas jijenís

Shih dashamir'sisht, o Nil, që ke shumë simpati, ata që tash* rendën me devotshmëri* për në shtëpinë tënde të hyjshme krejt,* dhe çdo kërkes' që bëjn' përmbushe, o i shenjt';
pusho* gjith' skandalet* e beljarit, dhe na jep* paqen që vjen nga lart[57] edhe është' e mir'.

Enë miroje të çmuar u shfaqe falë jetës sate, Nil,* që e ke jetuar ti,* je mirorrjedhës i mrekullueshëm* vërtet; pra derdhe erën e këndshme të hirit tënd* përmbi zemrat* e gjith' lumëronjësve,* të jetojm' me virtyt, at' me hyjlavdi.

Gji detar i qet' për sa po lundrojn' në dallgët e gjith' jetës është'* kisha jote shum' e shenjt',* dhe shfaqet plot me dhuntit' e tua, at';* kur rendim tek ajo me besë ne çlirohemi* nga furtuna dhe lëndime, oshënar* shën Nil, duke himnuar ne hirin tënd.

Hyjlindësore

O burim i hirshëm dhe i pasosur uji jete,[58] o Mari* e tërëbekuar je,* ja zemra ime digjet keq nga qymyr,* nga vese; ti freskoje[59] me një fllad dhe më

shpëto* nga komplotet* e armikut shum' të ndyr',* që gjithmonë kërkon shkatërrimin tim.

Irmosi: Apas jijenís

»Gjithë njerëzit, kërceni me ngazë»llim tek drit' e Shpirtit Shenjt',* eni »lavdërojeni;* engjëjt e q'ellit eni »kremtojeni* këtë të shenjtë panair »të kryezonjës Mari* dhe thërrisni:* »Ti je më e lumura,* Virgjëresh' e ku»lluar Hyjlindëse.*

Dërgimësore
E hierarkut
O uranón tis astris

Le ta himnojm' Joanin,* që imitoi dukshëm shum'* Perëndinë njeridhembshur,* që të arrijmë ne të gjith'* në larje borxhesh përmes k'tij* si dhe në zgjidhje mëkatesh.

[*Psalet vetëm nëse bie e diel:* O ëmbëlsi engjëllore* dhe ngazëllim për të mjerët,* ti që i mbron të krishterët,* o shën Mari Virgjëreshë;* përkrahmë ti dhe shpëtomë* nga zjarr i ferrit përjetë.[60]*]

E oshënarit
Jinekes akutísthite

Meqë pastrove zemrën krejt* nga lidhjet tokësore ti* falë djersitjes, ushtrimit* si edhe me çurka lotësh,* si alabast'r i çmuar shum',* plot me miro të gjall' je,* o Nil, u vlerësove pra* pas vdekjes, o lavd shenjtorësh,* që të burosh miro, arom'.

Hyjlindësore

Pasi e trupëzove ti* pashprehshëm Perëndinë ton',* që është mbi çdo substancë,* e përtërite natyrën* për ne të vjetërsuar keq* përmes rënies në ligësi;*[38] e lartësove drejt lavdis'* në qiejt; të madhështojm' pra,* si shkak shpëtimi, e Tër'shenjt'.

Pasvargje të Oktoihut
Lavdi *Ting. Tërth. II*

O atë oshënar, në gjithë tokën doli zëri[15] i arritjeve të tua, prandaj në qiejt gjete shpërblim[16] për lodhjet e tua; asgjësove batalionet e demonëve, arrite brigadat e engjëjve, jetën e të cilëve e kishe zili në mënyrë të paqortueshme; duke pasur guxim ndaj Zotit, kërko paqe për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*
Triímeros anestis

O Zonjë e panjollëshme,* atë që linde lute ti* të shpëtojë* gjith' gjinin' e njerëzve,* se të pohojmë ty dhe me gjuhë, dhe me zemër* Hyjlindësen dhe Virgjërnën' Mari.

ose Kryqhyjlindësore

Të pa e paqortueshmja, Krisht,* kur ishe varur përmbi kryq* dhe thërriste* si nën' me vajtime thell':* O biri im i ëmbël, o Zoti im, mos e lër* shërbyesen tënde, mos më braktis.

Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

[1] Ps. 111(112).9; II Kor. 9.9

[2] Ps. 43(44).22; Dan. Sus. 42

[3] Eks. 28.37; 29.7; 30.30; 40.13

[4] Ps. 19(20).5; 36(37).4

[5] Lev. 19.18; Ligji i Dytë 6.5; Matth. 22.37-39; Mark. 12.30-31; Lluk. 10.27

[6] I Tim. 5.10

[7] I Petr. 2.21

[8] Lluk. 20.36

[9] Matth. 25.40

[10] Gjen. 18.1-8

[11] Matth. 5.7

[12] Ps. 60(61).4

[13] II Kor. 9.7

[14] Joan 14.23

[15] Ps. 18(19).5

[16] Matth. 5.12; Lluk. 6.23,35

[16a] Joan 15.1

[17] Lluk. 21.19

[18] I Thes. 5.17

[19] Ps. 76(77).3

[20] Lluk. 2.37

[21] Ps. 131(132).9

[22] Gal. 5.1

[23] Ef. 2.13-18

[24] Kol. 3.2

[25] I Mbret. [Sam.] 10.8; 11.15 etj.

[26] II Kor. 8.9

[27] Jov 31.32; Is. 58.7; Matth. 25.35

[28] Gjen. 3.1-6

[29] Gal. 5.24; Kol. 3.5

[30] Ps. 83(84).6

[31] Ps. 41(42).2

[32] Matth. 7.14

[33] Eks. 25.37; Num. 8.2

[34] Rom. 8.3; Fil. 2.7

[35] Urt. Sol. 7.26; Hebr. 1.3

[36] II Kor. 2.15

[37] Vep. 12.5

[38] Gjen. 3.17-19

[39] Hebr. 10.20

[40] II Tim. 2.15

[41] Lluk. 11.27

[42] Joan 10.18

[43] Gal. 6.14

[44] Matth. 25.36

[45] Matth. 5.5,7,9

[46] Matth. 6.22; Lluk. 11.34

[47] II Kor. 5.6-9

[48] Vep. 7.55

[49] Matth. 22.30

[50] Ps. 46(47).2

[51] Hebr. 11.38

[51a] Dan. Kap. 3 Lutja e Azariut 34

[52] Ps. 45(46).5

[53] Ef. 6.11-13

[54] Rom. 8.6

[55] II Tim. 4.7

[56] Lluk. 12.32

[56a] Joan 8.44

[56b] Dan. 3.25

[57] Kol. 3.15

[58] Jer. 2.13

[59] Lluk. 16.23-25

[60] Matth. 18.8; 25.41,46; Lluk. 16.23,28; II Thes. 1.9; Juda 7



MË 13 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Joan Gojartit, kryepiskop i Konstandinopojës.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të hierarkut. Lavdi i hierarkut. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni dhe Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i hierarkut. Tani Hyjlindësorja ngjallësore (Zoti Krisht, bërësi). Përlëshoret: ngjallësore, e hierarkut dhe Hyjlindësorja e saj.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e hierarkut dhe Himne Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e hierarkut. Në Mëngjesore, Ndenjësoret ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësoret e hierarkut (që janë pas Polieleit). Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat e tingullit dhe Proqimeni. Kanunet: ngjallësor dhe i hierarkut. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Ndenjësoret e hierarkut. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e hierarkut dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e hierarkut dhe Hyjlindësorja e saj. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të hierarkut. Lavdi i hierarkut. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e hierarkut. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e hierarkut dhe e kishës. Kontaqi I përmbipaqmi Tempull. Apostulli i hierarkut. Ungjilli i së dielës.

NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Vargëzime Ting. I
Ton uranion tagmaton

Imitove Pagëzorin, si emnak i denjë me të, nga vetëpërmbajtja, edhe Ilian e madh, duke u plagosur nga zelli[1] i kreshmës dhe i dëlirësisë së tyre, o atë Gojart, dhe guxove kundër tiranisë mbretërore si bari i Kishës së Krishtit.

(2x)

Zëri i dogmave të tua, o atë, me frymëzim të hyjshëm të Fjalës, duke përshkuar gjithë dheun sipas Shkrimeve,[2] ndriçoi botën, pasi na hapi hyrjen e pendimit dhe na stampoi kujdesin për të varfrit dhe Ungjillin e Krishtit.

Drita e panjollshme dhe e pastër e shpirtit tënd llamburit tek bota rrezet diellore të dogmave të shpresëtarisë, o atë i urtë Joan Gojart; shporr mjegullën dhe shndrit si pishtar planetin për besën e mirë.

Lavdi *Ting. IV*

O Krisostom, je bërë instrument i hyjfrymëzuar nëpërmjet të cilit na thirri Shpirti i Shenjtë, sepse zëri i mësimdhënies[2] sate me jehonën domethënëse përshkoi anët e dheut, dhe pasi u bëre imitues i apostujve, fitove atë vend që e aspirove; ndërmjeto pranë Zotit, o i tërëlumur, që të paqësojë botën dhe të shpëtojë shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Shpëtona prej nevojave tona, o nënë e Krishtit Perëndi, ti që linde Bërësin e të gjithave, që të të thërrasim të gjithë: Gëzohu ti, mbrojtja e vetme e shpirtrave tanë.

Pasvargje
Ting. II
Ikos tu Efathá

U tregove, o Joan, trumbetë e artë, që shpall shkëlqyeshëm në anët e botës madhështitë e hyjshme.

Varg: Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

Si Moisiu prite ligj nga Zoti, o Gojart, duke urtësuar dhe ndriçuar botën me mësimdhëniet e tua të hyjshme.

Varg: Priftërinjtë e tu, o Zot, do të veshin drejtësi dhe oshënarët e tu do të ngazëllohen.

U bëre me të vërtetë predikuesi i mbretërisë së hyjnueshme, o Fjalëartë, duke thirrur "Pendohuni"[3] dhe duke vithisur dëshpërimin.

Lavdi *I ngjashëm*

O ati ynë Gojart, na mësove të besojmë vetëm në pushtetin unik të Trinisë së respektueshme, në Atin, Fjalën, Shpirtin.

Tani *Hyjlindësore*
E ngjashme

O Hyjlindëse Virgjëreshë, së bashku me Fjalartin përgjëroju Fjalës Perëndi që u lind prej teje, të shpëtojë shpirtrat tanë.

Përlëshore
Ting. Tërth. IV

Hiri i gojës sate që shkëlqen.

NË MBRËMËSOREN E MADHE

Pas Qëndrimit të parë
të Psaltirit (Lum ai njeri)
Vargëzime
Ting. IV
Os jeneon en mártisin

Me këng' melodikisht himnojm'* instrumentin me hyjfrym'zim,* trombë që na u farkëtua me flori,* det i pashtershëm besimi, dogmash, bazë për Kishën ton',* kup' e tërëart' që derdh* lum mësimesh mjalt'rrjedhëse,* që ujitën krejt* çdo krijes', pra lëvdojmë mendjen qiellore, majën e urtisë. Atë ta mburrim të gjithë ne.

(2x)

Yllin pa perëndim që shndrit* plot me rreze doktrinash fort* gjithë globin tonë, dhe predikuesin* pra të pendimit,[3] sfungjerin e tër'artë që thith plot'sisht* lagështirën mbytëse* të brengosjes, dhe i freskon* zemrat që u shkrin'* nga mëkate,[4] Joanin Fjalëart', le ta nderojmë denjësisht, siç e meriton, me çdo lavdërim.

(2x)

Dallëndyshen me zë të plot'* dhe fjalëmbël, të barabart'* me martirët, engjëllin tokësor mbi dhé* edhe njeriun krejt qiellor, thesarin dhe arkën tër'* të virtyteve me lavd,* gurin, shkëmbin që s'thyhet dot,* që si apostull* ka jetuar dhe që një lloj me engjëjt; le ta madhërojm' me himne shembullin tonë, Gojartin at'.

(2x)

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O oshënar tri herë i lumur, atë tepër i shenjtë, bari i mirë[6] dhe nxënës i kryebariut Krisht,[7] që vure shpirtin për dhentë;[6] ti dhe tani, o Joan Krisostom i tërëfamshëm, kërko me ndërmjetimet e tua që të na dhurohet përdëllimi i madh.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur, që shkëlqeu prej Atit pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre; i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra papërzier. Atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës dhe Leximet.*

Këndimi i Fjalëve të Urta
(10.6-7; 3.13-16; 8.35 etj.)

Kujtimi i të drejtit *është* me lavdërime dhe bekimi i Zotit mbi kryet e tij. Lum

njeriu që gjeti urtësi dhe i vdekshmi që njohu mençuri; sepse *është* më mirë ta tregtosh atë, se thesare ari dhe argjendi. Dhe është më e vyer se gurët e çmuar; dhe çdo gjë e çmuar nuk është e barasvlefshme me të; sepse nga goja e saj del drejtësi, ndërsa ligj dhe mëshirë mban në gjuhë. Prandaj më dëgjoni, o fëmijë, sepse do të them *gjëra* modeste; dhe lum njeriu që do të ruajë udhët e mia; sepse daljet e mia *janë* dalje jete dhe përgatitet vullnet nga Zoti. Prandaj ju lutem dhe u lëshoj zërin tim bijve të njerëzve; se unë, urtësia, bëra mendim dhe dituri, dhe kuptim unë thirra. Imi *është* mendimi dhe siguria, e imja mençuria, e imja edhe fuqia. Unë ata që më duan i dua, ndërsa ata që më kërkojnë do të gjejnë hir. Kuptoni pra, o të patëkeqë, zgjuarsi dhe ju, o të paedukuar, futeni zemrën. Më dëgjoni përsëri, sepse do të them *gjëra* modeste dhe nga buzë *unë* hap *gjëra* të drejta. Sepse do të studioj *një* të vërtetë laringu im, ndërsa të neveritshme janë para meje buzë të gënjeshtërta. Me drejtësi *janë* gjithë fjalët e gojës sime, brenda këtyre *s'ka* asgjë të shtrembër, as të zhdrejtë. Të gjitha janë të drejta për ata që kuptojnë dhe korrekte për ata që gjejnë dituri; sepse ju mësoj *gjëra* të vërteta, që të bëhet në Zotin shpresa juaj dhe që të mbusheni me shpirt.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(Përzgjedhje)

Goja e të drejtit pikon urtësi, ndërsa buzë burrash dinë hire. Goja e të urtëve studion urtësi dhe drejtësia i shpëton nga vdekja. Pasi mbaroi një burrë i drejtë, nuk humbet shpresë, sepse lindet bir i drejtë për në jetë dhe në të mirat e tij do të vjelë fryt drejtësie. Dritë *do të jetë* tek të drejtët përgjithmonë dhe nga Zoti do të gjejnë hir dhe lavdi. Gjuha e të urtëve di të mira dhe në zemrën e tyre do të prehet urtësi. I do Zoti zemrat oshënare dhe të pranueshëm prej tij *janë* gjithë të paqortueshmit në udhë. Urtësi Zoti ndriçon fytyrë të mençuri; sepse arrin tek ata që e dëshirojnë para se të njihet dhe me lehtësi vëzhgohet nga ata që e duan. Ai që mëngoi për atë nuk do të lodhet dhe ai që nuk fjeti për atë, shpejt do të jetë pa merak; sepse ajo lëviz rreth e rrotull duke kërkuar të denjët për atë, dhe në rrugë u shfaqet atyre me dashamirësi. Asnjëherë nuk do të mbizotërojë mbi urtësinë ndonjë e keqe. Prandaj dhe u bëra i dashuruar pas bukurisë së saj dhe e desha, dhe e kërkova që prej rinisë sime, dhe

kërkova ta marr nuse për veten time; sepse Zoti i të gjithave e deshi atë; sepse është njohëse e mistereve të diturisë së Perëndisë dhe zgjedhëse e veprave të tij. Lodhjet e saj janë virtyte dhe ajo *na* mëson mençuri dhe urtësi, drejtësi dhe burrëri, nga të cilat asgjë *tjetër* nuk është më e vlefshme në jetë për njerëzit. Dhe nëse dikush aspiron eksperiencë të shumtë, di të lashta dhe të supozojë të ardhshmet. Di me saktësi strofa fjalësh dhe zgjidhje enigmash. Paranjeh çudi dhe mrekulli, dhe përfundime kohërash dhe motesh. Dhe për të gjithë është kështilltar i mirë; sepse ka pavdekësi në të dhe lavdi në shoqërinë e fjalëve të saj. Prandaj shkova tek Zoti dhe iu luta, dhe thashë me gjithë zemrën time: O Perëndi i etërve dhe Zot i mëshirës, që i bëre të gjitha me fjalën tënde dhe që me urtësinë tënde e bëre njeriun që të zotërojë mbi krijesat që u bënë prej teje dhe që të drejtojë botën me oshënari dhe drejtësi, jepmë mua urtësinë që ulet pranë froneve të tua dhe mos më shpërfill nga shërbëtorët e tu; sepse unë *jam* shërbëtori yt dhe biri i shërbëtores sate. Dërgoje atë nga banesa jote e shenjtë dhe nga froni i lavdisë sate, që duke qenë bashkë me mua të më mësojë se çfarë është e pëlqyeshme para teje, dhe që të më udhëheqë në dituri dhe të më ruajë në lavdinë e saj; sepse mendimet e të vdekshmëve *janë* të gjitha frikacake dhe të pasigurta idetë e tyre.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(Përzgjedhje)

Kur lavdërohet i drejti, do të ngazëllohen popuj; sepse pavdekësi është kujtimi i tij; sepse njihet edhe nga Perëndia edhe nga njerëzit dhe *është* i pëlqyer prej Zotit shpirti i tij. Prandaj dëshirojeni, o burra, urtësinë dhe aspironi, dhe do të edukoheni; sepse fillimi i saj *është* dashuri dhe ruajtje ligjesh. Nderoni urtësinë që të mbretëroni përjetë. Do t'jua lajmëroj dhe nuk do t'jua fsheh misteret e Perëndisë; sepse ai është edhe udhëheqës i urtësisë edhe korrigjues i të urtëve; dhe në dorën e tij *është* çdo mençuri dhe njohuri punësh. Urtësia, mjeshtrja e të gjithave më mësoi; sepse ka në të shpirt mendor, të shenjtë, rrezatim drite të përhershme dhe ikonë e mirësisë së Perëndisë. Ajo bën miq Perëndie dhe profetë. Dhe është më e hijshme se dielli dhe mbi çdo vend yjesh. Duke u krahasuar me dritë, gjendet më me epërsi. Ata që i shërbyen asaj, ajo i shpëtoi nga mundime dhe i udhëhoqi në udhë të drejtë. U dha atyre njohje të shenjtë dhe i ruajti nga ata që kurthojnë, dhe u dha si

çmim një luftë të fuqishme, që ta dinë të tërë se më e fortë se çdo gjë është shpresëtaria dhe se nuk do të mbizotërojë kurrë e keqja mbi urtësinë, dhe se nuk do t'i kalojë shkarazi të ligjtë, kur do të bëjë hetim gjykimi; sepse thanë me vete, duke mos menduar drejt: Le ta tiranizojmë të drejtin, le të mos e kursejmë devotshmërinë e tij, as të mos druhemi nga thinjat shumëvjeçare të *një* plaku, dhe le të jetë fuqia jonë ligj. Dhe le të kurthojmë të drejtin, sepse na vështirëson në përdorim dhe u kundërvihet punëve tona, na qorton mëkatet e edukatës sonë. Deklaron se ka njohuri të Perëndisë dhe fëmijë Zoti e quan veten e tij. U bë për ne kritikë e mendimeve tona. I rëndë është edhe kur shikohet, sepse jeta e tij nuk *është* e ngjashme me të të tjerëve dhe *janë* të ndryshme udhët e tij. Fallco u konsideruam prej tij dhe distancohet nga udhët tona si nga papastërtitë, dhe lumëron mbarime të drejtësh. Le të shohim pra nëse fjalët e tij *janë* të vërteta dhe le të sprovojmë përfundimin e tij. Me sharje dhe tortura le ta shqyrtojmë atë që të njohim butësinë e tij dhe të provojmë mospasjen e mërisë së tij. Me vdekje të shëmtuar le ta dënojmë, sepse do të jetë mbikëqyrje nga fjalët e tij. Këto menduan dhe u mashtruan, se i verbëroi ligësia e tyre. Dhe nuk njohën mistere Perëndie, as nuk gjykuan se ti je Perëndia i vetëm që ke pushtet jete dhe vdekjeje, dhe që shpëton në kohë pikëllimi dhe çliron nga çdo e keqe, ti, i dhembshuri dhe mëshiruesi, dhe që u jep oshënarëve të tu hir, dhe që me krahun tënd u kundërvihesh mendjemëdhenjve.

Në Liti
Vargëzime Idhiomele
Ting. I I Anatoliut

Ondriçues Joan, gojë me pamje ari, zbukurim i virtyteve hyjbërëse dhe banesë Shkrimesh mistike, ti u bëre thesar i patëmetë i Shpirtit të Shenjtë të tërëpacenuar; prandaj e dëfreve gjithë Kishën me fjalën tënde shpëtimtare; pra meqenëse gjete guxim para Perëndisë në shijimin e trashëgimisë lart, ndërmjeto për ne, o atë tepër i shenjtë.

I njëjti

Uderdh hiri në buzët e tua, o atë oshënar, Joan Gojart; prandaj të leu ty Perëndia[8] kryeprift të popullit të tij, që ta kullosësh grigjën e tij[9] në devotshmëri dhe drejtësi;[10] kështu duke u ngjeshur me shpatën e të fortit,[11] preve llafazanëritë e herezive; dhe tani mos pusho së ndërmjetuari, që

ta paqësojë botën dhe t'i shpëtojë shpirtrat tanë.

Ting. II I Studitit

Ty, kryepriftin e madh,[12] bariun e patëkeq dhe oshënar,[13] predikuesin e metanisë,[3] gojën e artë të Hirit, duke të lavdëruar me mallëngjim lutemi: Na transmeto nga ndërmjetimet e tua, o atë, shpërblimin e shpirtrave tanë.

I njëjti
I Gjergjit të Nikomidhisë

Kisha e stolisur me fjalët e tua të arta, si me zbukurim të artë, o Joan Gojart, e ngazëlluar si nuse[14] të thërret ty: U mbusha me pijet[15] e tua arburuese duke shkëlqyer me rrjedhje të arta si dritë, të ëmbla mjaltë; sepse me nxitjet e tua të buta ngrihem nga praktika drejt teorisë dhe bashkohem me Krishtin, dhëndrin mendor,[16] duke mbretëruar bashkë me të; prandaj dhe ne të mbledhur në kujtimin tënd thërrasim: Mos u lodh së lypuri për ne para Zotit, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

I njëjti

E ke marrë, o hierark, filozofinë e tërëlartë dhe dole jashtë botës duke jetuar mbi të dukshmet dhe u dallove qartësisht si pasqyrë e panjollshme e Perëndisë; dhe duke qenë gjithmonë i bashkuar me dritë, merrje dritë[17] dhe arrite me sukses më të fuqishëm në fund të lumur; ndërmjeto, o Krisostom, për shpirtrat tanë.

Ting. IV

Me fjalë shumë të ndritshme si ar, i vadite anët e botës qartësisht, duke pasur si shpirtin edhe trupin florirrjedhës, o i tërëpasur; dhe pasi i veshe me ar të gjitha me fjalët e tua, o arpunues i dogmave të tua, dhe si shkrove libra të shkruara si me ar, fluturove në qiejt; prandaj të thërresim ty: Arburues dhe gojartë, përgjëroju Krishtit Perëndisë tonë, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Lavdi *I njëjti*
I Gjermanoit

Mbretëreshës së qyteteve i duhej të krenohej për Joanin si kryeprift, pikërisht si zbukurim mbretëror dhe trumbetë e farkëtuar me ar, që kumton në gjithë anët dogmat shpëtimtare; dhe na mbledh në panair të gjithë, që të bashkërendisim këngë të vyera për Perëndinë; atij le t'i thërrasim: O fjalartë dhe gojartë, përgjëroju Krishtit Perëndi që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të kemi mur, o Hyjlindëse e pacenuar, liman të paqtë dhe fortifikim; ndaj ne që dimërojmë në jetë, të lypim: Qeverisna dhe shpëtona.

Pasvargje
Ting. Tërth. I
Heris askitikón

G'zohu, o instrument tër' shkëlqim* si ar, i këndshëm, i frym'zuar i Kishës son',* o gjuhë që shkruan plot me filantropi çdo mënyr'* për pendim, o mendje që ngjan me flori,* pëllumb që ke shpinën ti,* siç thon' Psalmet,[18] që shndrit si ar* me gjelbërimin* e virtyteve; gjithashtu* dallëndyshe je* me goj' ari, edhe rrëke* me ujëra të bollshme, dhe me form', pamje si flori,* gjuhë e hijshme je edhe një garanci për bamirësi;* kërko, lyp nga Krishti* të dërgojë përdëllimin e madh tek shpirtrat tan'.

Varg: **Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.**

G'zohu, o ndihm' e shpejtë për sa* padrejtësi pësuan, ushqyes në uri,* je at' për jetimët, dhënës për çdo të varfër, të mjer',* korrigjim për sa kan' mëkatuar rënd';* je mjek me sukses të plot',* shum' i thjeshtë i shpirtrave;* je saktësia* shum' e lart' e theologjis';* qartësisht sqaron* Shkrimet që Shpirt i Shenjt' na dha,* kanuni fort i drejt', praktika bashkë me teorin',* që jan' të dyja tok kulmi i urtësis'; përgjëro për ne,* kërko, lyp nga Krishti* të dërgojë përdëllimin e madh tek shpirtrat tan'.

Varg: **Priftërinjtë e tu, o Zot, do të veshin drejtësi dhe oshënarët e tu do të ngazëllohen.**

Veten e bëre si një shtëpi* të hyjnizuar me virtyte të hyjshme krejt;* në ty k'to kan' vën' banesën, sikur në tempull të shenjt',* o at' shum' i pastër,* dhe të dhanë hir,* meqë qeverise drejt* shqisat e trupit urtësisht;* mendjen të pastër* nga pasionet e ruajte,* porsi ruhet mir' një thesar që nuk vidhet dot;* ndaj, o i tërëlumur, kishe formë hyjnie ti;* ishe eprori i Kishës dhe i stolisur me priftëri;* i luteshe Krishtit,* që tek bota përdëllimin e madh të jap' dhe ndjes'.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Trumbetë tingullartë u dëfteve, o fjalartë Gojart, si argjendar i punove zemrat e besimtarëve me mësimdhëniet e tua të prodhuara me ar; sepse profetikisht doli zëri i dogmave të tua, o atë oshënar, dhe ndriçove anët e gjithë botës.[2]

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë[19] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostujt dhe gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

[*Nëse është e shtunë:* **Z**oti Krisht, bërësi dhe shpërblyesi im, o e gjithëpastër, si lindi prej teje i veshur si un', çliroi Adamin[20] prej mallkimit të parë;[21] prandaj, o e gjithëpastër, të thërresim pa pushuar si nënë Perëndie dhe virgjëreshë me të vërtetë përshëndetjen e engjëllit: Gëzohu, o Zonjë,[22] mbrojtje dhe hije, dhe shpëtim i shpirtrave tanë.*]

Përlëshore
Ting. Tërth. IV

Hiri i gojës sate që shkëlqen si pishtar ndriçoi globin, i dorëzoi botës thesare të mosargjenddashjes, na tregoi lartësinë e përulësisë; ndaj duke edukuar me fjalët e tua, o atë Joan Gojart, ndërmjeto tek Fjala Krisht Perëndi, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Hyjlindësore

Ti që linde për ne prej Virgjëreshës dhe durove kryqëzim, o i mir'; që plaçkove vdekjen me vdekje dhe rrëfeve ngjalljen si Perëndi. Mos i zhvështro ata që gatove me dorën tënde, trego njeridashjen tënde, o mëshir'plot'. Prit Hyjlindësen që të lindi të ndërmjetojë për ne dhe shpëto, o Shpëtimtari yn', një popull të dëshpëruar.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

Kur mësove nga Zoti lart urtësin'* edhe hirin e fjalëve, fekse drit'* mbi gjith' njer'zit si flori* brenda furrës, dhe Shën Trinin'* e predikove si një Njësi, dhe qëllove drejt* me fjalët si shigjetë mashtrimin e koprracis';* ndaj kur kritikove mbretëreshën me zell ti,* i lum, të dëbuan larg* dhe nga grigja jote të ndan'* padrejt'sisht shenjt,* Gojart Joan;* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Shpirtin tim të përulur, o Virgjëresh',* që është' në turbullim ngasjesh jete tash,* po mbytet pa kapiten* në furtunë, dhe duket qart'* se është

mbingarkuar me peshë mëkatesh rënd',* dhe rrezikon të bjerë në fundin e Hadhit[23] posht',* shpejt arri, Hyjlind'se, dhe përmes ndërmjetimit* të ngroht' që bën, më shpëto* duke dhën' portin tënd të qet',* që me besë* të th'rras tek ti:* Ndërmjeto tek Biri yt, Zot,* që të më japë faljen* e fajeve;* shërbëtor i padenj' jam dhe shpres' un' ty të kam.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. III
Thias písteos

En' e Perëndis',* e Kishës sonë,* pasuri për bes',* që s'vidhet kurrë,*[24] u dëfteve, Krisostom kryeprift me fam',* gëzove ti jetën tënde pa ves aspak,* për të vobektët ke nxjerr' si burim mëshir';* oshënar at', lutju Krishtit pra Perëndisë ton',* që të dhurojë përdëllim të madh tek ne.

Lavdi *Ting. Tërth. I*
Ton sinánarhon Logon

Krisostomin që ësht' kopshti i dokrinave* të Shkrimit të hyjfrym'zuar, i cili na udhëheq* në pendim dhe i duroi sprovat me shumic',* siç duhet ta nderojm' atë,* o besnikë, se mësuam ne prej atij shum' dije,* dhe ai ndërmjeton tek Zoti të përdëllehen shpirtrat tan' me mëshir'.

Tani *Hyjlindësore*

Mrekullin' e mahnitshme të zënies mbi llogjik'* si dhe mënyrën që s'shprehet të shtatzënisë i dim'* tek ti, o e tërëd'lir' dhe Virgjëresh' gjithmon';* shtanget arsyeja, çudit* trurin tim lavdia jote, o e Tër'shenjt' Hyjlind'se,* lavdi që mbi të gjithë shtrihet, për hirin dhe shpëtimin ton' shpirtëror.

Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. IV
Epefanis símeron

O Gojart i tërëlum,* vaditën Kishën* fjalët si ar që ke thën',* pra gjith' ne, Kisha, na ujit* me çurk' floriri dhe i shëron* sa të himnojnë dhe jan' të sëmurë keq.

Lavdi *Ting. Tërth. I*
Ton sinánarhon Logon

Nuk i shojtën virtytet e tua, at' i shenjt',* as armiq'si e paligjshme e një sinodi të rrem',* as urrejtje mbretëreshe të shkalluar keq;* por si floriri në një furr'* ngasjesh je sprovuar[25] dhe tani përgjëron përpara* Shën Trinis' vazhdimisht, meqë për atë luftove me një shpirt shum' të zjarrt'.[26]

Tani *Hyjlindësore*

Strehën tënde të shpejt', ndihmën,

përdëllimin tënd* tek un' që jam shërbëtori yt m'i trego ti, o Zonj',* zbuti edhe dallgët e mendimeve që kam,* se jan' të kota, dhe e ngri* shpirtin tim që ra, Mari Hyjlindëse Virgjëreshë,* se e di un', e di se mundesh t'i bësh të gjitha fare leht', sa ti do.[27]

Shkallesat, Antifoni i parë i tingullit IV
Proqimeni
Ting. IV

Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

Varg: Dëgjoni këto gjithë kombet.

Ungjilli. Psalmi 50

Lavdi *Ting. II*

Sot kërcejnë në shpirt tërësi kryepriftërinjsh, duke nderuar tok me ne kujtimin tënd, o hierark Gojart oshënar, ndriçues i Kishës.

Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

U derdh hiri në buzët e tua,[8] o atë oshënar, dhe je bërë bari i Kishës së Krishtit duke i mësuar dhentë e logjikshëm, që të besojnë në Trininë e bashkëqenëshme në një hyjni.

Kanunet: i Hyjlindëses bashkë me Irmoset në 6 dhe i hierarkut në 8.

Ode I
Ting. Tërth. IV
Irmosi: Igrán dhiodhefsas

»**P**asi kish kaluar det si steré* edhe »u shpëtua nga inati egjiptian,* me »që Izraeli po thërriste:* Le t'i kën»dojm' Perëndis', Çlirimtarit ton'.

I mbytur prej ngasjeve si në det,* më ty po përikij dhe prej teje kërkoj shpëtim,* o nënë dhe Zonjë Virgjëreshë,* prej çdo rreziku dhe zie shpëtomë ti.*

Pësimet më mbushën me turbullim* dhe shpirtin ma mbytën me mërzitje dhe dëshpërim,* po ti qetësomë, Virgjëreshë,* me ngushëllimin dhe paqen e Birit tënd.*

Të lutem, o Zonjë, o Shën Mari,* që linde Jisuin, ti shpëtomë nga çdo rrezik,* më ty po përikij dhe të lutem,* me tërë forcën e zemrës dhe shpirtit tim.*

Se shpirti dhe trupi keq m'u sëmur,* pra ti mëshiromë, edhe syrin mbi mua hidh,* kujdesu për mua Virgjëreshë,* e mirë vetë dhe nën' e të mirit Bir.*

Meqë në shtrëngim jam dhe fatkeq'si,* denjësomë për vizit' hyjnore dhe providenc',* që un' ta lëvdoj të

vetmen të d'lir',* të hyjlëvduar, të tër'pacenuarën.

Kanuni i hierarkut, që ka Akrostihidhë: "Të psal ty, gojën e artë të Shpirtit. I Theofanit".

Ting. Tërth. IV
Armatilatin Faraó

Pasi u bëre predikues shum' i ngrohtë i pendimit,[3] Gojart,* ndërmjeto pran' Zotit* të pendohem me gjith' zemër, dhe e përgjëro atë* nëpërmjet dhembshuris' sate, të mjekohet çdo traumë* që kam un' prej kohësh nga fajet, at'.

Pasi e prite gjith' lavdin' e Shpirtit t' Shenjt', o at', u duke si shtyll'* e tër'ndritshme, ecje,* paraprije[28] para Kishën porsi re ndriçuese,* oshënar i tër'lumur, që hijeson[29] ti çdo tërësi* dhe sistemet e orthodhoksëve.

Kur ti prej Krishtit u dallove si mësues, na burove tër'sisht* edukim të shenjtë* me një gojë si flori dhe me logjik' hyjmendëse,* se u duke si lumi me uj'[30] të bollshëm prej Shpirtit t' Shenjt',* o Gojart hyjshfaqës, kryepiskop.

Hyjlindësore

E zbukuruar me shum' lloj stolisje[31] hiri, o e hirshme Mari,* Fjalën Zot të Atit,* që u bë mish nga mir'si dhe dhembshuri që s'shprehet dot,* e ke lindur mbi mend dhe logjik' ti, o e bekuar Zonj',* edhe pse ke mbetur e virgjër krejt.

Zbritësore: Anikso to stoma mu

»**J**a gojën e çel tani, i frymëzuar prej »Shpirtit[31a] Shenjt'* dhe këngë do t'i »këndoj nënës së madhe mbi fron;*[31] »dhe do ta kremtoj* me valle buzë»qeshur,* me zë do t'i shpall kudo »Hyrjen tek Tempulli. *

Ode III
E Hyjlindëses
Irmosi: Uranias apsidhos

»**P**erëndi që ke bërë apsid' në q'ell »si çati,*[32] ti që je ndërtues i Kishës,[32a] »më siguro mua* në dashurin' tënde »fort; je maja e çdo dëshire,* njeri»dashës, edhe mbështetja për çdo »besnik.

Si përkrahje dhe mbrojtje të jetës sime të kam,* ty, o Virgjëresh' e kulluar, ti pra më qeveris* dhe në liman të më çosh, se ti na fal çdo të mirë,* ti besnikët përgjithmon' i mbron, Hyjlindëse.*

Po të lutem, o Zonjë, ma qetëso shpirtin tim* dhe pushoma shqotën e zemrës, se më bie zali,* se ti o Zonjë Mari, ke lindur Mbretin e Paqes,*[32b] Shpëtimtarin, Zotin Krisht, ti o Hyjlindëse.*

Mirëbërësin[33] linde, që bëri çdo mirësi,* pasurisht të gjitha të mirat jepna të gjithëve,* se ti në dorë e ke,[27] se ti ke lindur të fortin,* Shpëtimtarin, Zotin Krisht, ti o Hyjlindëse.*

Me sëmundje të liga dhe çfarëdo pasion,* dergjem un' i mjeri, o Zonjë, eja shëromë ti,* se s'të mungon asnjë gjë, i ke të gjitha të mirat,* je thesar për çdo shërim, ti o Hyjlindëse.*

E hierarkut: O stereosas kat' arhás

Me sjellje shum' të pastër ti* fitove mendjen e Krishtit,*[34] pasurin' pra dhe u bëre udh'heqës,* folës, bashk'-pun'tor me ne të vdekshmit për shpëtim dhe jet',* duke buruar, Gojart,* fjalë shpëtimi me hyjfrym'zim.

At' oshënar, ke marr' thesar* nga pasuria e Shpirtit* që nuk vidhet, dhe ke nxjerr' nga burimet* e shpëtimit[35] ti burim mësimesh që nuk soset kurr';* dhe në vazhdim ujite* faqen e tërë[36] të Kishës son'.

Me kultivimin e tër'urt'* të fjalës, at', ti pastrove* ara shpirtrash me plot shkurre të egra* dhe të dendura, zabel; i shfaqe pra me fryte shum',* kur i vadite ato* me shi q'ellor, o hyjmarrës shenjt.

Hyjlindësore

Ndonjë akuzë apo njoll'* aspak s'ke, o Virgjëreshë,* madje ti banes' virtytesh q'ellore* u tregove, sepse shenjtërim i çdo virtyti thell'* brenda teje fushoi,* o Zonj' e tër'paqortueshme.

Zbritësore: Tus sus imnologus

»O Zonjë dhe nën' e Perëndisë, bu»rim i pasosur jetësor,* ti siguroji »gjith' ata që të këndojnë plot me »zell;* <u>në Hyrjen tënde që nderojn',</u> »kurorëzoi me çdo lavdi.*

Ndenjësore Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

Hyjnisht pe edhe nxore shum' pasuri* diturish dhe urtie që s'shprehet dot;* dhe na pasurove ti* që të gjith' me çurg orthodhoks,* që nga një an' hyjnisht i dëfren zemrat që kan' bes',* nga ana tjetër, siç duhet mbyt dogmë të pasakt';* pra me k'to të dyja dhe me mund për besimin,* u duke luftues ti* i pamposhtur i Shën Trinis',* o Gojart shenjt,* Joan i madh;* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Flakërim në Gjehenë, djegie në zjarr* dhe të qara, vajtime edhe largim,* pra ndarje të hidhur helm* dhe të mjer' nga çdo kor, çdo grup,* çdo trashëgim

shenjtorësh,[37] këto sill ndërmend me frik'* dhe shtangu, edhe trembu, o shpirt, psherëti me vaj;* nxitu që të shuash me lotim kataniksi* kontratat e borxheve*[38] të panumërta që ti ke,* duke pasur* përkrahësen* e paturpëruar Mari,* përmes së cilës ndjes' fajesh* na jepet ne,* që me orthodhoksi e quajm' Hyjlindëse.

Ode IV
E Hyjlindëses
Irmosi: Isakíkoa Kírie
tis ikonomias su

»**K**am dëgjuar misterin qart'* të »ekonomis' sate dhe kuptova krejt* »veprat që ke bërë[38a] dhe prandaj* »lavdërova un' hyjninë tënde, Zot.*

Shën Mari, o Hyjlindëse,* ti që linde Zotin, kapedanin ton',* zbute shqotën e pësimeve,* qetësoi valët e mëkateve.*

Ne të gjithë të lutemi,* dhembshurinë tënde tregona pa vones',* ti që linde njeridashësin,* Krishtin Shpëtimtarin e besnikëve.*

Për shumicën e dhuratave,* të falënderojmë ne mirënjohësit,* me këndime lavdëruese,* nënë virgjëreshë dhe Hyjlindëse.*

Ty të kemi përkrahëse* dhe fortesë të patundur dhe mbrojtëse,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* na shpëto përherë prej rreziqeve.*

O Hyjlindëse e vetmja e virgjër gjithmonë, si mirëdashëse ndihmomë mua që dergjem në shtratin e dhimbjes dhe të sëmundjes[39] sime.

E hierarkut:
Si mu iskís Kírie

Ai që me providencë kujdeset për të gjithë si i mirë, Krishti, dikë tjetër me sjellje apostolike na ka dhënë, predikuesin e njohurisë së fshehtë qiellore dhe folësin e hyjshëm të mistereve të sipërme, ty o Joan Gojart i tërëlumur.

Le ta nderojmë Joanin që ndriçon si ari dhe flet të arta, i cili i veshi të gjithë me ar, me llamburitjet e florinjta të mësimdhënies dhe e ngazëlloi botën me gjuhë më të shkëlqyer se ari dhe tejet të mbushur me dritë, që buron Hirin e perëndishëm.

I tëri u bëre banesë Zoti; i gjithi u duke instrument i Shpirtit që tingëllonte melodi të hyjfrymëzuar të çdo virtyti dhe të ngjarjes së shpëtimit, dhe që shfaqje bukurinë e mbretërisë qiellore, o Joan Gojart i tërëlumur.

Predikove dhembshurinë e Perëndisë duke paraqitur mënyrën e pendimit,[3] duke na mësuar shkëlqyeshëm dhe

përsosmërisht shmangien e të këqijave, o i tërëlumur, dhe duke thurur nxitje për vepra të shkëlqyera, o atë Gojart, tepër i respektuar.

Hyjlindësore

O e tërëpaqortueshme, pas Perëndisë ty të kemi mbrojtje, sepse ti ke qenë nënë Perëndie, e Bërësit dhe Krijuesit, i cili mori formën tonë, dhe e ka shpëtuar nga prishje dhe vdekje, dhe e lavdëroi me lavdinë e hyjshme.

Zbritësore: Tin aneksihníaston

»**T**ë pagjurmësuarin plan perëndor,* »që po mishërohet i larti Zot* prej »Virgjëreshës,* Abakumi si profet e »pa dhe tha me zë të madh:* O Zot i »fuqishëm, lavdi më ty.*

Ode V
E Hyjlindëses
Irmosi: Fótison imás

»**N**dritna ti, o Zot,* përmes urdhrave »të tua[39a] ne,* si dhe me krahun tënd »të fort' dhe të lart',*[39b] o njeridashës, »na jep paqen tënde[32b] të sigurt.*

Zemrën na e çel* me gëzim dhe ngazëllim, o Zonj',* falna gazin e pasosur tani,* sepse ke lindur ti shkaktarin e gëzimeve.*

Zonjë na shpëto,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* prej helmeve si dhe rrezikeve,* se ti ke lindur[39c] Shpëtimtarin, paqeprurësin.[40]*

Mjegullën largo* të mëkateve Hyjlindëse,* me dritën tënde jetëdhënëse,* sepse ke lindur diellin e parajetëshëm.*

Zonjë na shëro,* nga pësimet e sëmundjeve,* na mëshiro edhe na vizito,* edhe shëndetin na dhuro me ndërmjetimin tënd.*

E hierarkut: Ina ti me aposo

Të gjithë të njohim si ndriçues tepër të ndritshëm të Kishës dhe shpëtimtar shpirtrash, që i rrëmben ata nga gryka vdekjeprurëse[41] dhe i udhëheq drejt jetës së amshuar, o atë i kënduar.

Shpërbën rreshtat e heretikëve duke u rrethuar ti me armën e besimit të mirë dhe me trimëri shpirti, o i shumëhyjshëm; dhe i gëzuar sistemon dukshëm koret e orthodhoksëve me lidhjen e Shpirtit.[42]

Nofullat e tua janë si shishe plot me aroma[43] të perëndishme dhe e dëfrejnë botën me erë të këndshme mendore falë mistagogjisë mirobërëse të kuptimeve dhe bukurisë së fjalëve të tua, o i tërëurtë.

Hyjlindësore

Meqenëse zure Perëndinë, krijuesin,

ndërtuesin dhe Zotin, të gjithë gjeneratat e njerëzve të lumërojnë,[44] o e çiltër; edhe brigadat mendore të të patrupëve të lavdërojnë si nënë Perëndie.

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

»Të gjith' i habite ti me një çudi dhe »një lavdi,* ti, o Virgjëresh' e pamar»tuar;* Zotin e jetës që mbretëron lart »në q'ell si një bir e mbajte në pëqi,* »dhe shpëtim që lartazi* u dhurove »besnikëve.*

Ode VI
E Hyjlindëses
Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»Do derdh lutjen* para Zotit Perë»ndi* dhe atij do t'i tregoj hidhërimet* »që kam,[45] sepse* shpirti im është »mbushur* me çdo të keqe dhe jeta »po shkon në Hadh;*[46] pra si Jonai »lutem un':* Jetën time nga prishja, »ti ngrije, Zot.

Atij iu lut,* se prej vdekjes na shpëtoi,* si u dha nën thonjt' e vdekjes dhe vetë,* prapë tani* shpirtin tim ta shpëtojë,* nga shkatërrimi i vdekjes dërrmonjëse* dhe nga armiku zemërlig,* Biri yt, Zoti yt, o Hyjlindëse.*

Si mbrojtëse* ty të di dhe rojtëse,* të sigurt, o Virgjëreshë, për jetën,* ti i shpërndan,* gjithë ngasjet e liga* edhe veprime demonësh na i dëbon,* pra ty të lutem si gjithnjë:* Ti shpëtomë prej gjithë pësimeve.*

Fortes' e mur,* ty të kemi Zonja jon',* dhe shpëtim për shpirtrat tanë të plotë,* dhe ngushëllim* në mjerimet,[47] o Zonjë,* dhe n' errësirën me dritë na ngazëllon;*[48] pra ti, o Zonjë, dhe tani,* nga pësimet, rreziqet ti na shpëto.*

Në shtrat tani* i sëmurë shtrirë jam* dhe për trupin tim shërim dot nuk gjendet,*[49] vetëm pra ti,* që ke lindur për botën,* një Shpëtimtar dhe një mjek të sëmundjeve,* pra ty të lutem dhe tani:* Ti më ngri nga lëngatat Hyjlindëse.*

E hierarkut: Ilásthití mi Sotír

Me urtësi shpirtërisht* ti botën e tër' e pasurove, si shpërndar'si i urt',* i pasur i fjalës, se në buzët e tua at',* nga lart[50] Hiri u derdh* pasurisht,[8] o hierark me fam'.

Në gjithë tokën ka dal* porsi një rrufe,[51] pra zëri yt edhe fuqia, Gojart,* e fjalëve[52] që ti the, pik'risht si trumbet' e fort'* dhe e shquar ka dhën'* anembanë botës[2] shum' jehon'.

Këmishën që lart u thur,*[53] stolisjen pra me virtyte ti e veshe, o i tër'lum,* fitove tok me atë shkëlqimin e fjalëve,* k'shtu u duke bazë* shum' e fort' e së vërtetës,[54] at'.

Hyjlindësore

I gjith'pushtetshmi që mban* me forcë Gjith'sin',[52] nga ti e vesh, o Virgjëresh', dobësin'* e mishit për mirëbërjen, hirin e njerëzve,* Zoti njeridashës, o e tërëpaqortueshme.

Zbritësore: Tin thian taftin

»Këtë të kremte e lusim sot, për »Zonjën edhe nënën Hyjlindëse, gjithë »hyjmendësit,* eni trokisni pra »duartë*[54a] dhe lavdëroni Zotin që »lindi prej asaj.*

Kontaqi
Ting. Tërth. II
Tin ipér imón

Prite Hirin e hyjnueshëm që nga qiejt;* na mëson të gjith' me buzët e tua faljen,* o Joan, në një Zot dhe madje në një Trini,* oshënar i tërëlumur at',* o Gojart', k'shtu të lëvdojmë ty,* siç e meriton dhe denjësisht;* sqaron të hyjshmet vërtet,* si mësues i urt'.

Shtëpia

I gjunjëzohem Bërësit të të gjithave; i shtrij duart drejt Fjalës së parajetshme duke kërkuar karizmë fjale, që ta himnoj oshënarin, të cilin ai e madhështoi; sepse i thotë profetit ai që jeton në jetët: Lavdëroj ata që më lavdërojnë[55] në besë. Ai pra, që qëmoti lartësoi Samuelin,[56] lavdëroi tani hierarkun, sepse talentin që e mori me mirëbesim,[57] e tregtoi mirë dhe e solli tek Mbreti. Prandaj edhe e lartësoi atë i përmbisubstancshmi. Kështu i kërkoj unë i padenji të më japë fjalë,[58] që të mund ta përhimnoj besërisht; se anembanë botës sqaron të hyjshmet vërtet, si mësues i urt'.

Sinaksari

Më 13 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Joan Gojartit, kryepiskop i Konstandinopojës.
Vargje: Pasi mbylli Joani i artë gojën,/ na la një tjetër gojë, librat.
Rreth 13-s heshtën buzë të arta.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Ilarion gjeorgjianit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënarit, martirit të ri Damaskino.

Me ndërmjetimet e Fjalartit dhe të shenjtorëve të tjerë, o Krisht Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Ode VII
E Hyjlindëses
Irmosi: I ek tis Iudheas

»Tre Djem që nga Judea* përfun»duan si robër në Babilonë dikur,* me »besën e Triadhës kan' shkelur flakë

»furre duke psalur me gaz e hir:* O »Perëndi atëror,* o Zot je i bekuar.

Për shpëtimin e botës,* në pëqi virgjëror ke banuar ti, o Jisu,* dhe nënën Virgjëreshë, e cila të ka lindur, na e bëre ne mbrojtëse.* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Birit plot me mëshirë,* që ke lindur, o nën' e kulluar, lutju për ne,* të na i ndjejë fajet dhe njollat shpirtërore, se thërresim me zë të madh:* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Thesarin e shpëtimit*[59] dhe burimin e paprishjes ty Hyjlindësen pra,* kështjellën e përikjes dhe derën e pendimit ua shfaqe besnikëve.* O Perëndi i etërve,* o Zot je i bekuar.*

Sa po vijnë me shum' mall* edhe nën hijen tënde të gjith'sigurtë, o Zonj',* denjo që të shërohen si shpirtrat e sëmurë k'shtu dhe trupat në vuajtje,* se Krishtin ton' shpëtimtar,* për ne ti e ke lindur.*

E hierarkut: Theú singatávasin

Meqë njohe misteret e pafundësisë së mirësisë dhe dhembshurisë së Perëndisë, u pe sigurues i shpëtimit për ata që pendohen me ngrohtësi dhe që i thërrasin me gjithë shpirt Zotit: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Rregullon, o Gojart, me mësimdhëniet e tua çdo mendje dhe shëron sëmundjet e shpirtrave si shumë përdëllyes, dhe me ata që ecin drejt psal i ngazëlluar: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Ulartësove, sepse u bëre i zgjedhur, oshënar, i patëkeq,[13] prift i të Shumëlartit,[60] duke u veshur me drejtësi shkëlqyeshëm dhe duke thirrur me hare,[61] o i tërëpasur: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Hyjlindësore

Zure, o e pacenuar, Perëndinë dhe Zotin që është mbi të gjitha,[62] i cili deshte nga mirëdashja të shpëtonte gjininë e njerëzve nga prishje e vdekjes; duke e himnuar denjësisht, atij i thërrasim: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Zbritësore: Uq elátrefsan

»Nuk u faleshin krijesave hyjmen»dësit, por Kryetarit lart* dhe kërcëni»min me zjarr* e shkelën me trimëri, »psalnin me brohori:* Zot, lavdi më »ty, o Perëndi i etërve,* ti je vetëm i »bekuar.*

Ode VIII
E Hyjlindëses
Irmosi: Ton Vasilea ton uranón

»Mbretin në qiejt,* që gjith' ushtrit'

»engjëllore* e himnojnë edhe ju him-
»noni,* dhe e lartësoni gjithmon' në
»gjithë jetët.

Mos i harro kurr',* o Virgjëresh', sa
të luten,* të himnojnë me bes' e me
shpresë,* dhe të lartësojnë me zë për
gjithë jetët.*

Ti i shëron krejt,* përher' e pa u kursy-
er,* gjith' ata që të luten, o Zonjë,*
dhe të lartësojnë që linde Zotin
tonë.*

Ti më shëron krejt* nga gjith' sëmu-
ndjet e shpirtit* dhe nga dhembjet e
trupit, o Zonjë;* të të lartësoj pra, o
Virgjëresh' hirplote.*

Ti i largon krejt* sulmet dhe ngasjet
e liga,* dhe pësimet, o Zonjë e vir-
gjër,* pra të lartësojmë me zë për
gjithë jetët.*

E hierarkut: Eptaplasios káminon

Ne që me mençuri komunikojmë me
fjalët e tua, o Gojart, njohim gjëra mis-
tike, të respektueshme të theologjisë,
fitojmë të gjithë dobinë e të mirave
dhe shmangim dëmin e së keqes;
sepse u bëre gosti e përbashkët shpë-
timi duke thirrur: E përmbilartësoni
Krishtin në jetët.

Përgjëroju për ne Zotit, o Krisostom,
duke përdorur guximin tënd shumë të
dhembshur, dashurinë përdëllyese
dhe njeridashëse, o atë; sepse ty të
vemë para Shpëtimtarit me besë si
ndërmjetues, mbrojtës dhe ambasa-
dor tepër i ngrohtë, o hierark hyjmen-
dës, Joan i tërëlumur.

Ke treguar tek mbretërit që bënin
padrejtësi, rezistencë rinore dhe mo-
ral të papërkulur, duke qëndruar
ngrohtësisht pranë atyre që u bënin
padrejtësi, pranë jetimëve, vejushave
dhe të vobektëve, o oshënar, si u bëre
atë me mirëdashje duke thirrur: E
përmbilartësoni Krishtin në jetët.

Hyjlindësore

Në trajtë trupore dhe me shumë lloj
enigmash, me dukje simbolike dhe
tipike, hyjfolësit e paralajmëronin
lindjen tënde të mbinatyrshme dhe të
mahnitshme, o Virgjëreshë; prandaj
me besë të përhimnojmë të ngazëllu-
ar duke e përmbilartësuar Krishtin në
gjithë jetët.

Zbritësore: Pedhas evajís

»**D**jemat* e dënuar për t'u djegur,
»prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit
»Krisht, si simbol në lashtësi;*[62a] dhe
»si një veprim tani,* dhe tërë botën
»po e mbledh për këng' e lavdërim:*
»Himnojeni ju veprat e Zotit* dhe e
»lartësoni përmbi të gjitha jetët.*

Ode IX
E Hyjlindëses
Irmosi: Kirios Theotokon

»Pohojm' se je Hyjlind'sja,* ne që u »shpëtuam* nëpërmjet teje, e shenjt', »Virgjëreshë e d'lir';* me koret e të »patrupve të madhështojmë ty.

Shiko si qaj me lotë,* edhe mëshiromë,* se ti ke fshirë çdo lot prej fytyrave,*[63] o Virgjëreshë dhe Zonjë që linde Zotin Krisht.*

Gëzoje zemrën time,* Zonjë Virgjëreshë,* se ti ke lindur gëzimin për njerëzit,* dhe zhduke çdo helm me ndjesën e gjith' mëkateve.*

Liman dhe mbrojtje bëhu,* Zonjë Virgjëreshë,* kështjell' e mur i patundur, Hyjlindëse,* përikje, ndihmë dhe mbrojtje e gjithë njerëzve.*

Me rrezet dhe me dritën* ndritna, Virgjëreshë,* edhe largo errësirën e mendjeve*[64] t' atyre që të lëçitin Zonjë Hyjlindëse.*

Shëromë Virgjëreshë,* se jam i përmbysur,* edhe po dergjem[65] në shtratin e vuajtjes,* po eja ngremë dhe falmë shëndet edhe shpëtim.*

E hierarkut: Eksesti epí tuto

Tani, o at', shijon jetën e vërtet'* për të cilën luftove me plot fuqi mbi dhé, në tok',* se jet' engjëllore[5] ke bërë ti,* ndaj u dallove edhe se* kishe gjuhën, gojën e Krishtit ton,* të butë, o hyjfolës,* pra lut që të shpëtojmë* sa të lum'rojm' me madhështi dhe bes'.

Jan' fjalë jete[66] fjalët e tua, at',* që shkaktojn' jetë pa mbarim; si burim që na gufon* të dëfteu Krishti edhe si lum* që me bollëk na derdh rrjedha* mësimdhëniesh nga lart vërtet, Joan;* përrua me dëfrim je,*[67] dhe çurkë ndjese, falje,* dhe predikues për pendim[3] me hir.

O kryeprift, ke qen' ndërmjetues ti* midis Zotit dhe njerëzve[68] me lavdi; për shpres'tarin'* flisje dhe u duke ndriçim[69] i madh* me hyjshkëlqim, o shenjt fjalart',* ti na nxitje ne që të bëjm' lëmosh',* që ka hir para Krishtit,* me një dëshir' të madhe* të zemrës, ndaj të madhështojm' tani.

Hyjlindësore

O nën' e Perëndisë plot me lavdi* e kulluar, shpëto sa me mall të himnojm' shum', me dëshir',* duke i shpërbër' ngasjet si hordhi,* sepse ke përdëllim; arrin* që të bësh sa do,[27] pa aspak penges';* o Virgjëreshë, mundesh* të bësh çdo gjë, se linde* Jisun'; të madhështojm' pra ne të gjith'.

Zbritësore: Apas jijenís

»Gjithë njerëzit, kërceni me ngazë-
»llim tek drit' e Shpirtit Shenjt',* eni
»lavdërojeni;* engjëjt e q'ellit eni
»kremtojeni* sot Hyrjen e hyjnueshme
»të kryezonjës Mari* dhe thërrisni:*
»Ti je më e lumura,* Virgjëresh' e
»kulluar Hyjlindëse.*

Dërgimësore
En Pnévmati to ieró

Me fjalët që ndriçojn' si ar,* që ti the, Kisha jonë* gëzohet dhe shkëlqen me hir,* o Gojart, edhe shpirtrat* e shpresëtarëve kan' gaz,* shum' dëfrim, edhe lëvdojn'* kujtimin tënd të tër'shenjtë,* se udh'zues për gjith' ne* në shpëtim u duke ti* dhe predikues pendimi.[3]

Tjetër: Jinekes akutísthite

Të gjithë, predikuesin* që nxiste për pendim[3] me forc',* dhe pasurin' për të varfrit,* dhe gojën e art', të ëmbël,* gojën e Kishës dhe qart'sin'* e Ungjillit dhe Shkrimit,* me shpirt le ta lëvdojmë ne* Joanin e tërëurtë,* se na mbështeti fuqishëm.

Hyjlindësore

O Zonja ime, Virgjëresh'* e paqortueshme Mari,* lutu ngroht'sisht ti tek yt Bir* së bashku me Krisostomin* e lavdëruar për shpëtim,* nga ngacmimet e ndryshme ti* ne na shpëto se të himnojm',* na denjëso për të mirat* përjet', se mund të bësh sa do.[27]

Lavdërime

Ting. IV Édhokas simíosin

Më shumë se ari vezullojn' mësimet e tua krejt* që ti derdh, o i urt' Gojart;* o at', me k'to pasuron* çdo mendje të varfër,*[70] dhe dëbon larg mjegullën e pasionit, gjithashtu* dhe dimrin e argjenddashjes që mban frik'* dhe hidhërim; ndaj të lum'rojm' detyrimisht, edhe pluhurin* e lipsanit tënd e nderojm'* si burim shenjtërimi ne.

Shtyllë e përflakur,[28] lum' i tër' i bollshëm me rrjedha shum'* dhe uj' dogmash, dhe goj' e urt',* garanti i shkelësve,* mendja qiellore* e theologjis', predikuesi i shenjtë shum'* i metanis',[3] dhe ndriçuesi me nam,* i çiltër, i veçant', i lart', njeriu mbiqiellor, i madh,* Krisostomi i lumur shenjt* prej nesh sot të nderohet thell'.

Diell i tër'ndritshëm, që shkëlqen me fjalët e tua, at',* në gjith' botën je bërë ti,* dhe yll vezullues shum',* dhe llambadhe drite,* dhe pishtar për sa dimërojnë brenda detit keq,* në dallgë toke gjithmon', i fton në gji* të qet' dhe në shpëtim i çon ti me hir, o Kriso-

stom me nam,* ndërmjetues fjalart' për ne,* për shpëtimin e shpirtrave.

Padrejt'sisht nga grigja jote u dëbove në internim,* oshënar, dhe u lidhe ngusht'* me mjaft pikëllime ti,* me largim të hidhur;* k'shtu u denjësove krejt prej këtyre për mbarim* të lumur dhe për përsosje si atlet* shum' trim, që munde intrigantin tër'dinak; Krishti një kuror'* fitimtare të dha me nder,* ndërmjetuesi yn' Joan.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*
I Anatoliut

Me fjalë të florinjta dhe me mësimdhënie të hyjfrymëzuara, pasi e stolise tërësisht Kishën e Perëndisë, e pasurove atë me pasuri shpirtërore të fjalëve të tua të hyjdhëna; prandaj, si mpleksi me këngët kurorë nga lule të panjollshme, e ofron te kujtimi yt i hyjshëm tok me gjuhën, o i praruar në shpirt, Joan i hyjurtë; ndaj meqenëse ke guxim, o oshënar, ndërmjeto për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i hierarkut, Odet III dhe VI.

Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] III [I] Mbret. 19.10,14

[2] Ps. 18(19).5

[3] Matth. 3.2-3

[4] Ps. 106(107).26

[5] Lluk. 20.36

[6] Joan 10.11,14

[7] I Petr. 5.4

[8] Ps. 44(45).3,8

[9] Vep. 20.28

[10] Lluk. 1.75; Ef. 4.24

[11] Ps. 44(45).4

[12] Hebr. 4.14

[13] Hebr. 7.26

[14] Is. 61.10

[15] Kënga 5.1

[16] Matth. 9.15; Mark. 2.19-20; Lluk. 5.34-35; Joan 3.28-29

[17] Urt. Sol. 7.26

[18] Ps. 67(68).14

[19] Joan 15.1

[20] I Kor. 15.45

[21] Gjen. 3.14-19

[22] Lluk. 1.28

[23] Fja. Urt. 14.12

[24] Lluk. 12.33

[25] Urt. Sol. 3.6

[26] Vep. 18.25; Rom. 12.11

[27] Mark. 1.40

[28] Eks. 13.21

[29] Num. 9.15

[30] Ps. 64(65).10

[31] Ps. 44(45).2,10

[31a] Ps. 44(45).2; 118(119).131; Jez. 3.27

[32] Gjen. 1.7; Is. 40.22

[32a] Ef. 2.20-21

[32b] Is. 9.6; Joan 14.27

[33] Vep. 10.38

[34] I Kor. 2.16

[35] Is. 12.3

[36] Gjen. 2.6

[37] Matth. 25.32-46; Lluk. 16.23-26

[38] Lluk. 16.5-6

[38a] Abak. 3.1-2

[39] Ps. 40(41).4

[39a] Is. 26.9

[39b] Eks. 32.11

[39c] I Kor. 1.30

[40] Fil. 4.7

[41] I Mbret. [Sam.] 17.35

[42] Ef. 4.3

[43] Kënga 5.13

[44] Lluk. 1.48

[45] I Mbret. [Sam.] 1.15; Ps. 141(142).3

[46] Ps. 87(88).4

[47] II Mbret. [Sam.] 22.20; Ps. 4.2; 117(118).5

[48] Joan 5.35

[49] Ps. 37(38).4,8

[50] Jak. 3.15-17

[51] Matth. 24.27; Lluk. 17.24

[52] Hebr. 1.3

[53] Joan 19.23

[54] I Tim. 3.15

[54a] Ps. 46(47).2

[55] I Mbret. [Sam.] 2.30

[56] I Mbret. [Sam.] 3.19

[57] Matth. 25.14-28

[58] Ef. 6.19

[59] Is. 33.6

[60] Gjen. 14.18

[61] Ps. 131(132).9

[62] Rom. 9.5

[62a] Dan. 3.25

[63] Apok. 7.17; 21.4

[64] Ef. 4.18

[65] Ps. 43(44).20

[66] Joan 6.68

[67] Ps. 35(36).9

[68] I Tim. 2.5

[69] Fil. 2.15

[70] Matth. 5.3

MË 14 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i apostull Filipit.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të apostullit. Lavdi i apostullit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i apostullit dhe Tani ngjallësor (O çudi e re). Përlëshoret: ngjallësore, e apostullit dhe Hyjlindësore ngjallësore (Ti që ndërmjetove).

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, si zakonisht, por në fund Përlëshorja e apostullit. Në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor dhe i apostullit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e apostullit. Ndenjësorja e tij dhe Hyjlindësorja e saj. Të tjera si zakonisht. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Dërgimësoret: ngjallësore, e apostullit dhe Hyjlindësorja e saj. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të apostullit. Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e apostullit. Apostulli i apostullit dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore Lavdëroni.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime
Ting. Tërth. II
Olin apothémeni

Ti veprimin vure baz'* për teorin' e sinqertë,* dhe e vure teorin'* si qëllim veprimi, që Zotit i pëlqen;* dhe kërkon, o i lum,* ngulazi nga Krishti* të tregojë tek ti lavdin atëror që s'shprehet dot,* sepse çdo natyr' e logjikshme do,* o i lëvduar, dhe kërkon* Zotin që e bëri; arrite k'shtu* ç'deshe menjëher', duke pritur porsi vulë Birin[1] Zot,* të cilit lutju me plot guxim* dhe ngroht'sisht për shpirtrat tan'.

(2x)

Ngjitje të hyjnueshme* gjithmonë ti ke përdorur,*[1a] siç i bënte që më par'* Moisiu,[2] pra dëshiroje të shikosh* Perëndin' dhe e pe* qart' ikonën e tij,* dhe e prite si një ngjashmëri atë, se Biri ësht'* vërtetim dhe njohje e Atit lart;* ndaj dimë se ka një substanc'* Ati edhe Biri, dhe duket k'shtu* nëpërmjet të gjith've me shum' respekt identiteti tër',* dhe mbretëria, dhe forca krejt,* dhe lavdia, dhe falja.

(2x)

Ti u bëre instrument* i rën' prej erës hyjnore* edhe prej diktimeve* nga lart, pra prej Shpirtit të Shenjt'; kën-

doje k'shtu* melodin' nëpër bot'* dhe Ungjillin zot'ror,* që ësht' mbi natyr', me gjuhën tënde të përzjarrt', Filip;* edhe dogje çdo dredhi dhe mashtrim,* si lënd' që digjet lehtësisht* dhe si bar i tokës që fyshket shpejt,* edhe predikove në sferë Perëndinë Sundimtar,* që ësht' mbi çdo qenie edhe gjë,* o i mrekullueshëm. ***(2x)***

Lavdi *Ting. Tërth. II*
I Bizantit

Pasi u flakërove, o Filip, nga vetëtimat e dritës së madhe, fekse si ndriçues në mbarë botën;[3] dhe pasi e kërkove Atin e dritave[4] tek Biri, e gjete, sepse tek drita gjendet drita; dhe ai është vulë e barasstampuar, deklarues i prototipit;[1] atij, o apostull, përgjëroju që të shpëtohen të vulosurit me gjakun hyjnor.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se Biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre; i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra papërzier. Atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Pasvargje
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

O çudi paradoksale krejt! Ai që zinte dikur* peshq, apostulli pra, u bë* peshkatar i njerëzve,* i dalluar prej Perëndis'.* Me rrjet' fjalimesh i kapi kombet tër'* edhe me grepin e Kryqit ngriti lart* botën. O ç'gjueti* i blatoi ky hyjbërës Krishtit ton'!* Ne kujtimin e tij e kremtojm' tani me gaz.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij.

O çudi paradoksale krejt! Apostulli yn' Filip* u dërgua prej Krishtit ton'* si qengj në mes ujqërish,*[5] edhe shkoi ai pa frik'.* Me bes' tregoi bishat si dele ky,* me hyjshmëri e ndryshoi botën shum'.* O besë, ç'punë bën!* O fuqi e pashprehshme! I dhembshur je* vetëm ti, o Zot, me lutjet e tij na shpëto.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

O çudi paradoksale krejt! Pus që buron jet' për ne,* për mbar' botën, Filipi ësht',* me kov' urtësie pra,* k'shtu apostulli na u shfaq.* Nga ky pus dalin rrjedhat e dogmave,* nga ku ne pim' të gjith' çurka mrekullish.* O sa të frikshme dhe* gjëra të mëdha

ka bër' hyjbërësi!* Sot i bëjm' kujtimin dhe e lavdërojm' me bes'.

Lavdi *Ting. II*
I Bizantit

Si braktise gjërat tokësore, e ndoqe Krishtin dhe pasi u vulose me fryrjen e Shpirtit të Shenjtë,[6] u dërgove prej tij[7] tek kombet e humbura për të kthyer njerëzit në dritë hyjdijeje, o apostull Filip; dhe pasi bëre garën e aspiratës sate të hyjnueshme, me tortura të shumëthurura ia dorëzove shpirtin Perëndisë; atij lutju, o i tërëlumur, që të na dhurohet përdëllimi i madh.

Hyjlindësore

Gjith' shpresën time e besoj tek ti, o nën' e Perëndis', ruajmë nën strehën tënde.

Përlëshore
Ting. III

Filip, apostull i shenjt', lutju Zotit tonë Jisu Krisht, t'u falë shpirtrave tanë ndjesën e mëkateve.*#

Kjo është përlëshorja që përdoret për apostujt.

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së zakonshme, Kanunet: i Oktoihut dhe i apostullit, që ka Akrostihidhë: "Himnoj zellshëm Filipin e lavdishëm. I Theofanit".

Ode I
Ting. Tërth. II
Os en ipiro

Meqë kënaqesh me rrezet mbi çdo ndriçim* të shkëlqimit tër'hyjnor* të Jisuit, o Filip,* o hyjpredikues ti,* ndriçona me pjesëmarrjen e ndriçimit tënd të fort'.

Filip, ai që tregoi përmes vetes* tek ti lavdin atëror,*[1] ty të integroi krejt* në kor të dishepujve,* sepse paranjihte qart' virtytin tënd, o shum' i lum.

Tani s'e sheh në enigma, as në pasqyr',* as në hije[8] Krishtin ton',* për ne është' burim unik,* nxjerr të mira, apostull,* pra maja e çdo dëshire; e sheh faqe më faqe.[9]

Hyjlindësore

Meqë munguan arkondët nga fisi yt,* pra i Judës,[10] o e d'lir',* erdhi Zoti, Biri yt* si sundues dhe arkond;*[11] tani mbretëroi anembanë botës[12] son' vërtet.

Ode III
Uq estin ájios os si

Meqen'se ishe plot me drit'* prej teoris' praktike,* o Filip i mahnitshëm, kur na erdhi Krishti yn',* që ësht' ndriçimi i madh,*[13] si i denjë i shërbeve besërisht.

Si bazë dogmash bese ësht'* mistagogjia jote* dhe u duk tek besnikët k'shtu; përmes saj njohëm ne* se ësht' bashkuar Biri* tok me prindin; një natyrë kan' të dy.

U bëre si kandil i art'*[14] dhe si pishtar jep dritën* e amshuar tek njer'zit, e ndriçon planetin qart'* përmes asaj, o Filip* i shkëlqyeshëm, me dituri të sakt'.

Hyjlindësore

Meqen'se kam besim tek ti,* o e tër'd'lir' e thjeshtë,* të mos bie nga shpresa jote, por ti më çliro* nga çdo kurth armiqësor,* nën' e Njeridashësit, që ka mëshir'.

Irmosi: Uq estin ájios os si

»**N**uk ësht' i shenjt' ndonjë si ti,* Zoti »im, Perëndia,* që e ngrite lart bri»rin[14a] e besnikëve të tu* dhe na »forcove të gjith',* o i mir', mbi gurin »e pohimit tënd.

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

U dëfteve dëbues demonësh qart'* dhe ndriçues për sa jan' në errësir';*[15] tregove ti diellin* që ndriçoi e Virgjëra;* pasi dërrmove tempuj pagan', ngrite kisha shum',* o i tër'lum, për lavdin e Zotit ton' Jisu Krisht;* pra ne të nderojmë dhe kujtimin tënd të shenjt'* kremtojmë shkëlqyeshëm,* dhe thërresim me një zë bashk':* O apostull* Filip me fam',* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Lavdi *I ngjashëm*

U dëfteve vërtet re shiprurëse* shpirtërore për njer'zit që jan' mbi dhé;* vadit ti mistikërisht* zemrat tona si ar' krejt'sisht,* meqë me fjal' përshkove gjith' anët e botës son',* mbi varrin tënd hedh ti si shi miro dhe i freskon;* ndaj ke fryr' në zemrat e pabesa edhe k'shtu* i ke pasuruar k'to* plot me erë të Shpirtit t' Shenjt,* o apostull* Filip me nam,* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Tani *Hyjlindësore*

Shpirtin tim të përulur, o Virgjëresh',* që prej foshnje e ndota i mjeri un';* me fjalë dhe vepra bashk'* veten time e ndyva rënd',* dhe nuk kam çfar' të bëj edhe s'gjej streh' askund tani,* as nuk njoh shpresë tjetër veç teje, o Vajz' e mir';* oh, sa i fëlliqur jam, drejt teje vrapoj pra* tani si një shërbëtor,* fajin tim e pohoj tek ti;* lutem unë,* o e pacen,* ndërmjeto pran' Birit tënd Krisht,* të më dhurohet krejt ndjesa* e shkeljeve,* se më ty e kam vënë çdo shpres', o Zonja jon'.

Ode IV
Hristós mu dhínamis

U dallove si çadra e diellit, Krishtit, që është me të vërtetë dritë,[13] si tempull që mbante shkëlqimin e tij, dhe qiell, që u rrëfente njerëzve lavdi Perëndie.[16]

Kur u prish njerëzia nga pasionet, u vure brenda saj nga Krishti si kripë[17] e hyjnueshme, dhe thave kalbësirën e saj të tmerrshme, o hyjtregues i admirueshëm.

I forcuar, o Filip, me fuqinë e Krishtit, u dëfteve më i fuqishëm se hordhitë e demonëve dhe të besëkëqijve, duke thënë me zë të lartë tek njerëzit mbi dhé ungjillëzime jete të hyjshme.

Hyjlindësore

Të tregoi Krishti liman të qetë, o Zonjë e tërëpaqortueshme, tek ata që me besim dhe mall të vërtetë të shpallin me mendje të pastër Hyjlindëse.

Ode V
To thio fegji su

E thave me pëllëmbët e tua, dëbuese të së keqes, helmin shpirtshkatërrues të armikut, o hyjfolës, duke i çliruar ata që ishin mbajtur në fundin vdekjeprurës të dhimbjes së tmerrshme.

U tregove i tëri frymënxjerrës i zjarrtë me mbiardhjen dhe Hirin e Ngushëllimtarit,[18] o Filip, dhe gjallërove me nxehtësinë e besimit të ngrirët në akull pabesie.

Je afër Krishtit dhe sodit drejpërdrejt vezullimet që të jepen; i transmeton pra tek ata që rendin drejt teje, të cilët i ndriçon dhe i sjell tek Ndërtuesi yt.

Hyjlindësore

Zoti, i vetmi që i krijon me fjalë të gjitha[19] dhe i qeveris me providencë të urtë[20] siç do, falë dhembshurisë së tejskajshme krijohet prej teje dhe bëhet mish pa shpjegim, o e tërëkulluar.

Ode VI
Sineskethi al u kateskethi

Meqë shihje* hilen e armikut* ta prishte, ta shkat'rronte keq* tërë gjinin' e njer'zve,* i tendose[21] dhe dërgove[22] nxën'sit,* apostujt e tu* si shigjeta të mprehta,* dhe i hape rrudhat e dragoit,*[23] në kraharorin e tij; na shërove ne* gjith' nga prishja, nga sëmundja e tij, Krisht.

U pe i shndritur* me drit' superiore* edhe në botë fekse ti*[24] si vetëtim' e malit* që pikonte ëmbëlsi,[25] si vesë* e Perëndisë* që nga qielli kish rën',* si apostulli i zgjedhur, edhe* k'shtu plotësoje rreshtimin e nxënësve,* dymbëdhjet' apostujve të Krishtit ton'.

Si e njohu* thelbin e misterit,* nxënësi i hyjnueshëm* me zë të predikoi* me forc', o i Mir', si lum' i paqes,*[26] si një përrua* që shijimin[27] po buron*[28] me një dallg' që mbyt me lavd gjith' kombet;* ungjillëzoi pra zbrazjen tënde të plot',* që u bë për ne[29] me shum' lavdi dhe hir.

Hyjlindësore

Ti që linde* pavdek'sinë pa cen,* Krishtin, rithirre gjith' ata* që vdisnin dhe humbisnin* brenda vdekjes, pra të tërë njer'zit* i udhëzove* për në jetën pa mbarim* në amshim; e shndrite errësirën* dhe na çlirove, si zgjidhe nga prangat, Zonj',* Vajz' e tër'himnuar, ne, tër' robërit.

Irmosi: Sineskethi al u kateskethi

»**H**yri brenda,* po doli përjashta* »nga një balenë shën Jonaj,* se ty të »shëmbëllente,* që pësove dhe në »varrin zbrite;* dhe menjëherë* nga »balena jasht' u hodh* dhe u thoshte »rojeve të tu, Zot:* Ju që po ruani »gjëra të rreme kot,* latë për besnikët »përdëllim të madh.*

Kontaqi
Ting. Tërth. IV
Os aparhás

Nxënësi, miku yt dhe imitues i pësimit tënd* të predikoi, Filipi hyjfolës, nëpër bot' ty Perëndi Jisu;* Kishën tënde ti ruaje me lutjet e tij nga armiq të paudhë* përmes Perëndilindëses, o i shum'mëshirshëm Zot.

Shtëpia

Më jep rrjedhje fjale, o Zot, ti që ndërtove natyrën e ujërave; zemrën time forcoje,[30] o sundues, ti që forcove dhenë[31] me fjalën tënde; dhe ndriço mendjen time ti që vishesh me dritë si këmishë,[32] që të them dhe të psal të duhurat, dhe që të himnoj siç e meriton nxënësin tënd, ti o i shum'-mëshirshëm Zot.

Sinaksari

Më 14 të të njëjtit muaj, kujtimi i apostullit të lavdëruar dhe të tërëfamshëm Filip, një nga kori i parë i të dymbëdhjetëve.

Vargje: Filipi, duke u ngritur nga këmbët mbi dru,/ të shpaguan, o Shpëtimtar, shpërblimin e larjes së këmbëve.[33]

U ngrite kokëposhtë, o Filip, më 14.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Grigor Pallamait, kryepiskopit të Selanikut.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të ri të lavdëruar Kostandinit nga Hidhra.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
I pedhes en Vaviloni

Si dritë u dërgove porsi shigjetë,[34] o apostull, dhe i llamburite me hedhje drite ata që thërrasin me besë: I bekuar je, o Zot, Perëndi i etërve tanë.

Shkëlqeve hijshëm duke derdhur dritën e pasur të predikimit të hyjshëm, o i lum; ata që ishin në errësirë i ndriçove që të këndojnë: I bekuar je, o Zot, Perëndi i etërve tanë.

Pasi me fjalë të fuqishme besimi fitove absolutisht mbi llafazanëri oratorësh dhe mbi çdo mjeshtëri fjalësh, këndoje: I bekuar je, o Zot, Perëndi i etërve tanë.

Hyjlindësore

Ke lindur, o Virgjëreshë, në mënyrë të mbisubstancshme dy substanca të bashkuara pa ngatërrim në Krishtin, tek i cili thërrasim, o e dëlirë: I bekuar je, o Zot, Perëndi i etërve tanë.

Ode VIII
Nomon patroon

Drita atërore, Fjala enipostate të bëri ty dritën e botës,[35] pasi të zgjodhi nga bota si apostull, o tri herë i lumur; dhe si të armatosi plotësisht me forcën hyjnore të tij, të dha si luftëtar të pamposhtur ty që thërrisje: Zotin e himnoni, vepra dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

I forcuar nga fuqia hyjnore, triumfove mbi rendet kundërshtare, duke shembur rreshtimin e tyre të harbuar, se meqë e more paqen si trashëgim të pavjedhshëm,[36] mbolle në botë një situatë paqësore duke thirrur: Zotin e himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Me gjithë dëshirë iu afrove Fjalës së mishëruar të Perëndisë, o apostull, pasi u bëre dishepull dhe shërbyesi i tij i hyjshëm dhe mistikfolës; prandaj,

i dërguar prej tij në kombe, predikove[37] praninë e tij duke thirrur: Zotin e himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Në mitrën tënde, o Virgjëreshë e tërëshenjtë, u bashkua përmbi mendim Përmbiperëndia i gjithë me njerëzinë e tërë pa ndryshim; prandaj në dy natyra njihet Krishti, edhe pse ai është një në dy; atij i thërrasim duke himnuar: Zotin e himnoni, vepra dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Irmosi: Nomon patroon

»Djemtë e lumtur mbronin me rre»zik* në Babilonë ligjin e shenjtë »atëror,* e përbuzën urdhëresën e »palogjikshme të mbretit* dhe të »bashkuar me zjarr që s'i shkrinte k'ta »aspak,* po këndonin një himn të »denj' vërtet për Kryetarin:* O vepra, »ju himnojeni Zotin* dhe e lartësoni »përmbi të gjithë jetët.

Ode IX
Aporí pasa glosa

Tash që u denjësove* për lavdin' e pashprehshme* edhe për dritën që nuk perëndon, aty ku është ngazëllimi* që nuk thuhet dhe hareja pa fund, pra në Kishën* ku jan' të parëlindurit,[38] tendat, o Filip,* lutu gjat' për të gjith' të krishterët[39] ti, o i tërëurt'.

O Filip, zbukurohesh* me stolinë mendore* të hijshme dhe me një kuror'[40] mbret'rore, o hyjmendës, dhe me rreze* rreth e rrotull tejet dritëdhënëse, të hirshme,* me flakërim shkëlqimi të mbinatyrshëm krejt,* pran' fronit, o i lumur, të Zotit tënd po qëndron me gaz.

Me apostujt të gjithë,* me profetët, o Filip,* me athloforët si dhe oshënarët, dhe me hierarkët, et'rit,* me të drejtët, dhe të gjith' të respektueshmit bashk'* dhe me Hyjlind'sen, lyp të na jepet dhembshuri,* ndjes' fajesh tek ne që bëjm' kujtimin tënd shndritës me besim.

Hyjlindësore

Virgjëreshë, ke lindur* Fjalën e mishëruar* përmbinatyrshëm, që më parë ishte pa mish, pra të shpallim hapur* ne të gjithë besërisht Hyjlindëse, e d'lirë;* përshtatim epitetin me shum' vërtetësi,* se ti u bëre rrënjë shpëtimi, o Zonj', për çdo besnik.

Irmosi: Aporí pasa glosa

»Asnjë gjuhë në botë* s'të këndon »dot pas vlerës* dhe turbullohet me»ndja e gjith' engjëjve për ty, o Virgjë»reshë;* po na prit me mirësi pas

»besës që të kemi,* se ti e di fort mirë »që kemi mall për ty* edhe të madhë»shtojmë përher', o mbrojtj' e besni»këve.*

Dërgimësore
En Pnévmati to ieró

E bëre udhën lart me gaz,* kur u ktheve nga ecja* e këmbëve të tua pra,* që na kishin bukuri;*[41] dhe duke qen' pran' Trinisë,* e pe Birin, Shpirtin Zot* në Atin, prandaj me shum' mall* e kremtojm' kujtimin tënd* të hyjnueshëm tër'sisht* si dhe të shenjt', o apostull.

Tjetër
O uranón tis astris

Prej Shpirtit t' Shenjt' një rreze* ti prite dhe ndriçove fort* me jehonë fjalësh që the* botën,[42] i mrekullueshëm;* tani për ne përgjëroju* pran' Zotit, që të shpëtojmë.

Hyjlindësore

E Tërëshenjt' e virgjër,* ofroje lutjen tënde tash* bashkë dhe me shën Filipin,* hyjfolës, tek Biri për ne* dhe na shpëto ti të gjithë* nga të këqija të ndryshme.

Lavdërime
Ting. I Ton uranion tagmaton

Mbi dhé u derdhën jehonat e zërit qiellor,* dhe fjala jote mbushi,* o i lum' k'të[42] me dogma;* ne përmes këtyre theologojm'* mistikisht dhe e lavdërojm',* apostull, Birin porsi të njëqenëshëm* bashk' me Atin dhe me Shpirtin tok.

(2x)

Filip i lumur fort, si yllin e mëngjesit ty* të kemi ne të gjithë* nga apostujt e Krishtit,* o i famshëm, si një llamb' me shkëlqim* brenda Kishës me shum' respekt;* në shpirtrat thell' po ndriçohemi dhe shpëtojm'* nga rreziqe, se ti ndërmjeton.

Luftoje si një atlet përmes kryqit përgjithmon';* kurorat e fitores* denjësisht i fitove,* o Filip; u fute bashk' me ato* në mbret'ritë e sipërme;* ulesh me Krishtin, apostull, dhe ndërmjeton* të shpëtojm' dhe të çlirohemi.

Lavdi *Ting. II*

U dukën në botë nofullat e tua, o apostull i urtë Filip, si shishe me aroma,[43] që u qerasin besimtarëve pijen jetëbërëse; sepse duke pasur vepër për bazë teorie, u bëre pasues i Krishtit, e furnizove si dhe e stolise me mësimdhënie Kishën shterpe të kombeve, e cila u bë me fëmijë të mirë falë atij; dhe tani lyp që të shpëtohet ajo nga fatkeqësi dhe nevoja, sepse

mundesh shumë para Perëndisë, meqë je afër tij.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i apostullit, Odet III dhe VI.

Kungatore: Në gjithë dheun.

Shënim: Që nga nesër, me bekimin e Perëndisë, fillojmë Kreshmën e Krishtlindjes.

CITIME

[1] Joan 14.8-10

[1a] Ps. 83(84).6

[2] Eks. 33.13,18

[3] Fil. 2.15

[4] Jak. 1.17

[5] Matth. 10.16; Lluk. 10.3

[6] Joan 20.22

[7] Vep. 13.2

[8] Kol. 2.17

[9] I Kor. 13.12

[10] Gjen. 49.10

[11] Mik. 5.1; Matth. 2.6

[12] Ps. 58(59).14

[13] Joan 1.4-11; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46

[14] Eks. 25.30-39; 38.13

[14a] I Mbret. [Sam.] 2.1-2

[15] Rom. 2.19

[16] Ps. 18(19).1

[17] IV[II] Mbret. 2.19-22

[18] Vep. 2.3-4

[19] Gjen. 1.3,6,9,11,14,20,24; Ps. 148.5

[20] Urt. Sol. 14.2-3

[21] Ps. 44(45).5-6

[22] Ps. 17(18).15

[23] Jov 41.5-6

[24] Matth. 24.27; Lluk. 17.24

[25] Amos 9.13; Joel 4.18

[26] Is. 48.18

[27] Ps. 35(36).9

[28] Sirak 39.22

[29] Fil. 2.7

[30] I Thes. 3.13

[31] Is. 42.5; 44.24

[32] Ps. 103(104).2

[33] Joan 13.5

[34] Abak. 3.11

[35] Matth. 5.14

[36] Joan 14.27; 16.22

[37] Matth. 28.19

[38] Hebr. 12.23

[39] Ps. 117(118).15

[40] Urt. Sol. 5.16; Is. 62.3; Jez. 28.12

[41] Is. 52.7; Rom. 10.15

[42] Ps. 18(19).5

[43] Kënga 5.13

MË 16 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i apostullit dhe ungjillorit Matthe.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i ungjillorit. Tani ngjallësore (Zoti Krisht, bërësi). Përlëshoret: ngjallësore, e ungjillorit dhe Hyjlindësorja e saj.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, si zakonisht, por në fund Përlëshorja e ungjillorit. Në Mëngjesore, Kanunet: ngjallësor dhe i ungjillorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e ungjillorit, Ndenjësorja e tij dhe Hyjlindësorja e saj. Të tjera si zakonisht. Zbritësoret Ja gojën e çel tani. Dërgimësoret: ngjallësore, e ungjillorit dhe Hyjlindësorja e saj. Lavdërimet: 4 të tingullit dhe 4 të ungjillorit. Lavdi i ungjillorit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e ungjillorit. Apostulli i ungjillorit dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore Në gjithë dheun.

NË MBRËMËSORE

Vargëzime
Ting. IV
O eks ipsistu klithís

Ai që futet në zemra njerëzore,* kur me paranjohje të hyjshme e pa sakt'sisht* gjith' karakterin tënd shum' të mir',* dhe të çliroi* nga bota e padrejt'sis',[1] at'herë pra* të ka bërë ty si ndriçim mbarëbotëror,*[2] të urdhëroi që të shkëlqesh* dhe të ndriçosh ti* të gjitha anët e sferës, apostull;* u denjësove* që ta shkruash ungjillin e tij të hyjshëm me kthjelltësi;* lyp që të na ndriçojë,* të shpëtojë shpirtrat tan' ai.

(2x)

Ti nga dogana u ftove të jesh nxënës,* kur të thirri Fjala Zot pa nisje, nxiti k'shtu* të shkosh pas tij, edhe kur madje* ai premtoi* pjes'marrje në mbretërin' e qiejve,* o i tërëlumur, at'herë çdo gjë e le* dhe u largove nga çdo trazir',* edhe e ndoqe* me gjithë shpirt edhe forcë; dhe tani,* o hyjshikues,* plot je mbushur me teorinë, me pamje të pashprehshme;* lyp që të na ndriçojë,* të shpëtojë shpirtrat tan' ai.

(2x)

Symprehtësia e vjetër profetike* të ka parë qartësisht si gur të shenjt' me forc',* që rrokullisej mbi tokë[3] dhe*

dërrmonte përdhé* mashtrimin, dinakërin' rrethuese* satanike, o i tër'urtë, por Fjala Zot* enipostate të bëri drit'* për botën,[2] folës* dhe predikues drejt'sie të vërtet',* që llamburit plot* me shkëlqimet e dritës tridiellore, o ungjillor;* lyp që të na ndriçojë,* të shpëtojë shpirtrat tan' ai.

(2x)

Lavdi *Ting. IV*

Me gatishmëri ndoqe Krishtin kur të ftonte për mësimdhënie qiellore, o hyjmarrës, duke shtyrë tej larg në çast çdo përkujdesje tokësore; sepse pasi more me bindje mendim të denjë për mbretërinë e sipërme, u distancove nga jeta ziliqare për të poshtmet dhe nga lavdia boshe, duke u bërë nga doganier ungjillor, dhe duke qenë dritë e të errësuarve dhe udhëzues[4] për shpëtim i të humburve; ndërsa tani je ndërmjetues tepër i nxehtë për mbarë botën dhe roje shpëtimtar i atyre që të madhështojnë, o Matthe.

Tani *Hyjlindësore*
O eks ipsistu klithís

Kishe në mitrën Krijuesin e botës* kur u mishërua, o Zonj' e hyjlumur krejt,* i cili po rigatuante* njeriun që ra* më par' me shkeljen e gjarpërit[5] dinak,* se, o e kulluar, ke lindur Fjalën Jisu* ti pa shpjegim dhe çlirove k'shtu* me lindjen tënde* natyrën që prishja vjetëroi krejt;* ndaj të himnojmë* Virgjëresh' e panusëruar, dhe mburrim ne hirin tënd,* me të cilin mbuloji* dhe streho sa të lëvdojn' me bes'.

Pasvargje
Ting. IV
Os jeneon en mártisin

Ti për njohjen e Perëndis'* grumbullove mbar' njerëzit* me fjalimet që po kumbonin si trumbet',* ndërsa morin' e mashtrimeve e zmbrapse nga dheu yn'* dhe në një mendim dhe shpirt* i drejtove besnikët mir',* o Matthe me fam',* ndërmjeton që nga prishja dhe rreziqe të shpëtojn' tash sa kujtimin tënd me respekt e me bes' e bëjn'.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij.

Të tregoi si luftëtar* me forc' kundër mashtrimit ty,* kur të armatosi me gjuh' të zjarrt' që vjen* nga Shpirti,[6] pra Krishti Perëndia yn', prej të cilit ti* more qart' me shum' shkëlqim* çmime hiri me çdo lavdi;* lutu tek ai,* o apostull, nga prishja dhe rreziqe të shpëtojn' tash sa kujtimin tënd me respekt e me bes' e bëjn'.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

Në avushat e Shpirtit t' Shenjt'* u

përkule, apostull thell',* dhe kuptove tër' pasurin' që s'zmbrapset dot,* edhe pasi prej asaj e nxore hirin e bollshme krejt,* e shpërndave tek të gjith'* siç Ungjilli na thot'[7] qart'sisht,* edhe lutesh ti,* ndërmjeton që nga prishja dhe rreziqe të shpëtojn' tash sa kujtimin tënd me respekt e me bes' e bëjn'.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Nga fundi i së keqes ekstreme[8] drejt lartësisë ekstreme të virtytit, si shqiponjë që fluturon lart, vrapove sipër në mënyrë paradoksale, o Matthe i tërëfamshëm; sepse pasi ndoqe gjurmët[9] e atij që mbuloi qiejt me virtyt dhe që mbushi gjithë tokën[10] me mençurinë e tij, pra të Krishtit, u zbulove si imitues i përzjarrshëm në të gjitha, duke ungjillëzuar paqe,[11] jetë dhe shpëtim tek ata që u binden besërisht urdhëresave të hyjshme; në këto na udhëzo, që t'i pëlqejmë Ndërtuesit dhe të të lumërojmë ty.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë[12] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me apostujt dhe gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Përlëshore Ting. III

O apostull i shenjt' dhe ungjillor Matthe, lutju Zotit ton' Jisu Krisht, t'u falë shpirtrave tanë ndjesën e mëkateve.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së zakonshme, Kanunet e Oktoihut dhe të ungjillorit:

Poezi e Theofanit

Ode I
Ting. IV
Anikso to stoma mu

Më jep pasurisht nga hiri që banon brenda teje thell',* Matthe, shërbëtor i Krishtit, i lëvdueshëm fort,* dhe do të thërras,* shkëlqyeshëm do shpall un',* do psal me gëzim të çuditshmet që bëre ti.

Braktise absolutisht trazirën e tokësoreve,* kur zërin e Fjalës që u mishërua për ne* e dëgjove fort,* u shfaqe predikues* i hyjshëm, administrator Hiri,[13] o i lum.

U bëre shërbyes okular i Fjalës së Atit lart,* i cili ësht' para jetëve; përshkove me hov* të gjith' kombet ti,*

u ke ungjillëzuar* pranin' e saj, dhe u dallove, o ungjillor.

Hyjlindësore

E ungjillëzove, o i urt', gremisjen e vdekjes ti* dhe shembjen e prishjes me zbulimin e jetës son';* rigatoi pra* njer'zin' i pakufishmi,* i cili banoi në mitrën e virgjër krejt.

Ode III
Tus sus imnologus

I bëre të shquar dhe ndriçues për jetën apostujt e tu, Zot,* Fjalë e Perëndis', të cilët po dëbojnë errësir'* besimi fals dhe botën e tër' e ndriçojnë[2] në lavdin tënd.

Si e armatose, Shpëtimtar, ti Mattheun me armatimin tënd,*[14] më të fort' se tiranët e ke bërë të shkëlqyeshëm;* e shfaqe, njeridashës, shkatërrues idhujsh mashtrimi qart'.

Altarë demonësh gjuha jote e zjarrtë i dogji, zëri yt,* o Matthe, instrument të bëri Perëndia, Shpirt i Shenjt'* Ngushëllimtar, që Krishtin Fjal' enipostate e predikon.

Hyjlindësore

Kur theologonte si trumbetë Mattheu hyjmendës, shndriti k'shtu* popuj me flakërimin e Trinisë dhe me predikim* rreth mishërimit përmbi mend të Fjalës nga e panjollëshmja.

Irmosi: Tus sus imnologus

»**O** Zonjë dhe nën' e Perëndisë, burim »i pasosur jetësor,* ti siguroji gjith' »ata që të këndojnë plot me zell,* dhe »lart në q'ell ku mbretëron kurorëzoi »me çdo lavdi.*

Ndenjësore Ting. I
Ton tafon su Sotír

Mattheu shum' i urt',* që ka shkruar i pari* Ungjillin e Jisuit dhe shndrit si pishtari* çdo gjë që ësht' nën diell, pra Gjithësinë, ësht' njohësi* i mistereve* të Krishtit; tash po nderohet* me psalmim të shenjt';* për gjithë sa e nderojnë* kërkon ndjes' mëkatesh ky.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*
Tin sofian qe Logon

E braktise floririn me të vërtet',* aspirove ti Krishtin me përkushtim,* apostull Matthe, prandaj* u tregove ndriçues qart'* në botë,[2] në çdo an', dhe apostull i famshëm shum'* nga doganier që ishe, sepse nxënës ti je bër'* edhe predikues bese; detyrimisht pra* nderojmë kujtimin tënd* me respekt plot, si dhe kremtojm'* besërisht ne,* këndojm' me shpirt:*

Ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Tani *Hyjlindësore*

Gjith' ne malin e tër'shenjt'[15] le ta himnojm'* dhe Parajsën mendore, rikthimin tër'* të Evës; ësht' port'[16] dhe ark'*[17] qiellore, shkall'[17a] edhe re* që rrezaton gjer' dritë,[18] dhe ferr' e padjegëshme,*[19] thesar i madh i botës së tërë dhe pasuri;* se shpëtimi dhe falja e krimeve tona* të lashta, të vjetëra* u punuan përmes asaj;* i thërrasim* pra me mall'ngjim:* Ndërmjeto tek biri yt Zot,* që të dhurohet ndjes' shkeljesh* për sa me bes'* lindjes sate të pacenuar i falemi.

Ode IV
Tin aneksihníaston

O Perëndi, nxënësi hyjshikues, pasi mësoi pranë Fjalës sate enipostate, e shpërbëhu urtësinë e botës, duke të thirrur ty me zë të lartë: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Çfarë lavdërim do të shtojmë për ty, që u lumërove nga Krishti,[20] o hyjfolës? Sepse s'ka fuqi një i vdekshëm të rrëfejë me fjalë pikë për pikë hirin që lulëzon tek ti, o i vyer për admirim.

Meqenëse i Shumëlarti kishte parë mendjen tënde të panjollshme dhe të patëmetë, të vuri pikërisht si një llambadhe para të gjithëve, që të jesh në llampadar të lartë e të llamburitësh ata që janë në errësirë,[21] o hyjshfaqës.

Hyjlindësore

Ti, o e bekuar, lartësove natyrën e poshtëruar të të vdekshmëve, meqë kishe në bark mbinatyrshëm fuqinë e të Shumëlartit,[21a] o nënë e tërëpapikëluar, siç na mësoi Mattheu.

Ode V
Eksesti ta símpanta

Pasi e pranove Hirin e Shpirtit të Tërëshenjtë,[22] u dëfteve banesë e hyjnueshme,[23] duke na mësuar dritën e diturisë së hyjshme, meqenëse u besove të paraqesësh me gërma dogmat e Krishtit, si i preferuar nga Hyjnia, dëshmitar okular.

Gjuha jote është bërë perëndishëm kallam[24] i Ngushëllimtarit, i cili u jep çlirim atyre që njohën sundimin e tij dhe frymëzon në shpirtrat e të urtëve dije qiellore, o Matthe i tërënderuar.

Krishti të dërgoi tek bota, ndërsa feksje me çudi dhe hire terapish, që të shkelësh fuqinë e demonëve[25] dhe të ndriçosh shpirtrat e besnikëve, e të

gjithë atyre që të himnojnë ty, predikuesin e paqes.

Hyjlindësore

Virgjëreshë ka lindur Birin e parajetshëm, i cili veshi natyrën e njerëzve, siç thotë duke na mësuar hyjfolësi, i cili e shpëtoi atë nga prishje nëpërmjet pësimit të trupit; dhe ajo mbeti përgjithmonë e virgjër.

Ode VI
Ilthon is ta vathi

Sapo erdhi pas teje hyjfolësi yt, u përpunua,* dhe nga doganier u bë apostull,* Gjith'bërës Zot,* me fuqinë tënde krejt* i shkëlqyeshmi, Mattheu pra.

Lartësohet edhe rregullohet me shkrimin shpirtushqyes* të Ungjillit, o Matthe i tër'lum,* një bot' e tër',* kombet ngjiten lart në maj'* të virtyteve të larta shum'.

Kapen brenda rrjetës së hyjthurur që po e mban Mattheu* nxënësi, sistemet e krishtera,* çdo orthodhoks,* dhe drejtohen k'ta përher',* o mir'bërës, të të njohin ty.

Hyjlindësore

Duke shkruar se një virgjëresh' lindi pa far' dhe pa prishje* Bërësin e Gjithësisë, ty pra* të ungjill'zon,* o e paqortueshme,* i shkëlqyeshmi, Mattheu yt.

Irmosi: Ilthon is ta vathi

»Një stuhi më zhyti edhe rashë në »thellësit' e detit,* një stuhi mëkatesh »që s'njeh masë,* por ti si Zot,* o i »shum'mëshirëshëm,* ma ngri jetën »që nga fundi posht'.

Kontaqi
Ting. IV
O ipsothís en to stavró

Ishe përshtatur ti me zgjedh' drejtësie,*[26] pasi posht' hodhe zgjedhën e doganierit,* dhe u tregove si tregtar me shumë sukses,* se fitove urtësin' nga lart* porsi një pasuri të plot';* fjalën e vërtetë pra* predikove dhe shpalle;* dhe ngrite shpirtrat e dembelëve,* se shkrove fundin dhe orën e gjyqit ton'.[27]

Shtëpia

Tirania e armikut më shtyp pangopësisht dhe ma rrëmben egërsisht të gjithë farën[28] e shpirtit tim, o Matthe, mik i Krishtit; por ti pasi ke dhënë farën e uratave të tua, më fito mua për robërinë tënde[26] dhe tregomë si himnuesin tënd shumë të vogël dhe rrëfyes të arritjeve të tua të shumta e

të mëdha, dhe të lidhjes sate me Krishtin; kur i le të gjitha menjëherë, ndoqe ngrohtësisht atë që të kishte ftuar, duke u bërë ungjillori i parë në botë dhe shkrove fundin dhe orën e gjyqit ton'.[27]

Sinaksari

Më 16 të të njëjtit muaj, kujtimi i apostullit të shenjtë dhe ungjillorit Matthe.

Vargje: "Shpëton, o Jisu, edhe doganierë. Falenderime!"/ Kështu thërret Mattheu nga mesi i zjarrit.

Zjarr i palodhur vret Mattheun më 16.

Në të të njëjtën ditë, kujtimi i martires së shenjtë Ifigjeni.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Uq elátrefsan

Kishe qenë vula e hyjshme e vezullimit[29] të parë, si nxënës që ndriçoheshe nga rrezet e tij si prej një pishtari; atij duke psalur i thoje: O i përmbihimnuar, Zot i etërve dhe Perëndi, je i bekuar.

Si shërbyes i Fjalës, o i tërëlumur, në tenda të hyjnueshme, ku banon Krishti, atje të vuri të banosh siç të premtonte[30] ty Mbiperëndia, Zoti i etërve dhe i vetmi Perëndi i të gjithave.

Sëmundjet, o Matthe, dëbohen, dhe turma e demonëve arratisen[25] përmes karizmave të Shpirtit hyjnor, të cilat i ke brenda teje, dhe me të cilat psalje: Zot i etërve dhe Perëndi, je i bekuar.

Hyjlindësore

E rrëfeve, o apostull, me fjalët e tua të hyjshme Virgjëreshën e tërëhimnuar, se lindi Bërësin e gjithçkaje, të cilit i psalim të gjithë: O i përmbihimnuar, Zot i etërve dhe Perëndi, je i bekuar.

Ode VIII
Pedhas evajís

I hyjnizuar me prirje të papërkulshme për ty, Mattheu tepër i shenjtëruar, duke u bërë përmes birësimit ashtu si je ti nga natyra, tërhoqi botën që të të psalë ty, o Zot: Zotin e himnoni vepra dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Si një vetëtimë Fjala e lëshoi theologun nëpër botë, i cili nga një anë largonte errësirën, nga tjetër anë i ndriçonte kombet me dogma theologjie; prandaj dhe psalte: Zotin e himnoni vepra dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Falë mendjes dhe logjikës së pastër u lejua të shoqërohesh me Perëndinë; sepse sapo u shkëpute nga lënda, u afrove tek ai dhe u bashkove, o i lavdishëm; prandaj dhe psalje: Zotin e himnoni vepra dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Fjala denjoi të trupëzohet për të mirën e njerëzve, sepse kaloi Zoti portë virgjërie[31] dhe paraqiti një Hyjlindëse; prandaj thërrasim: Zotin e himnoni vepra dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Irmosi: Pedhas evajís

»Djemat e dënuar për t'u djegur prej »zjarrit i ka shpëtuar lindje e Zotit »Krisht, si simbol në lashtësi;*[31a] dhe »si një veprim tani* dhe tërë botën »po e mbledh për këng' e lavdërim.* »Himnojeni ju veprat e Zotit* dhe e »lartësoni përmbi të gjitha jetët.*

Ode IX
Apas jijenís

Prite tër' kurorën e bukuris' mendore të hyjnueshme;* me kuror' të hijshme shum'* mbret'rie u stolise, apostull, ti* nga dora e të Gjith'pushtetshmit,[32] o i urt', dhe feks* duke qenë* pranë fronit zotëror,* pranë Krishtit së bashku me engjëjtë.

Denjësisht fitove drurin e jetës,[33] ti je predikuesi* që shpall Perëndin' e gjall';* ungjillëzove tek bota një vizit'* hyjnore;[34] meqë mendja jote nuk u prish nga pem'* njohurie,*[35] mbete pa tundim, Matthe,* bazament i patundur i Kishës son'.

Me Ungjillin tënd ti nusen e Krishtit[36] e ke zbukuruar krejt* perëndishëm, Kishën ton'* si me kurorë,[37] o i hyjlum Matthe;* tani ajo bën panairin për kujtimin tënd* të shenjt', me gaz;* lyp që të shpëtojë kjo* nga çdo peripeci, çdo rrezik dhe tmerr.

Hyjlindësore

S'u largua kurrë Fjala që s'ka fillim nga gjiri prindëror,* pra nga Ati[38] pa fillim;* ungjillëzon Mattheu k'shtu, shkruan se:* Nga ti u mishërua Zoti,[39] veshi formën ton'*[40] nga çdo anë;* mori veçorit' e saj,* o e d'lirë, e tërëhimnuar, Zonj'.

Zbritësore: Apas jijenís

»Gjithë njerëzit, kërceni me ngazë»llim tek drit' e Shpirtit Shenjt;* eni »lavdërojeni,* engjëjt' e q'ellit eni »kremtojeni* këtë të shenjtë panair »të kryezonjës Mari* dhe thërrisni* ti »je më e lumura,* Virgjëresh' e kulluar »Hyjlindëse.*

Dërgimësore
En Pnévmati to ieró

E hodhe mençurisht zgjedhën* e doganës dhe shkove* pas Krishtit tonë, o Matthe,* o hyjmendës, me gjith' shpirt;* i ndoqe gjurmët e tij[9] ti* në mënyr' çuditëse;* ke marr' pjes' në mbretërinë* qiellore, po ashtu* në lavdin' e tij,[41] kështu* u bëre njohës misteresh.

Hyjlindësore

O Zonj' Hyjlind'se virgjëresh',* lutem, duart e tua* që mbajtën Krijimtarin ton',* ngriji për ndërmjetim ti,* në përgjërim për ne, që të* na shpëtojë prej ngasjesh* demonësh, të denjësojë* pra që të arrijm' të gjith',* o e paqortueshme,* në k'to të mira të ardhshme.

Lavdërime
Ting. IV
Edhokas simíosin

Fekse, o apostull, pikërisht si diell i shndritshëm plot* përmes rrezesh prej Shpirtit t' Shenjt',* edhe llamburite fort* gjithë botën, i lum,* me hyjnjohje, edhe dëbove mjegull, errësir'* politeizmi, Matthe i tërëurt';* ndaj sot bëjm' panairin tënd tepër të ndritshëm, që meriton* admirim, se ësht' si burim* shenjtërimi e hir për ne. ***(2x)***

Uleshe në lartësi hyjnjohjeje, apostull ti,* kur ndriçimin e Shpirtit t' Shenjt'* e prite, teksa u duk* tek ti në form' zjarri;* dhe me gjuh' të zjarrtë[6] hijove lëndën prishëse* të pabesis' së politeizmit qart';* prandaj të lavdërojmë si apostull edhe hyjfolës sot,* ne që bëjm' panairin tënd* të shenjt' me ngazëllim dhe mall.

O i urt', mësimet e hyjnueshme, shpëtimtare krejt* që the, në bot' gjëmuan fort,* Matthe; e pastrove k'shtu* prej manie idhujsh* çdo krijesë edhe ndriçove popuj pasurisht* me çdo shkëlqim prej ungjillit zotëror,* dhe tempuj idhujsh pra shkatërrove, edhe ndërtove ti* nëpërmjet Hirit kisha plot* për himnimin e Perëndis'.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Le të trokasim duart me këngë sot, o besnikë, me rastin e kujtimit të apostullit të nderuar dhe ungjillorit Matthe; sepse ai pasi hodhi zgjedhën dhe arin e doganës, ndoqi Krishtin dhe u bë predikues i hyjshëm i Ungjillit; prandaj doli profetikisht zëri i tij në tërë rruzullin[42] dhe ndërmjeton që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve të

tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i apostullit, Odet III dhe VI.

Kungatore: Në gjithë dheun.

CITIME

[1] Jak. 3.6

[2] Fil. 2.15

[3] Zah. 9.16

[4] Rom. 2.19

[5] Gjen. 3.1-6

[6] Vep. 2.1-4

[7] Matth. 10.8

[8] Matth. 18.17; 21.31; Lluk. 5.30; 15.1-2

[9] I Petr. 2.21

[10] Abak. 3.3

[11] Ef. 2.17

[12] Joan 15.1

[13] I Petr. 4.10

[14] Ef. 6.11,13

[15] II Petr. 1.18

[16] Gjen. 28.17

[17] Eks. 25.9-20,29; 38.1(37.1); 39.15; 40.21; Ligji i Dytë 10.2; Hebr. 9.4

[17a] Gjen. 28.12-16

[18] Eks. 13.21-22; Num. 9.15

[19] Eks. 3.2-3

[20] Lluk. 10.23

[21] Matth. 5.15; Mark. 4.21; Lluk. 8.16; 11.33

[21a] I Kor. 1.24

[22] Joan 20.22; Vep. 2.1-4

[23] Joan 14.23

[24] Ps. 44(45).2

[25] Matth. 10.5-8; Lluk. 10.19; Mark. 6.7,13

[26] Rom. 6.18-19,22

[27] Matth. 25.31-46

[28] Matth. 13.4; Mark. 4.4; Lluk. 8.5

[29] Hebr. 1.3

[30] Joan 14.2-3

[31] Jez. 44.2-3

[31a] Dan. 3.25

[32] Urt. Sol. 5.16

[33] Gjen. 2.9; Fja. Urt. 3.18; Is. 65.22; IV Makk. 18.16

[34] Matth. 1.20

[35] Gjen. 2.9,17

[36] Apok. 21.2,9; 22.17

[37] Is. 61.10

[38] Joan 1.18

[39] Matth. 1.23

[40] Fil. 2.6-7

[41] Matth. 19.28; Lluk. 22.29-30

[42] Ps. 18(19).5

MË 21 TË TË NJËJTIT MUAJ

Hyrja e Hyjlindëses së Tërëshenjtë në Tempull.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, pas Psaltirit (Kathisma I), Thirrtoret: 4 Vargëzime ngjallësore dhe 6 të së kremtes. Lavdi dhe Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i së kremtes. Përlëshoret ngjallësore dhe dy herë e së kremtes.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e së kremtes. Himnet Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret: 2 ngjallësore dhe e së kremtes. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret: 2 ngjallësore dhe e së kremtes. Pas Polieleit, Ndenjësorja e së kremtes (2x). Përsëri dhe përsëri. Se u bekua emri yt. Ipakoia. Shkallesat e tingullit. Proqimeni i së kremtes. Rendi i Ungjillit të së kremtes, por edhe: Ne që pamë Ngjalljen e Krishtit. Psalmi 50 hima. Vazhdimi i rendit të Ungjillit të së kremtes. Kanunet: ngjallësor dhe të dy të së kremtes. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Ndenjësorja e së kremtes (2x). Pas Odes VI, Kondaqi, Shtëpia e së kremtes dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja Krishti lind. Në vend të Më të nderuarën, psalen të dy Kanunet e së kremtes me madhështimet e tyre. Zbritësorja e Odes IX (O shpirt madhështoje. Mister të çuditshëm.). Dërgimësoret: ngjallësore dhe e së kremtes (2x). Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes. Lavdi i së kremtes. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes, por: ... ai që u ngjall prej së vdekurësh. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i së kremtes. Në vend të Të meriton: Engjëjtë. Si një arkë mistike. Kungatore Kupë shpëtimi. Pamë dritën.

NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Vargëzime
Ting. I
Ton uranion tagmaton

Pasi morën nga Zoti Joakimi dhe Ana fryt premtimi,[1] nënën e Perëndisë e kanë sjellë sot tek Tempulli si flijim i mirëpritur,[2] dhe Zaharia kryeprifti i madh, e pranoi pasi e bekoi.

(2x)

Shenjtorja e shenjtorëve u soll denjësisht që të banojë në të Shenjtat, si flijim i hyjpritur, dhe virgjëreshat e stolisura me virtyte, duke mbajtur llambadhe përpara, e ofronin tek Perëndia pikërisht si një enë tepër të hyjshme.

Sot le të hapet pra der' Tempulli hyjpritës krejt,* se Joakimi mori* dhe me lavd brenda solli* fronin,[3] tempullin e Tër'mbretit[4] ton'* dhe tek Zoti e dedikon;* i përkushton vajz' të zgjedhur tash prej atij,* që të bëhet nën' e tij më pas.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. IV

Davidi parathirri tek ti, o e pacenuar, duke paraparë përkushtimin e hyrjes sate në Tempull,[5] në të cilën anët e botës duke kremtuar sot të lavdërojnë, o e tërëhimnuar; se Zaharia dëfrehet duke të marrë ty që hyn sot në Tempull, e virgjër para lindjes dhe që mbete e paprishur pas lindjes, o Zonjë, nëna e Fjalës së jetës;[6] dhe të Shenjtat e të Shenjtave ngazëllohen kur të pritën ty, ushqyesen e jetës sonë; prandaj edhe ne me këngë të thërrasim ty: Lypi për ne Birit tënd dhe Perëndisë tonë të na dhurohet përdëllimi i madh.

Pasvargje

Ting. II Ikos tu Efathá

O dyer të Hierores, pranoni Virgjëreshën në të Shenjtat e të Shenjtave, tendë[7] të panjollshme të Perëndisë të gjithëpushtetshëm.

Varg: Do t'i sillen mbretit virgjëresha mbrapa asaj.

O virgjëresha, duke mbajtur llambadhe me ngazëllim, përcillni në të Shenjtat e të Shenjtave Virgjëreshën e kulluar si nuse të Tërëmbretit.[8]

Varg: Do të sillen me gaz dhe hare.

Dhoma e arsyeshme e Fjalës Perëndi, duke banuar në të Shenjtat e të Shenjtave, pranon bukë nga dorë engjëlli të hyjshëm.

Lavdi *dhe* Tani *I ngjashëm*

Drita tri herë e shkëlqyer, pasi të ndezi, o Hyjlindëse, në Tempullin e lavdisë, duke të madhëruar të dërgon ushqim qiellor.

Përlëshore

Sot është nisja.

NË MBRËMËSOREN E MADHE

Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit
(Lum ai njeri), Thirrtoret

Vargëzime
Ting. I
O tu paradhoksu thávmatos

O besnikë, sot le të kërcejm'* me shum' psalme, himnim* të këndojm' për Zotin[9] ton'* dhe bashk' të nderojmë tendën[7] e tij fort të shenjt',* pra arkën[10] e gjallë krejt,* se mbajti Fjalën që nuk mbahet dot askund.* Ofrohet mbi mendje kjo* si një fëmij' në mish tek Perëndia yn'.* Zaharia, kryeprifti* i madh e pranon atë* me dëfrim si banesë,* si shtëpi e Perëndisë ton'.

Tempulli[4] frymor si dhe i gjall'* i lavdisë së shenjt'* të Jisuit, Zotit ton',* e d'lira, e vetmja e bekuar mes grave,*[11] në Tempull Ligjor me gaz* ofrohet sot të banojë në të Shenjtat.* Dëfrehen bashkë me të* si Joakimi dhe Ana me gjithë shpirt,* edhe koret virgjërore*[12] i këndojnë Krishtit ton'* në mënyrë psalmike,*[13] edhe nënën e tij e nderojn'.

Predikimi i profetëve* si dhe lavdi i madh* i apostujve je, nder* e mburrje martirësh dhe ripërtëritja je* për gjith' ne mbi dhé, o nën'* e Zotit, se u pajtuam me Perëndin'*[14] përmes teje, Virgjëresh';* ndaj hyrjen tënde në Tempullin zotëror* e nderojmë dhe thërrasim* bashk' me engjëllin tek ti* të tër'thjesht' sipas Psalmit:* G'zohu,[11] lutja jote na shpëton.

Vargëzime të tjera
Ting. IV
Os jeneon en mártisin

Në të Shenjtat e t' Shenjtave,* e panjollshmja, e shenjta krejt,* po banon në Shpirtin e Shenjtë; nga një dor'* engjëlli çdo her' ushqehet, meqë është me të vërtet'* tempull plot me shenjtërim* i Jisuit dhe Zotit[4] ton'* që i shenjtë ësht';* shenjtëroi Gjith'-sin' ky me banimin brenda saj dhe hyjnizoi natyrën ton' të rrëshqitur keq.

Me llambadhe në duar vijn'* vajzat tok, me një gaz të madh* paraprijn' sot para llambadhes së tër'shenjt'* që ësht' mendore, e futin në të Shenjtat e t' Shenjtave* hyjnisht; parashfaqin k'shtu* se në t'ardhmen, në Shpirtin Zot* nga ajo një lavd* dhe hir që s' shprehet do të shndritë dhe do të shkëlqejë sa jan' ulur në errësir'[15] injorance t' thell'.

Thirri Ana e famshme plot* me hare: Zaharia, prit* vajzën që në Shpirtin e shpallën që më par'* njerëz, profetë të Perëndis', dhe fute në Tempullin* shum' të shenjtë ti hyjnisht,* që të

rritet me një qëllim,* që të bëhet fron* i tër'shenjtë i Zotit[3] të Gjith'sis', pallat mbret'ror dhe shtrat,[16] banes' dritëdhënëse me lavdi dhe nder.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. IV

Si u linde, o Zonjë hyjnuse ti, arrite në Tempull Zoti, që të rritesh në të Shenjtat e të Shenjtave, si e shenjtëruar; atëherë dhe Gabrieli u dërgua drejt teje, o e tërëpaqortueshme, duke të sjellë ushqim; të gjithë qiellorët u shtangën, duke parë Shpirtin e Shenjtë të fushojë brenda teje; prandaj, o e papikëluar, e panjollshme, që lavdërohesh në qiell e mbi dhé, nënë e Perëndisë, shpëto gjindjen tonë.

Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës dhe Leximet.*

Këndimi i Eksodit
(40.1-5,7,9,14,28-29)

Foli Zoti tek Moisiu duke thënë: Në ditën e parë të muajit të parë do të ngresh Tendën e Dëshmisë. Dhe do të vendosësh Arkën e Dëshmisë dhe do ta mbulosh me mbulesën. Dhe do të fusësh Trapezën dhe Shandanin, dhe do të vësh temjanicën e artë për të temjanisur përballë Arkës së Dëshmisë. Dhe do të vendosësh mbulesën e kurtinës mbi derën e Tendës së Dëshmisë. Dhe do të marrësh vajin e lyerjes, dhe do ta lyesh Tendën dhe të gjitha *që janë* në të, dhe do ta shenjtërosh atë dhe të gjitha enët e saj, dhe do të jetë e shenjtë. Dhe do të shenjtërosh Altarin, dhe Altari do të jetë i shenjtë i të shenjtave. Dhe bëri Moisiu të gjitha sa i porositi Zoti, ashtu bëri. Dhe mbuloi reja Tendën e Dëshmisë dhe me lavdi Zoti u mbush Tenda. Dhe nuk mundi Moisiu të hynte në Tendën e Dëshmisë, sepse hijesonte mbi të reja, dhe me lavdi Zoti u mbush Tenda.

Këndimi i III i Mbretërve
(8.1,3-7,9-11)

U bë që Solomoni, sapo përfundoi së ndërtuari shtëpinë e Zotit, dhe mblodhi gjithë pleqtë e Izraelit në Sion, që të ngrenin Arkën e Dhjatës së Zotit nga qyteti i Davidit; ky është Sioni. Dhe ngritën priftërinjtë Arkën dhe Tendën e Dëshmisë dhe të gjitha orenditë e shenjta që ishin brenda Tendës së Dëshmisë. Dhe mbreti dhe gjithë Izraeli *ishin* para Arkës. Dhe e fusin priftërinjtë Arkën e Dhjatës së Zotit në vendin e saj, në Dhavirin e shtëpisë, në të Shenjtat e të Shenjtave, nën flatrat e Keruvimeve; sepse Keruvimet i kishin flatrat të ngrëra

mbi vendin e Arkës, dhe Keruvimet mbulonin përreth Arkën dhe mbi sendet e shenjta të saj përsipër. Dhe nuk kishte në Arkë veçse dy pllakat e gurta, pllakat e Dhjatës, të cilat i vuri atje Moisiu në Horeb, të cilat dha Zoti për besëlidhje. Dhe u bë, sapo dolën priftërinjtë nga Shenjtërorja, edhe reja e mbushi shtëpinë e Zotit; dhe nuk mundnin priftërinjtë të qëndronin për të shërbyer nga faqja e resë, sepse mbushi lavdia e Zotit shtëpinë e Zotit.

Këndimi i profecisë së Jezekielit
(43.27; 44.1-4)

Do të jetë që nga dita e tetë dhe më pas, do të bëjnë priftërinjtë mbi altarin holokaustet tuaja dhe ato të shpëtimit tuaj. Dhe do t'ju pranoj, thotë Zoti. Dhe më ktheu drejt udhës së portës së jashtme të të Shenjtave që sheh nga lindja dhe ajo ishte e mbyllur. Dhe Zoti tha tek unë: Kjo portë do të jetë e mbyllur, nuk do të hapet dhe askush nuk do të kalojë nëpërmjet saj, se Zoti, Perëndia i Izraelit do të hyjë përmes saj dhe do të jetë e mbyllur, sepse ky prijës rri mbi të që të hajë bukë. Ai do të hyjë nga udha e portës së Elamit dhe nga udha e tij do të dalë. Dhe më futi nga udha e portës, *që ishte* drejt veriut përballë shtëpisë. Dhe pashë, dhe ja plot lavdi *ishte* shtëpia e Zotit.

Në Liti
Ting. I
I Gjergjit të Nikomidhisë

Le të gëzohet sot qielli nga lart dhe retë le të spërkasin[17] hare për madhështimet krejt paradoksale të Perëndisë tonë; se ja porta që shikon drejt lindjes,[18] pasi lindi nga premtimi prej një sterileje të pafrytshme[1] dhe si u përkushtua tek Perëndia për banim, sot sillet tek Tempulli si ofrim i panjollë.[19] Le të ngazëllohet Davidi duke i rënë harpës.[20] Do t'i sillen, thotë, mbretit virgjëresha mbrapa saj, ato që janë afër saj do të sillen[12] në tendën e Perëndisë, brenda Hierores së tij, të rritet që të bëhet banimi i të lindurit përpara jetëve pa rrjedhje nga Atë për shpëtimin e shpirtrave tanë.

Ting. IV I të njëjtit

Sot tempulli hyjnxënës,[4] Hyjlindësja, tek Tempulli i Zotit sillet dhe Zaharia e mirëpret atë. Sot të Shenjtat e të Shenjtave[21] ngazëllohen dhe kori i engjëjve bën panair mistikërisht. Tok me këta duke kremtuar edhe ne sot, le të thërrasim bashkë me Gabrielin: Gëzohu, o hirplote, Zoti është me ty,[11] ai që ka përdëllimin e madh.

I njëjti

Ejani gjithë kombet, le ta lavdërojmë të vetmen të panjollshme, që u predikua më parë prej profetëve dhe u soll në Tempull, atë që u paracaktua para jetëve nënë dhe që në kohët e fundit u tregua Hyjlindëse. O Zot, me ndërmjetimet e saj na jep paqen tënde dhe përdëllimin e madh.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. I
I Leonit Mjeshtër

Feksi ditë ngazëlluese dhe e kremte e tërënderuar; sepse sot e Virgjëra para lindjes dhe që mbeti e virgjër pas lindjes, sillet në Tempull. Dhe gëzohet plaku Zahari, prindi i Pagëzorit, dhe thërret me hare: Afroi pritja e të pikëlluarve, që të kushtohet në Tempull të shenjtë si e shenjtë, për banimin e Tërëmbretit. Le të dëfrehet paraati Joakim dhe Ana le të ngazëllohet, sepse i blatuan Perëndisë si mëshqerrë trevjeçare[22] Zonjën e paqortueshme. O nëna, bashkëgëzohuni, o virgjëresha, lodroni, dhe ju o beronja, kërceni tok, sepse na hapi mbretërinë e qiejve tërëmbretëresha e paracaktuar. Gëzohuni, o popuj dhe ngazëllohuni.

Pasvargje
Ting. Tërth. I
Heris askitikón

Qielli ngazëllohet me dhen',* se shohin qiellin mendor që të shkojë drejt,* tek Tempull i hijshëm, ku do të rritet me shpres'tari* virgjëresh' e vetme,* pa asnjë qortim.* I thirri me plot habi* Zaharia: Po hap për ty,* o port' e Zotit,*[18] të gjith' dyert e Tempullit;* me gëzim kërce* brenda tij dhe me ngazëllim,* se njoha dhe e kam besuar, se erdhi qartësisht* tashmë çlirimi i kombit tim Izraelit,[22a] dhe do të lind'* nga ti Zoti Fjala,* që dhuron tek bota falje dhe përdëllim të madh.

Varg: Do t'i sillen mbretit virgjëresha mbrapa asaj.

Ana, pra hiri i hyjshëm qart',* e sjell në Tempullin e Zotit me shum' gëzim* të d'lirën, gjithmon' të Virgjër, të hirësuar krejt'sisht,* duke ftuar tashmë,* që ta paraprijn'* të rejat e virgjëra* me llambadhe në duar. Thot':* Shko, o fëmijë,* edhe bëhu tek dhënësi* dedikim, ofrim* dhe temjan erëmirë plot;* hyr ti në të pashkelura, mësoji misteret tër'* dhe përgatitu të bëhesh banes' e këndshme, e bukur fort* për Krishtin, i cili* i jep botës përdëllimin e madh si dhe shpëtim.

Varg: Do të sillen me gaz dhe hare.

Tempulli që ka zën' Perëndin'* po dedikohet brenda Tempullit zotëror,* e Virgjëra e Tër'shenjtë; të reja para asaj* paraprijn' dhe mbajnë* tash llambadhe tok;* dhe çifti i prindërve* të shkëlqyer po hidhen bashk',* pra Joakimi* edhe Ana kërcejn' me gaz,* sepse mbajtësen* e krijuesit të Gjith'sis'* lindën. Ajo kërcen përbrenda Tendës së hyjshme sot,* edhe nga dora e engjëllit po ushqehet e hirshmja krejt,* dhe do paraqitet* nën' e Krishtit, që i jep botës përdëllim të madh.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. II
I Sergj ajiopolitit

Sot ne, turma e besimtarëve të mbledhur, le të bëjmë panair shpirtërisht edhe hyjfëmijën e virgjër dhe Hyjlindësen që sillet në Tempull Zoti, le ta lavdërojmë besërisht. Ajo u parazgjodh nga të gjithë brezat për banesë të Krishtit tërëmbret dhe Perëndisë të të gjithave. O ju të virgjëra, duke mbajtur llambadhe paraprini duke nderuar ecjen e respektuar të Gjithmonëvirgjërës. O nëna, duke shkarkuar çdo pikëllim, shoqërojeni me hare, duke e himnuar atë që u bë Nënë Perëndie dhe shkaktare gëzimi për botën. Të gjithë pra, me ngazëllim le të thërrasim bashkë me engjëllin "Gëzohu" tek Hirplota,[11] që përherë ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Përlëshore
Ting. IV

Sot është nisja e mir'pëlqimit të Perëndis' dhe paralëçitja e shpëtimit të njerëzve, te tempull i Perëndisë madhërisht rrëfehet Virgjëresha dhe Krishtin u paralajmëron të gjithëve. Asaj dhe ne le t'i thërresim me zë të madh: Gëzohu, o mbarim i urdhërit të Krijetarit.*

(3x)

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. I Ton tafon su Sotír

I sillet Perëndis'* fryti i Joakimit* dhe Anës, që kan' qenë të drejtë, besnikë;* ofrohet brenda Tempullit të shenjt' foshnjë në mish ajo,* pra ushqyesja* e jetës son'. Zaharia* e bekon atë.* Të gjith' le ta lumërojmë* si nënën e Zotit ton'.

Lavdi *dhe* Tani *I njëjti*

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Para zënies, o e d'lir',* u shenjtërove për Zotin,* dhe pasi ke lindur k'tu* mbi dhé, u solle si dhurat'* tek Perëndia, premtimin[1] at'ror përmbushje;* që në foshnjëri me shum' pastërti,* duke qenë tempull i hyjshëm[4] ti* vërtet, u dhe te Tempulli i hyjshëm* plot nur si dhe me llambadhe pra;* u duke ena* e dritës, Krishtit;* ecja jote e madhe ësht'.

Lavdi *dhe* Tani *I njëjti*

Pas Polieleit (Fjalën e mirë, Psalmi 44), Ndenjësore Ting. Tërth. IV
To prostahthén mistikós

Le të gëzohet himnshkruesi, Davidi;* le të kërcejnë* Joakimi tok me Anën,* se fëmijë e shenjtë* doli prej atyre,* Maria, llambadh' e hyjshme drit'prurëse.* Gëzohet që futet brenda* Tempullit sot.* Kur e pa këtë e bekoi biri i Varahiut dhe thërriste me hare:* G'zohu, o mrekulli me buj'.

Lavdi *dhe* Tani *I njëjti*

Shkallesat, Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni
Ting. IV

Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule veshin tënd, dhe harro popullin tënd dhe shtëpinë e atit tënd, edhe do të dëshirojë mbreti bukurinë tënde.

Varg: Nxori zemra ime fjalë të mirë.

Ungjilli. Psalmi 50. Pastaj:
Lavdi *Ting. II*

Sot tempulli frymor i mbretit[4] të madh hyn në Tempull, që të përgatitet për atë si banesë hyjnore. O popuj, ngazëllohuni.

Tani *I njëjti*

Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. IV

Sot tempulli hyjnxënës,[4] Hyjlindësja, tek Tempulli i Zotit sillet dhe Zaharia e mirëpret atë. Sot të Shenjtat e të Shenjtave[21] ngazëllohen dhe kori i engjëjve bën panair mistikërisht. Tok me këta duke kremtuar edhe ne sot, le të thërrasim bashkë me Gabrielin: Gëzohu, o hirplote, Zoti është me ty,[11] ai që ka përdëllimin e madh.

Kanune
Ode I
Kanuni i parë, që ka Akrostihidhë deri në Ode VII: "Ti, o Zonjë, i jep fjalës hirin".
Poezi e zotit Gjergji
Ting. IV
Irmosi: Anikso to stoma mu.

»Ja gojën e çel tani i frymëzuar prej

»Shpirtit[23] t' Shenjt* dhe këngë do t'i
»këndoj nënës së madhe mbi fron;*[24]
»dhe do ta kremtoj* me valle buzë-
»qeshur;* me zë do t'i shpall kudo
»Hyrjen tek Tempulli.*

Të njohim thesar të urtësis',[25] o e
tër'panjollëshme,* burim i pashter-
shëm që gufon gjithnjë hire plot;* të
kërkojm', na derdh* si shira pika di-
jesh,* o Zonjë Hyjlindëse, që të him-
nojmë ty.

Meqë ke qen' më e lartë se çdo qiell,
e tërëd'lir',* dhe tempull, pallat
mbret'ror,[4] në Tempull Zoti u dhe,* iu
besove k'tij* të përgatitesh mir' ti*
të bëhesh banesa e shenjt'[26] e pranis'
së tij.

Ashtu si një diell lindi dritë hiri Hyj-
lindësja,* të gjith' na ndriçoi e na
mblodhi, që ta himnojm',* ta stolisim
pra,* me këngë panairin* e ndritshëm
që bëjm' për të; ejani, mblidhuni.

Si ngriti dhe hapi dyertë[27] e Tempullit
zotëror,* e shum' lavdëruara, port' që
nuk shkelet[18] me mend,* na nxit ne
tani,* që si të hyjmë bashkë,* çudirat
e saj të hyjnueshme t'i shijojm'.

Kanuni i dytë
Poezi e zotit Vasil
Ting. I
Odhín epiníkion

Të gjith' le të mblidhemi sot me
Hyjlind'sen, të bëjm' panair dhe festë
shpirtërore, ta nderojmë me këngë
ne,* se si dhurat' blatohet tek Zoti
në Tempull kjo.[28]

Me shum' këngë le të himnojm'
vajtjen e lavdëruar të Zonjës, se si
tempulli i Zotit[4] profetikisht[5] u dha,*
blatohet si dhuratë e çmuar në Tem-
pull sot.[28]

Kur si një dhurat' të gjith'çmuar
ofronte tek Zoti në Tempull,[28] porsi në-
në, Ana e pacen ngazëllohej shum';*
me të bën panair me gaz dhe Joakimi
bashk'.

Davidi, stërati yt të ka himnuar që-
moti, hyjnuse Virgjëreshë, kur tha se
je bijë e mbretit[29] Krisht,* sepse e lin-
de dhe e mënde foshnjë si nën' ti.

Hyjlind'sja në mosh' trevjeçare, fëmi-
jë po sillet tek Zoti dhe e priti Zaharia,
prifti i Perëndis'* në Tempull dhe me
ngazëllim e përkushtoi krejt.

Kërceni të virgjëra llambadheprurëse
sot dhe në krye jini;[13] dhe ju nëna, për
mbret'reshën dhe nënën tok* këndoni,
se në Tempullin e Mbretit Krisht
po vjen.[5]

Lavdi

Trini e bashk'qenëshme, At' edhe
Fjalë dhe Shpirt i Tër'shenjt', të lavdë-
rojmë besërisht si Bër'sin e Gjithë-

sis',* dhe të thërrasim shpres'tarisht: Shpëtona ti, o Zot.

Tani

Pasi kishte veshur mantelin mbret'-ror, që u lye prej gjakut tënd Jisui, mbreti yn', o e papërlyer Zonj',* ka dal' dhe rigatoi tër' gjinin' ton' mirësisht.

Zbritësore: Hristós jenate

»Ja Krishti lind lavdërojeni; ja Krisht' »i q'ellit vjen dilni priteni;* ja Krishti »mbi dhenë ngrehuni.* Zotin pra e »këndoni lart e mbi dhé,[30] dhe me nga-»zëllime* përhimnojeni me mall popuj »dhe me lavdi.*

Ode III
Kanuni i parë
Irmosi: Tus sus imnologus

»O Zonjë dhe nën' e Perëndisë, burim »i pasosur jetësor,* ti siguroi gjith' ata »që të këndojnë plot me zell,* dhe »Hyrjen tënde që nderojn',* kurorëzoi »me çdo lavdi.*

U duk Tempulli i Virgjëreshës i këndshëm, i hijesuar sot,* si nuse u stolis për dhomën e gjall' zotërore, pra* të pastër, pa cen, më të ndritshme se të gjitha, të cilën pret.

Në krye të korit hidhet edhe kërcen bashk' me ne Davidi mbret,*[31] të quan mbretëreshë të stolisur, o e panjollshme,* që pranë Perëndisë Zot qëndron[8] në Tempull,[5] o shum' e d'lir'.

Nga gruaja shkelja e par' erdhi qëmoti[32] për ne, për njerëzin',* prej saj dhe rimëkëmbja, dhe paprishja lulëzoi, pra* Hyjlind'sja, që sot sillet në shtëpin' e Zotit dhe Perëndis'.

Kërcejnë ushtritë engjëllore dhe gjith' gjindja njerëzore tok;* mbajnë llambadhe sot e rendin para teje, o e d'lir';* himnojnë madhështit' e tua në shtëpinë e Perëndis'.

Kanuni i dytë
Stereothito i kardhia mu

Sa duam festa, panair të bëjm',* dhe le të dëfrejmë të gjithë në shpirt,* le të lodrojmë për të kremten e shenjtë të bijës, Vajz'* e Tër'mbretit[29] edhe nënës pra* të Zotit ton' Perëndi.

O Joakim, dëfre nga zemra sot,* Ana, ngazëllohu në shpirt dhe ti;* se ju ofroni tash tek Zoti, atë që prej jush u lind,* që ësht' trevjeçare, si mëshqerr',*[22] të thjeshtën, pa cen aspak.

Mariama, Nën' Perëndilindësja* dhe banesa e Perëndisë ton',*[26] ofrohet trevjeçare në mish në Tempull të shenjt' ajo,* edhe virgjëreshat para saj* vrapojn' me llambadhe tok.

Se shenjtërimi i lavdis' deshi* të ba-

nojë brenda një tende të shenjt';* k'shtu preferoi[33] tenda[7] që mbajti Zotin dhe Perëndin',* shqerra e papikëlluar dot,* p'llumbeshë e panjollshme.

Le të himnohet me këndim e bes'* trevjeçarja në trup, por që shpirtërisht* shumëvjeçare, më e gjerë se qiejt, me epërsi* mbi fuqitë qiellore lart,* hyjnusja e virgjër pra.

Kremtojmë hyrjen e Hyjlindëses* në një vend që nuk shkelej; pra mendërisht* le të afrohemi tek Tempulli me virgjëreshat[5] sot,* duke mbajtur me gëzim të thell'* edhe ne llambadhe bashk'.

O priftërinj të Perëndisë ton',* vishni drejtësinë[34] me hir, dilni jasht'* me ngazëllim, dhe prisni bijën e mbretit[29] dhe Perëndis',* edhe hyrjet e të shenjtave* i hapni dhe jepini.

Lavdi

Drit' është Ati, ësht' dhe Biri drit'* edhe Shpirti ngushëllimtar ësht' drit'.* Triadha perëndishëm feks, porsi një diell llamburit,* ruan shpirtrat tanë dhe shkëlqen* përmbi tërë botën ton'.

Tani

Të kishin parapredikuar ty,* o e thjesht', si ark' shenjtërimi,[10] shandan,*[35] dhe gjithashtu si temjanicë floriri,[36] si një tryez';*[37] pra ne të himnojmë ty si tend'* që mbajti Hyjninë ton'.

Zbritësore: To pro ton eonon

»Përpara nga jetët* lart në q'ell ti »ke lindur prej Atit si Bir,* edhe tani »prej Virgjëreshës* si një foshnjë u »shfaqe.* O Krisht Perëndi, të falemi;* »ti që na ngrite përpjetë[38] me nder,* »o Zot, i shenjtë je.*

Ndenjësore Ting. IV
Kateplaji Iosíf

Thirre, o David, me zë* çfar' ësht' e kremtja që bëjm' sot?* Ësht' për Vajzën, që dikur* e përhimnove ti me psalm* në librin tënd si të virgjër, fëmij' dhe hyjbij',*[29] duke thënë se do t'i sillen bashk'* mistikisht dhe mbrapa asaj mbretit* mikeshat virgjëresha afër saj;[5] pra* ti na e bëj të çuditshëm* dhe mbar'bot'ror k'të* festim; shkaktarja* e shpëtimit ton' erdhi.

Lavdi *dhe* Tani *Të njëjtën*

Ode IV
Kanuni i parë
Irmosi: Tin aneksihníaston

»Të pagjurmësuarin plan perëndor*[39] »që po mishërohet i larti Zot* prej

»Virgjëreshës,* Abakumi si profet e »pa dhe tha me zë të madh:* O Zot i »fuqishëm, lavdi më ty.*

Duke e pranuar sot shtëpia e Perëndisë portën e pashkelur,[18] pushoi adhurimin dhe hijen e Ligjit,[40] duke u thirrur të mbidheshmëve, se me të vërtetë u duk madhërisht e vërteta.

Malin hijeplotë, që si e parapa qëmoti Abakumi, e parapredikoi, pasi eci brenda të pashkelurave të Tempullit, lulëzon virtyte dhe mbulon plotësisht anët e botës.[41]

Le të shohë e tërë toka gjëra të huaja dhe të mrekullueshme:[42] sesi Virgjëresha, duke pritur ushqimin me anën e engjëllit, pranon simbole të ekonomisë.

Meqenëse, o hyjnuse, u duke tempull[4] dhe pallat mbretëror si dhe qiell frymor i Mbretit, në Tempullin Ligjor dedikohesh sot, e ruajtur për atë, o e tërëpapërlyer.

Kanuni i dytë
En Pnévmati provlepon

O profet Isaia, na profetizo: Cila është virgjëresha me barrë?[43] Është ajo që mbiu nga rrënja e Judës[44] dhe lindi nga Davidi mbret, fryti i lavdishëm i farës së shenjtë.[45]

Filloni, o virgjëresha, dhe këndoni këngë,[13] me llambadha në duar, duke kremtuar tok me ne dhe lavdëroni ecjen e së kulluarës dhe Hyjlindëses, e cila tani largohet për në Tempullin e Zotit.

O Joakim dhe Ana dëfreni tani, duke sjellë tek Zoti në Tempull si mëshqerrë trevjeçare[22] atë që lindi prej jush dhe që do të bëhet Nëna e dëlirë e Krishtit tërëmbret, Perëndisë.

Duke qenë e shenjta e të shenjtëve, o modeste, deshe të banosh në Tempull të shenjtë; dhe duke komunikuar me engjëjt, o Virgjëreshë, duroje duke pritur çuditërisht bukë nga qielli, o ushqyese e jetës.

Joakimi dhe Ana, pasi lindën jashtë çdo shprese të dëlirën e papikëluar, premtonin shpresëtarisht ta sillnin tek Perëndia; dhe e zbatojnë[46] duke e dhënë në shtëpi Zoti, pikërisht si flijim sot atë që u lind prej tyre.

Nxori lastar dikur shkopi i Aaronit,[47] duke parafiguruar, o e papërlyer, lindjen hyjnore; se do të zësh pa farë e nuk do të prishesh, dhe pas lindjes do të shihesh e virgjër, duke mëndur si foshnjë Perëndinë e të gjithave.

Shpresëtarisht vraponi afër Virgjëreshës, o virgjëresha, afër Nënës, o nëna, duke e nderuar së bashku me ne atë që u lind si flijim i patëmetë,[19] dhe

që lindi si frytdhënëse për Perëndinë; pra të gjithë le të kremtojmë me hare.

Lavdi

Lavdërojmë Trini në persona, Njësi në trajtë, Perëndi të vërtetë, të cilin e himnojnë brigada engjëjsh dhe kryeengjëjsh,[48] si zotëruesin e Krijesës, të cilit të gjithë i falemi besërisht përherë.

Tani

Iu përgjëro pa pushim Birit tënd dhe Perëndisë, të cilin linde në mish, o e tërëpacenuar, e kulluar, që të çlirohen gjithë shërbëtorët e tu nga kurthet e shumëanëshme të djallit dhe nga ngasje të ndryshme që sulmojnë.

Zbritësore: Ravdhos ek tis rizis

»Shkop nga rrënja e Jeseut je* dhe »lule[44] prej asaj, o Krisht,* ke lulëzuar »prej Hyjlindëses, prej mali hijeplot'* »dhe të dendur[41] me lisa;* dhe u mi»shërove prej Marisë,* dhe linde, o Pe»rëndi,* Zoti i fuqishëm lavdi më ty.*

Ode V
Irmosi: Eksesti ta símpanta

»Të gjith' i habite ti me një çudi dhe »një lavdi,* ti o Virgjëresh' e pamar»tuar;* sot brenda Tempullit zotëror »hyre thell',* si një tempull shum' i »pastër pra,* dhe shpëtim që lartazi* »u dhuron shpresëtarëve.

Si shenjtërim i lavdëruar dhe kushtim i hyjnueshëm, pasi u dedikua sot tek Tempulli i Perëndisë, Virgjëresha e tërëdëlirë, ruhet për banim vetëm për Perëndinë tonë[26] dhe tërëmbretin, siç e di ai.

Duke e parë dikur, o e tërëpacenuar, bukurinë e shpirtit tënd, Zaharia thërriste me besë: Ti je shpërblimi, ti je gëzimi i të gjithave, ti je rithirrja jonë, përmes së cilës i panxënshmi do të shihet tek unë i nxënshëm.

Oçuditë e tua përmbi mend, o e tërëpacenuar! Lindja jote është e huaj; mënyra e rritjes, e huaj; të gjitha të tuat janë të huaja dhe paradoksale,[42] o hyjnuse, dhe të pashpjeguara nga njerëzit.

Duke qenë kandil i shumëndritshëm,[35] o hyjnuse, sot fekse në shtëpinë e Zotit[49] dhe na shkëlqen me karizmat e respektueshme të mrekullive të tua, o Hyjlindëse e tërëhimnuar.

Kanuni i dytë
To fainón imín eksanátilon

Le të vishemi me të bardha, ne orthodhoksët, duke bashkërendur dhe duke lavdëruar hyjnënën, sepse sot i blatohet Zotit si flijim i mirëpritur.

Le të ngazëllohen stërprindërit sot, o Zonjë, dhe le të dëfrehet lindësja jote së bashku me atin tënd,[50] sepse fryti i tyre i sillet Zotit.

Le ta përhimnojmë të gjithë, duke kremtuar me besë mëshqerrën e pacenuar,[22] e lavdëruar dhe me shumë epitete, sepse e kishte në bark viçin hyjnor në mish.

Sot brenda shtëpisë së Perëndisë regjistrohen në Shpirtin e Shenjtë kontratat e hyjshme të martesës, o Virgjëreshë e dëlirë, e të shtatzënisë sate përmbi mend.

Le të hapen dyert e jashtme të lavdisë së Perëndisë tonë dhe le të pranojnë atë që s'njohu martesë, nënën e Perëndisë, pikërisht si mëshqerrë trevjeçare[22] të papërdhosur.

Le të himnojmë malin e shumëçmuar dhe hijeplotë,[41] Gjithmonëvirgjërën, që u bë nënë Perëndie, sepse ajo flakëroi dritën nëpër anët e dheut.[51]

Lavdi

Duke e lavdëruar, le t'i falemi Trinisë së vetme, të përmbipushtetshme dhe të amshuar në tre persona, natyrë e pandarë dhe e barasvlefshme në lavdi.

Tani

Ndërmjetimin tënd, o Perëndilindëse, e kemi në peripeci liman të qetë dhe të pamposhtur, duke na çliruar gjithnjë nga rreziqe dhe pikëllime.

Zbritësore: Theós on irinis

»O Zoti i paqes, o Atë me hir,* për »shpëtimin e njerëzve Engjëllin,* që »paqen perëndore sjell, dërgove[52] »përmbi dhé;* sot pra të udhëhequr* »me dritë Perëndie,* që me natë ngri»hemi[53] dhe lavdërojmë njerida»shësin.*

Ode VI
Kanuni i parë
Irmosi: Tin thian taftin

»Këtë të kremte e lusim sot për »Zonjën edhe nënën Hyjlindëse; gjithë »hyjmendësit,* eni trokisni pra duar»të* dhe lavdëroni Zotin që lindi prej »asaj.*

Ai që sjell me një fjal' të gjitha,[54] lutjen e të drejtëve e dëgjoi, pra e zgjidhi krejt* sterilizimin, i dhembshuri,* sëmundjen, dhe dhuroi shkaktaren e hares'.

Meqen'se Zoti yn' donte që ta bënte në gjith' kombet të njohur qart' shpë-

timin,[55] mori tash* nga njer'zit vajzën që s'kish përvoj'* burri, si shenj' pajtimi dhe rigatimi prap'.

Ti more pjes' në shijimin e pacen plot'sisht në Tempull, o tepër e panjollshme Zonja jon',* si një shtëpi hiri; jan' atje* thesaret fshehtazi[25] të ekonomis' së shenjt'.

Kur si kurorë mbret'rore të pranoi ty, o hyjnuse, Tempulli dëfrehej me gëzim,* druhej nga gjërat e larta shum',* se shihte përfundim profecish në ty, o Zonj'.

Kanuni i dytë
Ton profitin Ionán

O besnikë, ta kremtojm' festën shpirtërore thell'* me bes', duke përhimnuar ne nënën e Jisuit Perëndi,* se më e shenjt' se Mendjet në qiell ësht'.

Me këndime shpirtërore,[9] besnikë, ta lëvdojm'* nënën, lindësen e dritës, se sot u shfaq lavdishëm, kur eci* përpara për në Tempullin zotëror.

Shqerra pa përdhosje dhe pëllumbesha e tër'd'lir'* u blatua të banojë në streh' të Perëndis', e panjollshmja,* që u paracaktua si nën' Zoti.

Tenda[7] qiellore dhe tempulli i Perëndis'*[4] bën në Tempullin Ligjor hyrjen. Prej asaj shkëlqen çdo drit' tek ne,* të cilët ishim në errësir'[15] të mjer'.

Si një foshnjë mishërisht, e përsosur shpirtërisht* futet arka e shenjt'[10] brenda shtëpis' së Perëndis' dhe Zotit ton',* për të shijuar Hirin hyjnor bollshëm.

Ti nga çdo lloj ngasjeje dhe rreziku shpirtëror* na çliro ne që po rendim tek ti me ndërmjetimet e tua,* o e himnuar, nënë e Zotit Krisht.

Lavdi

Ati edhe Biri dhe Shpirt' i drejtë, një Trini* e pandarë edhe Njësi trihipostate, mëshirona ti;* pushtetit tënd të hyjshëm i falemi.

Tani

I panxëni në çdo gjë, o Hyjnën', pasi u bë* brenda barkut tënd i nxënshëm, ka dal' nga ti, o e panjollëshme,* natyrë e dyfisht', Perëndi-njeri.

Zbritësore: Splahnon Ionán

»Si profeti shën Jona,* pasi u gëlltit »në det* prej peshkut të madh doli dhe »nuk u nga,* gjithashtu tani,* edhe »Fjala e q'ellit Jesuj shpëtimtar* shkoj »nga gjir' i Virgjëreshës dhe Hyjlindë»ses,* se u mishërua pa pësim* edhe »nënën e la të pac'nueshme.*

Kontaqi
Ting. IV
O ipsothís en to stavró

I përmbipaqmi tempull i Shpëtimtarit,* e përmbishenjta nusërore e virgjër* dhe ark' e art' e ndritëshme, thesar i Zotit Krisht,* sot po sillet me lavdi* në shtëpin' e Perëndisë* dhe Hirin brenda po na sjell* plot me Frymën e Shenjtë;* pra e himnojnë engjëjtë gjithmon',* kjo këtu është banesa e qiellshme.*

Shtëpia

Duke parë tek Virgjëresha të deklarohet dhe të përmbushet dukshëm hiri i mistereve hyjnore dhe të papërshkrueshme të Perëndisë, gëzohem dhe hutohem të kuptoj mënyrën e huaj dhe të pashprehshme: Si e papërlyera u dallua e vetmja e zgjedhur mbi çdo krijesë të dukshme dhe mendore! Prandaj duke dashur ta lavdëroj, çuditem tepër fort në mendje dhe në fjalë, por megjithatë duke guxuar shpall dhe madhështoj, kjo këtu është banesa e qiellshme.

Sinaksari

Më 21 të të njëjtit muaj, kujtimi i Hyrjes së Hyjnënës në Tempull.
Vargje: Brenda Tempullit të ushqen Gabrieli, o Vajzë,/ dhe do vijë pas pak që të të thotë "Gëzohu!".[11]
Hyri Maria në Tempull të shenjtë më 21.

Me ndërmjetimet e Perëndilindëses, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Kanuni i parë
Irmosi: Uq elátrefsan

»Nuk u faleshin krijesave hyjmendë»sit, por Krijetarit lart,* dhe kërcëni»min me zjarr* e shkelën me trimëri, »psalnin me brohori:* Zot lavdi më ty;* »o Perëndi i etërve,* ti je vetëm i be»kuar.*

Ja ku sot shkëlqeu mbi anët e dheut pranverë e hareshme, që na ngazëllon me hir tërë shpirtin dhe mendjen tonë, panairi i Perëndilindëses; prandaj le të dëfrejmë mistikërisht.

Le ta pasojë Gjithësia si suitë nënën mbretëreshë, qielli dhe dheu, brigadat e engjëjve dhe shumica e njerëzve, dhe le të thërrasin: Futet në Tempull gëzimi dhe çlirimi.

Ligji i shkronjës kaloi, u zhduk pikërisht posi hije[40] dhe shndritën rrezet e Hirit kur futeshe në Tempullin e Perëndisë, o nënëvirgjëreshë e pacenuar, gjithmonë e bekuar.

Iu nënshtrua fëmijës tënd, o e Tërëpapërlyer, si Bërësi dhe Perëndia,

qielli, dheu dhe të nëndheshmet,[56] dhe çdo gjuhë njerëzish pohon se u duk madhërisht Zoti, Shpëtimtari[57] i shpirtrave tanë.

Kanuni i dytë
I káminos Sotír edhrosízeto

Le të kërcejmë, o krishtdashës sot, le të himnojmë Zonjën e pacenuar, duke lavdëruar siç e meritojnë Joakimin dhe Anën.

Profetizo ti që thua në Shpirtin: Do të udhëhiqen virgjëresha mbrapa teje, do të sillen në Tempull[5] për ty, nënën mbretëreshë.

Gëzoheshin brigadat e engjëjve, dëfreheshin shpirtrat e të drejtëve,[58] kur nëna e Perëndisë blatohej tek të Shenjtat.

Gëzohej edhe në trup edhe në shpirt Maria e paqortueshme, kur qëndronte me qetësi në Tempullin e Zotit, si një enë e përmbihyjnueshme.[59]

Duke marrë ushqimin qiellor, kishte përparuar në urtësi dhe në hir[60] ajo që u bë nëna sipas mishit e Krishtit shpëtimtar.

Të sillnin ty në pjesën më të brendshme të Tempullit prindërit e tu të mençur, o e pacenuar, që të rriteshe në mënyrë të huaj për banimin e Krishtit Perëndi.[26]

Lavdi

Le ta lavdërojmë Trininë e pandarë, le ta himnojmë Hyjninë që është një, Fjalën dhe Shpirtin e Tërëshenjtë së bashku me Atin.

Tani

Lyp Zotin që e linde, që t'i shpëtojë shpirtrat e atyre që të përhimnojnë, se është i dhembshur nga natyra, o Perëndilindëse.

Zbritësore: I pedhes efsevia

»**T**re Djemat që u rritën besëmirë,* »trimërisht përbuzën urdhërin e shty- »pësit;* nga furra dhe zjarri nuk u »tremb'n aspak,* por në flakë dhe në »prush me këngë faleshin:* O Perëndi »atëror, je i bekuar.*

Ode VIII

Kanuni i parë, që ka Akrostihidhë të brendshme alfabetike.

Irmosi: ´Akue kori Parthene

»**V**ajzë, dëgjo Virgjëreshë me nam,* »se engjëlli shën Gabriel* të sjell ty »lajme gazmore prej Zotit t'madh;* »gatitu për Perëndinë,[11] Zotin Jisu,* »se prej teje jetëdhënësi po lind si një »njeri mbi dhé.*[61] Pra të thërres me »gëzim: Që të gjitha* veprat e Zotit, »Jisunë bekojeni.*

Duke e udhëhequr dikur Ana një tempull të pacenuar në shtëpi Perëndie, i tha duke thirrur me besim prifitit: Pasardhësen që u dha edhe tek unë prej Perëndisë, pasi ta pranosh, fute në Tempullin e Krijuesit tënd dhe duke u gëzuar psali atij: E bekoni të gjitha veprat e Zotit Zotin.

Duke parë në shpirt Zaharia i tha Anës dikur: Ti po fut nënë të vërtetë jete, të cilën pikërisht me largpamësi profetët e Perëndisë e parapredikuan si Perëndilindëse; dhe si Tempulli do ta mbajë atë?[62] Prandaj duke u habitur thërras: E bekoni të gjitha veprat e Zotit Zotin.

Shërbëtore Perëndie u bëra unë, – kundërshtoi Ana, duke e ftuar atë në besë dhe lutje, – që të marr frytin e dhimbjes së lindjes sime, dhe pas lindjes fëmijën e sjell tek dhënësi;[46] prandaj thërras duke u hedhur lart: E bekoni të gjitha veprat e Zotit Zotin.

Prifti i tha asaj: Vërtet puna është Ligjore, por kuptoj se çështja është jashtëzakonisht e huaj, duke e parë atë që sillet në shtëpi Zoti, të futet në hir tek të Shenjtat[21] në mënyrë paradoksale; prandaj dhe thërras i gëzuar: E bekoni të gjitha veprat e Zotit Zotin.

Forcohem, i tha Ana, duke mësuar ato që ti flet; sepse pasi i kuptove këto me Shpirtin e Perëndisë, predikove fuqishëm rreth Virgjëreshës; ndaj mikprit të papërlyerën në Tempullin e Krijuesit tënd dhe psali i gëzuar: E bekoni të gjitha veprat e Zotit Zotin.

Na u ndez llambadhe dritëprurëse, thirri prifti, e cila rrezaton një hare shumë të madhe në Tempull; shpirtrat e profetëve le të dëfrejnë së bashku, se shikojnë gjëra paradoksale të bëhen në shtëpi Perëndie,[21] dhe le të thërrasim fort tani: E bekoni të gjitha veprat e Zotit Zotin.

Kanuni i dytë
On frítusin ángjeli

Dëfren sot me gëzim Joakimi, dhe Ana e paqortueshme i ofron Zotit Perëndi si flijim bijën e shenjtë, që iu dha asaj nga premtimi.[46]

Mburren shenjtorët David dhe Jese; krenohet Juda, sepse nga rrënja e tyre lulëzoi si lastar[44] Virgjëresha e kulluar, nga e cila lindi Perëndi i parajetshëm.

Maria e pastër dhe tenda[7] frymore ofrohet sot në shtëpinë e Perëndisë, dhe e pret Zaharia në duar si thesar i shenjtëruar i Zotit.

Le ta nderojmë, o besnikë, si portë[18] shpëtimtare dhe mal[63] mendor, si shkallë[64] të gjallë Virgjëreshën e

vërtetë dhe nënën e Perëndisë, e cila u bekua nga duart e priftërinjve.

Profetë, apostuj dhe dëshmorë të Krishtit, batalionet e engjëjve dhe të gjithë të dhélindurit, le ta nderojmë me himne Virgjëreshën e pastër, si nënën e bekuar të të Shumëlartit.

Të ofronin në Tempull si therore të pastër,[19] o e dëlirë e pacenuar, ata që të lindën perëndishëm, dhe qëndron në mënyrë të huaj në të pashkelurat e Perëndisë,[21] që të përgatitesh si banesë e Fjalës.[26]

Bekojmë Atin, Birin edhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin.
Le të himnohet trishenjti, Ati dhe Biri dhe Shpirti i Shenjtë, Njësia e pandarë, Hyjnia e vetme, që mban në pëllëmbë të gjithë Krijesën[64a] në gjithë jetët.

Tani

Pasi u lind në mish, siç[65] e mirëpëlqeu, prej Vajze të virgjër, fillon Fjala pa fillim, Perëndi dhe njeri, duke na rigatuar nga dhembshuria e skajshme, ne që më parë kishim rënë.

Zbritësore: Thávmatos iperfiús

»Furra vesëplotë[65a] na tregoj një »shembull* të çudisë që shkeli naty»rën;* se ajo s'i dogji Tre Djemat që »priti,* ashtu dhe zjarri i qiellit s'e »ngau Virgjëreshën aspak.* Pra, le ta »himnojm' e le t'i falemi,* e bekoni »të gjithë Zotin me zë të madh* dhe e »lartësoni përmbi të gjithë jetët.*

Ode IX
Kanuni i parë, që ka Akrostihidhë alfabetike të brendshme, të përmbysur; dhe Madhështime

Engjëjtë* çuditeshin duke parë* të futej e kulluara;* si hyri pra Virgjëresha* në të Shenjtat e Shenjtërores![21]

Irmosi: Os empsiho Theú qivotó

»Si një ark' zotërore[10] e gjall',* as»njëher'* të mos prek' dor' e pabe»së,*[66] por gjithmon' Hyjlind'ses le t'i »th'rrasin fort me zërin* e engjëllit[11] »buzët e besnikëve,* duke psalur me »ngazëllim k'shtu:* Virgjëresh' e d'lir', »vërtet më e lartë se çdo gjë je.

Engjëjtë* çuditeshin duke parë* të futej e kulluara;* si me lavdi ajo hyri* në të Shenjtat e Shenjtërores![21]

Bukurin' shpirtërore e ke* të pastër* dhe të ndritshme tepër, o Zonj',* Virgjëreshë e kulluar, dhe je mbushur me hir* të Zotit nga lart; pra shndrit plot me ndriçim* gjithnjë sa thërresim me shum' gaz:* Më e lartë je vërtet se të gjith', Virgjëresh' e d'lir'.

Engjëjtë* çuditeshin duke parë* të futej e kulluara;* si hyri çuditërisht

kjo* në të Shenjtat e Shenjtërores![21]

Fluturon, o Hyjlind'se e d'lir',* çudia* jote mbi fuqin' e fjalës,* se kuptoj tek ti një trup mbi fjal', që nuk pranon dot* asnjë rrjedh' mëkati; ndaj un' të thërras* me hare, me zë fort të lartë:* Më e lartë je vërtet se të gjith', Virgjëresh' e d'lir'.

Engjëjt lart* dhe njer'zit, le ta nderojmë* sot hyrjen e së Virgjërës,* se me lavdi ajo hyri* në të Shenjtat e Shenjtërores.[21]

Të parafiguronte, e d'lir',* ty Ligji* krejt çuditërisht si tendë,*[7] shtamb'[67] e shenjt' dhe ark'[10] e huaj, dhe kurtin',[68] dhe shkop[47] bashk',* dhe tempull i parrëzuar dot, dhe port'* Zoti;[18] na mëson pra të th'rrasim:* Më e lartë je vërtet se të gjith', Virgjëresh' e d'lir'.

Engjëjtë* çuditeshin duke parë* sot hyrjen e së Virgjërës,* se hyri siç deshte Zoti* në të Shenjtat e Shenjtërores.[21]

Cicëronte me plot melodi* Davidi,* që më par' të quante ty* vajzë mbreti;[29] të pa të qëndrosh pran', në të djathtën* e Zotit e zbukuruar me virtyt* si stoli;[8] ndaj profetizonte:* Më e lartë je vërtet se të gjith', Virgjëresh' e d'lir'.

O engjëj,* ju hidhuni me shenjtorët;* kërceni bashk' të virgjëra,* se hyjfëmija sot hyri* në të Shenjtat e Shenjtërores.[21]

Hyjpranuese të parapa* ty mbreti* Solomon, dhe me enigma* tha: Je port' për mbret,[4] burim i gjall' dhe i vulosur,*[69] nga ku doli uji i paturbullt krejt* për ne që thërrasim me besë:* Më e lartë je vërtet se të gjith', Virgjëresh' e d'lir'.

Engjëjt lart* dhe njer'zit, ne Virgjëreshën* me himne le ta madhërojm',* se perëndishëm sot hyri* në të Shenjtat e Shenjtërores.[21]

Na dhuro ti në shpirt butësi* karizmash,* që kudo shpërndan,[70] Hyjlind'se,* duke na buruar jetë ne që të nderojmë* siç kemi detyr'; na mbron dhe na strehon,* dhe na ruan, ty të thërrasim:* Më e lartë je vërtet se të gjith', Virgjëresh' e d'lir'

Kanuni i dytë
Tin fotoforon nefelin
Madhështim

O shpirt, madhështoje Vajzën e ofruar* në Tempullin e Zotit edhe që u bekua* prej duarsh priftërore.

Ky madhështim përsëritet në çdo tropar.

Nga Joakimi dhe Ana* të drejtë doli porsi fryt* premtimi hyjfëmija, Zonja Mari, dhe porsi temjan* i mirëpritur po ofrohet foshnjë në mish ajo tek Tempulli,* Hierorja e Shenjt' e Shenjtërores,* të banojë si e shenjt'.

Le ta nderojmë me himne* k'të foshnjë sipas natyrës,* që u dallua mbi natyrë si nëna e Perëndis',* sepse në Tempullin Ligjor ofrohet tek Zoti sot si er' e mir',* si aromë e këndshme,[71] fryt shpirt'ror krejt* i të drejtëve të shenjt'.

Gëzohu, le t'i thërrasim* Maris' siç e meriton drejt,* o besimtarë, bashk' me engjëllin:[11] Nuse e bukur shum',* gëzohu; g'zohu, re e ndritëshme[72] nga ka feksur Zoti tek ata* që po uleshin në err'sir'[15] padije;* g'zohu, shpres' për ne të gjith'.

Një himn të vyer Krijesa* po të thërret, o Hyjlind'se,* me engjëll Gabrielin tok me një zë të lart': G'zohu,* o nën' e Zotit; falë teje ne u çliruam[73] nga mallkim i lasht'*[74] dhe u bëmë pjes'tarë të paprishjes,* o e paqortueshme.

E shenjt' e t' shenjtëve, Vajzë* Mari, hyjnën' e kulluar,* çlirona ti me ndërmjetimet e tua nga grackat* armiqësore, gjithashtu nga çdo hidhërim dhe herezi të gjith'* ne, të cilët i falemi ikonës* së fytyrës sate t' shenjt'.

O Virgjëresh', u dallove* ti më e madhe, më shumë* se Keruvimet, më e lart', më shum' se Serafimet pra,* dhe më e gjer' se qiejt, se në bark mbajte të panxënin pa kufi,* Perëndin' ton', të cilin linde mbi fjal';* për ne lutju përgjithmon'.

Lavdi

O shpirt, madhështoje pushtetin e Hyjnisë* së pandarë krejt si edhe trihipostate.

Natyrën trihipostate,* lavdin' që nuk ndahet kurrë,* që lavdërohet pa pushim përmbi tokë dhe qiejt lart*[48] në një Hyjni; Triadhën pra të pandar' le ta lëvdojm', t'i falemi* me bes' Atit dhe Birit edhe Shpirtit* me pushtet mbi çdo natyr'.

Tani

O shpirt, madhështoje më të çmuarën pra,* më të lavdëruarën se fuqit' e larta.

Me përkushtim sa përikin* nën dhembshurin' tënde, o Zonj',* dhe që i falen besërisht Birit tënd posi Perëndis'* të botës edhe Zotit, o hyjnënë e virgjër, atij lutju ti* të çlirohen nga prishja, nga rreziqet* dhe nga çdo lloj ngasjesh k'ta.

Zbritësore: Mistírion ksenon

O shpirt, madhështoje Marinë e nderuar* dhe të lavdëruar mbi forcat engjëllore.

»**M**ister të çuditshëm* shikoj dhe s'e »marr dot vesh,* se si q'ell një shpellë »ndrit; fron* keruvik[3] u shfaq Vir»gjëresha dhe grazhdi i vogël* e nxuri »atë që bota nuk e nxë, Krishtin Perë»ndin'.* E madhështojmë pra me kë»ngë sot.*

Dërgimësore
Jinekes akutísthite

Marinë, hyjfëmijën krejt,* që kori i profetëve* e parashpalli qëmoti* si shtamb',[67] dhe shkop,[47] dhe pllak',[75] dhe mal* të palatuar,[63] me besim* ne le ta përhimnojm' me shpirt,* se që të rritet për Zotin,* po futet sot në të Shenjtat* e Shenjtërores në Tempull. ***(3x)***

Lavdërime
Ting. I
Ton uranion tagmaton

Vajza që mbajnë llambadhe me gaz po hapin udh'* për Gjithmon'virgjëreshën* edhe profetizojnë* për të ardhmen falë Shpirtit, se hyn* porsi foshnjë në Tempull sot* me një lavdi virgjërore, meqen'se ësht'* tempull Zoti[4] pra, Hyjlindësja.

Si fryt premtimi të shenjt'[1] është lavdëruar fort;* me të vërtet' Hyjlind'sja* u dallua në botë,* se ka epërsi mbi çdo gjë ajo.* Në shtëpi Perëndie hyn* me bes', pra lutjen e prindërve plotëson*[46] edhe mbahet përmes Shpirtit t' Shenjt.

Pasi, o Zonj', u ushqeve me buk' nga qielli*[76] në Tempullin e Zotit* me bes', linde për botën,* Virgjëresh', buk' jete, Fjalën,[77] Jisun';* tempull i tij i zgjedhur je;* si u fejove me Shpirtin mistikërisht,* u martove ti me Atin Zot.

Sot le të hapet pra der' Tempulli hyjpritës krejt,* se Joakimi mori* dhe me lavd brenda solli* fronin,[3] tempullin e Tër'mbretit[4] ton'* dhe tek Zoti e dedikon;* i përkushton vajz' të zgjedhur tash prej atij,* që të bëhet nën' e tij më von'.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. II I Leonit Mjeshtër

Sot në Tempull sillet Virgjëresha e tërëpaqortueshme për banesë të Perëndisë,[26] Tërëmbretit dhe ushqyesit të të gjithë jetës sonë. Sot shenjtërimi absolutisht i pastër si mëshqerrë trevjeçare[22] në të Shenjtat e të Shenjtave futet. Le t'i thërrasim asaj si

engjëlli: Gëzohu, o e vetmja e bekuar ndër gra.[11]

Dhoksologjia e Madhe
U jepet vëllezërve edhe vaj i shenjtë.

Në Liturgji, Antifonet
Antifoni i parë

Varg a): I madh ë*shtë* Zoti dhe i lavdishëm fort.
Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Varg b): Të lavdishme u folën për ty, qytet i Perëndisë.
Me ndërmjetimet.

Varg c): Perëndia në kullat e tij njihet.
Me ndërmjetimet.

Varg d): Pikërisht siç dëgjuam, ashtu edhe pamë.
Me ndërmjetimet.

Antifoni i dytë

Varg a): Shenjtëroi tendën e tij i Shumëlarti.
Shpëtona, o i Bir i Perëndisë, o i çuditshëm ndër shenjtorët.

Varg b): Shenjtëri dhe madhështi në shenjtëroren e tij.
Shpëtona.

Varg c): Kjo është porta e Zotit; të drejtët do të hyjnë në të.
Shpëtona.

Varg d): I shenjtë ë*shtë* tempulli yt, i mrekullueshëm në drejtësi.
Shpëtona.

Antifoni i tretë

Varg a): Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.
Sot është nisja.

Varg b): Gjithë lavdia e bijës së mbretit ë*shtë* nga brenda, me thekë të artë e veshur, e stolisur.
Sot është nisja.

Varg c): Do t'i sillen mbretit virgjëresha mbrapa asaj.
Sot është nisja.

Kontaqi I përmbipaqmi tempull. Në vend të Të meriton, Engjëjtë çuditeshin. Si një ark' zotërore. Kungatore Kupë shpëtimi. Pamë dritën.

Tipikon i së dielës pas së kremtes.

Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 Paskremtore. Lavdi i së kremtes. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani Paskremtor. Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, në fund, Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret: ngjallësore

dhe në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret Paskremtore. Kanunet: ngjallësor dhe i dytë i së kremtes. Pas Odes III, Ndenjësoret Paskremtore. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja Krishti lind; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Ndenjësoret: ngjallësore dhe e së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 Paskremtore. Lavdi Eothinoni. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket dhe Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes dhe e kishës. Kontaqi I përmbipaqmi. Apostulli dhe Ungjilli i së dielës. Të Meriton. Kungatore Lavdëroni. Pamë dritën.

CITIME

[1] Gjen. 21.2; Gjyq. 13.24; I Mbret. [Sam.] 1.19-20 etj.

[2] I Petr. 2.5

[3] Is. 6.1; Jez. 1.13-26; 10.1-2; Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 32

[4] Jez. 44.1-4

[5] Ps. 44(45).15-16

[6] Fil. 2.16

[7] Eks. 25.8 etj.; Num. kap. 2; Ps. 45(46).5; 131(132).5; Hebr. 9.2

[8] Ps. 44(45).10

[9] Ef. 5.19

[10] Eks. 25.9-20; 38(37).1; Ligji i Dytë 10.2; Ps. 131(132).8

[11] Lluk. 1.28

[12] Ps. 44(45).15

[13] Eks. 15.20-21; I Mbret. [Sam.] 18.6-7

[14] Rom. 5.10; II Kor. 5.18-19

[15] Is. 9.2; Matth.4.16; Lluk. 1.79

[16] Kënga 3.7

[17] Is. 45.8

[18] Jez. 44.1

[19] Lev. 1.3; 22.19,21; Num. 28.31 etj. Ef. 5.2; Fil. 4.18

[20] I Mbret. [Sam.] 16.23; II Mbret. [Sam.] 6.5,14

[21] Num. 4.19; Hebr. 9.3

[22] Gjen. 15.9

[22a] Lluk. 1.68

[23] Ps. 44(45).2; 118(119).131; Jez. 3.27

[24] Ps. 44(45).2

[25] Kol. 2.3

[26] Jez. 37.27; II Kor. 6.16; Ef. 2.22

[27] Ps. 23(24).7,9

[28] Lev. 21.6,8

[29] Ps. 44(45).14

[30] I Kron. 16.23; Ps. 95(96).1

[31] II Mbret. [Sam.] 6.16

[32] Gjen. 3.1-6

[33] Ps.131(132).13-14

[34] Ps.131(132).9

[35] Eks. 25.30,37; 35.16; 38.13-17; 40.22; Num. 4.9; 8.2

[36] Hebr. 9.4

[37] Eks. 25.29; 39.18

[38] Sirak 47.5

[39] Rom. 11.33

[40] Hebr. 8.5

[41] Abak. 3.3

[42] Jov 5.9; Lluk. 5.26

[43] Is. 7.14

[44] Is. 11.1

[45] I Es. 8.67; II Es. 9.2

[46] I Mbret. [Sam.] 1.11,24-28; 2.11; Rom. 4.18-19

[47] Num. 17.23

[48] Is. 6.2-3

[49] Sirak 50.7

[50] Fja. Urt. 23.25

[51] Fil. 2.15

[52] Is. 9.6

[53] Is. 26.9

[54] Hebr. 1.3

[55] Ps. 97(98).2

[56] Fil. 2.10

[57] Rom. 10.9; I Joan 4.2

[58] Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 63

[59] I Es. 6.25; 8.17,55

[60] Lluk. 2.52

[61] Vep. 1.4; 10.41

[62] III [I] Mbret. 8.27

[63] Dan. 2.34-35

[64] Gjen. 28.12-17

[64a] Ester 4.17b; Ps. 94 (95).4; Jov. 9.19

[65] Joan 1.14

[65a] Eks. 3.2-5

[66] II Mbret. [Sam.] 6.6-7

[67] Eks. 16.33; Hebr. 9.4

[68] Eks. 40.3,5,20

[69] Kënga 4.12

[70] I Kor.12.4

[71] Eks. 29.18; Lev. 1.9; 23.13,18; Num. 28.24; Ef. 5.2; Fil. 4.18

[72] Eks. 14.24; 16.10; Num. 9.15

[73] I Kor. 15.45

[74] Eks. 3.16-19

[75] Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10

[76] Eks. 16.4; Ps. 77(78).24; 104(105).40; Joan 6.31

[77] Joan 6.35

MË 25 TË TË NJËJTIT MUAJ

Mbyllja e së kremtes dhe kujtimi i martires së madhe të shenjtë dhe të tërëurtë Ekaterina, si dhe i martirit të madh të shenjtë Mërkur.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 Vargëzime ngjallësore, 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtores. Lavdi i së kremtes. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrja. O dritë gazmore. Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtores. Tani i së kremtes. Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtores dhe e së kremtes.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Himne Triadike. Trishenjti dhe Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore, por në vend të Hyjlindësoreve, Ndenjësoret e së kremtes (nuk thuhen Ndenjësoret e shenjtores, por kalojmë në Bekimtoret etj.). Kanunet: ngjallësor, i së kremtes dhe i shenjtores. Pas Odes III, Ndenjësoret: e shenjtores dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja Krishti lind; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Në vend të Më të nderuarën, Odet IX të së kremtes (psalen edhe Madhështimet së bashku). Dërgimësoret: ngjallësore, e shenjtores dhe e së kremtes. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të shenjtores. Vargjet për dy të fundit: a) Duke u duruar, durova duke pritur Zotin dhe më vuri re; b) Dhe siguroi mbi gur këmbët e mia dhe drejtoi hapat e mi. Lavdi e shenjtores. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes, por: ...ai që u ngjall. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes, e shenjtores dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli i shenjtores. Ungjilli i së dielës. Në vend të Të meriton, Engjëjtë. Si një ark' zotërore. Kungatore Kupë shpëtimi. Pamë dritën.

Shënim: Pas Mbylljes të së kremtes, fillon të psalet Kontaqi Virgjëresha sot po vjen.

NË MBRËMËSORE

Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit (Lum ai njeri), Thirtoret: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtores.

Vargëzime të së kremtes

Ting. I
O tu paradhoksu thávmatos

O besnikë, sot le të kërcejm'.
Tempulli frymor si dhe i gjall'.
Predikimi i profetëve.

Dhe 3 të shenjtores I njëjti
Ton uranion tagmaton

Aleksandria qyteti i madh kënaqet sot,* sepse me shpirt, me gaz mban* si thesar fashën tënde* brenda kishës sate të hyjshme krejt;* ndaj kremtojm' edhe ne me bes',* Ekaterina, kujtimin tënd me respekt;* lutu për ata që të nderojn'.

Tani kujtimin e Ekaterinës le ta bëjm',* sepse të gjith' fuqitë* e armikut i mposhti* falë fjalës dhe me vepër vërtet,* forcën e oratorëve.* O Perëndi, na çliro nga çdo herezi* përmes lutjeve të saj, o Zot.

Ekaterina martire e tër'lëvdueshme,* e thjesht', gëzohu, sepse* në mal ku Moisiu* pa se s'digjej ferra,[1] në të tani* transferoi lipsanin tënd* të hyjpëlqyeshëm Krishti; e ruan pra* derisa të vij' për her' të dyt'.

Lavdi *I shenjtores Ting. II*

Le të bashkërendim me gëzim në panairin e martires së hyjurtë Ekaterina, o martirëdashës, dhe le ta kurorëzojmë atë me lavdërime si me lule duke thirrur: Gëzohu ti, që kritikove arrogancën gojore e të pashkollë të oratorëve llafazanë dhe që i udhëhoqe ata drejt besimit të hyjnueshëm; gëzohu ti, që dorëzove trupin në tortura të shumëthurura për dashurinë e Bërësit tënd, dhe që nuk u rrëzove si një kudhër e pathyeshme;[2] gëzohu ti, që banove në banesa të larta[3] barasvlefshëm me mundimet e tua dhe që shijove thellësisht lavdi të amshuar; duke e dëshiruar atë, ne himnuesit e tu, le të mos biem nga shpresa.

Tani *I së kremtes*
Ting. Tërth. IV

Si u linde, o Zonjë hyjnuse ti, arrite në Tempull Zoti, që të rritesh në të Shenjtat e të Shenjtave, si e shenjtëruar; atëherë dhe Gabrieli u dërgua drejt teje, o e tërëpaqortueshme, duke të sjellë ky ushqim; të gjitha qielloret u shtangën, duke parë Shpirtin e Shenjtë të fushojë brenda teje; prandaj, o e papikëluar, e panjollshme, që lavdërohesh në qiell e mbi dhé, nënë e Perëndisë, shpëto gjindjen tonë.

Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës (dhe Leximet, nëse do i pari).*

Këndimi i profecisë së Isaias
(43.9-14)

Këto thotë Zoti: Gjithë kombet u mblodhën së bashku dhe do të mblidhen arkondë nga ato. Kush do t'i

njoftojë këto? Ose *gjërat* që nga fillimi kush do t'ju njoftojë? Le t'i sjellin dëshmitarët e tyre, dhe le të drejtohen, dhe le të dëgjojnë, dhe le të thonë të vërteta. Bëhuni dëshmitarët e mi dhe unë dëshmitar, thotë Zoti Perëndia, dhe fëmija im që zgjodha; që të njihni dhe të besoni, dhe të kuptoni se unë jam. Përpara meje nuk u bë Perëndi tjetër dhe pas meje nuk do të jetë. Unë, Perëndia dhe veç meje nuk është ndonjë që shpëton. Unë lajmërova dhe shpëtova, talla dhe nuk ishte në mes jush i huaj. Ju dëshmitarë për mua dhe unë Zoti *jam* Perëndia, ende nga fillimi dhe nuk ka njeri që të shpëtojë nga duart e mia. Do të bëj, dhe kush do ta kthejë mbrapsht këtë? Kështu thotë Zoti, Perëndia, që ju çliron, i Shenjti i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve *janë* në dorën e Perëndisë dhe nuk do t'i prekë mundim. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre dhe dërrmim ecja nga ne, por ata janë në paqe; sepse edhe nëse ndëshkohen para faqes së njerëzve, shpresa e tyre *është* plot pavdekësi; dhe pasi do të ndëshkohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojë në ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të do të kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë pranë tij, sepse *ka* hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë dhe paga e tyre *është* në Zotin, dhe përkujdesja e tyre pranë të Shumëlartit. Për këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë dhe kurorën e bukurisë nga dorë Zoti, sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do të marrë *si* armatim zellin e tij dhe do të mobilizojë me armë krijesën për mbrojtje armiqsh. *Si* korracë do të veshë drejtësi, dhe *si* helmetë do të veshë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë *si* mburojë të pamposhtur oshënarí dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me atë bota kundër të marrëve. Pre-

dha rrufesh do të ecin suksesshëm tek qëllimi, dhe si nga një hark i plotë rrethi nga retë do të hidhen në shënjestër, dhe nga zemërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohet kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të përmbytin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë dhe paligësi do të shkretojë gjithë dheun, dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur, mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinasti nga i Shumëlarti.

Në Liti

Lavdi *I shenjtores*
Ting. II

Si alabastër miroje[4] i ke ofruar gjakun dhëndrit tënd Krisht, o Ekaterina, athlofore e pamposhtur, ndërsa ke marrë shpërblim kurorë të paprishur nga ai, o e vyer për admirim; prandaj edhe çmprehe arrogancën gojore të oratorëve dhe ata i tërhoqe drejt hyjdijes, dhe e morën kurorën e martirizimit së bashku me Vasilisën e urtë; pra ndërmjeto tek Krishti Perëndi që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *I së kremtes*
Ting. IV

Sot tempulli hyjnxënës, Hyjlindësja, tek Tempulli i Zotit sillet dhe Zaharia e mirëpret atë. Sot të Shenjtat e të Shenjtave[4a] ngazëllohen dhe kori i engjëjve bën panair mistikërisht. Tok me këta duke kremtuar edhe ne sot, le të thërrasim bashkë me Gabrielin: Gëzohu, o hirplote, Zoti[4b] është me ty, ai që ka përdëllimin e madh.

Pasvargje të së kremtes, ose të mëposhtmet të shën Mërkurit
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Kishe, o athlofor Mërkur,* aleancën e Shpirtit t' Shenjt'* dhe k'shtu kundërshtarin e mposhte krejtësisht,* si një ushtar i paepur dot; me armën e besës son'* etiopianët pra,* gjith' demonët i preve fort* edhe ligjërisht* e ke bër' garën tënde; u kurorëzove ti me çdo atlet, o martir i madh, o i pasur shum'.

Varg: I drejti si palma do të lulëzohet dhe si kedër në Liban do të shumëfishohet.

T'u dërgua nga qielli* me një shenjë prej Shpirtit t' Shenjt'* pran' një engjëll për të shëruar traumat;* edhe pasi u mjekove prej tij plot'sisht, durove fort* kur ti shpoheshe me biz'*

të përflakur dhe vareshe* e tendoseshe;* dhe u lidhe me gur të rëndë shumë, i përlagur me gjak lum', që po rridhte nga çdo an', o dëshmor.

Varg: Tek shenjtorët që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

Tek po mobilizoheshe* nga një mbret tokësor, Mërkur,* urdhëroheshe prej tij që të bësh flijim* për nder demonësh, i lumur fort, hyjmendës, durove pra* shum' tortura edhe zjarr* djegie, vdekje të dhunshme, t' zez',* k'shtu vrapove lart* me kurorë drejt Krishtit dhe me koret e martirëve tani je, dhe lyp për botën e përgjëron.

Lavdi *I shenjtores*
Ting. II
E Vavilasit

Ushtrove në jetë jolëndore dhe kur arrite para podiumit ateist, qëndrove trofeprurëse, o Ekaterina modeste, duke lulëzuar shkëlqimin e Perëndisë; dhe e veshur me fuqinë e hyjnueshme, talle plotësisht dogmat e tiranit dhe pushove fjalimet llafazane të oratorëve, o fitimtare e madhe.

Tani *I së kremtes*
Ting. Tërth. II
I Sergj ajiopolitit

Sot ne, turma e besimtarëve të mbledhur, le të bëjmë panair shpirtërisht edhe hyjfëmijën e virgjër dhe Hyjlindësen që sillet në Tempull Zoti, le ta lavdërojmë besërisht. Ajo u parazgjodh nga të gjithë brezat për banesë të Krishtit tërëmbret dhe Perëndisë të të gjithave. O ju të virgjëra, duke mbajtur llambadhe paraprini duke nderuar ecjen e respektuar të Gjithmonëvirgjërës. O nëna, duke shkarkuar çdo pikëllim, shoqërojeni me hare, duke e himnuar atë që u bë Nënë Perëndie dhe shkaktare gëzimi për botën. Të gjithë pra, me ngazëllim le të thërrasim bashkë me engjëllin "Gëzohu" tek Hirplota,[4b] që përherë ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Përlëshore e së kremtes
Lavdi *I shenjtores*
Ting. Tërth. I
Ton sinánarhon Logon

Nusen e tërëfamshme të Krishtit ta himnojm',* Ekaterinën pra, mbrojtësen e Sinait me hir,* të hyjnueshmen, përkrahjen ton' dhe ndihmësen,* se mbylli gojën madhërisht* të të zgjuarve që s'kishin bes' me thikën e Shpirtit,*[5] dhe tash si u kurorëzua, kërkon për gjith' ne përdëllimin e madh.

Tani *Përsëri i së kremtes*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore e shenjtores

Ting. I Ton tafon su Sotír

Ti erdhe me guxim,* o e lumur, në garë;* pohove trimërisht, o martire, Jisun' Krisht;* tiranin besëkeq, të çmendur me shpirt e kritikove fort;* turpërove rënd'* dhe një mori oratorësh;* fluturove k'shtu tek tendat lart nëpër qiejt,*[6] prandaj të lëvdojmë ne.

Lavdi *dhe* Tani *I së kremtes*
E ngjashme

Isillet Perëndis'* fryti i Joakimit* dhe Anës, që kan' qenë të drejtë, besnikë;* ofrohet brenda Tempullit të shenjt' foshnjë në mish ajo,* pra ushqyesja* e jetës son'. Zaharia* e bekon atë.* Të gjith' le ta lumërojmë* si nënën e Zotit ton'.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore e shenjtores
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Virgjëresha e tër'urt',* Ekaterina e thjesht' sot,* me fuqin' e Krishtit ton'* u fuqizua vërtet kjo,* e ngazëlluar po futet në stadium tash,* dhe pasi tiranin e ashpër gur* dhe hordhi armiqsh me besim të rrem'* i mposhti posht' përdhé, me një gëzim të madh* dhe zë të lart' psalte pa pushim:* Lavdia ime,* Çlirues Krisht, Zot,* Shpëtimtar, ma prit shpirtin.[7]

Lavdi *dhe* Tani *I së kremtes*
E ngjashme

Para zënies, o e d'lir',* u shenjtërove për Zotin,* dhe pasi ke lindur k'tu* mbi dhé, u solle si dhurat'* tek Perëndia, premtimin[7a] at'ror përmbushje;* që në foshnjëri me shum' pastërti,* duke qenë tempull i hyjshëm[7b] ti* vërtet, u dhe te Tempulli i hyjshëm* plot nur si dhe me llambadhe pra;* u duke ena* e dritës, Krishtit;* ecja jote e madhe ësht'.

Pas Polieleit, Ndenjësore e shenjtores
Ting. Tërth. IV
To prostahthén mistikós

Aleksandria, qytet i madh, i shndritshëm* bën panairin* për kujtimin tënd, o e thjesht',* të lëvdon për arritjet,* o Ekaterina,* që bëre me trimëri, me mundime plot* për Krishtin; me mburrj' të madhe,* ndaj të thërret:* Virgjëresh' e sprovuar, o martire, që admirojm', gëzohu tash që je në tend'* qiellore[6] me Bër'sin tënd.

Lavdi *dhe* Tani *I së kremtes*
E ngjashme

Le të gëzohet himnshkruesi, Davidi;*

le të kërcejnë* Joakimi tok me Anën,* se fëmijë e shenjtë* doli prej atyre,* Maria, llambadh' e hyjshme drit'prurëse.* Gëzohet që futet brenda* Tempullit sot.* Kur e pa këtë, e bekoi biri i Varahiut dhe thërriste me hare:* G'zohu, o mrekulli me buj'.

Shkallesat, Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni
Ting. IV

I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

Varg: Tek shenjtorët që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

Ungjilli (i Dhjetë Virgjëreshave, kërkoje në të shtunën e javës së 17 të Mattheut). Psalmi 50. Pastaj:

Lavdi. Me ndërmjetimet e athlofores. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II

U ushtrove në jetë jolëndore dhe kur arrite para podiumit ateist, qëndrove trofeprurëse, o Ekaterina e thjeshtë, duke lulëzuar shkëlqimin e Perëndisë; dhe e veshur me fuqinë e hyjnueshme, talle plotësisht dogmat e tiranit dhe pushove fjalimet llafazane të oratorëve, o fitimtare e madhe.

Kanunet: dy të së kremtes dhe një i shenjtores (Kanuni i shën Mërkurit thuhet kur festohet posaçërisht për të).

Ode I

Kanuni i shën Ekaterinës, që ka Akrostihidhë: "Këndoj me këngë Ekaterinën e tërëkënduar. I Theofanit".

Ting. Tërth. IV
Armatilatin Faraó

O Krisht, me lutjet e Ekaterinës së tër'urt', martire me lavd,* syrin tim të errët*[8] shpirtëror ndriçoje, duke dhën' tek un' ndriçim, o Zot,* më derdh dritë që zhduk mjegullën e tërë të shkeljeve* që kam bërë, dhe prishin shpirtin tim.

O e tër'urtë, duke u drejtuar qart' nga porosia e shenjt'* e Jisuit, Krishtit,* e përflakur prej dëshirës së tij, rende me nxitim*[9] për në ndeshje, dhe mendje tiranësh ti i habite fort* me urt'si, me fjalë edhe me hir.

U qeverise nga pëllëmba shum' e fort' e Krishtit ton', dhe k'shtu,* o e lavdëruar,* ti u shmange, o martire, nga përlyerje idhujsh;* pa u lagur lundrove me kryqin si me direk dhe fllad* shpirtëror, dhe psalje tek Zoti yt.

Me bukurit' e virgjëris', o shën Ekaterina tepër e urt',* ngazëlloheshe,

dhe* duke pasur njohuri të hyjshme ti prej qiellit,* me guxim turpërove të parët e dijes së kot'sis'* dhe fitove mbi ata me pushtet.

Hyjlindësore

Kur shpallim se ti je Hyjlind'sja, zmbrapsim ne çdo herezi, o e d'lir',* Zonj' e pacenuar,* se atë që është' përtej të gjith' krijesës linde ti,* kur u bë pa ndryshim mish,[10] pra Fjalën e Perëndisë ton',* Fjalën e Përjetëshme, o Hyjnën'.

Kanuni i shën Mërkurit, që ka Akrostihidhë: "Fuqia e Mërkurit le të më ruajë. Josif".
Ting. Tërth. IV
I qekomeni

Mërkur, së bashku me koret e lart' atje qëndron me plot ngazëllim,* pran' burimit që gufon* të mirat, edhe mbushesh me kënaqësi të hyjshme përgjithmon'; ndaj ruaji sa bëjn'* me shum' mall panairin tënd* dhe këndojn' tek Zoti, se me lavd u lavdërua fort.

Në stadiumin e madh të dëshmis' ti hyre, o i urt', me dëshir',* i forcuar me fuqin'* e Krishtit, që pësimet shpëtimtare i duroi mishërisht për ne vullnetarisht,* dhe me gëzim thërrisje qart':* T'i këndojm' ne Zotit, se me lavd u lavdërua fort.

Ti poshtërove qart' fjalë tirani, me pohimin e Krishtit tënd,* o i urt', i mburrur shum';* durove pa frik' çdo ide torturash, dhimbjesh i gëzuar[11] dhe thërrisje tek ai* që të forconte, o Mërkur:* T'i këndojmë Zotit, se me lavd u lavdërua fort.

Hyjlindësore

I mishëruar nga Vajza e virgjër, ti u pe për njer'zit njeri,* pra u bëre qart' si ne;* si dëshmitarin e sinqertë të pësimeve të tua[12] na tregon Mërkurin tënd,* atletin trim, që psal për ty:* T'i këndojm' ne Zotit, se me lavd u lavdërua fort.

Zbritësore: Hristós jenate

Ja Krishti lind, lavdërojeni *(shih fq.154)*

Ode III
E shenjtores
O stereosas kat' arhás

Vullnetarisht dhe me dëshir'* ke shkuar drejt tek pësimi* që ti doje, imitove k'shtu Krishtin;* dhe e munde sundimtarin botëror të errët pis'*[13] shkëlqyeshëm; u duke,* Ekaterina, ti me kuror'.

I kritikove me moral* shum' të fuqishëm tiranët,* që posht' ishin rrokullisur në fundin* e besimit t' rrem', se ligjërove dogmë, hyjdije* me urtësi

të hyjshme,* që ti martire me fam' shndrisje.

Nga vajz' e but' shkelet ai* që pëshpëriti në veshët* e stërgjyshes barazinë me Zotin;*[14] se Ekaterina, duke pasur armatim kryqin,* e turpëroi atë* që mburrej pa mas',[15] martirja jon'.

Hyjlindësore

Me energji jetike shum'* që ti ke shfaqur në botë,* ngrite mendjen time që kishte vdekur,* duke zhdukur shenja, gjurmë plagësh prej mëkateve,* ti o Hyjnën' e vetme,* e paqortueshme tërësisht.

E shenjtit
Si i to steréoma

Tortura, zjarr, pranga, shpat'* si ëndrra k'to i gjykove ti,* se ty të tër'* të kishte përflakur* dashuria e Zotit ton'.

Kur rraheshe me kamxhik* tmerr'sisht, himnoje ti Bërësin,* martir i urt',* duke e pranuar* gjith' shërimin e plagëve.

Me shkop të hyjnueshëm* i fuqizuar, atlet, martir* me trimëri,* me mend, e përkule* arrogancën e djallit ti.

Hyjlindësore

Ushfaq ferr' e ndezur flak'* me zjarr, por s'digjej aspak,[1] sepse,* o e tër'-d'lir',* parafiguronte* shtatzënin' tënde mbi mendim.

Zbritësore: To pro ton eonon

Përpara nga jetët

Ndenjësore e shenjtores
Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

O martire me nam, e pamposhtur dot,* gjatë luftrash urt'sin' e vërtet'[16] nga lart,* si more nga gjuha dhe* goja e Mihailit ti,* frik'sove oratorët përmes urtësis' nga jasht',* ndërkaq e pakësove mashtrimin me urtësin'* nga q'elli; pa luftën tënde pra Krijimtari* dhe erdhi, qëndroi pran',* të forcoi dhe tha: Eja,* ngjitu, të pret* thesar i madh;* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Lavdi *I shenjtit Ting. IV*
Tahí prokatálave

Martiri Mërkur me luft' e turpëroi plot'sisht* armikun dinak dhe u kurorëzua nga Krishti si i qëndrue-

shëm.* K'shtu tash u lidh me koret* engjëllore; merr pjesë* dhe në lavdi që s'ka pasardhës dhe s'vjetërohet,* prandaj besërisht ne bëjm' kujtimin e tij të shenjt'.

Tani *I së kremtes*
I njëjti Kateplaji Iosíf

Shqerra e panjollëshme,* dhoma e papërlyer dot,* në shtëpin' e Perëndis'* me ngazëllim futet tani* çuditërisht, pra Marjama Hyjlind'se Zonjë.* Rreshta engjëllore rrethojn' me gaz* dhe të gjith' besnikët e lumërojn',*[17] dhe psalin tek ajo me kënaq'si plot,* me zë të madh pa pushim aspak:* Shpëtimi ynë* je dhe lavdia,* o e tër'papik'luar.

Ode IV
E shenjtores: Si mu iskís Kírie

O Ekaterina, martire e gjithëkënduar, tregove qëndrueshmëri atleti duke iu kundërvënë me shumë durim keqdashësit dhe duke e shkelur fort me këmbë të zbukuruara,[18] me fuqinë e kryqit,[19] o athlofore, krenaria e martirëve.

O Ekaterina e tërëpasur, nuse e Krishtit, u paraqite qartësisht të lavdërohesh me vezullime të shndritshme të bukurisë së hyjnueshme dhe të shkëlqesh përreth me hijeshi; prandaj e ngazëlluar i këndon Zotit: Lavdi fuqisë sate, o Njeridashës.

Poshtërove fodullëk tiranik dhe me fjalën e hyjnueshme të urtësisë sate, si prej fundit të besëtytnisë mashtruese, i rrëmbeve të mashtruarit, duke i mësuar t'i thërrasin me melodi Krishtit: Lavdi fuqisë sate, o Njeridashës.

Panairi i nderuar dhe dritëprurës i kujtimit tënd të lavdëruar, o e tërëfamshme, që me durim shkele fuqishëm arrogancën e armikut, lindi si diell; në të i thërrasim Zotit me zë të lartë: Lavdi fuqisë sate, o Njeridashës.

Hyjlindësore

Tani mposht fuqinë e atyre që mohojnë faljen e ikonës sate të respektuar, o Vajzë, dhe të atij që u mishërua prej teje përmbi mendje, i cili ndriçoi botën e tërë;[20] si dhe të ikonës së gjithë shenjtorëve; ndërsa ata që e nderojnë me besë, ngazëlloji, o e vetmja e tërëhimnuar.

E shenjtit: Isakíkoa Kírie tis ikonomias su

Hyre në familjen e Ndërtuesit tënd në saje të pësimeve të hyjshme të martirizimit, o hyjmendës, dhe pranove nga ai kurora të shkëlqyera si i pamposhtur, o i lavdëruar.

Tani ke veshur rrobë të thurur prej Hirit nga lart,[21] pasi zhveshe këmishat[22] e prishjes dhe të vdekshmërisë, o martir.

Pasi luftove kundër mëkatit deri në gjak,[23] o i lavdishëm, je dëftuar fitimtar dhe u vlerësove për lavdinë e lartë.

Hyjlindësore

Mbi ty ka zbritur si shi[24] Fjala shpëtimtare, o e Gjithmonëvirgjër, dhe thau shirat e politeizmit.

Zbritësore: Ravdhos ek tis rizis

Shkop nga rrënja e Jeseut

Ode V

E shenjtores: Ina ti me aposo

Duke u djegur nga malli për Zotin tënd, o martire e tërëkënduar, dhe duke kërkuar të shikosh bukurinë e tij të mbinatyrshme, e dorëzove veten tënde në tortura me vendim vullnetar, duke llamburitur me hire virgjërie.

Si e ndriçove fort veten me gatishmëri, me arritje shumë të hyjnueshme, o Vajzë e bukurvirgjër, je ngjitur drejt dhomës qiellore të Krishtit; dhe tani me hare u bashkove e ngazëlluar, o e tërëpasur, me dhëndrin tënd.

U paraqite si një e re tepër e hijshme, dhe e deshe atë që i vetmi e meriton dashurinë dhe duke e ndjekur pas, përshkove udhë në mënyrë shumë intensive duke thirrur: Do të vrapoj, o dhëndri im, në erën e miros sate,[25] që u zbraz mendërisht.

Hyjlindësore

O Zonjë e tërëkulluar, meqenëse të njohëm saktësisht si Hyjlindësen e vërtetë, duke njohur atë që lindi prej teje, Fjalën Perëndi, e shpallim të njohur në dy substanca që kanë vullnete të mëvetësishme, o Vajzë hyjnuse.

E shenjtit: Orthrízontes voomen si

Kur tendoseshe dhe shpoheshe me shtizë pa ndalim, o Mërkur, duroje pa u dorëzuar, sepse forcoheshe nga shpresa të hyjnueshme.

Ti që e sigurove zemrën time mbi gur[26] mendor, kur të varën gur, nuk dole jashtë rrugës, o Mërkur.

Meqenëse u bëre pjesëtar pësimesh të Zotit tënd,[27] more pjesë në lavdinë e tij dhe në shkëlqime të hyjshme.

Hyjlindësore

Vrit, o Virgjëreshë, mëkatin tim të gjallë, ti që mbajte në barkun tënd jetë, e cila vrau vdekjen.

Zbritësore: Theós on irinis
O Zoti i paqes

Ode VI
E shenjtores: Ávisos amartión

Të ka par' të bukur ty,* të shkëlqesh ti plot[28] me lavd virgjërie* dhe të ngjyrosur, o vajz', me gjak martirizimi pra* Zoti, Fjal' e mirë edhe e panjollshme, dhe të vendosi* brenda një dhome qiellore ty.

O Ekaterina, ti* ke arritur përmes kryqit ta shembësh* pushtetin e tiranëve dhe të kritikosh urt'sin'* e botës si një kotësi, dhe burove doktrinë, dogma* me hyjfrym'zim, o mendjendritur krejt.

Ke rrëzuar përdhé ti* me durimin e mundimeve gjatë* torturave, atë që nxori qëmoti me dredhi* Adamin, martire e tër'lavdëruar, jashtë Parajsës;* more kurorën e mbret'risë pra.

Hyjlindësore

Bëj që, o Hyjlindëse* Virgjëreshë, Biri yt dhe Gjykat'si* në ditën e Gjykimit ton' të bëhet i but' tek un'* si dhe shpëtimtar nga çdo tmerr, Nën', përmes lutjeve të tua;* vetëm në ty vë shpresën time, Zonj'.

E shenjtit: Tin dhéisin ekheó

Mërkur i urt',* të forconte Fjala Zot* e amshuar, duke par' se duroje* për të mundim* ti dhe çdo lloj torture,* k'shtu me një engjëll urdh'ronte të kishe forc',* guxim dhe të mos kishe frik'* nga tiranët dhe vrulli i tyre kurr'.

U vra gjarpri* shumëformësh; një atlet,* luftëtar trim, e shkel me këmbët e tij* plot bukuri,*[18] se me vrull vullnetar shum'* shpejt tek tortura, mundime ka ecur drejt* tek vdekja që ësht' mbushur plot* me lavdi, pra Mërkuri i madh, i shenjt'.

I çove ti* spontanisht vullnetin tënd,* gjithë zemrën tënde, Zotit, i lumur,* dhe për atë* i durove shtremb'rimet;* të dha ty si fitimtar një kuror' me lavd;* në qiejt tash qëndron pran' tij,* me të gjithë martirët bashk' edhe ti.

Hyjlindësore

Ke zën' me zë* engjëllor[29] vet' engjëllin* e vullnetit të madh,[30] o Vajz', dhe linde* me mish, me trup,* ti nga gjaku yt i d'lir',* i tërëshenjtë, atë që tregoi qart'* tek ne të gjithë hyrje, port'* jete nga përdëllim që nuk shprehet dot.

Zbritësore: Splahnon Ionán
Si profeti shën Jona

Kontaqi i shenjtores
Ting. II Ta ano zitón

Tani ngrini kor* të shenjt', të hyj-

pëlqyeshëm* dhe thurni lavd'rim,* ju o martirëdashës tok* për Ekaterinën; në stadium e shpalli qart' Krishtin ton'* edhe shkeli krejt gjarpërin,*[31] pështyu dhe dije oratorësh leht'sisht.

Shtëpia

Pasi mori që fëmijë urtësinë nga Perëndia martirja, ka mësuar mirë edhe të gjithë urtësinë e jashtme; dhe si njohu prej saj lëvizjen dhe bërjen e elementeve sipas logjikës edhe atë, i cili që nga fillimi i bëri nëpërmjet fjalës,[32] atij i ofronte falënderimin ditë e natë, ndërsa rrëzoi idhujt dhe ata që i adhuronin marrëzisht; pështyu dhe dije oratorësh leht'sisht.

Sinaksari

Më 25 të të njëjtit muaj, kujtimi i Ekaterinës, martire e madhe dhe e shenjtë.
Vargje: Ekaterina ishte edhe e urtë, edhe e virgjër,/ ndërsa nga shpata edhe martire. O tri të mira!
Më 25 një shpatë vrau vajzën oratore.

Në të njëjtën ditë, njëqind e pesëdhjetë oratorë të shenjtë, të cilët besuan tek Krishti përmes shën Ekaterinës, mbarojnë me zjarr.
Vargje: Qëndrueshmëritë e mëparshme të burrave ish oratorë të mashtrimit,/ që vdiqën me zjarr, u bënë fitim kurorash.

Në të njëjtën ditë, Vasilisa e shenjtë, bashkëshortja e Maksentit, mbaron me shpatë.
Vargje: Pasi u vra një bashkëshorte e një mbreti të vdekshëm,/ gjeti nusëroren e paprishur të Mbretit.

Në të njëjtën ditë, shën Porfir stratilati së bashku me dyqind ushtarët, mbarojnë me shpatë.
Vargje: Bashkë me ushtrinë tënde, o Porfir, shkove me gatishmëri/ drejt shpatës, pikërisht si kryegjeneral.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i ndeshjes së Mërkurit, martir i madh.
Vargje: Edhe pse goditesh, o Mërkur, me shpatë,/ edhe i vdekur godet ti armik Zoti.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Petro Isihasti.
Vargje: Pasi përshkove detin e jetës qetësisht,/ arrin, o Petro, në liman të qetë.

Në të njëjtën ditë, gjashtëqind e shtatëdhjetë martirët e shenjtë mbarojnë me shpatë.
Vargje: Priten me shpatë gjashtëqind burra,/ së bashku me ta edhe shtatëdhjetë burra të tjerë.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

E shenjtores: Theú singatávasin

U bëre krenaria e martirëve, hyjnjohësja e shpresëtarisë, pasi i solle bashkësi martirësh Krishtit, dhëndrit tënd të shkëlqyeshëm, bashkë me të cilët thërret, o e tërëfamshme, duke psalur: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Fjala jote, o e tërëurtë, rrëmbeu nga mania e idhujve shumë persona drejt shpëtimit dhe i dëfteu martirë dritëprurës, që thërrisnin me zë të madh së bashku me ty: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Një e re që shkonte pas teje,[25] pasi u pre me shpatë, është ofruar tek ti duke imituar pësimin tënd të pacenuar, dhe duke të thirrur e duke të thënë ty, Ndërtuesit: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Hyjlindësore

Shenjti i shenjtorëve, kur fushoi shenjtërisht në ty, o Hyjlindëse, Virgjëreshë e kulluar, lindi i mishëruar prej teje për të shpëtuar ata që me besë thërrasin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

E shenjtit: Pedhes Evreon

I shkëlqyer me ndriçimin e dritës prej së larti, o ushtar trim, i llamburit ata që të himnojnë tani dhe këndojnë me melodi: I bekuar je, o Zot Perëndi, në jetët.

Himnoje Mirëbërësin e të gjithave, duke u ndezur prej zellit të tij, o i lumur, dhe duke u përflakur prej zjarrit të ndjeshëm e duke kënduar: I bekuar je, o Zot Perëndi, në jetët.

Ata që u blatojnë respekt gurëve, ata që kanë ndijim të ngurtë, e rëndojnë qafën tënde me gur, o martir Mërkur, që thërret: O Perëndi, je i bekuar.

Meqenëse përzjeve gjakun tënd të çmuar me gjakun[33] e Zotit njeridashës, u dëfteve pjesëtar i pësimeve[34] të tij duke thirrur, o Mërkur: O Perëndi, je i bekuar.

Hyjlindësore

Thellësia e misterit tënd, o Perëndilindëse, habit rreshta engjëjsh, sepse u pa Perëndia të mishërohet[35] prej teje, të cilit i këndojmë, o e tërëkulluar: O Perëndi, je i bekuar.

Zbritësore: I pedhes efsevia

Tre Djemat që u rritën

Ode VIII
E shenjtores: Eptaplasios káminon

Vasilisa, duke iu bindur mësimdhënieve të tua, vrapoi tek besimi hyjnor, dhe duroi fort ndijimin e dhembjeve dhe u denjësua dukshëm për mbretërinë pa trashëgim të qiejve duke thirrur: Zotin, o priftërinj, e bekoni, popull e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Me anën e martirëve u plotësofshin kërkesat e besnikëve, sepse athloforja qëndron pranë Krishtit, duke kërkuar më të mirat dhe ato që sjellin shpëtim tek ata që me gatishmëri bëjnë kujtimin e saj të tërëshenjtë, të respektueshëm dhe këndojnë me melodi besërisht: O popull, përmbilartësoni Krishtin në jetët.

Pasi ngriti dyert[36] e Parajsës Dhëndri, të pret, o e tërëurtë, dhe bëri një dhomë shumë të respektuar që të banosh,[37] dhe të tregon pjesëtare mbretërie si pjesëmarrëse e pësimeve;[34] pranë tij tani duke qëndruar, o bijë mbretërish, e stolisur shkëlqyeshëm,[38] mos na harro.

Tirani i tmerrshëm duke folur për gjëra të mundshme, me fjalë sofistike[39] tentonte që ta paralizonte rezistencën tënde, siç shpresoi, o e lavdishme; por si çmove të martohesh me Krishtin, thërrisje: Zotin, o priftërinj, e bekoni, popull, e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Ushfaqe më e hyjnueshme se rendi mbibotëror i engjëjve, o Hyjlindëse e tërëpaqortueshme, sepse ke lindur Bërësin dhe Zotin e tyre nga bark i virgjër, pa përvojë martese, në dy substanca pa trazim, pa ndryshim, por në një hipostazë, Perëndi të mishëruar.

E shenjtit I njëjti

Kori i atletëve të priti si anëtar të ri, të zbukuruar dhe të hijeshuar falë bukurive të respektuara të trimërive tepër të nderuara dhe falë dëshmisë sate besëmirë e faqebardhë; dhe tani thërret pa pushim: O priftërinj, e bekoni, popull, e përmbilartësoni Krishtin në jetët.

Me frymë shpresëtarie, o i lavdishëm, përshkove luftën dhe me moral trimërie turpërove armikun; dhe meqenëse korre si fitimtar fitore qiellore, tani gëzohesh bashkë me kore engjëllore, me të cilët thërret pa pushim: O priftërinj, e bekoni, popull, e përmbilartësoni Krishtin në jetët.

Pasi mbarove me shpatë, o Mërkur i tërëpasur, dhe arrite fundin që ishte

para teje, nga një anë vadite tokën me gjakun që u derdh, ndërsa nga ana tjetër, e tregove fitimtar trupin dhe të lumur, më të bardhë se dëbora,[40] duke psalur: O popull, e përmbilartësoni Krishtin në jetët.

Hyjlindësore

Derisa je arsyeja e rigatimit tonë, o e pacenuar, të gjithë besnikët të himnojmë, sepse ke lindur përmbi arsye Perëndinë e gjithëarsyeshëm, i cili rigatoi nga dhembshuria e vet ikonën[41] e dërrmuar nga e keqja, o e vetme e përmbibekuar dhe hirplote.

Zbritësore: Thávmatos iperfiús

Furra vesëplotë

Ode IX

Në vend të Më të nderuarën, psalet Ode IX e së kremtes (dhe madhështimet e saj).

E shenjtores: Eksesti epí tuto

Me zbukurim nus'ror je stolisur ti,* duke mbajtur llambadhe në dorën e djathtë si dhe* në të majtën tënde kokën e prer',* në dhoma dritëformëshe* u shpërngule; edhe tani, me nur* pran' dhëndrit tënd, pra Krishtit* qëndron; na ruaj dhe ne* që të himnojm', Ekaterina, ty.

Hyjmendëse, u prit lutja jote[42] plot,* se ata që thërresin me bes' emrin tënd, o e thjesht',* Zoti i shpëton krejt nga çdo ngacmim,* u jep shëndet, dhe gjithashtu* i çliron nga çdo lloj sëmundjeje* që torturojnë shpirtin* a trupin, pra me gaz thell'* të lumërojm', Ekaterina, ty.

U sigurove tash në liman të qet',* si përshkove leht'sisht me shkatht'si gjithë detin bot'ror,* o e tërëurt', pa u ngarë dot* as nga furtuna; solle k'shtu* pasuri të shum'llojshme tek Krishti,* o e tër'lumëruar,* Ekaterina vajzë,* grupimin e martirëve me ty.

Tash që kërcen me kor virgjëreshash ti* brenda dhomave lart në q'ell, duke shkëlqyer me lavd* prej martirizimit tënd, e tër'urt'* Ekaterina, zgjidhmë krejt* nga vargonjt' e shkeljeve që kam bër',*[43] dhe lyp me zemër dhe shpirt,* me zell tek Mirëbër'si,* për hirin e të cilit derdhe gjak.

Hyjlindësore

U shfaqe nënë Zoti, o Virgjëresh',* mbi natyrë, kur linde me trup dhe mish Fjalën e mir',* që nga zemra Ati e nxori[44] krejt* përpara gjithë jetëve,* se ishte dhe është gjithmon' i mir';* atë ne e mendojmë* se dhe tani ësht' më lart* se çdo trup, edhe pse ka veshur trup.

E shenjtit: Éfrikse pasa akoí

Plagët nga ndeshjet që ke bër'* po lëshojnë kundërmim hiri dhe dëbojn' me fjal' që s'thuhet dot* pasionet tona me er' të keqe, na burojn' rrëke shërimesh kockat edhe vaditen shpirtrat e besnikëve* që himnojnë vlerën, hirin, që kan' ato.

Si pirg i madh i Kishës son',* pra e Krishtit, të lëvdojmë hyjnisht, si shtyllë e patundur dot,* martir, si mur i pamposhtur, si ushtar me shum' fuqi i Perëndisë tër'mbretit, dhe rrëzues kundërshtarësh ti* dhe ndriçues botëror[45] dhe mendor me fam'.

Si trashëgim dhe si një çmim* kishe engjëll drite[46] bashk'udhëtar në ndeshje, o hyjmendës ti,* ndaj nuk u frikësove kur digjeshe me zjarr llambadhe, shtrembëroheshe si dhe priheshe tmerr'sisht me shpat' pa m'shir,* athlofor shum' trim i Krishtit dhe Perëndis'.

Feksi një ditë plot me drit',* me hare, me ngazëllim; pra kujtimi yt i hyjshëm shndriti fort* për ne që të nderojmë, Mërkur martir; në të kujtona ne që të kujtojm', dhe çlirona nga gjith' ngasjet, fatkeq'sit',* nga pasionet e rreziqet, peripecit'.

Hyjlindësore

O derë drite, ma ndriço* shpirtin tim të verbër prej çdo pësimi dhe mendimi të pavend,* i cili u err'sua dhe rrezikon; dhe nxirrmë nga ngacmime, hidhërime si dhe rreziqe, të të lavdëroj* ty, pra shpresën dhe fuqin' e besnikëve.

Zbritësore: Mistírion ksenon

O shpirt, madhështoje

dhe

Mister të çuditshëm

Dërgimësore e shenjtores
En Pnévmati to ieró

Forcove shum', o virgjëresh',* gjith' moralin e grave;* je lavd për athloforet pra,* o e tërënderuar,* Ekaterina; dhe marr'zi* filozofësh i ule* në Zot, si mit dhe fjal' kot,* duke pasur ti si ndihm'* nënën e Jisuit ton'* që ësht' vërtet pa cen, pa njoll'.

E shenjtit E ngjashme

Rrëzove ti përfundimisht* rende armiqësore* demonësh arrogant', Mërkur,* edhe prite kurorë* nga dora e Krijimtarit,* meqë ishe dëshmitar* i së vërtetës, dhe shpëton* nga çdo lloj skandali t' keq,* me të cilin na helmon* të gjith' i huaji përher'.

E së kremtes E ngjashme

Hyjlindës' e virgjër, të pret* Hierorja

e brendshme* me duar kryeprifti sot* dhe me hir do qëndrosh ti,* fëmij' trevjeçare deri* dymbëdhjet' vjeç, dhe atje* do marrësh ushqim nga dorë* engjëllore e hyjshme,* se do jesh ti ark' e shenjt*[47] e Bër'sit të çdo natyre.

Lavdërime: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtores

Të së kremtes Ting. I
Ton uranion tagmaton

Vajza që mbajnë llambadhe.
Si fryt premtimi të shenjt'.
Pasi, o Zonj', u ushqeve.

Të shenjtores Ting. IV
Édhokas simíosin

O Ekaterina e tër'famshme, bëjmë kujtimin tënd,* e kujtojm' ndeshjen plot me nder* që ke bër' me trimëri;* lavdërojm' me zëra* pa pushim atë që të dha durim që s'mposhtej dot* dhe të tregoi ty fitimtare krejt* dhe dha tek ti fjal' që frik'soi oratorët, pra Zotin ton'* njeridashës dhe shpëtimtar,* Jisu Krisht, Perëndinë ton'.

O Ekaterina e tër'lavdëruar, u shfaqe qart'* vullnetare dëshmore ti,* qortove tiranin rënd'* dhe manin' e çmendur* të politeizmit e shembe me ndriçim hyjnor* dhe me hyjdije si dhe me hir nga lart;* prandaj dhe Krishti të kurorëzoi ty si martire t'shenjt',* virgjëresh' pa qortim aspak,* Shpëtimtari i shpirtrave.

O Ekaterina e tër'lavdëruar, pranove ti* Hirin e Shpirtit të Tër'shenjt'* me çeljen e gojës,[48] se* më par' e pastrove* me gatishmëri veten tënde dhe jetove mir',* i hodhe posht' vetulla tiranësh[49] krejt* përmes mendimit shum'durues; kundërvure hyjmendërisht* bukurinë e shpirtit tënd* ndaj asaj që kish trupi yt.

Lavdi *Ting. II*
I Vavilasit

U ushtrove në jetë jolëndore dhe kur arrite para podiumit ateist, qëndrove trofeprurëse, o Ekaterina modeste, duke lulëzuar shkëlqimin e Perëndisë; dhe e veshur me fuqinë e hyjnueshme, talle plotësisht dogmat e tiranit dhe pushove fjalimet llafazane të oratorëve, o fitimtare e madhe.

Tani *I së kremtes*
I njëjti I Leonit Mjeshtër

Sot në Tempull sillet Virgjëresha e tërëpaqortueshme për banesë të Perëndisë,[50] Tërëmbretit dhe ushqyesit të të gjithë jetës sonë. Sot shenjtërimi absolutisht i pastër, si mëshqerrë trevjeçare[51] në të Shenjtat e të Shenjtave futet. Le t'i thërrasim asaj si

engjëlli: Gëzohu, o e vetmja e bekuar ndër gratë.[52]

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtores dhe e kishës. Kontaqi I përmbipaqmi tempull. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtores. Në vend të Të meriton, Engjëjtë çuditeshin... Si një ark' zotërore.

Kungatore: Kupë shpëtimi.
Pamë dritën.

CITIME

[1] Eks. 3.2

[2] Jov 41.16

[3] Joan 14.2

[4] Matth. 26.7; Mark. 14.3; Lluk. 7.37

[4a] Num. 4.19; Hebr. 9.3

[4b] Lluk. 1.28

[5] Ef. 6.17

[6] Lluk. 16.9

[7] Vep. 7.59

[7a] Gjen. 21.2; Gjyq. 13.24; I Mbret. [Sam.] 1.19-20 etj.

[7b] Jez. 44.1-4

[8] Matth. 6.23; Lluk. 11.34

[9] Kënga 1.4

[10] Joan 1.14

[11] Vep. 5.41; Fil. 1.29

[12] I Petr. 5.1

[13] Ef. 6.12

[14] Gjen. 3.4-5

[15] II Kor. 10.13,15

[16] Jak. 3.17

[17] Lluk. 1.48

[18] Is. 52.7; Rom. 10.15

[19] I Kor. 1.18

[20] Joan 8.12; 9.5; 12.46

[21] Joan 19.23

[22] Gjen. 3.21

[23] Hebr. 12.4

[24] Gjyq. 6.38

[25] Kënga 1.3-4

[26] Matth. 7.24-25; Lluk. 6.48

[27] Gal. 2.20

[28] Kënga 4.7

[29] Lluk. 1.31

[30] Is. 9.6

[31] Gjen. 3.15

[32] Gjen. 1.3,6,9,11,14,20,24; Ps. 148.5

[33] Lluk. 13.1

[34] II Kor. 1.7; Fil. 3.10; I Petr. 4.13

[35] I Tim. 3.16

[36] Ps. 23(24).7,9

[37] Ps. 44(45).10

[38] Ps. 44(45).14

[39] Kol. 2.4

[40] Ps. 50(51).9

[41] Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6;
Urt. Sol. 2.23; 7.26; Sirak 17.3

[42] Tobit 3.16; Ps. 6.10; Vep. 10.31

[43] Fja. Urt. 5.22

[44] Ps. 44(45).2

[45] Fil. 2.15

[46] (II Kor. 11.14)

[47] Eks. 25.9-20; 38(37).1; Ligji i Dytë 10.2;
Ps. 131(132).8

[48] Ps. 118(119).131

[49] Ps. 17(18).28

[50] Jez. 37.27; II Kor. 6.16; Ef. 2.22

[51] Gjen. 15.9

[52] Lluk. 1.28

MË 30 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i apostullit të shenjtë Andrea.

Tipikon

Nëse bie e diel, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 të apostullit. Lavdi i apostullit. Tani Hyjlindësore dogmatike e tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i apostullit. Tani Hyjlindësorja e tij (Parakremtore). Përlëshoret: ngjallësore, e apostullit dhe Hyjlindësorja e saj.

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e apostullit dhe Himne Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e apostullit. Në Mëngjesore, Ndenjësoret: nga një ngjallësore dhe e apostullit së bashku me Hyjlindësoren e saj. Pas Polieleit, Ndenjësorja e apostullit së bashku me Hyjlindësoren e saj. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat e tingullit dhe Proqimeni. Kanunet: ngjallësor dhe i apostullit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Ndenjësorja e apostullit dhe Hyjlindësorja e saj. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e apostullit dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja Krishti lind; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor. Më të nderuarën. Dërgimësoret: ngjallësore, e apostullit dhe Hyjlindësorja e saj. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të apostullit. Lavdi i apostullit. Tani E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket dhe Lumërimet: 4 të tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të dytë të apostullit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e apostullit dhe e kishës. Kontaqi Virgjëresha sot po vjen. Apostulli dhe Ungjilli i apostullit. Kungatore Në gjithë dheun.

NË MBRËMËSORE

Pas Stancës së parë të Psaltirit (Lum ai njeri)

Vargëzime Ting. IV
O eks ipsistu klithís

Ti u mësove prej dritës së Pag'zorit,*[1] kur ndriçimi enipostat i lavdis' që vjen* nga Ati[2] Zot llamburit, meqë* nga dhembshuria* kërkonte që ta shpëtonte njerëzin',* o i lavdëruar, atëher' i pari ti* vrapove shpejt i ndriçuar krejt* nga vezullimet* e tër'përsosura të Hyjnis' së tij;* pra predikues* dhe apostull i Krishtit dhe Perëndis' ton' ke qen' dhe je;* lut atë të shpëtojë,* të ndriçojë shpirtrat tan' me drit'.

(2x)

Kishe dëgjuar fort zërin e Pag'zorit,*[3] kur u mishërua k'tu Fjala e Tërëshenjt',*[4] që të na jepte vërtet jet' dhe* ungjillëzimin* tek ne të gjith' për shpëtim; at'herë ti* shkove pas asaj, dhe si një gjë të çmuar shum',* pra si flijim frutash të tër'shenjt'*[5] i përkushtove* Jisuit, Zotit dhe Perëndisë ton'* veten, i tër'urt',* dhe e njohe, edhe e shpalle tek v'llai yt qartësisht;*[6] lutju që të shpëtojë,* të ndriçojë shpirtrat tan' me drit'.

(2x)

U shoqërove me degën e beronjës;*[7] kur bir lindi virgjërisht, diell, Mësuesi* i shpres'taris' edhe mençuris',* duke rrëfyer* virtytin e pastërtis', at'herë ti,* mik i ngusht', i ngroht' i së mirës u bëre shpejt,* dhe vure thell', o i lumur shenjt,* në zemër ngjitje,*[8] u ngjite k'shtu nga lavdia drejt lavdis'*[9] që dot nuk shprehet* e Jisuit Krisht, Perëndis' tonë edhe Çlironjësit;* lut atë të shpëtojë,* të ndriçojë shpirtrat tan' me drit'.

(2x)

Lavdi *Ting. IV*
I Anatoliut

Pasi braktise gjahun e peshqve, o apostull, njerëz zë në rrjeta me kallamin e predikimit, duke hedhur si grep karremin e shpresëtarisë dhe duke ngritur nga fundi i mashtrimit të gjithë kombet; o Andrea apostull, i një gjaku me korifeun dhe mësues zëmadh i botës, mos pusho së ndërmjetuari për ne, të cilët me besë dhe mall lavdërojmë, o i tërëlavdëruar, kujtimin tënd gjithmonë të respektuar.

Tani *I njëjti*

Isaia vallëzo, mikprit Fjalë Perëndie; profetizo tek vajza Mari një ferrë të përflaktë dhe të mos digjet[10] me shkëlqimin e Hyjnisë. O Bethlehem hijesohu, hape portën, o Eden,[11] dhe ju Magë ecni për të parë shpëtimin që mbështillet me shpërgënj në grazhd; atë e lajmëroi një yll mbi shpellë, Zotin jetëdhënës, që shpëton gjininë tonë.

Hyrje. O dritë gazmore. *Leximet.*

Këndimi i letrës së parë katholike të Petros

(1.1-2; 10-25; 2.1-6)

Petro, apostull i Jisu Krishtit, atyre që banojnë përkohësisht në diasporën e Pontit, Galatisë, Kapadhokisë, Azisë e Bitinisë, të zgjedhur sipas paranjohjes së Perëndisë Atit, me anë të shenjtërimit të Shpirtit, për dëgjim e spërkatje të gjakut të Jisu Krishtit; hir dhe paqe u shumofshin në ju. Për

shpëtimin kërkuan dhe hulumtuan profetët që profetizuan për hirin *që do të jepej* tek ju, duke hulumtuar në cilën apo në çfarë kohe deklaronte Shpirti i Krishtit që *ishte* në ata, kur dëshmonte që më përpara për pësimet e Krishtit dhe për lavditë pas tyre; këtyre iu zbulua se jo për veten e tyre, po për ne i shërbenin ato *gjëra*, të cilat tani ju janë lajmëruar juve me anë të atyre që ju ungjillëzuan në Shpirtin e Shenjtë, që u dërgua nga qielli, *gjëra* në të cilat engjëjt dëshirojnë të përkulen *e t'i shohin*. Prandaj si të ngjishni meset e mendjes suaj, duke vigjiluar shpresoni plotësisht në hirin që sillet tek ju në zbulesën e Jisu Krishtit, si bij të bindjes, duke mos u përshtatur me dëshirimet e mëparshme në padijen tuaj. Por sipas shenjtit që ju thirri, edhe ju bëhuni shenjtorë në çdo sjellje. Sepse është shkruar: "Bëhuni shenjtorë, sepse unë jam shenjt". Edhe nëse quani Átë atë që gjykon pa mbajtur anë sipas punës së gjithësecilit, silluni me frikë në kohën e qëndrimit tuaj të përkohshëm duke ditur se jo me gjëra që prishen, me argjend ose me ar, u shpërblyet nga sjellja juaj e kotë, që ju kanë dhënë etërit, por me gjakun e çmuar të Krishtit, si të një qengji pa qortim e të panjollë; i cili qe paranjohur përpara vendosjes së botës, por u shfaq në kohët e fundit për ju. Me anë të atij i besoni Perëndisë që e ngjalli atë prej së vdekurish, e i dha atij lavdi, që besimi dhe shpresa juaj të jetë më Perëndinë. Si të pastroni shpirtrat tuaj me bindjen e së vërtetës me anë të Shpirtit, për një dashuri vëllazërore e pa hipokrizi, të doni gjerësisht njëritjetrin me zemër të pastër; jeni lindur përsëri jo nga një mbjellje e prishshme, po e paprishshme, nëpërmjet fjalës së Perëndisë që rron e që mbetet përjetë. Sepse "çdo mish *është* si bar, dhe çdo lavdi njeriu si lule bari; u tha bari, dhe lulja e tij ra. Po fjala e Zotit mbetet përjetë". Edhe kjo është fjala që u ungjillëzua tek ju. Si të hidhni tej pra, çdo ligësi e çdo dredhi, dhe hipokrizira, dhe smira, dhe të gjitha thashethemet, si foshnja të sapolindura, qumështin mendor e të kulluar të dëshironi, që me anën e tij të rriteni në shpëtim, nëse "shijuat se Zoti *është* i mirë". Duke u afruar pranë tij, gurit të gjallë, të shpërfillur nga njerëzit, por të zgjedhur nga Perëndia e të çmuar, edhe ju, si gurë të gjallë, ndërtohuni *në* shtëpi shpirtërore, priftëri të shenjtë, që të ofroni therorë shpirtërorë të pëlqyer prej Perëndisë me anë të Jisu Krishtit. Prandaj përfshihet në Shkrim: "Ja tek vë në Sion *një* gur kryeqosheje, të zgjedhur, të çmueshëm; dhe ai që e beson atë nuk do të turpërohet".

Këndimi i letrës së parë katholike të Petros
(2.21-25; 3.1-9)

Të dashur, Krishti pësoi për ju duke ju lënë një shembull, që të ecni pas gjurmëve të tij; “ai nuk bëri mëkat, as nuk u gjet mashtrim në gojën e tij”, që kur përqeshej nuk përqeshte dhe ai, kur pësonte nuk kërcënonte, por dorëzonte tek ai që gjykon me drejtësi. “Ai mëkatet tona i mori përsipër” në trupin e tij mbi dru, si të mbarojmë për mëkatet, të rrojmë në drejtësi; “me plagën e tij u shëruat”. Sepse ishit “si dhen të endur”, po u kthyet tani te bariu dhe episkopi i shpirtrave tuaj. Gjithashtu *ju* gratë, *jini* të bindura ndaj burrave tuaj, që, edhe nëse disa nuk i binden Fjalës, të fitohen pa fjalë me sjelljet e grave, pasi të shohin sjelljen tuaj të dëlirë e me frikë. Stolia juaj le të mos jetë e jashtme, ajo e gërshetimit të flokëve dhe e varjes së *stolive të* arta, ose e veshjes së rrobave, por njeriu i fshehtë i zemrës, *stolisur* me paprishjen e shpirtit të butë dhe të qetë, që *është* përpara Perëndisë shumë i çmueshëm. Sepse kështu dikur edhe gratë e shenjta që shpresonin tek Perëndia, stolisnin veten e tyre, duke iu bindur burrave të tyre; siç iu bind Sara Abrahamit, duke e quajtur atë zot; fëmijë të saj jeni ju, kur bëni mirë dhe nuk trembeni nga asnjë frikë. Ju burrat, në të njëjtën mënyrë, jetoni bashkë *me gratë tuaja* me dituri, duke u dhënë nder grave si enë më e brishtë dhe si bashkëtrashëgimtare të hirit të jetës, që të mos pengohen lutjet tuaja. Edhe së fundi, *bëhuni* të gjithë në një mendje, të dhembshur, vëlladashës, përdëllimtarë, të sjellshëm, duke mos shpaguar të keq me të keq, apo talljen me tallje; por përkundrazi, duke bekuar; duke ditur se për këtë u thirrët, që bekim të trashëgoni.

Këndimi i letrës së parë katholike të Petros
(4.1-11)

Të dashur, pasi pësoi Krishti për ne në mish, edhe ju me po atë mendim armatosuni; se ai që pësoi në mish, pushoi nga mëkati, që të mos jetojë më në mish kohën që mbetet, në dëshirime njerëzish, po sipas dëshirës së Perëndisë. Sepse mjaft *është* për ju koha e jetës që iku, që bënit vullnetin e kombeve, duke ecur në ndyrësira, në dëshirime, në dehje, në dëfrime, në të pira, dhe në idhujtari të paudha. Për këtë çuditen *ata*, se ju nuk vraponi bashkë në po atë vërshim të plangprishjes, dhe shajnë. Ata do t’i japin llogari atij që është gati të

gjykojë të gjallë e të vdekur. Sepse për këtë u ungjillëzua edhe tek të vdekurit, që të gjykohen sipas njerëzve në mish, por të rrojnë sipas Perëndisë në shpirt. Edhe fundi i të gjithave u afrua; urtësohuni pra, e rrini zgjuar në falje. Edhe përmbi të gjitha, dashurinë ta keni të gjerë brenda vetes tuaj; sepse "dashuria do të mbulojë *një* shumicë mëkatesh". *Të jeni* mikpritës njëri për tjetrin, pa murmuritje. Gjithësecili sipas dhuratës që mori shërbeini njëri-tjetrit, si administratorë të mirë të hirit shumëfarësh të Perëndisë. Nëse flet ndonjë, *le të flasë fjalë* si fjalë Perëndie; nëse shërben ndonjë, *le të shërbejë* si prej fuqisë që i jep Perëndia, që në çdo gjë të lavdërohet Perëndia me anë të Jisu Krishtit, të cilit i përket lavdia dhe pushteti në jetë të jetëve. Amin.

Në Liti
Ting. I
I Andrea Jerusalemasit

Andrea, apostulli dhe nxënësi i parëthirrur dhe imituesi i pësimit, duke u përshtatur me ty, o Zot, ata që endeshin në fundin e padijes dikur, pasi i tërhoqi lart me grepin e kryqit, i solli tek ti; me ndërmjetimet e tij, o i tërëmirë, paqëso jetën tonë dhe shpëto shpirtrat tanë.

I njëjti

Le të himnojmë, o besnikë, vëllanë e Petros, Andrean, nxënës i Krishtit; sepse ai pasi hulumtoi dikur detin me rrjeta, zuri peshq, ndërsa tani botën e zë me kallamin e kryqit dhe kombet i kthen nga mashtrimi[12] përmes pagëzimit; dhe duke qëndruar pranë Krishtit, kërkon paqen për planetin dhe për shpirtrat tanë përdëllimin e madh.

I njëjti

Zjarrin mendor, i cili ndriçon mendjet dhe flakëron mëkate, pasi e mori në zemër apostulli i Krishtit dhe nxënësi, feks nga një anë me rrezet mistike të mësimdhënieve në zemrat e pandriçuara të kombeve, dhe nga ana tjetër, djeg mitologjitë e shkrumbuara të të pabesëve; sepse zjarri i Shpirtit ka energji të tillë. O çudi e huaj dhe e frikshme! Gjuhë balte, natyrë balte, trupi i dheshëm mikpriti dije mendore dhe jolëndore. Por, o njohës i mistereve të pathënave dhe shikues i qielloreve, përgjëroju që të shkëlqejnë shpirtrat tanë.

Ting. Tërth. IV

Kur e pe të ecte në mish mbi dhé Perëndia i dëshiruar, o hirshikues i parëthirrur, i thërrisje i ngazëlluar

vëllait: Gjetëm, o Simon, të dëshiruarin; ndërsa i thërrisje Shpëtimtarit si Davidi: Ashtu si sorkadhja dëshiron fort burimet e ujërave, kështu të dëshiron fort shpirti im ty, o Krisht Perëndi;[13] pra dhe duke shtuar mall mbi mall, nëpërmjet kryqit kalon tek ai që përgjërove, meqë u bëre nxënës i vërtetë dhe imitues i urtë i pësimit të tij përmes kryqit; ndaj dhe meqenëse u bëre pjesëmarrës i lavdisë së tij, lutju gjerësisht për shpirtrat tanë.

Lavdi *I njëjti*
I Andrea Jerusalemasit. Sipas të tjerëve, i Anatoliut.

Predikuesin e besimit dhe shërbyesin e Fjalës,[13a] Andrean le ta lavdërojmë, sepse ai peshkon njerëz nga fundi, duke mbajtur në duar në vend të kallamit kryqin, dhe duke hedhur si fije fuqinë, i rikthen shpirtrat nga mashtrimi i armikut dhe i blaton Perëndisë dhuratë të mirëpritur; gjithmonë, o besnikë, atë bashkë me korin e nxënësve të Krishtit le ta lavdërojmë, që të ndërmjetojë të bëhet për ne i butë në ditën e Gjykimit.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Pasvargje
Ting. Tërth. I
Heris askitikón

G'zohu, qiell mendor, që rrëfen* gjithnjë lavdin' e Perëndis',[14] që u binde krejt* i pari, kur Krishti ftonte, dhe menjëher' shkove pas* dhe u shoqërove* me atë ngroht'sisht;* prej tij u ndriçove mjaft,* pra u duke si drit' e dyt',* dhe na ndriçove* me shkëlqimet e tua ne* t'errësuarit;* imitove mir'sin' e tij;* ndaj bëjmë panairin tënd të tër'shenjtë; puthim dhe* me gaz kutin' e lipsaneve nga buron për të gjith' shpëtim,* për sa e kërkojnë* me besim atë, dhe ndjesë, dhe përdëllim të madh.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij.

Gjete të parën që dëshirojm',* të jet' e veshur me natyrën ton' dhembshurisht,* Andrea hyjmendës, dhe u bashkove me të me mall* të përflakt'; thërrisje* ti tek v'llai yt:* Atë që profetët tan'* predikuan në Shpirt të Shenjt'* e kemi gjetur,* mendja jon', pra dhe shpirti yn'* le të joshen shum'* nga e gjith' bukuri e tij,* k'shtu do ndriçojm' nga shkëlqime që madhërisht lëshon,* të mposhtim natë mashtrimi dhe errësir', injoranc' të thell';* dhe le ta bekojmë* Krishtin, që dhuron te bota jon' përdëllim të madh.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

Kombet që s'njihnin dot Perëndin',* nga thellësia e padijes i zure ti* me rrjetën e fjalës sate; trazon me vrull qartësisht* detin e tër'kripur, se u duke kal'*[15] i mir' i Sunduesit* të çdo deti, o shenjt me nam,* dhe kalbëzimin,* ateizmin e thave krejt,* duke vën' urtin'* që e kishe si krip'[16] me vler;* çuditi urtësia jote sa ndjekin paturp'sisht* besën e rrem', urtësin' që u prish,[17] apostull i njohur shum',* se nuk njohin Zotin,* Krishtin, që dhuron te bota jon' përdëllim të madh.

Lavdi *Ting. III*
I Gjermanoit

Vëllain e Petros dhe nxënësin e Krishtit, gjuetarin e peshqve dhe peshkatarin e njerëzve, le ta nderojmë me himne, Andrean apostull, sepse i mësoi të gjitha mësimdhëniet e Jisuit me dogmat; dhe si karrem tek peshqit u dha mishrat të paudhëve dhe i kapi ata. Me ndërmjetimet e tij, o Krisht, jepi popullit tënd paqe dhe përdëllimin e madh.

Tani *I njëjti*

O Josif, na thuaj ne, si Vajzën që more në dorëzim nga të Shenjtat, e sjell ti shtatzënë në Bethlehem? Unë, thotë, pasi hulumtova profetët dhe pasi mora orakull nga engjëlli, jam bindur se do të lindë Perëndi Maria pa shpjegim, për faljen e të cilit do vijnë Magë nga Lindja, duke e adhuruar me dhurata të çmuara. Ti që u mishërove për ne, Zot, lavdi më ty.

Përlëshore
Ting. IV

Si i parëftuari i apostujve dhe vëllai i kryetarit, lutju Zotit të Gjithësisë, o shën Andre, t'i falë paqen botës së tërë, dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.*

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Misteri i fshehur prej jete dhe i panjohur ndër engjëjtë, u shfaq ndër të dheshmit me anën tënde o Hyjlindëse, Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzier dhe denjoi kryq për ne duke dashur, me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtrat tanë.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. I Ton tafon su Sotír

Andrea apostull,* me mall thell' të lëvdojmë* si nxënës të hyjnueshëm, të parëthirrur* nga nxënësit e Krishtit,

dhe të thërresim me bes': Shpëto* grigjën tënde ti,* që Zoti ty ta besoi,* nga shtrëngim, mjerim* edhe skandale të ndryshme,* si dhe nga çdo keqtrajtim.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Tash, o modeste shum',* si do shtrish duart tek ne* me dhembshuri, na jep ndihmë prej Shenjtërores,* përkrahna që të shkojmë jetën pa fare rrezik, të gjith'* ne që Birin tënd* e lavdërojm', dhe ty, Zonjë,* të konsiderojm',* o Vajzë, shpresë dhe mburrje;* k'shtu ty të përshkruajmë.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. III Thias písteos

Kur të ftonte ty,* të gjeti Krishti,* o Andrea shenjt,* njoh'sin e parë* të mistereve; urdh'resat e tij shpallje* në bot' prer'; shndrite sistemet e kombeve,* ku fluturoje që të predikoje ti;* përgjëroju, o i lumur, atij si Perëndi,* të na dhurojë ndjes' dhe përdëllim të madh.

Lavdi *I njëjti*

Tani *Hyjlindësore*

Je, o Virgjëresh',* tendë e hyjshme*[18] krejt për Fjalën Zot,* se je e d'lirë;* epërsin' në pastërti e ke mbi engjëj;* i ndyrë jam më shum' se gjithë njerëzit,* me shum' mëkate mishore, pastromë pra,* me rrëke të ndërmjetimeve pranë Birit tënd;* më jep ti përdëllimin e madh, o e thjesht'.

Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. Tërth. I
Ton sinánarhon Logon

Të gjith' le ta lëvdojmë apostullin e shenjt'* si predikues sypamës i Fjalës dhe dëshmitar,* peshkatarin shpirtëror të kombeve vërtet,* se na e solli njohurin'* e Jisuit Krisht,[19] Andrean hyjfolës; dhe ai tash* ndërmjeton pa ndërprerje fare, që të shpëtohen shpirtrat tanë përjet'.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Virgjëresh', ti je strehë për çdo njeri që ka* krejt pa ngurrim në ty shpresat; çlirona nga çdo ngacmim* dhe nga çdo peripeci, nga çdo rrezik e tmerr,* dhe fatkeq'si të ndryshme ti,* o e pacenuar, duke lutur dhe ndërmjetuar* pranë Birit tënd me apostujt e tij; shpëto pra, sa të përhimnojn'.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni
Ting. Tërth. IV

Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

Varg: Qiejt tregojnë lavdi Perëndie.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e apostullit. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.
Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. I

Andrea, apostulli dhe nxënësi i parëthirrur *(Kërkoje në Liti).*

Kanunet: e Hyjlindëses dhe të dy të apostullit

Ode I
E Hyjlindëses
Ting. I Irmosi: Odhín epiníkion

»Një këng' triumfuese le t'ia kën»dojmë të gjith' Perëndis' që bëri mre»kulli mahnit'se me krahun shum' të »lart'*[19a] dhe e shpëtoi Izraelin; u »lëvdua fort.

Meqë vetëm ti në mish Birin e pakoh' e linde në kohë, o e d'lir', e Tërëshenjt' e panjollshme, çdo pasion* kronik të shpirtit tim mizor krejt ti shëroje, Zonj'.

Shfaros si e dhembshur ti, o e Tër'shenjtë, me lutjet e tua traumat e shpirtit tim, ngurt'sin' që në zemër kam,* err'sirën e mendimit[20] tim, çdo devijim mendor.

E ke lindur dritën ti, pra Çlirimtarin tim, o e panjollshme, prandaj çliromë nga err'sir' e përjetshme dhe* tortura, që të lavdëroj un' madhështimin tënd.

Largo errësirat e mendjes që un' kam, me dritën që ke, o lindëse e dritës, o e tër'paqortueshme;* më jep të shoh, o e mir', dritën që u lind nga ti.

Kanuni i parë i apostullit
Poezi e Joan Monakut
Ting. I
Su i tropeuhos dheksiá

Shpirtin tim të turbulluar keq* pastroje krejt nga mendime dhe fjalë, se* brenda teje ka fushuar Hir i shenjt',* Andrea predikues shenjt,* që un' të ofroj me d'lir'si tek ti një himnim të denj'.

Pararendësi i Zotit Krisht,* lastar i shterpës[7] të dha ty te Krishti yn',* fryti i lëvduar i së virgjërës;* të dha me gaz si një të madh,* si të çmuar midis dishepujve të tij, o Andre.

Falë dashuris' sate të thell'* dhe mallit tënd, ti u ngjite në shkall' të shenjt'* që ka plot virtyte, dhe studiove mir',* Andrea, ngjitje[8] përgjithmon';* në fuqi të madhe arrite ti nga fuqi e pakt'.[21]

Hyjlindësore

G'zohu, o burim i Hirit t' shenjt',*

gëzohu, shkallë dhe portë e qiellshme;*[22] g'zohu, shtambë ari[23] dhe kandil,[24] dhe mal* i palatuar,[25] që në barr'* kishe jetëdhënësin, Krishtin, për hirin ton' në bot'.

Kanun i dytë i apostullit
I njëjti O dhiá stilu pirós

Pasi u ngrite nga fundi i martirizimit me kallamin e Ungjillit, o Andrea i shumëhimnuar, zure popuj siç premtoi Krishti, i cili të mësoi që të kapësh me rrjetë njerëz si peshq.

Shtylla e besimit, selia e dogmave të vërteta të Krishtit, Andrea i hyjfrymëzuar fton sot anët e steresë, që të formojnë një të kremte vjetore; pra, le të mblidhemi të gjithë besnikët.

Duke hulumtuar me rrjeta gjerësinë detare ti, peshkatar në zanat, zë në Shpirtin me rrjetën e Shpirtit kombe, fise, popuj, dhe ua zbulon qartësisht fundin e sipërm, o i shumëçuditshëm.

Ti që lëviz brenda mistereve, dëshmitar okular dhe orator i dijes së pashprehshme të Krishtit, që pranove nga lart Shpirt të Shenjtë i ulur në formë gjuhësh, që flet dhe që ndan në zjarr[26] karizmat,[27] lyp për të na shpëtuar.

I falem besërisht, përmbi çdo qenie njësisë së Trinisë para çdo fillimi, duke mos prerë Hyjninë, sepse është e njëshme, e thjeshtë, e pandarë; dhe e bashkoj atë në esencën e personave dhe i ndaj besërisht.

Tani

Një Perëndi bëhet foshnjë nga një e virgjër dhe i bën të rinj ata që u prishën nga Adami dhe shkatërron murin ndarës[28] dhe rrethimin e armiqësisë në mishin e tij, dhe bekon mallkimin e stërnënës, pasi doli nga nënë e papikëluar.

Zbritësore: Hristós jenate

Ja Krishti lind, lavdërojeni
(shih faqen 410)

Ode III
E Hyjlindëses
Irmosi: Stereothito i kardhia mu

»**L**e të forcohet zemra ime fort* tek »vullneti yt, Perëndia im,* që mbarë »qiellin e dyt' e forcove mbi ujëra* dhe »mes ujërash mbështete dhen',*[29] o i »tër'fuqishëm Zot.

Shporr çdo pafryt'si të mendimit tim,* që ësht' shterp, pastaj e trego shpirtin tim* fryt'dhënës me virtyte, o e Tër'shenjtë Hyjlindëse;* ti je ndihma e besnikëve,* përkrahja dhe shpresa jon'.

Nga çdo dënim shpëtomë gjitha-

shtu* dhe nga shum' skandale të gjarprit ti,* nga errësira dhe nga zjarr i amshuar; nuk ke qortim;* na ke lindur dritën që nuk ka* aspak perëndim përher'.

Gjykimin e pashmangshëm e kam frik'* edhe zjarrin që kurrë nuk shuhet dot,* o e kulluar, dhe vendimin e trembshëm, nxito pra tash* dhe shpëtomë para fundit tim;* un' jam shërbëtori yt.

O Virgjëresh' e tër'himnuar, ësht'* i bekuar fryti i barkut tënd,*[30] sepse si kreu të paprishshëm me drurin, me kryqin pra,* sa u prishën me pem',[31] i ka bër'* pjes'marrës të Hirit t' shenjt'.

E apostullit: O monos idhós

I etur arrite plot me vrull,* megjith'se i paftuar ti,*[32] Andrea, tek burimi i jetës son'* si një dre,[13] dhe kur e gjete, tek të gjith'* e zbulove, dhe pastaj* pive; dhe çdo skaj në bot'* plot that'sirë vadite, ujite boll.

Ti njohe mir' ligjin natyror,* Andrea, që të admirojm',* pra more v'llain bashk', duke thirrur ti:* Të dëshiruarin ne e gjetëm[33] tash;* e udh'hoqe në njohje*[34] t' thell' të Shpirtit t' Shenjt' atë* që i hapi Jisuit rrug'[35] për lindjen.

Me rrjetën e fjalës ti ke zën'* nga fundi i mashtrimit thell',* apostull, gjah, pra peshqit mendorë krejt;* në tavolinën e Krishtit si një gjell'* e d'lir' i dhe, se u bën'* të ndriçuar nga Hiri* i atij që u duk në një form' mishi.[36]

Hyjlindësore

E padjegur mbete, Virgjëresh',* megjith'se nëpërmjet Shpirtit* të Tërëshenjt', në bark zure Perëndi,*[37] se ty një ferr' e përzjarrt' që s'prishej dot* të njoftoi qartazi* tek ligjvënës Moisi,*[37a] ti që prite zjarr që s'kufizohet dot.

Tjetri: Stereothito i kardhia mu

Me fjal' e ftoi Krishti: Ndiqmë ti.* Dhe në çast e ndoqi Kefa plot me zell* me v'lla Andrean, duke lën' atin, rrjetat, anijen gjith';* dhe u bën' fortifikim i madh* dhe muret e besës son'.

Ndryshove ti tempujt e idhujve,* o i respektuar, në tempuj zot'ror* dhe tek ata i dedikove gjith' bijt' e pag'zimit pra,* që ripërtëriti Shpirti Shenjt'* me Hirin e tij, me uj'.[38]

Margaritarin e shum'çmueshëm* ti e gjete[39] para në bot' mistikisht* të fshehur, o apostull, në arën e zemrës sate dhe* k'të e gjetën kombet me besim* dhe u pasuruan k'shtu.

Në duar more si thesar të madh,* o i tër'himnuar, Ungjillin, pastaj* e pasurove dhenë me predikim të hyjnueshëm;* ndaj nderon kujtimin tënd ai,* arritjet që ti i ke.

Lavdi

Fuqin' që ësht' një në Trinin' e Shenjt',* ne orthodhoksisht ta himnojmë të gjith',* të lavdërojmë Perëndinë e bashk'qenshëm, tridiellor,* pa fillim, Zot të bashk'fronëshëm* të pabër', trihipostat.

Tani

Çdo nën' që lind fëmij' nuk mundet më* që të jet' e virgjër; por ti qart'sisht,* nën'virgjëresh', edhe pse linde ti Krishtin, dhe jepje gji* tek ai që është jeta jon',* ti mbete prap' e tër'd'lir'.

Zbritësore: To pro ton eonon

Përpara nga jetët

Ndenjësore Ting. Tërth. IV
Tin sofian qe Logon

Më par' se çdo dishepull u thirre ti,* shërbëtor okular i Fjalës ke qen';* prandaj të lëvdojmë ty,* o Andrea detyrimisht,* se ndoqe ngrohtësisht me mall pa hezitim, kursim,*[32] pra qengjin që i ngre gjith' mëkatet e botës[40] son';* edhe u dallove si pjes'marrës pësimi,* që Krishti yt vuajti* në mish kur vdiq vullnetarisht;* ndaj thërresim* tek ti me zë;* ndërmjeto tek Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Lavdi *Tjetër e ngjashme*

Meqë tër' arrogancën e idhujve* e rrëzove dhe deshe pësim zot'ror,* Andrea i lumur fort,* u dëfteve apostull ti;* buroje për të gjithë çudira nga qielli,* u bëre dhe mësues i kombeve,[41] o i urt';* ndaj nderojm' kujtimin tënd siç e meriton krejt,* me himne të lavdërojm'* dhe me besë të madhërojm',* o apostull* i Perëndis',* ndërmjeto te Zoti yn' Krisht,* që të dhurojë ky ndjesën* e fajeve* tek ne që me mall bëjm' kujtimin tënd shum' të shenjt'.

Tani *Hyjlindësore*

G'zohu, o fron zot'ror me një form' si zjarr,*[42] o katedër mbret'rore, g'zohu, o Vajz',* shtëpi[43] ari, purpuri* dhe mantel mbretëror i kuq,* shtrat[44] me mbules' të purpurt dhe tempull i çmuar shum',* kandil[24] i shum' shkëlqyer dhe qerre porsi rrufe;*[42] je qytet me dymbëdhjetë mure rrethimi* dhe

port'[45] që u bë me ar,* dhe tra-pez'[46] lavdi me flori,* tend'[47] e bukur* hyjnisht me hir,* g'zohu, nuse me madhështi,* që po pikon porsi diell,* gëzohu ti,* g'zohu, o hijeshi për shpirtin tim, o Mari.

Ode IV
E Hyjlindëses
Irmosi: En Pnévmati provlepon

»Duke e parë në Shpirtin, o profet »Abakum, mishërimin e Fjalës, pre»dikoje duke thirrur: Në afrimin e »viteve do të bëhesh i njohur, në pra»ninë e kohës do të dallohesh; lavdi »fuqisë sate, o Zot.

O Virgjëreshë e Tërëshenjtë, tendë e panjollshme,[47] më pastro tani mua që u molepsa nga shkelje, me pikat tepër të pastra të dhembshurive të tua, dhe më jep dorë ndihmeje që të thërras: Lavdi ty, o e kulluar, e hyjlavdëruar.

U paraqite tempull i shenjtëruar i Perëndisë,[44] i cili banoi brenda teje përmbi mendje, o Virgjëreshë; i lyp atij që të na pastrojë nga njollë mëkatesh, që të njihemi si shtëpi dhe banesë e Shpirtit.

Mëshiromë ti, Perëndilindëse, e vetmja që linde burimin e mëshirës, dhe zgjidh sëmundjen e vështirë të shpirtit tim dhe ngurtësinë e zemrës, duke dhuruar para fundit me ndërmjetimet e tua rrëke lotësh dhe kataniks të hyjnueshëm.

Pasi kuptoi profeti në Shpirt Perëndie, të parashkroi ty mal hijeplotë,[48] o e kulluar, sepse ata që u shkrinë në flakë krimesh, i pastron plotësisht me ndërmjetimet e tua, o Virgjëreshë, rimëkëmbja e vetme e njerëzve.

E apostullit: Oros se ti háriti ti thia

Fuqia e hyjnueshme e Shpirtit gjithëbërës dhe të shkëlqyeshëm, që asgjëson të keqen, pasi banoi brenda teje, o Andrea, hyjnisht në formë gjuhe të zjarrtë,[26] të tregoi predikues të të pathënave.

Nuk ngriti armë mishore për mbrojtje dhe për rrëzimin e fortifikimeve të trembshme të armikut Andrea i tërënderuar, por kur u armatos me Krishtin,[49] pasi i robëroi, i ka sjellë kombet të bindur.

Mos ndërprit me ndërmjetimet e tua, o Andrea i tërëpasur, të mbushësh me rrjedhë ngazëllimi shpirtëror nga dhurata e bollshme e Mësuesit tënd Krisht, ata që bëjnë me përgjërim e me këngë kujtimin tënd.

Hyjlindësore

Himnojmë misterin tënd të madh dhe

të frikshëm, sepse pasi shpëtoi nga brigada përmbibotërore, ai që ekziston[50] ka zbritur mbi ty si shi mbi shtëllungë,[51] o e tërëhimnuar, për shpëtimin dhe rigatimin tonë.

Tjetri: En Pnévmati provlepon

Pasi hodhe poshtë rrjetat e tua dhe ngrite kryqin, ndoqe në udhë Krishtin,[52] i cili ftonte; dhe pasi e shtrive rrjetën e Shpirtit, në vend të peshqve zë njerëzit; lavdi Shpirtit që u dha tek ti.

Meqenëse u shtua tek ti përmes gjuhës flaka e Shpirtit,[26] u bëre, o apostull, burrë i hyjzënë; lëviz në bukuritë e qielloreve dhe mëson bukuritë mendore që janë në to, duke i zbuluar ato tek ne.

Shkretëtirën që kishte etje[53] e ujite, o i urtë, me fjalët e tua të perëndishme, dhe e tregove atë të lindë mjaft fëmijë[54] të Kishës, të cilët japin si fryte farën e predikimit;[55] lavdi Shpirtit që u dha tek ti.

O Jisu, Andrea, kur pa i pari bukurinë tënde të pashprehshme, i thirri vëllait shkëlqyeshëm: Vëlla Petro, kemi gjetur Mesian, i cili u predikua në Ligjin dhe në profetët; eja që t'i ngjitemi jetës së vërtetë.

Lavdi

Le ta himnojmë, o besnikë, Trininë në Njësi, në një Hyjni, Atin dhe Birin dhe Shpirtin hyjnor, një substancë dhe natyrë pa ndarje, pa shkëputje, pa veçim, se një është Perëndia në trini personash.

Tani

Pasi zure pashprehshëm në bark njërin e Trinisë, e ke lindur pa prishje si Bir; dhe Trinia nuk kishte aspak shtesë, ndërsa pastërtia, siç ishe edhe para lindjes, mbeti e pacenuar, o Hyjnënë.

Zbritësore: Ravdhos ek tis rizis

Shkop nga rrënja e Jeseut

Ode V

E Hyjlindëses

Irmosi: Tin sin irinin dhos imín

»Jepna paqen tënde, o Bir i Perë»ndisë,[56] sepse veç teje Perëndi tjetër »nuk dimë, emrin tënd thërrasim,[57] »sepse je Perëndi i të gjallëve dhe i »të vdekurve.

Bebëzat e zemrës sime hapi, o e kulluar, që ta shoh fuqishëm shkëlqimin e hyjnueshëm dhe lavdinë tënde të pashprehshme, që të fitoj përdëllimin dhe lavdinë e pasosur.

Në dy vullnete ke lindur, o e tërëpa-

cenuar, njërin e Trinisë, duke sjellë një hipostazë; atij lutju gjerësisht që të shpëtojmë ne të gjithë.

O e tërëpacenuar, meqë linde Shpëtimtar dhe Perëndi, ndërmjeto që të ruhem i paprekur unë, shërbëtori yt i padobishëm,[58] nga çdo lëndim, sëmundje dhe mundim.

Përgjëroju atij që linde përmbi mendje, o Virgjëreshë, që të shpëtohen ata që të thërresin me besë: Gëzohu, o Virgjëreshë e tërëpaqortueshme, e vetmja e bekuar, mbrojtje e botës.

E apostullit: O fotisas ti elampsi

E more atë që dëshiroje përzemërsisht, o Andrea apostull, pasi u vendose së bashku me të në tenda të paprishshme dhe pasi mblodhe denjësisht duajt e dhimbjeve[59] të tua; prandaj të lavdërojmë me himne.

E dëshirove thellësisht Zotin dhe e ndoqe me zell i udhëzuar në gjurmët e tij[60] drejt jetës dhe duke imituar pa gënjeshtër deri në vdekje pësimet e tij, o Andrea i gjithënderuar.

Pasi të tendosi si shigjetë të fortë,[61] o i lum, të lëshoi në gjithë botën Zoti, duke plagosur demonë dhe duke shëruar njerëzit e plagosur prej besimi të rremë.

Hyjlindësore

Dëfrehen fuqitë e qiejve duke të parë ty; ngazëllohen tok me to edhe sistemet e njerëzve, sepse me lindjen tënde u bashkuan, o Perëndilindëse e virgjër, duke të lavdëruar siç ka hije.

Tjetri: Katávgason imón

Meqenëse e dëshirove tepër kryqin e Krishtit, o nxënës, fitove me kryqin tënd mbretërinë e pacenuar, të cilën do ta trashëgojë tek ju, tek theologët e tij, ai që tërhoqi me kryq të gjithë njohësit e mistereve.

Kërkove Krishtin, jetën e vërtetë,[62] dhe pasi e kërkove i pari e gjete, dhe sapo e gjete mistikisht, e rroke dhe e more atë tek vetë dhënësi, dhe je bërë thesar jete të pamposhtur.

Fjalët e bubullimave të tua të përëndishme, jehuan nëpër botë dhe erdhën nga një anë në anën tjetër të tokës,[45] se u rrethuan pikërisht si rrotë dhe ndriçuan vetëtimat e tua, siç thotë Davidi,[63] në planet.

Kujtona, o nxënës i Krishtit, ne që bëjmë kujtimin tënd dhe nderojmë lipsanet e tua; lutu përherë gjerësisht për grigjën tënde, roje dhe shpëtim i së cilës je bërë që nga fillimi.

Lavdi

Le të lavdërojmë, o besnikë, me një zë, me theologji pa pushim Atin e Birin e Shpirtin, Perëndinë, Triadhën e pandarë, mbretërinë trihipostate duke e himnuar besërisht.

Tani

Linde dritën duke mos ditur si, ti, kandili i tërëshndritshëm i diellit, o llambadheprurëse, dhe je bërë enë e re drite jolëndore, që buron për gjithë dheun llamburitje hyjdijeje.

Zbritësore: Theós on irinis

O Zoti i paqes

Ode VI
E Hyjlindëses
Irmosi: Ton profitin Ionán

»Imitoj Jonan' profetin, thërras pra: »O i Mir',* jetën time ti çliroje nga pri- »shje dhe shpëtomë; unë th'rras:* »Lavdi ty, shpëtimtari i botës son'.

Të lyp ty, e mir' vërtet je dhe tenda[18] e panjoll',* përmes ndërmjetimit tënd më pastro nga çdo ndyr'si, se jam i pist'* prej shum' mëkatesh, larje pra un' kërkoj.

Bëhu kapiteni im, se lundroj gjithmon' në det* vështir'sish, në shumë ngasje të jetës, dhe shpëtomë, më drejto* në gji, liman shpëtimi, Hyjlindëse.

Fatkeq'si pasionesh edhe furtuna mendimesh,* dhe mëkate pa fund e dimërojnë shpirtin tim të gjor', o Zonj',* ndaj më ndihmo, Mari e Tër'shenjtë ti.

Madhështime të ka bërë ty Krishti[64] yn' përher';* atij lutju përgjithnjë, që të bëjë madhështime tek unë* me përdëllimin e pasur[65] që ka, o Zonj'.

E apostullit: Ekíklosen imás

Përshkoje detin jetësor me trupin tënd* si me anije, kur e pe,* gjete kapitenin, Krishtin, që Gjith'sin'* e tër'* qeveris, o i tër'lumur shenjt,* dhe tek ai me ngazëllim, o Andrea, je sjell' ti.

Me fjal' dëbohen frym'rat, arratisen krejt* sëmundjet, dhe largohet shpejt* banda e pasioneve të shpirtrave* larg nga* të sëmurët[66] falë hirit tënd,* që, o Andrea, është dhënë prej Perëndis' tek ti.

Si val' e butë që lëvizet nga një frym'*[67] e lehtë, thave, o i lum',* detet e politeizmit dredharak* me rrjedh'* të hyjnueshme; për ne të gjith'* burove dhe lumenj hyjdije,[68] apostull hyjmendës.

Hyjlindësore

Dëfrehen, o Hyjlind'se e pacen, në ty* të gjithë paraetërit* e gjinis' son, se Edenin që ata* humbën* përmes shkeljes, e kan' marr' më ty,* se para lindjes dhe pas lindjes ti je e d'lirë krejt.

Tjetri: Ton profitin Ionán

Na mbledh ne që të kremtojm' panairin e tij bashk'* sot ai që kish prejardhje nga Bethsaida, madje vë para nesh* arritjet, mundjet, çmimin e tij të lart'.

Peshkatari në zanat edhe nxënësi në bes'* hulumton gjith' zemrat e besimtarëve thell' në fund, dhe hedh posht'* grep fjale dhe na kap, na tërheq mjesht'risht.

Duke sjellë rrotull zjarr dashurie të Krishtit,* që në zemër kishe, nxënës, u thirre kombeve: Vërtet, tani* u shua flaka juaj, u duk Krishti.

O të shijshëm në mendim falë kripës[69] së Krishtit,* gjellët tuaja na kan' ëmbëlsuar dogmat e shijimit ton'* të pacenuar dhe qiellor përher'.

Lavdi

Atit, Birit edhe Shpirtit të drejtë, ne të gjith'* besimtarët le t'u falemi, një natyr' trihipostate dhe* pa ndarje, duke thirrur: Lavdi Trinis'.

Tani

Biri që u mishërua krejt brenda barkut tënd,* e kulluar, me mir'dashjen e Atit përmes Shpirtit, o Hyjnën',* shpëtoi qart' ikonën e mëparshme.[70]

Zbritësore: Splahnon Ionán

Si profeti shën Jona

Kontaqi
Ting. II
Tin en presvies

Hyjfolësin që kish emrin e burrërisë,* të parëthirrurin e nxënësve të Zotit,* v'llain e Petros, le ta lëvdojm' të gjith',* se siç kish bër' qëmoti me të, thërret tani tek ne:* E gjetëm[6] atë që donim, ejani.

Shtëpia

Nga fillimi Davidi pengon me të drejtë një mëkatar si unë që të tregoj të drejtat e Perëndisë;[71] por na mëson për besë përsëri dhe me shumicë lotësh rrëfen: Se sot, nëse do të dëgjoni zërin e tij, mos i ngurtësoni zemrat, si dikur Izraeli hidhëroi së tepërmi.[72] Prandaj shton si më poshtë në Psalmin: I këndoni Zotit e gjithë toka:[73] E gjetëm[6] atë që donim, ejani.

Sinaksari

Më 30 të të njëjtit muaj, kujtimi i apostullit të shenjtë, të lavdëruar dhe të tërëfamshëm Andrea i Parëthirrur.
Vargje: Duron Andrea kryqëzim të mbrapshtë,/ pasi u duk antipod i pahije.
Vuajti Andrea kryq me kokë poshtë më 30.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Frumenti, episkopi i Indisë.
Vargje: Duke u ruajtur nga Hiri i Triadhës së respektueshme,/ Frumenti e tregoi mashtrimin kotësi.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
E Hyjlindëses
Irmosi: Tus en kamino pedhas su

»Djemtë e tu në furrë, o Shpëtimtar, »nuk i preku as nuk i shqetësoi zjarri; »atëherë të tre si me një gojë him»nonin dhe bekonin duke thënë: I »bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Shpirtin e ndotur të shërbëtorit tënd, o e kulluar, e papërlyer, shenjtëroje përgjithmonë dhe zhduk shpejt rrobëri të ankthshme të mendjes, ngurtësi të zemrës dhe vrulle demonësh.

Mendjen time të vdekur nga pasione mishi, o e tërëpaqortueshme, gjallëroje dhe forcomë që të bëj të pëlqyeshmet tek Perëndia,[74] që të të madhështoj e të lavdëroj përherë mirësinë tënde.

M'i vrit, o Zonjë e pastër, pasionet e mishit, dhe duke fshirë ndyrësinë e frikshme të shpirtit tim të ulët, o Virgjëreshë, shpëtomë dhe çliromë nga hetimi i armiqve të padukshëm.

Para teje biem, o e dëlirë, e papikëluar, ne shërbëtorët e tu natë e ditë gjithmonë me mendje të dërrmuar, duke përgjëruar që të gjejmë zgjidhje mëkatesh me lutjet e tua.

E apostullit: Se noitín Theotoqe

Premtimi yt i pagënjeshtërt[75] u përmbush, o Krisht, sepse nxënësi yt tepër i perëndishëm, duke qortuar me fjalë furtunën, e ndryshoi në butësi[76] ngazëlluese duke kënduar: Je Perëndia i himnuar dhe i përmbilavdëruar.

I urdhëruar, o apostull, të shkosh tek mali mendor i Sionit, pasi ke marrë me hare potirin e shpëtimit,[77] ece duke kaluar përmes vdekjes[78] drejt jetës së hyjshme, ku është Krishti, Perëndia i përmbilavdëruar dhe i të gjithave.

Ti, o apostull, megjithëse ke qenë i dhélindur, bën çudi përmbinatyrshëm, sepse duke u përzier nëpërmjet dashurisë me Krishtin, i cili të deshi, e ndoqe duke kënduar: Je Perëndia i himnuar dhe i përmbilavdëruar.

Hyjlindësore

Gëzohu, o modeste, lëkurë deleje e Adamit, nga doli Bariu[79] i përmbilartësuar, pasi më veshi me të vërtetë mua,[80] njeriun e tërë; në barkun tënd më rigatoi, Perëndia i himnuar dhe i përmbilavdëruar i etërve.

Tjetri: Tus en kamino pedhas su

Pasi tërhoqe nga lart zjarrin e Shpirtit të Tërëshenjtë,[26] o apostull i Krishtit, u urdhërove që të flasësh me gjuhë të reja,[81] të cilat nuk i fole më parë askund, dhe tani të lëçitësh madhështimet e tij[82] anembanë botës.

E habit çdo mendje së tepërmi predikimi që trumbetuat mbi dhé, o hyjnjohës të Krishtit dhe shikues të të lartave, sepse duke qenë vetëm dymbëdhjetë, ndriçuat fort mijëra dhe mijëra mbi dhé.

U bë i çuditshëm, o Zoti Krisht, Hiri yt ndër nxënësit e hyjurtë, se, ndonëse ishin të vegjël dhe të thjeshtë,[83] përshkuan të gjithë tokën nga njëri cep tek tjetri.[45]

Ç'të mësoi që të flasësh kështu, o apostull? Ç'e shkëlqeu mendjen që të shohësh fuqishëm vezullimin e lavdisë së paafrueshme, i cili llamburiti shndritjen e së vërtetës në zemrat tona?[84]

Lavdi

Le të himnojmë, o besnikë, në mënyrë trinisore, duke lavdëruar Atin e pafillim dhe Birin, Shpirtin e drejtë, një esencë unike, të cilën le ta himnojmë trefish: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë[85] je në jetët. Amin.

Tani

Të lavdërojmë, o Krisht, si njërin e Trinisë, sepse pasi u mishërove prej Virgjëreshe pa ndryshim, i durove të gjitha njerëzisht, duke mos u shkëputur nga natyra atërore, o Jisu, edhe pse u bashkove me ne.

Zbritësore: I pedhes efsevia

Tre Djemat që u rritën besëmirë

Ode VIII
E Hyjlindëses
Irmosi: On frítusin ángeli

»Atë që e kanë frikë engjëj dhe të »gjithë ushtritë si Ndërtuesin dhe »Zotin, himnojeni, o priftërinj, lavdë»rojeni, o djem, bekojeni, o popuj dhe »e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Mishërohet i pamish prej teje siç i ka hije hyjnisht; nga ai kërko, o e tërëdëlirë, që të vrasë pasionet e shpirtit tim dhe që ta gjallërojë atë që vdiq qëmoti nga mëkat i keq së tepërmi.

Mjekove dërrmimin e Adamit nga balta, meqenëse kishe në shtatzëni Perëndi shpëtimtar, o e tërëpacenuar; i lyp atij që të shërojë plagët e shpirtit tim, që sëmuret pa gjetur shërim.

Ngrimë mua të shtrirë në thellësitë e të këqijave; lufto armiqtë që tani më luftojnë; mos më shpërfill mua që u plagosa në shpirt me kënaqësi pa vend, o e kulluar, por më dhembshuro dhe më shpëto.

Shëro, o e papërlyer, pasionet e zemrës sime, meqenëse kishe në bark mjekun e të gjithëve, dhe tregomë pjesëtar në pjesën e të drejtëve, duke i lypur Krishtit.

E apostullit: En kamino pedhes

Kujtimi yt i perëdishëm, dritëprurës dhe dëfryes, o Andrea, apostull i Krishtit, tani na ndriçoi me rreze shërimesh ne që thërrasim: Të gjithë veprat e Zotit, Zotin e himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Megjithëse të rastisi natyrë njerëzore, kapërceve kushtet e saj dhe ke shkuar drejt tendës së engjëjve, o Andrea apostull, dhe thërret: Të gjithë veprat e Zotit, Zotin e himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Fryma e Shpirtit Perëndi nga lart, pasi të flakësoi,[26] të tregon orator hyjfolës të ngrohtë ty, o apostull, që i thërret Krishtit tënd: Të gjithë veprat e Zotit, Zotin e himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Dole dritëdhënës pikërisht si vetëtimë në dritë kombesh[86] duke shporrur errësirën e padijes dhe duke llamburitur besnikët që thërrasin: Të gjithë veprat e Zotit, Zotin e himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Atë që lindi pa farë dhe përmbinatyrshëm nga vetëtima hyjnore, margaritarin e çmuar,[39] Krishtin, le ta himnojmë të gjithë duke thirrur: Të gjithë veprat e Zotit, Zotin e himnoni dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Tjetri: Ton en Siná ti vato

Me mjeshtërinë e peshkimit nxore nga deti peshq, o i tërëurtë, por tani me besë zë në rrjetë nga mashtrimi i armikut njerëz në Krishtin, sepse mashtrimi qëmoti ishte pa fund, duke i mbytur kombet në turbullimin e padijes.

Oqeanin mendor të jetës e lundrove pa dallgë, o apostull, pasi ngrite velin e Shpirtit me besimin e Krishtit, prandaj dhe arrite në liman jete i gëzuar në gjithë jetët.

Meqë dielli mendor perëndoi mbi dru me vetë vullnetin e tij, i shkëlqyer nga dielli, Andrea ndriçues i madh i Kishës, duke kërkuar që të ikë bashkë me të përmes vdekjes dhe që të perëndojë më Krishtin,[87] u var në dru kryqi.

O nxënës dhe mik i Krishtit, i zgjedhur bashkë me apostujt e tij, kur do të ulet Gjykatësi në fron tok me ju të dymbëdhjetë që të gjykojë, siç thotë premtimi,[88] le të bëheni për ne atëherë mur njeridashjeje.

Lavdi

Le ta lavdërojmë Njësinë e tridritëshme dhe Trininë e bashkëfronshme, duke mos e ndarë, por duke e bashkuar atë bashkënatyrshëm, si një esencë vërtet të bashkuar në tre persona, që nuk ngatërrohet.

Tani

Pasi zure njërin e Trinisë, u lind i mishëruar prej teje ripërtëritësi i ligjeve të natyrës me lindjen tënde, o e kulluar; mos pusho së lypuri për ne gjithmonë atë si Perëndi, o Hyjlindëse.

Zbritësore: Thávmatos iperfiús

Furra vesëplotë

Ode IX
E Hyjlindëses
Irmosi: Tin fotoforon nefelin

»**T**ë madhështojnë të gjithë* si »nënën e Perëndis' ton',* të d'lirën, »renë dritëmbajt'se,[89] ku Zoti i Gjithë»sis'* si shi nga qielli mbi lëmshin »zbriti,[51] edhe u mishërua krejt,* dhe »u bë k'shtu njeri pa nisje kurrë,* »edhe na shpëtoi ne.

Jetoj me indiferencë,* se mik mëkati jam unë,* o e kulluar, dhe e kam frik' gjykimin që s'merr ryshfet;* atje më ruaj pa dënim nëpërmjet ndërmjetimit tënd të shenjt', Hyjnën',* që si mbrojtësen time përgjithmonë* unë të të lumëroj.

Un' e kam frik' podiumin,* o Virgjëreshë, dhe syrin* e pagabueshëm të Birit tënd, se kreva vepra* të turpshme mbi dhé, ndaj thërras tek ti: O Zonj' e tër'dhembshur, më ndihmo,* pra at'herë çliromë nga nevoja,*[90] më shpëto, o e dëlir'.

Oh, sa e frikshme do jetë* ajo dit' e hulumtimit,* po aq i frikshëm dhe vendimi, i rënd' turpi, o Vajz',* kush do durojë? Por, o Nënë, Zonj' e tër'papërlyer, mëshiro* shpirtin tim edhe

para fundit jepmë* mua falje dhe shpëtim.

Vajz', linde dritën hyjnore;* ndriçomë, se jam i turbullt,* në errësir', në mes të sulmit e luftimit djall'zor,* se jam në çdo të keqe; Perëndinë e zemëroj, ndriçomë pra* dhe drejtomë në vepra të dobishme;* shkaku je për çdo të mir'.

E apostullit: Tipon tis agnís

Porsi* nxënës i shkëlqyeshëm* i Krishtit që u lidh me kryqin vullnetarisht,* e ndoqe atë,* pra Zotin deri në vdekje,[91] dhe* me gëzim përmbi kryqin u ngjite lart,* duke bër' udhëtimin* drejt qiejve, apostull shum' i lum.

U hap* porta e Edenit[11] krejt* dhe shkalla qiellore[22] për ty u shtua pas;* k'shtu tenda në q'ell*[92] të priten edhe qëndron me gaz,* o apostull, pran' Krishtit jet'dhënësit,* si ndërmjetues i mir'* dhe i shkëlqyeshëm për botën ton'.

Lum ti,* o Andrea shum' i urt',* u lavdërove me pësimin e barabart',* me kryqin zot'ror,* se pate fund të hyjnueshëm* me kryq edhe u bëre si Perëndi* ti me kungim, pjes'marrje; ndaj* lypim, lutu përgjithmon' për ne.

G'zohu,* çift i tër'shkëlqyeshëm,* që ke fituar jet' në qiej[93] me gaz tani,* nga lart ku je ti* pafsh mallin e përhimnuesve,* që ësht' më i fort' se forca që k'ta kan',* dhe na ndriço me shndritje* karizmash, çmimesh të hyjnueshme.

Hyjlindësore

Nga rrënj'* profetike, Virgjëresh',* pra nga Davidi hyjat', u lulëzove[94] ti;* Davidin ndërkaq* e ke lëvduar vërtet, sepse* linde Krishtin të profetizuarin,* Zotin e gjith' lavdisë,*[95] të cilin lavdërojmë denjësisht.

Tjetri: Tin fotoforon nefelin

Ti që e shtrive gjith' rrjetën* e teorisë mistike* dhe në atë si peshq ke zën' bukurit' e mendimeve* tër'qiellore, lutju nxeht' Trinisë së Tër'shenjtë, Zotit ton',* o i shenjt', të burojë për ne ndjesë* dhe të jet' me ne i but'.

Ne kombet falënderojmë,* që u ndriçuam prej teje* dhe që nga toka përmes teje u ngjitëm në qiejtë,* se adhurimin e armikut e shmangëm edhe jemi tash pjestar'* engjëjsh shumë të shenjt'; jemi pjesmarrës* të lavdis'[96] së Zotit ton'.[95]

Apostuj dhe shërbëtorë,* gjith' dëshmitarët e Fjalës,* të gjërave që jan' të fshehta, o njohës, udh'zues t'shenjt',* shikues gjërash të pagjurmësuara, lutuni të bëhemi* trash'-gimtarë me ju të mbretërisë*[97] dhe pjes'marrës të Hyjnis'.

Meqë e morët pushtetin* nga Krishti yn', që të lidhni* dhe që të zgjidhni,[98] na çlironi të gjith' nga vargonjt' e rënd'* të krimeve të shumta, se do vij Krishti dhe të dymbëdhjetë ju* mbi kaq frone do uleni për gjyqin* e çdo fisi hebraik.[88]

Lavdi

Natyrën trihipostate* edhe lavdin' e pandarë,* që përhimnohet pa pushim përmbi tokën dhe qiellin*[85] në një Hyjni, Trinin' që s'ndahet kurrë, ne le ta lavdërojm' Atin* bashk' me Birin dhe Shpirtin, dhe atyre* le t'u falemi me bes'.

Tani

Sa po përikin me besë* nën dhembshurin' tënde, edhe* i falen me devotshmëri Birit tënd, o e virgjër Vajz'* hyjnën', si Perëndis' së botës, Zotit, me lutjen tënde ti kërko* të çlirohen nga prishje dhe rreziqe,* nga gjithfarë ngasjesh, Zonj'.

Zbritësore: Mistírion ksenon

O shpirt madhështoje

dhe

Mister të çuditshëm

Dërgimësore
En Pnévmati to ieró

Kur ty të gjeti, o i lum,* Fjala para çdo nisje,* të parëthirrur të ka bër'* nga të gjithë apostujt,* Andrea i tër'kënduar,* edhe shkove pas asaj,* ia ndoqe gjurmët ti;[60] je bër'* udhëzues për sa jan'* në mashtrim dhe i drejton* në udh' të hyjshme, për qiell.

Tjetër: Jinekes akutísthite

Të parin e dishepujve,* që kish një gjak me Petron bashk',* dhe shërbëtorin okular* të Fjalës, Andrean nxënës,* le ta lëvdojmë madhërisht,* se ndriçoi gjith' kombet*[86] dhe përfundoi në kryq'zim* porsi apostull i Zotit,* i Krishtit ton' jetëdhënës.

Hyjlindësore

Iu lut ti Perëndisë ton'* që linde, Virgjëresh' e d'lir',* se ke fuqi për sa do ti,* për sa të nderojn' me besë,* lyp bashkë me apostullin* e lëvduar shum', që të gjejn'* dhe të fitojn' ndriçim të shenjt'* nga Biri yt, të bashkohen* tok me shenjtorët e zgjedhur.

Lavdërime
Ting. I
Ton uranion tagmaton

O Bethsaid', ngazëllohu, se lulëzove ti* zambakë erëmirë* prej livadhi mistik krejt,* Petron dhe Andrean; ata lëshojn'* në të gjith' botën er' të mir',* pra predikim[99] bese me hir të Krishtit ton',* imituan dhe pësim të tij.

Kërce Andrea, gëzohu, se e pranove qart'* kur feksi Fjala plot nur* diellin e lavdisë,* Krishtin jetëdhënës, të cilin ti* mbajte dhe predikove gjat'* me bes'; atij lutju, pra pa pushim për ne,* që me shpirt të përhimnojmë ty.

Thot' se Andrea, hyjfolësi i ekonomis'* hyjnore të Jisuit,* hyjshikues, i pari* që u zgjodh si nxënës i Zotit ton',* kur e pa Petron, v'llan' e tij,* thërriste: Gjetëm Mesian,[6] që çdo profet,* Shkrimi gjith' e predikuan fort.

Të ka qyteti i Patrës si mbrojtës shum' të shenjt',* bariun, çlirimtarin* në rreziqe të ndryshme,* si dhe rojen, o Andrea i urt',* me gëzim të nderon pra ty;* tani iu lut pa pushim, që ai gjithmon'* të mir'ruhet i paprekshëm krejt.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Predikuesin e besimit dhe shërbesin e Fjalës,[13a] Andrean le ta lavdërojmë, sepse ai peshkon njerëz nga fundi, duke mbajtur në duar në vend të kallamit kryqin, dhe duke hedhur si fije fuqinë, i rikthen shpirtrat nga mashtrimi i armikut dhe i blaton Perëndisë dhuratë të mirëpritur; gjithmonë, o besnikë, atë bashkë me korin e nxënësve të Krishtit le ta lavdërojmë, të ndërmjetojë që të bëhet për ne i butë në ditën e Gjykimit.

Tani *I njëjti*

Mikprit, o Bethlehem, metropolin e Perëndisë, sepse vjen tek ti për të lindur dritën e paperëndueshme. O engjëj, çudituni në qiell; o njerëz, lavdëroni mbi tokë; o Magë nga Persia, blatoni dhuratën tri herë të lavdëruar; o barinj në ara, këndoni melodikisht himnin trishenjtor;[85] çdo frymë le ta himnojë Gjithëbërësin.[100]

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket, dhe nga Kanuni i parë i apostullit Ode III dhe nga Kanuni i dytë Ode VI.
Kungatore: Në gjithë dheun.

CITIME

[1] Joan 1.35,41

[2] Urt. Sol. 7.26; Hebr. 1.3

[3] Joan 1.29,36

[4] Joan 1.14

[5] Eks. 22.29; 35.5

[6] Joan 1.42

[7] Lluk. 1.7,36

[8] Ps. 83(84).6

[9] II Kor. 3.18

[10] Eks. 3.2-5

[11] Gjen. 3.24

[12] Vep. 14.15; 15.3,19; 26.20

[13] Ps. 41(42).2;

[13a] I Kor. 4.1

[14] Ps. 18(19).2

[15] Abak. 3.15

[16] IV[II] Mbret. 2.20-22

[17] Rom. 1.22; I Kor. 1.20

[18] Num. kap. 2; Ps. 131(132).5; Hebr. 9.2

[19] Kol. 2.2; II Petr. 2.20

[19a] Eks. 6.1 etj.

[20] Ef. 4.18

[21] Ps. 83(84).8

[22] Gjen. 28.12-17

[23] Eks. 16.33; Hebr. 9.4

[24] Eks. 25.30,37; 35.16; 38.13-17; 40.22; Num. 4.9; 8.2

[25] Dan. 2.34-35

[26] Vep. 2.3-4

[27] I Kor. 12.4

[28] Ef. 2.14

[29] Ps. 135(136).6

[30] Lluk. 1.42

[31] Gjen. 3.6

[32] Joan 1.39-41

[33] Joan 1.42

[34] Matth. 11.10

[35] Matth. 3.3; Mark. 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23

[36] Rom. 8.3

[37] Lluk. 1.35

[37a] Eks. 3.1-2

[38] Joan 3.5

[39] Matth. 13.45-46

[40] Joan 1.29

[41] I Tim. 2.7; II Tim. 1.11

[42] Is. 6.1; Jez. 1.13-26; 10.1-2; Dan. kap. 3 Lutja e Azariut 32

[43] Ps. 18(19).5

[44] Kënga 3.7

[45] Jez. 44.1-4

[46] Eks. 25.29; 39.18; 40.21; Lev. 24.6; Hebr. 9.4

[47] Ps. 45(46).5; 131(132).5; Hebr. 9.2

[48] Abak. 3.3

[49] II Kor. 10.4

[50] Eks. 3.14

[51] Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6

[52] Matth. 16.24; Mark. 8.34; Lluk. 9.23

[53] Is. 35.1

[54] Is. 54.1; Gal. 4.27

[55] Lluk. 8.5

[56] Joan 14.27

[57] Is. 26.13

[58] Matth. 25.30; Lluk. 17.10

[59] Ps. 125(126).5-6; 127(128).2

[60] I Petr. 2.21

[61] Ps. 119(120).4

[62] Joan 1.4; 11.25; 14.6; I Joan 1.1-2; 5.11-12,20

[63] Ps. 76(77).19; 96(97).4

[64] Lluk. 1.49

[65] Ef. 2.4

[66] Matth. 10.8; Mark. 3.15; 16.17; Lluk. 10.17

[67] I Petr. 3.4

[68] Joan 7.38

[69] Kol. 4.6

[70] Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3

[71] Ps. 49(50).16

[72] Ps. 94(95).8; Hebr. 3.15

[73] I Kron. 16.23; Ps. 95(96).1

[74] I Joan 3.22

[75] Joan 14.12

[76] Mark. 4.39

[77] Ps. 115(116).4

[78] Matth. 20.23; Mark. 10.39

[79] Joan 10.11

[80] Gal. 3.27

[81] Mark. 16.17

[82] Vep. 2.11

[83] Vep. 4.13; II Kor. 11.6

[84] II Kor. 4.6

[85] Is. 6.3

[86] Is. 49.6; Vep. 13.47

[87] Fil. 1.23

[88] Matth. 19.28; Lluk. 22.30

[89] Eks. 19.9; 34.5; Num. 11.25; Ligji i Dytë 31.15

[90] Jov 5.19; Ps. 24(25).17; 106(107).13,19

[91] Fil. 2.8

[92] Lluk. 16.9

[93] Fil. 3.20

[94] Is. 11.1; Rom. 15.12; Apok. 5.5; 22.16

[95] I Kor. 2.8

[96] I Petr. 5.1

[97] Jak. 2.5

[98] Joan 20.23

[99] II Kor. 2.15-17

[100] Ps. 150.6

Përmbajtja

Parathënie. 3

MUAJI SHTATOR

1 Shtator

Fillimi i Indiktit, d.m.th i Vitit të Ri dhe kujtimi i atit tonë oshënar Simeon stilitit dhe arkimandrit; Mbledhja e Hyjlindëses së Tërëshenjtë të Miasinëve; kujtimi i martirit të shenjtë Aithalá; i dyzet grave të shenjta dhe i Amun dhjakut, mësuesi i tyre; i martirëve të shenjtë Kalista dhe i vëllezërve të saj Evodhit dhe Ermogjenit; i Jisuit të Naviut si dhe kujtimi i zjarrit të madh. 9

5 Shtator

Kujtimi i profetit të shenjtë Zaharia, i ati i Pararendësit. 34

6 Shtator

Kujtimi i çudisë që u bë në Kolasét, d.m.th.
në Honet nga kryeengjëlli Mihail. 43

8 Shtator

Lindja e Hyjlindëses së Tërëshenjtë dhe Virgjëreshës Mari. 62

9 Shtator

Kujtimi i Hyjprindërve të shenjtë dhe të drejtë Joakimit dhe Anës;
dhe kujtimi i martirit të shenjtë Sevirian. 82

13 Shtator

Kujtimi i Shenjtërimit të Ngjalljes së shenjtë të Krishtit tonë
dhe e Parakremtja e Kryqit të çmuar dhe jetëbërës,
dhe i martirit të shenjtë Kornel Kryeqindëshit. 95

14 Shtator

Lartësimi mbarëbotëror i Kryqit të çmuar dhe jetëbërës. 116

17 Shtator
Kujtimi i martireve të shenjta Pistit (Besës), Agapit (Dashurisë) dhe Elpisës (Shpresës), dhe të nënës së tyre Sofisë (Urtësisë). 136

23 Shtator
Zënia e të nderuarit, të lavdëruarit profet, Pararendësit dhe Pagëzorit Joan. 152

26 Shtator
Shpërngulja e apostullit të shenjtë, të lavdëruar dhe ungjillor Joan Theologut. 163

29 Shtator
Kujtim i atit tonë oshënar Qiriako Anakoretit. 186

MUAJI TETOR

3 Tetor
Kujtim i hieromartirit të shenjtë Dhionis Areopajitit. 196

11 Tetor
Të dielën pas datës 10 tetor (11-17) Kujtimi i Etërve të Shenjtë të Sinodit të VII Ekumenik. 207

18 Tetor
Kujtimi i apostullit të shenjtë dhe ungjillorit Lluka. 219

23 Tetor
Kujtimi i Jakovit, vëlla i Perëndisë, apostull dhe hieromartir. 231

26 Tetor
Kujtimi i martirit të madh të shenjtë Dhimitër Mirovlitit dhe kujtimi i tërmetit. 240

MUAJI NËNTOR

1 Nëntor
Kujtimi i Anargjendëve të shenjtë Kozma dhe Damian. 265

8 Nëntor
Mbledhja e kryeengjëjve Mihail dhe Gabriel dhe të Fuqive të tjera të patrup. 282

9 Nëntor

Kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Nektar në Egjina, mitropolit i Pentapojës, dhe të nënave tona oshënare Matrona dhe Theoktista. 306

11 Nëntor

Kujtimi i martirëve të shenjtë Minait, Viktorit dhe Vikentit, edhe i martires së shenjtë Stefania; edhe i atit tone oshënar dhe omologjet Theodhor Studiti. . . . 327

12 Nëntor

Kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Joan Përdëllimtarit, edhe i atit tonë oshënar Nil Mirovlitit. 343

13 Nëntor

Kujtimi i atit tonë ndër shenjtorët Joan Gojartit, kryepiskop i Konstandinopojës. 360

14 Nëntor

Kujtimi i apostull Filipit. 383

16 Nëntor

Kujtimi i apostullit dhe ungjillorit Matthe. 393

21 Nëntor

Hyrja e Hyjlindëses së Tërëshenjtë në Tempull. 403

25 Nëntor

Mbyllja e së kremtes dhe kujtimi i martires së madhe të shenjtë dhe të tërëurtë Ekaterina, si dhe i martirit të madh të shenjtë Mërkur. 428

30 Nëntor

Kujtimi i apostullit të shenjtë Andrea. 448